

MEHMET KRAJA

IDENTITETI KOSOVAR

(Publicistikë)

PEN Qendra e Kosovës



Prishtinë, 2011

Redaktor: Ali Podrimja
Përgatitja grafike: Valon Fetahu

Copyright (©) Mehmet Kraja

Pen Qendra e Kosovës, Prishtinë

Botimin e ndihmuan:
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës
Departamenti për Arsim dhe Kulturë i Komunës së Prishtinës

PËRMBAJTJA

Parafjalë.....	5
----------------	---

PJESA E PARË: IDENTITETI HISTORIK

Kosova në mendimin politik shqiptar.....	15
Konfuzioni historik.....	35
Identiteti pa shtet.....	58
Dyzimet identitare.....	81
Rikonfigurimi i identitetit.....	117
Nacionalizmi shqiptar në Kosovë.....	146
Bërja jugosllave e kombit kosovar.....	184

PJESA E DYTË: IDENTITETI KULTUROR

Identiteti fetar.....	207
Identiteti gjuhësor.....	254
Trashëgimia kulturore joidentitare.....	290
Kultura, letërsia, artet.....	365

PJESA E TRETË: IDENTITETI POLITIK

Pendesa e thellë e ndërhyrjes.....	365
Beteja e humbur për status.....	398
Kundërthëniet komb-shtet.....	453
Kosovarizma kundrejt shqiptarizmës.....	482

Në mbyllje.....	501
-----------------	-----

PARAFJALË

Në ditët kur u soll nga Tirana dhe u vendos në qendër të Prishtinës shtatorja e Skënderbeut, ende pa u fashitur entuziazmi i kosovarëve, një historian zviceran-austriak tha se ardhja e Skënderbeut në Kosovë ishte një gjest i pastër politik dhe nuk kishte të bënte fare me historinë e kësaj pjese të botës shqiptare. Sipas tij, ky ishte një lloj përvetësimi i një simboli, ose një zhvendosje krejtësisht artificiale e një miti historik nga një hapësirë në tjetrën, sepse Kosovën, sipas tij, nuk e lidhte asgjë me Skënderbeun, as origjina, as bëmat, as luftërat, pra asgjë. Në të vërtetë, atë ditë që u soll në Prishtinë shtatorja e Skënderbeut, ndërsa i shihje kosovarët që u ngritën i madh e i vogël dhe u dyndën ta shoqëronin Heroin Kombëtar në krejt rrugëtimin e tij, nuk kishe si të mos mendoje se në këtë entuziazëm, në këtë eufori masash kishte diçka irracionale, që nuk shpjegohet lehtë me parametra empirikë. Këto parametra bien ndesh me “anën e errët”, të pazbuluar dhe të pashpjegueshme të shpirtit, të frymës, të besimit dhe të një mori përbërësish gati mitologjikë të identitetit. Teoritë mbi kombin dhe identitetin ngatërrohen pikërisht në këtë pikë, në përpjekjen gati të dëshpëruar për të shpjeguar të pashpjegueshmen, nga se kombi dhe identiteti vazhdojnë të qëndrojnë diku në zonën asnjënese, ndërmjet botës materiale dhe jomateriale, ndërmjet racionale dhe irracionale.

Por, derisa këto teori vazhdojnë të mbushin faqe librash, gazetash e revistash dhe derisa shumë njerëzish të planetit

sakrifikojnë rehatinë mendore për të gjetur shpjegime të mbështetura dhe të pranueshme, një shumicë kosovarësh merrte fëmijët e vegjël në krah dhe, me fytyra të qeshura, bënte fotografi para shtatores së Skënderbeut në qendër të Prishtinës. Ndonëse isha i vetëdijsëm se një situatë e këtillë kishte shpjegime kryesisht të pafavorshme për Kosovën dhe për shqiptarët në përgjithësi (popull i vonuar, ringjallje e miteve të mesjetës, eufori nacional-romantike etj.), edhe përkundër të gjithave, ato ditë ndihesha disi i përplotësuar, sikur me magji kisha arritur gati të pamundshmen: paqen me veten dhe me të tjerët. Pra, kisha rënë në grackën e njëjtësimit me turmën, situatë kjo që në përgjithësi përçmohet nga njerëzit që vërtiten në botën e mendimit dhe ideve. Nuk e mohoj, ndoshta do të më kishte hije më shumë një qëndrim disi i rezervuar, në të cilin do të përzihej pak skepticizëm dhe pak modernitet, pak pozë dhe pak mendjemadhësi. Madje, nëse jo publikisht, me vete mund të thosha: Ç'na duhet tani Skënderbeu me shpatë dhe me kalë në mes të Prishtinës? Kujt i shërben ai? Çfarë mesazhesh përçjell ai në fillim të shekullit XXI? Ç'janë këto hije të mesjetës që ende na sillën mbi kokë? Këto pyetje nuk i bëra atëherë dhe nuk i bëj as tani, së paku jo në kontekst të Skënderbeut, vetëm se thënia e historianit zviceran-austriak se Kosovën nuk e lidh asgjë me Gjergj Kastriotin, m'u ngulit në tru dhe më mbeti në mendje për një kohë më të gjatë.

Në të vërtetë, për të dhënë një shpjegim sadopak të vlefshëm, gjërat nuk do parë vetëm në anën e tyre të errët dhe të shëmtuar. Prapavija e thënies së historianit të huaj mund të kishte disa kuptime. E para, se Kosova, duke u bërë shtet më vete, duhet të bëhet edhe komb më vete, jo sipas kuptimit tradicional, por atij modern dhe, që të bëhet komb, duhet të ketë historinë e saj, simbolet e saj, mitet e saj, gjuhën e saj, pra një identitet të mëvetësishëm, që e dallon nga të

tjerët. E dyta, se Kosova është bërë ose mund të bëhet shtet me vendim politik në rrethana të caktuara dhe se ajo nuk ka bazë historike që të jetë e tillë. E treta, se Kosova, në mungesë të një identiteti, nuk mund të jetë shtet i qëndrueshëm, por duhet t'i bashkëngjitet ose Shqipërisë, ose Serbisë. Se këtu nuk kemi të bëjmë me hamendësime të thjeshta, do ta dëshmojnë zhvillimet që erdhën pastaj, ndërkohë që mitologjia mesjetare, me krejt arsenalin e saj, do të vazhdojë t'i sillet Kosovës përreth si një kope ujqish, duke rrezikuar ta shqyejnë të tërën ose ndonjë pjesë të saj.

Nuk e kisha menduar se, në njëfarë mënyre, kështu do të fillonte te ne diskutimi për identitetin, me një transport të një shtatoreje prej bronzi, e cila në pikëpamje artistike kishte mangësitë e saj, ndërsa në pikëpamje të simbolikës, në vitin 2000, për shqiptarët merrte kuptime të shumta. Kuptimi më i drejtpërdrejtë dhe më i qartë ishte një: Kosova përfundimisht ishte çliruar nga Serbia. Kuptime të tërthorta kishte shumë. Kosova kishte dalë nga një luftë e gjatë, ajo kishte shumë plagë, kishte shumë dhembje, por kishte edhe krenari dhe dinjitet. Ndonjë gjë krejt e saktë për të ardhmen e saj ndoshta nuk mund të thuhet, por çdokush e dinte se ajo kurrë më nuk do të kthehej atje ku kishte qenë një herë. Përveç kësaj, dilemat dhe paqartësitë mund të ishin të shumëllojshme, mirëpo në pikëpamje të identitetit ajo kurrë më nuk do të shfaqej e dyzuar. Ishte pikërisht siguria e identitetit shqiptar ajo që e kishte bërë Kosovën të qëndrueshme dhe krejt të veçantë në historinë e saj. Me një fjalë, po të kishte dilema dhe paqartësi rreth kësaj çështjeje, Kosova nuk do ta kishte këtë histori. Po të ishte e luhatshme rreth këtij identiteti, Kosova mund të merrte secilën kthesë përgjatë historisë, por më së paku do të kishte gjasë të merrte këtë që mori. Fundja, ç'mund të ishte Kosova pa identitetin e saj shqiptar, në fund të një lufte planetare për të

drejtat e saj, një luftë që nuk do të ketë shembull të ngjashëm në krejt historinë e përbotshme...?

Pra, pyetjet nuk ishin retorike dhe dilemat nuk mund të quhen artificiale. Sepse, si mund të ndodhte që Kosova rishtas të përballej me problemet e identitetit, në fund të një epoke dhe të një mijëvjeçari dhe në fillim të një epoke të re dhe të një mijëvjeçari të ri, pas ngjarjesh që morën simbolikë universale, të cilat e vunë këtë vend të vogël në maje të botës? A mund të thuhet, pra, se kjo situatë rreth Kosovës u shpik për arsye politike, të cilat erdhën si pasojë e ndërhyrjes ndërkombëtare “në çështjen e saj”, apo kishte diçka që ishte mbajtur e fjetur për një kohë më të gjatë, ndërsa tani ishin krijuar rrethanat që të dilte në sipërfaqe? Dhe, përse çështja e parë identitare që shtrohej kishte të bënte pikërisht me Skënderbeun, Heroin Kombëtar, të cilin Kosova e kishte pranuar si simbol shumë kohë përpara se shtatorja e tij të vinte në Prishtinë...? Përse, pra, Skënderbeu duhej të ishte kontestimi i parë rreth identitetit të Kosovës? Natyrisht, ky ishte një kontestim ndryshe, që nuk vinte nga matanë, nga Serbia apo nga provenienca e saj shkencore ose pseudoshkencore. Ky kontestim dukej sikur vinte nga brenda, nga një shqetësim disi legjitim i njerëzve, të cilët tani, pa ngarkesën e Serbisë dhe të historicizmit mitologjik, kërkonin shpjegime të arsyeshme për të gjitha çështjet e mbetura pezull. Shqiptarët në përgjithësi, por Kosova në mënyrë të veçantë, kishin kaluar periudha të vështira, përgjatë të cilave nuk kishin pasur aq komoditet dhe as qetësi elementare për t’i shqyrtuar një sërë problemesh. Tani që historia kishte krijuar qartësi, kishte krijuar rrethana më të favorshme dhe tani që e nesërmja mund të kërkonte përgjigje më eksplicite për shumë çështje të mbetura pa shpjegim adekuat, ishte krejt e natyrshme që këto shpjegime të kërkoheshin pa paragjykime.

Por, më anë tjetër, Kosova kishte një situatë krejtësisht të paqartë rreth statusit politik dhe administrimi i saj ndërkombëtar kishte prodhuar kriza të njëpasnjëshme. Gjetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme supozonte pavarësinë, ose ndonjë modalitet që mund të ishte i afërt me të, gjë që një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare e refuzonte me këmbëngulje. Ngjarjet e marsit të vitit 2004, ndër të tjera, kishin bërë të qartë se Kosova, e tillë siç ishte, me status të pazgjidhur dhe me një të ardhme të mjegullt mund të prodhonte kriza serike, pafundësisht. Me një fjalë, bota kishte ndërhyrë në Kosovë në vitin 1999 dhe tani çështjen e kishte lënë disi "ad acta", madje ishte gati ta harronte diku, të arkivuar në dosjet gjigante dhe konfuze të OKB-së. Afate eksplicite për zgjidhjen e statusit të Kosovës nuk kishte pasur, por edhe një i tillë që ishte përmendur shkarazi në dokumentin e Rambujesë dhe në Rezolutën 1244 të KS të OKB-së nuk obligonte askënd. Duket se në këtë meskohë, e nxitur nga urgjenca për t'i dhënë një zgjidhje çështjes së Kosovës, duhet të ketë lindur edhe ideja e diskutimit të identitetit kosovar, pra, në përgjithësi, në një situatë krize për Kosovën dhe me imponime të fuqishme politike nga faktorët vendimmarrës. Po të ishte se Kosova vetë do të kishte nevojë ta hapte këtë çështje, gjërat do të shkonin sipas një radhe tjetër: së pari do të zgjidheshin urgjencat politike, pastaj do të krijoheshin një atmosferë qetësie dhe i fundit do të vinte debati për çështjet e identitetit.

Megjithatë, me ose pa vullnetin e kosovarëve, me ose pa dëshirën e tyre, çështja e identitetit kosovar u hap, në fillim si e imponuar, me paraqitje publike shpesh skandaloze dhe pa etikë të debatit publik, pastaj sikur u harrua dhe u la në heshtje, herë pas here u rishfaq, diku si primitivizëm agresiv, diku edhe si frymë qytetare, e denjë që të respektohet si mendim alternativ, ndonjëherë edhe si

kundërvënie identitetit shqiptar. Pavarësisht se nga kush u imponua fillimisht; pavarësisht se si u zhvillua ky debat në ambientin kosovar; pavarësisht se ndonjëherë debati mori konotacion të zhveshur politik dhe herë të tjera konotacion kulturor, gjuhësor, medial etj., e vërteta është se njëllëj debati tashmë ekziston brenda vetë shoqërisë kosovare, ndonjëherë i mbyllur, ndonjëherë i hapur, në familje, në medie, në rrethe shoqërore, në ambiente kulturore, më shpesh si refuzim i vetë debatit për identitetin kosovar se sa si analizë e qëndrueshme.

Mënyra jokompetente dhe agresiviteti me të cilin është diskutuar në fillim kjo çështje, shumë njerëz i ka bërë nevrinë, madje refuzues që ta pranojnë vetë debatin për identitetin, e jo më ta konsiderojnë si të mundshëm një identitet të mëvetësishëm kosovar. Ishte një shërbim i keq që iu bë trajtimit serioz dhe të matur të një çështjeje shumë të rëndësishme, e para, për shkak se vetë çështjet e identitetit janë të tilla, që nuk përjashtojnë askënd nga diskutimi; dhe, e dyta, për shkak se që në fillim ishte krijuar përshtypja se në debatin për këtë problem ishin përzier edhe sponsorë të dyshimtë. Jo pse ndaj këtyre sponsorëve ekziston ndonjë kompleks recidivist, por thjeshtë për faktin se gjatë dhjetë viteve të shkuara në Kosovë po këta sponsorë më së shumti para kishin dhënë për projektet që e çonin Kosovën në drejtim të Beogradit. Pikërisht, në sensin e promovimit të ideve identitare, sekush nga të huajt e pa të dobishme për demokratizimin e shoqërisë kosovare, për tolerancën ndëretnike etj., ndarjen e Kosovës nga trungu i vjetër shqiptar dhe vendosjen e saj në një zonë të ndërmjetme, në një zonë pa gravitet. Sipas tyre, ky ishte kompromisi që duhej të bënin kosovarët, për të fituar të drejtën e shtetit. Në një mënyrë, kjo edhe ndodhi. Është e vërtetë se kosovarët kanë qenë në gjendje të bëjnë shumë kompromise për

shtetin dhe pavarësinë, por ata edhe përgjatë historisë më të re kanë ditur dhe kanë mundur të jetojnë pa shtet, por asnjëherë pa identitet. Prandaj, beteja kosovare për identitetin sa ka konotacion historik që lidhet me të shkuarën, po aq ka edhe konotacion politik, që lidhet me të tashmen dhe me të ardhmen e Kosovës. Beteja sapo ka filluar dhe fundi nuk shihet krejt i qartë.

Ndërkohë, debati për identitetin kosovar do të vazhdojë, një debat që nuk do të duhej të ishte pronë intelektuale e asnjë grupi njerëzish dhe asnjë proveniencë politike ose kulturore. Ai mund të përfshijë shtresa të gjera të shoqërisë kosovare dhe të shtrihet edhe në diakroni, deri në skutat më të errëta të historisë. Debati nuk mund të përqendrohet në një çështje të vetme, sepse çështjet identitare implikojnë edhe politikën edhe politikëbërjen, edhe historinë edhe historiografinë, sikundër që implikojnë edhe kulturën dhe fushat e ndryshme të krijimtarisë, gjuhën, artin, letërsinë, të gjitha pa përjashtim.

PJESA I
IDENTITETI HISTORIK

KOSOVA NË MENDIMIN POLITIK SHQIPTAR

Ridimensionimi i çështjes shqiptare

Po e shikuar historinë e popullit shqiptar nga këndvështrimi i sotëm, del se ndarjet brenda këtij komuniteti janë të hershme dhe kanë filluar po atëherë kur nisën të vepronin edhe forcat e brendshme kohezive, që domethënë se veprimet çintegruese nuk janë zhvilluar si kundërpërgjigje e proceseve integruese, por janë të së njëjtës kohë dhe kanë vepruar mbi të njëjtën bazë të rrethanave historike. Nëse në një periudhë kohore ka qenë interes politik, ekonomik, tregtar, fetar, ushtarak etj., që një komunitet të funksionojë si i tërë, janë po këta faktorë, pavarësisht se nga kush nxitën, të cilët njëkohësisht veprojnë në drejtim të kundërt. Pikërisht për këtë arsye proceset e këtilla brenda një komuniteti duhet parë në tërësinë e tyre, pa krijuar në mënyrë artificiale renditje parësore të faktorëve, relevanca e të cilëve në kohë të ndryshme ka pësuar lëvizje suksesivisht.

Pra, janë këto dy procese, të cilët kanë shkuar në drejtim të kundërt, që e kanë përcaktuar përfundimisht njësinë identitare të shqiptarëve. Ndonëse është e vështirë të bëhet një përcaktim i qartë, ka të ngjarë që identiteti të jetë më i vjetër se kombi dhe njësi kombëtare të jetë krijuar mbi përbërësit e identitetit, të cilët përfshihen brenda tij, si përbërës substancialë të njësisë kohezive. Se cili përbërës ka

qenë më relevant se tjetri në ndërtimin e një subjektiviteti kombëtar, ta zëmë njësia territoriale, njësia gjuhësore apo njësia fetare tani është vështirë të përcaktohet, por që këto njësi kanë mbetur për një kohë të gjatë elementë substancialë të identitetit, as kjo nuk mund të kontestohet.

Megjithatë, edhe përkundër paqartësive të mëdha dhe mënyrave të ndryshme të interpretimit, historia nuk do të ndalet së kërkuari shpjegime për këto çështje, që filluan të bëhen të mprehta pikërisht atëherë, kur mendohej se ato u tejkaluan një herë e përgjithmonë. Duket disi paradoksale që pikërisht tani, kur proceset integruese globale, pra mbikombëtare dhe mbiindetitare kanë marrë hov dhe janë më aktuale se kurrë; pra, pikërisht në këtë rrethanë të rikthehen në vëmendje diskutimet (me krejt ashpërsinë e tyre) për kombin dhe identitetin. Në të vërtetë, në diskursin kontemporan ndodhi një depërtim i fuqishëm i këtyre çështjeve, pikërisht për shkak të ndryshimeve të mëdha në rendin botëror dhe në perceptimet e reja të botës dhe të fenomeneve të saj. Rrafshimet identitare që i supozon globalizmi dhe rendi i ri botëror nuk janë duke shkuar pa dhembje, madje kanë kundërshtarë të shumtë, qoftë të sërës intelektuale, qoftë të shtresave më të gjera të shoqërisë.

Në këtë kontekst, ne shqiptarët kemi disa probleme plotësuese, që nuk janë tipike për popujt e tjerë europianë, madje as ballkanikë. Pikërisht tani, ne duhet të nisim diskutime të reja për shumë gjëra, e para, për shkak se proceset e ndodhura decenieve të fundit kanë ridimensionuar pothuajse çdo çështje shqiptare; dhe, e dyta, për shkak se diskutimet tona të periudhës së shkuar, sado të pakta dhe të pamjaftueshme, kanë pasur edhe kufizime të theksuara politike dhe ideologjike. Ta zëmë, që të bëjmë një trajtim disi autentik të çështjeve të identitetit, pashmangshëm na duhet të kthehemi aty ku kanë pushuar

së trajtuari këtë çështje intelektualët integralistë të viteve njëzet dhe tridhjetë të shekullit të kaluar, si Merxhani, Frashëri, Milo etj., duke shkapërcyer periudhën mbi pesëdhjetëvjeçare të socializmit vetëm me një shpjegim përgjithësues, se trajtimi ideologjik i identitetit ka çuar te rrafshimi klasor i të gjithë përbërësve relevantë të këtij postulati mbiklasor dhe mbi ideologjik. Ky vakuum kohor nuk krijon vetëm vështirësi në zënien e hapit, por më e rënda punë mbetet zhveshja teorike, konceptuale dhe botëkuptomore e kufizimeve dhe reminishencave recidiviste. Ne duhet t'i bëjmë kritikë mendimit tonë kombëtar për historinë, për kombin, për gjuhën, për kulturën, për fenë, për të gjitha, në mënyrë që sadopak të kthjellojmë mendjen dhe t'i japim hapësirë mendimit të ri. Këtë nuk mund ta bëjmë as me shartimin e dijeve nga kulturat e huaja, as me një lexim sezonal të sociologëve dhe filozofëve bashkëkohorë, as me ndonjë përmbledhje citatesh nga librat dhe esetë në qarkullim, por me një stimul të brendshëm krejtësisht autentik, që do të synonte një ballafaqim pragmatik me sfidat bashkëkohore të një realiteti që ka predispozita për ndryshime të shpejta.

Nga duhet t'ia nisim, pra, një trajtimi të këtillë, i cili më shumë se synim mund ta ketë njëlloj dëshire për të nxjerrë në dukje një shqetësim për identitetin, i cili mund të mos jetë i nxitur nga asgjë frikësuese dhe kërcënuese, por thjesht nga provokimi i brendshëm, intelektual ose jo, për të dhënë përgjigje në një numër pyetjesh prej kaq kohësh të mbetura pezull? Në të vërtetë, nëse ka një histori të mendimit shqiptar, ai do të duhej të kishte të shënuar në analet e tij përgjigjet në pyetjet thelbësore, kush jemi, nga kemi ardhur dhe ku jemi nisur të shkojmë, sikundër që, nëse ka një mendim aktual shqiptar që shtrihet në sinkroni, pikërisht aty do të duhej të gjendeshin përgjigjet në pyetjet e reja, të

cilat u shfaqen rishtas në preokupimet e njerëzve, veçmas pas pavarësimit të Kosovës, apo edhe në periudhën pararendëse. Është krejtësisht e mundshme se një numër pyetjesh substanciale edhe më parë qëndronin pezull në mendimin shqiptar, por Kosova me krejt kompleksitetin e saj i nxori në sipërfaqe pikërisht atëherë, kur rrethanat ndryshuan rrjedhën e deriatëhershme të ngjarjeve. Këto rrethana, si çdo kthesë e madhe në histori, ishin fatlume dhe tragjike njëkohësisht. Ndër të tjera, ne mund ta quajmë rrethanë fatlume faktin që, më në fund, nuk kemi urgjenca të tjera më të mëdha, se ç'është, ta zëmë, çështja e identitetit kosovar, nëse identiteti kosovar është identitet i vërtetë kombëtar apo identitet lokal etj., sepse koha kur hapet kjo temë nënkupton të jenë zgjidhur disa probleme ekzistenciale të komunitetit që përfshihet me këtë identitet. Por, në të vërtetë, a është krejt kështu? Jo, sepse komoditeti ynë nuk është i tillë që të na lejojë shqyrtimin e kësaj çështjeje vetëm për kureshtje, pa ngarkesa të tjera, përfshirë këtu edhe utilitarizmin politik. Pra, çështja e identitetit kosovar u lidh shpejt me statusin politik të Kosovës, me të ardhmen e saj hipotetike ose reale. Prandaj, e shtruar sado në mënyrë abstrakte dhe perifrastike, çështja nuk mund të quhet më as e shpikur, as e trilluar, sepse në njëfarë mënyre ka të bëjë me fatin e njerëzve, me një të ardhme të tyre më të afërt ose pak më të largët.

Natyrisht, duke qenë vetë e ndarë, nuk mund të thuhet se bota shqiptare e ka trajtuar dhe vazhdon ta trajtojë këtë problem me të njëjtin interesim. Për disa, pra për një pjesë të botës shqiptare, për shqiptarët e Shqipërisë në radhë të parë, çështja e identitetit kosovar vazhdon të jetë një problem *i jashtëm*, që nuk u përket atyre drejtpërsëdrejti, sepse ata marrin pjesë tërësisht dhe të padyzuar në identitetin shqiptar. Ndryshe qëndron puna me kosovarët, të cilët, edhe

nëse nuk i mundojnë shumë dilemat e këtilla, megjithatë duket se i kanë disa andralla reale me identitetin, pavarësisht se ato mund të mos burojnë nga vetëdija e tyre, se ato vazhdojnë t'ua ndajshojnë të tjerët, qofshin këta pjesëtarët e trungut të përbashkët kombëtar, qofshin njerëz të ndryshëm të botës së madhe, të cilët, për një arsye ose për një tjetër, Kosovën vazhdojnë ende ta kenë në vëmendje. Së këndejmi, ka qenë e pritshme që identiteti kosovar të trajtohet në tri mënyra të ndryshme dhe me tre interesime po ashtu të ndryshme: nga vetë kosovarët, nga shqiptarët e Shqipërisë dhe nga të huajt.

Nëse ka një histori të trajtimit të kësaj çështjeje, nuk mund të thuhet se ajo ka nisur te ata që u përket më së shumti, pra te kosovarët, por pikërisht te shqiptarët e Shqipërisë, jo pse ata që në krye të herës u pajtuan me kufirin që i përjashtoi kosovarët nga shteti shqiptar, por nga se me kohë e kultivuan dhe u përpoqën ta përhapnin sa më shumë idenë e vetëmjaftueshmërisë, madje ta bënin të tillë që ajo të quhej e gjithëpranueshme për shqiptarët, përfshirë edhe Kosovën. Megjithatë, tani nuk mund të thuhet se ata ua rrëmbyen padrejtësisht kosovarëve *të drejtën e kombit*, duke i nxjerrë në marginë, por mund të shprehet njëfarë dileme se *të drejtën e shtetit* e përvetësuan dhe deri-diku e bëjnë vetëm çështje të tyre. Në këtë kuadër, ata identifikuan veten me kombin-shtet, duke u përpjekur ta bindnin veten, si dhe kosovarët, se e ashtuquajtura *Shqipëri londineze* është Shqipëri natyrale dhe se shqiptarizma ka trungun e vet dhe degëzimet po ashtu të natyrshme.

Një arsye tjetër përse trajtimi i çështjes kosovare së pari lindi në Shqipëri, atje u modelua dhe mori trajtë dhe shumë më vonë u bart edhe në Kosovë, duhet parë si gjendje të natyrshme, kur jemi në dijeni për potencialin e munguar intelektual të Kosovës në krejt shekullin XIX dhe në pjesën

më të madhe të shekullit XX. Deri në vitin 1945 popullsia e Kosovës ishte mbi 90% analfabete (deri në 10% mund të shkonte numri i atyre që dinin shkrim-lexim turqisht, cirilik ose shqip), nuk kishte as edukim as arsimim kombëtar dhe vetëdija për përkatësinë kombëtare në një masë të madhe ishte e ngatërruar me përkatësinë fetare. Deri në gjysmën e dytë të shekullit XX kosovarët ishin *shqiptarë natyrorë*, pa atributet e tjera të domosdoshme për një komb funksional. Prandaj, ishte krejt e kuptueshme që trajtimi i çështjes së Kosovës të fillonte dhe të merrte trajtë në Shqipëri, përfshirë edhe kultivimin e dijeve elementare ose të avancuara për këtë hapësirë. Defektet e mbetura nga ky trajtim do të reflektohen për një kohë të gjatë në mendjet e shqiptarëve, të njëjës dhe të tjetrës hapësirë. Vetë *çështja*, duke u bërë *kosovare*, në njëfarë mënyre do të zhvendoset nga konteksti shqiptar, dikur do të ndahet, pastaj do të mënjanohet dhe, së fundi, do të bëhen përpjekje që ajo të trajtohet krejtësisht e shkëputur dhe krejtësisht më vete.

Në të vërtetë, ekziston një paradoks në historinë tonë, i cili bëhet më i mprehtë sapo nis të diskutohen çështjet identitare, apo ato të jetës në një njësi të përbashkët: shqiptarët kanë qenë më të bashkuar, kanë pasur interesa më konvergjente dhe politikisht kanë qenë më monolitë në periudhat e gjata të pushtimeve nga perandoritë e mëdha, se sa në shekullin e fundit, pas lindjes “separate” të “Shqipërisë londineze”. Sikundër dihet, *çështja shqiptare* u shfaq si çështje unike në agjendën politike të Europës dhe të Ballkanit në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, duke kërkuar me urgjencë zgjidhjen e saj. Zgjidhja e pjesshme dhe e padrejtë e kësaj çështjeje në atë kohë, e la të hapur çështjen shqiptare dhe një shekull më vonë, më saktësisht në fund të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI, hapi *çështjen kosovare*, në njërën anë si pjesë të çështjes shqiptare, por më

anë tjetër edhe si çështje krejt më vete. Kjo rrjedhë logjike e gjërave bëri që çështja kosovare të perceptohet në dy forma, pra që shqiptarët të jenë deri diku të ndarë në këtë perceptim: një pjesë e tyre, ta zëmë shqiptarët e Shqipërisë dhe pjesërisht ata të Maqedonisë, çështjen kosovare do ta perceptojnë si çështje të jashtme, si problem me interes kombëtar, si çështje të një superstrukture ideore ose të konstalacionit emocional, por jo edhe aq si problem politik ekzistencial, sepse do të konsiderojnë se ajo edhe për një kohë të gjatë nuk do të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

E fundit çështje që duam të sjellim në vëmendje në këtë rast, është korpusi i ideve kundërthënëse në mendimin shqiptar, ide këto që zhvendosin çështjet e diskutueshme nga njëri ekstrem në tjetrin, nga drita në errësirë, nga e bardha në të zezë. Në këtë korpus idesh ka kryqëzime të panatyrshme çështjesh të shpërputhura, ndonjëherë ka mungesë dijesh, herë të tjera ka dashaligësi që tejkalon kritikën dhe shkon deri te sadomazohizmi; por më së shumti ka qëllime divergjente, që përplasen ndër veti dhe amortizojnë lehtësisht njëri-tjetrin. Viteve të fundit, që mund të thuhet se ka pasur një avancim të ndjeshëm idesh në mendimin shqiptar, kanë ndodhur edhe përplasjet më jokonstruktive që janë parë ndonjëherë. Duket se sot problemi më i madh i shqiptarëve nuk është dija, rreth të cilës mund të kenë deficite të ndjeshme, por stërngopja e tregut shqiptar të ideve me *mendimin mercenar*, i cili lehtësisht manipulon me koncepte, me parime, madje edhe me shenjtëri më sipërore dhe më të paprekshme.

Ndarja e parë

Trajtimi i çështjes së Kosovës në Shqipëri ka kaluar nëpër faza të ndryshme, disa prej të cilave kanë qenë shumë intensive, kurse disa të tjera janë shquar për intensitet të ulët të interesimit. Intensiteti i trajtimit është varur në radhë të parë nga faktorët e brendshëm, që domethënë nga vetë zhvillimet në Shqipëri, pastaj nga zhvillimet në Kosovë dhe nga rrethanat ndërkombëtare, kundrejt të cilave bota shqiptare ka pasur gjithnjë ndjeshmëri. Para vitit 1912, në mendimin politik shqiptar Kosova nuk identifikohet si e ndarë nga pjesa tjetër e botës shqiptare. Kjo ishte rrethanë normale, sepse e gjithë hapësira shqiptare funksionon brenda Perandorisë Otomane.

Megjithatë, me Kosovën e kësaj kohe, veçmas me atë të shekullit XIX ekziston një problem, i cili nuk është trajtuar ndonjëherë, qoftë në historiografinë tonë, qoftë në shkrimet e tjera për këtë periudhë: Kosova ka një pjesëmarrje të vogël, jashtëzakonisht të vogël në lëvizjet kulturore të asaj kohe. Ose nuk ka fare. Kosovarët nuk i shohim të pranishëm në klubet dhe shoqatat kulturore. Vetëm aty-këtu mund të haset emri i ndonjë shqiptari nga kjo hapësirë të jetë përfshirë në ndonjë aktivitet me parashenjë kulturore shqiptare, ndonëse është e njohur se shqiptarë të arsimuar që vepronin në kuadër të institucioneve turke, ta zëmë, nga Peja dhe Prizreni kishte jo pak. Përse, pra, asnjë rilindës me nam nuk e ka origjinën nga kjo zonë, nga ky vilajet i Perandorisë? Natyrisht që Kosova në atë periudhë nuk identifikohet si e ndarë nga hapësira tjetër shqiptare, përveç se si vilajet i veçantë, siç ishin edhe tre vilajetet e tjera me shumicën e popullsisë "arnaute". Atëherë, çfarë kishte të veçantë ky vilajet, i cili së paku që nga gjysma e shekullit XIX e prapa, derisa nuk u nda përfundimisht nga trunngu

shqiptar, nuk merr pjesë pothuajse në asnjë *lëvizje kulturore*, nuk bën letërsi shqipe, nuk shpërmdan shkrimin shqip, nuk formon shoqata dhe klube kulturore, nuk merr pjesë në këto forma të organizimit, nuk jep kontribut për mbijetesën e tyre? Përse ndodhë kjo? Ndoshta është gabim të thuhet se shqiptarët nga vilajeti i Kosovës, bie fjala, nuk ishin anëtarë të shoqërisë “Bashkimi” të Stambollit, sepse anëtarë anonimë mund të ketë pasur, por një emër i përveçëm përse nuk gjendet midis tyre? Çfarë thonë arkivat për këtë, çfarë thonë dokumentet historike, ne ende nuk e dimë.

Ne mund ta kundërshtojmë një konstatim përgjithësues për një përjashtimin kaq radikal të Kosovës nga lëvizjet kulturore dhe arsimore shqiptare të asaj kohe me faktin se në Prizren u hap një shkollë shqipe vetëm dy vjet pas asaj të parës në Korçë, por nuk mund të mos shprehim çudi dhe njëfarë zhgënjimi që pikërisht nga po ky Prizren, nga Peja ose Gjakova, qytete këto që u bënë qendra të ngjarjes më të rëndësishme kombëtare të shekullit XIX, siç ishte Lidhja e Prizrenit dhe më vonë Lidhja e Pejës, të mos ketë asnjë emër që dëshmon se shkruan shqip. Seç janë aty ca myderrizë dhe imamë, për të cilët nuk mund të themi me qartësi përse u përfshinë në lëvizjet politike të asaj kohe, për të bërë Shqipërinë apo për të shpëtuar Turqinë, por dihet se nuk e bënë shqip asnjë shkronjë, sepse edhe për shumë kohë, bashkë me krejt vilajetin e tyre, vazhduan të bënë ilahi dhe të shkruanin nga e djathta në të majtë. Vërtet, ç’ ishte, pra, ky vilajet i errët?

As në Kongresin e Manastirit të vitit 1908, ku u vendos për alfabetin shqip, Kosova nuk merr pjesë me ndonjë përfaqësues. Do të pranohet si i mirëqenë shpjegimi se Kosova tashmë ishte përfshirë nga trazira të mëdha dhe se ishte pamundësuar udhëtimi për në Manastir i ndonjë delegati nga Kosova. Por cili ishte ai? A kishte një emër, një

burrë i ditur që mund ta përfaqësonte Kosovën në Kongresin e Alfabetit? Përse një i tillë nuk përmendet askund, as në dokumentet e Kongresit, as në shtypin e kohës? Nëse nuk mund të vinte nga Kosova e përfshirë në trazira e kryengritje, përse një i tillë, me origjinë nga ai vilajet, nuk gjendej në kolonitë shqiptare, veçmas në Stamboll, ku dihej se nuk kishte mungesë kosovarësh. Pra, duket se mungesa e Kosovës nuk do të mund të shpjegohet vetëm me mungesën e një përfaqësuesi hipotetik, por më shumë me mungesën e një lëvizjeje kulturore. Apo bëhej fjalë për diçka tjetër: se Kosovës tashmë i qe caktuar një rol në skenën e historisë shqiptare dhe se ai nuk mund të ishte rol i parë...?

Supozimet çojnë te ideja se pikërisht mund të ketë qenë Kongresi i Manastirit ai që kishte shënuar ndarjen e parë të madhe ndërmjet Kosovës dhe asaj pjese të hapësirës shqiptare, që më vonë do të quhet Shqipëri, edhe përpara se të shpallej pavarësia dhe të bëhej shteti i cinguar shqiptar. Është e vërtetë se kufijtë e "Shqipërisë londineze" i vendosen fuqitë e mëdha, shqiptarët duke pasur të vetmën mbështetje reale Austro-Hungarinë pothuajse të armiqësuar me të gjithë. Po përse nuk na shkoi mendja qoftë edhe një herë të themi se padrejtësia e madhe që iu bë Kosovës me këtë rast, deri në njëfarë shkalle reflektonte edhe gjendjen e saj të brendshme? Është e vërtetë se Kosova i bëri kryengritjet e mëdha, që i paraprinë shpalljes së pavarësisë më 1912. Po përse ata nuk e shpallën pavarësinë në Prishtinën dhe Shkupin e çliruar, por i shpërbënë çetat kryengritëse pikërisht atëherë kur kishin arritur sukseset më të mëdha në terren? Ç'ishte kjo marrëzi kosovare? Përse, pra, kishin luftuar? Përse tani duhet së dyti të krijohet një territor i lirë, kësaj radhe në Vlorë, qindra kilometër larg dhe të vinte Isa Boletini t'i rrinte në krah Ismail Qemalit, kur këtë

po ky Isa ka mundur ta bënte me Hasan Prishtinën në cilindo qytet të Kosovës? Sepse kështu donin fuqitë e mëdha, kemi thënë gjithmonë, në këtë rast Italia. Por nuk kemi thënë se Kosova në atë periudhë, sikundër edhe më parë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, kishte një *deficit identiteti*, i cili nuk garantonte suksesin e asnjë ndërmarrjeje të madhe kombëtare. Pak më shumë se tridhjetë vjet përpara se të shpallej pavarësia e Shqipërisë, Kosova e kishte dëshmuar potencialin e saj identitar me Lidhjen e Prizrenit. Kështu kemi thënë gjithmonë. Mirëpo nuk e kemi thënë ndonjëherë se, kur u desh të mbrohej Lidhja e Prizrenit, Kosova nuk dha më shumë se tre mijë burra. Tani, ku ishte problemi, te programi i paqartë i Lidhjes, apo te vetëdija e munguar identitare e kosovarëve? As në këtë pyetje nuk jemi përpjekur të japim përgjigje.

Refuzimi konceptual i Kosovës

Me shpalljen e pavarësisë dhe me caktimin e kufijve të Shqipërisë, fillon një fazë tjetër e trajtimit të çështjes së Kosovës në Shqipëri. Deri atëherë, nëse ndër shqiptarët kishte një *çështje kosovare*, ajo ishte çështje lokale, ndërsa nga pikëpamja shtetërore, Kosova bëhet çështje e jashtme. Në të vërtetë, në këtë periudhë, e cila përfshin kohën e konsolidimit të shtetit shqiptar, kemi njëlloj dualizmi, të ndërtuar nga njëra anë mbi sentimentin e shqiptarëve të Shqipërisë për Kosovën e shkëputur nga “dheu mëmë” dhe të mbetur në robëri; dhe, më anë tjetër, një pragmatizëm shtetëror, i cili kërkon të lirohet nga ndjeshmëria për Kosovën dhe këtë “çështje madhore kombëtare” ta sakrifikojë për interesa të shtetit, sa herë që për këtë

paraqitet nevoja. Në një mënyrë, kjo ka qenë politikë shtetërore e periudhës së Zogut, në të cilën nuk kishte shumë moral, por mund të thuhet se kishte synim krijimin e *vetëdijes shtetërore*, aq shumë të munguar ndër shqiptarët.

Zogu u shpall mbret i të gjithë shqiptarëve dhe duket se ai vërtet e mendoj veten si të tillë, pavarësisht se, paraprakisht, kur i erdh puna për të mbajtur pushtetin, me shumë ëndje bëri marrëveshje me Pashiqin dhe me shtetin e tij, që vetëm pak vite më parë kishte ushtruar gjenocid mbi Kosovën. Megjithatë, kjo politikë dhe kjo mënyrë sjelljeje ndaj Kosovës merr një përkrahje të gjerë në Shqipërinë e asaj kohe. Në njëfarë dore, mënyrën e këtillë të trajtimi të çështjes së Kosovës e përvetësojnë në masë edhe qarqet intelektuale dhe shtypi i kohës. Sentimenti për Kosovën deri diku vazhdon të ruhet, por ajo më shumë ngjan si një plagë e fshehur, e mbuluar me kujdes, të cilën askujt nuk i pëlqen ta ngacmojë. Aty-këtu gjendet ndonjë intelektual nacionalist, i cili, në kuadër të shqyrtimeve të trendit të kohës, nuk e projektin kombin vetëm në suaza të shtetit, por zërat e tillë bëhen gjithnjë e më të rrallë, ngase në mendimin politik dhe përgjithësisht në mendimin shqiptar fillon të dominojë vetëdija e *kombit-shtet*. Mbase ky mund të jetë edhe një pragmatizëm i pëlqyeshëm, i cili fillon të dominojë vetëdijen e shqiptarëve të Shqipërisë. Ata, duke e parë potencialin real të shtetit të tyre, nuk projektojnë ëndrra krejtësisht të parralizueshme, madje tejet të rrezikshme. Ekzistenca e Shqipërisë ishte e rrezikuar edhe pa Kosovën si çështje e hapur, kështu që një interesim simbolik për Kosovën mund të ishte shumë më produktiv se çdo angazhim tjetër radikal.

Prandaj, zërat që e konsiderojnë Shqipërinë të *vetëmjaftueshme* fillojnë e shtohen vazhdimisht, derisa një ditë, ndonëse asnjëherë nuk u shpall, kjo u bë vetëdije mbisunduese te mbarë shqiptarët e Shqipërisë. Pikërisht, që

nga ky çast fillon edhe refuzimi i ndërsjellë i kosovarëve dhe shqiptarëve të Shqipërisë, i cili natyrisht që nuk shpallet asnjëherë publikisht dhe rrallëherë merr shpërfaqje të drejtpërdrejtë dhe të hapur, por si një virus i padukshëm sëmur dhe helmon krejt marrëdhëniet e mëvonshme ndërshqiptare. Thelbi i kësaj mosmarrëveshjeje qëndron në këtë pikë: Kosova ndihet padrejtësisht e braktisur, ndërsa Shqipëria e projekton Kosovën si një telashe që e bezdis vazhdimisht. Madje, në këtë drejtim shkohet edhe një hap më tej: në mendimin shqiptar të asaj kohe fillon të përvijohet braktisja ose *refuzimi konceptual* i Kosovës, që ndodh me Konicën dhe Çabejn, siç e kemi përmendur edhe herë të tjera.

Në veprën e tij "Shqipëria kopshti shkëmbor i Europës Juglindore" Konica, me shumë erudicion, ndër të tjera, bën edhe përshkrimin historik-etnografik të Shqipërisë, që nga cepi jugor, që është Konica e tij në Greqi, e deri në cepin më të epërm të Shqipërisë, duke mos dalë për asnjë pëllëmbë përtej kufirit shtetëror, andej ku shtrihej Kosova. Do të ishte një pretendim i gabuar po të thuhej se Konica nuk e njihnte atë botë shqiptare që shtrihej matanë kufirit verior të Shqipërisë, sepse shumë vjet përpara Pejën, Gjakovën dhe Prizrenin ai vetë i kishte quajtur "zemra e Shqipërisë" dhe doemos që e kishte një njohje historike të asaj pjese të hapësirës shqiptare. Nuk duket i besueshëm as supozimi se Konica me këtë rast u ruajt nga implikimet diplomatike, meqë pretendimet e librit ishin të mëdha, "një letërnjoftim i Shqipërisë në botën perëndimore", ngase nga këto implikime eventuale nuk e kurseu veten në rastin Konicës së tij, e cila prej kohësh gjendej në Greqi. Atëherë, përse Konica, pra, me vetëdije bën një shkapërcim të tillë dhe Shqipërinë historike dhe etnografike nuk e sheh përtej

kufijve të shtetit, me përjashtim të atij cepit fundor, ku shtrihet vendlindja e tij?

Një përgjigje nuk e gjen dot në këtë pyetje, së paku jo të tillë, e cila nuk do të supozonte se Konica, që tashmë ishte i vetëdijshëm për pozitën e liderit në mendimin shqiptar, nga vitet e fundit të jetës kishte marrë edhe rolin e ndërtimit të pikëpamjeve të avancuara për kombin (ose t'u bënte jehonë atyre), të cilat esencialisht dalloheshin nga pikëpamjet e shekullit XIX, sepse kombi tani lidhej me shtetin dhe në shumë pika shteti kishte filluar të merrte prerogativat e kombit. Këto pikëpamje, të cilat filluan të dominonin Europën e shekullit XX dhe që krijuan bazën ideore të fashizmit dhe nazizmit, Shqipërisë i leverdisnin jo të tilla siç ishin shfaqur në edicionin e tyre primar, por të modifikuara dhe të konvertuara në një pragmatizëm të kundërt: Shqipëria duhej t'ia kufizonte vetes përgjegjësitë për Kosovën dhe për hapësirat e mëdha të mbetura jashtë kufirit shtetëror, nëse dëshironte t'i shpëtonte rrezikut që i vinte "së jashtmi", nga vetë pjesëtarët e kombit të vet. Prandaj, në këtë kohë, e cila shquhet gjithandej për ide nacionaliste dhe shoviniste, në Shqipëri ndodh ridimensionimi i patriotizmit dhe nacionalizmit, që do të vazhdojë edhe në kohët më të vona. Ky rideimensionim në Shqipëri nuk përfshin idenë e kombit të madh, as idenë e bashkimit të kombit, por idenë e kombit cilësor. Edhe Konica, në ato vite, shqetësim themelor e ka bërjen e shqiptarëve, pasi që Shqipëria tashmë ishte bërë, dhe jo bërjen e një Shqipërie tjetër, me të tjerë kufij dhe me tjetër gjeografi. Në një mënyrë, po këtë e thoshte edhe Branko Merxhani dhe Jakov Milo, njësoj si edhe Eqrem Çabej, i cili më 1939 shkon një hap më larg nga të gjithë: Shqipërisë politike ia vesh atributet e Shqipërisë natyrore.

Rikonfigurimi ideologjik

As periudha e komunizmit në Shqipëri nuk e ndryshoi në esencë qëndrimin ndaj Kosovës, vetëm e rikonfiguroi atë, në përputhje me situatat e reja të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore. Ndërkohë, vitet e pushtimit italo-gjerman do të marrin një kuptim të veçantë për të gjithë shqiptarët, si për ata që e glorifikuan rëndësinë e kësaj “lirie të pushtuar”, si për të tjerët që vazhdojnë ta mohojnë *Shqipërinë e Madhe*, më të madhin shtet shqiptar që ishte bërë ndonjëherë. Në të vërtetë, të gjithë historianët dhe krejt mendimi politik shqiptar do të gjenden ngushtë me shpjegimin e krejt asaj që ndodhi në atë periudhë, të vetëdijshëm se të lavdërosh një shtet kuisling të sajuar nga nazifashistët është nonsens për kuptimin dhe shpjegimin që u ka dhënë bota rasteve të këtilla dhe të ngjashme të historisë. Por, më anë tjetër, shqiptarët do ta kenë shumë të vështirë të gjejnë argumente të vlefshme se kjo periudhë e shkurtër e historisë së tyre, megjithatë, kishte edhe pikat e saj të ndritshme, ndoshta më të ndritshme se shumë kohë të tjera edhe më të lavdishme se kjo. Për shumë arsye, përfshirë edhe shkaqet që lidheshin drejtpërdrejt me Kosovën, shumica e intelektualëve të Shqipërisë të kësaj kohe mbeten disi të stepur ndaj atyre zhvillimeve dramatike, duke mos krijuar alternativë tjetër: ose fashizmin, ose komunizmin. Në këtë ngushticë idesh dhe zgjedhjesh pragmatike, një numër syresh gjetën mënyrë ta braktisnin skenën publike, ndërsa një numër jo i vogël u pozicionua qartë në anën e kuislingëve.

Sado që kjo rrethanë u duk e favorshme për Kosovën, pasojat e angazhimit të padiferencuar nga idetë dhe praktikat nazifashiste, do t'i kthehen asaj si bumerang në vitet që erdhën pastaj. Dëmi do të jetë i madh dhe i pariparueshëm. Hija e errët e asaj *Shqipërie të Madhe*, që e

bënë nazifashistët, do të shtrihet përgjatë gjithë shekullit XX dhe të kapë edhe fillimin e shekullit XXI, duke stigmatizuar deri në përfytyrim të përbindëshit çdo vizion politik ose ide integraliste shqiptare. Një Shqipëri e zgjeruar përtej kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht, në të cilën nuk përfshiheshin një pjesë e konsiderueshme e trojeve etnike shqiptare, e sajuar nga të tjerët në rrethanat e një lufte botërore, do të bëhet një tmerr i vërtetë për vetë shqiptarët. Idetë e nacionalizmit shqiptar do të marrin një ndëshkim që nuk e mor asnjë nacionalizëm tjetër pas Luftës së Dytë Botërore, as në Ballkan, as në Europë. Për shkak se një *Shqipëri etnike*, një Shqipërie deri diku gjithëpërfshirëse ishte bërë dhe kishte funksionuar nën pushtimin nazifashist, nacionalistët e Shqipërisë të kohës së komunizmit, edhe nëse kishte mbetur ndonjë i tillë pas përvetësimit në masë të ideve të internacionalizmit proletar, bashkë me kufizimet e tjera ideologjike, u privuan edhe nga çdo e drejtë për t'u shprehur dosido për çështjen e Kosovës.

Një dëm i madh iu bë Kosovës edhe në anë të tjera, në marrëdhëniet ndërkombëtare, sikundër edhe në vetë Kosovën e mbetur peng, madje u krijua një deformim i pashembullt në perceptimin e ideve nacionale. Për shkak të kësaj stigme, nuk do të mund të përpunohet as të avancohet pothuajse asnjë program nacional i shqiptarëve, sepse për shumë kohë të gjithë do t'i druhen identifikimit me fantazmën e *Shqipërisë së Madhe* nazifashiste. Të paktë do jenë ata që do të marrin guximin ta sfidojnë këtë kufizim në fushën e ideve dhe akoma më të paktë ata që do të guxojnë të përballen me pasojat praktike të mbështetjes së një ideje të këtillë. Me anë tjetër, bërja e njëfarë Shqipërie etnike në kohën e pushtimit nazifashist do të shërbejë edhe si alibi për Shqipërinë e periudhës komuniste, që me çështjen e Kosovës të mos merrej si me një çështje të rëndë politike, bie fjala

territoriale, por duke e reduktuar atë në çështje periferike, minoritare, siç ishte ruajtja e identitetit, gjuhës, kulturës etj.

Së këndejmi, kapërcimi i temës së Kosovës në rrafshin e *trajtimeve ideologjike* shënon fazën më të rëndë të degradimit të saj në mendimin politik shqiptar. Në Shqipërinë komuniste Kosova bëhet pjesë e luftës së klasave, bëhet torturë më vete për ata që duan të merren me të. Kjo ndodh për dy arsye themelore: e para, për shkak se Kosova në Shqipërinë diktatoriale konsiderohet pjesë e mendimit të lirë, që domethënë del jashtë skemës së kufizimeve ideologjike, pra bëhet e sanksionushme; dhe, e dyta, Kosova bëhet objekt i propagandës ideologjike në raport me konfliktin e përbotshëm, real ose të perceptuar si të tillë nga bartësit e diktaturës në Shqipëri, siç është ndarje në blloqe, lufta e ftohtë etj., të gjitha këto të hedhura në rrafshin e ideve si luftë kundër imperializmit dhe revizionizmit.

Në të dy rastet trajtimi i çështjes së Kosovës rrëshqet nga objekti i saj i vërtetë dhe vetvetiu bëhet i frikshëm për të gjithë njerëzit, si për njerëzit e zakonshëm, si për ata që këtë çështje duan ta analizojnë në mënyrë më të thelluar. Prandaj, në kohën e diktaturës në Shqipëri nuk ka më *mendim për Kosovën*, ka vetëm zbatim të politikave që i përcakton partia dhe shteti. Deri në vitin 1981 këto politika janë "dërdëllitje nën zë", që domethënë janë të mbyllura dhe konfidenciale, të tilla që nuk kalojnë pragun e institucioneve më të larta të shtetit dhe nuk u bëhen të ditura as kosovarëve, as vetë njerëzve të Shqipërisë, e aq më pak bashkësisë ndërkombëtare. Kjo periudhë është e mbushur me konspiracione nga më të çuditshmet, si në opinionin e brendshëm, si në atë të jashtëm. Lëvizjet politike në Shqipëri janë të thuash tektonike: dalja nga Traktati i Varshavës, dilemat se nga do të shkojë Shqipëria, a do të ndodhë me të si me Hungarinë dhe Çekosllovakinë, a do të shkojë

Shqipëria nga Perëndimi, kush do të jetë aleati i saj i ri dhe, mbi të gjitha, si do të reflektohen këto lëvizje në raport me Kosovën. Lidhja me Kinën bëhet qetësuese për të gjithë ata që supozojnë tronditje të mëdha, sikundër që prishja me të paraqet njëfarë lehtësimi, por nuk davarit të gjitha mjegullat dhe nuk i fashit të gjitha dilemat.

Pas vitit 1981 politikat e Shqipërisë ndaj Kosovës bëhen më të hapura, gati-gati publike. Duket sikur shteti nuk fsheh më asgjë për Kosovën, madje edhe ndonjë dyndje të tankeve të vjetruara në kufirin verior e bën në pikë të ditës, me shumë tym dhe zhurmë. Shteti tani ka nevojë të identifikohet me Kosovën dhe të luajë një kartë kombëtare, pasi i ka shpenzuar të gjitha të tjerat, politike dhe ideologjike. Edhe kësaj radhe Kosova përdoret nga pushtetmbajtësit, por asaj i krijohen disa favore: çështja e saj masivizohet në opinionin e Shqipërisë dhe politikat ndaj saj bëhen popullore, sikundër që edhe shtrëngesat e mëhershme ideologjike hiqen në njëfarë mase. Vetëm se kosovarët tani janë larguar nga skena, nuk janë të pranishëm në Shqipëri, sepse bashkëpunimi kulturor me Kosovën ishte ndërprerë. Kjo i krijon një favor Shqipërisë: të merret me Kosovën dhe kosovarët në distancë, përmes valëve të radios ose frekuencave televizive, pa i pasur nëpër këmbë, pa e helmuar ambientin me praninë e tyre revizioniste. Prandaj periudha 1981-1991 në Shqipëri është periudha më idilike për Kosovën. Përfytyrimi për kosovarët është fantastik: ata janë trima, të moralshëm, të dinjitetshëm, patriotë të mëdhenj, lirisdashës, arsimdashës. Në këtë e sipër, duhet treguar edhe fytyrën e vërtetë të socializmit revizionist jugosllav, për të gjithë ata që brenda dhe jashtë Shqipërisë kanë pasur iluzione rreth tij. Të gjitha këto ambalazhohen me kujdes brenda një pakoje propagandistike, e cila iu

dërgohet kosovarëve përmes eterit, pa asnjë kontakt fizik me ta.

Pas vitit 1991 fillon një fazë e re e trajtimit të çështjes së Kosovës në Shqipëri. Është periudha më e komplikuar e këtyre marrëdhënieve dhe njëkohësisht periudhë e sqarimeve dhe mosmarrëveshjeve të mëdha. Nuk ka më iluzione dhe fshehtësi, por ende ka shumë konfuzion. Del në shesh se raportet Kosovë-Shqipëri janë shumë komplekse, se demokratizimi i mendimit shqiptar nuk sjell vetvetiu favorin e shpjegimit adekuat dhe të argumentuar të të gjitha çështjeve të mjegulluara prej shumë kohësh. Në situatat e caktuara, nëpër të cilat kalon Shqipëria pas vitit 1991, Kosova përdoret dhe keqpërdoret ndonjëherë, por ajo nuk funksionon më si dikur, nuk gëzon kurrfarë reputacioni, pra është demistifikuar. Në të vërtetë, kjo është kohë e rinjohjes së Shqipërisë me Kosovën, pas një ndarjeje të gjatë, një takim i serishëm, që nxjerr në sipërfaqe dallimet e mëdha dhe pikëtakimet e vërteta në mentalitet, në botëkuptime, në etnopsikologji, në filozofinë jetësore, në nivelet kulturore dhe arsimore, në dije, në të gjitha. Në këtë ritakim dhe rinjohje ka jashtëzakonisht shumë hatërmbetje, keqkuptime, mosmarrëveshje, por ka edhe komunikim normal dhe afri reale dhe të qëndrueshme.

Mbështetur në një realitet të ri, në koncepte dhe ide të reja, çështja e Kosovës në Shqipëri tani fillon të trajtohet me një plotëni më të madhe. Edhe kjo periudhë ndahet në dy faza, para vitit 1999 dhe pas këtij viti. Deri më 1999 Kosova e kërkon Shqipërinë vetëm si mbështetje, si vëlla të madh, si shtet amë, i cili duhet t'i rrijë pranë në të gjitha të papriturat, lëndimet dhe pësimet. Krahas kësaj, kosovarët duket sikur kërkojnë edhe privilegjet e tyre në këtë Shqipëri të sapo njohur, të cilën e konsiderojnë disi të përbashkët, sikur është edhe e tyre, po aq sa është edhe e shqiptarëve të Shqipërisë.

Shqipëria, e lënduar dhe e traumatizuar nga diktatura e gjatë, bën shumë, jashtëzakonisht shumë për Kosovën, shpesh më shumë se vetë Kosova për veten e saj. Por tanimë shihet qartë një gjë: Kosova dhe Shqipëria janë dy realitete që kanë arritur deri te një pikë ndarjeje. Ato nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por nuk do të mundën kurrë t'i tejkalojnë dallimet që i kanë. Nëse deri atëherë, në të gjitha trajtimet, çështja e Kosovës kishte attribute lokale në kuadër të çështjes shqiptare, tani, veçmas pas vitit 1999, ajo sikur fillon ta rivalizojë Shqipërinë dhe, duke ndërtuar identitetin shtetëror, të supozojë se është duke ndërtuar edhe një identitet kombëtar. Deri në këtë kohë, që nga viti 1912 e prapa, identiteti kombëtar ka qenë privilegj i Shqipërisë dhe ajo ka pasur monopolin e tij, ndërsa identiteti kosovar i ka pasur të gjitha karakteristikat e *identitetit lokal*. Pas vitit 1999 dhe veçmas pas shpalljes së plotfuqishme të pavarësisë së Kosovës më 2008, identiteti kosovar përpiqet ta tejkalojë këtë kufizim provincial dhe të futet në konkurrencë me identitetin shqiptar. Por, a thua do t'ia dalë?

Çështjet që deri më 1999 mund të diskutoheshin vetëm si teori, pas këtij viti përnjëherësh marrin një kuptim tjetër: Kosova bëhet realitet i ri politik, pra bëhet shtet i pavarur, me njohje ndërkombëtare dhe me gjasa serioze që të konsolidohet si e tillë. Me pavarësinë u zgjodhën dhe pritën të zgjidhen shumë çështje politike të mbetura pezull, vetëm se çështja e identitetit duket se do të mbetet e fundit, jo për të marrë ndonjë zgjidhje, sepse ajo nuk kërkon diçka të tillë, por një shpjegim për të qenë, i cili nuk interferon, ose nuk bie ndesh, ose nuk shkon kundër rrjedhës, ose nuk u bën dëm, ose nuk është në kundërshtim me zhvillimet bashkëkohore ndër shqiptarët.

KONFUZIONI HISTORIK

Problemet e diskursit

Kosova ende nuk ka arritur ta shkruajë një histori të veçantë, një tekst historie, në të cilin që nga fillimi e deri në fund do të flitej vetëm për të. Përpjekjet për të bërë një tekst të tillë, nisur në ndonjë rast, kanë dështuar ende pa filluar mirë, që domethënë se Kosova, sikundër edhe në disa fusha të tjera, vazhdon të mos e ketë të konsoliduar dijen e historisë për veten e saj. Instituti i Historisë së Kosovës, i bërë para dyzet vjetësh, nuk kishte për qëllim të studionte tërësinë e ngjarjeve historike që lidheshin me Kosovën, por vetëm ato që ishin të mëvetësishme, të veçanta, ato që, duke qenë ngjarje lokale, nuk do të trajtoheshin në masë të mjaftueshme nga historiografia jugosllave, ose nuk do të trajtoheshin në mënyrë të përshtatshme. Në kohën e autonomisë së Kosovës ishte e mundshme të bëhej dhe u bë një institut i tillë. Mirëpo, koncepti i historisë së Kosovës për shumë kohë mbeti peng i një botëkuptimi inferior: Kosova nuk kishte prodhuar histori për vete, pra nuk kishte ngjarje historike autentike, por vetëm të tilla që mund t'i atribuoheshin Shqipërisë ose Jugosllavisë, njërës apo tjetrës palë, por jo ekskluzivisht Kosovës. Kjo nuk lidhej me idenë se ngjarjet historike, sado lokale qofshin, asnjëherë nuk mund të ndodhin të shkëputura nga një realitet më i gjerë. Më shumë lidhej me botëkuptimin e përhapur gjerësisht se Kosova, duke qenë pjesë e arealit historik shqiptar, e kishte

bërë historinë me shfaqjet e saj periferike, ose, edhe po të ketë qenë qendër e ndonjë ngjarjeje, përsëri ishin rrethanat dhe konteksti më i gjerë shqiptar që i kishin kushtëzuar ato. Prandaj, në njëfarë dore, në këtë këndvështrim, për një kohë në Kosovës nuk dukej aq e mirë "Historia e popullit shqiptar" e shkruar në Tiranë, por ishte e mjaftueshme për të mbajtur piketat kryesore për mësimin shkollor të historisë kombëtare.

Veçanërisht me shkrimin e LNÇ-së gjërat nuk kishin shkuar si duhet. Ideja e autonomisë duhej të fillonte pikërisht aty, te një organizim i mëvetësishëm dhe "i ndërmjetëm" i luftës antifashiste dhe i lëvizjes komuniste në Kosovë, e cila merrte e jepte me Shqipërinë dhe Jugosllavinë, gjithsesi Jugosllavisë i referohej pothuajse 90%, por kishte edhe disa specifika autentike, të cilat nuk ishin trajtuar si duhet as në historinë e Shqipërisë, as në atë të Jugosllavisë. Në këtë pikë duhej të përqendrohej historiografia e Kosovës, kuadri i saj i shkolluar dhe me tituj kumbues shkencorë. Kjo historiografi nuk u krijua për t'iu kundërvënë historiografisë serbe dhe jugosllave, siç fantazojnë disa, as për të promovuar një identitet historik të Kosovës, por thjeshtë për një përdorim politik: të shkruante historinë e LNÇ-së në Kosovë në frymën e postulateve politike të ideve të Titos dhe të socializmit jugosllav, duke shpjeguar njëkohësisht dy gjëra themelore: e para, se përkatësia e Kosovës në Jugosllavi buronte nga LNÇ-ja, pra nga vullneti i popullit; dhe, e dyta, se autonomia e Kosovës, njësoj si federalizmi jugosllav, i kishte rrënjët po në këtë luftë dhe po në këtë lëvizje. Ky ishte identiteti i atëhershëm historik i Kosovës dhe historiografia zyrtare i referohej pikërisht kësaj pike. Prandaj, duke prodhuar historiografi për këtë përdorim, Kosova i përshkroi ngjarjet e LNÇ-së deri në detaje pa fund, në një kohë që shkroi shumë pak gjëra të tjera me vlerë,

sadopak të ndryshme nga ç'ishin të shkruara në historiografinë zyrtare të Shqipërisë apo të Serbisë.

Pra, bëhet pyetja, a ekzistonte ose jo ideja e një *identiteti historik* të Kosovës në mendjen e atyre që u përpoqën ta shkruanin historinë e saj gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX? Disa duan të thonë se po, të tjerëve nuk iu shkon mendja fare se në Kosovë mund të ketë pasur ndonjëherë një synim të këtillë. E vërteta është ajo që thamë më sipër, se kuadri kryesor i historianëve u arsimua dhe u kualifikua për historinë e LNÇ-së, ndërsa periudhat historike si antika dhe mesjeta mbeten pothuajse pa kuadër shkencor. Atëbotë, me punët e historiografisë në mbarë Jugosllavinë merreshin institucionet më të larta të shtetit, jo vetëm për shkak se mbajtësit e pushtetit ishin pjesëmarrës të LNÇ-së dhe pretendonin hisen e tyre në këtë periudhë historike, por edhe për arsye se balancat historike kishin rëndësi të madhe për mbajtjen në këmbë të vetë shtetit jugosllav. Nga ky rregull nuk bënte përjashtim as Kosova. Gjatë viteve të autonomisë Kosova mund ta shkruante historinë e saj pa ndonjë kufizim të madh, ta zëmë, për periudhën e Mbretërisë SKS, për luftërat ballkanike, madje edhe për krejt shekullin XIX, përfshirë edhe Lidhjen e Prizrenit dhe Lidhjen e Pejës, por e kishte pothuajse të ndaluar të merrej me mesjetën dhe antikën. Mesjeta e Kosovës duhej t'i takonte historisë serbe dhe në këtë pikë nuk lëshonte për as Serbia e kohës së Titos, ndërsa antika ishte ilire dhe lidhja e Kosovës me këtë origjinë të largët nënkuptonte përjashtimin (ose relativizimin) e dominimit serb të kohës së mesjetës.

Prandaj as sot Kosova nuk shkruan dot një histori të plotë, sepse në trajtimin e periudhave të caktuara ka zbrazësi të mëdha. Por më shumë se këto kufizime, ajo ka të pazgjidhur një problem konceptual historik: Ngjarjet që e bëjnë historinë e saj, a kanë qenë krejtësisht autentike apo

pjesërisht autentike, në raport me historinë e pjesës tjetër të popullit shqiptar? A kanë qenë ato ngjarje mjaftueshëm të shkëputura nga zhvillimet në arealin historik shqiptar, sa të mund të quhen autentike dhe të trajtohen si të veçanta? Apo kanë qenë ngjarje shpesh të ndikuara edhe nga Serbia, ndikim ky që nuk është shtrirë në pjesën tjetër të hapësirës shqiptare? Ose, pyetjet mund të shtrohen edhe më ndryshe, në një sens më pozitiv: Cilat ngjarje të historisë shqiptare e kanë pasur epiqendër Kosovën dhe ato ngjarje a janë të mjaftueshme që të bëjnë një histori më vete, pra një histori shqiptare të Kosovës?

Përgjigja në këto pyetje paraqitet e domosdoshme, për të gjithë ata që përpiqen t'i atribuojnë Kosovës një identitet të veçantë historik, sepse identiteti i askujt deri më sot nuk është ndërtuar pa këtë komponentë. Po të duam, mund të shkojmë edhe një hap më tej dhe të shohim se ku mund të nis një histori e Kosovës, e mëvetësishme, e tillë që do të mund të krijonte një identitet, apo, thënë më qartë, ngjarjet historike që lidhen vetëm me Kosovën a mund të krijojnë një identitet të ndarë, i cili do të qëndronte në themelet e kujtesës historike të popullit të saj...? Dhe më tej: Ngjarjet historike që kanë përfshirë Kosovën në periudha të ndryshme, a kanë qenë më shumë të karakterit lokal, që domethënë se kanë qenë të tilla që kanë krijuar identitet historik të ndarë dhe të veçantë, apo kanë qenë ngjarje historike të karakterit më gjithëpërfshirës, pra gjithëkombëtar? Të përpiqemi të përgjigjemi në këto pyetje, duke shkuar radhazi.

Beteja e Kosovës e vitit 1389

Studiues të ndryshëm, më parë serbë dhe pastaj edhe shqiptarë, secili për qëllime të veta, kanë bërë përpjekje që territorit të Kosovës së sotme t'i japin attribute të veçanta, që në periudhën antike. Këto attribute ata i gjenin te Dardania antike, e cila, sipas mendjes së tyre, që të prodhonte Kosovën e sotme serbe ose shqiptare, duhej të ndryshonte që atëherë nga pjesa tjetër e Ilirisë. Po të përkufizohej ky ndryshim vetëm si territorial, mund të kishte një mbështetje, por synimi ishte të shkohej një hap më larg, veçmas nga studiuesit serbë, të cilët përpiqeshin që Dardanianë e atëhershme ta popullonin me një përzierje banorësh, ta zëmë, pellazgë, ilirë, trakas, ose kështu disi, mjaftonte që ajo të mos ishte tërësisht ilire dhe që, përkthyer në kontekstin e sotëm, domethënë të mos kishte një trashëgimi me vazhdimësi shqiptare. Kishte dhe ende ka shqiptarë që pretendojnë të njëjtën gjë, vetëm në sens të kundërt, të cilët i kërkojnë rrënjët e shtetit të Kosovës që në periudhën antike, përsëri jo si një nga organizimet e ndara ilire ose romake, por si një entitet më vete. Këto teori nuk kanë gjetur ndonjë mbështetje të gjerë dhe kanë mbetur kryesisht si projeksione të politizuara të historisë.

Sido që të jetë, në kronologjinë e ngjarjeve historike për Kosovën, Beteja e Kosovës e vitit 1389 është ngjarja e parë më e rëndësishme, e cila për nga pasojat largvajtëse, paraqitet si njëra nga ngjarjet më të mëdha historike të Ballkanit. Duke qenë ngjarje mjaft e hershme dhe pak e dëshmuar, si dhe duke u zhvilluar në kohën kalorësiake të historive të përziara me mjegull dhe fantazi, kjo betejë nuk e pat të vështirë të bëhej një nga modelet europiane të shndërrimeve mitike dhe legjendare. Është kjo kohë jashtëzakonisht e errët në krejt historinë e Europës, e cila

ishite zhytur thellë në obskurantizëm fetar dhe përjetonte krizë të gjithanshme. Por më e përshtatshme se për çdo arsye tjetër që të kalojë në mitologji, Beteja e Kosovës kishte “favorin” e ndeshjes fetare ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, një ndeshje që kishte filluar me kryqëzatat e njëpasnjëshme dhe tani, shikuar nga perspektiva e sotme, duhej të merrte një epilog me një betejë vendimtare. Beteja, përsëri nga perspektiva e sotme, ndodhi sa në realitet, po aq në fantazinë e çakërdisur evropiane dhe për epilog nuk kishte një zgjidhje tokësore të konfliktit, por një shndërrim mistik, që domethënë një shkapërcim të ngjarjes nga realiteti në fiksionin fetar. Në këtë mënyrë ose disi ngjashëm kanë lindur të gjithë *epet kalorësiake*, përfshirë këtu edhe një literaturë me përhapje të jashtëzakonshme, të cilën në mënyrë të mrekullueshme e stigmatizon Servantesi në “Don Kishotin” e tij. Pse, ç’dallim ka ndërmjet ngjarjeve të pabesueshme të romanit të Servantesit dhe bëmave të heronjve të Betejës së Kosovës, sipas legjendave serbe, nëse atyre iu shtojmë prirjen fantastike të autorit për t’i tallur dhe për t’i përqeshur ata? Fundja, a mund ta përfytyroni se ç’hero do të ishte Marko Kraveviqi, ç’pamje mund të kishte ai dhe ç’gjëra të papara mund të bënte, pasi të kalonte nëpër transformimin letrar të pendës së Servantesit? Thënë me një fjalë, është koha e heronjve mesjetarë, të cilët, kur luftojnë mes veti, “shtatë pash në tokë” e ngulin topuzin. Copëza të bëmave të këtyre heronjve i kemi ruajtur edhe ne në këngët legjendare. Prandaj, edhe perceptimi i ngjarjeve historike të kësaj kohe është krejt ndryshe nga periudha e modernitetit.

Të gjitha këto janë të qarta dhe në këtë pikë Beteja e Kosovës nuk përbën ndonjë ndryshim nga ngjarjet e tjera kalorësiake të periudhës mesjetare në Europë. E vetmja pikëpyetje mbetet: Pse Kosova? Pse u gjend Kosova të bëhej epiqendër e një ngjarjeje, që projektonte në sfond ndeshjen e

dy botëve, të dy civilizimeve? A ndodhi kjo rastësisht apo kishte një pararendje ngjarjesh, të cilat pothuajse e bëjnë të pashmangshme këtë ndeshje, pikërisht në këtë vend? Deri tani historiografia nuk ka bërë përpjekje të japë përgjigje në këto pyetje, duke u mjaftuar me gjetjen e fakteve që e konfirmojnë ndodhinë, dhe duke u munduar që prej një legjende të mjegullt të bëjnë një ngjarje sa më të besueshme historike. Me rrethanat, me kontekstin kohor të kësaj ngjarjeje historiografia është marrë më pak, pra, nuk i ka kushtuar vëmendje njohjes së tyre nga një auditor më i gjerë. Nuk është se historianët nuk dinë gjë për rrethanat, ndonëse edhe aty ka vështirësi njohjeje, por më shumë ndoshta bëhet fjalë për një zhvendosje të vëmendjes. Dhe, vëmendja ka ikur pothuajse në tërësi nga fakti se luftërat e këtilla në mesjetë janë bërë në kufijtë e njëjës apo të tjetrës perandori, të njëjës apo të tjetrës principatë dhe se ato nuk janë konfiguruar me parametrat e sotme fetare ose civilizuese. Në rastin e Betejës së Kosovës ky fakt merr kuptim edhe më specifik, sepse ngarkesat apo konfuzionet e mëvonshme politike shpesh janë projektuar në atë të shkuar krejtësisht të mjegullt.

Përse, pra, të mos themi ndryshe, se Beteja e Kosovës, në kohën kur ka ndodhur, nuk ka qenë ndeshje civilizimesh as ndeshje e dy botëve, e dy feve etj., por ka qenë një ndeshje e një ushtrie pushtuese, me një tjetër që mbrohej dhe asgjë më shumë se kaq. Ose, ishte një përballje e një koalicioni të dobët me ushtrinë e një perandorie të madhe, e cila kishte arritur suksese të mëdha në Lindje dhe tani ia mësynte Europës. Nuk ka qenë Perandoria Otomane e vetmja që e ka bërë këtë gjë, sepse "ekskursione" të këtilla Europë-Azi dhe anasjelltas kanë bërë të gjitha perandoritë e mëdha, që nga Aleksandri i Madh e prapa. Atëherë, ç'gjë të veçantë ka kjo betejë, që del nga konteksti i ngjarjeve të këtilla të asaj kohe?

Pothuajse asgjë. Në anën e turqve luftojnë edhe prijës ushtarakë vendas, ndërkohë që vasalë bëhen pothuajse të gjithë prijësit ballkanikë, sapo e humbin këtë betejë. Por diku, megjithatë, është një gërvishtje që ngacmon dhe nxjerr në sipërfaqe idetë fetare dhe civilizuese: kronistët turq të betejës, ata që luftonin kundruall, pra të krishterët, i quajnë “të pafe”.

Por a ndodhte kjo ndarje në fushëbetejë? Absolutisht jo. Kronikat u lexuan më vonë dhe dijenia për to hyri në Europë shumë kohë prapa. Kjo është e dëshmuar dhe e njohur. Pra, atributet fetare evropiane Beteja i mori më vonë, atëherë kur Europa po kërcënohej jo nga civilizimi i papërkufizuar oriental, por nga një rrezik latent dhe krejtësisht real, nga një perandori e fuqishme, e cila ishte pothuajse dy hapa larg kështjellave të Europës. Dhe europianët, të parehatshëm nga ky kërcënim, për një kohë të gjatë qëndruan të mobilizuar ushtarakisht dhe ideologjikisht kundër këtij rreziku të afërt. A u përdor feja nga të dy palët? Gjithsesi, por jo në momentin e betejës. Beteja ishte një ndeshje e zakonshme mesjetare. Madje, mund të thuhet se, për kohën kur ndodhi, ajo ishte një ngjarje lokale, sepse aty për aty nuk tërhoqi vëmendjen e shteteve të fuqishme të Europës. Europa mori vesh për ngjarjen shumë kohë më vonë se ajo të ndodhte. Ndërsa koalicioni ballkanik është pak e besueshme të ketë funksionuar si koalicion i krishterë, për arsye se viset ballkanike tashmë kishin përjetuar një ndarje fetare, atë të ndarjes së kishave, e cila shpesh kishte çuar në konflikte të hapura dhe popujt i kishte bërë të paqëndrueshëm në pikëpamje të besimit fetar. Ballkanasit tashmë nuk ishin fanatikë të asnjë feje. Madje, ata e kishin të ngulitur idenë e konvertimit, sepse jo një herë iu kishte ndodhur që, bashkë me aleancat politike dhe ushtarake, të ndërrojnë edhe përkatësinë kishtare.

Por, megjithatë, pse Kosova? Pse u zgjodh, pra, pikërisht Kosova që të ndodhte kjo ngjarje? Atë nuk e ka përcaktuar asgjë tjetër, pos vijës së komunikimit, rrugës, territorit, reliefit, që domethënë se ishte një hapësirë e përshtatshme që komunikonte pa pengesa relievoe nga Lindja drejt Perëndimit. Thënë ndryshe, Kosovën si fushëbetejë ndërmjet turqve dhe ballkanasve nuk e kishin përcaktuar ballkanasit, por strategjia e ushtrisë turke, e cila përmes Kosovës synonte depërtimin e mëtejshëm drejt viseve perëndimore. Vija e depërtimit përmes Kosovës ishte njëra nga tri rrugët, të cilat ushtria turke i ka përdorur vazhdimisht në ekspeditat e saj drejt Europës. Ballkanasit, me këtë rast, nuk bënë gjë tjetër, përveç se mblodhën një ushtri, u përpoqën ta ndalnin depërtimin turk dhe u thyen keqas. Asgjë mistike dhe asgjë simbolike nuk kishte në atë ndodhi.

Ikja nga historia

Versionet e përshkrimit të kësaj beteje nga kronistët dhe historianët janë të ndryshme, shpesh të tilla që përjashtojnë njëri-tjetrin. Ndërsa flasin për këtë ngjarje, dokumentet dhe relacionet e kohës kanë brenda një pasaktësi të madhe, kështu që e përbashkëta e këtyre përshkrimeve është pikërisht kundërshtimi i ndërvetshëm dhe pasaktësia. Megjithatë, versionet kryesore të përshkrimit të kësaj beteje tani janë katër: versioni serb, i ndërtuar në shekullin XIX, që është më i përhapuri; versioni shqiptar, i ndërtuar në shekullin XX, që përpiqet ta kontestojë versionin serb; versioni turk, që mbështetet në shkrimet e kronistëve dilirantë me mendje të turbullt nga hashashi dhe nargjiletë;

si dhe versioni euro-perëndimor, i cili është ndërtuar gradualisht dhe që synon të duket sa më neutral dhe më i besueshëm.

Për versionin serb mjafton të themi se ai është ndërtuar mbi kujtesën e mjegullt popullore, bartur në formë të këngëve të epikës legjendare deri në shekullin XIX, kur idetë romantike, si me magji, *shprishën strukturën poetike të ngjarjes* dhe prej saj *ndërtuan një realitet të supozuar historik*. Procesi tashmë është i njohur: Vuk Karaxhiqi mbledhi disa këngë për Betejën e Kosovës dhe i prezantoi ato në qarqet evropiane, ku tashmë kishte filluar një pasion i jashtëzakonshëm për folklorin dhe traditën. Këngët u pëlqyen dhe u vlerësuan me atributet më të larta. Gëte dhe Kopitari nuk do ta kenë pasur as idenë, se vlerësimi që ata i bënë eposit serb për Betejën e Kosovës, do të shndërrohej nga romantikët serbë në mit kombëtar dhe se në këtë pikë ata dhanë kontributin e tyre të madh, duke mos e parashikuar se veprimi i tyre do ta kthente Ballkanin për afro një shekull e gjysmë në arenë gjakderdhjesh të njëpasnjëshme. As atëherë dhe as më vonë, evropianët racionalë nuk do ta kuptojnë se, kur bëhet fjalë për popujt e Ballkanit, të vlerësosh njërin më shumë se tjetrin do të thotë njëkohësisht edhe të japësh miratimin e heshtur për shfarosje dhe gjenocid ndaj atyre që janë të dënuar të mos e kenë këtë mbështetje. Historia e mëpastajme do ta vërtetojë këtë në vazhdimësi. Në këtë “lojë” evropiane për Ballkanin, shqiptarët do ta pësojnë më së keqi, jo gjithmonë me fajin e tyre dhe jo gjithmonë pa fajin e tyre.

Versionit serb të Betejës së Kosovës do të vijë në ndihmë edhe versioni turk, i cili ka aq shumë pasaktësi rreth vendit të ndodhjes së kësaj ngjarjeje, sa që i ka krijuar hapësirë shumë të përshtatshme versionit mitik serb të ndërtojë një topografi të ngjarjes sipas interesave krejt pragmatike

politike. Bie fjala, në vendin ku turqit besonin se ishte vrasëri i sulltan Murati, në fshatin Mazgit të rrethinës së Prishtinës, u ndërtua një tyrbe. Si ndodhi të ndërtohej tyrbja pikërisht në këtë vend, kur kronikat turke e lëviznin vendngjarjen në lindje dhe perëndim me dhjetëra kilometra, kjo gjithsesi mbetet e paqartë. Ajo që mbeti e besueshme në versionin turk për Betejën e Kosovës, ishte vrasja e sulltan Muratit nga një "i pafe" në fushëbetejë, se pastaj trupi i sulltanit u balsamos dhe u dërgua në Edrene, ndërsa në vendin e vrasjes, aty ku u varrosen rropullitë e tij, u ndërtua një tyrbe. Është e ditur se tyrbja e sotme e Sulltan Muratit në fshatin Mazgit është e shekullit XIX dhe askush nuk mund ta vërtetojë se tyrbja e re është ndërtuar pikërisht në vendin ku ishte tyrbja e mëhershme. Por do të jetë pikërisht kjo tyrbe, e cila do të shërbejë si piketë kryesore për konfigurimin toponimik serb të Betejës së Kosovës. Sipas gjasës, do të jetë Jovan Cvijiqi me *shkollën antropogjeografike*, i cili, pas pushtimit serb të Kosovës më 1913, do të serbizojë shumicën e toponimeve dhe, me këtë radhë, do të përkufizojë edhe hapësirat "serbe" të Betejës së Kosovës. Ishte krejt logjike që këto hapësira t'i vendoste përreth Tyrbes së Sulltan Muratit: në kodrinën përball tyrbes, Gazimestanin; në të majtë të tij Orloviqin; pak më tej në jugperëndim Obiliqin dhe në luginën prapa Jugoviqin. Duket se vetë serbët për shumë kohë nuk do t'i kenë marrë aq seriozisht këto toponime, sepse u desh të vinte viti 1954 që në kodrinën e mbiquajtur Gazimestan të ndërtonin një pirc të shëmtuar në kujtim të Betejës së Kosovës, përmendore kjo që sot e kësaj dite qëndron në anë të rrugës Prishtinë-Mitrovicë. Ndonëse e ndërtuar në dhjetëvjetëshin e parë të Jugosllavisë socialiste, deri vonë, deri në ditët para 600-vjetorit të Betejës së Kosovës, kjo përmendore rrinte pothuajse e pavërejtur ndanë rrugës. Dukej sikur as serbët e Kosovës dhe as serbët e Jugosllavisë së atëhershme nuk ia kishin ngenë një

përmendoreje të tillë, e cila seku lidhej me ca legjenda të moçme dhe ishte më e largët se vetë historia.

Ndërkaq, shqiptarët, të gjendur nën trysninë e vazhdueshme të mitit serb për Kosovën, u përpoqën të krijonin versionin e tyre historik dhe legjendar për Betejën e Kosovës, kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit XX, atëherë kur ndër shqiptarët u akumulua deri diku një potencial i mjaftueshëm intelektual, për të dhënë përgjigje në shumë çështje të mbetura pezull. Ky version nuk mohoi asgjë nga ajo që tashmë njihet në histori dhe ishte pranuar pothuajse botërisht, vetëm se ata i mëshuan më me forcë idesë se në Betejën e Kosovës të vitit 1389, përball ushtrisë turke nuk u gjenden vetëm serbët, por një koalicion i gjerë ballkanik, ku pjesëmarrja e shqiptarëve ishte e dëshmuar. Në këtë pikë ata u përpoqën të shkonin pak më larg. Duke ndjekur shembullin serb të përvetësimit, që është i theksuar dhe gjithandej i pranishëm, u shkoi mendja të bënin të vetin njërin nga heronjtë kryesorë të kësaj beteje, Milosh Obiliqin, duke ia ndërruar mbiemrin (Kopiliq) dhe duke i dhënë atij attribute shqiptare.

Por, derisa çështja historike e koalicionit ballkanik preokupoi mendje të shquara të shkencës shqiptare, me çështjen e eposit shqiptar për Betejën e Kosovës, prej nga duhej të buronte edhe miti shqiptar për këtë beteje (sipas modelit serb), u morën emra periferikë të shkencës, të historisë dhe të folklorit. Ndonjë përpjekje për të bërë një lidhje ndërmjet mitit shqiptar të Kopiliqit dhe Luftës së Kosovës të vitit 1999 (Anna di Lellio), veçmas të idesë së sakrificës dhe të rebelimit individual dhe kolektiv të Drenicës (ku gjendet edhe fshati Kopiliq, prej nga mendohet se mund ta kishte origjinën heroit mesjetar), në rrethanat e sotme do të marrë konotacion dashamirës për shqiptarët, por nuk do të mund t'i bëjë ballë kritikës shkencore. Arsye

janë disa. E para, sepse shekulli XX nuk është kohë e krijimit dhe e kultivimit të miteve, pavarësisht nga ndonjë aluzion i tërthortë se shqiptarët edhe në këtë pikë paraqiten të vonuar, sikundër edhe në shumë çështje të tjera. Po të ishte se të shqiptarët ekzistonte një bazë për mitin e Betejës së Kosovës, ai do të valorizohej që në shekullin XIX, atëherë kur u valorizua edhe miti për Skënderbeun. E dyta, eposi shqiptar për Betejën e Kosovës, nëse mund të quhet i tillë, ka një shtrirje tepër të kufizuar, që pothuajse nuk del jashtë Drenicës dhe zonës përreth saj. E treta, këngët shqiptare për Betejën e Kosovës dhe Milosh Kopiliqin janë nga më të varfrat në pikëpamje artistike dhe nuk qëndrojnë as afër krijimeve të ngjashme të epikës legjendare ndër shqiptarët. E katërta, në krahasim me eposin serb, ato dalin shumë të kufizuara dhe ndonjëherë ngjajnë të shëmtuara. E pesta, ato janë ndër të rrallat këngë shqipe, për të mos thënë të vetmet që i thurin lavde sulltanit, gjë që në këtë pikë mund të përafrohen me disa krijime të vonuara të rrymës së bejtexhinjve, e cila në Kosovë ishte e pranishme deri vonë, deri nga në dhjetëvjetëshat e parë të shekullit XX. Pra, është krejt e besueshme se ato këngë do të jenë krijuar nga ndonjë bejtexhi anonim dhe i patalentuar, jo shumë kohë përpara se Margaret Hasluck, Albert Lord dhe Glisha Elezoviq t'i kenë regjistruar dhe t'i kenë bërë të ditura për opinionin shkencor, ndoshta më shumë si nostalgji e ndonjë bejtexhiu zemërplatur për Turqinë që tashmë kishte ikur në pakthim.

Duke bërë një rezymë të këtyre dilemave dhe hamendësimeve, del shumë e qartë se varianti shqiptar i eposit të Betejës së Kosovës në tërësinë tij është i paqëndrueshëm dhe i pamundshëm. Kjo shpjegohet me faktin se popujt e Ballkanit, kush më shumë e kush më pak, pas shekujve XIV-XV e tutje ranë në një errësirë të thellë dhe se vetëm rizgimi i tyre në prag ose gjatë shekullit XIX bëri të

mundur rikthimin e miteve pothuajse të harruara. Në të vërtetë, mitin për Skënderbeun, në formë të shkruar, e ruajti dhe e kultivoi vetë Europa dhe atë e rimorën rilindësit shqiptarë në trajtën më shumë historike dhe më pak legjendare. Duke qenë të një proveniencë fetare heterogjene, rilindësit shqiptarët hoqën ose relativizuan nga bëmat e Skënderbeut veshjen fetare të krishterë dhe e kthyen atë në përmasat e tribunit popullor, të akceptueshëm si për myslimanët, ashtu edhe për katolikët dhe ortodoksët. Ndryshe ndodhi me mitin serb për Betejën e Kosovës. Në shekujt e errët atë e ruajti kisha serbe dhe që andej ai u zhvendos në formën e eposit popullor. Prandaj në këngët dhe rrëfimin e tyre popullor për këtë ngjarje ka aq shumë elemente liturgjike, nga njëra anë, sikundër që ka shumë më pak histori se në rastin e Skënderbeut. Por në të dy rastet, Evropa ishte ajo që këto mite i riktheu në Ballkan me krejt domethënien e tyre historike dhe mitologjike. Vetëm se do të ketë një dallim cilësor ndërmjet njërit dhe tjetrit mit, dallime këto që u përshtateshin gjendjes së popujve ballkanikë: miti shqiptar për Skënderbeun përmbante në vete idenë e çlirimit, ndërsa miti serb për Betejën e Kosovës përmbante idenë e pushtimit, sepse ishte ndërtuar mbi postulatet e kryqëzatave dhe të luftës për tokën e shenjtë.

Tani, pasi frymëzoi dhe pajisi ballkanasit me ide të këtylla, duke parë se në këto hapësira mitet riinkarnohen me cikle kohore të një kalendari krejtësisht të ndryshëm nga ai perëndimor, europianët synojnë ta ndryshojnë këtë rrjedhë, ndoshta jo sipas ndonjë programi të veçantë, por sipas bindjes dhe ideologjisë së tyre eurocentriste. Duke marrë rolin e arbitrit në politikë, po këtë rol duan ta marrin edhe në shkencë, veçmas në histori, e cila, sikundër dihet, ngarkon së tepërmi vetëdijen ballkanase. Kur flasim për ngjarjet historike në Ballkan, ata kanë filluar të marrin

qëndrim refuzues dhe arrogant ndaj të gjitha palëve. Historitë e tyre kanë një emërues të përbashkët: çmistifikimin me çdo kusht, madje ndonjëherë edhe deri në mohim. Teknologjia e këtij çmistifikimi është e thjeshtë: pasi bredhin nëpër dokumente dhe interpretime vendore ballkanase, duke i mohuar ato me lehtësi; pasi hedhin sytë edhe në dokumentet turke, që edhe ashtu kanë shumë mjegull dhe lehtësisht kontestohen, nxjerrin ndonjë dokument të proveniencës perëndimore (ta zëmë, të Venedikut ose Padovës), bëjnë interpretimin e tij si plotësisht të besueshëm (sepse nuk është ballkanik, nuk është as turk, pra është europian!) dhe, në këtë mënyrë, pretendojnë se kanë vendosur në vend të vërtetën historike. Vetëm se në këtë qasje eurocentriste gjithmonë ka një problem: prirja për t'i dhënë të drejtë gjithkujt nga pak dhe askujt tamam, duke mos njohur situatën nga brenda, jo rrallë çon në mohimin e të pamohueshmes dhe në pohimin e asaj që nuk mund të konfirmohet.

Zhbërja e shpejtë e identitetit

Pse, pra, kosovarët nuk e përfshinë dot në identitetin e tyre historik Betejën e Kosovës të vitit 1389? Sepse atë tashmë e kishin bërë serbët dhe shqiptarët, duke qenë më të vonuar, nuk mund ta bënin të njëjtën gjë. Mund të thuhet kështu? Apo duhet kërkuar diçka tjetër në këtë mes, një shpjegim që deri-diku u afrohet rrethanave të kohës. Më e mundshme është se Beteja e Kosovës, ashtu sikundër e thamë më parë, mund të ishte një ndeshje ushtrish të huaja, pa pjesëmarrjen e shqiptarëve vendas. Muzaka dhe Balsha fare lehtë mund të ishin pjesëmarrës me kontingjentet e tyre

të luftëtarëve shqiptarë, por jo me kosovarët. Ata mund të kishin bërë aleanca ushtarake me prijësit serbë, të ishin vendosur nën komandën e Lazarit, por kjo nuk do të thotë aspak se vendasit shqiptarë ishin futur në betejë. Prandaj edhe nuk do të merren me të. Ndërsa shqiptarët e Balshës dhe Muzakës mund ta kishin Betejën e Kosovës njëherë nga ekspeditat e shumta, ku do të kishin marrë pjesë, prandaj nuk kishin përse të këndonin për të.

Hipoteza e dytë çon te një përfundim i afërt me këtë: për shqiptarët Beteja e Kosovës ishte luftë pushtuese, në të cilën u ndeshen turqit pushtues me serbët pushtues (në ndihmë të këtyre të fundit, shqiptarët e Muzakës dhe të Balshës mund të kishin bërë aleancë). Prandaj as i kënduan, as e mistifikuan këtë luftë. Hipoteza e tretë lidhet me rrethanat e krijuara pas Betejës: shqiptarët vendas, si mospjesëmarrës në Betejë, pas përfundimit të saj, do të jenë shpërngulur në masë nga ky territor, në jug ose në veri. Një ngjarje të tillë, me pasoja për ekzistencën e tyre, nuk kishin përse ta madhëronin, as ta glorifikonin. Dhe hipoteza e katërt lidhet me *karakterin liturgjik* të një pjese të eposit serb për Betejën e Kosovës: këtë epos mund ta kenë krijuar dhe mund ta kenë ruajtur murgjit serbë të manastireve, ku shqiptarët ortodoksë gjithnjë e më pak fillojnë të jenë të pranishëm dhe të identifikueshëm (për shkak të asimilimit dhe konvertimit). Madje, është e njohur historikisht se në periudhën pararendëse, gjatë pushtimit serb të Kosovës, kisha serbe, tashmë autoqefale, kishte ndërmarrë një invazion kundër klerit vendas, të cilin e persekutoi dhe e dëboi nga kishat, e bashkë me të sigurisht që dëboi edhe besimtarët shqiptarë.

Por nuk është vetëm Beteja e Kosovës ngjarja që shkakton konfuzion në historinë e kësaj treve. Në të vërtetë, çfarë ndodhi me shqiptarët e Kosovës pas kësaj kohe dhe

pas kësaj ngjarjeje? Ata paraqiten të stabilizuar si entitet në Kosovë dhe në dy shekujt vijues dalin si popullsi dominuese, pjesa dërmuese e konvertuar në fenë islame. Dokumentet turke e dëshmojnë këtë shumë qartë dhe demantojnë tezën serbe se shqiptarët filluan të bëheshin shumicë në Kosovë pas luftës austro-turke (1683-1690) dhe pas shpërnguljes serbe, të prirë nga Arsenije III. Në të vërtetë, këtu fshihet një mit tjetër serb për Kosovën, të cilët pretendimet për *tokën e shenjtë* gjithnjë i kanë ndërtuar gjoja sipas modeleve biblike. Sipas versionit të tyre të historisë, pas dështimit të kryengritësve serbë që u vunë në anën e ushtrisë austriake, pasoi një hakmarrje shqiptaro-turke, e cila shkaktoi *eksodin biblik* të serbëve (1690) në një numër fantastik prej 400-500 mijë syresh. Sipas këtij versioni, pikërisht me këtë rast ndodhi edhe ndryshimi i raporteve etnike në Kosovë, sepse hapësirën e zbrazët, prej nga u larguan serbët, me ndihmën e pakursyer të otomanëve, e pushtuan shqiptarët e ardhur nga viset malore të Shqipërisë.

Por ngjarjet duket se janë zhvilluar pak më ndryshe dhe kjo tashmë është e konfirmuar nga historianët. Është e vërtetë se lufta austro-turke dha shkas për një kryengritje në Kosovë në vitin 1688, por ajo kryengritje nuk ishte serbe, por shqiptare dhe atë e udhëhiqte Pjetër Bogdani. Në kryengritje mund të ishte përfshirë edhe një pakicë serbe, mirëpo ata nuk ishin shumicë, sepse në këtë kohë serbët si entitet nuk ishin shumicë në Kosovë. Këtë e konfirmojnë dokumentet turke, që dëshmojnë për një popullsi shumicë myslimane, ndërsa dihej që shqiptarët ishin ata që u konvertuan në masë në fenë islame. Pra, mund të ishte se kryengritja kishte dominim të krishterë dhe brenda saj mund të kishte përfshirë edhe një pakicë serbe, e cila, njësoj si të katolikët shqiptarë, vuanin nga represioni turk, por do të ishte e paakceptueshme që në krye të kryengritësve serbë të vihej

një prift katolik shqiptar. Pas dështimit të kryengritjes, do të ndodhë eksodi, por ai do të jetë i përmasave shumë më të vogla. Përveç kësaj, nuk do të jenë vetëm serbët që u larguan nga Kosova, bashkë me ushtrinë austriake, por edhe një numër shqiptarësh katolikë, të cilët morën pjesë në kryengritje. Atëherë, përse duhet përmendur *arnautët* në këtë ngjarje, kur dihej se Stambolli ishte ai që iu sul kryengritësve? Sepse në krye të ekspeditës osmane, që vendosi rendin në Kosovë, ishte Mahmud Pashë Begolli, për të cilin historianët thonë se në radhët e ushtrisë së tij ndëshkuese kishte mobilizuar edhe shqiptarë, edhe serbë. Mirëpo, ishin njësitë tartare ato që ushtruan hakmarrjen e përgjakshme ndaj kryengritësve.

Megjithatë, për këtë periudhë historike, mbetet një dilemë e pasqaruar: Përse shqiptarët e Kosovës u konvertuan aq shpejt në fenë islame? Përse ata ishin kaq të paqëndrueshëm në fenë e tyre më të hershme, qoftë katolike apo ortodokse? Ky proces është interesant edhe për një arsye tjetër: ai zhvillohet më ndryshe, krahasuar me viset e tjera të banuara me shqiptarë, me përjashtim të zonave shqiptare të Maqedonisë, ku procesi i islamizimit është zhvilluar njëjtë si në Kosovë. Disa historianë duan të thonë se këtë proces në Kosovë e kanë nxitur disa zhvillime paraosmane, siç është rënia e njëkohshme e dinastisë dhe kishës serbe, nën administrimin e së cilës ishin edhe besimtarët shqiptarë ortodoksë të Kosovës. Disa të tjerë u japin përparësi aspekteve ekonomike, pra favoreve që u krijonte Perandoria Otomane atyre që përqaфонin islamin. Nuk janë të paktë edhe ata që e theksojnë dhunën si faktor relevant. Por më të paktë janë ata që i japin rëndësi faktorit gjeografik, respektivisht konfiguracionit të relievit, i cili, duke qenë kryekëput fushor dhe nën trysinë e qarkullimeve si të karvanëve tregtare, ashtu edhe të njërive

ushtarake, nuk siguronte asnjë mbrojtje për popullsinë vendase.

Pavarësisht se cili faktor kishte përparësi, e vërteta është se islamizimi i Kosovës pothuajse përfundoi që në shekujt XVI-XVII. Së pari, gjatë shekullit XVI, islamizimi përfshiu qytetet dhe qendrat urbane, në mënyrë që më pastaj, një shekull më vonë, të bëhej fe dominuese edhe në fshatra. Kështu, ta zëmë, në fund të shekullit XV, Peja nuk kishte më shumë se 23 shtëpi myslimane, Vuçitërna 33, Prishtina 51, nga 299 sa kishte qyteti. Por një shekull më vonë në Pejë do të jetë rreth 90% e popullsisë myslimane, në Vuçitërnë 80%, në Prishtinë dhe Prizren 60%, ndërsa në Novobërdë, Trepçë e Janjevë kjo përqindje është dukshëm më e vogël. Pas qendrave urbane, pothuajse me një shekull vonesë, islamizimi përfshin edhe fshatrat e Kosovës, veçmas pas dështimit të kryengritjes kundërosmane të viteve 1688-1690.

Në këtë kuadër është interesant fakti se Kosova, e cila nuk do të arrijë t'i japë pothuajse asgjë kulturore lëvizjes shqiptare të shekullit XIX, madje as të fillimit të shekullit XX, që në shekullin e parë pas pushtimit otoman, kulturës turke do t'i japë emra të shquar të dijes, veçmas të letërsisë. Poetët Mesihiu nga Prishtina dhe Suzi Çelebiu nga Prizreni, si dhe autori i një historie Xhelalzade Salih Çelebi, që të gjithë bëhen emra me nam në kulturën osmane që në fillim të shekullit XVI, kohë kur pushtimi osman mund të thuhet se ende nuk ishte stabilizuar tërësisht në trevat shqiptare. Sadriazemët, vezirët dhe titullarët e tjerë të lartë, përgjithësisht shqiptarë, në administratën e Perandorisë do të jenë të shumtë, që nga fillimi dhe deri në ditët e fundit të sundimit të saj në Ballkan. Nga Kosova veçmas u krijua tradita e rekrutimit të ushtarakëve të zellshëm dhe të oficerëve të lartë, të cilët shumë shpesh viheshin edhe në krye të ekspeditave që i mësynin viset shqiptare.

Pikat themelore të identitetit

Ndërkohë, Europa iluministe e shekullit XVIII tashmë kishte filluar të merrej me çështjen shqiptare, me historinë dhe me gjuhën e tyre, në kuadër të thellimit të dijeve për shumë fusha shkencore. Ndonëse të heshtur nën sundimin e gjatë të Perandorisë Osmane, origjina, gjuha dhe historia e tyre e lashtë bëhen objekt studimesh të thelluara të shkencëtarëve enciklopedistë, të cilët hedhin idetë e para për origjinën ilire të shqiptarëve dhe përkatësinë indoevropiane të gjuhës shqipe. Që më 1709 Lajbnici e quan shqipen “gjuha e ilirëve të lashtë”, ndërsa në vitin 1774 Johan Tunman u përcaktonte shqiptarëve autoktoninë në hapësirat ku jetojnë dhe origjinën e tyre ilire, të cilët ishin “fqinjët e lashtë të grekëve dhe qytetarët e Romës antike”. Po në ato vite, Herderi shprehet se shqiptarët “nuk janë aspak popull i huaj, por një popull i lashtë i familjes europiane”. Po në atë kohë, në Europën shkencore ishte bërë e njohur edhe pikëpamja tjetër, e cila mohonte origjinën autoktone të shqiptarëve, sikundër edhe prejardhjen e tyre ilire. Është interesant se ky mohim vinte nga autori bizantin Halkokondili, i cili i sjell shqiptarët gjatë mesjetës nga Alba e Italisë dhe nga dy historianë kishtarë, Le-Quien dhe Asseman, të cilët i bartin ata nga Albania e Kaukazit. (Duket se që atëherë fillon të diferencohet një qëndrim negativ i botës së krishterë ndaj shqiptarëve me shkallë të lartë të islamizimit.)

Kjo periudhë e iluminizmit evropian përputhet me një situatë të favorshme për shqiptarët: Ali Pashë Tepelena bën një pashallëk të fuqishëm dhe pothuajse autonom, i cili bëhet ambient interesant për shumë evropianë, duke filluar nga poetët romantikë, që kërkonin aventura për të qetësuar shpirtin e trazuar, e deri te udhëpërshkrues e studiues të

ndryshëm, të cilët çuan në Europë idenë e ekzistimit të një populli të ndryshëm nga grekët dhe turqit. Në këtë pikë Ali Pashai ka meritë shumë më të madhe për shqiptarët, se sa të gjitha bëmat e tij ushtarake, gjithmonë kontradiktore. Ndër të tjera, në pashallëkun e tij u vendosën për herë të parë përfaqësues diplomatikë të Francës dhe të Anglisë, më vonë edhe të shteteve të tjera, të cilët me veprat e tyre i dhanë botës shkencore evropiane informacione të vlefshme për historinë dhe aktualitetin shqiptar (Pukëvili, Liku, Bajroni, Hobhaus, Bue, Hezej etj.).

Edhe pas rënies së Ali Pashait, tradita e krijuar e *konsujve udhëpërshkrues* do të vazhdojë pothuajse përgjatë gjithë shekullit XIX, ndër të cilët Johan fon Hahni mbetet më i spikaturi. Njërin nga mitet shqiptare, i cili më vonë do të krijojë shumë probleme në marrëdhëniet tona me sllavët, do të jetë thënia e këtij gjermani, se “shqiptarët e sotëm janë banorët e hershëm parasllavë të atij vendi”, ose “miti” tjetër, që do ta lëndojë sedrën serbe dhe do ta nxisë krenarinë shqiptare, do të lidhet po me konstatimet e Hahnit, se bota e lashtë nuk ishte vetëm greke e romake, por edhe ilire. Gjithsesi më i kontestuar për historiografinë serbe do të jetë konstatimi i tij për autoktoninë e shqiptarëve të Kosovës, të Serbisë së sotme dhe të Maqedonisë. Nëse shqipja flitej ndër zona malore të këtyre hapësirave, kurse sllavishtja në luginat dhe fushat që shtrihen rreth tyre, thoshte ai, “atëherë kjo shpjegohet si pasojë e një pushtimi”, ku gjuha e parë u takon shqiptarëve që u detyruan të prapseshin ndër male, kurse e dyta sllavëve që erdhën si pushtues. Ose tjetri konstatim i tij, se kosovarët janë *pasardhës të dardanëve* dhe se vetë “topografia e Kosovës tregon se shqiptarët e Kosovës në tërë zonën malore të saj formojnë një tërësi të pandërprerë me Shqipërinë, kurse në zonat fushore kjo vazhdueshmëri është e ndërprerë nga elementi serb”. Një

gjermani tjetër, historianit Mommsen, ndër më të mëdhenjtë historianë të dy shekujve të fundit, i takon identifikimi i epirotëve të lashtë të prirë nga Pirroja si “shqiptarë të lashtësisë”.

Pra, ishte dija europiane ajo që kishte përcaktuar vijat kryesore të *identitetit shqiptar*, identitet ky që ndër shqiptarët ende kishte jehonë të largët, por që sillej rreth po atyre pikave “kumulative”, të cilat krijonin edhe identitetet e tjera kombëtare, siç ishte gjuha e veçantë në familjen indoeuropiane, autoktonia, origjina ilire e kështu me radhë, identitet ky që forcohej me argumentimin përkatës historik, me bëmat e mbretërve ilirë dhe me luftërat e lavdishme të Skënderbeut. Në këtë identitet shqiptar doemos që ishte përfshirë edhe Kosova. Ndërkohë, nga shqiptarët, të njëkohshëm me dijetarët evropianë, janë vetëm priftërinjtë katolikë të maleve veriore të Shqipërisë, si Budi e Bardhi, që me veprat e tyre i japin *lëndë gjuhësore* Lajbnicit, sikundër edhe dijetarët arbëreshë, të cilët, edhe përkundër faktit se për zgjimin kombëtar të shqiptarëve cyteshin nga interesat italiane në Adriatik, dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në identifikimin e postulateve themelore të identitetit kombëtar shqiptar. Më anë tjetër, një elitë intelektuale shqiptare, brenda Shqipërisë ose ndër kolonitë shqiptare, e cila do të mund ta bënte të njëjtën gjë, ende nuk ishte profilizuar qartë dhe, me pak përjashtime, ajo nuk do të formësohet deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur tashmë i gjen të gatshme postulatet e identitetit. Kjo ndodh për shkak se bota shqiptare përjetonte prej disa shekujsh letargjinë feudale të Perandorisë Osmane dhe në fushën e ideve ende kishte mbetur shumë prapa.

Atëherë, si ndodhi pra që po kjo Europë, e cila i vendosi piketat kryesore të identitetit kombëtar shqiptar, në çastet vendimtare, siç ishte Kongresi i Berlinit ose më vonë

konferencat e paqes në Londër dhe Paris, jo vetëm që nuk i mbështeti shqiptarët në të drejtën e tyre për shtet natyral në hapësirën etnike, por në një mënyrë ua dha të drejtën fqinjëve të shqiptarëve që në tërësi ta zhbënin këtë popull? Si ndodhi kjo kthesë kaq e madhe? Ishin shqiptarët fajtorë për këtë, apo Europa kishte ndryshuar pikëpamje? Ose, në këtë ndeshje të ashpër dhe përfundimtare ndërmjet shqiptarëve dhe fqinjëve të tyre, grekëve, serbëve, malazezve, se kush nga Ballkani do t'i bashkohej Europës dhe kush duhej të dëbohej bashkë me Perandorinë Osmane, shqiptarët kishin dalë të humbur, e para, për shkak të shkallës së lartë të islamizimit dhe të identifikimit tepër të ngathtë me identitetin evropian; dhe, e dyta, për shkak të ndërhyrjes së fuqishme të Ruisë, e cila tashmë kishte bërë vend në radhën e fuqive të mëdha evropiane dhe në Ballkan kishte gjetur aleatë që i premtinin dalje në ujërat e ngrohta. Në mesin e këtyre aleatëve natyrorë të Ruisë mund të ishin të gjithë popujt e tjerë të Ballkanit, përveç shqiptarëve, të cilët tashmë kishin filluar ta bënin pjesë të identitetit të tyre *antisllavizmin*. Më anë tjetër, në përballjen me Rusinë nëpër konferenca të ndryshme të paqes, fuqitë evropiane, të cilat ishin vënë në lëvizje ta rregullonin Europën pas dëbimit të Turqisë nga kontinenti i vjetër, thuaja se i kishin gjetur shqiptarët si viktimë të përshtatshme për çdo lloj pazari. Zërat reformatorë, të cilët kishin bërë shumë në formësimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve dhe që e kishin hapur rrugën e tyre drejt Europës, tërhiqen dhe heshtën në përballje me konservatorizmin e krishterë, i cili fiton pikë në rrethanat e ngadhënjimit kundrejt armikut të vjetër fetar, perandorisë islamike të otomanëve.

IDENTITETI PA SHTET

Përfshirja identitare e Kosovës

Nga këndvështrimi i sotshëm, Kosova arrin në shekullin XIX, në kohën e zgjimit kombëtar të të gjithë popujve të Ballkanit, me disa kontestime të fuqishme brenda saj, nga të cilët tri janë më me rëndësi: e para, me shkallë të lartë të islamizimit, që pothuajse nuk gjen një shembull të tillë në asnjë hapësirë tjetër të Ballkanit; e dyta, me një situatë thellësisht të paqartë në raport me lëvizjet politike në hapësirat e tjera shqiptare; dhe, e treta, me një histori të pasur luftërash ndërmjet familjeve të mëdha, traditë kjo që në Kosovë do ta ruajë vazhdimësinë deri në ditët e sotme.

Atëherë, si ndodhi që Kosova, gati si papritur, në vitin 1878 bëhet qendër e lëvizjes kombëtare shqiptare, epiqendër e ngjarjeve më të rëndësishme historike të shekullit XIX ndër shqiptarët dhe njëkohësisht promotor i zhvillimeve politike, deri në pavarësinë e Shqipërisë? Në të vërtetë, Lidhja e Prizrenit është ngjarja e parë historike me forcë integruese ndër shqiptarët të përfshirë nën sundimin e Perandorisë Osmane, sikundër që është edhe ngjarja e parë që i identifikon ata në tërësinë e tyre si entitet më vete në kuadër të Perandorisë. Para Lidhjes së Prizrenit shqiptarët kishin marrë pjesë në bërjen e historisë së Turqisë, përfshirë këtu edhe Ali Pashë Tepelenën zulmëmadh. Tani ata shkonin një hap më tej: ende bënin Perandorinë, sepse një pjesë e tyre kërkonin pikërisht ruajtjen e saj në Ballkan, por, me këtë

rast, kishin shpërfaqur interesa që nuk ishin krejtësisht të njëjta me ato të Turqisë. Nga ana tjetër, Lidhja e Prizrenit më shumë se si ngjarje, për shqiptarët kishte rëndësi si lëvizje. Si ngjarje historike ajo ishte njëra nga shumë luftërat e humbura, por si lëvizje bëri një integrim (të fuqishëm për kohën) të shqiptarëve rreth një ideje. Deri atëherë nuk kishte ndodhur që shqiptarët nën sundimin turk të integroheshin në një ide dhe kjo duhet të ketë qenë arsyeja përse ata u shfaqën të vonuar në skenën politike të Ballkanit dhe të Europës. Para Lidhjes së Prizrenit ata ishin mobilizuar nga Ali Pashai dhe Bushatlinjtë për të bërë pashallëqe, por lufta e tyre nuk kishte pasur asnjë parashenjë shqiptare. Ali Pashë Tepelena u ndihmoi grekëve që të bënin shtetin, ndërkohë që shqiptarëve u solli shumë fatkeqësi. Me Lidhjen e Prizrenit çështja qëndronte më ndryshe: shqiptarët tani kishin një ide që ta çonin përpara dhe kishin një interes, i cili mund të ishte i njëjtë ose i ndryshëm me atë të Perandorisë.

Duke parë rrethanat dhe zhvillimet rreth Lidhjes, nuk ka sesi të të mos shkojë mendja te vështirësitë e jashtëzakonshme të atyre që e kanë ideuar këtë lëvizje, qofshin ata të Komitetit të Stambollit apo personalitete të shquara vendore. Vështirësi edhe më të mëdha duhet të kenë pasur ata që lëvizjes u përpoqën t'i jepnin karakter shqiptar. Vartësit e Perandorisë, ku bënin pjesë edhe kosovarët dhe shqiptarët e zonave të rrezikuara pas paqes së Shën Stefanit, nuk do të ketë qenë aq vështirë t'i mobilizojë për t'u mbrojtur nga aneksimet serbe, malazeze ose bullgare, sepse në luftë i çonte instinkti i mbrojtjes, njësoj si identifikimi i gjatë me Perandorinë, apo edhe tradita e luftërave të shpeshta me fqinjët plaçkitës dhe uzurpatorë. Por do të ketë qenë shumë më e vështirë që në këtë luftë të futeshin me idenë e bërjes së një Shqipërie sovrane, për të cilën duhej të luftonin pjesëtarë të një kombësie tërësisht të

paintegrUAR mes veti. Për këtë ide duhej të luftohej që nga Ulqini deri në sanxhakun e Nishit, nga Preveza deri malet e Plavës dhe të Gucisë, në një kohë që kjo botë shqiptare pothuajse asnjëherë nuk kishte funksionuar si një e tërë, aq më pak në një perandori të prapambetur, me infrastrukturë të degraduar dhe me ndarje të thellë administrative ndërmjet vilajeteve. Më së vështiri do të ketë qenë t'i vije në lëvizje kosovarët, tashmë tërësisht të identifikuar me Perandorinë dhe në çdo pikëpamje të lidhur me interesat e saj.

Prandaj, ishte krejt e natyrshme që në Lidhjen e Prizrenit të kishte dy rryma, njëra që ishte proturke dhe një tjetër që mezi arriti të identifikohet si shqiptare. Nuk ishte aspak e çuditshme që rryma proturke dominonte përgjatë gjithë kohës së mbajtjes së kuvendeve dhe mbledhjeve, sepse Lidhja, sado që ishte ideuar nga Komiteti i Stambollit dhe brenda kishte ide kombëtare, në rrethanat e Prizrenit, ku duhej të bëhej implementimi, dominohej nga një elitë titullarësh me edukatë dhe bindje plotësisht otomane. Vetëm implementimi i vendimeve të Lidhjes, jashtë mbledhjeve dhe jashtë *dokumenteve të shkruara turqisht*, i dha asaj karakter shqiptar, sepse në këtë fazë ajo doli nga shtërëngesa e bejlerëve dhe myderizëve dhe mori përmasat e një lëvizjeje popullore, me prijës dhe tribunë që nuk i përimitonin idetë me numërimin e tespiveve. Mirëpo, ishte po kjo rrethanë që i ndihmoi Lidhjes të pësonte disfatë, sapo u përball me një ushtri të mirëfilltë turke, sepse në mbrojtjen e saj u vu një numër i kufizuar vullnetarësh, të mbledhur kryesisht nga zonat rurale, ndërkohë që vendbanimet urbane të Kosovës duket se e mbështeten ekspeditën e Dervish Pashës. Kjo ndodhte për shkak se elitat urbane të Kosovës atëbotë kishin degraduar plotësisht në ithtarë të një orientizmi dhe osmanizmi ekstrem. Tek ata, që nga fillimi,

nuk do të funksiononte kurrë ideja e shkëputjes nga Turqia, por në idenë e autonomisë në kuadër të Perandorisë gjenin interesat e tyre krejt reale: pas reformave të Tanzimatit titullarët e familjeve të mëdha vendore kishin humbur fuqinë e dikurshme, kështu që një autonomi në kuadër të Perandorisë mund t'ua kthente këto privilegje. Deri këtu mund ta çojë elitën kosovare, më tuje asnjë hap.

Ndërkohë, situata rreth Lidhjes u dramatizua atëherë, kur, nga njëra anë, u kuptua se Turqia po i tradhtonte interesat e shtetasve të saj dhe se Perandoria, që i kishte mbajtur nën sundim pesë shekuj, copë pas cope po ua dorëzonte tokat e tyre "kryqalive", ndërsa, më anë tjetër, disa nga ideatorët e Lidhjes kërkonin "t'i ngulnin thikën pas shpine" Perandorisë, duke shpikur njëfarë *arnautllëku* në kufijtë e saj të bekuar nga vetë Allahu. Edhe përkundër tradhtisë së hapur që po ua bënte Stambolli, popullsia urbane e Kosovës do të qëndrojë e pa luhatur në mbështetje *baba Dovletit* dhe nuk do të rreshtohet në mbështetje të ideve dhe as të strukturave të organizuara të Lidhjes. Vetë qyteti i Prizrenit nuk ndërmori asnjë hap në këtë drejtim. Mirëpo, duket se qarkullimi i ideve të Lidhjes, pavarësisht nga shkalla e pamjaftueshme e mbështetjes, do të vërë në lëvizje botën shqiptare, përfshirë edhe një pjesë të mirë të popullsisë së Kosovës të zhytur thellë në orientalizëm. Për herë të parë shqiptarët po funksiononin si komb i tërë, pavarësisht dallimeve fetare dhe krahinore. Kosova tashmë ishte pjesë e kësaj tërësie dhe pak nga pak po kryente një proces identifikimi.

Edhe përkundër të gjitha përpjekjeve dhe luftërave, me këtë rast shqiptarët nuk e bënë dot shtetin e tyre. Fuqitë e mëdha duket se kishin informacione të sakta për pamjaftueshmërinë e organizimit të tyre rreth kësaj ideje. Europeanët duket se e dinin mirë se çfarë ndodhte në mileun

shqiptar, se brenda tij kishte një diversitet në idenë bazë rreth autonomisë në kuadër të Perandorisë osmane, apo të një pavarësie të plotë të Shqipërisë. Vonesën në kthjellimin e kësaj ideje shqiptarët do ta paguajnë shtrenjtë në vitet, në dhjetëvjeçarët dhe në shekullin që erdh pastaj.

Idetë unifikuese

Tre dhjetëvjetëshat pas Lidhjes së Prizrenit do të jetë koha me ngjarjet më dinamike dhe më domethënëse, më përmbajtësore që janë zhvilluar ndonjëherë ndër shqiptarët. Realisht, pas një procesi të mundimshëm përgatitor, për të cilin nuk mund të thuhet se shkoi aq mirë, për këto tri decenie shqiptarët u bënë komb me të gjitha karakteristikat e identitetit: me gjuhë, me shkrim, me letërsi, me histori, me botime, me shtyp, me shkolla, me simbole, me flamur, me mitin e tyre kombëtar (Skënderbeun) që duhej t'i frymëzonte në luftë për liri, me një lëvizje politike pothuajse të unifikuar për pavarësi dhe shtet kombëtar, pra, thënë me një fjalë, me të gjitha atributet që duhej t'i kishte një komb ballkanik, i cili bënte luftë të vështirë në shumë fronte njëherësh: luftë për mbijetesë, për identitet, për liri, për shtet kombëtar, për prosperitet, për zhvillim arsimor, kulturor etj. Realisht, kombi as që mund të jetë gjë tjetër, përveç se përfshirja e një komuniteti në një lëvizje të këtillë. Kjo lëvizje ndodhi pikërisht në periudhën nga Lidhja e Prizrenit e deri më 1912. Ato vite janë të mbushura me ngjarje politike dhe ushtarake, janë të mbushura me ngjarje kulturore dhe arsimore; mbi të gjitha, janë të mbushura me ide të një unifikimi kombëtar.

Pse Kosova u gjet pothuajse në qendër të këtyre zhvillimeve? Në të vërtetë, ajo u gjet në qendër të zhvillimeve politike dhe ushtarake, por jo edhe në qendër të zhvillimeve kulturore dhe arsimore. Konfuzioni që krijuan vendimet e Kongresit të Berlinit, sikundër edhe insistimi i Turqisë (nën tryshninë e fuqive të mëdha) që t'i zbatojë këto vendime, do ta bëjnë Kosovën dhe viset e tjera shqiptare, t'i quajmë kufitare ose periferike, të jetojnë kohë të vështira, me kërcënimin e vazhdueshëm mbi kokë, se do të ngrysen në një shtet dhe do të zbardhin në një shtet tjetër. Dhe jo çfarëdo shteti, por nën Serbinë, e cila që në rastin e parë, me pushtimin e zonave të sanxhakut të Nishit, dëboi jo më pak se 140 mijë shqiptarë. Pra, Kosova tani gjendej në përballjen e parë me rrezikun e një aneksimi të ri. Ky fakt do ta mobilizojë popullsinë e saj rreth idesë së luftës në dy fronte: për t'iu kundërvënë aneksimit, por njëkohësisht për të kërkuar një status të ri brenda Perandorisë. Sikundër dihet, krizat e Turqisë në Ballkan vinin njëra pas tjetrës, me rrezikun permanent që pjesë të shtetit osman, kryesisht territore shqiptare, të shkëputeshin sa nga Greqia, sa nga Serbia dhe Mali i Zi dhe sa nga Bullgaria. Por as Turqia dhe as shqiptarët nuk ditën të bënin asgjë si duhej në këtë rrethanë. Ndonëse kishin një rrezik të përbashkët, ata rrallë arritën të krijonin një koalicion legal. Gjatë gjithë kohës ata i minuan veprimet e njëri-tjetrit: Turqia u binte shqiptarëve që rebeloheshin, shqiptarët i binin Turqisë që tregohej e ashpër ndaj tyre.

Kështu, menjëherë pas shuarjes së Lidhjes së Prizrenit, që nga viti 1883 e deri në mbyllje të shekullit XIX, Kosova u përfshi në një sërë kryengritjesh të njëpasnjëshme, herë me kërkesa të paqarta, herë me program të përcaktuar politik, të formësuar në kuvende burrash e mexhlise, që kishin përbërje të ndryshme dhe merrnin emra të ndryshëm. Por

duhet thënë qartë se Kosova, e trazuar së tepërmi ushtarakisht, në këtë kohë nuk kishte një *elitë politike*, e cila do të arrinte t'i bashkonte interesat e ndara të prijësve vendorë, kryesisht kryeparë fisesh, pasunarë ose përfaqësues të familjeve të mëdha. Këta prijës nuk arrinin ta kanalizonin pakënaqësinë e popullit, i cili vuante shtypje dhe arrestime, taksa të larta dhe plaçkitje në të gjitha format. Burra të armatosur të një fshati ose të një nahije i binin një kazerme ose një postëkomande, i dëbonin që andej ushtarët dhe oficerët turq, por nuk dinin se çfarë duhej të bënin pastaj. Të tjerë burra zinin një pritë, kthenin prapa ndonjë ekspeditë ndëshkuese, ua merrnin armët, këpucët dhe tërë logjistikën ushtarëve turq, por në mbrëmje përfundonin te gratë e tyre, të kënaqur që luftën e kishin bërë tamam dhe që kishin sjellë në shtëpi ndonjë rrogoz kuajsh.

Natyrisht, në etapa të ndryshme të kësaj periudhe, lufta arriti të bëhej edhe sipas ndonjë programi politik. Të tilla do të jenë edhe *Besëlidhja shqiptare*, por edhe Lidhja e Pejës, të cilat arritën të shtriheshin në një territor mjaft të gjerë dhe të përfshinin numër të madh mbështetësish. Këto organizime politike herë pas here u shtrinë edhe jashtë vilajetit të Kosovës, gjetën mbështetës edhe te komitetet e ngritura në Stamboll dhe gjetiu, formuan degë që nga Shkodra e deri në Manastir, nga Prishtina e deri në Berat e Vlorë. Gatishmëria për mbështetje pra ishte e madhe, ndoshta më e madhe se ç'kishte qenë edhe në Lidhjen e Prizrenit. Të gjitha këto janë të njohura dhe të shkruara në historinë tonë, por më duket se një shpjegim i rëndësishëm nuk është bërë i njohur sa duhet: Programi politik i kryengritjeve të Kosovës deri në vitin 1908 ishte për një *organizim autonom* të shqiptarëve në kuadër të Perandorisë osmane. I këtillë ishte një krah i udhëheqjes në organet dhe forumet e Lidhjes së Prizrenit, i dominuar nga turkoshakë të regjur, të cilët nuk kërkonin

asgjë më shumë se privilegjet që mund t'ua sillte një autonomi në kuadër të Perandorisë. Ideja e Shqipërisë së pavarur nuk përkrahej prej tyre. Krejt çka donin ata, ishte bashkimi i katër vilajeteve shqiptare në një njësi administrative, në të cilën do të kishte shkolla shqipe, nëpunës shqiptarë dhe pak gjëra më shumë se kaq. Këto ide ishin në agjendë përgjatë gjithë atyre viteve, duke kërkuar dhe duke gjetur mbështetës edhe në viset e tjera shqiptare.

Vetëm se një ndarje në ide tashmë kishte filluar të përvijohet. Ideja e *autonomisë* kishte gjetur mbështetje të gjerë në Kosovë, pjesërisht në vilajetin e Manastirit dhe shumë më pak në vilajetin e Shkodrës (Kuvendi i Gerçës). Pra, Kosova printe në këtë ide të prapambetur, ndiqej prapa nga sanxhaku i Dibrës dhe përgjithësisht nga zona me dominim të thellë të islamit dhe të kulturës orientale. Ndiqej edhe nga individë dhe nga qarqe thellësisht të prapambetura gjithandej hapësirës shqiptare. Por, te një pjesë tjetër e shqiptarëve tashmë kishte filluar të piqej ideja e pavarësisë. Te Kosova jo. Kosovarët, në shumicë, vazhduan të mbetnin ithtarë të autonomisë, ndonëse edhe në këtë pikë përkufizimi dhe ndarja nuk ishte gjithnjë e qartë. Nga ana tjetër, ndryshe nga viset e Shqipërisë së mëvonshme londineze, në Kosovën e këtyre viteve nuk zhvillohet ndonjë lëvizje kulturore, e cila do të ushtronte ndikim në vetëdijesimin kombëtar. Që atëherë vërehet një ndarje, ndoshta e para dhe më e madhja e kohës së re, ndërmjet Kosovës së zhytur thellë në orientalizëm kulturor dhe botës tjetër shqiptare, tek e cila tashmë kishin filluar të depërtonin ide më të avancuara politike dhe emancipuese. Kjo ndarje bëhet më e mprehtë dhe me pasoja largvajtëse, kur të marrim në dijeni faktin aspak të këndshëm se në Kosovë dhe në sanxhakun e Dibrës ideja e autonomisë ishte shumëfish më e përhapur, kundruall idesë së pavarësisë, e

cila tashmë ishte bërë dominuese në mbarë botën tjetër shqiptare.

Që këndeje, nga ideja e autonomisë erdh edhe një rreshtim i shqiptarëve në krah të xhonturqve, ndonëse nga kosovarët dhe nga shqiptarët e veriut nuk ishin të paktë të tillët që iu gjetën pranë Sulltan Hamitit edhe në ditët e fundit të pushtetit të tij, tashmë të urryer nga shumica e shtetasve të vet. Nuk bëhej fjalë për mbështetës të thjeshtë, por për njerëz që i qëndruan afër sulltanit në ditët e tij më të vështira, disa syresh (si një kushëriri im, Tahir Pasha i Krajës) duke e shoqëruar edhe në rrugëtimin e gjatë të internimit në Anadoll. Më anë tjetër, shqiptarë të tjerë kishin varur shpresat te xhonturqit, të cilët kishin premtuar reforma të thella dhe një përmirësim të ndjeshëm të të drejtave të tyre. Xhonturqit nuk i realizuan premtimet dhe, në raport me shqiptarët, mund të thuhet se ndikuan pozitivisht, që ata të hiqnin dorë përfundimisht nga ideja e autonomisë, ndërsa në raport me shtetin e tyre, ata e përshpejtuan degradimin e gjithanshëm të Perandorisë në Ballkan. Ideja se ata mund të merreshin vesh me shqiptarët, që t'i mbronin bashkërisht interesat e tyre kundrejt trysnisë në rritje për ta dëbuar Turqinë nga Europa, në radhë të parë duke pushtuar toka shqiptare, nuk funksionoi tamam asnjëherë. Xhonturqit dukej se ishin më antishqiptarë se monarkistët konservativë, prandaj nuk shkoi shumë kohë nga ardhja e tyre në pushtet dhe në viset shqiptare të Perandorisë filloi një rrëmujë e përgjithshme: sekush luftonte për sulltanin e sekush për pavarësinë e Shqipërisë; sekush merrte pushkë nga Serbia e sekush merrte para nga Austro-Hungaria apo Italia. Fija e perit që i ndante patriotët shqiptarë nga tradhtarët ishte tëholluar më shumë se kurrë.

Kryengritjet pa program

Në këtë situatë, Kosova nisi kryengritjet e njëpasnjëshme, por si gjithnjë, pa elitë udhëheqëse dhe pa program politik. Tani që ka kaluar një shekull nga ato ngjarje të rrëmujshme, gjithsesi shtrohet pyetja: Përse Kosova i bëri kryengritjet e viteve 1908-1912? Çfarë synonte të arrinte me ato luftëra, ku donte të shkonte? Të bënte pavarësinë? Në asnjë mënyrë, sepse pavarësia nuk mund të bëhej pa një rend gjërash, vetëm me bashibozukë të organizuar nëpër çeta. Duhej një program politik, duhej një organizim, duhej një udhëheqje politike. Kosovarët nuk e kishin asnjërin. Nëse Hasan Prishtina ishte marrë vesh me Komitetin e Stambollit që në Kosovë të niste lëvizjen për pavarësinë e Shqipërisë, atëherë del se dikush ose nuk iu përmbajt marrëveshjes, ose zhvillimet e rrëmujshme e nxorën situatën jashtë kontrollit. Çetat kosovare çliruan Prishtinën, Ferizajin dhe arritën deri në Shkup. Ismail Qemali, i fshehur diku në Lushnjë, nuk iu përgjigjet telegrameve të Hasan Prishtinës. Vetëm Hasan Prishtina duket se e di se çfarë fshihej pas gjithë kësaj, sepse shumë vjet më vonë do të shkruajë "Një shkurtim kujtimesh", që kurrë nuk do t'i bëjë kujtime të plota, jo sepse nuk ua kishte ngenë, por ngase nuk donte ta thoshte hapur të vërtetën. Sepse ky ishte veprimi më i marrë që bëjnë kosovarët: luftojnë, çlirojnë vendin, hyjnë si fitimtarë në Shkup, në kryeqendrën e vilajetit të Kosovës, dhe pastaj, me vendim të prijësve të kryengritjes, çetat demobilizohen. Pse? Sepse prijësit e kryengritjes nuk merren vesh për qëllimet e luftës. Isa Boletini synon të marrë rrugën për Selanik dhe që andej të shkojë në Stamboll, që të kthejë në fron Sulltan Hamitin, sepse xhonturqit ia kishin ndalë pensionin. Kështu e shpjegon situatën Hasan Prishtina, i cili duket se është i

vetmi që për pak nuk i vë duart mbi kokë, për t'ia dhënë kujës.

Sido që të jetë, në këto vite ndodhin aq shumë kryengritje gjithandej Kosovës dhe viseve të ndryshme të Shqipërisë, sa të krijohet ideja se shqiptarët luftojnë jo me një armik të vetëm dhe të përbashkët, me Turqinë, por një duzinë sish, që domethënë se luftërat ishin të paorganizuara, se prijësit lokalë i bënin luftërat secili për vete dhe secili për hesap të vet. Pastaj, duke menduar se mund të krijonin një aleancë me Turqinë, për t'u bërë ballë sulmeve të fqinjëve ballkanikë të organizuar në një front të përbashkët, shqiptarët humbën shumë kohë me kërkesa e memorandumë, në të cilët gjithmonë kërkonin të njëjtat gjëra: gjuhë, shkolla, flamur, pra një autonomi të përsëritur që nga Lidhja e Prizrenit e prapa. Turqia herë refuzonte kategorikisht, herë i zbuste fjalët, për shkak të rrethanave të ndjeshme me të cilat përballej, mirëpo asnjëherë nuk ia doli të merrej vesh tamam me shqiptarët. Më anë tjetër, ndonëse tashmë i kishin bërë të ditura sa e sa herë kërkesat e tyre, shqiptarët nuk reshtnin të mblidheshin herë në një kuvend dhe herë në një tjetër, dhe nga ato kuvende përsëri dhe përsëri i dërgoheshin Portës së Lartë të njëjtat kërkesa. Nga kuvendet dhe mexhliet e shumta, shqiptarët më në fund duket se u mësuan në njëfarë dore të merreshin vesh mes veti, sikundër që edhe kosovarët më konservativë e kuptuan përfundimisht se "baba Dovleti" nuk bënte më as për interesat e veta në Rumeli, e jo më për interesat e tyre. Prandaj edhe zërat e mbështetjes së Turqisë nëpër kuvende u bënë më të paktë dhe ithtarët e pavarësisë fituan terren. Por, ndërkohë, për shkak të këtyre kryengritjeve të pareshtura fuqia mbrojtëse e Turqisë kundrejt aleancës së shteteve ballkanike u dobësua ndjeshëm. Vetë shqiptarët, ndonëse ende i kishin armët në dorë, nuk bënë ndonjë

mbrojtje të organizuar. Një numër syresh, veçmas kosovarët, kërkuan shpëtimin duke u larguar në drejtim të Turqisë, bashkë me trupat turke, që tashmë pësonin disfatë pas disfatë.

Në vjeshtën e vitit 1912, Serbia sulmoi Kosovën dhe për dy muaj u masakruan mbi 25 mijë vetë. Tani ajo nuk e dëbonte popullsinë e Kosovës, si në rastin e Toplicës, por hynte shtëpi më shtëpi dhe i vriste të gjithë pa përjashtim. Kosovës nuk i doli në mbrojtje pothuajse askush. Në muajt vijues u pushtua edhe Shkodra nga Mali i Zi dhe trupat serbe ia mësyn Shqipërisë, për të realizuar ëndrrën e vjetër, daljen në Detin Adriatik. Nuk është shumë e qartë nëse disa burra të Kosovës, që braktisën vendin e tyre dhe shkuan në Vlorë për t'u bërë pjesë e Kuvendit Kombëtar, e bënë këtë nga motive patriotike, apo për të shpëtuar nga masakrat serbe. Ata që tashmë ishin identifikuar si armiq të Serbisë, si Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Idriz Seferi dhe ndonjë tjetër, nuk kishin si të shkonin në Vlorë, sepse gjendeshin në burgjet serbe. Megjithatë, Kosova u përfshi denjësisht në këtë ngjarje të rëndësishme, sepse atje shkuan shumë burra, si Salih Gjuka, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Mehmet Deralla, Vehbi Agolli, Isa Boletini, Riza bej Gjakova, Hajdin Draga, Dervish bej Peja, Zenel dhe Qerim Begolli etj. Duket se tani ideja për të bërë shtet shqiptar dhe për ta përfshirë Kosovën brenda tij ishte dominuese për të gjithë, sepse të gjitha opsionet e mëhershme kishin dalë të pasuksesshme.

Në të vërtetë, *ideja e shkëputjes* së Kosovës nga Shqipëria nuk kishte qenë ndonjëherë opsion i shqiptarëve, pavarësisht si ishin zhvilluar ngjarjet dhe pavarësisht rrjedhës së tyre. Por, më anë tjetër, ata nuk përpunuan ndonjë strategji të mbrojtjes së saj nga aneksimi, ndonëse krerët politikë ishin në dijeni për këtë. Është cinike të thuhet, siç dëgjohet ndonjëherë, se Shqipëria e sakrifikoi Kosovën

për të shpëtuar kokën e saj, sepse vetë ideja e ndarjes Shqipëri-Kosovë nuk ishte e ndërtuar mbi ndonjë ide politike e përpunuar më përpara ndër shqiptarët. Kjo ndarje ishte e vilajeteve turke. Por duhet pranuar se Shqipëria u bë aty ku është sot sa për shkak të insistimit të fuqive të mëdha, kryesisht Austro-Hungarisë dhe Italisë, për të mos i lënë dalje Rusisë (përmes Serbisë) në ujërat e ngrohta, po aq edhe për shkak të disa zhvillimeve politike brenda vetë mileut shqiptar. Disa prej këtyre zhvillimeve i kemi përmendur më herët. Tani është mjaft dilemore nëse themi se Kosova mbeti jashtë Shqipërisë më shumë për shkak të njërit apo të tjetrit faktor. Ndoshta faktori historik ka qenë vendimtar, respektivisht miti serb për Kosovën, i cili në sytë e europianëve nuk ishte krejt eterik dhe i stisur nga nacionalizmi serb, sepse në terren kishte një numër monumentesh fetare që dëshmonin për një përkatësi të krishterë të këtij territori. Dhe, të krishterë, në shumicën e tyre në Kosovë, nuk ishin shqiptarët rezidentë, por serbët pretendues. Por nuk ishte vetëm kjo. Edhe pse nuk kishin reshtur asnjëherë përpjekjet e shqiptarëve për ta zotëruar territorin e tyre, këtë kusht themelor për të përfshirë brenda shtetit një hapësirë ose një hapësirë tjetër, ata nuk kishin arritur ta plotësonin. Kur aktin final të bërjes së një shteti e përmbyllin të tjerët dhe jo banorët e tij, doemos që ai do të bëhet sipas shumë kompromiseve. Dhe do të bëhet duke hequr një copë ose një tjetër. Shqipërisë, natyrisht, nuk i hoqën vetëm Kosovën, sikundër që ishin tepër të predispozuar t'ia hiqnin edhe ndonjë copë tjetër, bie fjala Shkodrën dhe Korçën

Inferioriteti historik i Kosovës

Lidhur me këtë çështje, diskutimi rreth Kosovës dhe Shqipërisë tani mund të orientohet në një pikë: Cili ishte *trungu* dhe cila ishte *dega*? Ose, thënë më ndryshe, a duhej Kosova të bëhej Shqipëri, apo të ishte Shqipëria ajo që u bë në të vërtetë? Po u shikuan luftërat që bëri Kosova që nga Lidhja e Prizrenit dhe deri më 1912, do t'i binte Kosovës që të bëhej Shqipëri, që ajo të ishte *trungu* dhe që prej saj eventualisht të shtriheshin degët, ose edhe hiqeshin "copat" (sepse copat do hiqeshin doemos, përderisa shtetin ta bëjnë të tjerët). Unë them se, shikuar nga kjo distancë, nuk ishin vetëm interesat serbo-ruse ato që nuk e lënë Kosovën të merrte këtë rol në botën shqiptare. Nuk ishte as pjesa serbe historisë së saj. Më shumë ishte *identiteti i paqartë* ose pak i ngatërruar, fryma orientale që e dominonte, ambienti konservativ mysliman dhe lufta jo gjithmonë e konsistente që kishte bërë: autonomi në kuadër të shtetit turk, por jo pavarësi. Europa edhe ashtu kishte krijuar idenë se bërja e Shqipërisë do të thoshte një *Turqi e vogël* në Ballkan. Atëherë, ishte krejt normale që kjo "Turqi e vogël" të bëhej atje ku kishte më pak gjasa të ishte tamam Turqi. Dhe gjasat për këtë ishin pikërisht aty ku u bë Shqipëria, ku identiteti shqiptar (i pangatërruar aq shumë me identitetin fetar) ishte afishuar më qartë; ku tashmë ekzistonte një vetëdije kombëtare; ku civilizimi perëndimor kishte depërtuar ndjeshëm, edhe përkundër të qenit nën Turqi; ku kishte një lëvizje dhe emancipim kulturor etj.

Nëse merren për bazë këta faktorë (dhe merren gjithnjë, kur shteti bëhet në tavolinën e bisedimeve), atëherë ishte krejt logjike që qendër e bërjes së Shqipërisë të mos ishte Kosova, asnjë qytet i saj, asnjë krahinë e saj. Sepse Kosova kishte bërë luftëra të mëdha, herë të qarta e herë konfuze,

por kishte ngecur prapa në identitetin shqiptar. Prandaj, që nga kjo kohë, ajo do t'i shkojë prapa Shqipërisë në të gjitha vijat themelore të identitetit dhe do të jetë e varur prej saj në ide dhe në të gjithë përbërësit kulturor. Si mund të bëhej Shqipëria në Kosovë, kur, ta zëmë, Isa Boletini, i cili kishte shkuar në Vlorë për të mbrojtur shpalljen e pavarësisë, ndërsa e kishte parë flamurin shqiptar tek ishte shfaqur në ballkonin e asaj shtëpie të vogël, thonë se paskësh thënë nën zë: Koka si i Kralit!

Pra, që nga ajo kohë, Shqipëria është *diku tjetër* dhe Kosova nuk mund të ishte gjë më shumë, përveç se *atribut* i saj, ndajshim identitar. Që nga ajo kohë, identiteti kosovar zbret nga piedestali kombëtar dhe bëhet *identitet lokal*, ose *identitet territorial*, që domethënë njëri nga shumë identitete shqiptare, identitet i përdorshëm vetëm për të identifikuar një hapësirë fatkeqe shqiptare dhe një popullsi gjithashtu fatkeqe shqiptare. Etnonimi kosovar tani fillon të përdoret në Shqipëri për të identifikuar *Shqipërinë e jashtme*, Shqipërinë e mbetur të papërfshirë në hartën e saj londineze. Më anë tjetër, atributi kosovar nga vetë kosovarët, as atëherë dhe as më vonë, nuk merr ndonjë kuptim specifik, përveç se identifikon banorët e një hapësire. Që nga bërja e Shqipërisë, madje përpara se të ndodhte kjo, do të jenë vetë kosovarët që tashmë e pranojnë një lloj *inferioriteti historik* dhe një *rol të dytë* në historinë kombëtare. Kosova tashmë bëhet *linja e dytë* e rrëfimit shqiptar. Identiteti i saj është identitet mbështetës, bashkëngjitës, nuk është identitet parësor.

Prandaj, kësaj radhe Kosova do të shkonte në Vlorë dhe jo Shqipëria të vinte në Prizren, siç kishte ndodhur pjesërisht në një kohë të shkuar, sepse Prizreni vërtet që kishte trasuar rrugën e bërjen së kombit shqiptar, më vonë edhe të shtetit shqiptar, por këtë rrugë e kishte trasuar përmes autonomisë. Kurse tani duhej diçka tjetër, duhej pavarësi, e cila nuk

kishte qenë dhe nuk ishte ide nxitëse e Kosovës. Kosova duhej të shkonte në Vlorë, sepse në ide kishte mbetur prapa. Kosova, gjatë kryengritjeve të viteve 1908-1912 e kishte dëshmuar se kishte mangësi në formimin e vetëdijes politike. Mangësi kishin të gjithë shqiptarët, por Kosova më shumë se të tjerët, sepse kosovarët çliruan territore, por pastaj nuk ditën ç'bënin me atë liri që e fituan me gjak. Me veprimet që bënë, krejtësisht në mënyrë të pavetëdijshme, i ndihmuan Serbisë për pushtime dhe aneksime, më një anë duke e lodhur Turqinë deri në atë shkallë, sa ajo të mos ishte në gjendje t'i mbronte territoret e veta; ndërsa më anë tjetër, duke e dobësuar veten deri në gjendje molisjeje e dëshpërimi nga luftërat pa kuptim. Atëherë, çfarë mund të bënin kosovarët, në një gjendje të këtillë pa shpresë? Të iknin me Turqinë, gjë që e bënë një numër syresh; t'i bashkëngjiteshin idesë së pavarësisë dhe të shtetit kombëtar, që gjithashtu e bënë një numër jo i vogël; ose ta mirëpritnin pushtimin e Serbisë, që e bënë disa familje të mëdha, fatmirësisht në numër jo aq të madh, kryesisht për të ruajtur interesat dhe pronat.

Ndërkohë, Serbisë nuk i mjaftoi Kosova, por desh që situatën e krijuar ta shfrytëzonte për ta përmbyllur idenë e daljes në Adriatik, ashtu siç e kishin menduar që nga mesi i shekullit XIX ideatorët e programit nacional serb. Ushtria serbe hyri në territoret e Shqipërisë së sotme dhe gjithashtu bëri masakra, pothuajse si në Kosovë. Ashtu sikundër e shpjegon Tucoviçi, ideja e pushtimit të kësaj pjese të Shqipërisë ishte krejtësisht e gabuar, sepse vendimi për ta bërë Shqipërinë tashmë ishte marrë nga fuqitë e mëdha dhe Serbia, pas këtij inkursioni ushtarak, do të kthehej nga kishte ardhur. Tucoviçi i bën një kritikë të themeltë edhe idesë së daljes së Serbisë në det, përmes territoreve shqiptare ose në ndonjë mënyrë tjetër, sepse, konsideron ai, zhvillimet e

fundit në Europë tregojnë se Adriatiku dhe Mesdheu kurrë më nuk do ta kenë atë rol që e kishin pasur dikur. Por shqiptarët, veçmas kosovarët, u entuziazmuan kot me Tucoviqin, të cilin e “zbuluan” nga vitet ‘60 të shekullit të kaluar, e përkthyen shqip, e botuan dhe e ribotuan, e cituan dhe e afishuan, duke e sjellë gjithnjë si model të një serbi me qëndrim parimor ndaj çështjes shqiptare, sepse Tucoviqi në librin e tij “Serbia dhe Shqipëria” fsheh nga sytë e lexuesit dy gjëra esenciale: e para, ai me asnjë fjalë nuk e përmend Kosovën, pra, pushtimin e saj dhe vrasjen në masë të shqiptarëve, që domethënë se në këtë pikë, duke e heshtur, e arsyeton veprimin e Serbisë; dhe, e dyta, ai e quan të panevojshëm dhe të dëmshëm inkursionin ushtarak në Shqipëri, por nuk shpjegon motivin e masakrave serbe mbi shqiptarët, larg territorit të Kosovës.

E zëmë se për Serbinë, Kosova ishte “tokë e shenjtë” dhe se për “arnautët” e saj serbët kishte një mllef të vjetër, sepse ata, me ndihmën e Turqisë kishin mbajtur të pushtuar me shekuj “Jerusalem” e tyre. Prandaj, për hakmarrje, Serbia edhe mund t’i vriste kosovarët, të futej shtëpi më shtëpi dhe t’i faronte deri më një. Po përse të njëjtën gjë ta bënte, ta zëmë, në rrethinën e Elbasanit ose gjetiu? Përse ushtria serbe hynte nëpër fshatrat e Shqipërisë dhe i digjte shtëpitë me gjithë njerëzit brenda? Këtë nuk e shpjegon Tucoviqi, ndonëse veprimet e këtilla, që i kishte parë me sytë e tij, i kritikon me shumë elokuencë. Ai nuk e thotë se Serbia tashmë kishte përpiluar një program nacional, i cili në themel kishte zhdukjen e të gjithë shqiptarëve, pavarësisht se ku mund të ishin ata. Tucoviqi ka dijeni për këtë program, por nuk e radikalizon kritikën ndaj tij deri në atë shkallë, sa t’i bëjë vërejte të tilla esenciale elitës nacionale serbe. Mbi bazat e socialdemokracisë, ai vetëm kritikon

veprimet e kundërshtarëve të tij politikë, por asnjëherë idenë frymëzuese të kësaj politike.

Ndarja nga Shqipëria

Lufta e Parë Botërore dhe periudha deri në luftën tjetër të madhe, për Kosovën do të jetë kohë tragjike në të gjitha pikëpamjet, kohë e ripushtimit, kohë e ndarjes nga Shqipëria, kohë e vuajtjes, e prapambetjes, e etnocidit, e shpërnguljeve, e kulturocidit, e humbjes së identitetit, kohë që la shumë pasoja në kujtesën historike të kosovarëve dhe në vetëdijen e tyre të trashëguar. Gjatë viteve pararendëse, kosovarët mezi kishin arritur ta konsolidonin disi një identitet të luhatshëm ndërmjet fesë dhe përkatësisë kombëtare. Ata, sapo kishin filluar të liroheshin nga trysnia e *identitetit të dyzuar*, menjëherë u përjashtuan nga tërësia kombëtare, të cilën doemos që e krijon secili shtet përmes mekanizmave të tij. Por nuk ishte vetëm kjo. Të qenit shqiptar, ndonëse asnjëherë nuk kishte qenë ndonjë privilegje e madhe, për kosovarët tani kjo përkatësi bëhet fatkeqësi më vete, shenjë për diskriminim në të gjitha format, deri në zhdukje fizike. Duke qenë fillimi shekullit XX dhe koha e asaj lufte që vrau mbi 50 milionë njerëz, ishte e pritshme se nga fuqitë e mëdha nuk do të kishte ndonjë reagim serioz rreth trajtimit çnjerëzor që u bëhej kosovarëve nga Serbia dhe më vonë edhe nga Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene. Europa e dinte se çfarë po ndodhte me shqiptarët në Kosovë dhe në viset e tjera të pushtuara dhe të aneksuara, sepse në drejtim të kancelarive perëndimore shkuan shumë ankesa dhe peticione, sikundër që u bënë edhe shkrime të shumta në shtypin e atëhershëm. Mirëpo,

atëbotë, mekanizmat për ndërhyrje në rast të shkeljes së të drejtave të njeriut nuk ishin aspak funksionale, megjithëqë tashmë ishin ratifikuar disa konventa për mbrojtjen e minoriteteve dhe Mbretëria Jugosllave ishte nënshkruese e tyre.

Ja disa fakte relevante se çfarë ndodhi në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të pushtuara nga Serbia pas vitit 1912 dhe të aneksuara pas Konferencës së Londrës të vitit 1913. U mor një territor shqiptar prej 24 mijë kilometër katrorë, që banohej me rreth një milionë banorë, 80% shqiptarë. Pra, me sipërfaqe pak më e vogël se Shqipëria e 1913-ës, ndërsa me banorë më shumë se ajo. Gjatë Luftës së Parë Botërore, Kosova u nda në zonën austro-hungareze dhe bullgare. Në zonën bullgare popullsisë iu konfiskua drithi dhe ndodhi një vdekje masive e njerëzve nga uria. Më 1918 Kosova u ripushtua nga Serbia me ndihmën e francezëve, të cilët hynë të parët në Kosovë, u priten pa rezistencë nga popullsia, ndërsa ata ndihmuan Serbinë që të vendoste administratën dhe pushtetin ushtarak. Konferenca e Versajës, e organizuar nga fuqitë e mëdha fituese të Luftës së Parë Botërore, konfirmoi vendimet e Kongresit të Berlinit dhe të Konferencës së Londrës për aneksimin e territoreve shqiptare. Në Kosovë nuk pushoi rezistenca e armatosur, u krijuan zona të çliruara. Kosovarët nuk e pranorin kufirin me Shqipërinë. Në Shqipëri vepronte Komiteti për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës me Kadri Prishtinën, Bajram Currin, Hasan Prishtinën dhe emra të tjerë të shquar të lëvizjes politike në Kosovë. Në Kosovë nuk lejohen shkollat shqipe, gjuha shqipe në përdorim zyrtar, librat shqip, shkrimi shqip. Më 1919 në Shkup formohet partia myslimane-turke "Xhemijet" në krye me Nexhip Dragën, e cila në legjislaturën 1920-24 arriti të kishte 17 deputetë. Elektorati dhe aktivistët e partisë ishin shqiptarë. Më 1925 pushteti

mbyll edhe këtë parti, burgos Ferhat Dragën dhe shumë aktivistë të tjerë dhe ndal gazetën e saj. Sapo u bë pushtimi i Kosovës, filloi shpronësimi i shqiptarëve dhe kolonizimi i saj, i cili u zyrtarizua me të ashtuquajturin *ligj i reformës agrare*, i nxjerrë më 1919 dhe i plotësuar më 1933. Kështu, në periudhën 1919-1941 në Kosovë u shpronësuan 192 mijë hektarë tokë dhe, sipas Bato Tomasheviqit (“Jetë dhe vdekje në Ballkan”), i cili vetë rridhte nga një familje kolonësh malazezë nga Mitrovica, pas aneksimit të Kosovës në tokat e pushtuara u vendosen 70 mijë kolonë sllavë, të cilët krijuan mbi një mijë vendbanime. Më 1912 Kosova kishte 90% shqiptarë, ndërsa më 1941 ky numër ra në 70%. Përveç vrasjeve sistematike, urisë, sëmundjeve, kolonizimit, në këtë rënie të numrit të popullsisë shqiptare ndikuan edhe shpërnguljet, kryesisht për në Turqi dhe Shqipëri. Një numër i atyre që fillimisht u shpërngulën për Shqipëri, që andej serish përfunduan në Turqi. Historianët shqiptarë thonë se numri i të shpërngulurve arrinte shifrën prej 240 mijë vetash. Më 1937 në Stamboll u hartua konventa jugosllavo-turke “për shpërnguljen e popullsisë turke nga rajoni i Serbisë Jugore të Jugosllavisë”, sipas të cilës parashihej që në periudhën 1938-1944 të shpërnguleheshin edhe 400 mijë shqiptarë të tjerë në Turqi, por për shkak të rrethanave që i paraprinë Luftës së Dytë Botërore, konventa nuk u ratifikua nga Turqia.

Pra, janë tridhjetë vjet të tjera, që bëjnë njërin nga kapitujt më të dhembshëm të historisë së Kosovës, një situatë pa shpresë dhe pa shtegdalje. Mbi Kosovën e çrregulluar në çdo pikëpamje Serbia vepron në mënyrë barbare, Turqia i ndihmon politikat e saj, ndërsa Shqipëria, pasi e sheh se është e pafuqishme të ndryshojë gjendjen, shpreh keqardhje dhe sillet me mospërfillje. Ndërsa në Kosovë shqiptarët vriten në masë, më 1924 Zogu bën

marrëveshje me Pashiqin për t'u kthyer në pushtet, ndërkohë që Noli, tri ditë pasi ishte bërë kryeministër i Shqipërisë, kishte pezulluar Komitetin e Kosovës. Duket sikur Zogu dhe Noli vihen në garë, se kush do të stabilizojë një shtet shqiptar, duke përfillur interesat sllave në Ballkan, të Rusisë dhe të Serbisë. Zogu del më i shkathtë në çdo pikëpamje.

Edhe përkundër kësaj situatë refuzuese me Shqipërinë, pikërisht tani varshmëria e Kosovës ndaj shtetit shqiptar do të bëhet e madhe dhe e pashkëputshme. Kosova nuk gjen mbështetje tjetër. Pa Shqipërinë tani ajo nuk mund të bëjë gjë, qoftë në pikëpamje të vlerave jomateriale, qoftë edhe në pikëpamje fizike: secili kosovar e di se, nëse arrin t'i kalojë malet, matanë është Shqipëria, e cila, së paku, ia siguron jetën. Këtë shpëtim e kërkojnë dhe e gjejnë jo vetëm ata që bien në kundërshtim me ligjin për shkaqe politike, por edhe ata që bëjnë krime ordinere. Shqipëria tani bëhet pikë referimi për të gjithë kosovarët, me ose pa vetëdije kombëtare. Ata nuk kanë shumë mundësi zgjedhjeje. Ata që zgjedhin Serbinë janë të paktë, sepse as Serbisë nuk i duhen shumë të tillë, përveç disa familjeve bejlerësh dhe një numër i kufizuar nëpunësish dhe bashkëpunëtorësh. Këta rekrutohen kryesisht nga shtresa qytetare, e cila në Kosovë për shumë kohë vazhdon të ketë identitet të luhatshëm: herë quhen turq, herë shqiptarë, varësisht nga rrethanat.

Pra, strategjia serbe ishte e qartë: elementi shqiptar i përfshirë në Jugosllavinë e Versajës duhej të zhbëhej me metoda të kombinuara, me terror, me vrasje, me asimilim, me uri, me epidemi etj. Të gjitha këto metoda nuk do të jepnin rezultat, sa shpërngulja në Turqi, e cila e rrëronte në mënyrë jashtëzakonisht efikase elementin shqiptar në Kosovë. Por strategjia e shpërnguljes nuk ishte e thjeshtë. Së pari duhej penguar në çdo mënyrë krijimin dhe fuqizimin e

identitetit shqiptar: s'ka shkolla shqipe, s'ka shkrim shqip, s'ka gjuhë shqipe, s'ka kombësi shqiptare; por ka me shumicë mejtepe në gjuhën turke, xhamia me hoxhallarë që predikojnë Turqinë, madje ka edhe parti politike turke. Pra, çdo gjë që është shqiptare në Kosovën e atyre viteve bëhet përpjekje të konvertohet në atë turke. Situata në Kosovë ishte studiuar mirë nga Serbia. Serbët e dinin se një pjesë e kosovarëve kishin pasur telashe jo të vogla me identitetin e tyre gjatë sundimit të Perandorisë Osmane. Edhe tani nuk ishte i paktë numri i kosovarëve që identitetit fetar i jepnin përparësi karshi atij kombëtar. Të tjerët, për shkak të vetëdijes së munguar, identitetin fetar e identifikonin me identitetin kombëtar. Ky element i paqëndrueshëm i Kosovës ishte "lëndë" e përshtatshme për zhbërje: lehtë bëheshin turq dhe po kaq lehtë shpërnguleshin për Turqi. Në këtë mënyrë, edhe karshi bashkësisë ndërkombëtare, Serbia dhe Turqia dilnin të lara, sepse çonin në vend "vullnetin e popullit".

Nuk mund të thuhet se Shqipëria nuk ishte e ndjeshme ndaj kësaj situatë në Kosovë. Ndoshta ajo as që mund të bënte më shumë. Kosovarët e ikur i strehonte, fëmijëve të tyre iu jepte shkollë, kufirin me Kosovën e mbante poroz. Madje, ndonjë ithtar i Zogut do të thotë se ai u shpall mbret i shqiptarëve pikërisht për këtë arsye, që të ishte një lloj simboli i unitetit kombëtar dhe i mbrojtjes edhe i shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë. Ose që të shprehte edhe aspiratën e tij për një shtet shqiptar unik dhe tërësishëm. Është e vërtetë se ai, formalisht dhe publikisht, nuk pengoi ndonjë lëvizje nacionaliste në Shqipëri, e cila do ta merrte në konsideratë çështjen e Kosovës, por as e fuqizoi ndonjërin prej tyre. Më e keqja ishte se kundërshtarë të tij politikë, më të ashpër dhe më të papajtueshëm, u bënë pikërisht ata që dikur kishin qenë patriotë të mëdhenj,

ndërsa tani nuk i miratonin politikat e tij kombëtare. Nuk ishte kjo luftë për pushtet, sikundër e paraqesin disa. Nuk vritej Bajram Curri në malet e Dragobisë, për shkak se ai gjoja ia rrezikonte pushtetin Zogut në Tiranë. Më shumë duket se ishte një zotim i Zogut dhënë Pashiqit. Ç'i pengonte atij Hasan Prishtina, që ta vriste më 1933, në kohën kur ai tashmë kishte arritur stabilizim të plotë të pushtetit?

Me këto veprime kriminale dhe të përgjakshme, Zogu po bënte diçka tjetër shumë më të rëndësishme se ç'ishte vrasja e dy simboleve të Kosovës: e para dhe më e rëndësishmja, ai po ridimesiononte politikën e shtetit shqiptar ndaj Kosovës, që tani e tutje do të ishte politikë realiste dhe jo aventuriere, pra politikë e shtetit të vogël dhe të dobët dhe jo politikë e një kombi të frustruar; dhe, e dyta që po ashtu lidhet me këtë, ai, bashkë me të edhe shteti shqiptar, po i dërgonin mesazh Kosovës se Shqipëria, në asnjë rrethanë nuk do t'i rrezikonte interesat e saj, aq më pak ekzistencën e vet, për shkak të një idealizmi kombëtar, siç ishte tani përfshirja e Kosovës në të njëjtin shtet. Për kosovarët përfshirja e tyre në kuadër të shtetit shqiptar mund të quhej domosdoshmëri, mund të quhej luftë për jetë a vdekje. Për shtetin shqiptar kjo urgjencë e kosovarëve nuk kishte të njëjtin kuptim. Prandaj, Zogu dëshmoi se në këtë pikë ai dhe shteti që përfaqësonte ishin partnerë seriozë të fuqive të mëdha, të cilat kishin marrë vendime për këtë mënyrë të rregullimit të situatës ballkanike dhe donin që këto vendime të zbatoheshin dhe të ishin të qëndrueshme. Ai dëshmoi se këtë ridimensionim të politikës së tij ndaj Kosovës do ta çonte deri në fund, deri në zhdukjen fizike të oponentëve të saj.

DYZIMET IDENTITARE

Avantazhet e pushtimit

Lufta e Dytë Botërore krijoi një precedent të çuditshëm, ndoshta më të çuditshmin në Europën e atëhershme: Kosova jetoi më mirë gjatë viteve të kësaj lufte, se sa në paqen e deriatëhershme dhe asaj që erdh pastaj. Pushtimi i Kosovës ishte nazifashist, pra nuk kishte ndonjë emër tjetër. Italia që pushtoi Shqipërinë dhe pastaj pjesën më të madhe të Kosovës, ishte po ajo Itali fashiste e Musolinit, njësoj si Gjermania naziste e Hitlerit, e cila shkaktoi aq shumë vdekje dhe vuajtje në Europë dhe më gjerë. Nuk duhet paragjykuar arsyet përse ky pushtim nuk ishte as i urryer dhe as i dëmshëm për Kosovën. Para se të ndodhte pushtimi, kosovarët kishin përjetuar gjenocid të tmerrshëm. Edhe pas luftës, me ardhjen e komunistëve në pushtet, ndodhi po e njëjta gjë. Prandaj, nuk ka asnjë arsye t'i vihet embargo shqyrtimit real të kësaj çështjeje, vetëm pse një *zgjidhje më të mirë për Kosovën* e gjeti fashizmi dhe nazizmi, sesa demokracitë e përparuara evropiane. Është paradoksale dhe tepër cinike kjo situatë: për shkak se nazifashistët gjetën për Kosovën një zgjidhje më të drejtë, më normale se evropianët e Kongresit të Berlinit, të Konferencës së Londrës dhe të Versajës, kosovarët duhet ta vuajnë përjetësisht padrejtësinë që u bëhet, vetëm për shkak se këtë zgjidhje e gjetën dhe e aplikuan të parët nazifashistët. Evropianët është dashur që këtë çështje ta shtronin pak më ndryshe: Çfarë kishte që nuk

shkonte në projektin e tyre për Ballkanin dhe shqiptarët, dhe jo ta shpallin herezi zgjidhjen e çështjes së Kosovës përmes revidimit të kufijve dhe të përfshirjes së saj në një shtet të vetëm shqiptar. Fantazma e të ashtuquajturës *Shqipëri e Madhe* do t'i ndjekë fuqitë vendimmarrëse të Europës edhe gjashtëdhjetë vjet pas Luftës së Dytë Botërore, duke sjellë në vëmendje të botës një plan të tillë për Kosovën, që në të gjitha pikat relevante duhej të ishte i ndryshëm nga zgjidhja që kishin gjetur dikur nazifashistët. Për europianët ky është një kompleks i pashërueshëm, për kosovarët kjo është një nëmë e keqe.

Megjithatë, situata e krijuar me Kosovën gjatë Luftës së Dytë Botërore do të ketë disa avantazhe, edhe pas përfundimit të luftës dhe në vitet që erdhën pastaj. Është e vërtetë se kosovarët u bënë komunistë më pak se të gjithë të tjerët dhe më pak se bashkëkombësit e vet shqiptarë morën pjesë në LNC. Arsyeja ishte e qartë dhe e thjeshtë: ata e kishin më mirë se ç'e kishin pasur ndonjëherë dhe përfshirja në luftën antifashiste, komuniste ose jokomuniste, kishte kuptimin e kthimit të gjendjes së mëparshme në Kosovë, pra kthimin e Serbisë. Kjo mund të mos ishte vetëdije politike e kosovarëve, më shumë mund të ishte frikë dhe instinkt, një instinkt që e parandiente rrezikun real. Mirëpo, me ardhjen në pushtet të komunistëve dhe me përfshirjen e përsëritur të Kosovës në Serbi dhe Jugosllavi, paralelisht me dhunën sistematike, me vrasjet dhe përndjekjet në masë, pushteti i ri do të jetë i detyruar t'ua siguronte kosovarëve disa të drejta, sado minimale që mund të ishin ato. Nëse nazifashistët kishin lejuar mësimin në gjuhën shqipe, madje e kishin stimuluar atë, do të ishte absurde që këtë të mos e bënte *pushteti populluer*. Nëse nazifashistët dhe kuislingët e kishin bërë administratën shqip, pushteti i ri nuk mund të binte aq poshtë, sa ta pezullonte atë në tërësi. Më anë tjetër, lidhjet që

ishin vendosur ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë gjatë kohës së okupimit, nuk mund të shkëputeshin aq lehtë, sepse kjo lidhje tashmë nuk ishte thjeshtë fizike, por kishte depërtuar më thellë, ishte bërë lidhje shpirtërore. Ishin krijuar dhe vazhdonin të krijoheshin edhe varshmëri të tjera, nga të cilat më me rëndësi ishin ato kulturore dhe arsimore. Të mësoje fëmijët e Kosovës të lexonin shqip, duheshin abetare nga Shqipëria; ta shtypje “Rilindjen” shqip në Prizren, duhej të shkoje t’i merrje shkronjat shqip në Tiranë, siç u detyrua të bënte Fadil Hoxha. Pra, në pikëpamje arsimore dhe kulturore, Kosova pa asnjë mundësi tjetër, u lidh fort pas Shqipërisë dhe e tillë do të mbetet që atëherë dhe tutje, pavarësisht zhvillimeve të pafavorshme politike që erdhën pastaj.

Këto lidhje komunistët u munduan t’i modifikonin dhe t’i ç’naturalizonin që me shfaqjen e tyre të parë në skenën politike. Në vend të lidhjes së gjakut, të lidhjes së gjuhës, të traditës, të mentalitetit e të etnopsikologjisë, ata fuqizuan dhe i dhanë përparësi lidhjes në vijën ideologjike. Përkatësinë ideologjike ata e vendosen mbi përkatësinë kombëtare. Në raportet e ndërvetshme që krijuan komunistët shqiptarë, pastaj komunistët shqiptarë me ata serbë e jugosllavë, rëndësia e përkatësisë kombëtare u zhvendos në prapavijë, për t’ia lënë vendin ideologjisë. Është e vërtetë se komunistë shqiptarë në Kosovë u bënë kryesisht ata që morën pak shkollim në Shqipëri, u lidhen me grupet komuniste të Shkodrës, Korçës ose Tiranës, por ideologjia që të gjithë i çoi shumë shpejt në lidhje të forta me komunistët serbë dhe jugosllavë, duke ua dobësuar gradualisht lidhjen natyrore me Shqipërinë. Vetë komunistët e Shqipërisë për një kohë të shkurtër u bënë vasalë ideologjike dhe organizativë të komunistëve jugosllavë. Në këtë pikë, përveç Kominternës, një rol

shkatërrimtar duhet ta kenë luajtur edhe komunistët shqiptarë të Kosovës, të cilët, të gjithë pa përjashtim e identifikuan rolin e organizimit partiak me spiunimin ordiner. Fundja, është e njohur se i pari që përhapi idetë komuniste në Shqipëri, që kishte lidhje me Kominternën dhe me komunistët serbë të Pejës, ishte Ali Kelmendi.

Në grupet komuniste të Shqipërisë, veçmas në atë të Shkodrës, por më vonë edhe të Tiranës, pjesëmarrja kosovare ishte shumë e dukshme. Si mund të shpjegohet ky fakt? Çfarë i lidhte kaq fort kosovarët me komunizmin, sa ata në këtë rast, së paku përpjestimisht, t'ua kalonin shqiptarëve të Shqipërisë? Në pikëpamje arsimore dhe të përgatitjes intelektuale, që domethënë edhe ideologjike, kosovarët ngeleshin shumë prapa, në krahasim me pjesëtarët e grupeve nga Shqipëria. Përse ata, pra, ishin aq të shumtë në numër? Pothuajse shumica e nxënësve kosovarë të shkollave të mesme nëpër Shqipëri, u bënë komunistë dhe u përfshin në LNÇ. Ata, në përgjithësi, nuk vinin nga një *trashëgimi proletare*. Shumica syresh ishin bij zejtarësh të kamur, që nuk kishin probleme sociale, sepse të tillët zakonisht nuk shkonin në Shqipëri të bënin shkollë. Nëse ata jo, prindërit e tyre kishin edhe njëfarë vetëdijeje kombëtare, ndryshe fëmijët e tyre mund t'i futnin nëpër shkolla serbe dhe mejtepe turke. Atëherë, si ndodhi që ata, pothuajse pa përjashtim, u përfshin në të njëjtën mënyrë në grupet komuniste (shpesh nga të njëjtit persona), u bënë tradhtarë të Kosovës dhe të çështjes kombëtare në të njëjtën mënyrë, vranë kundërshtarët e tyre politikë brenda radhëve, të gjithë pa përjashtim spiunuan ku arritën, te Pavli, te Bora, te Spasoja etj., morën pjesë në ngjarjet kontradiktore dhe ndërvetshëm përjashtuese, siç ishte Konferenca e Bujanit dhe Kuvendi i Prizrenit, qëndruan në pushtet për një kohë relativisht të gjatë dhe prapë nuk e dekonspiruan njëri-tjetri

as në amanetin e fundit të jetës...? Pra, si mund të ndodhte kjo? Përgjigja më e mundshme është se ata nuk ishin njerëz politikë, me një organizim të thjeshtë politik. Gjithsesi ishin diçka më shumë se kaq.

Improvizimi i luftës

Nga ajo që kemi lexuar nëpër librat e kujtimeve të pjesëmarrësve të LNÇ-së të Kosovës, mund të nxirret përfundimi se kosovarët nuk bënë ndonjë luftë për të qenë. Ata e improvizuan luftën, aty ku patën mundësi ta bënin këtë, zunë ndonjë pritë, bënë edhe ndonjë atentat, kryesisht mbi ndonjë bashkëpunëtor të armikut dhe pjesën më të madhe të kohës së luftës e kaluan nëpër ato zona malore, ku ushtritë italiane e gjermane as që dukeshin asaj ane, qoftë në malet e Sharrit, nëpër bjeshkët e Tropojës apo pjerrinave të pakalueshme të grykave të Valbonës. Kishte edhe raste të shpeshta të demobilizimit, të kthimit në shtëpi, që domethënë se për trimat partizanë jo që nuk dinte gjë ushtria armike, por edhe njerëzit e mëhallës mungesën e tyre e pandehnin si shkuarje te dajallarët ose dalje në bjeshkë. Në ndonjë rast, kur këta partizanë mund të bëheshin të bezdisshëm, ushtritë pushtuese ndërmerrnin aksione të shpejta përmasash të kufizuara, vritnin ose kapnin disa syresh, vetëm sa t'ua bënin të ditur njerëzve se andej rrotull silleshin ca djem të rinj me mendje çiliminjsh, që donin ta futnin përsëri Kosovën nën Serbi. Gjithashtu, kam vënë re se pothuajse asnjëherë nuk thuhet numri i saktë i pjesëtarëve në këto njësi partizane, sepse duket të ketë qenë tepër i vogël, i tillë që demanton plotësisht idenë e një mbështetjeje të gjerë e lëvizjes te popullsia e Kosovës. Por

edhe këtu duhet bërë një saktësim: mbështetjen më të madhe idetë komuniste e gjetën te popullsia sllave, veçmas te ajo malazeze e Pejës me rrethinë (për shkak të lidhjeve tradicionale me rusët), ndërkohë që serbët e Kosovës ishin mbështetës të flakët të ideve çetnike.

Ndërkaq, glorifikimi i LNÇ-së dhe i bëmave të paqena të partizanëve të Kosovës nuk lidhet vetëm me faktin e njohur se historitë e luftërave e shkruajnë fitimtarët, as me të dhënë se glorifikimi i LNÇ-së u krijonte komunistëve një lloj argumenti për mbajtjen e pushtetit. Duan të thonë se ky glorifikim krijonte në Kosovë edhe disa efekte të tjera, ta zëmë, se autonomia e Kosovës nuk ishte një dhuratë që Titoja ua kishte bërë shqiptarëve, siç shpreheshin nacionalistët serbë, por bazat e kësaj autonomie ishin vendosur që në kohën e luftës, me pjesëmarrjen e barabartë të kosovarëve në lëvizjen antifashiste, krah për krah me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Por edhe më shumë se kaq, pjesëmarrjes së kosovarëve në LNÇ, njësoj sikundër edhe përfshirjes së tyre në organizimin e PKJ-së, kohëve të fundit kanë filluar t'i atribuojnë edhe efekte që kurrë nuk i ka pasur dhe nuk ka mundur t'i ketë. Kështu, ta zëmë, gjithnjë e më shpesh thuhet se, po të mos kishte ndodhur pjesëmarrja e shqiptarëve të Kosovës në lëvizjen antifashiste dhe përfshirja e tyre në organizimin komunist jugosllav, fati i kosovarëve do të ishte i njëjtë me atë të çamëve në Greqi, ose i "folkdojçerëve" të Vojvodinës. Pra, një dëbim i tyre masiv nga Kosova.

Vërtet, a mund të ndodhte diçka e tillë, apo këto janë argumente që përdoren tash së fundi, për të justifikuar gjëmën e madhe që i solli Kosovës ripushtimi komunist, apo për të korrigjuar disi këtë pjesë të palavdishme të historisë? Së pari, krahasimi i kosovarëve me çamët është i paqëndrueshëm, sepse bëhet fjalë për dy popullsi

numerikisht të pakrahasueshme. Përveç kësaj, dëbimi i kosovarëve në Shqipëri nuk do të mund të ndodhte, sepse në të dy vendet, edhe në Jugosllavi, edhe në Shqipëri kishin fituar dhe kishin ardhur në pushtet komunistët dhe ata formalisht e kishin proklamuar se regjimi i ri do të gjente zgjidhjen më ideale për çështjen kombëtare: vëllazërimin e popujve. Nëse kjo ishte gënjeshtër, e që ishte gënjeshtër nuk ka asnjë dyshim, atëherë Jugosllavia nuk do të bënte me shqiptarët të njëjtën gjë që kishte bërë Greqia me çamët edhe për faktin se çamët ishin e vetnija popullsi myslimane në atë vend, në një kohë që në Jugosllavi, përveç shqiptarëve, kishte edhe një popullsi sllave me besim mysliman (boshnjakët).

Më anë tjetër, kosovarët nuk mund të krahasoheshin as me "folkdoçerët" e Vojvodinës, sepse ata ishin pakicë gjermane që kishin mbështetur Hitlerin dhe kishin marrë pjesë aktive në luftërat e tij. Dëbimi i tyre nga Vojvodina nuk ishte fenomen i shkëputur, por ndodhi në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë me dëbimin e pakicave gjermane pothuajse nga të gjitha shtetet e Europës Lindore. Fundja më në fund, dëbimi i kosovarëve për në Turqi u riaktivizua shumë shpejt pas Informbyrosë, që domethënë se pjesëmarrja në LNÇ nuk i ndihoi ata që të shpëtonin nga kjo e keqe, sapo në Jugosllavi u krijuan rrethanat e përshtatshme për një gjenocid të ri.

Mbi të gjitha, nga librat e kujtimeve që i përmendëm më sipër, mund të kuptohet në mënyrë të tërthortë se roli i kosovarëve në lëvizjen komuniste jugosllavo-shqiptare nuk ka qenë aq i madh dhe as vendimtar, por më shumë ka pasur rëndësinë e mbështetjes për jugosllavët dhe të marrjes së informacionit të nivelit jo shumë të lartë. Deri në Konferencën e Bujanit kosovarët i shohim të vrapojnë sa andej, sa këndej, herë duke shoqëruar ndonjë person të

rëndësishëm jugosllav që shkonte në Shqipëri, herë të tjera duke shoqëruar emisarë të Shqipërisë që vinin në Kosovë. Por gjithnjë, pas secilës ecejake nëpër Shqipëri, Fadil Hoxhën, ta zëmë, e shohim duke ngarendur që sa më shpejt t'i bëjë raport Pavle Joviqieviqit ose Boro Vukmiroviqit në Vitomiricë të Pejës. Sikundër që do të shihet në ndonjë rast, informacione të nivelit të lartë as që kishin mundësi të bënin komunistët kosovarë, sepse, ta zëmë, Enver Hoxhën nuk e spiunonte dot te jugosllavët Fadil Hoxha, sepse lidhjet e tij nuk shkonin më larg se në Vitomiricë, në një kohë që për takimin e këtyre dy "hoxhallarëve" në Tiranë, Beogradi do të informohej nga dora e parë, nga vetë Koçi Xoxe. Prandaj, kur e sheh se diçka e tillë ka ndodhur, Fadil Hoxha zihet ngushtë, jo pse me Enver Hoxhën kishte folur diçka që do t'ua fshehte jugosllavëve, por nga se e vëren rolin e vet tepër të vogël te jugosllavët, madje edhe në raport me "kushëririn" e tij në Tiranë.

Konferenca e Bujanit

E zëmë se tani, një ngjarje me rëndësi, që duhej të kishte *rol identitar* në historinë e Kosovës, do të duhej të ishte Konferenca e Bujanit. Historianëve të Kosovës asnjëherë nuk ka qenë e mundur t'u thuash se Bujani nuk kishte asgjë nga ato që do të mund ta bënë ngjarje të madhe. Madje edhe Noel Malcolm shprehet se "Rezoluta e Bujanit paraqiste dokumentin themelor të vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës". Në vitet e para të pasluftës, ngjarja pothuajse ishte heshtur nga vetë ata që e kishin organizuar. Nga vitet shtatëdhjetë, në kohën e autonomisë, filloi të përmendej më shpesh, por gjithmonë duke i mëshuar idesë së

jugosllavizmës dhe të bashkim-vëllazërimit. U bë ngjarja më e rëndësishme e LNÇ-së për Kosovë pas viteve nëntëdhjetë, atëherë kur në Kosovë filloi një garë e të gjithëve, për të thënë se për Kosovën kishin punuar edhe bashkëpunëtorët e nazifashizmit, njësoj si edhe bashkëpunëtorët e OZNA-s dhe të UDB-së. Këtë idil rreth Bujanit nuk doli kush t'ua prishte ish-partizanëve të Kosovës dhe mbase nuk do t'ua prishnim as këtë radhë, sikur disa syresh, bashkë me historianët e tyre, të mos dilnin të thoshin se Konferenca e Bujanit, për nga rëndësia që kishte për Kosovën, ishte e barasvlershme me Lidhjen e Prizrenit. Kjo është një gënjeshtër e madhe.

Ja disa fakte rreth saj, të cilat, nëse dimë t'i lexojmë, flasin pak më ndryshe. Disa historianë thonë se Konferenca e Bujanit u mbajt si përgjigje e organizmave të LNÇ-së në Kosovë kundrejt trysnisë në rritje të PKJ-së dhe UNÇJ-së, të cilët kërkesën e zëshme të shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje do ta cilësojnë si *ndikim të linjës shqiptaromadhe*. Pra, sipas shkresave që iu vijnë radhazi udhëheqësve të LNÇ-së në Kosovë në vjeshtën e vitit 1943, kryesisht nga Tempoja, jugosllavët nuk donin që në këtë fazë të diskutohej çështja e kufijve, e aq më pak nëse Kosova do të shkonte me Shqipërinë ose do të mbetej me Jugosllavinë. Po këtë gjë ia thotë udhëheqjes së PKSH-së edhe Titoja, në një letër dërguar në fillim të dhjetorit të po atij viti. Më anë tjetër, Kosova nuk ishte përfaqësuar as në Mbledhjen e Dytë të AVNOJ-it, që donte të thoshte, sipas disave, se ajo nuk llogaritej si pjesë e Jugosllavisë, ndërsa sipas të tjerëve, se ajo nuk do të përfaqësohej në nivel jugosllav, por do të ishte pjesë e Serbisë. Në një rrethanë të këtillë, thonë historianët, udhëheqësit e LNÇ-së në Kosovë nuk panë zgjidhje tjetër, përveç se të konvokonin një mbledhje, në të cilën do të formohej Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës, me ç'rast do

të viheshin bazat e pushtetit popullor dhe të strukturave të tij të organizuara.

Deri këtu gjërat janë relativisht të qarta, por tani lind një pyetje tjetër: Kush ishte nismëtar i organizimit të Konferencës së Bujanit? Përgjigja është një dhe vetëm një: Komiteti Krahinuer i PKJ-së për Kosovë dhe Metohi. Atëherë, këta komunistë të Kosovës, që ishin avangarda e LNÇ-së, që paskan vendosur të mbahej Konferenca e Bujanit, në të cilën qartë do të thuhej se Kosova do t'i bashkohej Shqipërisë, përse edhe më tej ishin strukturë e organizuar e PKJ-së dhe jo e PKSH-së? Si bëhet, pra, që avangarda e LNÇ-së në Kosovë, komunistët pra, në njërën anë të ishin pjesë e organizimit partiak jugosllav, ndërsa në anën tjetër, si struktura të organizimit të pushtetit popullor, të merrnin vendime që shkonin kundër këtij organizimi? Nëse komunistët e Kosovës donin që Kosova t'i bashkohej Shqipërisë, kush i ndalte ata që si strukturë partiake me kohë të lidheshin me PPSH-në? Nuk donin vetë? Le ta thonë. Nuk i donte PPSH-ja? Kush i ndaloi që ta thonë këtë? Apo nuk i lejonte PKJ? Po të donin, edhe këtë mund ta thoshin. Fadil Hoxha, në rrëfimin e tij autobiografik, Konferencës së Bujanit i jep atributet e vetëvendosjes, në një kohë që bën të ditur se i pari i radhës që kishte marrë përsipër përgatitjen e Konferencës, ishte Pavle Joviqeviqi. Vetëvendosja e Kosovës dhe Pavle Joviqeviqi nuk mund të vihen në të njëjtën radhë, në asnjë rrethanë.

Por tani le t'iu referohemi edhe disa thënieve të historianëve rreth Konferencës së Bujanit. Ata thonë se organizatorët u përpoqën që në Konferencë të tërhiqnin sa më shumë njerëz me influencë, patriotë të shquar, pavarësisht se të tillët nuk ishin pjesë e organizuar e LNÇ-së. Megjithatë, me ndonjë përjashtim të rrallë, ata nuk ia dolën ta bënë këtë. Nuk ia dolën ta bindnin të merrte pjesë në këtë

mbledhje as Bedri Pejanin, as Selman Rizën, apo ndonjërin nga vëllezërit Kryeziu, as përfaqësues të pushtetit vendor. (Pothuajse në të njëjtën kohë, me Lidhjen e Dytë të Prizrenit, pjesëmarrja e intelektualëve, e patriotëve me nam dhe e përfaqësuesve të pushtetit vendor ishte krejt ndryshe.)

Sido që të jetë, Konferenca u mbajt më 31 dhjetor 1943 dhe më 1e 2 janar 1944, me pjesëmarrjen e 49 delegatëve. Që të kishin legjitimitet këta delegatë, duhet të ishin të zgjedhur prej dikujt. Shumica ishin të zgjedhur prej komunistëve, që domethënë se nuk kishin *legjitimitet demokratik*. Por më e çuditshmja është se një konferencë e këtillë për Kosovën mbahet në Bujan, në një fshat të humbur të Tropojës, që edhe atëherë gjendej në Shqipëri. Vërtet ishte kohë lufte dhe në një rrethanë të tillë kufiri nuk kishte ndonjë rëndësi. Pastaj, Bujani ishte krejt afër me kufirin e Kosovës... Pra, a kishte ndonjë domethënie tjetër mbajtja e Konferencës pikërisht në Bujan? Duket se po. Konferenca u mbajt në malësitë e Tropojës, në një zonë krejtësisht të izoluar nga bota, që domethënë në Shqipëri, në male, për shkak se atje ende funksiononte *besa dhe kanuni*. Për komunistët kosovarë, që kryesisht vinin nga Gjakova, ky mund të ishte vendi i vetëm ku ata mund të ndiheshin të sigurt, jo pse ushtria gjermane i ndiqte hap pas hapi, siç kishin qejf të thoshin gjithmonë, por nga se nuk e gjenin një vend të tillë askund në Kosovë. Në Kosovë, kudo që hynin, partizanëve ua kthenin pushkën, në fshatrat shqiptare pse kishin serbë me vete; në fshatrat serbe, pse kishin shqiptarë me vete. Në Tropojë situata ishte më ndryshe, sepse aty kishin zënë vend disa batalione partizanësh të Shqipërisë, si dhe ndonjë aradhë partizanësh kosovarë. Megjithatë, del pak e paqartë pjesëmarrja e Tefik Çangës nga Shkodra, Beqir Ndout, Veli Maxhun Doçit, Shaban Haxhisë, Jalë Sali Bajraktarit nga Malësia e Gjakovës, pra të territoreve brenda Shqipërisë, si

dhe e pesë përfaqësuesve nga Plava dhe Gucia, përfshirë edhe Sadik Bekteshin. Çfarë donin ata në Konferencë, kur dihej se ajo duhej të lidhej territorialisht me Kosovën? Mos ishte kjo një lloj garancie se Konferenca nuk do të merrte kahe të padëshiruar për shqiptarët, prandaj ajo ishte siguruar nga brenda dhe nga jashtë? Dhe kush e kërkonte këtë garanci? Në këto pyetje unë nuk kam gjetur gjë të shkruar si përgjigje, përveç fjalëve të Sadik Bekteshit, të cilin e kam takuar në Tiranë më 1992 dhe rreth Bujanit më pat thënë fjalë për fjalë: “Nuk ka pasë djalë nane që ka mujt me dalë prej atij vendi, pa e shkruar n’Rezolutë se Kosova ka me u bashkue me Shqipninë.”

Ndërkohë, të dhënat nga brenda Konferencës nuk flasin se hareja dhe entuziazmi, siç thotë Fadil Hoxha në kujtimet e tij, i karakterizonin seancat kryesore të Konferencës. Sikundër dihet, problem më vete paraqiste *rezoluta*. I pari që reagoi ndaj tekstit të rezolutës ishte Pavle Jovičevići, i cili kishte postin e sekretarit politik të Komitetit Krahinuer të PKJ-së për Kosovë dhe Metohi (ky është emërtimi i saktë dhe jo “Kosovë e Rrafshi i Dukagjinit”, siç u shkrua më vonë). Ai kërkon që paragrafi i rezolutës, në të cilin flitej për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, duhej të hiqej, duke argumentuar se çështjet që kanë të bëjnë me vetëvendosjen, me ndarje, me kufijtë etj. do të bisedoheshin pas përfundimit të luftës. Pavle Jovičevići i kundërvihet Hajdar Dushi. Duket se ndërmjet tyre zhvillohet një duel i ashpër verbal, sepse pozicionet e tyre paraqiten të papajtueshme. Nën tryshninë nga brenda dhe jashtë Konferencës, delegatët detyrohen të gjejnë një kompromis, të cilin, sipas dëshmitarëve e shpik pikërisht Fadil Hoxha. Kështu, në Rezolutë mbetet se “Kosova dhe Metohija asht krahinë e banueme me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me

Shqipërinë”, por më tej shtohen fjalitë që flasin për luftën e përbashkët të popullit të Kosovës “me popujt e tjerë të Jugosllavisë”, si “e vetmja rrugë për me fitue lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetëvendosjes deri në shpëputje. Garanci për këtë është UNÇ e Jugosllavisë dhe UNÇ e Shqipërisë, me të cilën asht ngusht e lidhun” si dhe “aleatët tanë të mëdhenj, Bashkimi Sovjetik, Anglia e Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)”.

Natyrisht që Konferenca e Bujanit u kritikua nga komunistët jugosllavë, por, më anë tjetër, periudha pas saj u shoqërua me likuidime fizike të shumë pjesëtarëve të LNÇ-së. Duket se në vetë strukturat partiake të Kosovës, njësoj si në ato të *pushtetit populluer* fillon një spastrim përmasash të gjëra. Ndërkaq, sa i përket Konferencës së Bujanit, gjërat ende mbesin të paqarta në fakte dhe në interpretim. Pra, edhe sot e kësaj dite nuk u mor vesh nëse Konferenca e Bujanit qëndron në themel të autonomisë së Kosovës, siç e interpretojnë disa historianë dhe siç ishte interpretimi politik deri në vitet '90 të shekullit të kaluar; apo bëhet fjalë për “synimin shekullor të shqiptarëve të Kosovës” për t’iu bashkëngjitur Shqipërisë. Ky dualizëm në interpretimin e kësaj ngjarjeje përbën esencën kosovare të një *identiteti të dyzuar*, i cili, varësisht nga rrethanat, duket e ka më të lehtë të shfaqet në variante sesa që të kristalizohet dhe të qartësohet përfundimisht. Për rrethanat e sotme, vetëm një gjë ka arritur të bëhet e qartë: Konferenca e Bujanit ishte një ngjarje komuniste në të gjithë përbërësit e saj.

Lidhja e Dytë e Prizrenit

Por, derisa Konferenca e Bujanit viteve të fundit u lartësua së tepërmi, një ngjarje që në njëfarë mënyre mund t'i ketë paraprirë asaj, ose ishte zhvilluar paralelisht me të, Lidhja e Dytë e Prizrenit, vazhdon të lihet në heshtje edhe sot e kësaj dite. Sipas historiografisë zyrtare, atë e organizuan kuislingët shqiptarë të shtyrë nga shërbimi sekret gjerman, me qëllim të nxitjes së reaksionit kundër LNÇ-së. Natyrisht, si për shumë konstatime të ngjashme, askush nga historianët nuk ka sjellë ndonjë dëshmi për këtë. Më e çuditshmja është se në trajtimin e kësaj ngjarjeje, sikundër edhe të shumë zhvillimeve që lidhen me veprimtarinë e nacionalistëve shqiptarë gjatë Luftës së Dytë Botërore, rënia e komunizmit, pas viteve '90, për historianët shqiptarë nuk ka pasur ndonjë domethënie. Historinë shqiptare të kësaj periudhe vazhdojnë ta shkruajnë komunistët, si në ditët e tyre më të mira.

Kështu, ta zëmë, ndodhi që për një ngjarje kaq të përfolur, siç ishte Lidhja e Dytë e Prizrenit, as pas kaq vitesh të heqjes formale të embargos komuniste, nuk gjendet një studim serioz, me dokumente dhe me qasje shkencore. Në mungesë të studimeve të këtilla, edhe më tej mbesin të vlefshme shkrimet e shtypit të kohës dhe dëshmitë e shkruara nga pjesëmarrësit, të shpërndara në shtypin e emigracionit shqiptar. Nga këto dëshmi një gjë del e qartë: Lidhjen e Dytë të Prizrenit nuk e ka themeluar Xhafer Deva, siç thuhej nga historianët zyrtarë, me qëllim të cilësimit të saj si organizatë kuislinge dhe profashiste (Xhafer Deva arriti në Prizren në seancën e dytë të Lidhjes), por një grup patriotësh dhe intelektualësh, me synim që të ruhet tërësia territoriale e Shqipërisë, me kufijtë e saj *të gjakut dhe të gjuhës*. Ja emrat e grupit *nisjatuër* (ku nuk bën pjesë Xhafer Deva):

Sheh Musa Shehzade (kryetar), Shefqet Shkupi, Sheh Hasani, Asllan Boletini, Qazim Bllaca, Pjetër Vuçaj, Tahir Zajmi, Hevzi Meraku, Luk Simoni, Qemal Balila, Haxhi Fahriu dhe Sokol Dobrosi (anëtarë).

Ky organizim erdh si përgjigje e domosdoshme e shqiptarëve, veçmas e viseve të Kosovës, të Dibrës dhe të Pazarit të Ri, kundrejt situatës së re gjeopolitike, e cila ishte krijuar pas kapitullimit të Italisë fashiste, në fillim të shtatorit të vitit 1943. Pra, ishte evidente frika ndër shqiptarët e Kosovës dhe më gjerë se zhvillimet e reja mund t'i copëtonin serish tokat shqiptare, respektivisht se mund të ndodhte që bota sllave, që tani ose në fund të luftës, t'i aneksonte serish trevat që nuk ishin përfshirë në Shqipërinë londineze. Prandaj, siç njoftonte shtypi i kohës, pika e parë e programit të bisedimeve ishte kërkesa “e bashkimit të përhershëm dhe të pazgjidhshëm” të të gjitha krahinave shqiptare”; pika e dytë e programit ishte bashkimi me Shqipërinë i “krahinave të Mitrovicës, Vuçitërnës, të Pazarit të Ri dhe të Senicës”; ndërsa pika e katërt bënte fjalë për formimin e një “Komiteti Qendruer në Prizren”, i cili do të merrte përsipër “organizmin ushtarak dhe politik të Kosovës”. Në pikën e pestë të programit kërkohej mbledhja e të gjitha “dokumenteve historike, politike dhe diplomatike që forcojnë qenien shqiptare të tokave të lirueme”, si dhe “vuajtjet pa fund të banorëve të këtyre viseve në kohën e sundimit jugosllav”, të gjitha këto “si dokument në rasën e nji paqie të ardhme”.

Pas seancave të fillimit të mbledhjes, në Prizren fillojnë të vijnë delegatë nga të gjitha viset shqiptare jashtë Shqipërisë londineze, kështu që në ditët në vijim (më 17,18 dhe 19 shtator) arrihet një përfaqësim i tërësishëm, i paparë deri atëherë në tubimet politike të shqiptarëve. Nuk mbetet asnjë njësi administrative e Kosovës pa një përfaqësim në

këtë tubim, sikundër që pjesëmarrës ishin edhe përfaqësuesit e Strugës, Dibrës, Tetovës, Shkupit, Pazarit të Ri, Senicës, Tutinit etj. Nuk kishte përfaqësues nga brendia e Shqipërisë, me përjashtim të zonave kufitare me Kosovën. Disa nga përfaqësuesit ishin prefektë ose zyrtarë të lartë administrativë, ndërsa një numër i delegatëve kishin autoritet të madh në mjediset prej nga vinin, duke qenë disa syresh titullarë ofiqesh të larta profesionale, si avokatë e profesorë, madje edhe doktorë, ose të tjerë që kishin kredibilitet të madh patriotik. Ja disa nga emrat që i drejtohen tubimit, ose popullit të mbledhur përjashta, i cili ndiqte me entuziazëm punimet e Lidhjes: Shefaqet Shkupi, dr. Rexhep Krasniqi, Tahir Zajmi, dr. Xhelal Mitrovica, Bedri Pejani, Ibrahim Fehmiu etj. Për anëtarë të Komitetit Qendruer të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, u zgjodhën: Rexhep Mitrovica (kryetar), Sheh Musa Shehzade dhe Kolë Margjini (nënkryetarë), Sheh Hasani, Asllan Boletini, Tahir Zajmi dhe Qazim Bllaca. Në tetor bëhen disa ndryshime në strukturat udhëheqëse të Lidhjes, për shkak se disa nga këta personalitete përfshihen në qeverinë e Tiranës dhe në Asambleenë Kombëtare, sikundër edhe vetë Rexhep Mitrovica, i cili bëhet kryeministër i Shqipërisë dhe në krye të Lidhjes zëvendësohet nga Bedri Pejani. Nga mesi i janarit të vitit 1944 mbahet një tjetër mbledhje e Komitetit Qendruer të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në të cilën, thonë kronikat e kohës, “u bënë disa ndryshime në strukturën udhëheqëse dhe miratohet statuti i organizatës”. Në të vërtetë, ndryshimi më i madh do të ndodhë ndonjë muaj më vonë, kur Xhafer Deva, pas masakrës së 4 shkurtit në Tiranë, vendos të kthehet në Kosovë dhe, më sa duket, ta marrë vetë në dorë Lidhjen e Dytë të Prizrenit dhe luftën antikomuniste.

Për veprimtarinë e mëtejshme të Lidhjes së Dytë të Prizrenit nuk ka informacion të mjaftueshëm, së paku jo derisa udhëheqja e saj u detyrua të braktiste vendin dhe të shpërndahej në emigracion, që atje të vazhdojë një aktivitet pothuajse të pamundur, për shkak të shumë rrethanave. Gjithashtu nuk dihet nëse Lidhja e Dytë e Prizrenit arriti t'i realizonte disa nga detyrat e saj sipas statutit që ishte miratuar, sepse ajo, përveç se kishte karakterin e një lëvizjeje politike, planifikonte edhe ngritjen e strukturave paraushtarake nëpër të gjitha vendbanimet shqiptare "të Kosovës, të Dibrës dhe të Pazarit të Ri". Bie në sy gjithashtu fakti se emri i Xhafer Devës, të cilit historiografia zyrtare ia veshi rolin kryesor në themelimin e Lidhjes, nuk përmendet gjëkund, vetëm si i pranishëm, por jo si i zgjedhur në ndonjë strukturë të organizatës. Duket se theksimi i Xhafer Devës si ideator i Lidhjes së Dytë të Prizrenit është bërë me qëllim, për ta afruar organizatën sa më shumë me shërbimin sekret gjerman, pjesëtar i të cilit supozohej se ishte Xhafer Deva.

Situata politike e krijuar në periudhën vijuese në Kosovë nuk shkoi në favor të forcave që e krijuan Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Organizata nuk arriti të profilizohej qartë politikisht, veçmas në raport me Gjermaninë naziste dhe me forcat e brendshme që e mbështetnin atë. Rreshtimi i patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë, të përfshirë në Lidhjen e Dytë të Prizrenit apo edhe jashtë saj, tërësisht shkoi në drejtim të gabuar, sepse opsioni i tyre politik i krijimit të një shteti unik shqiptar, ose thënë edhe më qartë, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, u lidh më shumë me fuqitë e Boshtit se sa me Aleancën antifashiste. Por edhe sikur kjo lidhje të mos bëhej siç u bë, një zgjidhje tjetër për Kosovën vështirë që do të gjendej, sepse për një ndryshim eventual të kufijve në Ballkan nuk ishte marrë miratimi i

fuqive të mëdha, të cilat në përfundim të Luftës së Dytë Botërore bënë hartat e reja të botës.

Mirëpo, edhe përkundër rezultatit asfare, apo, thënë më mirë, të një shkarjeje esenciale që ndodhi në mbarë botën shqiptare, Lidhja e Dytë e Prizrenit kishte rëndësi politike, sepse në një kohë zhvillimesh të turbullta dhe kontradiktore, ajo qartësoi vijën konsistente kombëtare të përbërë nga dy postulate themelore: e para, se shqiptarët nuk e deshën komunizmin dhe iu kundërvunë atij deri në vetëshkatërrim, duke e identifikuar atë si ideologji antikombëtare; dhe, e dyta, se kosovarët e identifikuan perspektivën e tyre kombëtare vetëm në një lidhje të pashkëputur me Shqipërinë. Këto dy postulate do të përbëjnë “shkapërcimin kohor” ndërmjet dy epokave, të asaj parakomuniste dhe paskomuniste, duke lënë në mes një vakuum të errët të një kohe ndër më kobshmet për shqiptarët.

Masakra e 4 shkurtit 1944 në Tiranë

Sa herë që flitet për funksionimin e të ashtuquajturës *Shqipëri e Madhe*, referencë kryesore merret Kosova dhe aspiratat e saj për të jetuar në një shtet kombëtar, ndërkohë që lihet disi në heshtje vullneti politik i asaj pjese të botës shqiptare, që ndryshe quhet *Shqipëri londineze*. Më herët iu referuam disa fakteve, që bëjnë të njohur se në periudhën midis dy luftërave botërore Shqipëria filloi të ndjehej e vetëmjaftueshme në hapësirën që përfshinte dhe, po në këtë periudhë të konsolidimit të shtetit shqiptar, ndjehet edhe një lloj indiference, refuzim i heshtur, ose edhe i hapur ndaj viseve shqiptare të mbetura jashtë kufijve shtetërorë. Një pjesë e njerëzve në Shqipëri, patriotë dhe nacionalistë të

ndryshëm, gjatë kësaj periudhe, ndjehen emocionalisht të lënduar rreth Kosovës, por politikat e shtetit synojnë të bëhen racionale dhe të dimensionohen në varshmëri me interesat e tij. Pas vitit 1941, deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, kuptimi i shtetit shqiptar zgjerohet edhe për shkak se pjesa më e madhe e Kosovës përfshihet në kuadër të këtij shteti, sikundër edhe për faktin se *shteti amë*, pra Shqipëria, merr rolin integrues dhe emancipues për pjesën tjetër të kombit, i cili, për shkak të rrethanave historike, ka nevoja specifike në raport me Shqipërinë. Nën ombrellën nazifashiste, këtë rol Shqipëria e luan me shumë sukses dhe për njëfarë kohe nuk bëhen të ditur shenja të raporteve të acaruar ndërmjet veriut dhe jugut, toskëve dhe gegëve, apo Kosovës dhe Shqipërisë. Përkundrazi. Përveç idilit kombëtar, në këto vite marrin hov edhe format e tjera të integrimit.

Por, sikundër do të shohim, vjen një çast kur ky idil do të përmbysset në një mënyrë mjaft të vrazhdët, duke lënë prapa një shije të keqe për vite dhe dekada me radhë. Atë që mund të thuhet se Xhafer Deva e paskësh bërë si veprim pozitiv me mbështetjen që i paskësh dhënë idesë së bashkimit kombëtar, sikundër edhe me veprimet konkrete për ta bërë funksionale këtë ide, më anë tjetër, po kaq negativ mund të quhet veprimi i tij në fillim të shkurt të vitit 1944, kur, për hakmarrje personale, kapitullit të marrëdhënieve Kosovë-Shqipëri ia shtoi një rast tragjik, që do të dominojë këto marrëdhënie për dekada me radhë dhe do të flasë, në mënyrë të tërthortë, edhe për të ardhmen e këtyre marrëdhënieve. Faktet tashmë kanë dëshmuar se masakra e 4 shkurtit të vitit 1944 nuk ka pasur përmasa të tilla çfarë i është dhënë nga komunistët që erdhën në pushtet pak më vonë dhe se kjo masakër nuk kishte kuptimin e një *konflikti shqiptaro-kosovar*, ose të një mllëfi të

kosovarëve të frustruar nacionalistë kundër Tiranës komuniste. Masakra ishte një qërim hesapesh, ose ndeshje ndërmjet pushtetit kuisling dhe ilegales komuniste të Tiranës, e menaxhuar keq nga aktori kryesor i saj, Xhafer Deva. Por duhet vërejtur se rrethanë më fatkeqe e kësaj situate ishte fakti se pushtetin kuisling e përfaqësonin kosovarët, në rastin konkret kryeministri Rexhep Mitrovica, ministri i Brendshëm, Xhafer Deva dhe mercenarët apo sejmënët e tij kryesisht kosovarë. Më anë tjetër, të vrarët dhe të burgosurit në mbrëmjen e 4 shkurtit 1944, pavarësisht në ishin komunistë ose jo, shumica ishin banorë të Tiranës, fakt ky që e lëndoi së tepërmi kryeqytetin dhe nxiti një valë të paparë antikosovarizmi në Shqipëri.

Është e ditur se komunistët e Shqipërisë, të cilët më pas erdhën në pushtet, këtë rrethanë fatkeqe e shfrytëzuan për qëllimet e tyre propagandistike. Ata manipuluan shumë fakte rreth kësaj ngjarjeje, përfshirë edhe numrin e të vrarëve dhe të burgosurve. Dokumentet e kohës do të tregojnë se numri i të vrarëve ishte shumë më i vogël nga 80-104, sa thuhej nga propaganda komuniste; se të vrarët nuk ishin të gjithë shqiptarë dhe se disa që i konsideruan si të vrarë më atë datë, nuk u identifikuan ndonjëherë. Kështu, burimet e kohës thonë se numri i tërësishëm ishte gjithsej 44, prej të cilëve 23 u identifikuan me emra dhe mbiemra si shqiptarë, 4 u identifikuan si të kombësisë italiane, 4 të kombësisë malazeze, 1 i kombësisë jugosllave, 6 të identifikuar si punëtorë, por pa emra dhe 6 të tjerë të pidentifikuar. Këto të dhëna janë botuar në gazetën "Bashkimi" një vit pas masakrës dhe aty u bëhet thirrje banorëve të Tiranës që të paraqesin rastet e të vrarëve në këtë masakër, gjë që bën të ditur se as numri dhe as emrat e të vrarëve, edhe një vit pas masakrës, nuk ishte plotësisht i njohur. Gjithashtu është interesant fakti se shoqatat antifashiste të Shqipërisë, të cilat

me rastin e 65-vjetorit të masakrës së 4 shkurtit i dërgojnë një promemorie Këshillit Bashkiak të Tiranës për të ndërtuar një monument në përkujtim të viktimave, nuk janë në gjendje të nxjerrin më shumë se 30 emra të të vrarëve me këtë rast. Ndërkaq, kombësia e të vrarëve është mjaft heterogjene për rrethanat e Shqipërisë së asaj kohe. Derisa 4 italianët mund të ishin nga kontingjenti i të "harruarve" në Shqipëri pas kapitullimit të Italisë, ndërsa tani të përfshirë në lëvizjen komuniste, më anë tjetër del krejtësisht e paqartë prania e 4 malazezve, përfshirë këtu edhe një "jugosllav", i cili, sipas gjasës, ishte hebre (David Kohen).

Sido që të ketë ndodhur, një gjë është e sigurt: përgjegjës i drejtpërdrejtë i vrasjes së këtyre njerëzve (pavarësisht numrit) ka qenë Xhafer Deva dhe në raportet Kosovë-Shqipëri ka lënë një plagë të hapur, e cila rregullisht është apostrofuar qoftë nga regjimi komunist, qoftë nga banorët e Tiranës. Pavarësisht se nuk u quajt përgjegjës për këtë masakër vetëm Xhafer Deva "me kosovarët e tij mercenarë", sepse aty ishte edhe kryeministri i qeverisë kuislinge Rexhep Mitrovica, pastaj komandanti i përgjithshëm i xhandarmerisë, Hysni Dema, komandanti i forcave të Ballit Kombëtar, Kadri Cakrani, prefekti i Tiranës, Qazim Mulleti, përgjegjësia doemos që do të bjerë pikërisht mbi të, në radhë të parë, sepse ai ishte ministër i Brendshëm dhe, e dyta, sepse vrasjet dhe burgosjet masive morën shkas nga një atentat që u bë mbi nipin e tij, Fahri Ibrahimin. Sikundër do të dëshmojë Isuf Deva, një tjetër nip dhe sekretar personal i Xhafer Devës (ai u arrestua nga jugosllavët në Zagreb në qershor të vitit 1945, iu dorëzua palës shqiptare dhe pas një procesi gjyqësor u pushkatua), lista e të burgosurve dhe të vrarëve të 4 shkurtit kishte dalë nga dosjet e Xhafer Devës. Duket se edhe një fakt tjetër e ka irrituar keq Xhafer Devën, sepse atentati mbi nipin e tij ishte bërë te hotel "Dajti",

ndërsa ai kishte dalë nga makina ministrore, pra nga makina e Xhafer Devës, që domethënë se atentati mund të ishte planifikuar të bëhej mbi vetë ministrin e Brendshëm. Por, mbi të gjitha, Xhafer Deva me këtë rast nuk manifeston cilësi pushtetari të vërtetë, sepse masakrën mbi qytetarët e Tiranës, sado që shumica syresh mund të kishin qenë komunistë, e motivon me një hakmarrje krejt personale, pra primitive. Më anë tjetër, Xhafer Deva nuk shfaqet i kujdesshëm në frenimin dhe përmbajtjen e bashibozukëve të tij kosovarë, të cilët duket se marrin shkas nga ky atentat të shfryjnë mllafe të vjetra mbi banorët e Tiranës, duke vrarë, duke burgosur dhe keqtrajtuar me këtë rast edhe persona që nuk kishin asnjë lidhje më lëvizjen komuniste.

Kjo situatë bëhet më e ngarkuar edhe për shkak të një rrethane tjetër: Kryeministri i qeverisë kuislinge të Shqipërisë dhe ministri i Brendshëm, Rexhep Mitrovica dhe Xhafer Deva, pra dy njerëzit më të fuqishëm të asaj Shqipërie që do të duhej të shërbente si *model i një bashkimi* të mundshëm të shqiptarëve në një shtet, janë kosovarë, që domethënë se në këtë rast ndodh një lloj "pushtimi" kosovar i Shqipërisë. Ky pushtim i dytë i Shqipërisë (sepse pushtimi i parë ishte gjerman), hipotetik ose real, bëhet pikërisht nga Xhafer Deva, i cili e ushtronte pushtetin e tij jo përmes strukturave legale të pushtetit, por kryesisht përmes mercenarëve kosovarë dhe bandave që i shkonin prapa. Nën një pushtet të këtyllë, Tirana qytetare nuk do të jetë ndjerë aq mirë dhe prandaj masakra e 4 shkurtit do të marrë edhe konotacionin e *luftës civile* ndërmjet shqiptarëve të bashkuar në një shtet. Këtë fakt do ta shfrytëzojnë për interesa të tyre edhe komunistët e Shqipërisë, por edhe antikosovarët në përgjithësi, sikundër edhe të gjithë ata që në Shqipëri nuk e përkrahin idenë e një shteti të përbashkët me Kosovën. Pra, shija e keqe e kësaj ngjarjeje, përfshirë këtu edhe epilogun e

saj tragjik, do të hidhtësojë për një kohë të gjatë raportet Kosovë-Shqipëri dhe do ta sjellë në vëmendje të Shqipërisë drojën ose skepticizmin se një bashkim i mundshëm i shqiptarëve në një shtet mund të shoqërohet edhe me episode çfarë ishte edhe masakra e 4 shkurtit të vitit 1944.

Tradhtia e dyfishtë

Por le t'i kthehemi Kosovës. Tashmë është e njohur se ngjarjet më dramatike në Kosovë nuk kanë ndodhur njëkohësisht me zhvillimet më dinamike të Luftës së Dytë Botërore, por ndodhën atëherë, kur lufta ishte në përfundim e sipër ose menjëherë pas përfundimit të saj. Këto ngjarje për një kohë të gjatë kanë qenë nën embargo, për shkak se ishin pikat më të errëta të luftës dhe të "heronjve" të saj, të cilët e mbajtën pushtetin për një kohë të gjatë dhe pandehnin se vetë mund ta merrnin vendimin se çfarë mund të mbetej e shkruar në histori dhe çfarë duhej të harrohej përgjithmonë. Mirëpo, përveç historisë së shkruar, një popull që kishte traditë të gjatë gojore, pra të rrëfimit të gjërave gojë më gojë, doemos që do ta kultivonte edhe këtë mënyrë të ruajtjes në kujtesë të atyre ngjarjeve, të cilat historia zyrtare mëtonte t'i harronte sa më shpejt. Kështu, u mbajtën në kujtesë dhe shpëtuan nga harresa ngjarjet si *kryengritja e Drenicës* e Shaban Polluzhës, e ndodhur në janar-shkurt të vitit 1945; vendosja e *pushtetit ushtarak* po në dimër të vitit 1945; *masakra e Tivarit* e ndodhur në prill të po atij viti; si dhe *kuvendi i Prizrenit*, i mbajtur në korrik të vitit 1945, me të cilin realisht mbyllet kapitulli më tragjik i kësaj lufte në Kosovë.

Në të vërtetë, përgjatë gjithë kohës së sundimit të komunistëve, në Kosovë ishin në qarkullim të dy variantet e

historisë së këtyre ngjarjeve. Zyrtarisht ishte thënë se në mbarim të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë shpërthyen kryengritje kundërrevolucionare, të organizuara nga reaksioni dhe mbeturinat e armikut, të cilat u shuan me goditjen e fuqishme të forcave të organizuara të shtetit të ri jugosllav. Mirëpo, këto ngjarje kishin edhe versionin e tyre popullor, i cili përhapej gjithandej odave, kuvendeve të burrave, bisedave familjare, ku ngjarjet dhe pjesëmarrësit në to cilësoheshin si patriotike dhe gëzonin simpatinë e gjerë të kosovarëve. Ky *variant gojor* i shpjegimit të këtyre zhvillimeve e mbajti gjallë kujtesën për kryengritjen e Drenicës, për Shaban Polluzhën, për masakrën e Tivarit, për të gjitha ato ngjarje që u vunë nën embargo e fuqishme të pushtetit dhe të zyrtarëve të tij. Kjo situatë zgjati deri në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, kur realisht filloi rishikimi i ngjarjeve të historisë dhe heqja e ndalesave për trajtimin e tyre pa kufizime ideologjike. Mirëpo, tani kufizimet u shfaqen në krah tjetër: ngjarjeve të ndaluara iu atribuuhan fakte, persona dhe ndodhi të paqena. Megjithatë, kjo ishte një rrethanë e përshtatshme në kontekst të krijimit të parakushteve për shpjegime dhe arsyetime, të pjesëmarrësve të ngjarjeve dhe të atyre që ishin dëshmitarë. Rrëfimet e tyre, pa asnjë kufizim, mundën t'i bënin publike si pala që kishte pasur embargo për shumë vite, si pala tjetër, që e kishte ushtruar këtë embargo. Tani askush më nuk mund të ankohej për kufizime apo censurë zyrtare.

Dhe çfarë doli nga kjo? U bënë të ditura publikisht ndodhitë të atij dimri famëkeq të fillimit të vitit 1945. Në të vërtetë, shqetësimet kishin filluar që disa muaj më parë, që nga vjeshta e vitit 1944, kur ndodhi i ashtuquajtimi çlirim i Kosovës. Vendi u gjend në një rrëmujë politike dhe ushtarake. Në Kosovë hynë brigadat e Shqipërisë, të cilat qëndruan fare shkurt dhe vazhduan operacionet luftarake

në ndjekje të ushtrisë gjermane, e cila tashmë tërhiqej në veri. Populli i Kosovës do ta konsiderojë tradhti atë që bëjnë këto brigada, sepse ato, edhe përkundër lutjeve dhe përgjërimeve që të mos e linin Kosovën, e braktisën atë në situatën më të rëndë. Brigadat e Shqipërisë shkuan në drejtim të Vishegradit, ndërsa prapa tyre hynë brigadat partizane malazeze dhe serbe, të cilat i kishin shtuar radhët e veta me çetnikë të konvertuar. Ato, në emër të luftimit të reaksionit dhe të mbeturinave të armikut, ndërmoren reprezalje në mbarë Kosovën. U burgosën dhe pastaj u pushkatuan shumë njerëz, pa shkas dhe pa më të voglën arsye. Pas përfundimit të operacioneve luftarake deri në Bosnjë, brigadat e Shqipërisë u kthyen prapa, kaluan nëpër Kosovë, panë se çfarë kishte ndodhur në mungesë të tyre, kosovarët përsëri u përgjëruan të mos i braktisin, por ato marrin urdhër të largohen nga Kosova. Këtë veprim të brigadave të Shqipërisë kosovarët gjithmonë e kanë konsideruar tradhti.

Por a kishin të drejtë? Jo, nëse mendonin se ishin të zot të vetes, se kishin ushtrinë e tyre partizane, se kishin zgjedhur këshillat e tyre nacionalçlirimtare. A vazhdojnë kosovarët të thonë edhe sot se Konferenca e Bujanit legjitimoi pushtetin politik në Kosovën autonome në kuadër të Jugosllavisë? Atëherë, çfarë donin në Kosovë brigadat partizane të Shqipërisë? Asgjë. Por e vërteta është se vendimet e Bujanit, njësoj sikundër edhe lidhjet e vazhdueshme organizative të komunistëve të Kosovës dhe të aradheve partizane me strukturat e Serbisë nuk ishte vullnet i popullit të Kosovës. Ata, pa Shqipërinë, konsideronin se nuk kishin fuqi për t'iu kundërvënë ripushtimit të Kosovës. Atyre, pra kosovarëve, nuk u pengonte fare se udhëheqja politike e brigadave partizane të Shqipërisë ishte komuniste. Kjo për ta nuk kishte rëndësi.

Ata ishin shqiptarë dhe kosovarët e kërkonin mbrojtjen e tyre. Kur Shqipëria nuk i merr në mbrojtje, ata zhgënjehen dhe shtetin amë e akuzojnë për tradhti.

Në dimrin vijues, krahas operacioneve të spastrimit që vazhdojnë me të njëjtin intensitet, fillon edhe mobilizimi i kosovarëve për të ashtuquajturën luftë përfundimtare kundër Gjermanisë në tërheqje e sipër. Ishte hapur Fronti i Sremit dhe atje ishte menduar të dërgohej Shaban Polluzha me drenicasit e tij. Duke ditur si rrodhën ngjarjet e mëvonshme, askush nuk beson se kërkesa për t'i dërguar drenicasit me traditë rebelimi në Frontin e Sremit, ishte bërë pa paramendim. Përkundrazi. Sikur bën me dije vetë Fadil Hoxha në kujtimet e tij, me shkuarjen në Frontin e Sremit, Shaban Polluzha duhej të tregonte bindje dhe lojalitet. Ai i çon luftëtarët e tij deri në Podujevë, aty përfundimisht vendos të mos shkojë më tej dhe nis të kthehet prapa. Askush tjetër, por vetë Fadil Hoxha jep urdhër të shtihet me topa kundër drenicasve të Shaban Polluzhës. Këtë e pohon ai vetë, në librin e tij të kujtimeve.

Pacifizimi i Kosovës

Realisht, me urdhrin që jep Fadil Hoxha të shtihet kundër luftëtarëve të Shaban Polluzhës, luftës së pambaruar në Kosovë i jepet dimension i *luftës civile*. Tanimë partizanët në Kosovë nuk luftojnë kundër armikut nazifashist, luftojnë kundër kundërshtarëve të tyre politikë. Dhe kundërshtarë politikë e kanë shumicën e popullit të Kosovës. Ndërsa Fadil Hoxha, që mrekullisht kishte shpëtuar nga një "vetëvrasje" e menduar dhe e perealizuar, pavarësisht se i bëri shërbimet e nevojshme në ndihmë të terrorit që ushtrohej në Kosovë, po

atë dimër hiqet nga pozita e shefit të shtabit (megjithatë, mbetet zëvendës), në Kosovë vihet pushteti ushtarak dhe të gjitha kompetencat i marrin ushtarakët serbo-malazezë, bashkë me OZNA-n. Vrasjet masive të shqiptarëve tani bëhen edhe me pretekst tjetër: fillon mobilizimi i tyre për t'i dërguar në fronte të ndryshme të luftës. Në të vërtetë, gjithkush e dinte se, në rrethanat çfarë ishin atëherë, shqiptarët e Kosovës nuk mobilizoheshin për luftëtarë frontesh, por për efekt terrori brenda vetë Kosovës dhe për efekt vrasjesh, kudo që mund të realizoheshin ato.

Në këto rrethana ndodhi edhe *masakra e Tivarit*. Ajo që është shkruar deri më tani për këtë masakër, për nga interpretimi i lirë i rrëfenjës, ngjan shumë me ato që kam dëgjuar unë që në fëmijërinë e hershme në katundet e Krajës, të rrethinës së Tivarit. Kosovarët u vranë pa ndonjë arsye, numri i tyre i saktë nuk dihet, kufomat e tyre u hodhën në det, mbi ata shtinë edhe civilët, një numër syresh u vranë edhe nëpër male, atje ku u kapën nga banorët malazez të rrethinës. Më kujtohet, kur isha fëmijë, derisa përshkonim këmbë rrugën për në Tivar, nën maje të Rumisë, matanë Gropave të Pinçit, kalonim nëpër një vend që quhej Maja e Shkallës. Nën bokërrinat që zbritnin teposhtë në drejtim të Tivarit të Vjetër, rruga malore kalonte përmes një katundi të vogël malazezo-boshnjak. Njerëzit e anëve tona, ndërsa kalonin pranë shtëpive të atij katundi, u grahnin mushkave që të ecnin më shpjet dhe muhabetet e nisura i ndalnin përgjysmë. Njëra nga shtëpitë e katundit kishte një dritare të vogël që shikonte nga rruga dhe im atë një herë më pat thënë se nga ajo dritare, dikush nga katundi, i kishte vranë 12 kosovarë të paarmatosur, të cilët iknin bokërrinave të zhveshura përpjetë dhe nuk gjenin një vend ku të futeshin. Në katundet e Krajës u strehuan një numër i

të mbijetuarve dhe miqësitë që u lidhën atëherë kanë vazhduar deri në ditët e sotme.

Por më është dukur disi e çuditshme dhe një mungesë respekti për të vrrarët në këtë masakër mënyra sesi Fadil Hoxha në kujtimet e tij i shmanget ndonjë shpjegimi çfarëdo qoftë dhe përpiqet të bëjë të paditurin, madje në njëfarë mënyre duke e miratuar versionin zyrtar të ngjarjes, se kishte qenë një incident tragjik, të cilin e kishin shkaktuar vetë kosovarët. Më anë tjetër, historianët e Kosovës, që me kohë nuk bënë ndonjë hap të madh në hulumtimin e dëshmimeve arkivore për këtë ngjarje, por u mjaftuan me rrëfimet e dëshmitarëve. Nuk ishte vetëm embargoja jugosllave, që pamundësoi një hulumtim më thelbësor të ndodhisë, por edhe njëlloj frike e historianëve kosovarë se në këtë ngjarje do të dalë e implikuar edhe udhëheqja politike dhe ushtarake e Shqipërisë. Dhe, merret vesh, ajo ishte e implikuar në mënyrë jashtëzakonisht tragjike.

Në të vërtetë, Shqipëria tashmë kishte kapitulluar para Jugosllavisë dhe atributet jugosllave për kosovarët si reaksionarë, kishin zënë vend në botëkuptimin e udhëheqjes politike dhe ushtarake të Shqipërisë dhe do të qëndrojnë i pandryshuar deri në kohët e vona. Në përgjithësi, përgjatë viteve 1944-48, kur miqësia shqiptaro-jugosllave njihte ditët e saj më të marra, trajtimi i kosovarëve që ankoheshin nga terrori jugosllav te autoritetet e Shqipërisë ishte refuzues dhe i egër. Kosovarët, qofshin të ikur ose të ndjekur, arrestoheshin në Shqipëri, mbaheshin nëpër burgje, u nënshtroheshin hetimeve dhe një numër syresh u dorëzoheshin autoriteteve jugosllave. Rasti më i përçudshëm është ai i Selman Rizës. Por nuk është vetëm ky. Me aksione të përbashkëta dhe duke këmbyer reciprokisht informatat, Shqipëria dhe Jugosllavia për një kohë relativisht të shkurtër arritën të vendosnin nën kontroll

zonat veriore të Shqipërisë, përfshirë edhe zonat kufitare me Kosovën, ndërsa Kosovën e pacifizuan pothuajse tërësisht.

Prandaj, nuk bisedohet nëse Shqipëria ishte në dijeni ose jo për masakrën e Tivarit, por në çfarë shkalle e ndihmoi atë. Hulumtimi i arkivave do të duhej të nxirrte në dritë se çfarë ishte shkruar në marrëveshjen shqiptaro-jugosllave, që kolonat e të mobilizuarve kosovarë të kalonin rrugës Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër dhe më tej në drejtim të Tivarit, kush i shoqëronte ato kolona, sa kosovarë të mobilizuar u vranë para se të arrinin në Tivar dhe gjëra të ngjashme. Sepse nuk ishte vetëm një kolonë dhe nuk ishte vetëm një rast. Edhe pas kësaj masakre, nëpër Shqipëri kaluan së paku edhe dy kontingjente të mobilizuarish, po me të njëjtin destinacion. Në këtë mënyrë, pas Luftës së Dytë Botërore, pacifizimin e Kosovës e ndihmoi edhe Shqipëria, duke u bërë pjesë e një skenari ndarës dhe refuzues për kosovarët, tashmë të mbetur pa asnjë mbrojtje dhe pa asnjë perspektivë politike.

Kuvendi i Prizrenit

Pas shpalljes së gjendjes ushtarake, mobilizimit të dhunshëm të rreth 50 mijë kosovarëve dhe vrasjes së një numri të madh syresh me pretekste të ndryshme, në Kosovë u krijuan rrethanat për një ndërmarrje të re politike: anulimin e vendimeve që ishin marrë në Konferencën e Bujanit. Kjo u bë në të ashtuquajturin Kuvend i Prizrenit, i cili u mbajt 8-10 korrik 1945. Kisha krijuar idenë se në librin e kujtimeve të Fadil Hoxhës kjo ngjarje duhej të zinte një vend të rëndësishëm, sepse në popull ishte krijuar një si gojëdhënë për qëndrimin që kishte mbajtur ai në këtë

kuvend. Dhe legjenda thoshte kështu: Pasi kishte bërë përpjekje të pasuksesshme për ta ndryshuar rrjedhën e kësaj ngjarjeje, Fadil Hoxha, pjesëmarrësve shqiptarë të mbledhjes, me lot në sy u kishte thënë afërsisht këto fjalë: Mbaruem, burra! Pshtojeni kokën, kush mundet! Në librin e kujtimeve, me një gjakftohtësi lapidare, Fadil Hoxha të thuash si shkarazi përmend faktin se “vendimet e Konferencës së Bujanit u suprimuan në Kuvendin e Prizrenit” dhe se aty u vendos që Kosova t’i bashkëngjitej Serbisë. Është pak e çuditshme, dhe këtë ai nuk e thotë asnjëherë, si arritën Fadil Hoxha dhe disa të tjerë t’i mbijetonin këto ngjarje kaq të kundërta me njëra-tjetrën: edhe Konferencën e Bujanit, ku, siç thonë ata, qenka marrë vendimi që Kosova t’i bashkëngjitej Shqipërisë, po edhe Kuvendin e Prizrenit, ku u mor vendimi që Kosova të bëhej me Serbinë? Fadil Hoxha thotë: “Të gjithë anëtarët e Bujanit kanë qenë aty”, pasi pak më sipër kishte pohuar, se tashmë ishte dhënë në diskutim deklarata “që do t’i bashkohemi Republikës së Serbisë” dhe se dokumentet e prezantuara pranohen “njëzëri”.

Tashmë dihet se disa nga pjesëmarrësit e Kuvendit të Prizrenit nuk arritën ta mbijetonin atë ngjarje, disa të tjerë u burgosën, sekush u shantazhua në forma të ndryshme, por, krejt në fund, u krijua një listë e “përfaqësuesve të popullit” që nënshkruan “vendimin unanim”, me të cilin Kosova t’i bashkëngjitej Serbisë, “me vullnetin e lirë të popullit”. (Kjo situatë do të përsëritet së paku edhe një herë në historinë më të re të Kosovës, në vitin 1989, kur Kuvendi i Kosovës do të votojë ndryshimet kushtetuese të Serbisë, me të cilat suprimohej autonomia e Kosovës. Po të mos kisha qenë i pranishëm në Prishtinë në vitin 1989, nga ndonjë distancë kohore me siguri kisha besuar se delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës u gjetën nën tryshninë e madhe të

ushtrisë dhe policisë serbe, sepse edhe ashtu kushtetuta e Serbisë e miratuar asaj radhe u quajt *kushtetutë e tankeve*. E vërteta është se kosovarët me këtë rast, njësoj si në vitin 1945 në Prizren, tradhtuan veten e tyre dhe se për këtë vetë e mbajnë përgjegjësinë. Madje, çuditërisht, pothuajse në të njëjtën mënyrë, në të dy situatat, “përfaqësuesit e popullit” janë përpjekur të fshihen prapa ngjarjeve të tjera që ndodhën atëbotë. Por e vërteta është se delegatët e Kuvendit të Prizrenit të vitit 1945 ishin përzgjedhur nga OZNA, ndërsa të Kuvendit të Kosovës të vitit 1989 nga SPB-ja e asaj kohe. Nënshkrimi i qitur në letër në vitin 1945 dhe gishtat e ngritur në Kuvendin e Kosovës më 1989, janë dy gurë të lidhur në qafën e Kosovës, që përforcojnë idenë e *vetëvrasjes politike*, të cilën kosovarët dinë ta bëjnë mirë herë pas here.)

Edhe dy gjëra bien në sy rreth Kuvendit të Prizrenit të korrikut të vitit 1945: emrat e nënshkruesve, si dhe shpërndarja e tyre nëpër komunat e Kosovës. Disa nga këta persona, nënshkrues të aktit të bashkëngjitjes së Kosovës me Serbinë, mrekullisht kanë ditur të fshihen për aq shumë vite nga sytë e opinionit, duke u shfaqur njëkohësisht në pamje të dyfishtë. Disa të tjerë veprimin e kishin bërë me ndërgjegje dhe vetëdije të plotë. Ja disa emra që kumbojnë dhe bien në sy në mesin e 82 emrave të përfaqësuesve të rrethëve të vendit: Kolë Shiroka (Prizren), Elhami Nimani (Gjakovë), Ibrahim Tërnavci (Drenicë), Xhavit Nimani (Vuçitër), Fadil Hoxha e Mark Krasniqi (Pejë), Sinan Hasani (Gjilan), Sahit Zatriqi (Istog), Qamil Brovina (Rahovec), Asllan Fazliu (Suharekë) etj. Të pashmangshëm janë aty edhe emrat e afro 30 serbëve dhe malazezëve, të cilët publikisht ose nga prapavija, për shumë dekada bënë ligjin në Kosovë.

Por rastet e këtilla nuk duhet marrë në shqyrtim si diçka e jashtëzakonshme, sepse Kosova, si çdo vend tjetër i botës,

ka pasur kolaboracionistë me çdo pushtues. Fenomenin duhet parë në një plan tjetër: Përse më 1945 aq lehtësisht një numër kosovarësh, jo pa dije politike, marrin vendim t'i bashkëngjiten Serbisë? Dhuna dhe terrori doemos që e kanë bërë të veten. Por do parë këtu edhe një fakt tjetër, po kaq i dhembshëm: mesazhi që iu vjen kosovarëve nga Shqipëria në atë kohë nuk është aspak inkurajues për ta vazhduar qëndresën dhe rezistencën. Përkundrazi. Më anë tjetër, kjo mund të jetë edhe arsyeja, përse një pjesë e mirë e kosovarëve, veçmas komunistët dhe pjesëmarrësit aktivë në atë pjesë të LNC-së të organizuar nga PKJ-ja dhe PPSH-ja, u përfshin në zhvillimet më negative të asaj periudhe, sepse Shqipëria nuk funksiononte si mburojë për asgjë, as për ide, as për veprime. Madje, ishte po ajo Shqipëri që e ndihmonte Jugosllavinë në të gjitha format t'i persekutonte dhe t'i nënshtronte kosovarët. Disa detaje nga kjo situatë zbulohen në mënyrë autentike nga një letër e Spasoje Gjakoviqit, e shkruar në vitin 1981...

Një histori me OZNA-n

Në të vërtetë, bëhet këtu fjalë për veprimtarinë dhe bashkëpunëtorët e OZNA-s në Kosovë, përfshirë edhe viktimat e saj, të cilat në realitet janë viktima të dhunës shtetërore jugosllave. Nga një letër e Spasoje Gjakoviqit, shef i atëhershëm i OZNA-s për Kosovë, dërguar më 18 shkurt 1981 organeve partiake dhe të pushtetit të asaj kohe, kuptohet se ndërmjet Spasoje Gjakoviqit dhe Mahmut Bakallit, ende në pushtet, kishte shpërthyer një konflikt. Po e japim këtë situatë, ashtu siç është gjetur në dokumentet e kohës.

Spasoje Gjakoviqi qenkësh hidhëruar shumë në Mahmut Bakallin, për faktin se ky nuk e kishte pranuar në një takim sy më sy, madje as pas ndërhyrjes së Fadil Hoxhës. Prandaj Spasoje Gjakoviqi vendos që të shkruaj letrën prej 41 faqesh. Letra nis pikërisht me faktin se Mahmut Bakalli, në një takim me Titon kishte kërkuar sqarime për likuidimet e disa njerëzve në Kosovë gjatë viteve të pasluftës. Në letër janë dhënë fakte, të cilat duket se kanë qenë të panjohura jo vetëm për Mahmut Bakallin, por edhe për shumë njerëz të tjerë në Kosovë. Pas leximit të kësaj letre të Spasoje Gjakoviqit, Bakalli kërkon një takim urgjent me Fadil Hoxhën, Xhevdet Hamzën dhe Xhavit Nimanin, një takim zyrtar. Por ky takim nuk ndodh asnjëherë, ndoshta edhe për faktin se demonstratat e vitit 1981 nisin vetëm 20 ditë më vonë.

Por, për këtë letër, qëndron edhe një shkas tjetër. Bakalli, kohë më parë, kishte refuzuar kërkesën dhe intervenimin e disa njerëzve nga Beogradi, që Ali Shukrija të dërgohej në Federatë, si kuadër i Kosovës. Ai kishte vendosur që Shukrija të mbetej në Kosovë, pa asnjë funksion. Por pas presioneve të shumta, ai vendos që ta zgjerojë kryesinë e Komitetit Krahinor të Kosovës, për t'i ofruar një vend Ali Shukrisë. Ky fakt e irriton Spasoje Gjakoviqin. Në të vërtetë, për Ali Shukrinë, Gjakoviqi kishte reaguar edhe më parë, në një letër dërguar Titos, më 24 maj të vitit 1974, me rastin e propozimit të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës që Ali Shukrija në Kongresin e Dhjetë të LKJ-së të zgjidhej anëtar i Komitetit Qendror dhe sekretar ekzekutiv i Kryesisë. Informata, thotë Gjakoviqi, kishte të bënte me qëndrimet e Ali Shukrisë gjatë LNÇ-së. "Për këtë ka ditur edhe shoku Xhavit Nimani dhe shokët e mi nga OZNA, për çka shumë udhëheqës të OZNA-s kanë kërkuar që unë ta burgos Ali Shukrinë".

Më tej, Gjakoviqi vazhdon: “Shokët Miladini dhe Krsta gjatë LNÇ-së e kanë akuzuar Ali Shukrinë si fajtorin kryesor që u burgosën shokët nga KPJ-SKOJ-i, përveç Ali Shukrisë, sepse nga një anëtar i celulave partiake ishte lënë pa u burgosur, që të shërbente si lidhje për burgosjet e tjera.” Sinjalet e para për qëndrimin e Ali Shukrisë gjatë LNÇ-së kishin ardhur nga OZNA e Serbisë dhe më vonë edhe nga OZNA e Jugosllavisë. Vërtetimi i këtyre fakteve, thotë Gjakoviqi, ishte bërë nga kuadrot shqiptare. Mjaft të dhëna të sakta kishte dhënë edhe Çapajev Bajgora. Pas këtyre fakteve, që Gjakoviqi ia kishte bërë me dije Titos, më 1974, kishte ardhur edhe reagimi nga Prishtina: Mahmut Bakalli ia kishte parë për të madhe Spasoje Gjakoviqit për qëndrimin që kishte mbajtur ndaj Ali Shukrisë.

“A kam pasur një zgjedhje tjetër”, bën një pyetje retorike Spasoje Gjakoviqi, “përveç se ta shpalos haptas një pjesë të historisë që do të duhej të mbetej e panjohur për opinionin. Nga kjo që po iu them dhe shkruaj më poshtë, do të shihet se nuk kam pasur asnjë zgjedhje tjetër. Sepse, më duhet të them, se një fjali që më ka ardhur nga Bakalli, ka qenë shumë e rëndë: Hë, shoku Spasoje, më thuaj, ajo OZNA jote sa njerëz ka pushkatuar pas luftës në Kosovë? A kanë qenë 12.500 apo 13.500? Kjo pyetje më ka befasuar shumë edhe për faktin se u bë përmes telefonit, ndërsa unë isha në zyrat e Prokurorit të Përgjithshëm...”

“Të nesërmen”, vazhdon Spasoje Gjakoviqi, “e kam thirrur shokun Alush Gashi dhe i kam thënë se OZNA ka pushkatuar në Kosovë 1.274 bashkëpunëtorë të okupatorit, vrasës apo organizatorë të ndryshëm. Në këtë numër nuk hyjnë të vrarët gjatë aksionit të Ushtrisë Popullore Jugosllave.” (Të përkujtojmë, shkruan Gjakoviqi, në atë kohë ballistët kishin marrë Trepçën, kishin pasur si territor të lirë

Sërbicën, kishin marrë Podujevën, Ferizajn dhe një pjesë të Gjilanit.)

“Por dua t’iu them, shoku Bakalli, edhe disa fjalë për OZN-ën”, shkruan në letër Spasoje Gjakoviqi. “Si udhëheqës i OZNA-s për Kosmet, bazën e parë e kemi vendosur në Prokuplje dhe pastaj në Podujevë, në rajonin e Llapit. Podujeva dhe rajoni i Llapit gjithmonë kanë qenë territor më i mirë për veprim, si për gjetjen e njerëzve, ashtu edhe për shtrirje të pastajme në territorin e Kosovës.” Gjakoviqi shkruan se me veprimet që kishte bërë, ishte pajtuar edhe Miladin Popoviqi. “Atëherë, shoku Bakalli”, vazhdon Spasoje Gjakoviqi, “dua t’ua bëj me dije se në OZNA kam punuar me këta njerëz të kombësisë shqiptare: Rasim Cerkezin për rajonin e Mitrovicës, Ali Shukrinë për rajonin e Ferizajt, Kacanikut, Vitisë, Gjilanit dhe Kamenicës, Alush Gashin për rajonin e Pejës, Xhevdet Hamzën për rajonin e Gjakovës, Mehmet Cikulin për rajonin e Prizrenit. Kurse në qendër të OZNA-s për Kosovë, kam punuar me shokët Xhavit Nimani dhe Ismet Shaqiri. Por ka pasur edhe disa shokë të tjerë shqiptarë në OZNA, si: Mazlum Nimani, Shaban Kajtazi, Shabo Gutiq, Nazmi Kursani...”

Pastaj letra trajton shpjegime të ndryshme për punën e OZNA-s në Kosovë dhe bën përpjekje të sqarojë lidhjet me Shqipërinë, si dhe marrëveshjen me Koçi Xoxen, për të likuiduar qindra njerëz të Gjakovës me rrethinë, të cilët ishin përgatitur të iknin nga Kosova në Shqipëri. “Por dikush kishte dekonspiruar dhe aksioni nuk është kryer më sukses”, shkruan Gjakoviqi. Edhe një sqarim tjetër jep ai: Kur është aprovuar Rezoluta Informbyrosë e vitit 1948, në malet e Kosovës kemi pasur vetëm 22 ballistë, që ka qenë një situatë e lehtë për t’u kontrolluar. Në atë kohë mua më dërgojnë në Shqipëri për tu takuar me Koçi Xoxen, i cili fliste shumë mirë gjuhën maqedonase. Për mua ishte inkurajues

momenti kur Koci Xoxe më shpalosi fakte të tjera për gjendjen në teren. Ai më thotë, shkruan Spasoje Gjakoviq në letrën e tij, se në Kosovë dhe në malet e saj ka më shumë se 2 mijë luftëtarë nën armë, që janë të gatshëm të luftojnë. Koçi Xoxe thoshte se këto informata i kishte marrë nga një qendër spiunazhi në Greqi. “Është e qartë pra, shoku Bakalli, se prapa kësaj ka qëndruar një qendër e fortë. Mund ta merrni me mend cila: Bashkimi Sovjetik ka qenë i vetmi vend që ka pasur interes të shkatërrojë Jugosllavinë përmes Kosovës”, konstaton Gjakoviqi.

RIKONFIGURIMI I IDNETITETIT

Alternativat e mbijetesës

Është pak e çuditshme si ndodhi që shqiptarët e Kosovës, që në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, krijuan alternativa e tyre të shpresës, me anë të të cilave duhej t'i kundërviheshin dëshpërimit dhe defetizmit. Marrë në përgjithësi, gjendja e kosovarëve ishte tmerrësisht e pashpresë. Idili i Shqipërisë etnike kishte marrë fund bashkë me luftën. Ajo kishte qenë një ëndërr e shkurtër, e cila tani ishte prishur përfundimisht dhe kosovarët duhej t'i ktheheshin një realiteti me iluzione krejtësisht të shkatërruara. Ata që kishin mbështetur idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, kishin pësuar disfatë të pariparueshme, kishin ikur nga kishin mundur (thuhet se me këtë rast ikën nga Kosova rreth 4.000 veta), ishin degdisur nëpër botë dhe Kosova, ndoshta njësoj si edhe Shqipëria, kishte mbetur pa nacionalizëm dhe pa idealizëm kombëtar. Në rrethanat ballkanike të mbeteshe pa nacionalizëm ishte njësoj si të shfaqeshe i zbuluar përpara një llave ujqërish, pa asgjë në dorë dhe pa vend ku të futesh. Të mbeteshe pa idealizëm kombëtar, siç kishin mbetur shqiptarët e Kosovës, ishte njësoj sikur të humbje pikat e orientimit në një mjegull të dendur.

Çfarë duhej të bënin tani kosovarët, cilën rrugë duhej të ndiqnin? Katër vitet e jetës së përbashkët me Shqipërinë, përveç që kishin mëkuar shumë shpresa për të ardhmen,

kishin qenë produktive edhe në rrafshin arsimor, kulturor, madje edhe ekonomik, por më shumë në fushën e vetëdijes dhe të identitetit. Një pjesë e kosovarëve, me shumë dilema fetare dhe të pidentifikueshëm qartë me njësinë kombëtare shqiptare, përfundimisht e kishin gjetur “rrugën e Zotit”. Një pjesë tjetër, e mësuar me traditën e gjatë të qëndrueshmërisë së Perandorisë Osmane, ishte struktur me një anë dhe rrinte në pritje të zhvillimeve më afatgjata. Tani që ndodhi përmbysja, njerëzit e kishin të vështirë ta merrnin veten: Shqipëria pothuajse ishte bërë një me Jugosllavinë, por vetëm në luftimin e përbashkët të nacionalistëve, të antikomunistëve, të NDSH-istëve, apo edhe të komunistëve që patën guximin të kërkonin zgjidhje të drejtë për Kosovën. Çdo gjë e kishte një alternativë, përveç nacionalizmit, i cili alternativë të vetme e kishte pushkatimin ose burgosjen.

Kjo periudhë, periudha 1944-1948, duket të ketë qenë koha më e pamundshme për Kosovën, sepse konfuzioni ishte aq i madh, sa që ishte vështirë të gjendej një shpjegim racional. Më pas gjërat filluan të qartësoheshin, pra filluan të bëheshin tragjikisht të qarta. Shqipëria, jo për shkak të Kosovës dhe as për shkak të rrezikut permanent që të gllabërohej nga Jugosllavia, por për “çështje parimore” dhe “të ideve të mëdha”, vihet në anën Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit, në konfliktin e tij me Titon dhe Jugosllavinë. Ky zhvillim e mbyll përfundimisht kufirin e Kosovës me Shqipërinë dhe kjo bëri që kosovarët e atyre viteve të mos kenë më asnjë iluzion sa i përket Shqipërisë. Shqipëria nuk shërbente më për asgjë, përveç se për një kohë, ndonjë kosovar mund ta shpëtonte kokën duke kapërcyer kufirin, sikundër që ndonjë tjetër mund të vriste fqinjin e tij për shkak të megjes ose pse ia kishte shikuar gruan, më pas të ikte në Shqipëri dhe atje të gënjente se kishte ikur nga represioni serb. Më anë tjetër, Shqipëria nxirrte grupe

diversantësh në zonat kufitare, dhe Jugosllavia e bënte po të njëjtën gjë. Njerëzit vriteshin nga të dyja palët, por në të dy rastet ishin shqiptarë ata që e hanin plumbin.

Rezoluta e Informbyrosë çoi edhe një numër kosovarësh në Goli Otok, por ata, kryesisht, nuk u burgosen për shkaqe ideologjike, siç ndodhi me informbyroistët serbë e malazias, por për çështje nacionale. Të burgosurit politikë shqiptarë që atëherë filluan të ishin të ndryshëm nga të burgosurit e tjerë politikë të Jugosllavisë. Në rrethanat çfarë u krijuan, ata nuk mund të ishin njerëz pa ideologji dhe nuk mund të ishin unikë në pikëpamje, përfshirë edhe identitetin kombëtar. Një pjesë e shqiptarëve të Kosovës, për të shpëtuar nga identifikimi negativ që bënte pushteti jugosllav, u regjistruan si turq. Këtë proces të konvertimit e parapëlqente dhe mbështeste pushteti. Kështu, më 1948 nuk kishte të regjistruar më shumë se 1.315 turq në Kosovë, por pesë vjet më vonë ky numër arrin shifrën fantastike prej 259.535 vetash. Procesit të regjistrimit të vitit 1953, prej të cilit doli kjo shifër, i parapriu një propagandë e intensifikuar, e zhvilluar përmes emisarëve të ndryshëm të angazhuar nga UDB-ja, kryesisht njerëz të fesë, të cilët me insistim kërkonin që shqiptarët të regjistroheshin si turq. Më pas, po këta njerëz e vazhduan propagandën e tyre, për t'i bindur njerëzit të shpërnguleshin në Turqi. Shifrat që kanë publikuar studiuesit shqiptarë janë alarmante, tragjike: përgjatë viteve 1952 - 1958 thuhet se janë shpërngulur në Turqi 285.810 persona, ndërsa në periudhën 1959 - 1965 janë shpërngulur 179.871 veta.

Në të vërtetë, sikundër që do të shihet edhe në vitet në vijim, Jugosllavia e re nuk u distancau asnjëherë nga programi nacional serb, i cili, herë përmes elaborateve dhe herë përmes organizimeve legale, vazhdonte politikën diskriminuese ndaj shqiptarëve. Legalisht shqiptarët ishin

pakicë kombëtare e pranuar në Jugosllavi, por paralelisht me politikat legale, bëheshin edhe politikat gjysmë institucionale, të cilat favorizonin idenë e vjetër të nacionalizmit serb, se shqiptarët e Kosovës ishin kolonë turq, të ardhur në Kosovë bashkë me Perandorinë Osmane. Studiuesit shqiptarë insistojnë se në janar të vitit 1953 në Split ishte zhvilluar një takim ndërmjet Titos dhe ministrit të Jashtëm të atëhershëm të Turqisë, Fuad Kypriliu, me të cilin kishte biseduar për riaktivizimin e traktatit të paratifikuar të vitit 1938 ndërmjet mbretërisë së Jugosllavisë dhe Turqisë, për shpërnguljen e një milion shqiptarëve nga Kosova dhe nga Maqedonia Perëndimore. Është vështirë të dihet nëse pretendimet e studiuesve shqiptarë kanë një bazë reale, se edhe vetë Tito ka qenë i angazhuar në këtë projekt të shovinizmit serb, por ajo që mund të dihet saktësisht është fakti se shpërngulja ka qenë legale dhe se është bërë me miratimin dhe me nxitjen e organeve të shtetit.

Këto kanë qenë vite të rënda për Kosovën. Veprimet e shtetit jugosllav kanë qenë të studiuara mirë dhe të kombinuara, të tilla që popullsia e pambrojtur e ka pasur të vështirë t'iu bëjë ballë. Është ushtruar dhunë sistematike policore, është ushtruar dhunë ekonomike, është ushtruar propagandë dhe, kur është parë se të gjitha këto nuk japin rezultatet e dëshiruara, janë ndërmarrë edhe aksione suplementare, ta zëmë, si aksioni i armëve, i cili nuk ka pasur ndonjë shkas të veçantë që të ndërmerret gati dhjetë vjet pas luftës, por është organizuar vetëm për të ushtruar terror mbi popullsinë civile. Madje, sikur kanë rrëfyer dëshmitarët e kohës, aksioni kishte degjeneruar në shitblerje pushkësh nga një dorë në tjetrën, nga policia sekrete te spiunët, nga spiunët te hallexhinjtë, të cilët, pas torturave çnjerëzore, shitnin kaun e lavrës ose lopën e qumështit për të blerë pushkën e kërkuar, kudo që mund të gjendej ajo.

Modeli i shqiptarit jugosllav

Këtu dua të ndalem pak më gjatë dhe, bashkë me lexuesin, të sqaroj një dilemë. Unë e kam lexuar librin me kujtimet e Fadil Hoxhës dhe, në disa vende, më ka bërë të stepem për shkallën e lartë të papërgjegjësisë, ose të cinizmit, që shfaq autori kundruall disa zhvillimeve fatkëqija që kanë ndodhur në Kosovë, për të cilat Fadil Hoxha, nëse mund të thuhet se nuk ka qenë përgjegjës i drejtpërdrejtë, doemos që ka pasur dijeni; nëse nuk ka pasur dijeni në kohën kur janë zhvilluar ato ngjarje, doemos që ka dëgjuar të flitet për to në rrethana të tjera; nëse nuk ka dëgjuar të flitet dhe nuk ka pasur bashkëpunëtorë dhe miq t'i tregojnë në atë kohë, doemos që për këto gjëra ka mundur ta mësojë të vërtetën pas viteve '90, kur u hoq embargoja nga të gjitha ngjarjet historike dhe politike. Atëherë, përse ky njeri, që e supozonte veten si lider të pakontestueshëm të Kosovës për një periudhë shumë të gjatë kohore, në rrëfimin e tij nuk e sheh të arsyeshme të zbulojë anën e errët të këtyre ndodhive? Ose të mbajë qëndrim rreth tyre, sepse janë ngjarje që i kanë sjellë shumë fatkeqësi këtij vendi, kanë hapur shumë varre, kanë lënë shkretë shumë konakë dhe e kanë cenuar Kosovën në qenien e saj...?

Të themi se Konferenca e Bujanit ishte ajo që ishte dhe Fadil Hoxha nuk kishte qenë ai që e kishte përcaktuar kahet e zhvillimin të kësaj ngjarjeje; të themi se Kuvendi i Prizrenit i korrikut të vitit 1945 ishte ai që ishte dhe se Fadil Hoxha nuk ka pasur aq forcë dhe ndikim sa të ndryshojë rrjedhën e tij; të themi se edhe kryengritja e Drenicës ishte ajo që ishte dhe Fadil Hoxha nuk kishte mundur të bënte gjë tjetër, përveç se të jepte urdhër të sulmoheshin me topa luftëtarët e Shaban Polluzhës. Ishin këto ngjarje që zhvilloheshin në rrethanat e luftës dhe Fadil Hoxha nuk ka qenë as i pari as i

fundit, që mund të jetë gjendur në anën e gabuar në një luftë të tillë. Por pas këtyre ngjarjeve, në Kosovë vjen një periudhë e *pushtetit populluer*, në ushtrimin e të cilit marrin pjesë edhe komunistët dhe ish-partizanët shqiptarë, përfshirë edhe Fadil Hoxhën. Ne tani e dimë se në vitet e para të pasluftës në Kosovë, madje deri në vitin 1966, kuadrove shqiptare nuk u mundësohej dhe as u lejohej ushtrimi i një pushteti real. Për të gjitha gjërat e rëndësishme vendosnin të tjerët. Shqiptarët mund të ishin ekzekutorë të vegjël, shërbëtorë të pushteti dhe pak gjë më shumë se kaq. Në këtë sens, për Fadil Hoxhën dhe shokët e tij mund të gjendet një arsyetim: ata ishin idealistë dhe, si të tillë, kishin besuar shumë gjëra që më pas dolën të pabesueshme, joreale. Ata kishin besuar në idealet e komunizmit dhe ishin zhgënjyer. Ata kishin besuar në vëllazërim-bashkimin e popujve të Jugosllavisë dhe ishin zhgënjyer. Ta zëmë, ne kemi pasur kurajë ta arsyetojmë deri diku shkrimtarin Hivzi Sulejmani, i cili pas luftës emërohet prokuror, dhe të emëroheshe prokuror për atë kohë donte të thoshte të dërgoje shumë njerëz para skuadrës së pushkatimit. Këtë fakt të tmerrshëm për një shkrimtar ne kemi qenë disi të prirë ta harrojmë, për faktin se ishte po ky Hivzi Sulejmani që një ditë doli e tha: Jo, unë nuk kam luftuar për këtë! Kjo nuk është ajo, për të cilën ne kemi qenë të gatshëm të japim jetët tona! Kjo që po shohim, nuk ka qenë kurrë ideali im! Ky Hivzi Sulejmani, që tërhiqte një rrënjë shqiptarësh të boshnjakizuar të Peshterit, që librat i shkruante serbisht dhe pastaj i përktheheshin shqip, pat kurajë të gjitha këto t'i thoshte, kur Jugosllavia ende ishte shumë e fortë dhe kur komunizmit nuk i shihej fundi askund.

Fadil Hoxha jo që nuk e bëri këtë, sepse të gjithë nuk mund të bëheshin disidentë, apo diçka që i shëmbëllen asaj, por ajo që mua më habit, është synimi dinak dhe cinik që të

arsyetohen gjërat. Ja si e shpjegon ai shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. “Kanë arritur pak vonë informatat për shpërnguljet e shqiptarëve në Turqi, në vitet 1953-54”, thotë ai dhe, pasi shpjegon se informatën e kishte sjellë Sinan Hasani në Beograd, jep edhe shifrën prej 50 mijë njerëzve që kishin marrë viza prej Ambasadës së Turqisë për t’u shpërngulur. Bashkë me një serb të Kosovës, Fadil Hoxha shkon te Rankoviqi për ta sqaruar këtë çështje. Dhe Rankoviqi, për habinë e tij të mëvonshme, mban “qëndrim korrekt”, sepse, thotë ai, turqit mund të shkojnë në Turqi, ata shkojnë në atdheun e tyre, ndërsa shqiptarët gjithashtu mund të shkojnë, nëse atje kanë ndonjë anëtar të familjes së ngushtë, ndryshe jo. Tani Fadil Hoxha pretendon se kishte arritur ta ndalte shkuarjen e shqiptarëve në Turqi, ndërkohë që ka harruar se pak më përpara vetë pohon se në Kosovë gjatë atyre viteve ishte hapur një çështje deri atëherë e panjohur: *regjistrimi i shqiptarëve si turq*. Fjalitë vijuese janë lapidare për nga konfuzioni: “Aty Rankoviqi ka pasur qëndrim korrekt. Do të vdes dhe nuk do t’ia harroj. Haptazi na tha: ‘Shqiptarët mos i lejoni të shkojnë!’. Kemi vështirësi. Që nga ajo kohë shkuarja në Turqi u ndërpre. Por, megjithatë, prapë kanë shkuar. Kanë shkuar në Shkup, janë bërë banorë të Maqedonisë – të Shkupit një javë dhe pastaj e kanë marrë shpërnguljen prej Kosovës. Në Shkup kanë marrë viza...”

Ngjashëm flet edhe për aksionin e armëve, ndonëse edhe me këtë rast gjen një arsyetim se ishte informuar vonë, sepse kishte qenë në spital. Por ama e thotë: “Nuk kemi qenë kundër mbledhjes së armëve, mirëpo kemi qenë kundër mënyrës se si i kanë mbledhur armët dhe jemi përpjekur ta ndalim. Krejt këtë punë e ka bërë OZNA.” Por një raport i mëvonshëm i krerëve të sigurimit serb, të cilët arsyetoheshin për zhvillimet e asaj kohe ndër kosovarët,

thoshte prerazi se udhëheqësit shqiptarë të Kosovës kishin qenë të informuar paraprakisht për aksionin e armëve dhe e kishin miratuar atë. Dhe e kishin vlerësuar. Në këtë kuadër, vetëm një gjë nuk del e qartë: si arrinte Fadil Hoxha të ruante te populli i Kosovës një aureolë lideri të paprekshëm, sikur ai çdo gjë që bënte, e bënte për të mirën e shqiptarëve, se ishte i vetmi që i kishte përballuar të gjitha, se ishte i afërt me Titon, se prej tij i kërkonte të drejtat e Kosovës, se ai ia miratonte me zemërgjerësi, se ai kishte qenë në konflikt të vazhdueshëm me nacionalizmin serb, me OZNA-n, me UDB-në, me Rankoviqin etj. Madje, legjendat për Fadil Hoxhën thureshin me një autenticitet të çuditshëm: Fadili i tha kështu e kështu Titos, Titoja i tha kështu Fadilit; Fadili i tha kështu Rankoviqit, Kardelit, Bakariqit, në një kohë që po ky Fadili, siç e tregon vetë në rrëfimin e tij, për një kohë të gjatë nuk kishte pasur asnjë kontakt me Titon dhe asnjë rol në zhvillimet politike të nivelit të lartë. Si arriti ai ta krijojë këtë aureolë rreth vetes, kjo ende mbetet enigmë. Në të vërtetë, sikundër që do të shihet edhe më vonë, liderë të këtillë me aureolë shenjtërie dinë të krijojnë vetëm popujt primitivë. Prijësit kosovarë, shumica syresh, përgjatë gjithë historisë më të re do të shfrytëzojnë me shkathtësi të madhe këtë rrethanë fatkeqe të injorancës së thellë të popullit të vet dhe me lehtësi të pashembullt do të bëjnë shkapërcimin e pamundshëm nga tradhtarë në heronj.

Ndërsa i themi këto, nuk e kemi synim për të vënë në vend ndonjë të vërtetë historike, por për të qartësuar idenë se brenda vetë Kosovës, pas Luftës ë Dytë Botërore, filloi të formohej një kontingjent njerëzish të *distancuar* nga shumica shqiptare, nga shqiptarët e zakonshëm, të cilët vuanin pasojat e rënda të diskriminimit. Ata u profilizuan menjëherë pas luftës, si bashkëpunëtorë të pushtetit, shumica të rekrutuar nga OZNA dhe më vonë nga UDB-ja.

Aty-këtu mund të gjendej edhe ndonjë kuadër i pamanipuluar nga pushteti, por të tillët ishin jashtëzakonisht pak. Ky kontingjent kosovarësh, në fillim, në vitet e para të pasluftës, ishte i vogël dhe në Prishtinë ose në qytetet e tjera të Kosovës jetonte në marrëdhënie tepër të ngushta me kuadrot komuniste serbe dhe malazeze, duke përzier edhe familjet. Ky kontingjent kosovarësh të distancuar, me kohë zgjerohet dhe rritet në numër, paralelisht me avancimet që bën Kosova në drejtim të zhvillimit politik, ekonomik, social, arsimor, kulturor dhe të hapave të përshpejtuar që bën në integrimin jugosllav. Diferencimi dhe distancimi i tij në pikëpamje sociale është i qartë. Ata jetojnë më mirë se të gjithë shqiptarët e tjerë në Kosovë, kanë rroga të mira, udhëtojnë në Beograd, vishen më mirë dhe dinë të flasin serbisht. Në rrethin e tyre tërheqin edhe njerëz të rinj, të cilët fillojnë t'i shkollojnë në universitetet jugosllave, por më së shumti në Beograd. Përzgjedhjen e këtyre të rinjve e bëjnë ose organet e sigurimit të shtetit, ose komitetet lokale të partisë, me shumë besueshmëri dhe me shumë konfidencë. Nga familjet e njohura nacionaliste tërhiqen djemtë e rinj, të cilët arsimohen dhe edukohen me para të shtetit. Përmes kërcënimeve dhe shantazheve ata futen në spiralen e varshmërisë shtetërore, bëjnë martesë të përziera, në mënyrë që pastaj të bëhen shembull për rrethin prej nga vijnë. Cenet biografike, kërcënimet dhe shantazhet përdoren edhe ndaj kuadrove të vjetra e të verifikuara, sa herë që ata duhej ta rikonfirmonin lojalitetin ndaj Jugosllavisë.

Këta kosovarë, tashmë të distancuar nga populli i vet, bëjnë të gjitha përpjekjet të njëjtësohen me mentalitetin sllav. Duke qenë pjesëtarë të një kombi të fyer dhe të përçmuar nga të gjitha anët, ata i përqendrojnë të gjitha përpjekjet të mos identifikohen me shqiptarët shumicë, të cilët tashmë

kishin filluar të mbushnin rrugët e qyteteve të mëdha të Jugosllavisë si punëtorë krahu, sharrëxhinj, hamaj. Ideali i jetësor i një pjese të shqiptarëve të Kosovës bëhet Jugosllavia, elita e saj, kuluaret e Beogradit, jeta politike dhe kulturore e kryeqendrës, ku ka frekuencë të madhe idesh kontemporane, por edhe fërkime të mëdha nacionale brendajjugosllave, të cilat me sukses neutralizohen nga idetë e Titos për bashkëjetesë të të gjitha kundërshtive nën modelin jugosllav të socializmit. Kjo pjesë e kosovarëve ka një brengë: si ta afrojë sa më shumë Kosovën me Jugosllavinë, me standardin e saj të matjes së të të gjitha vlerave. Por derisa elitat politike të mbarë Jugosllavisë, krahas mbështetjes të parimet e integritetit jugosllav, ndërtojnë elita të pavarura kombëtare, elita e atëhershme politike kosovare synon të ndërtojë një elitë politike dhe kulturore që përjetësisht duhej të qëndronte e varur nga ideja e jugosllavizmit. Elita kosovare e periudhës së autonomisë u ndërtua jashtë kësaj skeme, kur në Kosovë filloi të zhvillohej një luftë e ashpër ndërmjet nacionalizmit shqiptar dhe integralizmit jugosllav.

Pra, gradualisht, u krijua modeli i *shqiptarit jugosllav*, i cili shumë shpejt identifikohet si mbështetës i fuqishëm i idesë së vëllazërim-bashkimit, që për kushtet kosovare donte të thoshte përvetësim i rezervë të të gjitha vlerave jugosllave dhe, paralelisht me këtë, heqje dorë nga identiteti shqiptar. Në të vërtetë, askush nuk kërkonte nga këta kosovarë të mos quheshin shqiptarë, të mos flisnin shqip, të mos mendonin shqip, të mos jetonin sipas traditave shqiptare, të mos krijonin familje shqiptare. Por atyre iu ofrohej një model tjetër i jetës, që për rrethanat kosovare ishte shumë më i avancuar: ishte *modeli jugosllav*, ku shkatërrohej pamëshirshëm çdo identitet kombëtar jugosllav dhe i pabarabartë me të. Që shqiptari i Kosovës të bëhej

jugosllav i barabartë, nuk mjaftonte vetëm të avanconte në kulturë jete, në kulturë sjelljeje, në kulturë banimi, të avanconte në arsimim, të mësonte të fliste serbokroatisht pa theks shqiptar, të bënte miq serbë, boshnjakë, maqedonë, kroatë, por duhej të bënte më shumë se kaq: të distancohej nga çdo gjë që ishte shqiptare, madje mundësisht t'i përqeshte traditat e veta dhe identitetin e vet. Me sjelljen e vet, më mënyrën e vet të jetës, me lojalitetin ndaj shtetit dhe ndaj të tjerëve, ai duhej të tregonte se nuk ishte primitiv, se nuk e meritonte të urrehej e të përçmohej, se dallonte nga shqiptarët vrasës dhe gjakatarë të kohës së shkuar, se mund të kishte emër mysliman, por nuk duhej të ndihej i tillë, se kishte kulturë dhe kjo kulturë doemos që duhej të ishte sllave, ndryshe ajo nuk kishte kuptim.

Shovinizmi komunist

Po i lexuam shkrimet tona të historisë, do të vërejmë se në këtë periudhë ngjarjet rreth Kosovës rrjedhin disi njëtrajtshëm, në kuptimin e njëanshmërisë së tyre. Do të shohim se komunistët e Shqipërisë flasin për zhvillime pozitive në kuadër të LNÇ-së, për luftë të suksesshme kundër okupatorit dhe bashkëpunëtorëve të tij, për vendosjen dhe stabilizimin e pushtetit popullor dhe, natyrisht, për disa rrethana të jashtme jo shumë të favorshme dhe gjithsesi më shumë për reaksionin e brendshëm. Kjo ka qenë skema, e cila është ndjekur nga historiografia zyrtare e Shqipërisë. Kur vinte puna te Kosova, me sa më pak rreshta, duhej thënë diçka e mjegullt edhe për të, që në esencë kishte këtë kuptim: se revizionistët jugosllavë i tradhtuan idealet e komunizmit dhe prandaj as

çështja e Kosovës nuk gjeti zgjidhjen e duhur mbi parimet leniniste.

Historiografia zyrtare e Jugosllavisë natyrisht që gjërat do t'i shikojë ndryshe, nga këndvështrimi i saj. Historianët jugosllavë mund të jenë dukur më pak ideologjikë, por kjo ka qenë vetëm pamje e jashtme. Në të vërtetë, në raport me çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve, ata do të bëjnë një kombinim gati të pamundur nacional-shovinist dhe komunist njëkohësisht. Ata do të glorifikojnë vijën komuniste projugosllave në Partinë Komuniste të Shqipërisë, që nga grupet e para komuniste, njëkohësisht duke i atribuuar rolin e themeluesit PKJ-së dhe emisarëve të saj, si Miladinit, Dushanit dhe Tempos. Por, më anë tjetër, me këmbëngulje do ta mbrojnë pozicionin e tyre nacional-shovinist ndaj shqiptarëve, duke mos hequr asnjë presje nga programi nacional serb, të cilin tani do ta riambalazhojnë me veshjen terminologjike të internacionalizmit proletar. Pra, shovinizmi i mëparshëm imperialist serb tani do të bëhet shovinizëm komunist serb, duke gjetur pikëtakime edhe aty ku kjo të duket krejt e pamundur. Edhe rreth Kosovës historianët jugosllavë i nënshtrohen diktatit serb, duke mos bërë ndonjë përpjekje të madhe të arsyetojnë veprimet radikale që ndërmorën në Kosovën e pasluftës. Në mënyrë shumë përgjithësuese do të thonë se në Kosovë reaksioni ishte shumë i fuqishëm dhe se në disa momente ai mori karakter kundërrevolucionar. Me këtë formulë përligjeshin të gjitha masakrat që ishin bërë në Kosovë që nga viti 1944 e prapa.

Historiografia kosovare, gjatë viteve të autonomisë, u gjet në një situatë jashtëzakonisht paradoksale, kur bëhej fjalë për zhvillimet në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo duhej të mbronte qëndrimin e udhëheqjes politike kosovare, se autonomia e Kosovës i tërhiqte rrënjët që nga

LNÇ-ja dhe në këtë pikë ajo duhej t'i kundërvihet historiografisë serbe, e cila e mohonte këtë fakt. Historianët serbë LNÇ në Kosovë (për aq sa pranonin se kishte pasur LNÇ në Kosovë) e trajtonin si të pandarë nga LNÇ-ja e Serbisë, respektivisht si të tillë që ajo mund t'i referohej njëloj *pavarësie organizative*, por jo që të kishte një lidhje të drejtpërdrejtë me organizimin e LNÇ-së në nivel jugosllav. Sipas tyre, i tillë kishte qenë edhe organizimi partiak. Kjo dëshmohej edhe me mospërfaqësimin e Kosovës në mbledhjet e AVNOJ-it. Mësimi që jepnin historianët e Kosovës ishte i qartë, por edhe mësimi që synonin të jepnin historianët serbë gjithashtu dilte i qartë. Arbitër në këtë pikë mund të ishte Dedieri, historiani personal i Titos, por ai, ndonëse kroat, në parim nuk e ndryshon diskursin e tij antishqiptar, të kodifikuar qartë që në librin e hershëm "Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare (1939-1944)" të botuar në vitin 1949, kështu që historianëve të Kosovës u mbetej që këtë betejë ta bënin vetë, madje edhe pa mbështetjen e historianëve të bunkerizuar të Shqipërisë.

Pra, konflikti ndërmjet historianëve jugosllavë dhe historianëve shqiptarë të Kosovës të kohës së autonomisë nuk u zhvillua vetëm rreth LNÇ-së në Kosovë, por edhe rreth themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe zhvillimit të LNÇ-së në Shqipëri. Në Jugosllavi, atëbotë, ishte ngulitur pikëpamja se Partinë Komuniste të Shqipërisë e kishin themeluar komunistët jugosllavë, nga grupet e përçara, që nuk arrinin të krijonin një organizatë të përbashkët partiake. Kjo çështje nuk ishte vetëm historike, por më shumë politike, sepse duke ia kontestuar Shqipërisë autenticitetin e organizimit partiak-komunist, kontestohesh edhe LNÇ-ja, e bashkë me këtë edhe legjitimiteti i pushtetit të tanishëm në Shqipëri. Për historianët nacionalistë serbë, njësoj si edhe për ish-organizatorët jugosllavë të LNÇ-së në

Shqipëri, po kaq i rëndësishëm ishte afishimi publik i një sprove të re shoviniste kundrejt shqiptarëve në përgjithësi, i nënçmimit të tyre, sprovë kjo që duhej parë nëse do të kalonte e pandëshkuar në rrethanat e socializmit liberal të Titos dhe të Jugosllavisë së rirregulluar me ndryshimet kushtetuese, të cilat tashmë kishin filluar dhe që duhej të nxirrnin si përfundim funksionimin e një modeli të ri të federatës jugosllave. Për një nënçmim të këtyllë arrogant të komunistëve të Shqipërisë kishin dhënë argumente të mjaftueshme vetë krerët komunistë të PKS-së, veçmas me ato përqafimet dhe puthjet e grave të tyre krejt “dorëllira” ndaj Miladinit, Dushanit dhe ndonjë tjetri, që kosovarët tashmë i kishin të njohura përmes librit të Dedierit.

Do të jenë dy autoritete shkencore të Kosovës, Ali Hadri dhe Fehmi Agani, që do ta hapin dhe do ta diskutojnë politikisht dhe historikisht këndvështrimin jugosllav të themelimit të PKS-së. Së pari ndodhi reagimi i Ali Hadrit ndaj memoareve të Svetozar Vukmanoviq-Tempos, ndërsa më vonë mbrojtja e disertacionit të doktoratës nga Fehmi Agani, afërsisht mbi të njëjtën temë. Në kujtimet e tij, Tempoja kishte përfshirë edhe aktivitetin që kishte zhvilluar dy-tri vjet me radhë, si i dërguar i PKJ-së në Shqipëri, Greqi, Maqedoni dhe Kosovë për organizimin e LNÇ-së. Tempoja pohonte me këmbëngulje se lëvizjen komuniste në Shqipëri, përfshirë edhe themelimin e PKS-së, e kishin bërë jugosllavët dhe se komunistët shqiptarë, gjatë viteve të luftës dhe menjëherë pas saj, kishin bërë dy gabime të mëdha: kur kishin tentuar të bënin marrëveshje me ballistët dhe kur kishin eliminuar Koçi Xoxen. Ali Hadri i kundërvihet Tempos kryesisht duke përdorur argumente nga “Historia e Partisë së Punës”. Sipas tij, Tempoja nuk i kundronte në mënyrë marksiste themelimin e PKS-së, sepse nuk merrte para sysh faktin se Partia Komuniste e Shqipërisë ishte

themeluar si rezultat i rrethanave të brendshme etj. Kurse për Koçi Xoxen thotë po atë që thoshte udhëheqja politike e Shqipërisë, se kishte qenë fraksionist dhe i përfshirë në rrjetin e spiunazhit jugosllav.

Ali Hadri nuk ishte historian dosido dhe reagimi i tij ndaj Tempos nuk mund të merrej vetëm si reagim i pastër shkencor, sepse, në njëfarë mënyre, ai ishte historian zyrtar i Kosovës për LNÇ-në dhe prapa qëndrimeve të tij mund të fshihej një tendencë pothuajse e tejdukshme e kreut politik të Kosovës, i përfaqësuar nga autonomistët e rinj në krye me Mahmut Bakallin, të cilët haptazi, duke shfrytëzuar politikat liberale të Jugosllavisë, dukej sikur tashmë kishin marrë guximin të sfidonin Serbinë dhe Jugosllavinë dhe pak nga pak të bënin hapa afrimi me Shqipërinë, madje edhe në ato pika, ku mospajtimet midis dy shteteve ishin jashtëzakonisht të mëdha. Në rastin e Tempos, reagimi i Ali Hadrit ishte një mbështetje e hapur që Kosova i bënte Shqipërisë, veçmas *bazës historike* të udhëheqjes së saj. Por mbulesa e kontestimeve kishte tjetër bazë ideore: Tempoja, në memoaret e tij, e kishte mohuar pothuajse në tërësi LNÇ-në në Kosovë dhe kishte thënë se shqiptarët e Kosovës kishin pasur qëndrim armiqësor ndaj komunistëve. Ky kontestim ia mohonte Kosovës të drejtën për status më të mirë në bashkësinë jugosllave, nga ç'e kishte pasur në vitet e para të pasluftës, si një krahinë ku represioni arsyetohej me qëndrimin armiqësor të shqiptarëve ndaj LNÇ-së, ndaj komunistëve dhe Jugosllavisë në përgjithësi.

Identiteti pezull

Me një ndarje të thellë brenda vetes, Kosova tashmë po identifikohet si hapësirë e veçantë, që nuk ishte tamam as Shqipëri e jashtme, as Jugosllavi e brendshme. A ishte ky një identitet i mëvetësishëm? Nuk mund të thuhet. Ishte një identitet pezull, një identitet në pritje, një identitet i papërfunduar, i tillë çfarë është edhe sot e kësaj dite. Atëbotë, edhe përkundër trysisë së madhe nga të gjitha anët, substanca kombëtare e Kosovës nuk u shpërbë. Në dhjetëvjetëshat e parë të pasluftës, një pjesë e kosovarëve mori rrugën e arratisë, një pjesë tjetër përfundoi në Turqi, një pjesë u manipulua nga Jugosllavia dhe u bënë shqiptarë jugosllavë, një pjesë tjetër u regjistruan turq, dikush u bë goran, dikush boshnjak, por kishte edhe të tillë që zhvilluan emigrimin e brendshëm: furrarë të Hasit dhe të Gorës u shpërndanë anë e kënd Jugosllavisë, ëmbëltoreshinjtë e Tetovës gjithashtu, ndërsa punëtorët sezonalë kosovarë gjendeshin atje ku zhvilloheshin projektet e mëdha të ndërtimit në infrastrukturë ose në objektet ekonomike. Martesat e përziera firuan një numër jo të vogël kosovarësh, të cilët populluan qytetet xehetarësh të Bonjës e të Serbisë, ose ata më me shumë fat, kryeqytetet e republikave më të zhvilluara. Nga fundi i viteve '60 filloi edhe emigracioni ekonomik në shtetet e Europës Perëndimore. Por, megjithatë, substanca nuk u shpërbë. Ku qëndron enigma?

Nuk ishte vetëm nataliteti i lartë, ndonëse edhe këtë faktor duhet marrë në konsideratë. Pjesa e kosovarëve që tregohej e qëndrueshme kundrejt asimilimit dhe shpërbërjes, bënte jetë tradicionale, pothuajse të pandikuar nga depërtimet bashkëkohore. Në njërin anë, kjo situatë e linte Kosovën të pazhvilluar, me ecje tepër të ngadalshme për rrethanat e reja, por më anë tjetër po atë Kosovë e bënte

rezistuese kundrejt trysnive të fuqishme, qofshin ato të menduara e të planifikuara, qofshin ato spontane, që i sillte koha. Nuk ishte favorshme një situatë e këtillë për Kosovën, që substanca e saj të ruhej përmes formave të jetës tradicionale, shpesh të prapambetur. Fundja, kjo nuk ishte një zgjedhje që e kishte bërë ajo. Ishte një situatë negative, që në mënyrë paradoksale favorizonte kompaktësinë etnike të elementit shqiptar, kudo që gjendej ai në hapësirat e Jugosllavisë. Këtë rrugë të mosnënshtrimit e zgjodhi pjesa dërmuese e popullsisë kosovare. Ata jetonin keq, bënë jetë të mbyllur, jetonin në bashkësi të mëdha familjare, lindnin shumë fëmijë, zhvillonin një ekonomi ekstenzive të mbështetur në bujqësi dhe blegtori, komunikonin pak me jetën urbane, shitnin gjëra të pakta dhe blinin gjëra të pakta. Por ato bashkësi kishin një gjë të mirë: ishin të ndërtuara asisoj, që e bënë pothuajse të pamundur depërtimin e ideologjisë komuniste, krahas ideve të jugosllavizmës dhe të mënyrës së jetës sllave.

Depërtimin e parë në këtë bashkësi të *konseroative dhe tradicionale* e bëri shkolla në gjuhën shqipe. Vetën ajo arriti të luhaste brenda kësaj bashkësie pozicionin shumë të fuqishëm të fesë dhe të zakoneve kanunore. Çuditërisht ajo ishte e pranueshme dhe e besueshme, sepse vinte në gjuhën shqipe, e kuptueshme dhe sugjестive, e afërt dhe imponuese. Vetëm shkollës shqipe Kosova tradicionale dhe konservative iu dorëzua pa kushte. Ndonëse me probleme dhe mungesa të mëdha, ajo u zhvillua shpejt, u masivizua dhe, në ndonjë segment, arriti të bëhej edhe cilësore. Komunistët, as shqiptarë e as jugosllavë, nuk mund ta ndalnin këtë arsimim të shpejtë të Kosovës, jo vetëm pse një veprim i tillë do të shkonte kundër rrjedhës, por më shumë për faktin se përmes saj, pra përmes shkollës synonin të thyenin kompaktësinë e traditës kosovare, të ndryshonin

mentalitetin kosovar dhe ta konvertonin atë në një lëndë nëse jo të përdorshme, atëherë gjithsesi të parrezikshme për Jugosllavinë. Unë nuk them se në këtë pikë sistemi jugosllav nuk arriti të bënte asgjë në Kosovë. Vitet e autonomisë, përveç që avancuan Kosovën në shumë drejtime, kishin edhe një shkallë të lartë rrezikshmërie, sepse përmes arsimimit të integruar jugosllav, krahas rritjes së ndjeshme të numrit të kosovarëve me identitet të qëndrueshëm dhe stabël, rriten ndjeshëm edhe kontingjentin e shqiptarëve jugosllavë, të cilët, që të ndiheshin si të tillë, kishin mbështetjen e fuqishme të institucioneve, të partisë dhe të shtetit. Natyrisht që atyre iu besohet qeverisja e Kosovës, por nga poshtë, terrenin fillojnë ta fitojnë kosovarët e një lloji tjetër, me arsimim dhe formim kombëtar, pak nacionalistë, pak folklorikë dhe pak marksistë-leninistë, por të tillë që gradualisht e fituan betejën me kontingjentin e *integralistëve jugosllavë*. Në vitin 1981 ndodhi beteja finale, kur kosovarët e fituan luftën kundër të gjithë projekteve dhe elaboreteve, kundër të gjitha joshjeve dhe trysnive, kundër dilemave të veta dhe konfuzionit në të cilin kishin jetuar për një kohë relativisht të gjatë.

Por, që të arrihej deri në këtë pikë, *beteja identitare* në Kosovë ishte zhvilluar e ashpër. Së paku deri në vitin 1968, Kosova kishte një identitet të ndrydhur, të heshtur, nga një trysni që nuk lejon mundësi identifikimi. Kosovarët ishin të privuar nga identiteti edhe për një arsye tjetër: nuk kishin potencial të brendshëm të shpërthenin *murin e heshtjes*, prapa të cilit qëndronin të paformësuar, të paartikular. Jugosllavizma i joshte dhe i kërcënonte njëkohësisht. Por shumica syresh ishin hezitues. Bartnin me vete një trashëgimi të rëndë, një kujtesë negative. Mbi shumë varre dheu nuk ishte terur ende. Të tjerët, ata që bartin trashëgiminë e LNÇ-së dhe të ndërtimit të "pushtetit

populluer", ishin sinonim i kushteve të avancuara të jetës, i prishjes së strukturës tradicionale të shoqërisë, i ndërtimit të normave të reja etike dhe shoqërore, por të gjitha këto të amputuara panatyrshëm në jetën kosovare, ose të paguara me çmimin e rëndë të tradhtisë. Shqiptarët jugosllavë ishin komunistë dhe, të ishe komunist, për pikëpamjet e shumicës së kosovarëve tradicionalë, donte të thoshte të ishe sllav, të ishe serb, ose shumë i afërt me këtë proveniencë.

Vetëm depërtimi i mëvonshëm i ideologjisë marksiste-leniniste nga Shqipëria do ta ndryshojë deri diku këtë përfytyrim që kishin kosovarët tradicionalë për komunizmin. Në të vërtetë, ata me këtë rast bënë një kompromis të pashembullt: E pranuan në njëfarë dore komunizmin e urryer për hir të Shqipërisë. Sepse, në ato vite te hershme, të ishe komunist në Kosovë donte të thoshte të ishte polic, të ishe spiun, të ishe pushtet, të ishe i pafe, të ishe rrënues i normave etike. Me kohë natyrisht që ndryshon ky imazh i komunistëve, veçmas në periudhën e autonomisë, atëherë kur në Jugosllavi bëhet liberalizimi edhe i organizatave partiake, por edhe i konceptit ideologjik të doktrinës. Për më tepër, në periudhën e autonomisë bëhet një masivizim pothuajse i panatyrshëm i LKJ-së në Kosovë, për shkak të një ideje utilitare, që konsistonte në një dualizëm tepër kontradiktor: Partia mendonte se duke masivizuar organizatën në Kosovë, do të shtrinte ndikimin e saj në të gjitha porët e jetës, edhe atje ku nuk kishte arritur të depërtonte asnjëherë, ndërkohë që një pjesë e mirë e kosovarëve kultivuan idenë se me aderimin masiv në LKJ krijonin rrethana të favorshme që partinë ta përdornin për interesat e tyre madhore. Ishte njëloj gare në një lojë të dyfishtë, se kush do t'ia dilte të ngadhënjente mbi tjetrin.

Varshmëria identitare e Kosovës

Nga historiografia jonë nuk mund të kuptohet, nëse ndonjëherë është zhvilluar farë gare ndërmjet hapësirave të ndryshme shqiptare, për të marrë primatin e *shqiptarizmit* ose të *shqiptarisë*. Para se të bëhej Shqipëria, nuk kishte as shenja të ndonjë konflikti veri-jug, ose diçka e tillë. Madje mund të thuhet se edhe lufta për pushtet në Shqipëri, pas vitit 1924, arrin të stabilizohet ndjeshëm dhe dy herë radhazi bëhet ndërrimi i pushtetit veri-jug, jo mbi baza rajonale, fetare ose dialektore, por mbi baza të tjera. Nuk kam parë të jetë shkruar diku se pushteti i Zogut ishte i urryer, për shkak se ai ishte verior, ose diçka e tillë. Mund të jetë thënë se ai vendosi në pushtet një bandë bashibozukësh të paarsimuar, me të cilët edhe ai vetë tallej sa herë që i vinte rasti. Madje, çuditërisht nuk kam parë të jetë shkruar diku as ndonjë ankesë, përse Zogu aplikoi në administratën qendrore gegërishten, siç u dëgjuan më vonë ankesa për aplikimin e toskërishtes. Ose, nuk u tha gjëkund se Noli e rrëzoi Zogun përkohësisht nga pushteti, sepse njëri ishte gegë dhe tjetri ishte toskë. Në atë tentativë për marrje pushteti, Zogu më shumë pat kundërshtarë nga veriu sesa nga jugu. Po kjo, në njëfarë mënyre, mund të thuhet edhe për komunistët, të cilët nuk u mbështetën nga njëra palë pse ishin toskë, ndërsa u kundërshtuan nga pala tjetër sepse nuk ishin gegë. Tjetër është se Enver Hoxha spekuloi me origjinën e vet jugore dhe ndarjen dialektore e ktheu në instrument të ushtrimit dhe të mbajtjes së pushtetit.

Në një plan më të gjerë gjithëshqiptar, aspiratat për të marrë rol prijës në botën shqiptare, edhe nëse kanë ekzistuar ndonjëherë, ato kanë pushuar me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Tashmë e kemi thënë se Kosova më 1878 dhe më 1912, pra dy herë radhazi, e kishte dëshmuar se *nuk kishte*

potencial shtetformues, për shkak të tri rrethanave të pafavorshme: e para, sepse kishte një *luhatje identitare*, që ishte faktor limitues për ta çuar deri në fund çdo projekt kombëtar; e dyta, sepse nuk kishte krijuar një *elitë kombëtare*, as politike, as kulturore, madje as ekonomike (kishte bejlerë turkoshakë, të mykur në konservatorizmin e tyre); dhe, e treta, sepse Kosova ishte *hapësirë mitologjike serbe* dhe kjo mitologji (në pazaret e fuqive të mëdha, me fillimin e depërtimit të interesave ruse në Ballkan) arriti të ngadhënjente mbi realitetin shqiptar të paidnetifikueshëm aq qartë. Në këto rrethana, veçmas pas vitit 1912, Kosova tërhiqet përfundimisht nga ideja (nëse një të tillë e ka pasur ndonjëherë) e marrjes së rolit prijës në botën shqiptare. Për këtë kanë qenë të vetëdijsëm edhe liderët kosovarë të asaj kohe, si Hasan Prishtina e Isa Boletini dhe Bajram Curri, të cilët ndjekin logjikën e bashkëngjitjes së Kosovës me Shqipërinë dhe jo të krijimit të një Shqipërie tjetër lloji, me epiqendër të zhvendosur. Ata bëhen të vetëdijsëm se Kosova nuk ka potencial identitar për të marrë rol *prijës*, por ka potencial për të marrë rol *bashkëngjites*.

Degradimi identitar i Kosovës vazhdon të thellohet dhe bëhet jashtëzakonisht i rëndë pas vitit 1912, veçmas pas Luftës së Parë Botërore, deri në vitin 1941. Gjatë kësaj periudhe Shqipëria për Kosovën është një vend ku mund të shpëtohet koka, më vonë një vend ku mund të merret pak shkollë, por jo aq shumë edhe një vend që ëndërrohet prej kosovarëve. Një numër i vogël kosovarësh të zhvendosur në Shqipëri përpiqen të mbajnë gjallë idenë e bashkimit kombëtar, ose të çlirimit të Kosovës dhe të bashkimit të saj me Shqipërinë. Vetë kosovarët, brenda Kosovës, pasi përjetojnë një terror të paparë nga mbretëria Jugosllave me dominim serb dhe pasi dështojnë të ndryshojnë diçka me kryengritjet e njëpasnjëshme, duke e njohur pamundësinë

apo edhe mosdashjen e Shqipërisë për t'i ndihmuar në çfarëdo forme, fillojnë të gjejnë rrugët e shpëtimit. Në këtë periudhë substanca shqiptare pëson erozion të madh dhe merr goditje të pariparueshme. Përveç shpërnguljeve, ndodh edhe konvertimi në turq në qendrat urbane të Kosovës dhe të Maqedonisë, në boshnjakë në zonat e Ulqinit, Tivarit, Plavës, Gucisë, Peshterit dhe Pazarit të Ri, si dhe një shndërrim i pandreqshëm i ortodoksëve shqiptarë të Maqedonisë në maqedonas dhe i një numri të kufizuar i katolikëve gjithashtu shqiptarë në sllavë të të gjitha kombësive, por më së shumti në kroatë.

Ndërkohë, situata ndryshon rrënjësisht në vitin 1941. Shqiptarët janë të lirë, madje janë aq të lirë sa që një numër syresh mund të kthehen serish në identitet. Apo janë aq të lirë, sa që pa ndonjë ndëshkim mund t'i dëbojnë një numër të kolonistëve dhe t'i kthejnë tokat që ua kishin marrë ata, mund t'i vrasin disa syresh, por çuditërisht janë të kujdesshëm ndaj banorëve të vjetër serbë të Kosovës, të cilët nuk hezitojnë t'i marrin në mbrojtje. Për Kosovën tani Shqipëria është çdo gjë, është anë e horizontit prej nga vjen liria, është ndjenjë e lehtësimit, është këndellje, është ringjallje e ndjenjave më të fshehta të patriotizmit të struktur nën njëmijë trysni. Shqipëria është abetare me shkronja shqip, është mësues që flet dhe të mëson shqip, është ofiqar që shkruan emrat shqip, është administratë që t'i kthen tapitë e tokave të grabitura nga kolonët serbë. Realisht, në katër vjetët e Luftës së Dytë Botërore u vendos varshmëria përfundimtare e Kosovës nga Shqipëria. Për tridhjetë vitet e shkuara, Kosova nën mbretërinë jugosllave kishte degraduar shumë, ndërsa Shqipëria e pavarur kishte avancuar së tepërmi. Pra, ishte krijuar një shpërpjestim raportesh që nuk mund të kompensohej, as të tejkalohet. Shqipëria tani kishte elitë kombëtare, arsimore, kulturore,

përgjithësisht intelektuale, kishte edhe aristokraci, sado të vogël dhe sado të kufizuar, kishte shtresë të lartë shoqërore dhe infrastrukturë kulturore. Në vitet e indipendencës shqiptarët e Shqipërisë i kishte mësuar Konica si të vishej fraku, një numër i madh syresh kishin parë botë dhe kishin marrë arsim të avancuar perëndimor; gratë mbanin kapele si në revistat e modës dhe dikur bënë edhe një mbretëreshë që organizonte ballo dhe pritje të shoqërisë së lartë. Shqipëria kishte mësuar sjellje me etiketë, kishte mësuar kulturë dhe tolerancë fetare.

Po në Kosovë? Asgjë nga këto. Kosovarët kishin një dëshirë të papërmbajtur që të bëheshin si Shqipëria. Ishin vitet e luftës dhe të Shqipërisë unike, që i bënë kosovarët të shihnin se Shqipëria përfundimisht kishte marrë *atributin e referencës* së tyre kombëtare dhe identitare. Më pas, vitet 1945-1948, u kaluan në konfuzion të madh. Shqipëria u gjend nën trysni të jashtëzakonshme politike dhe ekonomike, që të pranonte vasalitetin kundrejt Jugosllavisë, madje edhe përfshirjen në të njëjtin shtet. Kosova nuk e donte këtë. Nuk e donte as qëndrimin *internacionalist* të udhëheqjes politike të Shqipërisë kundrejt Jugosllavisë dhe çështjes së Kosovës. Donte një qëndrim të qartë të udhëheqjes politike të Shqipërisë: bashkim të Kosovës me Shqipërinë dhe asgjë tjetër. Komunistët kosovarë tashmë e kishin marrë vendimin në Prizren që kjo të mos ndodhte. Ata kishin vendosur që Kosova t'i bashkohej Serbisë. Populli e kundërshtoi këtë në mënyrë kategorike dhe kërkoi që në këtë synim të mbështetej nga Shqipëria. Shqipëria bënte të paditurin dhe luante në kartën ideologjike: Këta janë reaksionarë! Kosova është reaksionare! Kosovarët u irrituan nga ky qëndrim i Shqipërisë dhe i thanë njëri-tjetrit: Na tradhatoi Shqipëria!

Konfigurimi i brendshëm

Ishte ky largimi i parë shpirtëror i Kosovës nga Shqipëria, pas disa vitesh të lidhjes së afërt. Natyrisht që komunistëve kosovarë iu pëlqeu kjo situatë e krijuar dhe u ngutën ta thellonin edhe më shumë ndarjen e brendshme kosovare: më një anë nacionalizmi dhe reaksioni; më anë tjetër “forcat progresive”, komunistët, spiunët jugosllavë, tradhtarët. Ky ishte konfigurimi i brendshëm i Kosovës. Ndarja ishte e thellë dhe e papajtueshme. Ajo do të vazhdojë përgjatë krejt periudhës së pastajme dhe do të oscilojë në varshmëri nga situata e krijuara në Kosovë dhe nga shkalla e besimit që kishin kosovarët ndaj udhëheqjes komuniste. Deri më 1966 kosovarët nuk u besonin komunistëve dhe as komunistët kosovarë nuk i besonin popullit të vet. Komunistët kosovarë e ushtronin pushtetin e tyre përmes dhunës ushtarake dhe policore, duke kërkuar te populli jo mbështetje normale, por kolaboracionistë. Kosovarët e indinjuar dhe të mllefosur e refuzuan komunizmin jugosllav, por gradualisht filluan të binin në grackën e komunizmit shqiptar. Ishte Shqipëria ajo që filloi të funksiononte. Ajo filloi t’i tërhiqte pas vetes kosovarët, kryesisht me propagandë. Pas mospajtimit të thellë ndërmjet kosovarëve dhe Shqipërisë rreth Jugosllavisë, tani midis tyre krijohet një pakt i heshtur: që të dy palët urrejnë Jugosllavinë. Nacionalistët kosovarë marrin satisfaksionin e munguar: Shqipëria më në fund e shpall Jugosllavinë *armik ideologjik, politik dhe nacional*. Kjo iu leverdis nacionalistëve kosovarë, madje politikën e Shqipërisë, pavarësisht se është e veshur me njëmijë e një marrëzi ideologjike, e përvetësojnë si program të veprimtarisë së tyre, edhe të ngritjes ideologjike, edhe të punës politike, edhe të organizimit ilegal.

Pra, deri në vitin 1966, Shqipëria ka avantazhe të mëdha në Kosovë, madje funksionon pa konkurrencë, por megjithatë nuk e ka me vete shumicën e popullit, sepse kosovarët ende e kanë të freskët tradhtinë e viteve të pasluftës, një masë e madhe e njerëzve janë analfabetë, komunikimi me Shqipërinë mbështetet kryesisht te Radio-Tirana (më vonë te Radio-Kukësi) dhe ajo, pra Shqipëria, nuk mund t'i manifestojë të gjitha avantazhet që i ka kundrejt Kosovës, sepse propaganda e saj perceptohet vetëm në një dimension, në atë tonik, jo vizual. Por, më anë tjetër, imazhi tonik i Shqipërisë, përmes Radio-Tiranës, është një indikator i mjaftueshëm për të krijuar *ëndrrën kosovare për Shqipërinë* ideale. Një imazh më i plotë i Shqipërisë do të nxirrte në sipërfaqe mungesa dhe mangësi të mëdha. Imazhi i reduktuar është më funksional dhe më i efektshëm për përfytyrimin e idealizuar. Shqipëria funksionon në Kosovë pikërisht përmes këtij imazhi të reduktuar dhe selektiv.

Plenumi i Brioneve e ndryshon situatën, e bën më të komplikuar, më të vështirë për nacionalistët shqiptarë të Kosovës, njësoj edhe për Shqipërinë. Por krijon edhe disa avantazhe. Tani në konkurrencë u futën edhe *shqiptarët jugosllavë*, komunistët shqiptarë të Kosovës dhe mbështetësit e tyre. Plenumi i Brioneve nuk u mbajt për shkak të Kosovës dhe Kosovën as që e kishte në rend të ditës. Ishte një ndeshje e Titos me bashkëpunëtorët e tij të afërt rreth pushtetit, të balancave të brendshme jugosllave, por që u kamuflua si ndeshje e koncepteve të ndryshme të qeverisjes. Komunistët kosovarë përfituan nga kjo situatë, sepse, duke bërë ca ndryshime të rëndësishme, bënë për vete numër më të madh ithtarësh dhe mbështetësish. E favorshme iu doli edhe gjetja e një fajtori sipëror, ndaj të cilit ata gjoja kishin qenë të pafuqishëm, siç ishte UDB-ja, që thuhej se kishte kontrolluar pushtetin e të gjitha niveleve në Jugosllavi. Kaq iu desh

komunistëve kosovarë që të arsyetonin çdo gjë që kishte ndodhur dhe çdo gjë që kishte shkuar keq në Kosovë. Ata nuk i dhanë kujt llogari se edhe vetë, shumica syresh, kishin qenë pjesë e strukturave të UDB-së, kishin qenë vetë UDB-ja. Situatën e tejkaluan pa ndonjë traumë të madhe, madje, si gjithmonë, duke u rigjeneruar shpejt dhe duke mos prekur levat kryesore të pushtetit.

Pra, për kosovarët e të dy krahëve u krijuan disa avantazhe, por gjithsesi përfitimin më të shpejtë dhe më të drejtpërdrejtë e patën *shqiptarët jugosllavë*. Me dënimin verbal që iu bë akteve të dhunshme të UDB-së, përfshirë edhe veprimet shoviniste dhe gjenocidale ndaj kosovarëve, sikundër edhe me liberalizimin e jetës dhe me avancimin e disa proceseve, ata e zgjeruan ndikimin e tyre të masat e gjëra të popullit. Njerëzit sikur filluan të luhateshin. Një pjesë e tyre u vu në pozitë të zgjedhjes së domosdoshme: ose *Jugosllavi reale*, me të gjitha favoret jo të pakta që i krijonte ajo, ose *Shqipëri ideale* dhe iluzore, me të gjitha rreziqet dhe të panjohurat që i shkonin pas. Kjo ndeshje nuk ishte e lehtë. Kjo nuk ishte dilemë teorike, ishte rrethanë jetësore. Nuk vendosje këtu nëse në shqyrtimet teorike neutrale do t'i mbaje më shumë krah Buharinit, Troçkit, Stalinit, apo titizmit revizionist, apo marksizëm-leninizmit enverist. Vendosje për jetën tënde dhe të familjes, për të ardhmen e fëmijëve, për kafshatën e gojës, për shkollimin e tyre, për shumë gjëra të këtilla. Kosova kishte vuajtur shumë dhe nuk e kishte të lehtë ta refuzonte *ofertën*, të cilën në njëfarë mënyre po ia bënte Jugosllavia. Ajo i ofronte zhvillim, arsimim, prosperitet, brenda mundësive dhe rrethanave, ndërsa prej Kosovës kërkonte besnikëri dhe lojalitet. Një serb ose një kroat mund t'i shfrytëzonte të gjitha privilegjet e socializmit liberal jugosllav edhe pa qenë mirënjohës dhe pa dëshmuar lojalitet, sepse Jugosllavia ishte e drejta e tij

natyrore. Për kosovarët kjo nuk vlente. Për ta Jugosllavia liberale dhe e shanseve për jetë të dinjitetshme kërkonte si kundërvlerë lojalitetin e padiskutueshëm.

Kur ta shikosh situatën në një kontekst më të gjerë, kjo kërkesë nuk nënkuptonte ndonjë sakrificë të madhe për kosovarët. Popujt joslavë të Bashkimit Sovjetik, sipas modelit të të cilit ishte ndërtuar në fillim Jugosllavia socialiste, kishin qenë të detyruar të bënin shumë më tepër sakrifica se shqiptarët dhe pakicat e tjera në Jugosllavi dhe, si kompensim, të fitonin shfarosjen në vazhdimësi, atë që realisht kishin përjetuar kosovarët deri më 1966. Tani oferta kishte tjetër përmbajtje: mund ta ruaje identitetin, mund ta kultivoje atë, mund të zhvilloje arsim dhe kulturë, por të gjitha këto brenda një kornize të përcaktuar qartë: Jugosllavinë nuk mund ta prekje, as rregullimin e saj shoqëror, as ideologjinë, as fetishet e saj. Madje të ofronin edhe një privilegj tjetër: në bashkësinë jugosllave nuk do të quheshe me emër pezhorativ, por po me atë emër që quhen të gjithë shqiptarët. Edhe gjuhën mund ta shkruaje me alfabetin tënd, dhe jo si disa popuj joslavë të Bashkimit Sovjetik; edhe libra mund të lexoje në gjuhën tënde; edhe në punë të shkollës mund të avancoje; por nuk mund të bëheshe krejt i barabartë me të tjerët, sepse ti kishe një shtet diku matanë, ndërsa Jugosllavia ishte bashkësi e kombeve që nuk kishin shtet tjetër.

Afërsisht këto ishin kushtet e lojalitetit, që kosovarët i akceptuan në fazën e hershme të autonomisë, në periudhën 1966-1974. Në këtë rrethanë, t'i refuzoje këto mundësi do të dukej marrëzi. Por edhe të zgjedhje rrugën e zhbërjes, do të ishte një sakrificë që nuk ia vlente. Prandaj në Kosovë u krijua një *identitet i dyfishtë*, i cili mbështetej mbi një moral të dyfishtë, ose, thënë më mirë, mbi një rrethanë dualiste: duhej t'i shfrytëzoje të gjitha mundësitë që t'i krijonte

Jugosllavia, jashtësisht dhe formalisht të ishte qytetar luajal i saj, ndërsa më anë tjetër të doje Shqipërinë, të punoje për interesat e tua kombëtare, aty ku kishe alternativë, të zgjidhje atë që shkonte në të mirë të kombit tënd, të kishe ideal të largët një Kosovë të bashkuar me Shqipërinë etj. Kjo ishte *vetëdija ilegale* e një mase të madhe të shqiptarëve të Kosovës, që nga Lufta e Dytë Botërore e prapa. Nacionalistëve kosovarë, pavarësisht se ishin kritikues të ashpër të të gjitha praktikave kombëtare, politike, sociale, ekonomike, arsimore, kulturore që zbatoheshin në Kosovë, u shkonin përshtat avancimet autonomiste dhe përmirësimi i pozitës kushtetuese të Kosovës në Jugosllavi, veçmas në ato segmente ku ky avancim prodhonte efekte të drejtpërdrejta zhvillimore, si në arsim dhe kulturë, sepse nacionalizmi kosovar mbështetjen më të madhe e llogariste në kontingjentet që kishin arritur të shkëputeshin nga injoranca, nga prapambetja dhe nga konservativizmi fetar.

Pra, në fund të viteve '60 dhe më tej, kosovarët zbuluan se paralelisht mund të ishte edhe jugosllavë korrektë, edhe nacionalist shqiptar të respektueshëm dhe kjo bashkëjetesë e këtyre dy kundërshtive ishte e mundshme, sepse të qenit nacionalist shqiptar në atë periudhë domosdoshmërisht nuk kërkonte veprim, nuk kërkonte realizim praktik të ndonjë programi politik, madje as përkufizimin e tij. Ata kosovarë që nacionalizmin shqiptar e kthenin në program politik dhe që bënin çfarëdo veprimesh për ta realizuar atë në ndonjë formë praktike, përfundonin në burg dhe dënoheshin në mënyrë shembullore. Të tjerët vazhdonin ta jetonin *nacionalizmin* e tyre *shtëpiak*, familjar, të brendshëm, klandestin, pa rënë në kolizion me shtetin dhe institucionet e tij. Por kjo gjendje nuk mund të qëndronte pezull përgjithmonë, sepse të dy palët bënin garë që të fitonin terren: nacionalizmi shqiptar që t'i bënte sa më të zëshëm

mbështetësit e vet, ndërsa jugosllavizma që të tërhiqte në anën e saj sa më shumë mbështetës dhe t'i neutralizonte të gjitha format e nacionalizmit shqiptar, përfshirë edhe atë klandestin.

NACIONALIZMI SHQIPTAR NË KOSOVË

Lojaliteti jugosllav

Në konfigurimin e reliefit politik të Kosovës duhet bërë një përkufizim më të qartë të rolit të përbërësve kryesorë të identitetit kosovar. Komunistët, ata që kishin marrë pjesë në LNÇ, që kishin bërë organizimin partiak në Kosovë dhe që Kosovën e kishin lidhë pashkëputshëm me Jugosllavinë, në pikëpamje teorike, deri me shfaqjen e Mahmut Bakallit në skenën politike, nuk ishin në gjendje të shqyrtonin në mënyrë të qëndrueshme asnjë segment të zhvillimeve politike në Kosovë. Madje as t'i kuptonin ato. Ata ishin zbatues besnikë të politikave që përcaktoheshin në nivelin e Serbisë ose të Jugosllavisë, në Kosovë e ushtronin pushtetin në formë të padiskutueshme, bënë jetë të mbyllur, përfitonin aq sa mund të përfitohej në ato rrethana, qarkullonin sa më shpesh që mundeshin në relacionin Prishtinë-Beograd, kishin nga një dashnore serbe ose ishin frekuentues të rregullt të shtëpive publike gjysmë legale. Më anë tjetër, brenda klanit ushtronin konkurrencën dhe xhelozinë, ndërsa në raport me qarqet publike shfaqeshin unikë, të papërçarë. Tregoheshin të kujdesshëm kundrejt kuadrove të reja, të cilat i rekrutonin përmes strukturave të partisë, të lidhura ngushtë me UDB-në dhe spiunët e saj.

Pavarësisht se me kohë ndodhi njëlloj demokratizimi i jetës politike në Kosovë, ashtu sikundër ishte trendi në

mbarë Jugosllavinë, klani qeverisës për shumë vite arriti të ruante strukturë pothuajse të pandryshuar, me një shtrirje horizontale tepër të kufizuar, më të kufizuar së të gjitha hapësirat e tjera të ish-Jugosllavisë. Arsyet pse ndodhi kështu ishin të shumta, por më e besueshme është vështirësia e rekrutimit të kuadrove të reja, për shkak të kriterëve rigoroze që aplikoheshin në Kosovë, respektivisht të një mosbesimi të përgjithshëm për shqiptarët në Jugosllavinë e atëherëshme. Pavarësisht se mund të ishin tepër të devotshëm në kryerjen e shërbimeve ndaj shtetit jugosllav, siç e kemi thënë, shqiptarët duhej ta verifikonin rregullisht lojalitetin e tyre. Prandaj në Kosovë klani i pushtetarëve mbeti i kufizuar dhe nuk arriti të përfshinte brenda vetes struktura më të gjëra të shoqërisë, më shumë intelektualë, më shumë profesorë universiteti, më shumë gazetarë, në shumë mjekë, më shumë inxhinierë, më shumë ekonomistë, juristë, më shumë krijues të fushave të ndryshme. Klani i pushtetarëve në Kosovë, sipas shembullit të vet, u mjaftua të krijonte *rrathë luajalësh* gjithandej Kosovës, por nuk u tregua i gatshëm të hapte dyert e institucioneve dhe të organeve të pushtetit për shumë prurje të reja. Prandaj, edhe përkundër ushtrimit të gjatë të pushtetit, edhe përkundër favoreve që u bëheshin, klasa e pushtetarëve në Kosovë, me gjithë trashëgimtarët dhe mbështetësit e tyre të të gjitha niveleve, nuk besoj se arriti të përfshinte më shumë se 5% të popullsisë.

Po t'i shihje më nga afër, dilte se edhe kjo klasë luajalësh kishte diferenca dhe çarje të brendshme dhe, sikundër e thamë, shfaqeshin unikë vetëm kur ishin të kërcënuar nga jashtë. Kështu, diferenca të dukshme kishte ndërmjet vetë luftëtarëve të LNÇ-së, të cilët tashmë ishin ndarë në dy taborë: në njërën palë që ende mbaheshin shqiptarë dhe përpiqeshin të ruanin njëfarë drejtpeshimi ndërmjet

identitetit shqiptar dhe lojalitetit jugosllav; dhe, në palën tjetër, të cilët ishin të gatshëm të hiqnin dorë ose tashmë kishin hequr dorë nga identiteti në këmbim të lojalitetit. Të parët ishin më të pranueshëm për shqiptarët e Kosovës, sepse kishin familje shqiptare, fëmijë që iu flitnin shqip dhe i kultivonin lidhjet miqësore brenda klanit, ku prania serbo-malazeze nuk ishte aq vendimtare. Kultura dhe mënyra e jetës së tyre qëndronte në një kapërcyell që kurrë nuk kalohej tamam: kishin përvetësuar çdo gjë jugosllave, por ende nuk kishin hequr dorë nga një identitet pasiv shqiptar. Ata ishin plotësisht luajalë ndaj Jugosllavisë, Titos dhe vëllazërim-bashkimit, por meqë ende kishin paraqitje deri diku shqiptare, nuk konsideroheshin krejtësisht të besueshëm nga organet e sigurimit serb, veçmas në situata kritike. Më anë tjetër, konsiderohej se as lidhjet me Kosovën reale nuk i kishin shkëputur tërësisht. Të dytët, ndërkaq, bënë jetë jugosllave plotësisht të integruar, kishin bërë martesë të përziera, nëpër familje flitnin kryesisht serbokroatisht, lidhjet familjare i kultivonin me sllavë dhe vetë kishin filluar ta flitnin keq gjuhën shqipe. Besimi ndaj tyre ishte i madh dhe, në situata kritike, ishin ata që pyeteshin legalisht ose jolegalisht për ndonjë zhvillim specifik në Kosovë. Por, më anë tjetër, të tillët dërgoheshin kryesisht për të ushtruar funksione republikane ose federative, atje ku ushtrimi i pushtetit kishte shumë privilegje, por pak përgjegjësi.

Taborin e tretë e përbënin luajalët e rinj, ata që së fundi, pas një shoshitjeje të gjatë nga partia dhe organet e sigurimit, kishin treguar se mund të ishin të besueshëm për të vazhduar politikën jugosllave në Kosovë. Përveç besueshmërisë, të rekrutuarit në këtë tabor duhej të dëshmonin se, mbi të gjitha, nuk ishin nacionalistë shqiptarë, se kishin respekt për revolucionarët e vjetër dhe

se ambicien e tyre për t'u ngjitur rrugës së karrierës nga prapavija duhej ta mbështeste së paku një kuadër i besueshëm i klanit të vjetër, ose të kishte një lidhje krushqie me të. Për këta burra shkallët e ngritjes në karrierë nuk ishin të lehta, sepse t'i çaje radhët e ngjeshura të revolucionarëve të vjetër ishte një punë shumë e vështirë dhe delikate. Prandaj, nuk ishte aspak e rastit që pas kthesave të mëdha në Kosovë, siç ishin vitet 1968 apo 1981, mënjanimet e para ndodhnin pikërisht nga radhët e luajalistëve të rinj, të cilët, sa herë që shihej e nevojshme, sakrifikoheshin lehtësisht nga "ujqërit" e vjetër, kështu që nuk ishte aspak e rastit që edhe pas dyzet vjet të pushtetit socialist numri i kuadrove që qarkulloheshin në pozita të larta në Kosovë kishte mbetur afërsisht i njëjtë dhe emrat që lakoheshin dilnin krejtësisht të njohur.

Qëndrimi ndaj Shqipërisë

Ishte e ditur dhe krejtësisht normale për rrethanat, se politikën e jashtme të shtetit të atëhershëm jugosllav e bënte Titoja. Por ishte dyfish normale që pikat nevralgjike të politikës së jashtme, siç ishte në këtë rast Shqipëria, me rigorozitet të madh i orientonte dhe i kontrollonte vetë njëshi i shtetit dhe i partisë, pa i lënë asgjë rastësisë. Po përse Shqipëria e izoluar, me reputacion të shkatërruar ndërkombëtar, pa miq dhe pa mbështetje nga asnjëri bllok politiko-ushtarak, ishte kaq e rëndësishme për politikën e jashtme të Jugosllavisë, që atëbotë konsiderohej njëri nga shtetet prestigjioze të botës, miqësinë e së cilës përpiqeshin ta fitonte si Lindja, si Perëndimi...?

Pozicioni i Shqipërisë u bë i rëndësishëm për Jugosllavinë veçanërisht pas prishjes me Bashkimin Sovjetik dhe vazhdoi të ishte po kaq i rëndësishëm pas daljes së saj formale nga Traktati i Varshavës dhe lidhjes miqësore me Kinën. Pozicioni i Jugosllavisë së “painskuadruar” ishte jashtëzakonisht i ndjeshëm në raport me blloqet ushtarako-politike dhe ndërhyrjet e shpeshta të Bashkimit Sovjetik në shtetet e Lindjes ishin bërë tmerr për Titon e miqësuar me Perëndimin, por pa një mbrojtje të drejtpërdrejtë nga asnjë aleancë dhe nga asnjë shtet i veçantë. Jugosllavia i kishte në kufijtë e saj NATO-n dhe Traktatin e Varshavës, dihej se në Jaltë ishte vendosur ndarja e saj, vetëm një raport shumë i balancuar i forcave që ushtronin ndikim mbi Jugosllavinë mund ta ruanin këtë shtet që të mos merrte tatëpjetën e pakthyeshme. Në këtë raport forcash që ushtronin ndikim mbi Jugosllavinë, pozicioni i Shqipërisë ishte tejet i rëndësishëm, sepse Shqipëria kishte brenda shtetit jugosllav një minoritet tepër të madh dhe të papërbalueshëm edhe për Jugosllavinë njëzet milionëshe, veçmas nëse rebelimin e këtij minoriteti e ndihmonte një Shqipëri e kthyer serishmi në përqaftimin e Bashkimit Sovjetik dhe të Traktatit të Varshavës. Titoja e dinte se vetëm një Shqipëri çfarë ishte, e armiqësuar me tërë botën, i shkonte për shtat më së miri politikës së balancave të kujdesshme të Jugosllavisë. Duke bashkëpunuar me Shqipërinë në planin ekonomik dhe tregtar, ai shpresonte të bëhej gradualisht partneri i saj më i rëndësishëm, në mënyrë që ta minimizonte nevojën e Shqipërisë për të pasur pranë një fuqi të madhe botërore. Më anë tjetër, ai e dinte, sepse këtë e kishte provuar edhe më parë, se mënyra më e mirë e *pacifizimit të Kosovës* mund të bëhej përmes Shqipërisë së varur politikisht dhe ekonomikisht. Zgjimi kombëtar shqiptar në Jugosllavi, i cili dukej i paevitueshëm, më së lehti mund të kontrollohej përmes Shqipërisë.

Nga raportet që bënin për Shqipërinë vizitorë të ndryshëm jugosllavë, përfshirë edhe kosovarët, nga fundi i viteve '60, kur filluan qarkullimet e para me Tiranën, interesim më i madh shfaqej rreth asaj, nëse kishte shenja të riafrimit të mundshëm të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, pastaj i bëhej një analizë e rrethanave të brendshme dhe, së fundi, theksi vihej vazhdimisht te gatishmëria e Shqipërisë për të thelluar marrëdhëniet me Jugosllavinë. Një kujdes i jashtëzakonshëm tregohet për fjalimet e Enver Hoxhës, analizoheshin me kujdes nëse aty mund të gjendej ndonjë element i ri, nuk u vihej veshi sharjeve dhe vulgarizmave politike dhe ideologjike, por një analize të hollësishme iu nënshtroheshin paragrafët ku flitej për raportet me fuqitë e mëdha dhe për marrëdhëniet me Jugosllavinë. Kur Enver Hoxha thoshte, ta zëmë, se nëse sulmohet Jugosllavia, Shqipëria përsëri do të luftonte përkrah saj, siç e tha në një rast në Tropojë, këto fjalë barteshin nga një stenogram në tjetrin, nga një analizë në tjetrën dhe interpretoheshin si vullnet i mirë i Shqipërisë për ta rikthyer miqësinë e vjetër me Jugosllavinë.

Të gjithë e dinin në Jugosllavi, përfshirë edhe Titon, se përmes bashkëpunimit kulturor Shqipëria do të eksportonte në Kosovë edhe *romantizëm nacional*, edhe nacionalizëm, edhe ideologji marksiste-leniniste, edhe enverizëm, edhe spiunazh, pra të gjitha që ajo i kishte të mjaftueshme ose me tepri. Çmimi që duhej të paguante Jugosllavia, për t'iu kundërvënë kësaj makinerie funksionale të Shqipërisë, ishte shumë i madh. Por për këtë ishte përpunuar një strategji, e cila në asnjë rrethanë nuk duhej të dështonte. Që më përpara, përmes formave të ndryshme të joshjes dhe të shantazhit, Jugosllavia, para se të bënte çdo gjë tjetër në Kosovë, kishte rekrutuar bashkëpunëtorë të shumtë të UDB-së. Nuk është e tepërt të thuhet se të tillë kishte shumë në

Kosovë, qoftë për shkak se Kosova, krahas traditave pozitive, të tilla që pothuajse nuk i gjeje askund tjetër, kishte edhe traditën e gjatë të nënshtimit ndaj pushtuesve, respektivisht të qenit në shërbim dhe shërbëtor, pra edhe spiun. Në vitet '50 dhe '60, por edhe më vonë, rekrutimi nga UDB-ja ishte masiv, qoftë përmes parasë, përmes privilegjeve, përmes punësimit, përmes shkollimit; qoftë edhe përmes kërcënimeve, siç ishte ndonjë njollë në biografinë personale, të prindërve, të farefisit, ose edhe të njerëzve me të cilët mund të kishte kontakte sporadike. Pra, të gjitha mekanizmat ishin vënë në veprim, por duket se më së miri funksiononte paraja, ngase Kosova, në përgjithësi, kishte një gjendje të rëndë ekonomike dhe ngase mercenarizmi, sikundër e thamë, është një traditë gjithëshqiptare e kultivuar dhe e ushtruar për një kohë të gjatë.

Siç u zbulua pas vitit 1981, Jugosllavia, në raport me Shqipërinë, kishte bërë përgatitje që edhe një herë, si në vitin 1941 me themelimin dhe diktatin ndaj PKSH-së, pothuajse të njëjtën gjë ta bënte me një depërtim të fuqishëm në liberalizimin e jetës politike në vend, duke ndryshuar sistemin, duke nxitur lëvizje politike, duke rekrutuar njerëz etj. Për këtë kishte pasur një plan, i cili tërthorazi u zbulua pas atyre ngjarjeve. Ata që kishin "dizajnuar" bashkëpunimin kulturor Kosovë-Shqipëri, nuk ngurruan të thoshin botërisht se kishin pritur jo shpërthimin dhe destabilizimin e Kosovës, por të kundërtën, atë të Shqipërisë, sepse, sipas mendjes se tyre, efektet e bashkëpunimit disavjeçar duhej të reflektoheshin pikërisht në rënien e sistemit në Shqipëri. Ata kishin qenë të bindur se sistemi jugosllav ishte superior ndaj atij të Shqipërisë, se njerëzit edhe në Kosovën e prapambetur jetonin shumë më mirë se në Shqipëri, se qarkullimi i shpeshtë i njerëzve të

estradës, të artit, të arsimit, të shkencës, përzier në shumë raste me spiunë dhe provokatorë ordinerë, herë do kur do të krijonte efekte të rebelimit dhe të rënies së pushtetit të Enver Hoxhës. Pra, Jugosllavia edhe një herë ëndërronte që Shqipërinë ta mbërthente fuqishëm pas vetes.

Në kuadër të këtyre raporteve gati të çmendura ndërshtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Kosova u gjend në mes, e pafuqishme të përvetësonte vetëm njërën apo të refuzonte vetëm tjetrën anë. Vetë *konstalacioni politik* i kosovarëve ishte tepër i ngatërruar. Elita politike e Kosovës e urrente Shqipërinë, sa për shkak të Enver Hoxhës që e kishte shkruar vetë historinë e LNÇ-së dhe i kishte nxjerrë në sipërfaqe shumë gjëra të pakëndshme që kishin të bënin me Kosovën, sa për shkak të propagandës së fuqishme që distribuonte Tirana, në të cilën udhëheqja e Kosovës quhej e shitur dhe tradhtarë. Ndërkaq, kjo elitë politike kosovare aspak nuk ishte kreative e politikës jugosllave ndaj Shqipërisë. Atë politikë e bënte Titoja me bashkëpunëtorët e tij të ngushtë në Beograd, ku kosovarët nuk bënin pjesë. Elita politike kosovare dukej se e kishte të ndaluar edhe të fliste publikisht për Shqipërinë. Vetëm në mbledhje të mbyllura ajo shprehej lirshëm dhe shfrynte, në dukje të parë kundër Enver Hoxhës, por në të vërtetë shante Shqipërinë në tërësinë e saj. Aty ku kishte mundësi dhe ku nuk binte në kolizion të drejtpërdrejtë me politikën qendrore, po t'i vinte rasti, kjo elitë politike e Kosovës persekutonte pa mëshirë këdo që mund ta gjente të dyshimtë në lidhje me Shqipërinë, duke hapur procese hetimi edhe për ata që dëgjonin Radio-Tiranën. Për të zhvilluar një luftë të ashpër kundër nacionalizmit shqiptar, klasa politike e Kosovës nuk ishte e motivuar dhe e nxitur vetëm nga qendra. Ajo shpesh i tejkalohte udhëzimet që merrte, duke e bërë luftën politike edhe më të ashpër nga ç' duhej të ishte në të vërtetë

Lindja e romantizmit nacional

Më anë tjetër, në Kosovë, përveç opozitës nacionale, e cila konfrontohej drejtpërdrejt me regjimin dhe për këtë arsye burgosej pa mëshirë, ishte krijuar edhe *opozita e heshtur* dhe e fshehtë, e cila jopublikisht kontestonte çdo gjë që thoshte politika zyrtare. Kjo opozitë e heshtur dhe shumë masive ishte tërësisht mosbesuese ndaj pushtetit dhe njerëzve të saj, pavarësisht në bëhej fjalë për zhvillimet politike në Kosovë dhe Jugosllavi, apo për sharjet dhe përçmimin që ia bënin Shqipërisë. Kosovarët ishin gënjer dhe mashtruar për një kohë të gjatë nga Jugosllavia, për çdo gjë, më së shumti për të drejtat e barabarta në kuadër të bashkësisë jugosllave. Ata tashmë kishin përfituar aq dije politike, sa të kuptonin se premtimet që ishin bërë dhe fjalët që thuheshin gjithandej nuk korrespondonin me realitetin. Në një rrethanë të këtillë, kur gënjehej në mënyrë kaq të hapur për realitetin që kosovarët e jetonin dhe e kishin para sysh çdo ditë, përse të mos besohej se shumëfish më shumë gënjehej për Shqipërinë, të cilën ata nuk kishin mundësi ta shihnin? Në të vërtetë, realiteti i Shqipërisë për kosovarët ishte *realitet virtual*, i krijuar me efektet tingullore të Radio-Tiranës, me lajmet e saj, me reportazhet e saj, më vonë me imazhet e kurdisura të Televizionit Shqiptar. Si realitet që nuk jetohej, ai kishte mundësi më të mëdha që të besohej.

Por a kishin zgjedhje tjetër kosovarët, përveç se ta besonin një *Shqipëri-ëndërr*, një Shqipëri imagjinare? Është e vërtetë se Shqipëria, përmes propagandës, i keqpërdori kosovarët, duke ndërtuar në sytë e tyre një shtet krejtësisht të pamundur, aq i përsosur pretendohej se ishte. Por edhe kosovarët, në mënyrën e tyre, e keqpërdorën Shqipërinë, sepse në hapësirën e saj të kufizuar, në pamjen e saj të rrëgjuar, në mundësitë e saj të vogla projektuan të gjitha

mungesat që i kishin tani dhe që i kishin pasur gjatë historisë. Përveç që duhej të ishte një vend ideal në sytë e tyre, Shqipëria duhej të ishte e aftë të bënte luftë për kosovarët, t'i mbronte ata, të kishte armatim superior ndaj Jugosllavisë, të kishte avionë supersonikë, raketa tokë-tokë të largësive të mëdha, armë bërthamore, çdo gjë. Po të mos e besonin këtë Shqipëri imagjinare, çfarë duhej të bënin kosovarët? Cilën alternativë e kishin? Jugosllavinë dhe integrimin në të gjithë përbërësit e saj. Ata tashmë e kishin vërejtur se ky integrim nuk donte të thoshte vetëm lojalitet politik ndaj Jugosllavisë, as vetëm përvetësim dhe miratim i padiskutueshëm i standardeve të saj ideologjike, por edhe humbje e sigurt dhe pakthyeshme e identitetit. Shqiptarët që e përvetësonin pa rezervë integralizmin jugosllav ishin masë që deformoheshin shpejt dhe pasojat bëheshin të dukshme që në hapat e parë. Rrugëve të Prishtinës tashmë nuk e kishte të vështirë të shihje djem të rinj që imitonin "homot" e Beogradit, ose vajza të reja që çmendeshin pas idhujve të estradës jugosllave, sikundër që mund t'i shihje gjithandëj bijtë dhe bijat e gjeneratës së parë të shqiptarëve të integruar, me nëna serbe që flitnin serbisht dhe bënin shkollë serbisht; me nëna boshnjake që flitnin serbisht dhe bënin shkollë serbisht; me nëna maqedone, me nëna hungareze, me nëna kroate, madje me nëna dhe baballarë shqiptarë, që flitnin në familje serbisht dhe bënin shkollë serbisht; apo që nuk flitnin serbisht dhe nuk bënin shkollë serbisht, por që tashmë ishin futur me tërë qenien në spiralen e ndërtimit të *identitetit jugosllav*. Nga shumica e kosovarëve nuk mund të miratohej një rrëshqitje kaq e shpejtë në identitetin jugosllav (në këtë rast serb, sepse identiteti serb participonte më së shumti në identitetin jugosllav dhe shqiptarët me të i krijonin afritë më të mëdha), sepse të shumta ishin plagët e këtyre marrëdhënieve dhe varret vinin radhë-radhë nëpër të gjitha kohët e historisë.

Të rinjtë kosovarë, nxënësit dhe studentët e fundit të viteve '60 dhe të viteve '70, të cilët përbënin potencialin biologjik, botëkuptimor dhe dituror të të gjitha zhvillimeve politike deri në pavarësinë e Kosovës, kishin dy alternativa: ose të shkonin te salla e sotme "1 Tetori" (atëherë "25 Maji") në Prishtinë dhe të dëgjonin ansamblin "Belo dugme"; apo të shkonin në ndonjërin nga auditorët e atëhershëm të Fakultetit Filozofik dhe, të ulur nga dy vetë në një karrige, të dëgjonin ligjëratat e Eqrem Çabejt, Aleks Budës, Shaban Demirajt etj., të cilat vërtet që për shumë syresh ishin të pakuptueshme dhe shkencërisht tepër të lartësuar, aty-këtu edhe nacional-romantike gjithsesi, por së paku ishin të tilla që *thërrisnin në identitet* përmes dijes dhe shkencës. Kishte edhe nga ata, doemos, që mund të ishin të pranishëm edhe në koncert, edhe në ligjëratat e profesorëve të Shqipërisë, por të tillët, të dyzuar dhe të papërcaktuar, filluan të bëheshin gjithnjë e më të paktë.

Duke mos mundur dhe duke mos qenë e interesuar që vetë të krijonte identitet të ndarë, e lidhur fort pas Shqipërisë, Kosova u bë *nacional-romantike* për një kohë tepër të shkurtër. Predispozitat për këtë i kishte të mjaftueshme: Kosova ishte në një shkallë të tillë të zhvillimit dhe të emancipimit, një ambient i tillë arsimor dhe kulturor, i cili absorbonte lehtësisht idetë nacional-romantike. Ajo, më një anë, kishte të pazgjidhur problemin kombëtar, kishte prapa vetes një histori të dhimbshme, e cila e thërriste për vetëdijesim, ndërsa më anë tjetër kishte trysinë e shovinizmit serb, që e ndiqte hap pas hapi; kishte integralizmin jugosllav që i kërcënohej me shpërbërje të identitetit, si dhe kishte ofertën Shqipëri, e cila ishte më e afërt dhe lehtësisht e akceptueshme. Rrëshqitjen e shpejtë të Kosovës në romantizëm nacional dhe më pas në nacionalizëm nuk e ndalnin dot as klasa e politikanëve

vendorë, të cilët, duke dashur t'i mbeteshin luajalë Jugosllavisë në çdo rrethanë dhe duke qenë të paarsimuar dhe dogmatë në perceptimin e nacionalizmit, derdhën shumë mund, dhe bënë shumë tautologji ideologjike, dhe ranë në grackën e antishqiptarizmit, jo pse ishin të vetëdijsëm se nacionalizmi shqiptar rrezikonte Jugosllavinë, por më shumë për faktin se atyre dhe fëmijëve të tyre iu shfaqej përpara një e ardhme e pasigurt, në një Kosovë ku ata për shumë kohë kishin bërë punën e spiunëve të vegjël dhe tradhtarëve ordinerë.

Ata nuk e ndalnin dot bashkëpunimin me Shqipërinë, nuk ndalnin dot librat, koncertet, profesorët, shfaqjet teatrore (të cilat i kritikonin në çdo rast në mbledhjet e tyre të mbyllura në Brezovicë ose në Gërmë), sepse Titoja kishte thënë ndryshe. Por as ndonjë kontroll më të rreptë nuk venin dot, qoftë sepse ishin të padijsëm, qoftë nga se e nënçmonin nacionalizmin shqiptar, që kishte fraza dhe parulla të shkruara me shkumës nëpër shkolla, ose pamflete të shtypura me makina të vjetra shkrimi dhe asgjë më shumë se kaq. Njerëz që lexonin vetëm shtypin e Beogradit (ndonjëri pak më i avancuar edhe ndonjë revistë të Zagrebit), ata nuk dinin asgjë për librat, për revistat dhe për produktet e tjera kulturore që vinin nga Shqipëria. Duke qenë struktura parapolitike, struktura publike të sigurimit të shtetit dhe të policisë së fshehtë, ata e kishin përqendruar tërë vëmendjen në zbulimin dhe dënimin e grupeve ilegale, kështu që nuk e kishin as idenë se çfarë ndodhte në botën përreth tyre. Disa syresh, duke dashur të dukeshin më tolerantë, më liberalë, më të afërt me popullin e vet, krijonin ndonjëherë edhe marrëdhënie afrie me nacionalistët shqiptarë, por për këtë menjëherë pastaj bënin autokritikë në mbledhjet e shpeshta të organizatave të partisë. Nacionalizmin shqiptar ata nuk e ndalnin dot edhe për një

arsye tjetër: ai po shfaqej në skenë në të njëjtën kohë me nacionalizmin e popujve të tjerë të Jugosllavisë dhe atje, madje, kishte edhe mbështetjen e nomenklaturave partiake dhe politike të republikave dhe të kombeve brenda tyre. Mirëpo, kur nacionalizmi shqiptar u bë i dukshëm, u bë publik, siç ishte rasti i vitit 1981, Jugosllavia u bë unike, u ngrit në këmbë dhe i goditi shqiptarët në të gjitha format.

Si u bënë, pra, kosovarët nacional-romantikë dhe çfarë gjetën të glorifikonin te kombi i tyre? Si të gjithë popujt e Ballkanit, gjetën shumë luftëra që i kishin humbur dhe shumë më pak nga ato që i kishin fituar. Nga kjo histori e vuajtjes dhe e pësimit dilte një konkluzion, se kombi është një *dhembje e bukur*, pra është vuajtje, është sakrificë, që bëhet për një ide të lartësuar. Ky lloj sadomazohizmi është i pranishëm te të gjithë popujt që kombin ende e kanë ide abstrakte, pra, që kombin nuk e përjetojnë si bashkësi që krijon favore, por si bashkësi që kërkon t'i bëhen favore. Në fazën e konstituimit dhe të konsolidimit, të gjithë kombet e kanë këtë atribut, atributin e martirizimit dhe të sakrificës. Në rastin e Ballkanit, në sytë e europianëve kjo duket atipike dhe te kosovarët në mënyrë të veçantë, sepse proceset e vonuara sikur përsërisin një histori tragjike, diçka si ngarendje e fantazmave të ferrit në pikë të ditës. Në të vërtetë historia nuk po përsëritej në Ballkan, vetëm po ndodhte një zhvendosje në kohë e asaj që vetë Europa e kishte kultivuar një shekull më parë.

Më pastaj vinin përbërësit e tjerë romantikë, që glorifikoheshin dhe lartësoheshin në mënyrë joracionale. Këtu bënte pjesë lashtësia, pra *origjina ilire e shqiptarëve*, e cila te kosovarët mori një domethënie të veçantë. Ata ishin të nënçmuar nga sllavët, me të cilët jetonin në të njëjtën bashkësi, pa dëshirën e tyre. Kosovarët ishin të varfër, të paemancipuar, pa traditë kulturore, në çdo pikëpamje

inferiorë ndaj të tjerëve, prandaj duhej ta kërkonin dhe ta gjenin krenarinë në një kohë tjetër. Për kosovarët, të kishe origjinë ilire donte të thoshte të ishte më i lashtë se sllavët në Ballkan, se atëbotë kishe pasur kulturë dhe një civilizim që mund të barabitej me antikën greke dhe romake. Ky *idealizëm historik* ose gjysmë-historik, gjysmë-legjendar, i përvetësuar dhe i bartur si ide nga shekujt e mëparshëm, nuk u bënte përshtypje vetëm shqiptarëve në atë Jugosllavinë e atëhershme, por edhe të tjerëve, veçmas atyre që kufizoheshin me shqiptarët: serbëve, malazezëve dhe maqedonasve. Liria që secili komb të shprehte identitetin e vet në kuadër të Jugosllavisë, kishte bërë që në njëfarë mase të zhvillohej një garë e brendshme për mitologjinë historike: secili glorifikonte mitet e veta nacionale dhe secili i mbante ato si argumente për barazi ose superioritet. Nëse pranohej teza e origjinës ilire të shqiptarëve, kosovarët dilnin më superiorët e bashkësisë jugosllave. Por, mbi të gjitha, origjina e ilire e shqiptarëve kontestonte të drejtën historike të serbëve mbi Kosovën, sepse me këtë përkufizim serbët shpalleshin “të ardhur në tokën e huaj”.

Teza e origjinës ilire të shqiptarëve në esencën e saj nuk mund të ishte as nacionaliste, as nacional-romantike. Vetëm përdorimi i saj politik i jepte këto attribute. Kosovarët e përdorën atë si një *emblemë mbrojtëse* kundrejt sulmeve që ndërmerreshin ndaj tyre, si shumicën e përbërësve të tjerë të nacional-romantizmit. Ata nuk patën asnjë mundësi që mitet e tyre nacionale t’i shndërronin në veprime konkrete dhe, në këtë mënyrë, të rrezikonin ose ta cenonin në çfarëdo mënyre ekzistencën e popujve të tjerë. Ata thoshin se kanë origjinë ilire, por nuk kishin në dispozicion asnjë instrument të forcës apo të dhunës, që do t’u jepte mundësi të zgjeroheshin në krejt ato territore, ku dikur ishin shtrirë ilirët. Por, sido që të ishte, Kosovën e donin për vete, jo pse

aty ishte ruajtur më së miri vazhdimësia dardane-shqiptare, por më shumë për faktin se hapësira e tyre jetësore që një shekull e prapa ishte rrudhur në vazhdimësi dhe tani kishin dy zgjidhje: ose të qëndronin aty ku ishin, ose të merrnin arratinë, në Turqi, në Shqipëri, kudo qoftë. Ky pozicion vetëmbrojtës i shqiptarëve, pozicion krejtësisht natyror, madje biologjik, nga serbët, maqedonët dhe të tjerët e bashkësisë jugosllave u quajt nacional-shovinizëm shqiptar.

As në këtë rast kosovarët nuk nisën ndonjë ndarje me Shqipërinë, ndonëse patën mundësi ta bënin këtë. Brenda origjinës ilire ata mund të specifikohehin si *dardanë*, fis ilir që kishte banua pjesën më të madhe të territoreve ku jetonin shqiptarët në hapësirat e Jugosllavisë, por ky specifikim nuk mori ndonjëherë attribute të një *origjine të ndarë*, ose të së drejtës historike vetëm kosovare. Në perceptimin e origjinës si përbërës të identitetit kombëtar, kosovarët përvetësuan një zgjidhje krejt logjike krahasuese, madje shkencërisht të qëndrueshme: ilirët ishin populli, dardanët ishin fisi; shqiptarët ishin kombi, kosovarët ishin pjesë e tij. Pra, idenë e ndarjes nga njësia kombëtare ata e minimizuan maksimalisht, sa që as kundërshtarëve të tyre nuk u ra ndër mend ta bënin këtë. Vetëm pas vitit 1981 dolën disa zëra sporadikë që thanë se ishte bërë gabim që kjo ndarje nuk ishte bërë me kohë, madje duke krijuar emërtimin dhe perceptimin për dy entitete: *shiptari* për shqiptarët në Kosovë dhe *albanci* për shqiptarët matanë Bjeshkëve të Nemuna. Të gjithë e dinin, edhe hartuesit e elaborateve gjenocidale, se një ndarje e këtillë ishte shkencërisht e paqëndrueshme dhe nuk kishte si të aplikohesh te pakicat e tjera kombëtare, të cilat nuk ishin të pakta në Jugosllavi. Kjo ndarje krijonte edhe implikime të tjera politike: po të bëhej nga shqiptarët në Jugosllavi një komb më vete, atëherë kjo do t'i shëmbëllente maqedonëve dhe një republikë e tyre do

të ishte e paevitueshme. Këtë më së paku e donin serbët, malazeztë, maqedonasit.

Një përbërës tjetër i nacional-romantizmit shqiptar, nga fundi i viteve '60 u bë *Skënderbeu*. Kosovarët e morën nga Shqipëria idenë e shënimit të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Tashmë në Kosovë kishte arritur një literaturë e mjaftueshme që fliste për Skënderbeun, apo edhe për historinë e popullit shqiptar në përgjithësi; pastaj libra të mjaftueshëm të letërsisë së traditës, libra shkencorë të historisë, të gjuhësisë dhe përgjithësisht të shkencave albanologjike. Rilindësit shqiptarë, të cilët i kishin kënduar Skënderbeut dhe bëmave të tij sa historike aq edhe të pabesueshme; që u kishin kënduar bukurive të vendit dhe kishin ngritur në qiell virtytet shqiptare, në Kosovën e sapo dalë nga errësira e analfabetizmit dhe prapambetjes përnjëherësh u bënë shumë popullorë, të lehtë për t'u kuptuar, të afërt për nga idetë dhe nxitës për nga angazhimi kombëtar. Letërsia e Rilindjes në Kosovë gati për gjysmë shekulli shërbeu si mjete kryesor i emancipimit: ajo lexohet dhe rilexohet, mësohet përmendësh dhe recitohet, në shkollë dhe në të gjitha aktivitetet kulturore. Përmes saj krijohet përfytyrimi për atdheun, për Shqipërinë, krijohet edhe modeli për heroin kombëtar, për njeriun e qëndresës dhe të sakrificës. Ai, natyrisht, është Skënderbeu, trim i paepur, i pamposhtur nga armiqtë, i pagabueshëm në veprime dhe në gjykim. Ai i shërben Kosovës edhe si simbol i luftës kundër orientalizmit, kundër mentalitetit anadollak, i cili kishte qëndruar i konservuar kryesisht në ambientet urbane, gjysmë turke, gjysmë shqiptare. Në Prishtinë, në vitin 1968, mbahet një simpozium shkencor për Skënderbeun, në të cilin ligjërojnë shkencëtarë të shquar të Shqipërisë. Në sytë e kosovarëve ata kthehen në heronj të dijes, të erudicionit dhe të angazhimit kombëtar. Shfaqet

edhe filmi për Skënderbeun, bëhet një ekspozitë tematike dhe shpërndahen emblema me figurën e heroit kombëtar. Ky është një kuadër i mjaftueshëm për të krijuar një përbërës të nacional-romantizmit, i cili në rrethanat e Kosovës gradualisht po merrte atributet e *identitetit funksional*, i forcës që shtrëngon radhët dhe bëhet element kohezioni dhe qëndrueshmërie.

Përbërësit e tjerë të identitetit

Ndërsa punoja redaktor i suplementeve kulturore të gazetave të Prishtinës, jo shumë vjet më parë më kishte rënë në dorë një fotografi e vitit 1941, e bërë në Pejë më 28 Nëntor të atij viti jo edhe aq të largët. Në atë foto, dy djem të rinj pejanë, rreth të njëzetave, të gjatë, të hijshëm, njëri i veshur me rroba tradicionale të qytetit, ndërsa tjetri “allafrënga”, shihen në qendër të qytetit të Pejës tek mbanin me vete një flamur shqiptar, të cilin e kishin punuar vetë. Në të vërtetë, në foton bardh-zi flamuri duket një improvizim i çuditshëm: një copë katrore e çarçafit të bardhë, në të cilin me bojë të zezë është vizatuar diçka që i ngjan shqiponjës dykrenore. Kjo foto bën me dije se më 1941, kur kosovarët për herë të parë patën mundësi ta përdornin flamurin kombëtar, shumica e tyre nuk kishin as idenë si dukej ai. Edhe nëse në kohën e Haxhi Zekës mund të ishte përdorur flamuri kombëtar, gjë që lë shumë për të dyshuar, që atëherë kishin kaluar më shumë se dyzet vjet të ndarjes me Shqipërinë, kohë kjo e mjaftueshme për të tronditur në esencë identitetin e paqëndrueshëm të kosovarit të zakonshëm.

Kjo foto shpjegon edhe një gjë tjetër: se kosovarët, edhe përkundër pjesëmarrjes në ngjarje të rëndësishme

kombëtare, për shkak të orientalizmës së tyre më të madhe se ç'mund ta mbante një identitet i pakonsoliduar; për shkak të lidhjes shumë të ngushtë me Perandorinë Osmane dhe më vonë me Turqinë; dhe, së fundi, për shkak të shkëputjeve të mëdha me Shqipërinë, e cila tashmë kishte marrë rolin e Piemontit të idesë kombëtare; pra, për të gjitha këto arsye, kosovarët duhej të riformësonin ose të rithemelonin identitetin e tyre kombëtar. Vitet e Luftës së Dytë Botërore dhe ato të paktë që erdhën pastaj, luajtën rol të rëndësishëm për rikthimin në identitet të kosovarëve, por fill pastaj erdh një shkëputje e re, e cila zgjati deri në fund të viteve '60.

Pra, nga fundi i viteve '60 kosovarëve iu lejohet përdorimi i *flamurit kombëtar*, atij flamuri për të cilin ata tashmë kishin lexuar ode dhe himne, kishin lexuar histori dhe bëma heroike, kishin dëgjuar për pësime dhe sakrifica. Jo shumë vjet më parë, po për këtë flamur ishin futur në burg dhe ishin dënuar me shumë vjet heqje lirie grupe irredentistësh kosovarë. Për ata tani rrëfehej legjenda se në mbrëmjen e 28 Nëntorit flamurin kombëtar e kishin vendosur natën në të gjitha institucionet e Kosovës, përfshirë edhe lokomotivën e një treni, i cili, me flamurin shqiptar sipër, në mëngjes kishte hyrë "triumfalisht" në Beograd. Kosova, pra, tani kishte krijuar edhe *legjendat e saj për flamurin*, kishte edhe heronjtë e saj të këtij simboli. Më anë tjetër, ajo tashmë kishte përfituar aq emancipim, sa ta akceptonte flamurin si një simbol themelor të identitetit të saj të ringritur. Ndonëse është fenomen i njohur dhe i përhapur gjithandej, në rastin e shqiptarëve janë dy faktorë që flamurit kombëtar i japin attribute kombëtare, jo vetëm shtetërore: e para, sado që në masë të kufizuar, flamuri filloi të funksiononte si simbol i shqiptarëve përpara se të bëhej Shqipëria (u quajt flamur kombëtar përpara se të quhej

flamur shtetëror); dhe, e dyta, ishte Kosova ajo që më këmbëngulje deri në sakrificë kërkoi të ishte e përfshirë në funksionimin gjithëpërfshirës të këtij simboli. Ndoshta çudia më e madhe për rrethanat e Kosovës ndodhte me një paradoks: flamuri shqiptar zyrtarisht ishte lejuar në Kosovë, ndërsa nëpër burgje vazhdonin të qëndronin ata që e kishin kërkuar lejimin e përdorimit të tij. Kjo, ndër të tjera, dëshmonte se politikat jugosllave rreth Kosovës ende ishin në luhatje, ishin joparimore dhe shpesh konfuze.

Për shkak të natyrës së saj si përbërës jopolitik i identitetit, *gjuha e njësuar*, gjuha letrare, gjuha standarde shqipe nuk u afishua asnjëherë si element i nacional-romantizmit kosovar. Meqë gjuha do të trajtohet veçmas në kuadër të këtij shqyrtimi për identitetin, le t'i theksojmë këtu tri çështje që nuk janë të panjohura, por që mendoj se duhet sjellë në vëmendje të lexuesit pikërisht në këtë vend: e para, se Kosova bëri hapat paraprak të njësimin të gjuhës së saj letrare me gjuhën letrare të Shqipërisë shumë vjet para Kongresit të Drejtshkrimit; e dyta, se që nga viti 1966 dhe prapa, si në shumë fusha të tjera të kulturës, në Kosovë ekzistonte një lloj i idealizmit dhe entuziazmit gjuhësor; dhe, e treta, se vendimi që gjuhëtarët e Kosovës të merrnin pjesë në Kongresin e Drejtshkrimit ishte vendim politik që i tejkalonte suazat e Kosovës.

Lidhur me çështjen e parë, le të rendisim këtu një kronologji ngjarjesh gjuhësore, të cilat ndodhën në Kosovë deri në vitin 1972, ashtu siç i paraqet Rexhep Ismajli në shumë studime të tij për këtë problematikë. Kështu, më 1952, pra njëzet vjet para Kongresit të Drejtshkrimit, në Kosovë u bë një mbledhje gjuhëtarësh, në të cilën u vendos që "si gjuhë letrare të vazhdonte të përdorej gegërishtja e mesme (e përgjithësuar), por me njohjen e tërë leksikut të shqipes si të gjuhës letrare". Pesë vjet më vonë, më 1957, u

mbajt një mbledhje tjetër e gjuhëtarëve, ku u theksua nevoja që gjuha letrare “të ishte sa më afër gjuhës së folur”. Kjo mund të ishte mbledhja që bëri përpjekje të largonte gjuhën e kosovarëve nga “gjuha e Shqipërisë”, por sikundër vërehet më vonë, me vendimet e këtij tubimi nuk dolën të kënaqur as gjuhëtarët, as intelektualët e Kosovës, të cilët disa vjet më vonë, më 1964, duke u mbështetur në ortografinë e Tiranës të vitit 1956, nxorën një ortografi të gegërishtes, e cila çonte në drejtim të afrimit më të madh të dy dialekteve. Atmosfera që u krijua pas vitit 1966 në Kosovë solli frymën e përafritimit më të madh të gjuhës me shqipen letrare të Shqipërisë, kështu që më 1968, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës fuqizoi vendimin që në Kosovë në përdorim zyrtar dhe publik të vihej shqipja letrare, ashtu siç ishte kodifikuar në “Projektin e rregullave të drejtshkrimit”, publikuar në Tiranë në vitin 1967, që në të vërtetë ishte një projekt në diskutim publik dhe që synohej të miratohej në momentin përkatës. Organizatorët e Konsultës i pret Fadil Hoxha, që atëherë ishte kryetar i Kuvendit të Kosovës, që domethënë se ky tubim shkencor për gjuhën merr edhe miratimin zyrtar.

Ka të ngjarë që në vitin 1957 duket të jetë bërë përpjekja më e drejtpërdrejtë e shkëputjes së gjuhës letrare të Kosovës nga gjuha letrare e Shqipërisë, respektivisht synimi për të krijuar një *variant autentik* të gjuhës së shkruar shqipe për Kosovën, e cila do të ishte kryekëput dialektore, e mbështetur në gjuhën e folur, duke mos qenë as një gegërishte me bazë historike. Kjo është koha kur Kosova përjetonte një gjendje të rëndë, kur asaj i qenë pezulluar pothuajse të gjitha atributet e autonomisë, përjetonte dhunë sistematike, kishte kaluar aksionin e armëve dhe shpërnguljet masive për Turqi. Trysnia politike doemos që do të jetë reflektuar edhe në vendimin e gjuhëtarëve, të cilët në këtë rast i nënshtrohen situatës dhe duket se marrin

vendime të diriguara, sepse jo plotë shtatë vjet më vonë, në një klimë pak më të favorshme, e ndryshojnë plotësisht këtë qëndrim dhe adaptojnë vendime që shkojnë në drejtimin tjetër, në përafrimin e gjuhës së Kosovës me të Shqipërisë. Por ajo që bie në sy më qartë në krejt këtë situatë, është varshmëria e pakundërshtueshme e vendimeve të gjuhëtarëve të Kosovës në raport me vendimet që paraprakisht ishin marrë në Shqipëri. Hapat që bën Kosova që në atë fazë për përafrimin gjuhësor me Shqipërinë, kanë qenë me rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimet e mëvonshme, sepse gjuha shfaqet këtu si një *lidhje shpirtërore* që Kosova vazhdon ta mbajë me Shqipërinë, pavarësisht se lidhjet e tjera ishin dobësuar shumë dhe komunikimi kulturor pothuajse ishte ndërprerë tërësisht.

Atëherë, a kishte pra një *romantizëm gjuhësor* te kosovarët në këtë periudhë dhe si shfaqet ai? Doemos. Gjuha nuk mund të ndahej nga atmosfera e përgjithshme, e cila sundonte në ato vite, pas vitit 1966 dhe deri më 1981. Ishte atmosferë e entuziazmit, e rizgjimit kombëtar, e euforisë, e romantizmit nacional dhe në gjuhë kjo atmosferë do të reflektohet në një përpjekje pothuajse masive për të përvetësuar sa më mirë një normë letrare dhe një ortografi tepër të vështirë për Kosovën, e cila sapo i kishte bërë hapat fillestarë të nxënies së shkrim-leximit. Pra, në atë atmosferë entuziazmi, e cila mbretëronte në fund të viteve '60, as që mund të mendohej ndonjë vendim tjetër i gjuhëtarëve të Kosovës, edhe sikur të provonin diçka të tillë, përveç se një adoptim i plotë i vendimeve që tashmë ishin marrë në Tiranë. Por, megjithatë, nuk mund të thuhet se gjuha letrare në Kosovë, në këtë rrethanë, qenkësh zhveshur nga funksioni i saj themelor dhe paskësh marrë attribute që nuk i takojnë. Nëse funksioni themelor i gjuhës është komunikimi, atëherë ky komunikim me literaturën e Shqipërisë, e cila

kishte vërshtuar të gjitha fushat e dijes, do të ishte i pamundur nëse nuk adaptohej një gjuhë letrare e afër me të Shqipërisë. Kosova kishte arritur në gjysmën e viteve '60 me një numër tekstesh shkollorë të përkthyer, me pak letërsi dhe me një shkrim publik dhe zyrtar të deformuar, për shkak të ambientit bilingual dhe dominimit të serbokroatishtes. Për një kohë shumë të shkurtër të gjitha nevojat elementare me tekste dhe literaturë u plotësuan nga Shqipëria, me marrje të drejtpërdrejtë ose me ribotime. Shfrytëzimi i kësaj literature ishte bërë i domosdoshëm për rrethanat e Kosovës dhe një komunikim me të do të ishte i pamundur nëse nuk adaptohej edhe në Kosovë një gjuhë letrare e përshtatur me atë të Shqipërisë. Gjuha letrare që vinte nga Shqipëria për Kosovën e atyre viteve ishte gjuhë e arsimimit dhe emancipimit. Pa këtë gjuhë letrare, Kosova do të ishte e destinuar të varej jo nga vetvetja, sepse gjërat e veta i kishte aq të pakta, por nga dija dhe kultura sllave, e cila edhe ashtu kishte marrë një shtrirje tepër të gjerë dhe ishte futur në të gjitha porët e jetës, përfshirë edhe fushat e mendimit. Le të ishte politik vendimi për të njëzuar gjuhën letrare; le të ishte i padrejtë dhe i imponuar; Kosova nuk kishte alternativë tjetër, përveç se ta adoptonte me çiltëri dhe entuziazëm. Nuk mund të thuhet se këtë e bënte për shkak të ideologjisë, ose vetëm për shkak të patriotizmit, as për shkak të inferioritetit kundrejt Shqipërisë, megjithëqë kishte pak nga të gjitha. Ajo e bënte këtë për shkak të nevojave të saj, për shkak se nuk kishte rrugë tjetër. Me një gjuhë letrare të ndryshme nga Shqipëria, Kosova do të shkërmoqej, do të shpërbëhej, do të tretej. Nuk do të krijonte identitet, por do të vajtonte identitetin e humbur.

Implikimet ideologjike

Një detaj i shkëputur nga kujtimet e Fadil Hoxhës të nxit të mendosh se çfarë në të vërtetë kishte ngjarë në nivelet e larta të politikës jugosllave, pikërisht në kohën kur Kosova fillon të ndërtonte subjektivitetin e saj politik në kuadër të Jugosllavisë. Detaji thotë kështu: Miratimin për të marrë pjesë kosovarët në Kongresin e Drejtshkrimin të vitit 1972 e kishte dhënë Petar Stambolliqi, një politikan serb i niveleve më të larta, që nuk shquhej për ndonjë simpati ndaj shqiptarëve, përkundrazi. Po të mos e thoshte vetë Fadil Hoxha, askush në Kosovë nuk do ta besonte këtë gjë, sepse për një shumicë kosovarësh miratimi duhej të vinte pikërisht nga Fadil Hoxha, eventualisht pas një konsultimi me Titon, por jo nga një politikan serb i proveniencës nacionaliste. Pse, pra, Petar Stambolliqi duhej të pyetej për këtë dhe pse pikërisht ai duhej të jepte miratimin për pjesëmarrjen e kosovarëve në Kongresin e Drejtshkrimin? Pse Serbia, në këtë rast, i bënte Kosovës koncesione të këtilla? A ishte kjo rrethanë e atmosferës liberale, që atëbotë mbretëronte në Jugosllavi, apo bëhej fjalë për diçka tjetër?

Pas vitit 1981, ndonjë politikan naiv, si puna e Sinan Hasanit, do të thoshte se Jugosllavia kishte bërë gabim që e kishte miratuar pjesëmarrjen e kosovarëve në Kongresin e Drejtshkrimin më 1972, sepse, sipas tij, gjuha e njësuar kishte qenë një nga *burimet e nacionalizmit* shqiptar. Kjo tezë atëbotë nuk u mbështet as nga nacionalistët serbë, jo për shkak se ishte një tepri që nuk do të mund të gëlltitej nga politikat e barazisë nacionale, të cilën e proklamonte Jugosllavia, por pikërisht për shkak të disa implikimeve të tjera. Në të vërtetë, në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70 çështja e shqiptarëve në Jugosllavi kishte arritur deri në atë pikë, sa të bëhej i domosdoshëm përpunimi i një strategjie,

pjesë e së cilës doemos që mund të ishin kosovarët, pavarësisht në ishin luajalë ose jo ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë. Kjo strategji duhej të jepte një përgjigje të qartë, nëse shqiptarët në Jugosllavi duhej të krijonin një *identitet të mëvetësishëm* nga shqiptarët e Shqipërisë dhe, në këtë e sipër, të merrnin atributet e një kombi të ri, siç kishte ndodhur me maqedonët, apo të trajtoheshin si pakicë kombëtare. Në rrethanën e ngjashme me maqedonët, Kosova do të merrte atributet e njësisë së veçantë federative me të drejtë shkëputjeje, ashtu siç e kishin republikat, ndërkohë që një zgjidhje të këtillë në asnjë variant nuk mund ta pranonte Serbia.

Këtë strategji e kishte përpunuar Titoja me udhëheqjen e ngushtë serbe dhe jugosllave që më 1968, kur përfundimisht u mohua kërkesa e Kosovës për republikë. Më anë tjetër, që të mos kishte çfarëdo luhatjeje në këtë drejtim, krerët partiakë dhe shtetërorë jugosllavë e ndiqnin me shumë kujdes vijën e mosndarjes dhe të veçimit të Kosovës nga *trungu identitar* i Shqipërisë. Me këtë qëllim, por edhe me qëllimin e mbajtjes së Shqipërisë më afër pikërisht përmes Kosovës, duke iu frikësuar kthimit ose futjen e saj eventuale në ndonjë aleancë ushtarake, jugosllavët toleruan pak romantizëm nacional panshqiptar dhe pak nacionalizëm shqiptaromadhi në radhët e kosovarëve, por, natyrisht, jo edhe të shqiptarëve të tjerë, veçmas jo atyre të Maqedonisë. Ata, pra kosovarët, mund të mbanin flamurin kombëtar njësoj si të Shqipërisë, pa asnjë shenjë dalluese; mund të kishin hero kombëtar Skënderbeun; mund të futnin në përdorim zyrtar gjuhën e njësuar letrare; mund të sillnin pedagogë universitarë nga Tirana, që të jepnin mësim në Universitetin e Prishtinës; mund të importonin libra pa ndonjë censurë të veçantë, sepse në Jugosllavi tashmë ishte ngulitur ideja se socializmi vetëqeverisës jugosllav kishte

superioritet të padiskutueshëm mbi derivatet e tjera të këtij sistemi kudo në botë. Të gjitha këto Kosova mund t'i bënte në këmbim të identitetit të mëvetësishëm dhe të synimit për sovranitet dhe shkëputje. Kosovarët nuk ishin dhe nuk mund të bëheshin komb, ishin pakicë kombëtare, *kombësi* siç thuhej atëherë, dhe nuk mund të dilnin nga kjo kornizë me asnjë çmim.

Në të vërtetë, këtë trajtim nuk e kundërshtonin as vetë kosovarët, pavarësisht nga bindjet e tyre politike dhe nga diferencat e brendshme ideologjike. Të dyja palët, edhe nacionalistët shqiptarë, edhe integralistët jugosllavë në një moment u gjenden në të njëjtën anë, në të njëjtin front, duke i harmonizuar qëndrimet e tyre rreth avancimit të statusit të Kosovës nga krahina në republikë, secila palë duke e shikuar këtë çështje në mënyrën e vet dhe për interesa politike krejtësisht të ndara. Nacionalistët kishin krijuar idenë se një republikë e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë, në rrethana të caktuara, do të mund të shkëputej dhe t'i bashkëngjitej Shqipërisë, sepse me kushtetutat jugosllave dhe me kushtetutat e republikave bashkimi i popujve në Jugosllavi ishte bërë mbi bazë të vullnetit të lirë të popujve, që domethënë se edhe shkëputja buronte po nga kjo e drejtë. Kosovarët me bindje jugosllave, ndërkaq, republikën e panë si një mundësi për të avancuar pozicionin e tyre prej pushtetarësh dhe për t'i dhënë Kosovës një status të barabartë në federatë, atje ku ata ishin të anashkaluar dhe të nënçmuar nga Serbia.

Më 1968, kur të dyja palët u gjenden pranë njëra-tjetrës, në Kosovë u krijua një konfuzion i madh politik, që nuk ishte parë kurrë deri atëherë. Kosovarët nacionalistë u hodhën në demonstratë, kërkonin republikë dhe brohoritnin emrin e Fadil Hoxhës dhe disa emra të tjerë të hierarkisë politike dhe intelektuale të Kosovës, që në atë kohë realisht

ishin në të njëjtin tabor. Por nuk u deshën më shumë se disa ditë që të kuptohej se në të vërtetë bëhej fjalë për një keqkuptim dhe mashtrim reciprok. Sapo u vërejt se nacionalistët e kërkonin statusin e republikës për *të drejtën e shkëputjes*, kosovarët e përfshirë në strukturat e pushtetit dhe ata me bindje jugosllave, bënë një prapaktheu të shpejtë dhe u distancuan nga të gjitha kërkesat, të cilat deri atëherë pothuajse i kishin mbështetur legalisht. Kjo në të vërtetë ishte ndeshja e parë ndërmjet luajalëve jugosllavë dhe nacionalistëve shqiptarë, ndërsa viti 1981 paraqet ndarjen e tyre përfundimtare.

Mirëpo, ajo që do vërejtur në këtë rast, asnjëra palë, as më 1968 dhe as më 1981, apo më vonë deri në vitin 1999, në skenën legale politike ose në prapaskenat e saj, në lëvizjen ilegale apo në manifestimet publike të saj, asnjëherë nuk u nxor ideja e formimit të një *kombi të veçantë*, kosovar, dardan apo çfarëdo emri tjetër që mund të kishte ai. Gjatë asaj periudhe, pra që nga viti 1968 e prapa, ndërsa lëvizja politike në Kosovë njohu faza dhe përshkallëzime të ndryshme, në pikëpamje të identitetit çështja mbeti “e pazhvilluar”, pra as në stadin e një ideje të hedhur kuturu, se kosovarët mund të krijonin një identitet të veçantë ose identitet të ndarë. Duke mos u zhvilluar bashkë me idetë e tjera politike, me idenë për republikë, me idenë për pavarësi, me idenë për bashkim kombëtar, ideja për identitet të ndarë mbeti krejt e papjekur, disi infantile. Përse të ndodhte kështu? Përse edhe kjo ide të mos kalonte nëpër fazat e saj, të kishte historinë e saj dhe të arrinte në një pikë, kur nuk mund të injorohet ose të anashkalohej?

Janë dy arsytet për këtë: E para ka të bëjë me historinë, pra me ato zhvillime që ndodhën në fazën e konstituimit të kombeve, kryesisht në shekullin XIX, kur Kosova nuk prodhoi identitet, por mbeti e lidhur pas Shqipërisë dhe

Turqisë. Historisë i takojnë edhe ato zhvillime, kur Kosova, pas vitit 1912, degradoi tërësisht në pikëpamje politike, kombëtare dhe identitare dhe u detyrua të bëhej *atribut* i pashkëputshëm i Shqipërisë. E dyta, ndërkaq, ka të bëjë me mënyrën se si u perceptua kombi dhe çështja kombëtare gjatë shekullit XX, përfshirë këtu edhe periudhën e socializmit dhe mënyrën si u mendua ta zgjidhte çështjen kombëtare ky sistem dhe ky rend botëror. Natyrisht që çështja e Kosovës, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, nuk mund të dilte jashtë *postulateve ideologjike të socializmit*, as nga këndvështrimi jugosllav, as nga ai shqiptar, sepse në të dy krahët, pavarësisht se bëhej fjalë për kualitete të ndryshme, baza teorike mbetej e njëjtë. Në Shqipëri për çështjen kombëtare i referohej Stalinit, në Jugosllavi i referohej Kardelit.

Kështu, në perceptimin e përbërësve të identitetit ideologjia socialiste futi elemente të reja, siç ishte lufta e klasave, internacionalizmi proletar etj., u mundua të shpjegonte çështjen përmes materializmit historik, por nuk ndryshoi diçka thelbore në interpretimin që u bëhej çështjeve të veçanta kombëtare. Socializmi nuk gjeti zgjidhje për asnjë çështje të hapur kombëtare, kudo që të ketë ekzistuar ajo. Përkundrazi, me identifikimin që bëri me nacional-socializmin, si instrument për ruajtjen e pushtetit në disa nga këto perandoritë lindore, shtetet socialiste gradualisht filluan të ktheheshin në *varre të kombeve*. Pra, thënë me një fjalë, as interpretimi socialist i çështjes kombëtare dhe as situatat e krijuara në realitetin politik jugosllav apo shqiptar nuk krijuan rrethana të favorshme as të disfavorshme që çështja kosovare të merrte një trajtim tjetër. Ajo mbeti një çështje e pazgjidhur kombëtare, me rrënjët e saj në periudhën para socializmit dhe që u bart si çështje e pazgjidhur deri në periudhën pas socializmit.

Socializmi nuk ndryshoi gjë në këtë rrjedhë, përveç se krijoi vonesa në disa pika, duke e futur ideologjinë jo si shans të zgjidhjes, por si ngatërresë të saj.

Hipokrizia dhe morali i dyfishtë

Krijimi i elitës kosovare, e tillë çfarë u bë ajo, ndodhi pikërisht në këto rrethana të depërtimeve të fuqishme nacionaliste dhe ideologjike nga Shqipëria dhe të avancimit të autonomisë nëpër të gjitha fazat e saj, pra të një dualizmi të papajtueshëm ndërmjet kundërshtive të interesave politike dhe kombëtare. Vetëm se kosovarët, në një fazë, sikur arritën t'i pajtonin këto dy kundërshti, duke i dhënë Kosovës arritje të shpejta dhe të jashtëzakonshme në fushën e arsimit, të kulturës dhe përgjithësisht të infrastrukturës institucionale. Ky kohabitacion politik dhe ideologjik në rrethanat e Kosovës u tregua i mundshëm, madje i domosdoshëm, duke pasur në dijeni mungesat e mëdha që kishte ajo në punë të krijimit dhe të konsolidimit të elitave politike dhe intelektuale. Për një kohë, për më shumë se një dekadë, që nga viti 1968 e deri më 1981, nacionalistët kosovarë, që ishin forca kryesore e perceptimit në opinion, që ishin "eminenca" gjysmë klandestine e çdo vlerësimi politik, nuk e drejtuan shënjestrën e tyre kundër autonomistëve dhe të tjerëve të përfshirë në ndërtimin e institucioneve. Nga opinioni nationalist ose nga vetë nationalistët ata nuk u gjykuan si tradhtarë, ose si "të shitur" të Titoja dhe Jugosllavia e tij. Ata nuk e mohonin se me ta ishin kundërshtarë politikë të papajtueshëm, por faza e ekskomunikimit të tyre ishte tejkalluar disi, me zhvillimet që kishin ndodhur nga viti 1966 e prapa. Ndarja ishte zbutur

ndjeshëm, sepse luajalistët jugosllavë të Kosovës, nga tradhtarë dhe antishqiptarë që ishin konsideruar deri atëherë, shpejt u bënë njerëz “të dobishëm”, të cilët mund të çonin përpara çështjen e Kosovës, qoftë duke avancuar pozitën e saj kushtetuese, qoftë duke ndërtuar institucione të rëndësishme. Kjo mund të ishte arsyeja pse në Kosovë, para luftës së vitit 1999, nuk kishte atentate politike, edhe përkundër polarizimeve të mëdha që kishte pasur atëbotë.

Krahas kësaj zbutjeje në ekstremet politikisht të polarizuara, një ndryshim ndodhi edhe në perceptimin e elitës intelektuale, e cila politikisht ishte autonomiste, por formimin e kishte thellësisht nacional. Kjo elitë arsimore, kulturore dhe profesionale, e cila ishte krijuar me ndihmën e institucioneve autonomiste (sepse vetë shteti jugosllav kishte investuar në krijimin e saj), gradualisht, nga fundi i viteve '80, shndërrohet në elitë intelektuale, kur nga *interpretuese e ngathtë e ideve* shndërrohet në *prodhuese e ngathtë e ideve*, me rëndësi të madhe për Kosovën dhe për zhvillimet rreth saj. Pavarësisht nëse ishte arsimuar në Universitetin e Prishtinës apo në ndonjërin nga universitetet jugosllave, kjo elitë kosovare, me të filluar punë në institucionet e Kosovës, para vetes kishte dy mundësi zgjedhjeje: të ishte e qëndrueshme dhe koherente në raport me interesat kombëtare të shqiptarëve, apo të bëhej pjesë e establismentit politik, që nënkuptonte një avancim më të shpejtë në karrierë dhe një sërë privilegjesh që shkonin bashkë me to. Në përgjithësi njerëzit me arsim të lartë dhe me aftësim të mirë profesional zgjidhin kohabitacionin: ta kishin mirë me kërkesat minimaliste të nacionalizmit shqiptar, por njëkohësisht të kryenin shërbime sa më cilësore dhe sa më profesionale në hierarkinë institucionale të Kosovës. Nëse nuk pretendojë të përfshiheshe në ndonjë organizim ilegal, kërkesat e nacionalizmit shqiptar nuk ishin

të papërballueshme. Përkundrazi. Pragu moral, të cilin nuk duhej ta kalonte asnjëri, ishte të qenit spiun, megjithëqë së fundi u zbut shumë edhe ky kriter, duke proklamuar nëpër qarqe të caktuara se një spiun shqiptar, i punësuar në policinë e fshehtë, në një rrethanë të caktuar, mund të ishte shumëfish më i mirë dhe më i dobishëm se një spiun serb. Kërkesat e tjera që shtronte nacionalizmi shqiptar në të shumtën e rasteve ishin deklarative.

Kjo bëri që *morali i dyfishtë* të bëhej rregull sjelljeje për shumë njerëz, të cilët gjatë ditës e shpallnin veten nacionalistë, kurse gjatë natës bënim spiunime e matrapazllëqe politike gjithfarëshe. Ndërsa ky moral i dyfishtë ruante në Kosovë njëfarë baraspeshimi ndërmjet nacionalizmit shqiptar dhe lojaliteti jugosllav dhe në këtë pikëpamje mund të quhej më i dobishëm se sa një adoptim i tërësishtëm i integralizmit jugosllav, në pikëpamje të formimit të korpusit intelektual dhe në përgjithësi të integritetit moral dhe të personalitetit, ky dualizëm shkaktoi pasoja të pariparueshme në Kosovë, sepse në momente të caktuara ai u bë pjesë e edukatës dhe mënyrë e jetesës. Në këtë pikëpamje, Kosova ka shumë individë moralisht dhe konceptualisht të deformuar, me personalitet të dyzuar, me një shpërpjestim të jashtëzakonshëm ndërmjet asaj që deklarojnë dhe asaj që bëjnë. Tashmë është pjesë e sjelljes publike e njerëzve në Kosovë një dualizëm moral, i cili, në rrethanat e reja, pothuajse ka marrë përmasat e një hipokrizie kolektive.

Më anë tjetër, qëndrimi i luajalistëve jugosllavë ndaj nacionalistëve shqiptarë njohu faza të ndryshme, herë të zbutjes e herë të ashpërsimit të skajshëm, varësisht nga rrethanat politike në Kosovë dhe Jugosllavi. Para vitit 1966 nacionalizmi shqiptar në Kosovë ishte pothuajse embrional dhe kishte një shtrirje tepër të kufizuar. Analfabetizmi dhe

injanca, pastaj represioni i egër i pushtetit e bëri pothuajse të pamundur mbijetesën e një fryme nacionaliste të shtrirë në jetën publike ose institucionale. Nacionalizmi shqiptar në këtë periudhë ishte *bindje individuale*, ishte botë e brendshme e individit, që vështirë merrte ndonjë formë të manifestimit të jashtëm, madje rrallë arrinte të përfshinte edhe jetën familjare, sepse edhe aty ndjehej i pasigurt. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore dhe në vitet që erdhën pastaj, pavarësisht se çfarë emri iu dha represionit dhe me çfarë preteksti bëhej ai, nacionalistët ishin ata që do të pësonin në të gjitha variantet, si kolaboracionistë, si ballistë, si tradhtarë, si NDSH-istë, si antikomunistë, si kundërrevolucionarë etj. Sekush u vra, sekush u dëbua, sekush u dënua me burgime të gjata, por në përgjithësi numri i tyre u zvogëlua ndjeshëm.

Nga fillimi i viteve '60, ndërkaq, për herë të parë Kosova filloi të njihte aktivitetin ilegal të grupeve të organizuara, të cilat zunë ta kundërshtonin në mënyrë programatike mbajtjen e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. Shfaqja e këtyre grupeve, që nga ajo periudhë e prapa, e orientoi në një pikë luftën kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar: tani nuk ishte i tërë populli shqiptar i Kosovës kundër Jugosllavisë, siç u proklamua në vitet e para të pasluftës, por vetëm disa individë dhe grupe të caktuara, të cilët duhej ndëshkuar në të gjitha format, sepse ata vepronin sa kundër shtetit, po aq edhe kundër interesave të popullit të vet. Përfshirja e intelektualëve në grupet e organizuara ilegale do të përbëjë shqetësim të madh për pushtetin dhe për luajalistët jugosllavë të Kosovës, kështu që, edhe përkundër shtimit të ndjeshëm të numrit të tyre, kontrolli i pushtetit mbi këtë kategori shoqërore do të jetë i vazhdueshëm dhe i ashpër. Ata survejoheshin, shantazhoheshin, kërcënoheshin në forma të ndryshme dhe,

nëse kjo mënyrë tregohet e paefektshme, atëherë vihet në veprim ndonjë proces i montuar politik (me përgjegjësi partiake, që reflektohet në karrierë) ose gjyqësor (me përgjegjësi penale).

Survejmimet e shumta në atë periudhë dhe më vonë në Kosovë krijuan atmosferën e mosbesimit ndërmjet njerëzve, në radhët e intelektualëve në mënyrë të veçantë. Të gjithë ishin patriotë, të gjithë ishin të dyshimtë. Përveç kësaj, në jetën publike u bë një përzjerje e pashembullt e ekzemplarëve me bindje dhe mendësi të kundërt. Shantazhimet, ndërkaq, krijuan kategorinë e intelektualëve të frikësuar, të cilët tërhiqeshin nga veprimtaria publike dhe bënë jetë të mbyllur. Të kërcënuarit gjithashtu. Ose, jo rrallë ndodhte *thyerja* dhe njerëzit, një numër i madh syresh, pas kërcënimeve dhe shantazheve, përfundonin si bashkëpunëtorë të organeve të sigurimit, shpesh jo për të bërë ndonjë shërbim kushedi se çfarë, por më shumë për të dëshmuar lojalitet. Një "përpunim" i këtillë i shtresës së arsimuar të njerëzve, që për rrethanat e Kosovës quhej shtresë intelektuale, ishte pothuajse gjithëpërfshirëse, deri me hapjen e fakulteteve të para të Universitetit të Prishtinës. Kush dërgohej me studime në Beograd, Zagreb, Sarajevë, Lubjanë gjithsesi duhej të kalonte një filtër përshtatshmërie. Më vonë, me shtimin e madh të numrit të njerëzve të përfshirë në arsimin e lartë, kjo situatë evoluoi ndjeshëm, kështu që përshtatshmëria si kriter i kontrollit politik, nga organet e sigurimit, të cilat më parë e kishin kompetencën ekskluzive, kaloi te një "kombinim informativ" ndërmjet po këtyre organeve dhe strukturave partiake, duke futur kështu në veprim të ashtuquajturin kriter të përshtatshmërisë moralo-politike.

Synimi i pushtetit për të kontrolluar sa më shumë njerëz në Kosovë, e çoi situatën në degradim të përgjithshëm, sepse

nga mesi i viteve '80 u bë e ditur një shifër fantastike e hetimit dhe e "përpunimit" të njerëzve, që kapte numrin mbi 700 mijë persona. Duket se, duke u zgjeruar në masë, kontrolli humbi në cilësi, kështu që dikur, pas vitit 1981, në Kosovë ishte vështirë të kuptohej se kush anonte në cilën anë: të gjithë sa për sy e faqe angazhoheshin kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar, të gjithë ishin luajalë ndaj Jugosllavisë, të gjithë ishin komunistë të devotshëm, por njëkohësisht të gjithë ishin patriotë, nacionalistë shqiptarë etj. Mirëpo, sikundër e thamë edhe më herët, kjo mënyrë e sjelljes ndaj shtetit me hipokrizi dhe përgjithësisht shfaqja në jetën publike me një moral të dyfishtë, do të krijojë te shqiptarët e Kosovës një deformim karakteri dhe sjelljeje: nga jeta politike, hipokrizia dhe morali i dyfishtë do të kalojë në jetën shoqërore dhe aty do të marrë përmasat e një vesi shoqëror tmerrësisht refuzues dhe tepër negativ. Po kjo mënyrë sjelljeje ndaj shtetit, që nënkupton mashtrimin, hipokrizinë, moralin e dyfishtë, edhe sot do ta bëjë Kosovën një shtet të cilin askush nuk e do sinqerisht.

Amalgama ideore

Afërsisht, në këtë mënyrë ishte e mbushur hapësira ndërmjet dy ekstremeve, ndërmjet dy skajshmërive, nacionalizmit shqiptar dhe luajalizmit jugosllav, të cilët, ndonëse njohën zbutje të herëpashershme, deri në fillim të viteve '90 qëndruan kryesisht në pozicione të kundërta dhe armiqësore, politike dhe ideologjike. Derisa lojaliteti jugosllav e ushqente klasën politike të Kosovës dhe mbështetësit e saj me privilegje, me farsën e vëllazërim-

bashkimit dhe me ideologjinë e socializmit liberal të tipit vetëqeverisës, nacionalizmi shqiptar ushqej me iluzione të pabesueshme, por tepër të fuqishme dhe joshëse për shumicën e popullsisë, e cila në Kosovë ende jetonte në varfëri. Në sytë e shumicës së shqiptarëve të Kosovës slogani i vëllazërim-bashkimit degjeneroi shpejt, sepse ai nënkuptonte, në radhë të parë, braktisje të çdo gjëje shqiptare dhe përvetësim të gjuhës, kulturës dhe mënyrës së jetës sllave, përfshirë këtu edhe pranimin e pabarazisë, respektivisht të superioritetit të racës sllave mbi atë shqiptare. Në kushtet e Kosovës, ta pranoje vëllazërim-bashkimin donte të thoshte të pranoje privilegje të pakontestueshme për serbët, malazetët, goranët, madje edhe turqit (me përjashtim të romëve) në dëm të shqiptarëve në të gjithë segmentet e jetës, në politikat e punësimit, në politikat arsimore, në politikat kulturore, në politikat sociale, në çdo gjë. Më anë tjetër, socializmi jugosllav kishte dështuar të zbatonte drejtësi sociale, çfarë ishte premtuar në fazat e hershme të socializmit dhe të tillë çfarë supozohej se e zbatonte socializmi real i llojit të Shqipërisë.

Për pasojë, në Kosovë tashmë kishte filluar të ndodhte një lloj *diferencimi social* i rëndë dhe i papërceptueshëm për shumicën e popullsisë së varfër. Në një gjendje shumë të rëndë sociale jetonte pjesa më e madhe e popullsisë fshatare, e cila nuk arrinte të mëkëmbej as në zonat me tokë të mjaftueshme, e jo më në zonat pasive. Toka e parcelizuar, shumë herë e zvogëluar nga kolonizimi dhe kooperativizimi, bujqësia dhe blegtoria ekstensive, tregu i pazhvilluar, të gjitha këto bënë të jetohej keq jo vetëm në fshatrat e Drenicës kodrinore-malore, por edhe të Dukagjinit me fusha jashtëzakonisht pjellore. Deri në vitet '70 gjëra të pakta kishin ndryshuar në jetën e njerëzve: pa infrastrukturë, pa arsimim, e shkallmuar nga shtypja e gjatë

sociale dhe kombëtare, pjesa më e madhe e kësaj popullsie mezi arrinte të siguronte bukën e gojës. Kjo popullsi ndihej e shtypur në pikëpamje kombëtare dhe sociale. Aty-këtu, në zonat rurale, dalloheshin për jetë më të mirë bashkëpunëtorët e pushtetit, të punësuarit në mënyrë selektive: mësuesit, shoferët, rojat e pyllit, korrierët e shkollave, inkasantët e rrymës etj., të cilët, paralelisht me punën primare, zakonisht detyroheshin të bënin edhe punën e spiunëve. Ndjenjën e pabarazisë e krijonte edhe jeta shumë më e mirë në fshatrat serbe, ku toka ishte më e shumtë, më pjellore, ku punohej me mjete pune më të avancuara të siguruara nga shteti, ku kishte infrastrukturë, ku prodhimet bujqësore dhe blegtorale mbledheshin në mënyrë të organizuar etj.

Në qytete, ndërkaq, ku filloi një përqendrim më i shpejtë i popullsisë, diferencat sociale filluan të ndjeheshin ndërmjet një klase të sapo formuar proletarësh, e cila punonte nëpër fabrika ose kantiere ndërtimi dhe popullonte periferitë e qyteteve, si dhe të një shtrese të popullsisë etnikisht të përzier, serbë, malazezë, pak nga pak edhe shqiptarë, të cilët popullonin qendrat e urbanizuara të qyteteve. Gradualisht, edhe në Kosovë u konsolidua e ashtuquajtura *borgjezi e kuqe*, ngjashëm me republikat dhe krahinat e tjera jugosllave. Shikuar nga prizmi i sotëm i privilegjeve dhe abuzimeve të pushtetarëve, gjendja pasurore e kësaj shtrese shoqërore mund të duket e papërfillshme, por për rrethanat e kohës ajo nuk mund të quhej e tillë. Ata i gëzonin të gjitha privilegjet që ua mundësonte socializmi liberal i Jugosllavisë, privilegje këto që e bënin të avancuar standardin e jetës së tyre në krahasim me shtresat e tjera të popullatës.

Këto diferenca sociale i ndjenin fort të rinjtë, rinia shkollërore dhe studentore, shumica me origjinë fshatare, të

cilët kishin vërshtuar Prishtinën për të bërë universitet dhe jetonin në gjendje të mjeruar. Më anë tjetër, nga Shqipëria vinte propaganda e vazhdueshme për drejtësi sociale, për luftën e klasave, për zhvillimin socialist të vendit, kështu që një masë e njerëzve në Kosovë filluan të bënin jetën ndërmjet një realiteti përgjithësisht të zymtë dhe të një *fiksioni*, i cili gradualisht u shndërrua në pasion revolucionar, që i bëri njerëzit joracionalë dhe nxit tek ata shpirtin e sakrificës. Kështu, një pjesë e kosovarëve e bënte jetën në Kosovë, ndërsa ëndrrat i shihte në Shqipëri. Ata nuk do ta kenë të lehtë ta pranojnë realitetin kosovar dhe do të bëjnë çdo gjë që ai realitet të përshtatet me fiksinon Shqipëri, të cilin e ndërtojnë mbi idetë e marksizëm-leninizmit, mbi literaturën propagandistike, mbi letërsinë e realizmit socialist dhe mbi traditën nacional-romantike. Ishte kjo *amalgama ideore*, e cila vuri bazat e vetëdijes kombëtare të shumicës së kosovarëve në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Ndërsa në anën tjetër të këtij polarizimi shoqëror vazhdon *euforia jugosllave*: shumica e kosovarëve tashmë përkundeshin në djepin ideologjik të Shqipërisë, pavarësisht se jetonin një realitet krejtësisht ndryshe dhe përgjithësisht bënin një jetë me mungesa dhe shtrëngesa më të pakta se bashkëkombësit e tyre matanë kufirit. Ta zëmë, fshatarësinë kosovare nuk e kishte përfshirë kooperativizmi dhe ajo ruante dhe kultivonte një ekonomi familjare deri diku autonome. Madje, ishte kjo ekonomi familjare dhe jeta e mbyllur patriarkale që e kishin ruajtur bërthamën e pacenuar të substancës shqiptare të shumicës së popullsisë. Për shkak të sulmeve të vazhdueshme të serbëve mbi pronat shqiptare dhe të idesë së cenimit të substancës kombëtare të kosovarëve pikërisht përmes shkatërrimit të pronës (kolonizimi, nacionalizimi dhe, në vitet e para të pasluftës,

kooperativizimi), ideja e ruajtjes së pronës tashmë ishte kthyer në fetishizëm. Propaganda e Shqipërisë së kooperativizuar nuk mund të besohet se e ndryshoi këtë mentalitet, por fshatari kosovar mund ta gëlltiste në heshtje edhe këtë sakrificë të paperceptueshme, vetëm me kushtin që edhe ai të bëhej Shqipëri.

Në të vërtetë, në krejt këtë rrethanë kosovare kishte edhe pak hipokrizi, sepse sistemin e diktaturës së ashpër që zbatonte Shqipëria një pjesë e kosovarët e donin vetëm për Shqipërinë, por jo edhe për veten e tyre. Ta zëmë, është e njohur se ideologjia marksiste-leniniste njohu një shtrirje të gjerë ndër kosovarët e diasporës, respektivisht tek ata kosovarë që ikën në Perëndim, fillimisht për shkak të shtrëngesave ekonomike, ndërsa më vonë edhe për motive politike. Mbi këtë masë kosovarësh Shqipëria ushtronte një propagandë të papenguar dhe tepër agresive. Në të vërtetë, fillimet e kësaj fushate propagandistike (nga fundi i viteve gjashtëdhjetë dhe fillimi i viteve shtatëdhjetë, kohë kur edhe Sartri u bë maoist) gjetën një terren të përshtatshëm politik edhe në vetë botën perëndimore, ku tashmë ishin profilizuar organizata terroriste marksiste-leniniste të tipit “Bader Mainhof” dhe të ashtuquajturat “parti të gjelbra”, që kishin po atë ideologji. Kosovarët pothuajse në asnjë rast nuk u përfshin në këto organizata, por punën e tyre politike e bënë në një mënyrë krejt tjetër: punonin në kushtet e një kapitalizmi jashtëzakonisht të zhvilluar, jetonin të paintegruar, lexonin libra të Enver Hoxhës dhe literaturë tjetër nga Shqipëria, organizoheshin në grupe marksiste-leniniste dhe shihnin ëndërr Kosovën e bashkuar me Shqipërinë. Po këta kosovarë, kur pas vitit 1991 ra diktatura në Shqipëri, pothuajse ishin të gatshëm t’i bashkoheshin Haxhi Lleshit, Nexhmije Hoxhës ose kujtdo tjetër për të rivendosur edhe me armë diktaturën në Tiranë. Kur disa

syresh, të tillë që në ato vitet e para të demokracisë vinin në Shqipëri nga Zvicra, Gjermania ose Suedia, ndodhte t'i pyesja se si ishte e mundur që socializmin dhe diktaturën e donin vetëm për Shqipërinë, ndërsa jetën e tyre e bënë në kushtet e kapitalizmit jashtëzakonisht të zhvilluar, nuk të jepnin ndonjë përgjigje të vlefshme. Ata e kishin perceptuar dhe vazhdonin ta perceptonin Shqipërinë si vend i ëndrrave të tyre, por jo si vend ku do të bënin jetë reale. Po u shikua nga aspekti politik, kjo ishte hipokrizia më e madhe kosovare kundrejt Shqipërisë, por ishte tepër naive që të mund të nxiste hatërmbetje.

BËRJA JUGOSLLAVE E KOMBIT KOSOVAR

Identiteti i përkohshëm

Gjatë periudhës së autonomisë së Kosovës, e cila me gjithë fazën e saj përgatitore nuk zgjati më shumë se 15 vjet (1966-1981), duhet pranuar se në mileun kosovar ndodhën transformime të jashtëzakonshme, të cilat përfshinë të gjitha shtresat dhe të gjitha kategoritë shoqërore. Në planin botëkuptimor pat shumë hamendje, dualizma, mjegull dhe paqartësi. Për shqiptarët e Kosovës, dhe jo vetëm për ata, fuqia asimiluese dhe integruese e Jugosllavisë ishte e jashtëzakonshme. Kosovarëve të varfër, për shumë kohë të shtypur dhe të diskriminuar, përnjëherësh u hapen perspektiva e emancipimit, e prosperitetit, e zhvillimit ekonomik dhe kulturor, e komunikimit dhe e lëvizjes së lirë pothuajse në të gjitha shtetet e Europës Perëndimore. Këtyre avantazheve nuk mund t'u bënte ballë aq lehtë as ai kosovari nacionalist, që e urrente Jugosllavinë me krejt qenien e tij dhe jetën intelektuale e bënte në një komunikim virtual me Shqipërinë; por as kosovari konservativ, i cili përpiqej ta mbronte identitetin duke mbajtur rreth vetes një mur rrethues që e ndante nga bota.

Në përballje me kosovarin u desh që, në njëfarë mase, të ndryshonin qëndrim edhe ata që e urrenin me krejt qenien e tyre, qofshin nacionalistët serbë, malazias apo maqedonë, sikundër që edhe vetë luajalistët jugosllavë të Kosovës u

desh ta kuptonin se kosovari, në masën më të madhe, së jashtmi shfaqej i bindur ndaj Jugosllavisë, ndërsa në brendi vazhdonte të mbetej nacionalist. U pa qartë, ndër të tjera, se ai nuk do ta ndërronte identitetin e tij, pavarësisht nga trysnitë dhe represioni, nga favoret apo nga joshjet, çfarëdo qofshin ato. Sloganet jugosllave të vëllazërimit-bashkimit dhe as atmosfera integruese që zotëronte gjithandej, te shumica e kosovarëve nuk kishin ndryshuar bindje, vetëm se e kishin bërë të dukeshin pak më ndryshe, disi më tolerantë dhe më të përmbajtur. Në të vërtetë, pamja e kosovarit më 1981 ishte befasuese pothuajse për të gjithë, si për jugosllavët, ashtu për edhe vetë kosovarët. Madje as nacionalistët e lëvizjes ilegale, që e kishin nxitur dhe e kishin organizuar këtë rebelim, nuk e kishin besuar se lëvizja mund të kapte përmasa të atilla.

Por, më të befasuar nga të gjithë duket se kishin qenë kosovarët me bindje jugosllave, të cilët për shumë vite kishin ushqyer iluzionin se Kosova përfundimisht ishte *nënshtruar*, ishte pacifizuar, ishte integruar. Në të vërtetë, iluzioni i tyre më i madh nuk kishte të bënte as me zgjidhjen politike për Kosovën, që pas vitit 1974 ishte një autonomi e gjerë, një Kosovë që kishte të drejtën e vetos në Federatë; as me zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor, që për pak vite kishin transformuar pamjen e Kosovës në çdo aspekt; as me avancimet e mëdha që ishin bërë në ndërtimin e institucioneve, në arsim, në shëndetësi, në kulturë, sepse ata e dinin se në të gjitha këto fusha Kosova ende kishte shumë probleme të pazgjidhura. Iluzioni i tyre kishte të bënte me integrimin, respektivisht me transformimet që ishte dashur të ndodhnin në vetëdije dhe në botëkuptim.

Luajalistë jugosllavë mendonin se, më në fund, kishin arritur të formonin një *kosovar tjetër*, një kosovar që vërtet e besonte vëllazërim-bashkimin dhe socializmin vetëqeverisës

jugosllav, që besonte Titon dhe idealet e tij për Jugosllavinë e popujve të barabartë. Sipas bindjes së tyre, kosovari i zakonshëm nuk ishte i denjë për një Jugosllavi të tillë, sepse ajo iu kishte dhënë më shumë nga ç'e meritonin. Prandaj, ndonjëri nga trashëgimtarët e liderëve politikë të Kosovës pjesëmarrësit e demonstratave të vitit 1981 do t'i quajë publikisht "zhelana", që në të vërtetë nuk ishte fyerje, por një atribut me konotacion shumë të qartë në përfytyrimin e kosovarëve me bindje jugosllave. Si guxonin të tillët të preknin Jugosllavinë?

Dhe, në të vërtetë, kush ishin ata plëngprishës? Djem dhe vajza, por më shumë djem, që nuk i nënshtroheshin diktatit, që ishin treguar kokëfortë dhe të pabindur, që nuk donin t'ia dinin për asnjë shenjtëri jugosllave, që Kosovën donin ta bënin republikë, pastaj ta shkëputnin nga Jugosllavia dhe t'ia bashkëngjitnin Shqipërisë. Një program politik krejt i qartë, por aq i guximshëm, sa mund të quhej i paturp dhe i pacipë. Dhe më e keqja ishte se ai nuk kishte pësuar asnjë ndryshim për dyzet vjetët e socializmit jugosllav, por shfaqej në formën e tij krejt primare dhe krejt fundamentale: Shqipëria ishte magneti, Shqipëria ishte joshja. Më kot i kishin mëshuar asaj Shqipërie si kishin ditur dhe sa kishin mundur, me propagandë dhe kundërpropagandë, me burgosje dhe me demaskime, me përqeshje dhe me fyerje, ajo përsëri ishte aty, në mendjen dhe në shpirtin e njerëzve. Ata kishin lejuar që një numër kosovarësh ta shihnin Shqipërinë nga afër dhe e dinin se shumica syresh nuk ishin kthyer të kënaqur nga ajo që kishin parë. Më anë tjetër, ata kishin mundur të shihnin Jugosllavi dhe Europë, kishin provuar kënaqësi të jetës që nuk i ofronte Shqipëria. Përse, pra, këta njerëz nuk ishin transformuar sadopak, përse nuk ishin bërë jo jugosllavë, se të tillë e dinin se nuk bëheshin dot, por së paku *jugosllavë-*

dashës, qytetarë luajalë të një vendi që iu kishte dhënë aq shumë mundësi? Kjo ishte enigma më e madhe.

Pra, nuk mund të thuhet se dikush kishte pritur nga kosovarët që të ndërrojnë identitet, të bëheshin diçka tjetër përveç se shqiptarë, por kishin kërkuar integrimin, atë që kërkohet zakonisht në raste të këtilla. Gabimi ishte bërë në vetë konceptin integrim, sepse në Jugosllavinë e atëhershme, ndonëse me institucione të fuqishme qendrore, askush nuk mund ta dinte saktë se kush kë duhej të integronte. Ideja jugosllavizmes, e cila mbase duhej t'i integronte shqiptarët në Jugosllavi, ishte një ide pezull, e cila nuk kishte shumë qartësi dhe nuk kishte gjetur mbështetje aq të gjerë. Jugosllavë me identitet gjithandej ishin bërë ata që e kishin vetë një identitet të paqartë ose të luhatshtëm, kryesisht personat me martesë të përzierë, ose trashëgimtarët e martesave të tilla. Në rastin e kosovarëve, jugosllavë me kombësi ishin bërë ata që, sa për sy e faqe, nuk donin të deklaroheshin të ndonjë kombësie tjetër, serb në radhë të parë, ndonëse si të tillë dihej se kishin përfunduar. Kontingjenti i kosovarëve luajalë i dinte këto gjëra, prandaj kishte ndjekur *rrugën e butë të integritit*, e cila pak gjë kërkonte më shumë se lojalitet ndaj Jugosllavisë. Por ata nuk e dinin ose nuk e kuptonin se ishte pikërisht ky lojalitet që i ngatërronte të gjitha, sepse çështja e pazgjidhur e Kosovës kishte mbetur peng i Jugosllavisë. Si mund të ishte shqiptar patriot, shqiptar romantik, shqiptar idealist dhe njëkohësisht të ishte luajal ndaj shtetit që pamundësonte zgjidhjen e çështjes kombëtare të shqiptarëve? Konceptualisht kjo nuk qëndronte. Lojaliteti jugosllav për kosovarët ofronte vetëm një mundësi: që zgjidhjen e gjetur për Kosovën ta pranoje si zgjidhje të qëndrueshme. Në fund të viteve '70 kjo ide kërkoi të gjente më shumë terren ndër kosovarët, kështu që atëbotë mund të gjeje edhe ndonjë intelektual të gjeneratave

të reja, të cilët Jugosllavinë e shihnin si *sendërtim të idealeve kombëtare* të një pjese të shqiptarëve.

Pikërisht këtë donin luajalistët: një heqje dorë të vullnetshme dhe të vetëdijshme nga zgjidhjet ideale, siç mund të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, dhe një pajtim me zgjidhjet parciale, as më të mira as ideale, por të pranueshme, siç ishte një Kosova autonome në kuadër të Jugosllavisë. Ata e kishin menduar dhe vazhdonin ta mendonin Jugosllavinë si kuadër të fortë shtetëror, i cili nuk mund të zhbëhej, që pastaj ta lejonte shkëputjen e Kosovës. Kjo ide, pra ideja e Jugosllavisë si kuadër i fortë shtetëror, ka qenë gur sprove për shumë kosovarë, të cilët, në situata kritike ishin luhatur, disa të tjerë ishin zhgënjyer dhe kishin përfunduar ose *në anën tjetër*, ose të tërhequr nga të gjitha angazhimet politike. Por, nëse themi se luajalistët jugosllavë të Kosovës u ndalën vetëm me kaq, do të bënim një amnisti të tyre të pashembullt, për çdo gjë që ata bënë kundër popullit të tyre, përfshirë edhe ngulitjen e idesë se jugosllavizma duhej të ishte ideal kombëtar i kosovarëve. Ata, ndryshe nga elitat politike të popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë, e kultivuan idenë e jugosllavizmës deri në histeri, duke përdorur të gjitha mjetet që ajo të zëvendësonte nacionalizmin shqiptar, respektivisht të kthehej në një nacionalizëm të pamundshëm, utopik, të pashembullt diku tjetër në Europë. Ata kërkonin nga kosovarët ta donin Jugosllavinë për hatër të tyre, të integroheshin në Jugosllavi për hatër të tyre, të harronin për hatër të tyre se çfarë kishte bërë Serbia në Kosovë, ta urrenin Shqipërinë për hatër të tyre. Janë po këta kosovarë, ose trashëgimtarët e tyre biologjikë apo botëkuptimorë, të cilët do ta ruajnë në vazhdimësi idenë e të qenit ndryshe, idenë e krijimit të një identiteti të ri ndër kosovarët e hutuar.

Dëbimi nga ëndrra jugosllave

Pas vitit 1981 nacionalizmi shqiptar në Kosovë fitoi pikë, sa për shkak të shpërthimeve euforike të formës së demonstratave, po aq edhe për shkak të sjelljes pa takt të shtetit dhe të pushtetarëve. Nën presionin e fuqishëm të nacionalizmit serb, shteti jugosllav pothuajse e humbi toruan: riktheu në agjendë recidivat e vjetra antishqiptare, si në vokabularin e propagandës, ashtu edhe në metodat e veprimit politik. Brenda një kohe tepër të shkurtër, Jugosllavia që së fundi kishte fituar shumë mbështetës në Kosovë, mbeti pothuajse pa krejt kontingjentet e saj të përkrahësve ideologjikë dhe politikë. Vitet e autonomisë kishin qenë periudhë e shkëlqyer e nacionalizmit shqiptar në Kosovë, por kishin qenë njëkohësisht edhe vite të triumfit të jugosllavizmës, të politikave të vëllazërim-bashkimit dhe të integritimit. Gara ndërmjet nacionalistëve shqiptarë dhe mbështetësve të ideve integruese ishte zhvilluar vite me radhë në prapaskenë. Pavarësisht se Kosova tradicionale dhe konservative mbante qëndrim refuzues ndaj Jugosllavisë dhe, për shkak të përvojës së hidhur historike, qëndrim krejtësisht armiqësor ndaj Serbisë, *politikat liberale identitare* të pandikuara nga Serbia, sikundër edhe zgjerimi i përgjithshëm i të drejtave, kishin krijuar përkrahës të shumtë të jugosllavizmës ndër gjeneratat e reja të popullsisë urbane në Kosovë. Beteja ndërmjet këtyre dy polarizimeve zhvillohej në të gjitha frontet, por përplasjet më të mëdha ndodhnin në planin e identitetit dhe të vetëdijes politike.

Shqipëria apo Jugosllavia, kjo ishte çështja për një numër jo të vogël kosovarësh, të cilët tashmë kishin filluar t'i vilnin frutat e integritimit dhe të lojalitetit jugosllav. Luhatjet dhe dilemat ndër kosovarët nuk kishin qenë të vogla. Por edhe nëse kjo situatë e dyzuar e kosovarëve nuk

manifestohej në formë të tillë, pra të luhatjes dhe dilemave, praktikat jetësore kishin çuar në drejtim të pranimit të shumë postulateve politike të integritit. Gjuha dhe kultura, mënyra e jetës dhe ambienti identitar *bipolar* sikur u stabilizuan në Kosovë. Këto ishin shenjat identifikuese të integritit. Kosovari fliste shqip në komunikimin e përditshëm, në shkollë, në fakultete, në administratë, në jetën e përditshme, por aty pranë gjithmonë e kishte dikë me të cilin duhej të fliste serbisht, ose serbokroatisht, siç thuhej atëherë. Dhe këtë ai e bënte pa ndonjë shkathtësi të madhe, por duke mos qenë i vetëdijshëm se në brendinë e tij, në perceptimin e tij gjuhësor tashmë ishte krijuar *dualizmi bilingual*. Në radio, në televizion dhe në shtyp, ndonëse me mjaft ngathtësi, përdorte gjuhën e standardizuar, gjuhën letrare shqipe, por pa qenë i vetëdijshëm se në perceptimin e tij gjuhësor ishin futur nocione sllave, idioma sllave, togfjalësh të gjuhëve sllave, të cilat interferonin me shqipen letrare të pastabilizuar në mendjen kosovare dhe, për pasojë, krijonin përparësi perceptimi dhe përdorimi. Kosovarët lexonin serbokroatisht, sepse literatura që vinte nga Shqipëria ishte e kufizuar dhe nuk mjaftonte. Të paktë ishin ata që mësonin gjuhë të huaja, sepse serbokroatishtja dukej e mjaftueshme për të dalë nga kuadri uniform dhe i kufizuar i një gjuhe. Kundruall shqiptarëve të Kosovës, por edhe kundruall shqiptarëve në përgjithësi, Jugosllavia e popujve të bashkuar, edhe për shkak të pozicionit të favorshëm ndërkombëtar, kishte përparësitë e një superfuqie kulturore, arsimore, shkencore. Një numër i këtyre intelektualëve kosovarë as që e lexonte literaturën shqipe, madje e nënçmonte atë, sepse përmes serbokroatishtes mund të kapnin majat e avangardës dhe modernitetit, ndërsa literatura e Shqipërisë, krahas pamundësive të tjera, kishte edhe kufizime ideologjike, prej të cilave Jugosllavia ishte çliruar që vitet '50. Mirëpo, këta kosovarë për shumë vite me

radhë, madje një numër syresh edhe sot e kësaj dite, do të mbajnë të fshehur në veten e tyre një defekt jashtëzakonisht të madh: Ata do të flasin një gjuhë surrogat, do të bëjnë një kulturë surrogat dhe do të krijojnë një mentalitet surrogat. Tani së fundi do të jenë edhe ideatorët dhe përkrahësit më të zëshëm të identitetit surrogat.

Për paradigmën kulturore të identitetit kosovar do të flasim në një hapësirë të veçantë në këtë shqyrtim, ndërsa tani do të mjaftohemi me një konstatim të përgjithshëm se ndër kosovarët fryma e integritetit tashmë kishte depërtuar thellë në të gjitha sferat e jetës intelektuale, ishte bërë pjesë e mentalitetit të një numër jo i vogël syresh dhe ishte bërë mënyrë e perceptimit të botës dhe të realitetit të një kategori tjetër jo aq e papërfillshme e popullsisë. Nga fundi i viteve '70 rinia urbane e Kosovës filloi të konsumonte me të madhe dhe t'i bënte për vete modelet e kulturës mediale, e cila sapo kishte filluar të shfaqej në hapësirat më të zhvilluara të Jugosllavisë. Për shkak të pozitës inferiore në të gjitha aspektet dhe në të gjitha fushat, kjo rini kosovare nuk do të jetë në gjendje t'i asimilojë këto modele, por do t'i imitojë ato në variantin krejtësisht jokreativ, duke pranuar shartime të panatyrshme dhe kundërthënëse kulturash me referenca antagonistë dhe përjashtuese.

Sido që të jetë, në vitet e lulëzimit të autonomisë, Kosova ishte përballur me rrezikun permanent të *dëmtimit të substancës*, kësaj radhe jo përmes dëbimit, shpërnguljeve dhe dhunës sistematike, por përmes një integriteti që gradualisht po merrte përmasat e një asimilimi, të ngadalshëm por të sigurt. Koha e shkurtër e autonomisë nuk krijoi shumë hapësirë për pasoja më tragjike, por që këto pasoja do të jenë evidente dhe do të përçohen në të gjithë përbërësit identitarë të kosovarëve, për këtë tashmë nuk duhet pasur asnjë dilemë. Demonstratat e vitit 1981 me një shpejtësi të paparë i

ndërprenë këto rrjedha të panatyrshme në të dy krahët. Pas atyre ngjarjeve, Jugosllavia, nën diktatin e fuqishëm të Serbisë, iu kthehet recidivave të vjetra antishqiptare dhe zbraz mbi kosovarët krejt arsenalin e urrejtjes, dhunës dhe përçmimit. Më anë tjetër, reagimi i kosovarëve do të jetë i menjëhershëm dhe do të ketë objektiv ndërprerjen e të gjitha lidhjeve me serbët dhe jugosllavët në përgjithësi.

Në të vërtetë, reagimi kosovar ishte i imponuar dhe vinte pas dhunës joproportionale të përdorur ndaj demonstruesve dhe pas shpërthimi të një mllëfi dhe urrejtjeje të paparë ndaj shqiptarëve, në medie, në organizata partiake, në institucione, kudo. Histeria antishqiptare ishte e tillë, sa që ajo përfundimisht bëri të qartë se idetë e bashkëjetesës dhe të integritit të shqiptarëve në Jugosllavi kishin qenë floskula dhe gënjeshtër propagandistike, ose, thënë më mirë, shkarje të çastit nga vija konsistente e politikave antishqiptare. Kjo histeri, sado që dikur u pa se kishte kaluar çdo masë dhe u bënë disa përpjekje të pasuksesshme që ajo zbutej dhe të kontrollohej, nxori “në anën tjetër” jo vetëm shqiptarët e zakonshëm të Kosovës, ose ata me pikëpamje të luhatshme, por edhe një numër të integruarish dhe me identitet të dyzuar. Kosovarët nuk kishin si t’i përgjigjeshin ndryshe kësaj histerie, përveç se duke shtrënguar radhët e veta dhe duke u rreshtuar në krah të nacionalizmit të tyre. Ata mund të mos kenë bërë ndonjë veprim që do të çonte në masivizimin e organizatave ilegale, por rreshtimi i tyre në krah të nacionalizmit shqiptar ishte e vetmja rrugë logjike, sepse streha e tyre komode e integritit jugosllave ishte prishur përfundimisht.

Pra, as atëherë e as sot nuk mund të thuhet se braktisja pothuajse euforike e integritit jugosllav ishte meritë e kosovarëve me identitet tashmë të dyzuar, apo *vetëdijesim* i

tyre në këto rrethana të reja, megjithëqë as kjo nuk mund të përjashtohet. Më shumë ishte një *dëbim* i tyre, si e qenit me shkop, që do të prodhojë situata përcmuese për një numër syresh dhe situata tragjike për një numër tjetër. Do të prishen familje me martesë të përzierë, do të përfundojnë të izoluar nga rrethi shoqëror fëmijët e paintegruar kosovarë të këtyre martesave. Baballarë dogmatë, të magjepsur pas jugosllavizmës, do të kërcënohen dhe do të shahen nga fëmijët e tyre. Do të prishen lidhje intime, të kultivuara vite me radhë dhe do të ndodhë ajo që nuk është tipike: nacionalizmi do të ngadhënjejë edhe mbi dashurinë. Ideatorë dhe kultivues të kësaj atmosfere doemos që ishin serbët, të cilët urrejtjen ndaj shqiptarëve tashmë e kishin bërë kredo jetësore, individuale dhe kolektive.

Në këtë rrethanë, klani politik i Kosovës ishte i prirë që situatën ta kanalizonte në favor të vetin, ashtu siç kishte bërë më 1968. Mirëpo, në mungesë të Titos, ai u marginalizua nga udhëheqja qendrore e Serbisë dhe Jugosllavisë dhe, më keq kaq, iu nënshtrua një verifikimi dhe diferencimi të padinjitetshëm, duke kërkuar prej secilit ta ridëshmonte lojalitetin. Disa nga ky klan u sakrifikuan, të tjerët u bënë bastardë që turpëruan familjet, farefisën dhe kombin, por shumica syresh, me etër dhe bij, me klane familjare dhe me rrethe miqësore, një herë mbeten të stepur, pastaj e morën veten dhe shpejt u futën në luftën politike kundër nacionalizmit shqiptar, në mënyrë që t'i shpëtonin valës së parë të nëpërkëmbjes dhe etiketimit. Në skenë dolën kuadrot e vjetra, kryesisht të rekrutuarit e hershëm të OZNA-s dhe UDB-së, tradhtarë me damkë, të cilët në kohën e autonomisë ose ishin veshur me lëkurë qengji, ose ishin mënjeluar nga skena politike. Vërsulja e tyre kundër rinisë së popullit të vet ishte e turpshme, por njëkohësisht edhe pa ndonjë rezultat, sepse rikuperimi i tyre në skenën politike do

të dalë i pamundshëm. Fadil Hoxha dhe të tjerët pas tij për pak që nuk veshin edhe një herë uniformat partizane, kësaj radhe për t'u futur në një luftë kundër popullit të vet pa ekuivoke. Mecenët e tyre politikë në Beograd, kryesisht nga radhët e nacionalizmit serb, pasi i shfrytëzuan deri në turpërim në mësymjet antishqiptare, në çastin kur u bënë të papërdorshëm, ua dhanë shqelmin dhe i nxorën nga *ëndrra jugosllave* pa pikë dinjiteti.

Kaq vlen të thuhet për fundin politik të veteranëve të lojalitetit jugosllav në Kosovë, por jo për fundin e tyre botëkuptimor, sepse rikuperimi i tyre do të ndodhë në intervale kohore përgjatë gjithë periudhës së mëvonshme, deri në ditët e sotme.

Bërja utilitare e kombit kosovar

Por si ndodhi rikuperimi i parë i luajalistëve të hershëm jugosllavë të Kosovës dhe të integruarve apo të bashkuarve të tjerë rreth idesë së jugosllavizmës, pas katastrofës që pësuan më 1981? Në të vërtetë, ajo ishte një katastrofë e dyanshme, sepse, më një anë, ata prej vitesh i kishin këputur të gjitha lidhjet e komunikimit normal me popullin e vet, ndërsa, më anë tjetër, Jugosllavia e idealeve të tyre i kishte dëbuar në mënyrë tepër cinike dhe fyese. Pra, kishin mbetur pa asnjë mbështetje. Për popullin e vet ata kurrë nuk kishin pasur konsideratë, madje e kishin urreyer atë, ose e kishin konsideruar të denjë vetëm sa për të ushtruar pushtetin, ose për të siguruar privilegjet mbi kurrizin e tij. Por, gjithsesi, Jugosllavia ishte dhembja e tyre e madhe, sepse ata, për shkak të identitetit të luhatshëm, ose për shkak të inferioritetit; për shkak të shërbimeve të mëdha

që i kishin bërë asaj, të shpirtit vasal apo mercenarizmit, shtetin e sllavëve të jugut e kishin parë si të përjetshëm, si identifikim, si emblemë, si strehë, si azil, si mburojë, madje si ideal. Dëbimi i tyre nga Jugosllavia, nga Beogradi, nga gjezdisjet në Terazia dhe nga shëtitjet në Kalemekdan, sikundër edhe përplasja e dyerve përpara fytyrës nga miqtë e tyre të dikurshëm sllavë të të gjitha republikave, bashkë me kthimin e detyrueshëm në Prishtinën provinciale, të gjitha këto do t'i ngajjnë me një *farsë tragjike*, e cila u ndodhë të gjithë shërbëtorëve të padinjetshëm të kësaj bote.

Në të vërtetë, vitet '80 në Kosovë, veçmas në gjysmën e dytë e prapa, dukej sikur ishin të mbaruar për të nxjerrë në sipërfaqe çdo ditë një konfuzion të ri politik. Fillimisht luajalistët jugosllavë u përpoqën të bënin hapin e parë të rikuperimit, duke e goditur vetë me ashpërsinë më të madhe nacionalizmin shqiptar dhe duke u bërë bashkëpjesëmarrës në euforinë antishqiptare, e cila shpërtheu anë e kënd Jugosllavisë. U gjunjëzuan dhe u skllavëruan, pështyn veten në surrat dhe përfolën e shanë gjenezën e vet dhe origjinën me zë të lartë, vetëm e vetëm që të fitonin edhe një herë "të drejtën" për të qenë të nënshtruar. Si e kryen këtë mision të shëmtuar dhe si u bënë të urryer dhe të mjerë para popullit të vet, njëri pas tjetrit u flakën si të papërdorshëm. Në të vërtetë, fillimisht u futën në betejën e klaneve të brendshme, për disa vjet e zhvilluan luftë brenda llojit, sakrifikuan të gjithë ata që kishin sadopak integritet moral dhe, në vitet vijuese u zëvendësuan me gjeneratën e dytë të luajalistëve. Nëse gjenerata e parë kishte qenë e rekrutuar nga OZNA që në kohën e LNÇ-së, gjenerata e dytë, që nga i pari e deri në të fundit, ishte e rekrutuar nga UDB-ja. Duke qenë shumica syresh agjentë të sigurimit të shtetit, ata vazhduan fushatën e egër të

diferencimit ndaj të gjitha shtresave shoqërore, por sulmin më të ashpër dhe më të paskrupullt e ndërmorën kundër inteligjencies krijuese dhe universitare. Disa nga këta burra edhe sot mund t'i takoni gjithandej rrugëve të Prishtinës, ndërsa nuk u vjen turp aspak për atë që kanë bërë në një kohë jo shumë të largët.

Gjatë këtyre viteve për herë të parë u shfaqën në skenën intelektuale të Kosovës *trashëgimtarët* e veteranëve të lojalitetit jugosllav. Çuditërisht ata fituan terren shumë shpejt, gjë që bënte me dije se nuk ishin të paktë njerëzit në Kosovë, të cilët binin dhe zgjoheshin me *ëndrrën jugosllave*. Tashmë ata ishin kthyer në iluzionistë, sepse do të mbeten ndër të fundit në krejt Jugosllavinë, që do të heqin dorë nga idetë e jugosllavizmës. Këta trashëgimtarë të veteranëve të lojalitetit jugosllav, ashtu sikundër mund të pritej, së pari fituan terren duke synuar të rikthenin në agjendë vlerat burimore të politikës jugosllave të periudhës së Titos, siç ishte barazia e kombeve dhe e kombësive, që iu leverdiste më së shumti kosovarëve të anatemuar. Krahas kësaj, duke pasur biografi dhe gjenealogji krejtësisht të pastër jugosllave, ata guxuan të shqiptonin kritika të vockla, gjithsesi jo ndaj parimeve, por ndaj praktikave politike të fushatave antishqiptare, gjithnjë duke ndjekur parimin tashmë të sprovuar mirë: njëqind herë godite nacionalizmin në radhët e kombit tënd, një herë në radhët e kombeve të tjera. Në hapësirën jugosllave paraqitja e këtyre trashëgimtarëve botëkuptimorë (ndonjëherë edhe biologjikë) të veteranëve të lojalitetit jugosllav nuk do të thoshte asgjë, sepse ata do të vazhdojnë edhe më tej avazin e vjetër të histerisë antishqiptare, ndërkohë që në Kosovë, bashkë me paraqitjen e tyre në skenën mediale, do të lind idea e hershem dhe e pavërejtur e rikuperimit dhe të ringritjes së klaneve të të integruarve në Jugosllavi.

Sikundër e thamë, nga fundi i viteve '80, Kosova u përfshi nga një konfuzion i paparë politik, sepse askush që merrej me politikë në këtë vend nuk ishte në gjendje t'i printe ndonjë procesi, por merrej vetëm me pasojat e asaj që ndodhte në Beograd ose gjetiu në Jugosllavi. Udhëheqjet politike të Kosovës ndërronin njëra-tjetrën, përdorëshin për një kohë të shkurtër dhe flakeshin tej. Ndodhin edhe shumë absurditete politike, në qendër të të cilave ende ishin luajalistët jugosllavë, të cilët manipulonin popullin dhe bënë prej tij një popull politikisht palaço. Në të vërtetë, në fund të viteve '80 ata ia dalin ta mundin nacionalizmin burimor shqiptar dhe nga kosovarët arrijnë të bëjnë *komb jugosllav*, pa asnjë atribut tjetër. Në këtë rrethanë, ideja e *shqiptarizmit kosovare*, e tillë siç ishte, e degjeneruar në shumë pika, ishte ide krejtësisht autonome, kryekëput kosovare, sikundër që edhe lëvizjet politike ishin krejtësisht kosovare, autoktone, pra nuk njihnin asnjë dualizëm me ndikim nga Shqipëria. Mund të ketë zgjatur disa muaj, një vit, dy, por *kombi kosovar* ishte bërë politikisht vetëm në ato rrethana. Ishte komb jugosllav? Doemos, sepse nëpër manifestime publike dalin rreth një milion njerëz, të cilët mbajnë të lidhur njëri pas tjetrit flamurin shqiptar dhe flamurin jugosllav.

Kombi kosovar, i themeluar në atë rrethanë dhe funksional vetëm për një përdorim, ishte komb jugosllav, sepse, qoftë edhe për pak çaste, kishte hequr dorë nga integralizmi shqiptar dhe ishte futur me krejt qenien e tij në lojërat politike jugosllave. Ishte komb jugosllav, sepse me krejt qenien e tij mbështeste udhëheqjen e vet politike krejtësisht pro-jugosllave, autonomiste, e cila natën takohej me Milosheviqin, ndërsa ditën manifestonte kundër tij. Ishte komb jugosllav, sepse mbështeste minatorët e "Trepçës", që bënë grevë urie qindra metra nën tokë, për të mbrojtur të

drejta politike minimale në një bashkësi të kombeve që tashmë i refuzonte me përçmim. Kosovarët për pak kohë ishin bërë komb më vete dhe komb jugosllav, sepse i kishin ngatërruar në mënyrë të tmerrshme të gjitha gjërat, patriotizmin shqiptar, idealet kombëtare, amendamentet kushtetuese, ndryshimet kushtetuese të Serbisë, autonominë, madje edhe moralin politik. Edhe Shqipëria, e gjendur në zgrip të rënies së sistemit, ishte e kënaqur me atë që ndodhte në Kosovë, sepse për herë të parë një lëvizje politike në Prishtinë zhvillohej pa asnjë ndikim nga Tirana.

Për disa muaj *kombi kosovar* i kreu disa misione të shpejta: një herë vetë i miratoi ndryshimet kushtetuese të Serbisë, me të cilat Kosovës i merreshin atributet e autonomisë, pastaj vetë u ngrit kundër këtyre ndryshimeve; shpalli të ashtuquajturën deklaratë kushtetuese, kushtetutën e Kaçanikut, nxori njerëz në rrugë që të vriteshin radhë-radhë etj. Por çfarë ndodhi në të vërtetë? Dhe kush ishin këta njerëz, që e manipulonin aq keq një popull të tërë? Ishin autonomistët, ata që idetë politike i kishin formuar nën ndikimin e madh të titizmit dhe të Jugosllavisë ideale, si bashkësi e përsosur e popujve të barabartë. Përveç se të mbrujtur me ide politike titiste dhe jugosllave, ata, shumica syresh, për vite me radhë kishin qenë bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit, pra të UDB-së, e cila në Kosovë kishte krijuar një kontingjent të jashtëzakonshëm spiunësh të vegjël dhe të mëdhenj. Ishte kjo gjenerata e dytë e luajalistëve jugosllavë, të cilët ishin përpunuar nga shërbimet e sigurimit që në bankat shkollore, pastaj si studentë, pastaj si aktivistë të LKJ-së, pastaj si funksionarë të vegjël ose të mëdhenj, në administratën qendrore ose lokale, në organizata punuese gjithandej Kosovës. Ata i organizuan tubimet masive me fotografitë e Titos në krye të kolonave. Ata u bënë bartës të proceseve politike në LKJ dhe në të gjitha organet e pushtetit

qendror dhe lokal, nëpër kuvende, nëpër këshilla ekzekutive, nëpër të gjitha dikasteret. Ta zëmë, është i njohur fakti se të ashtuquajturën deklaratë kushtetuese, sikundër edhe kushtetutën e Kaçanikut e shpallën delegatët e Kuvendit të Kosovës të zgjedhur një për një me miratimin e UDB-së. Pra, në Kosovë, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, jugosllavizma kishte triumfuar. Lëvizja politike nuk kishte synim avancimin e të drejtave politike të shqiptarëve, pra jo “republikë me të drejtë shkëputje” siç kishte qenë më 1968 dhe 1981, por mbrojtjen e autonomisë së reduktuar, atë që vetë klasa e re politike e Kosovës, nën tryshninë e Beogradit, e kishte minimalizuar deri në zhvlerësim.

Që të konstituohej dhe të bëhej komb tamam, kombi kosovar kishte zgjedhur momentin më pak të përshtatshëm, sepse, sipas logjikës së gjërave, ai duhej të ishte komb jugosllav, *komb komunist*, ndërkohë që Jugosllavia dhe komunizmi kishin marrë tatëpjetën dhe rënien pa kthim. Më anë tjetër, ky *komb politik* mbahej pas idesë autonomiste dhe jo të idesë indipendentiste. Pra, ishte komb që nuk kërkonte mëvetësi dhe pastaj bashkim të barabartë në një “bashkësi kombesh”, siç ishte Jugosllavia, por ishte komb që kërkonte strehë ku të futej, kërkonte Jugosllavinë që ta pranonte, me kusht që ajo Jugosllavi edhe më tej të ishte titiste, të ishte komuniste në variantin e saj dhe autonomia e Kosovës, edhe pse tashmë e reduktuar, ta konsideronte si zgjidhje e përhershme dhe të qëndrueshme.

Në përgjithësi, kjo lëvizje politike në Kosovë do të jetë *johistorike*, një lëvizje që nuk do të prodhojë asgjë të qartë dhe asgjë të qëndrueshme, përveç se do të shumëzojë ndërvetshëm autonomistët dhe do t'i inkurajojë ata për rigjenerim dhe ringritje, sa herë që për këtë paraqitej ndonjë situatë e volitshme.

Recidivizmi autonomist

Sapo u shfaqën shenjat e parë të pluralizmit politik, lindi edhe ideja se Jugosllavia mund të shpëtohej me anë të kësaj forme të organizimit politik, duke pandehur se Jugosllavia komuniste në rënie e sipër mund të zëvendësohej me një Jugosllavi demokratike më të qëndrueshme. Trashëgimtarët biologjikë dhe botëkuptimorë të luajalistëve jugosllavë në Kosovë ishin ndër të parët që e përvetësuan këtë ide, duke themeluar një të ashtuquajtur “union demokratik jugosllav”, me mbështetës nga një “elitë” autonomiste, kryesisht të tillë që ishin zhvendosur nga Beogradi në Prishtinë, bashkë me idetë, botëkuptimet, mënyrën e jetës, madje edhe gjuhën e ngatërruar shqipe, të cilën kurrë nuk do ta mësojnë tamam. Por ideja e shpëtimit të Jugosllavisë nuk do të funksionojë, kështu që autonomistët bënë lëvizjen tjetër të radhës: futën dhe fuqizuan krahun e tyre në Lidhjen Demokratike të Kosovës, pastaj themeluan ca “partijëza” të tjera, organizuan lëvizje të ndryshme politike, tubime masive, “varrosje të dhunës”, ndezje qirinjsh, zhurmë me çelësa, me tenxhere, vetëm me një synim, që ta rikuperonin veten dhe situatën grvide ta kthenin në favor të *trashëgimtarëve të ligjshëm* politikë të Kosovës. Ata kishin bindje se Kosova ishte e tyre, e tillë siç kishte qenë gjithmonë, vetëm se tani duhej ndërruar mënyrën e qeverisjes së saj. Nëse dikur ishte qeverisur me “pushtetin populluer” dhe më vonë me institucione autonomiste, tani mbi Kosovën mund të ushtrohej *pushteti moral* i po asaj proveniencë politike dhe ideologjike, vetëm me një kostum tjetër, më në modë dhe i përshtatur për klimën e re politike.

Ata u trimëruan jashtëzakonisht shumë dhe pandehen se e kishin marrë situatën në dorë, kur vërejtën se në

manifestime publike të “padëgjueshmërisë qytetare” mund të tërhiqnin me vete mijëra njerëz, madje tërë Kosovën. Ende vazhdonte atmosfera e homogjenizimit dhe, në një rrethanë të tillë, e gjithë Kosova dukej sikur merrte frymë me një komandë. Por me kalimin e ditëve, kur organizimi politik kërkonte sakrificë, guxim dhe përgjegjësi, veçmas kur padëgjueshmëria e tyre qytetare u gjend përball policisë së Miloshveiqit, ata u tretën, u zhdukën dhe, në këtë rrethanë, LDK-ja mbeste vetëm në të gjitha aktivitetet politike, me Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut prapa, i cili, pasi kalonte furtuna, vetëm se numëronte të vrarët dhe të plagosurit.

Që në ditët e para, që në themelim, autonomistët arritën të futnin eksponentët e tyre në LDK, në kryesi dhe në të gjitha instancat organizative, në forumin e gruas, të rinisë, nëpër degë dhe nëndegë, pra gjithandej. Ata ishin shumë fleksibilë dhe ne, edhe përkundër faktit se i identifikua shumë qartë, nuk arritëm asnjëherë t’i nxirrnim jashtë. Pse nuk arritëm asnjëherë t’i largonim nga strukturat e LDK-së, besoj se kanë qenë dy arsye: e para, sepse LDK nuk ishte e profilizuar qartë në pikëpamje ideore, pra ishte një lëvizje gati gjithëpërfshirëse, një konglomerat njerëzish të të gjitha profileve, biografive dhe interesave politike; dhe, e dyta, sepse autonomistët, brenda dhe jashtë LDK-së, bënë koalicion të shpejtë dhe efikas me marksist-leninistët dhe ish-të burgosurit politikë dhe, së bashku, ndërmorën një fushatë kundër asaj pjese të LDK-së që konsiderohej autentike. Por gjithsesi profili më i çoroditur politik i asaj kohe do të jetë Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ), ku ishin mbledhur në një vend ish-të burgosur politikë dhe persekutorët e tyre (madje edhe ata që iu kishin hequr dajak), avokatë që dikur kishin qenë gjyqtarë dhe që iu kishin shqiptuar me qindra vjet burgim po atyre

me të cilët rrinin pranë e pranë në të njëjtin forum “për liri dhe të drejta”, pastaj spiunë të OZNA-s dhe të UDB-së, pastaj patriotë të dëshmuar, intelektualë në zë etj. Të tillë e donin organizimin politik autonomistët, sepse vetëm në një zallamahi të tillë ata shpëtonin pa u etiketuar.

Puna politike me autonomistët u paraqit tejet e vështirë në fillim të viteve '90, por edhe më vonë. Ndër të tjera, ata morën edhe një mbështetje të fortë ndërkombëtare, sepse ky ishte kontingjenti që mbështeste mbetjen e Jugosllavisë dhe Kosovën në kuadër të saj, ndërkohë që po këtë ide e kultivonte edhe faktori ndërkombëtar. Më vonë, me shpërbërjen e Jugosllavisë, autonomistët ishin të gatshëm për të gjitha zgjidhjet parciaisë, për të gjitha modalitetet, përfshirë edhe mbetjen e Kosovës nën Serbi. Më anë tjetër, ata paraqiteshin të pasigurt në çdo veprim, sepse, përmes lidhjeve të vjetra, të cilat vazhduan t'i mbanin funksionale, dekonspironin çdo nismë politike. Në kuadër të LDK-së, ata kishin gjetur një mbështetje të fuqishme të vetë Ibrahim Rugovës, i cili, ndërsa vetë i konfirmonte lidhjet që krahu autonomist mbante me serbët dhe me Beogradin, në anën tjetër bëhej mbrojtës i tyre i pakursyer, sapo të tjerët ndërmerrnin ndonjë veprim demaskimi. Akoma më e vështirë paraqitej puna në terren, për shkak të këtij krahu brenda LDK-së, sepse jo rrallë bëheshin akuza të drejtpërdrejta, me emër dhe mbiemër dhe me dëshmi konkrete, për veprimtarinë e dyshimtë ose punën prej spiuni të ndonjërit prej anëtarëve të kryesisë.

Për shkak të zhvillimeve që morën hov në vitet '90, profilizimi politik në Kosovë mbeti në gjysmë të rrugës dhe më nuk do të përfundojë kurrë. U bë një homogjenizim i jashtëzakonshëm i popullsisë dhe një diferencim politik dhe botëkuptimor brenda saj ishte pothuajse i pamundur. Megjithatë, nën trysinë politike dhe publike të krahut

autonomist, atëbotë Kosova do të jetë e detyruar të futet në një sërë bashkëbisedimesh politike me Serbinë, që nuk synonin kurrfarë zgjidhjeje, vetëm konfirmonin mbetjen e Kosovës në kuadër të Serbisë dhe autonomistët i bënin faktor politik vendimmarrës. E njëjta gjë, afërsisht, mund të thuhet edhe për bisedimet e Rambujesë: autonomistët e përfaqësuar gjerësisht si të infiltruar në njërin krah ose në krahun tjetër politik, ndonëse nuk përfaqësonin askënd, në ato bisedime do të shërbenin si katalizatorë, respektivisht si amortizues të krahut nationalist. Realisht, me sjelljen e tyre *konformiste*, autonomistët tashmë e kishin përgatitur terrenin e brendshëm dhe të jashtëm që Kosova të mos dilte e pavarur, por limitet e saj të shkonin te një autonomi e vitit 1974.

U bë apo nuk u bë lufta, ndodhën apo nuk ndodhën bombardimet e NATO-s, u bënë apo nuk u bënë bisedimet e Vjenës, u shpall apo nuk u shpall formalisht pavarësia, ideja e një Kosove autonome, tani e modifikuar por që gjithnjë do ta ketë limit të paarritshëm pavarësinë e plotë dhe funksionale, çuditërisht do t'i mbijetojë të gjitha sfidat, sepse është një ide kompatibël me interesat e një pjese të rëndësishme të faktorit ndërkombëtar në Ballkan, dhe, më anë tjetër, nuk cenon baraspeshën politike, të vendosur që më shumë se një shekull dhe këndeje, ku Serbia e dominon këtë hapësirë politikisht dhe ekonomikisht. Autonomistët, në rrethanat e reja, do t'i japin lëndë të mjaftueshme Ahtisaarit që ai të përcaktojë një status të *baraspeshuar* të Kosovës dhe të kërkojë decidivisht që në kushtetutën e saj të përfshihet pamundësia e bashkimit me dikë tjetër, as bashkimit të dikujt tjetër me të. Por kjo ka pak rëndësi, karshi faktit se Kosova u bë një *shtet i idealeve politike dhe historike të askujt*. Autonomistët tradicionalë dhe mbështetësit e tyre, që të mbeteshin të faktorizuar edhe pas

mbylljes politike të çështjes së Kosovës, duke u ekspozuar si tolerantë dhe të moderuar karshi faktorit ndërkombëtar, pikërisht me ndihmën e këtij faktori me pushtet të vazhdueshëm politik dhe të parasë, arritën të futnin në agjendën e diskutimeve publike dy çështje themelore: e para, çështjen e kombit, respektivisht të identitetit kosovar; dhe, e dyta, çështjen e integritetit, respektivisht rrugën e integritetit të Kosovës në Europë, përmes Beogradit apo përmes Tiranës.

PJESA II

IDENTITETI KULTUROR

IDENTITETI FETAR

Mbi konceptet dhe diskutimin

Shqiptarët në përgjithësi, e për pasojë as kosovarët, në identitetin e tyre historik nuk kanë të përfshirë ndonjë ngjarje fetare. Madje, do të gjenden shumë njerëz në botën shqiptare që nuk do të jenë të gatshëm të pranojnë ndonjë rol të fesë në konsolidimin identitar, më herët ose më vonë gjatë historisë. Gjithsesi më të shumtë janë ata që mendojnë se feja, veçmas fakti se shqiptarët ishin të tri besimeve të ndryshme fetare, ka qenë një nga shkaqet e vonësive tona të mëdha në histori, përfshirë edhe zgjidhjet jo fatlume që ka marrë çështja shqiptare në disa raste të veçanta. Por, derisa në shqyrtim historik problemi i fesë të shqiptarët ka marrë disa shpjegime të vlefshme, të themi konsensuale, në vështrimin e aktualitetit të sotëm politik, madje edhe të identitetit, gjërat paraqiten mjaft të ngatërruara dhe ndonjëherë me tendencë ashpërsimi. Në të vërtetë, numri i atyre që kërkojnë revidim botëkuptimor, madje edhe korrigjim të postulateve historike për fenë dhe rolin e saj është gjithnjë e më i madh, ndërkohë që edhe zërat për aktualitetin fetar të shqiptarët kanë filluar të bëhen disonantë, duke kërkuar më shpesh dhe më me forcë që feja e shqiptarëve të zhvendoset nga historia, ku kishte qëndruar pothuajse gjatë tërë shekullit XX, dhe të rishfaqet e plotë dhe aktuale në ditët e sotme. Pra, ideja se problemet tona fetare i takojnë historisë dhe se ato nuk do të kenë ndikim në

zhvillimet aktuale politike, duket se nuk ka marrë një mbështetje të qëndrueshme as në mendimin shqiptar, sikundër që nuk tërheq argumente të mjaftueshme as nga mendimi kontemporan. Feja në botë është duke u ridimensionuar, është duke marrë tjetër domethënie dhe një rol tjetër në zhvillimet politike të shekullit XXI. Ky funksion i ri i fesë nuk ka asnjë arsye të mos ketë refleksione edhe në botën shqiptare, pozitive apo negative qofshin ato.

Trajtimi marksist i fesë përgjatë gjysmës së dytë të shekullit XX ka lënë pasoja të ndjeshme në botën shqiptare, jo vetëm për shkak të interpretimeve *materialiste* dhe të njëanshme që e karakterizon këtë mënyrë trajtimi, por ndoshta më shumë për shkak të një reaksioni që u shkaktua, apo reagimi në sens të kundërt, sapo trajtimi marksist u tërhoq nga agjenda, si e vetmja mënyrë e shqyrtimit të problemeve fetare ndër shqiptarët. Për të kompensuar vakuumin e krijuar, provenienca fetare ndër ne u bë agresive, madje ndonjëherë duke kërkuar ta dominojë gjithë mendimin shqiptar, ose ta keqorientojë diskutimin për fenë. Këtij agresiviteti i shkuan në favor edhe zhvillimet jashtëzakonisht atipike në rrafshin global, ku ndodhën përmbysje të mëdha politike dhe botëkuptimore, të cilat në prapavijë kishin fenë apo diskursin fetar.

Më anë tjetër, në kontekst të zhvillimeve politike jashtëzakonisht dinamike, shqiptarët e Kosovës u gjenden përball një mori paragjykimesh dhe damkash recidiviste, të prodhuara dhe të shpërndara nga propaganda serbe, e cila kishte për synim ta minimizonte përkrahjen perëndimore për Kosovën, duke u përpjekur t'i jepte karakterin e konfliktit fetar ose të konfliktit të civilizimeve një lufte që zhvillohej vetëm për të drejtat e njeriut dhe për të drejtat politike. Në të vërtetë, rreziku për shqiptarët, në raport me fenë, ishte dy planesh: e para, që të merrte formë dhe të

thellohej një *keqkuptim planetar* për shqiptarët; dhe, e dyta, që vetë shqiptarët të binin në grackën e këtij keqkuptimi. Duket se kjo ka qenë arsyeja përse ndër shqiptarët në përgjithësi, por ndër shqiptarët e Kosovës në mënyrë të veçantë, tema e fesë nuk u diskutua pothuajse asnjëherë në mënyrë eksplicite, por u përdor aty-këtu në kuadër të trajtimeve për historinë, për kombin, për identitetin, për politikën, për civilizimin etj. Mbase ky diskutim për fenë e pësoi deformimin më të madh kur, në kuadër të diskutimeve për identitetin kombëtar të shqiptarëve, u bë objekt polemikash mujshore ndërmjet personaliteteve të jetës kulturore, të cilët nuk morën parasysh ndjeshmërinë e temës, por u futën në diskutime me një polarizim të ashpër konceptual, duke harruar se tema e fesë dhe e identitetit nuk mund të bëhen objekt armiqësish personale, sepse janë tema tepër të ndjeshme, sa të durojnë interpretime tekanjoze. Diskutimet e këtilla nuk nxorën ndonjë shpjegim të vlefshëm. Përkundrazi, duke mbetur në nivel të polemikave joparimore, e hoqën temën e fesë nga agjenda e shqyrtimeve sadopak korrekte dhe e bënë temë “të rezervuar” vetëm për keqkuptime ose mosmarrëveshje.

Pra, çështja e parë që shtrohen në diskutimet tona për fenë, ka të bëjë me mënyrën e qasjes. A është feja për ne një temë tabu, e cila nuk duhet të preket, sepse ende nuk jemi të gatshëm të ballafaqohemi me pasojat e saj? Apo, pyetja mund të shtrohet edhe më ndryshe: A kemi ne shqiptarët mosmarrëveshje të tilla fetare, sa të na leverdis më shumë heshtja se sa trajtimi i ngutshëm i kësaj teme? Pastaj: A është feja te shqiptarët çështje e trashëgimisë historike apo e civilizimit bashkëkohor? A është feja te ne çështje identiteti, pra diçka e brendshme, që ka të bëjë me kosntalacionin tonë identitar, apo më shumë çështje perceptimi, diçka e jashtme, që lidhet me diskursin dhe interpretimin? Çfarë është

autentike, tradicionale, në perceptimet tona fetare dhe çfarë është e importuar, e bartur nga lëvizjet politike, civilizuese dhe fetare të përbotshme? Dhe, së fundi, a ka një dallim në trajtimin, në perceptimin dhe në ndijimin fetar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë?

Perceptimet historike

Në aspektin e trajtimit historik nuk mund të themi se i kemi zgjidhur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fenë. Kemi ende shumë pyetje të mbetura pezull, të cilat kërkojnë përgjigje më eksplicite, në mënyrë që të mos bëhen objekt spekulimesh dhe keqinterpretimesh me pasoja largvajtëse. Me historinë ne edhe ashtu kemi shumë çështje të hapura, të trajtuara shkel e shko, pa përqendrim, pa metodë dhe pa dije historike. Por feja, mbi të gjitha, ka pësuar në këtë trajtim, sepse historiografia shqiptare, përveç që ka kaluar një periudhë të vështirë të kufizimeve ideologjike, po gjatë asaj kohe ka përjetuar edhe një “kontakt aksidental” ndërmjet ideve të rilindësve dhe ideologjisë diktatoriale të periudhës së socializmit.

Rilindësit shqiptarë, që të mund të bëheshin të mosvarur dhe të mund të bënin shtet, ndër vështirësitë e para që duhej të kapërcenin, ishin problemet fetare. Njësinë kombëtare ata e projektuan si *mbifetare* dhe në këtë pikë ata arritën sukses të jashtëzakonshëm: toleranca fetare u bë rregull e jetës në të gjitha bashkësitë dhe vendbanimet shqiptare. Mirëpo, është gabim të thuhet se shqiptarët në këtë periudhë nuk manifestuan identitet fetar, se atë identitet e braktisën për llogari të interesave kombëtare. Jo, ata nuk braktisën asgjë. Ata vazhduan të bënin jetën e tyre të

ndarë në bashkësi të veçanta fetare, po me atë komunikim dhe moskomunikim që kishin pasur më herët. Të vetmen gjë që shqiptarët kishin arritur ta bënin më mirë se shumë të tjerë në Europën fanatike ishte tejkalimi i konfliktit fetar.

Në të vërtetë, rilindësit nuk e shpikën tolerancën fetare te shqiptarët, ata e gjetën aty, por idenë e kombit e ndërtuan mbi të tjera postulate, siç ishte gjuha e përbashkët, hapësira e përbashkët, historia e hershme e përbashkët, trashëgimia kulturore e përbashkët (mitet, legjendat etj.), mentaliteti i përbashkët etj. Pra, fenë e lënë të paprekur, ashtu siç e gjetën, duke hedhur mbi të më shumë tolerancë, mirëkuptim dhe komunikim të ndërvetshëm. Ata askujt nuk ia mohuan fenë, as besimin fetar, këtë nuk mund ta bënin qoftë për shkak të ambientit që do t'i refuzonte në mënyrë të ashpër, por edhe për shkak se shumë syresh ishin me shkollim fetar superior. Më anë tjetër, do pasur në vëmendje se rilindësit asnjëherë nuk proklamuan ateizmin si mënyrë për të tejkaluar dallimet fetare. Ata proklamuan idenë e kombit që ndërton bashkimin jo mbi rrafshimin e dallimeve, por mbi *përbashkësinë mbifetare*, pra jo duke relativizuar ose duke shmangur fenë, por duke e tejkaluar atë mbi parimin e një ideje sipërore, se të gjithë njerëzit janë të barabartë para Zotit. Rilindësit nuk synuan ta shmangnin fenë nga jeta shqiptare, ata synuan ta shmangnin fanatizmin fetar dhe asgjë më shumë se kaq. Kredoja e tyre se *Fe e shqyptarit asht shqyptaria* nuk proklamonte as ateizmin dhe as braktisjen e fesë në emër të idealeve më të larta, siç është shpjeguar dhe vazhdon të shpjegohet gabimisht. As vendosjen e idesë kombëtare mbi bindjen fetare, ose renditjen e kombit mbi fenë, apo në pedestal më të lartë. Këtë edhe mund ta bënte Pashko Vasa, sepse idetë e tilla do të ishin në konkordancë të plotë me kohën dhe me utilitarizmin kombëtar. Por ai nuk e bëri këtë dhe nuk kemi

pse t'ia atribuojmë një gjë që nuk e ka. Ai idenë e dallimeve fetare ndër shqiptarët nuk e lidh me besimin fetar, pra me bindjen fetare, me diçka të brendshme, por me *manifestimin jashtësor*.

Ishte pikërisht kjo kredo e rilindësve, e cila u keqpërdor nga diktatura komuniste dhe ideologët e saj, përfshirë edhe historinë e letërsisë, duke krijuar atë "kontaktin aksidental" ndërmjet ideve të rilindësve dhe ideologjisë komuniste. Kredoja e rilindësve, e pranueshme ose jo, funksionale ose jo, qëndronte në rrafshin e ideve. Ajo nuk përbënte ideologji, sepse nuk ishte kodifikuar dhe aq më pak kishte instrumente të zbatimit të dhunshëm. Pra, ajo qëndronte në rrafshin e pranimit ose mospranimit të vullnetshëm dhe krejtësisht të lirë të individëve që i referoheshin kësaj problematike. Ndërkaq, duke u nisur nga parimet e marksizëm-leninizmit, ideologjia komuniste, si në shumë raste të tjera, bëri një shartim krejtësisht të panatyrshëm të ideve të rilindësve, fillimisht duke ua atribuuar atyre një korpus idesh që ata nuk i kishin dhe nuk mund t'i kishin: rilindësit nuk thanë asnjëherë se feja është e dëmshme për shqiptarët, respektivisht se "feja është opium për popullin" dhe se për shkak të unitetit kombëtar duhej braktisur besimin fetar. Të shumtën ata iu referuan fatit të keq historik, që i ndau shqiptarët në tri fe dhe, për pasojë, ua bëri të vështirë funksionimin e tyre si një tërësi kompakte etnike. Ishte ky një instrumentalizim i ideve të rilindësve, pra, që zuri vend në propagandën ditore kundër fesë në Shqipëri në kohën e diktaturës, ndërsa në Kosovë, më një anë, duke ardhur bashkë me korpusin e ideve enveriste, krijoi ekzemplarët e rrallë të ateistëve dhe, më anë tjetër, duke gjetur terren dhe duke funksionuar bashkë me idetë e tjera iluministe të rilindësve, në njëfarë mase e largoi Kosovën nga tradita fetare konservative.

Nga pikëpamja fetare, në këtë kuadër, deri-diku ka mbetur pa marrë një shpjegim të vlefshëm edhe çështja e Skënderbeut. Është e njohur se rilindësit, që ta bënin hero kombëtar të gjithëpranueshëm për shqiptarët, e minimizuan karakterin fetar të luftërave të tij. Më pastaj, në rrethana të tjera, kur shqiptarët u etiketuan si orientalë, mbështetës të Turqisë, aziatikë etj., dhe kur duhej të bënin Shqipërinë duke i tejkuluar këto paragjykime, ata i mëshuan faktit se Skënderbeu kishte bërë një luftë në dobi të krishterimit, se ishte mbështetur nga papa dhe se ishte quajtur *Atlet i Krishtit*. Kjo histori e sforcuar irritoi fanatikët shqiptarë myslimanë, të cilët një herë sikur nuk kishin qejf ta zinin në gojë Skënderbeun dhe dikur filluan të mërmëritnin nën zë se Skënderbeu nuk është figurë integrale shqiptare, se ai shkakton ndasi fetare, se ai është hero i Shqipërisë, por jo edhe i shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë. Në të vërtetë, me ngritjen e monumenteve të Skënderbeut në Prishtinë dhe Shkup, shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë nuk *importuan identitet*, siç thuhet me ndonjëherë me dashaligësi, por në njëfarë mënyre ata, përveç që ripërkufizuan hapësirën tyre etnike dhe i mëshuan fuqishëm monolitizmit të tyre kombëtar, përkufizuan edhe referencat e tyre ndaj qëndrueshmërisë së Skënderbeut si figurë historike kombëtare edhe mbifetare. Ky ripërkufizim i rolit të Skënderbeut në botën shqiptare bëri që zërat kundër tij të bëhen më të paktë në Kosovë dhe në Maqedoni, ndërkohë që Shqipëria “e brendshme” po përballet me *teprinë identitare* dhe, në disa raste, Skënderbeu atje përdoret edhe për skandale të vogla letrare ose pseudointelektuale.

Ndikimet shkombëtarizuese

Çështja e tretë, që po kështu lidhet me historinë, ka të bëjë me një tezë që është hedhur së pari në Kosovë, në qarqet e disa historianëve, dhe që andej, pak nga pak, është zhvendosur në rrethe fetare, ose gjysmë fetare, gjysmë shkencore apo intelektuale. Sipas tyre, islamizimin më të madh të shqiptarëve të Kosovës në Perandorinë Osmane duhet parë në një këndvështrim pozitiv, sepse ka qenë pikërisht ky konvertim që i ka ndihmuar ata të ruajnë identitetin dhe kombësinë, kundrejt sllavizimit, i cili i asimiloi në masë të madhe shqiptarët e krishterë në Kosovë dhe në viset përreth saj. Kjo tezë zakonisht ilustron me dy fakte: e para, me shpërnguljet masive të shqiptarëve të krishterë, bashkë me serbët, pas luftës austro-turke dhe pas kryengritjes së vitit 1690, që domethënë një model i zhbërjes së shpejtë të substancës shqiptare; dhe, e dyta, zhdukja dhe asimilimi i pakthyesëm i një numri të madh i shqiptarëve të krishterë në Maqedoninë Perëndimore dhe në Kosovë.

Natyrisht, një kundrim i këtillë i konvertimit fetar dhe i historisë në përgjithësi është pak e besueshme se mund t'i qëndrojë kritikës shkencore. Janë po ata zëra, ose të ngjashëm me to, që thonë se Skënderbeu e ka dëmtuar substancën shqiptare me luftërat e tij kryeneçe kundër një perandorie të madhe, siç ishte Turqia. Po të gjykohet kështu, realisht deformohet krejt kuptimi i luftërave për liri, të shqiptarët dhe të mbarë popujt e botës, e para, dhe, e dyta, që është akoma më e rëndësishme për shqyrtime dhe perceptime studimore, *koha historike* ngatërrohet me *kohën subjektive*. Edhe në rastin e konvertimeve fetare, mungesa e analizave objektive dhe mbështetja të perceptimeve subjektive kanë çuar tek idetë me anim fetar dhe me konotacion aktual,

që domethënë se ka ndodhur edhe një insturmentalizim i historisë për efekte joshkencore.

Pra, nuk qëndron fakti se konvertimet në islam, që erdhën bashkë me pushtimin turk, e kanë ruajtur substancën shqiptare, veçmas në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, sepse, përveç dëmit tjetër disa shekullor që u është bërë shqiptarëve nga ky pushtim, vetëm shpërnguljet nga këto hapësira në viset e ndryshme të Perandorisë Otomane kanë çuar numrin e shqiptarëve në Turqinë e sotme mbi dyfishin e numrit të tyre në Kosovë dhe Maqedoni, marrë të dyja së bashku. Më anë tjetër, janë shqiptarët e konvertuar në islam që kryesisht kanë prodhuar minoritetin turk në qendrat urbane të Kosovës dhe të Maqedonisë, një minoritet plotësisht i trilluar, i shpikur në periudhat e ish-Jugosllavisë, vetëm e vetëm për të dëmtuar substancën shqiptare. Për këtë nuk ka nevojë të na bindë njeri, këtë e kemi parë më sytë tanë, pothuajse në të gjitha rrethanat, madje deri në kohët e vona, përfshirë edhe favorizimet e sotme që i bëhen minoritetit turk në Kosovë, qoftë për shkak të idesë së dhunshme të Kosovës si shtet multietnik, apo të vasalitetit politik dhe ekonomik që ka shteti i ri i Kosovës ndaj Turqisë së sotme agresive.

Se islamizimi nuk krijoi mbrojtje për substancën shqiptare kundrejt sllavizmit e dëshmon edhe një fakt tjetër: Në zonat ku shqiptarët patën kontakt me islamin e sllavizuar, dëmtimi i shqiptarëve mori përmasa të frikshme dhe për këtë mjafton të sjellim në vëmendje shembujt si Pazari i Ri (tani Novi Pazari), Tutinin, Rozhajën me krejt krahinën e Sanxhakut, të cilët në Lidhjen e Dytë të Prizrenit kishin përfaqësinë e tyre dhe kërkonin t'i bashkoheshin Kosovës. Pastaj, po këtu është Plava dhe Gucia, për mbrojtjen e të cilave shqiptarët bënë një luftë legjendare, gati njëqindvjeçare, për t'i humbur përfundimisht përmes

asimilimit. Apo Tivari. Të paktë janë ata të brezit të ri, që e dinë se Tivari ka qenë qytet shqiptar, ndërkohë që unë e mbaj mend, nga mesi i viteve '60 (para se të ndërtohej porti dhe të dyndeshin kolonizuesit e rinj), në Tivarin e Vjetër flitej shqip. Në zonat përreth Tivarit, në Zalef dhe në Tukemil, që më herët jetonte një popullsi sllave e islamizuar, e cila e vërshoi Tivarin, e sllavizoi në tërësi për një kohë të shkurtër, pastaj e humbi edhe vetë. Lidhja me Bosnjën dëmtoi dukshëm edhe substancën shqiptare në Ulqin, por ajo arriti të shpëtonte, për shkak të lidhjeve të forta që u krijuan me Kosovën. Edhe aktualisht, në Mal të Zi, janë shqiptarët myslimanë të zonës së Tuzit, të cilët, për arsye të një konflikti fetar të heshtur me shumicën katolike, po konvertohen në boshnjakë, megjithëqë të tillë nuk kanë qenë asnjëherë.

Më anë tjetër, nuk mund të mohohet fakti se *sllavizmi i shqiptarëve ortodoksë*, ndonjëherë edhe katolikë, duhet ta ketë dëmtuar shumë substancën shqiptare të zonave të kontaktit me sllavë, siç është Kosova dhe Maqedonia Perëndimore. Duhet pranuar se, historikisht, vetë shqiptarët e krishterë në këto hapësira kanë pasur identitet të dyzuar. Siç e kemi përmendur edhe më herët, pas luftës austro-turke të vitit 1690, bashkë me Arsenijen III u shpërngulën edhe një numër i konsiderueshëm shqiptarësh të krishterë, katolikë dhe ortodoksë së bashku, ndërkohë që Pjetër Bogdani, që e udhëhoqi këtë luftë, nga historianët serbë quhet Petar Bogdanoviq dhe thuhet se ka qenë "një serb, pasardhës i Bogdanit të Dushanit". E zëmë se serbët, sipas bindjes sonë tashmë të ngulitur, e kanë pasur gjithmonë tendencën e përvetësimit të vlerave të të tjerëve në Ballkan dhe se për këtë dëshmia më e mirë është Skënderbeu, ndaj të cilit gjithashtu kanë shprehur pretendime. Mirëpo, duket se në këtë rast bëhet fjalë për diçka tjetër. Është krejt e mundshme

se, pas ndarjes së kishës, Kosova ishte bërë *zonë e lëvizshme*, e cila dyndej herë në Lindje dhe herë në Perëndim. Kjo paqëndrueshmëri e kishës, sikundër edhe dëbimi shqiptarëve nga kishat serbe, siç thonë historianët, kanë sjellë si pasojë islamizimin në masë të shqiptarëve të mbetur pa mbështetje. Por, më anë tjetër, një islamizim i këtillë duhet të ketë sjellë edhe një përafrim të minoritetit shqiptar katolik dhe ortodoks me serbët e krishterë, pavarësisht se ata i takonin kishës lindore. (Interesant është edhe rasti i Shtjefën Gjeçovit nga Janjeva, të cilin bashkëvendësit e tij kroatë e njihnin si Gjeçoviq). Ndërkaq, duhet pranuar se shqiptarët u paraqitën të vonuar në ndërtimin e identitetit të tyre, i cili nuk u shfaq i gatshëm në shekullin XIX, siç përfytyrohet tani, por përfshinte gjithë periudhën e mesjetës së vonë, identitet ky që në atë kohë ndërtohej kryesisht përmes institucioneve fetare dhe principatave, të cilat shqiptarët nuk i patën konsoliduar pikërisht në kohën kur te fqinjët ndodhnin lëvizjet e këtilla. Prandaj shqiptarët firuan shumë, edhe në atë periudhë, edhe më vonë.

Sido që të jetë, rasti më eklatant i sllavizmit të vonë dhe të pakthyeshmë të shqiptarëve të krishterë paraqitet në Maqedoni, një rast gati i pavërejtur dhe i patrajtuar asnjëherë në diskursin aktual shqiptar. Po e shikuar hartën e Maqedonisë në kufizimin e saj me Shqipërinë, do të vërejmë se ajo kap më pak zonën e verilindore, më shumë zonën e mesme dhe pjesërisht zonën jugore të arealit shqiptar. Kjo shtrirje do të duhej të nënkuptonte vetvetiu edhe pjesëmarrjen e shqiptarëve të të tri feve në këtë areal: shqiptarët e fesë islame në tërë territorin, ata të besim katolik në veri, qoftë edhe në formë të ndonjë "enklave", dhe të besimit ortodoks që nga brezi i Dibrës dhe më në jug, sepse Maqedonia Perëndimore ka qenë pothuajse gjithnjë etnikisht e pastër shqiptare. Ata që nuk e njohin më nga afër

situatën në Maqedoninë e ditëve të sotme, do ta kenë të vështirë ta kuptojnë se deri vonë në Shkup kishte një komunitet shqiptar katolik dhe se nga Maqedonia e mesme dhe më në jug kishte një komunitet shqiptar ortodoks, i cili për një kohë relativisht të shkurtër (kryesisht në kohën e Jugosllavisë së vjetër dhe të re) u zhduk pa asnjë gjurmë.

Se për shumë kohë Shkupi ishte qendër ipeshkvisë Shkup-Prizren, këtë e dimë edhe nga doracakë e historisë elementare. Duke u renditur para Prizrenit si qendër ipeshkvnore, mund të gjykohet se Shkupi për organizimin kishtar kishte përparësi, që domethënë se numri i katolikëve të atjeshëm ishte më i madh se ai i Prizrenit me rrethinë. Këta katolikë ishin shqiptarë, doemos, sepse maqedonas të fesë katolike nuk ka pasur kurrë. Më anë tjetër, duke qenë qendër e vilajetit të Kosovës, Shkupi me kohë tërhoqi në zonat e tij urbane shqiptarë katolikë nga viset e Karadakut dhe më gjerë, që sot shtrihet në të dy anët e kufirit Kosovë-Maqedoni, por edhe shqiptarë katolikë të zonave të tjera të Kosovës, të cilët, njësoj si shqiptarët e besimit mysliman, u dyndën drejt Shkupit, për të zhvilluar tregtinë dhe për të gjetur treg për zejet e tyre tradicionale. E kësaj origjine është e Nëna Terezë. Origjina e saj nuk është aspak e diskutueshme, siç duan ta bëjnë maqedonasit ose arumunët shqiptarë, por duhet pranuar se ajo vinte nga një komunitet i paqëndrueshëm shqiptarësh, të cilët tashmë kishte marrë hov procesi i asimilimit dhe i shkombëtarizimit, gjithsesi pas përfshirjes së Maqedonisë në mbretërinë Jugosllave. Vetë Nëna Terezë fliste dhe shkruante maqedonisht, ndërsa shërbesat fetare i kryente në Letnicë, në gjuhën kroate. Gjuhën shqipe e përdorte vetëm në komunikim familjar, shumë-shumë në komunikim me njerëzit e lagjes ose të mëhallës së qendrës së vjetër të Shkupit. Në të vërtetë, problemet e shfaqura së voni rreth origjinës së saj

manifestojnë realitetin brenda vetë komunitetit katolik shqiptar të Shkupit, i cili, ta zëmë, me rastin e ngritjes së përmendores së shenjtore shqiptare në këtë qytet, organizoi një tubim katolik, në të cilin nuk u fol asnjë fjalë shqip.

Po kaq *gjak i shprishur* u bënë edhe ortodoksët shqiptarë të Maqedonisë të zonave të ndryshme, më perëndimore ose më jugore. Manastiri ishte qendër e njërit nga katër vilajetet shqiptare, brenda dhe përreth tij kishte një komunitet shqiptar ortodoks, i cili u shqua edhe për pjesëmarrje shumë aktive në jetën kulturore shqiptare. Fakti që në Manastir u mbajt Kongresi i Alfabetit dëshmon këtë më së miri. Tezat e hedhura së fundi se ky komunitet shqiptar ortodoks me shumicë nuk ishte tamam shqiptar, por kishte origjinë arumune, nuk janë mbështetur me argumente të qëndrueshme. Përkatësinë arumune të këtij komuniteti mbase nuk duhet mohuar në tërësi, por ai gjithsesi mbetet i kufizuar në numër dhe në shtrirje, që domethënë se nuk përfshinte në tërësi komunitetin shqiptar ortodoks të kësaj hapësire. Të ashtuquajturit tyrbesh (torbesh) dëshmojnë se procesi i asimilimit dhe i shkombëtarizimit të kësaj popullsie ishte një proces i shpejtë dhe i takon kohës krejt të vonë.

Ballafaqimet komb-fe

Shikuar nga aspekti historik, pra, gjërat rreth fesë në Kosovës dalin të qarta dhe e vetmja gjë e kontestueshme është klima ose ambienti shoqëror, që nuk pranonte ose hezitonte të bënte diskutime të hapura rreth raportit të fesë me lëvizjet politike ose të rolit të saj për konsolidimin ose zhbërjen identitare. Në krijimin e kësaj klime jo të favorshme për diskutime konstruktive dhe të argumentuara kanë

ndikuar shumë faktorë, por tre prej tyre duhet ndarë si më relevantët. I pari është faktori autentik, pra faktori shqiptar i Kosovës, i cili deri vonë nuk e vendosi fenë në kuadër të asnjë zhvillimi identitar, por më shumë e konsideroi si trashëgimi historike, ndonjëherë edhe si fatkeqësia e saj më e madhe. Më pas vjen faktori Serbi, Jugosllavi, ose faktori sllav, i cili çështjen fetare në Kosovë e ka deformuar ndjeshëm, duke e instrumentalizuar atë për problemet e pazgjidhura politike dhe të statusit të Kosovës. Dhe, i treti, faktori i Shqipëri komuniste, ose diktatoriale, e cila dogmatizmin e vet të kundërimit të çështjes së fesë, duke e shndërruar në nacional-komunizëm, e zgjeroi edhe në Kosovë.

Pra, si u sollën me fenë vetë shqiptarët e Kosovës dhe si e trajtuan atë përgjatë historisë së tyre më të re? Sikundër e kemi thënë edhe më herët, shkalla e islamizimit të popullsisë së Kosovës, që me pushtimet e para osmane ishte tepër e lartë, dhe në periudhat e mëvonshme Kosova, si vilajet i Perandorisë, paraqitet si njëra ndër zonat më të turqizuara, më të orientizuara të Ballkanit. Për këtë arsye, që herët Kosova njohu një emancipim pothuajse integral otoman, por, për pasojë, ishte pothuajse e përjashtuar nga lëvizjet kulturore shqiptare, veçmas të atyre të Rilindjes Kombëtare. Substancën shqiptare të Kosovës, gjatë historisë së vonë, e lënduan së tepërmi luftërat e pareshtura, asimilimi dhe shkombëtarizimi, dhe, si rrjedhojë, shpërnguljet për në Turqi ose në viset e tjera të Perandorisë. Në këtë aspekt, krijohet situatë jotipike për shqiptarët e Kosovës pas largimit të Turqisë nga Ballkani dhe pas krijimit të shtetit shqiptar: pikërisht atëherë fillon një proces i ri i shkombëtarizimit të tyre dhe i mbitheksimit të identitetit fetar në dëm të identitetit kombëtar. Brenda një kohe të shkurtër shqiptarët e Kosovës bëhen turq dhe si turq

ose u krijohen favore, ose dëbohen me dhunë për Turqi. Paradoksi: edhe përkundër shkallës së lartë të islamizimit dhe të orientalizimit, kosovarët paraqiten me identitet kombëtar më të qëndrueshëm në fund të shekullit XIX se në gjysmën e parë të shekullit XX. Shembull: Prizreni deri në ditët e sotme konsiderohet si qendër e frymës orientale në Kosovë dhe e minoritetit turk. Duket se i tillë është bërë në kohë krejt të vona, në gjysmën e dytë të shekullit XX, sepse në fund të shekullit XIX (1894), shkrimtari serb Branisllav Nushiq, i cili nuk manifeston ndonjë konsideratë ndaj shqiptarëve, në librin e udhëpërshkrimeve "Nga Kosova deri në detin e kaltër" thotë shprehimisht se Prizreni, përveç pakicës serbe dhe arumune, shumicën dërmuese të popullsisë e ka shqiptare dhe se turq "nuk ka më shumë se dhjetë deri pesëmbëdhjetë shtëpi". Situata do të ndryshojë rrënjësisht pas vitit 1913. Mbretëria jugosllave e favorizon shndërrimin e shqiptarëve në turq dhe më pas dëbimin e tyre për Turqi. Megjithatë, për shkak të këtyre shpërnguljeve, më 1948 Kosova numëron gjithsej 1.315 turq, ndërsa pesë vjet më vonë regjistrohen 259.535 pjesëtarë të kësaj kombësie.

Por, realisht, a duhet lidhur çështjen e fesë islame në Kosovë me minoritetin turk, pavarësisht se në çfarë numri ishte ky minoritet dhe si u manipulua politikisht nga ish-Jugosllavia? Po, sepse ai do të përbëjë bërthamën e frymës orientale, të ruajtjes së *statusit identifikues komb-fe* ose anasjelltas. Më anë tjetër, ky minoritet do të jetë kontingjent pararendës për shpërnguljet në Turqi, për intensifikimin e marrëdhënieve Jugosllavi-Turqi dhe për kompensimin e shpejtë të identitetit kombëtar të munguar ose të rrezikuar me identitetin fetar. E identifikuar me ikonografinë fetare, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, Turqia do të jetë e pranishme në Kosovë po aq sa Shqipëria: gjysmëhëna dhe

ylli i flamurit turk, simbole të minoritetit turk në Kosovë, do të vihen në minaren e secilës xhami në Kosovë dhe Maqedoni, në porta oborresh dhe në gurë varresh, në qëndisma vajzash dhe në prikë nusesh, në ceremoni martesash dhe syнетish, në lindje dhe vdekje. Duke qenë fe, turqizma në Kosovë gradualisht u bë kombësi.

Gjatë gjithë shekullit XX, identiteti fetar në Kosovë do të zhvillojë betejë të ashpër me identitetin kombëtar, duke u përpjekur ta zëvendësojë ose ta kompensojë atë. Kjo betejë ka marrë konotacione të ndryshme, është transformuar, por vazhdon ende, edhe sot e kësaj dite. Në të shkuarën, kjo rrethanë nuk fliste për një harmoni ndërmjet këtyre dy identiteteve, por për një kundërshtim të njëri-tjetrit, deri në përjashtim. Identiteti turk ishte në harmoni me fenë islame në Kosovë, ndërsa identiteti shqiptar ishte në kundërshtim me të. Mbeti çështje e hapur edhe sot e kësaj dite se si mund të përafroheshin këto dy identitete, *identiteti shqiptar* dhe *identiteti fetar mysliman*, pa e cenuar njëri-tjetrin, pa i hyrë në hak njëri-tjetrin, pa e dëmtuar asnjërin. Përse të mos ndodhte kjo, përse në Kosovë kjo të duket e pamundur, kur tashmë nuk duket e pamundur as për një Turqi europiane? Mbase duket e pamundur për shkak të qëndrimit të Kosovës në kapërcyell, në tehun e ndarjes së civilizimeve, ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, aty ku ende zhvillohet një betejë, gjë që nuk është rast me Turqinë. Ajo është civilizim lindor, oriental, i konsoliduar, dhe pranimi i saj në Europë nuk është çështje nëse Turqia do të ndryshojë kahen e vet civilizuese (e vetmja lëvizje e saj mund të ndodhë ndërmjet sekularizmit dhe fundamentalizmit), por do të jetë sprovë për shkallën e tolerancës evropiane, respektivisht e gatishmërisë së Europës konservative për t'u përfshirë në procesin kontradiktor të globalizimit. Me Kosovën çështja qëndron ndryshe. Kosova ende qëndron në një barkë që

luhatet, madje edhe ndryshe nga Shqipëria, e cila tashmë ka bërë një hap vendimtar drejt Perëndimit. Kosova nuk po arrin të përkufizohet qartë, për shkak të historisë, për shkak të fesë, për shkak të identitetit të dyzuar, për shkak të paragjytimeve të vjetra dhe dilemave të reja, të cilat, asnjëra syresh, nuk arritën të bëhen mbisunduese, as si civilizim, as kulturë, as si politikë, as si identitet.

Dua të bëj këtu një retrospektivë, ndoshta pak të papërshtatshme, por për mua të domosdoshme, dhe të kthehem në vitet, kur për herë të parë e kam parë Kosovën, saktësisht në shtatorin e vitit 1971. Ajo që më ka bërë përshtypje, ka qenë shkalla e lartë e islamizmit dhe orientalizmit, që për mua, atëbotë, nuk kishte ndonjë dallim të madh. Unë isha lindur në Krajë, ku të dukej vetja sikur je i përfshirë në një ritual të përjetshëm paganizmi. Më anë tjetër, muranat e një kishe të vjetër i kishim pak përtej oborrit të shtëpisë, ndërsa im atë shkonte një herë në javë në xhami, në të cilën xhumanë e falnin tre veta: hoxha, ai dhe një Xhaferi, kushëriri ynë, të cilit gruaja i kishte lindur vetëm vajza dhe prandaj shkonte në xhami, nuk dinte të falej, por vetëm lutej për një djalë. Pastaj kisha kryer gjimnazin në Ulqin, ku atëbotë kishte një përzierje të madhe identitetesh fetare dhe kombëtare: kishte katolikë shqiptarë që ishin bërë gjysmë-malazezë, kishte myslimanë shqiptarë që ishin bërë gjysmë-boshnjakë ose tamam boshnjakë, që për ne nuk kishin ndonjë dallim nga malazezët, sepse flitnin serbisht; por, mbi të gjitha, urrenim ulqinakët që flitnin shqip e serbisht përzier, kurse shkruanin vetëm serbisht, me një fjalë, që ishin në rrugë të shkombëtarizimit dhe humbjes së identitetit.

Në Kosovë, në dukje të parë, çështja nuk ishte kaq e ngatërruar. Megjithatë, ajo që më ka mbetur në mendje ishte pasioni i madh i njerëzve për fenë, numri i madh i atyre që

agjëronin, përfshirë edhe kolegët e mi studentë, të cilët ditën e Bajramit iknin të gjithë nga fakulteti dhe nga konviktet. Referencat fetare në gjuhën e komunikimit të përditshëm ishin tepër të dendura, enorme: në çdo të dytën fjali të bashkëbiseduesit do të përmendej Allahu ose Kurani (Musafi). Gjithandej Kosovës dëgjoje emra fëmijësh të vegjël Naser, Arafat, së voni edhe Gadaf, që reflektonin një pietet të paparë ndaj raporteve të Titos me këta liderë arabë, ndonëse ndonjëri syresh, si Naseri bie fjala, dihej se ishte antishqiptar i tërbuar. Më anë tjetër, qëndrimi ndaj katolikëve, aq të paktë sa ishin në Kosovë, në përgjithësi ishte refuzues dhe ndryshonte rrënjësisht nga qëndrimi që mbahej ndaj tyre në anët tona. Ne bashkëjetonim me katolikët, ndërsa në Kosovë ende duhej të bisedohej për tolerancë elementare. Në katundet tona diheshin familjet me ndarje fetare, “të ndamë zjarmit”, siç thuhej, por që ende jetonin nën një kulm. Në Kosovë shumë vonë pata mësuar për të ashtuquajturit *laramanë*, që në të vërtetë ishin *katolikë klandestinë*, me shfaqje të jashtme myslimane dhe me jetë familjare katolike, krejtësisht të mbyllur. E kam pasur shumë të vështirë ta kuptoj këtë fenomen, sepse atëbotë nuk ma kapte mendja se ky “katolicizëm klandestin”, gjithsesi i rrallë, i referohej ambientit fanatik të Kosovës myslimane. Në të vërtetë, siç e kam kuptuar më vonë, *laramanët* në Kosovë nuk janë aspak të tillë, por janë katolikë, të cilët prej kohësh nuk kanë gjetur ambient të përshtatshëm shoqëror që të shfaqen me fenë e tyre të vërtetë.

E tillë ishte Kosova e fillimit të viteve '70, që sapo kishte kaluar stadin e parë të emancipimit. Pikërisht këtu, në këtë kohë dhe në këtë fazë të emancipimit, ndërhyri Shqipëria. Kosova jashtëzakonisht konservative, e zhytur e tëra në ambientin e saj anadollak, tani kishte marrë pak arsimim kombëtar, i cili shpejt avancoi dhe e la dy hapa prapa

fanatizmin fetar. Sikundër e kemi thënë, idetë e rilindësve do të gjejnë përshtatje të gjerë në Kosovë dhe do të absorbohen në mënyrë të mrekullueshme, me një shpejtësi të madhe. Por, këto ide nacional-romantike, sikundër është e ditur, në Kosovë fillojnë të depërtojnë bashkë me ideologjinë marksiste-leniniste të Enver Hoxhës dhe të krejt Shqipërisë komuniste. Aty feja është e anatemuar, quhet e dëmshme për kombin, më pas ndalet plotësisht. Kosova çuditërisht krijoi një lloj aftësie të përvetësimit selektiv të këtyre ideve: e donte nacional-komunizmin e Enverit, por e donte edhe pronën private; i mbështeste idetë e Enverit, por për fenë dhe besimin i ruante konsideratat tradicionale. Kjo ndodhte me shtresat më të gjera të popullsisë. Atëherë, nga korpusi i ideve për fenë, të cilat filluan të vinin në Kosovë përmes propagandës dhe përmes literaturës, kosovarët e emancipuar filluan të merrnin atë që mund të ishte më e mira për rrethanat e tyre: nuk morën ateizmin, që e propagandonte Enveri, por morën *indiferencën fetare*, që ndonjëherë mund të ishte ateizëm i kamufluar, ndërsa herë të tjera teizëm gjithashtu i fshehur. Kjo indiferencë fetare i krijonte hapësirë Kosovës që të emancipohet më shpejt, por njëkohësisht ne shpëtonte edhe nga *zhveshja morale*, të cilin e sjell me vete ateizmi në një shoqëri të paemancipuar.

Mënjanimi i fesë nga identiteti

Viti 1981edhe në punë të fesë shënon një kthesë në Kosovë: nga ky vit dhe prapa, edhe në këtë çështje të Kosovës serish zë të përzihet Jugosllavia, respektivisht Serbia, duke e deformuar atë në masë të ndjeshme. Tashmë e kemi të njohur se zhbërja e elementit shqiptar në Kosovë,

në Jugosllavi, por edhe më gjerë kishte zënë një vend të rëndësishëm në programin nacional serb. Njëra nga format e zhbërjes së identitetit kombëtar të shqiptarëve ishte favorizimi i fesë, respektivisht i krijimit të hapësirës së lirë dhe stimulimit të saj në dëm të identitetit kombëtar. Shqiptarët në përgjithësi, por shqiptarët e Kosovës në veçanti, *nuk e kishin të harmonizuar interesin kombëtar me identitetin fetar*, kështu që Serbia përgjatë gjithë shekullit XX gjeti mënyrë që përmes fesë ta dëmtonte interesin kombëtar të shqiptarëve. Pasi bëri prej tyre muhamedanë, turq, islamikë dhe nxiti shpërnguljen e tyre, radha ishte të hidhte në lojë kartën e fundit: fundamentalizmin islamik, për të cilin bota ende nuk kishte dëgjuar tamam, por Europa tashmë kishte krijuar një ndjeshmëri, qoftë edhe si preventivë të largët.

Sapo ndodhën demonstratat e vitit 1981, në televizionin shtetëror të Jugosllavisë dhe në mediet e shkruara gjithandej këtij shteti të madh u shfaqën pamje të vendbanimeve të Kosovës me minare, xhamia dhe hoxhë, pra një ambient tipik oriental. Që andej këto pamje u bartën shumë shpejt në mediet botërore, për të cilat të qenit shqiptar që kërkon të drejta kombëtare u ngatërrua shumë shpejt me të qenit mysliman që kërkon të drejta fetare. Sapo ndodhte diçka në Kosovë, ose pa ndodhur fare, pra me shkas dhe pa shkas, pamjet që duhej të ilustronin rrëfimin, komentit ose reportazhin ishin të gatshme: minarja, xhamia, hoxha. Me një propagandë intensive, ne periudhën pas vitit 1981 e deri në luftën e vitit 1999, Serbia në mënyrë permanente u përpoq të deformonte identitetin e shqiptarëve të Kosovës, ta mbitheksonte te qenit e tyre myslimanë, madje duke hedhur edhe teza për lidhje të ngushta të lëvizjes nacionaliste shqiptare me fundamentalizmin islamik. Kjo propagandë bëri që në Kosovë njerëzit të ndiheshin shumë

keq, veçmas klasa politike dhe intelektualët në përgjithësi. Ishte një propagandë shumë e trilluar, por tepër e vështirë që të demantohej. Vështirësia kishte të bënte me faktin se kosovarët, në masë të madhe, ishin myslimanë nga trashëgimia, se një numër syresh praktikonte ritet fetare myslimane, por në çështje kombëtare ata ishin thellësisht mbifetarë. Kjo nuk akceptohej lehtë nga opinioni evropian, madje as nga kancelaritë politike dhe diplomatike.

Kosovarët nuk patën rrugë tjetër, përveç se të futeshin në një betejë jotipike identitare me qëllime të pastra politike: të zmbrahnin Serbinë me propagandën e saj agresive, duke sakrifikuar në këtë e sipër një dialog fetar normal dhe një diskutim përmbajtësor për fenë. Kosova kishte frikë ta hapte temën e fesë. Kosova nuk ishte e përgatitur ta hapte temën e fesë. Kosova i bishtnonte temës së fesë. Kosova kishte frikë nga keqkuptimet rreth fesë. Kosova filloi t'i shikonte me refuzim të gjitha manifestimet fetare myslimane. Kosova filloi ta konsideronte si fatkeqësi përkatësinë e saj me shumicë myslimane. Kosova, e detyruar nga propaganda serbe dhe nga keqkuptimet e botës, filloi të kërkonte zgjidhje të panatyrshme për kohën e sotme, pra, t'i rikthehej një procesi, i cili për botën mbarë ishte tashmë proces i mbyllur, një proces historik që vështirë kthehej prapa. Nuk bëhej fjalë për ridimensionimin e fesë, bëhej fjalë për refuzimin e saj në emër të një *ideali politik*. Nja dhjetë mijë të rinj, që shkonin në oborrin e vogël të Kishës së Shën Ndout në lagjen "Ulpiana" të Prishtinës natën e Krishtlindjeve, nuk shkonin për të konfirmuar konvertimin e tyre eventual në katolicizëm, siç mund të jetë marrë gabimisht nga administratorët e kishës, por thjesht për një refuzim kategorik të imazhit të politizuar mysliman, respektivisht për ndërtimin e një imazhi tashmë të lënduar perëndimor.

Natyrisht që ky ishte një deformim, ishte një dhunë që ushtrohej mbi vetëdijen e të rinjve të Kosovës. Ata nuk kishin përse instrumentalizoheshin deri në këtë shkallë dhe kjo nuk kishte të bënte me bindjen e tyre, por më shumë me nacionalizmin kosovar, i cili ishte konfuz në manifestimin e tij të jashtëm: nuk i kishte caktuar prioritetet, por tërhiqej "për hunde" nga propaganda serbe dhe nga refuzimi arrogant i Europës. Ishte ky refuzim njëshekullor, që pikërisht Europa ua kishte bërë shqiptarëve dhe një pjesë e inteligjencies së saj tashmë e kishte krijuar bindjen se, meqë Europa nuk ndryshonte qëndrim, duhej që shqiptarët t'i përshtateshin paragjykimeve të saj. Që në fillim të shekullit XX, i brengosur me zhvillimet e pafavorshme në Europë rreth shqiptarëve, Konica u propozonte bashkëkombësve të vet të konvertoheshin në të krishterë. Kjo ide u përvijua gjatë tërë shekullit XX ndër një numër intelektualësh shqiptarë, të cilët, për shkak të ndjeshmërisë, nuk e artikuluan krejt qartë, por e menduan më shumë se një herë. Kosova e viteve '90, e përballur me dhunën serbe dhe me indiferencën perëndimore, pothuajse u fut në një klimë të tillë, e nxitur edhe nga pikëpamjet konfuze të liderit të saj, Ibrahim Rugovës. Natyrisht që kjo ishte një lëvizje johistorike, e tillë që më vonë do të sillte pasoja të pashmangshme për Kosovën. Në vitet '90, për shkak të nacionalizmit, ose më mirë thënë të kundërvënies ndaj Serbisë, më shumë se gjysmën e Kosovës mund ta bëje katolike, nëse dikush shprehimisht e vendoste një kusht të tillë për t'u çliruar nga Serbia. Kjo nuk diskutohej. Po pastaj çfarë do të bëje me këta njerëz, ku do ta çoje katolicizmin e tyre të trilluar, çfarë zgjidhje mund të ofroje?

Ky ishte një deformimet, ishte një gjendje e përkohshme dhe njëkohësisht e panatyrshme në identitetin fetar të Kosovës. Po të kishte lider me vizion politik, në aventurën e

fesë Kosova nuk kishte përse të hynte, sepse është një terren dhe një klimë, ku zakonisht mbjell shi e korr furtunë. Në këtë ngushticë nuk kishte përse tregonte shpirtngushtësi as Perëndimi, sepse shqiptarët, veçmas pas vitit 1990, i kishin përcaktuar qartë kahet e lëvizjes së tyre politike dhe civilizuese. Dyshimi nuk kishte bazë tjetër, përveç propagandës serbe dhe skepticizmit cinik european, respektivisht fundamentalizmit të krishterë, i cili as që merrej me dilemat fetare të shqiptarëve, por zhvillonte teoritë e veta paragjykuese dhe recidiviste. Në të vërtetë, ky paragjykim, njësoj si propaganda serbe, gjente një mbështetje në pamjen e jashtme të Kosovës, e cila në disa pika pa mëdyshje që krijonte asociacion oriental; sikundër edhe në faktin historik, të pamundur që të ndryshohet, se mbi 98% e shqiptarëve të Kosovës ishin të përkatësisë fetare myslimane. Në këtë kohë, dukej se në Perëndim të paktë ishin ata që fenë në Kosovë e trajtonin në *nivel historik*, pra vetëm si një e kaluar historike, e cila mund të kishte disa refleksione aktuale, por nuk përcaktonte identitetin e kosovarëve. Historikisht shumica e kosovarëve ishin të besimi mysliman dhe ata nuk mund ta mohonin këtë, por aktualisht shumica syresh me sukses të jashtëzakonshëm e kishin mënjanuar fenë nga përbërësit identitarë, ta zëmë, ndryshe nga myslimanët e Bosnjës, të cilët fenë e kishin bërë esencë të identitetit. Shqiptarët e Kosovës, për një kohë fare të shkurtër, gjatë periudhës së vetëdijesimit të përgjithshëm (vitet '60-'70 e më tej) kishin ç'orientizuar pothuajse në tërësi emrat individualë, duke kultivuar gati me fanatizëm burimin e tyre iliro-shqiptar, ndonjëherë, madje, duke bërë edhe tejkalime të papërshtatshme gjuhësore dhe onomastike. Ata, gjithashtu, në njëfarë mase, ishin përpjekur ose vetvetishëm kishin ndryshuar mënyrën e jetës. Ata tashmë kishin futur në jetën e tyre pothuajse në tërësi

manire evropiane dhe vetëm në disa përbërës zakonor kishin ruajtur elemente të trashëgimisë orientale.

Të gjitha këto kosovarët i bënë pa ndihmën e pushtetit, ose, thënë më mirë, duke pasur kundër vetes shtetin e fuqishëm, i cili tashmë botërisht ishte i interesuar që procesi i deorientalizimit të shqiptarëve të mbetur nën sundimin e tij ose të ndërpritej, ose të ngadalësohej sa më shumë. Nga programi nacional serb orientalizmi tashmë ishte identifikuar si rrezikues potencial i identitetit shqiptar, krahas faktit që ai ishte terren i përshtatshëm për mbajtjen e shqiptarëve në injorancë të thellë, pra larg procesit të emancipimit dhe të vetëdijesimit kombëtar. Sikundër që tashmë e kemi shpjeguar, procesi i ç'orientalizimit të shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë (pra, të ish-vilajetit të Kosovës) as që kishte filluar ndonjëherë. Përkundrazi, përgjatë gjithë kohës së sundimit të Jugosllavisë mbretërore dhe Jugosllavisë komuniste, ai ishte stimuluar në të gjitha format që të avanconte sa më shumë, ose së paku të mbetej i konservuar. Në të vërtetë, ashtu sikundër e kemi shpjeguar tashmë, në krahasim me viset e Shqipërisë londineze, për shkak të pozitës gjeografike dhe të faktorëve të tjerë historiko-politikë, ish-vilajeti i Kosovës mund të thuhet se kishte përjetuar një shkallë më të lartë të islamizimit dhe orientalizimit. Por nuk ishte vetëm ky faktor që iu dha pamje të ndryshme këtyre viseve nga pjesa tjetër e Ballkanit Perëndimor dhe Europës Juglindore. Në fillim të shekullit XX pamje orientale kishte një pjesë e madhe e Greqisë dhe Bullgarisë, Serbia jugore dhe tërë Maqedonia dhe Shqipëria, pastaj Sanxhaku dhe pjesa më e madhe e Bosnjës. Në të gjitha këto vende, pas daljes nga Turqia, paralelisht me konsolidimin e shtetit, filloi një proces i shpejtë i deorientalizimit, ose i evropianizimit. Është kjo koha, kur Konica i mësonte shqiptarët e Shqipërisë si të visheshin dhe

si të silleshin, në mënyrë që të kishin pamje sa më të kultivuar evropiane. Me shqiptarët e ish-vilajetit të Kosovës ndodhi krejtësisht ndryshe. Të përfshirë në mbretërinë jugosllave, tek ata ndodhën procese krejtësisht të kundërta me çdo proces normal: u shkëputën lidhjet me Shqipërinë, u ndërpre komunikimi i ndërvetshëm, u ndal procesi i emancipimit, i vetëdijesimit kombëtar. E vetmja gjë që iu la në dispozicion ishte feja. Madje edhe organizmi politik i shqiptarëve në mbretërinë jugosllave për një kohë u lejua të bëhej mbi baza fetare. Pas Luftës së Dytë Botërore vazhdoi pothuajse i njëjti avaz: shqiptarëve u jepeshin me pikatore të gjitha të drejtat e tjera, vetëm në punë të fesë të drejtat i kishin me bollëk.

Feja dhe identiteti kosovar

Kjo nuk do të thotë aspak se gjatë kësaj periudhe të profilizimit identitar të shqiptarëve të Kosovës feja luajti gjithnjë rol negativ. Përkundrazi. Ajo i kishte momentet e saj të ndritshme, varësisht nga rrethanat dhe konteksti i ngjarjeve. Para Luftës së Dytë Botërore xhamitë ishin i vetmi vend ku mund të mësohej fshehurazi shkrim-lexim shqip dhe këtë e bënë një numër hoxhallarësh. Prandaj, nuk qenë të paktë hoxhallarët që u persekutuan nga pushteti, u përndoqën dhe u burgosën si nacionalistë. Një numër syresh u përfshin edhe në ngjarjet politike të kohës, duke shfrytëzuar fenë dhe ndikimin fetar për t'iu kundërvënë pushtetit komunist dhe ripushtimit të Kosovës nga Serbia dhe Jugosllavia. Emrat e këtyre hoxhallarëve edhe sot përmenden me respekt të madh në Kosovë. Më vonë, në vitet e autonomisë dhe pas saj, ndodhi edhe një reformë e

madhe brenda vetë institucioneve të fesë islame, që pastaj u përhap në krejt botën shqiptare: një pjesë e mirë e shërbesave fetare filluan të bëheshin në gjuhën shqipe, gjë që nuk kishte ndodhur më parë, përfshirë këtu edhe përkthimin e literaturës së nevojshme për këtë qëllim. Krahas kësaj, përgjatë viteve '90, bashkësitë fetare islame iu bashkëngjiten *rezistencës* së përgjithshme popullore dhe dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në përballimin situatave të rënda. Në plot raste ato u bënë mbështetja kryesore për përballimin e gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale. Mbi të gjitha, në këtë kohë liderët e fesë islame të Kosovës japin deklarata të mrekullueshme, të cilat mund të konsiderohen model i tolerancës dhe bashkëjetesës fetare. Janë deklarata të emancipuara, civilizuese, që reflektojnë angazhim thellësisht kombëtar. Edhe në Maqedoni, ku vepronte një kler mysliman më konservativ dhe ku praktikat e pushtetit për gati një shekull e kishin përdorur fenë për ta lënë popullin shqiptar në injorancë të thellë, pra edhe atje përgjatë viteve '90, prijësit fetarë dhe xhemati në përgjithësi u përfshi në një lëvizje pozitive, gjithsesi më e kufizuar se në Kosovë dhe më pak emancipuese se në Kosovë.

Megjithatë, përfshirja e fesë në politikë dhe në proceset kombëtare, do të krijojë pasoja jo të vogla për Kosovën dhe për zhvillimet vijuese. Në vetë radhët e bashkësisë fetare islame do të shtohet numri i atyre prijësve fetarë, të cilëve do t'u rriten ambiciet për rol më të madh të fesë në shoqërinë kosovare. Përafrimi politik i dy hapësirave shqiptare, i Maqedonisë dhe i Kosovës, në fazën e parë, në vitet '90, do të reflektohet në reformimin dhe emancipimin fetar të shqiptarëve të Maqedonisë. Por, me ndryshimet politike që ndodhën në Kosovë dhe në Maqedoni pas vitit 2000, përfshirë edhe zhvillimet në planin global të viteve të fundit,

një pjesë e komunitetit të fesë islame të Maqedonisë do të bëhet gjenerator i konservatorizmit fetar në Kosovë dhe në mbarë hapësirën shqiptare. Derisa emancipimi i përgjithshëm i shqiptarëve të Maqedonisë gjithnjë ka shkuar dhe vazhdon të shkojë me vështirësi të mëdha, duke mos u profilizuar asnjëherë si një lëvizje kulturore me orientim kombëtar, një lëvizje tjetër kulturore me karakter krejtësisht fetar ka marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm. Dhe, derisa integrimet e tjera ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë, veçmas ato kulturore, shkojnë me pengesa të mëdha, integrimi fetar tashmë ka marrë hov të madh dhe ai konsiston në krijimin e një *tregu unik* të propagandës fetare, të këmbimit të ideve, të komunikimit intensiv etj. Për shkak të trashëgimisë së tyre fetare thellësisht të përeformuar; për shkak të një ambienti tradicionalisht të përshtatshëm për fuqizimin e institucioneve fetare myslimane; si dhe për shkak të politikave konsistente dhe të pandryshuara të shtetit të Maqedonisë kundër emancipimit kombëtar të shqiptarëve, të shqiptarët e Maqedonisë, më saktë të liderët fetarë të kësaj bashkësie si dhe tek eksponentët e saj me numër gjithsesi më të madh, tashmë është përvijuar qartë ideja se kjo bashkësi myslimane mund të marrë rolin e *liderit shpirtëror* të shqiptarët e fesë islame të krejt hapësirës shqiptare. Për arsye të njohura, ndikimi i kësaj bashkësie fetare ka filluar të ndjehet jashtëzakonisht shumë qoftë në Kosovë, qoftë në Shqipëri.

Por, më anë tjetër, politizimi i fesë, ose përdorimi i saj për qëllime politike, pat reperkusionet e veta negative në Kosovë edhe në një plan tjetër: të raportet fetare ndërmjet komunitetit fetar mysliman dhe atij katolik. Klima e homogjenizimit kombëtar, e krijuar në vitet '90, ndër të tjera, përfshinte me vete edhe nxitjen e apostrofuar më lart, se shqiptarët, veçmas shqiptarët e Kosovës, nëse kërkojnë

mbështetjen e Perëndimit për t'u çliruar nga Serbia, duhet patjetër të riprofilizohen në çështje të fesë, pra duhej nëse jo të bëheshin katolikë, atëherë së paku të anojnë nga katolicizmi. Kjo ide e hershme ndër shqiptarët, sikur e thamë, ndonjëherë gjeti mbështetës edhe në mendimin e avancuar politik, i cili realisht më këtë *aventurë identitare* nuk u nis nga ndonjë analizë e gjendjes reale, por më shumë si një reagim emocional kundrejt refuzimit cinik të Europës ndaj shqiptarëve. Në Kosovën e viteve '90 kjo frymë nuk sollli me vete ndonjë reagim nga pala tjetër, pra nga komuniteti fetar mysliman, sepse homogjenizimi kombëtar ishte pika ku përputheshin të gjitha interesat dhe ndaheshin të gjitha mosmarrëveshjet dhe keqkuptimet. Ndërhyrja e bashkësisë ndërkombëtare, bombardimet e NATO-s mbi Serbinë, me një fjalë çlirimi i Kosovës nga Perëndimi deri vonë shumë refuzues, duhej të krijonte një klimë, ta themi kushtimisht, në mbështetje të katolicizmit dhe të krishterimit në përgjithësi. Duket se këtë e kishin menduar disa eksponentë të *katolicizmit të ri* në Kosovë, të cilët, të trimëruar nga situata e krijuar, por më shumë nga mosdija e tyre, filluan një *kapardisje katolike*, e cila nuk i shkonte as kohës as vendit, e aq më pak mund të ishte qëndrim i kishës dhe i hierarkisë së saj.

Ndodhi, pra, që disa eksponentë të kësaj feje, përfshirë këtu edhe disa përfaqësues lokalë të kishës, gjatë kësaj kohe patën paraqitje publike agresive, duke krijuar kështu një atmosferë provokuese për palën tjetër, gjë që nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë me bashkësinë katolike të Kosovës. Ata, duke shfrytëzuar rrethanat, kërkuan të vendosnin në Kosovë një *supremaci historike*, duke u imponuar para shqiptarëve të Kosovës, por edhe në botën shqiptare në përgjithësi, si krahu më i qëndrueshëm dhe më i avancuar patriotik i kombit. Më anë tjetër, po për qëllime të

këtilla meskine, u keqpërdor edhe figura e Nënë Terezës, e cila në Kosovë tashmë kishte filluar të nderohej nga të gjithë si shenjtore. Ndërsa çelësi i krejt kësaj situatë ishte vendimi për të nderuar një katedrale në qendër të Prishtinës, vendim ky arrogant dhe i pamatur, i cili tashmë ka lënë pasojë të padiskutueshme në situatën fetare në Kosovë.

Që nga fillimi unë e kam bërë publik kundërshtimin tim për ndërtimin e katedrales në qendër të Prishtinës dhe për këtë kam marrë kundërshtime të ashpra dhe fyerje nga eksponentët e bashkësisë katolike të Kosovës dhe më gjerë, përfshirë këtu edhe një numër miqsh të mi të hershëm nga ky komunitet, sikundër që, në anën tjetër, kam marrë lëvdata po kaq fyese nga eksponentët e komunitetit mysliman. Unë kam thënë se vendimi për të ndërtuar katedrale në qendër të Prishtinës ishte politikisht i gabuar dhe në pikëpamje fetare i paqëndrueshëm. Ndërkaq, sa i përket imazhit ndërkombëtar, Kosova tani nuk kishte përse të demonstronte dhunshëm një katolicizëm të panatyrshëm, sepse bashkësia ndërkombëtare tashmë e kishte marrë krejt informacionin e nevojshëm për Kosovën dhe recidivat e vjetra sekush mund t'i ruante për shkak të paragjykimeve ose dashaligësisë, por jo për shkak të keqinformimit. Ndërsa në paragjykime dhe dashaligësi rreth Kosovës, një katedrale e bërë si marketing nuk do të ndryshonte gjë. Marketingu ishte krejt politik dhe i tejdukshëm, dhe secili që e njih sadopak historinë e Kosovës, me 98% të popullsisë të përkatësisë fetare myslimane, do ta ketë të vështirë ta pranojë një rirreshtim të saj në identitet fetar të krishterë. Këtë propagandë të panatyrshme, të instrumentalizuar dhe mosbesuese Kosova nuk kishte përse ta bënte tani, kur informacioni për të kishte përmasa planetare.

Kundrejt kësaj, ndërtimi i një katedraleje katolike në qendër të Prishtinës ishte një vendim politik i Ibrahim

Rugovës, pasioni i të cilit për Kosovën me orientim perëndimor u keqpërdor nga krerët e kishës, duke e nxjerrë pothuajse nga shtrati i vdekjes liderin e sëmurë, për të vënë gurin e themelit të katedrales, me nguti, para se ai të ikte përgjithmonë nga kjo botë. As Kosova, as kisha katolike nuk kishte përse të binte në një grackë të këtillë, sepse mbështetësit e idesë së katedrales duhej ta kishin parasysh se ajo, më shumë se të krijonte imazh pozitiv për Kosovën, do të ishte një *generator i përhershëm i fundamentalizmit islamik*. Nuk vonoi dhe reagimi i fanatikëve myslimanë erdhi i ashpër: sapo katedralja u fut nën kulm, nëpër Prishtinë u panë grafite, përmes të cilëve u bëhej ftesë myslimanëve që të shkonin të faleshin në katedrale, që domethënë ta kthenin atë në xhami, veprim ky që nuk është i panjohur nga tradita e kësaj feje. Për të qenë e keqja edhe më e madhe, këto grafite nuk shprehnin vetëm mllef fetar, por tregonin edhe për një realitet të deformuar: më një anë, besimtarët myslimanë në Prishtinë nuk kishin hapësira të mjaftueshme nëpër xhamia dhe faleshin në parkingje, në rrugë e gjetiu; më anë tjetër, për numrin e katolikëve në Prishtinë edhe kisha e vogël e Shna Ndout në lagjen “Ulpiana” ishte tepër e madhe. Mbi të gjitha, duke bërë këtë veprim të imponuar politikisht, kisha katolike kishte rënë në të njëjtën grackë si kisha serbe, e cila me forcën e vendimit politik të Milosheviqit kishte lënë po në qendër të Prishtinës, në kompleksin universitar, një godinë betoni, si monument të shtypjes dhe jotolerancës.

Pra, çuditërisht në këtë rast kisha katolike dhe mbështetësit e idesë së katedrales në qendër të Prishtinës patën nevojë që dikush t’i mbronte nga vetja e tyre, njësoj siç vazhdon të ketë nevojë Nëna Terezë të mbrohet nga adhuruesit e saj. Edhe figura e saj në Kosovë u përpoq të përdorej për një marketing politiko-fetar, por me këtë nuk u

arrit gjë tjetër, përveç se t'i bëhej një dëm vetë shenjtores së madhe dhe të nxiteshin mërmëritje nën zë për teprimet rreth saj. Është e njohur se vetë Nëna Terezë ka qenë kundër përdorimit politik të figurës së saj. Nga frika se mund t'i keqpërdorej emri, ajo vetë, që më 1993, me një letër që ia vuri në dispozicion zyrës së Kosovës në Tiranë, kërkoi të mbyllej Shoqata humanitare "Nëna Terezë" në Prishtinë, me shpjegimin se emri i saj nuk mund të përdorej për mbledhje fondesh dhe gjëra të këtilla, sepse ishte kundër rregullave të rendit që përfaqësonte ajo. Me këtë letër ka qenë e njoftuar me kohë edhe udhëheqja e shoqatës në Prishtinë, e cila natyrisht që e ka heshtur këtë fakt. Përveç kësaj, Nëna Terezë nuk ka bërë ndonjë prononcim politik publik rreth Kosovës, pavarësisht se ka qenë e njohur me rrethanat e krijuara. Ajo kishte vizituar Jugosllavinë, në këtë kuadër edhe Kosovën, që në kohën e Titos, pasi kishte marrë Çmimin Nobel, por asgjëkund nuk mund të gjendet ndonjë deklaratë e saj për shqiptarët, ose për Kosovën.

Pse i themi të gjitha këto? Sepse *balancat fetare* në Kosovë nuk janë të përshtatshme dhe ndaj tyre duhet të sillemi me kujdes dhe në mënyrë të përgjegjshme. Kosova tashmë nuk mund t'i krijojë vetes imazh europian duke proklamuar katolicizmin, madje as tolerancën fetare, sepse në një vend ku shumica dërmuese e popullsisë është e një besimi fetar, në këtë rast myslimanë, *toleranca nuk ushtrohet*, ajo *sanksionohet*, në mënyrë që të mbrohet pakica dhe të mos diskriminohet ajo. Që të funksionojë si shtet europian, Kosova ka nevojë të ndërtojë dhe të proklamojë *sekularizmin dhe laicitetin* e institucioneve. Më anë tjetër, po me kaq kujdes duhet të sillemi edhe ndaj identitetit, kombëtar apo fetar qoftë ai, sepse çdo e çarë eventuale në identitetin kombëtar, në rrethanat e Kosovës, doemos që krijon hapësirë për manipulim me identitetin fetar. Tashmë është e njohur,

katërçipërisht e vërtetuar, se çdo identitet i paqëndrueshëm në një mënyrë është aleat i fundamentalizmit. Ndryshe nga identiteti shqiptar që është tradicional, stabil dhe i konsoliduar në të gjitha pikëpamjet, *identiteti kosovar është identitet i luhatshtëm*, identitet në lëvizje, i cili krijon hapësirë për një garë të re identitetesh. Kjo garë, në rrethanat e Kosovës, nuk do të zhvillohet asnjëherë ndërmjet identitetit shqiptar dhe atij kosovar, sepse ata nuk janë të barabartë, por do të zhvillohet ndërmjet identitetit shqiptar dhe "derivateve" të deformatuara, përfshirë këtu edhe fundamentalizmin islamik. Ndoshta pa e kuptuar as vetë, mbështetësit e identitetit kosovar janë futur në garë me islamistët, të cilët tashmë kanë parë tek është krijuar një hapësirë e përshtatshme për ëndrrën e tyre të një *republike islamike shqiptare*, ose të një *kombi të ri mysliman* ngjashëm me atë të Bosnjës, ku do të përfshiheshin shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Luginës së Preshevës.

Me një fjalë, duke qenë identitet i paqëndrueshëm, identiteti kosovar me kohë ka krijuar "rrjedhje" brenda vetë substancës shqiptare, duke përbërë një masë të përshtatshme për zhbërje dhe asimilim. Për shkak të historisë; për shkak frymës së fuqishme orientale, e cila për një kohë të gjatë i ka dominuar hapësirat e ish-vilajetit të Kosovës; për shkak të qëndrimit në pragun e fërkimit të vazhdueshëm me sllavët armiqësisht të disponuar ndaj shqiptarëve; për shkak të rrethanave bashkëkohore botërore, të cilat favorizojnë islamizimin radikal dhe fundamentalizmin; për shkak të institucioneve të brishta të shtetit të Kosovës dhe të mungesës së lojalitetit të shtetit të Maqedonisë ndaj shqiptarëve; për shkak të zgjidhjeve jo të përshtatshme që ka ofruar bashkësia ndërkombëtare për rregullimin kushtetues të Kosovës dhe të raporteve të saj inferiore ndaj Serbisë; për shkak të qeverisjes së keqe dhe të

mungesës së perspektivës në të gjitha “shtetet” shqiptare; për shkak të vonesave ndonjëherë të paarsyeshme në integrimet europiane të rajonit dhe të shqiptarëve në përgjithësi; pra, për shkak të këtyre rrethanave, identiteti i paqëndrueshëm dhe i luhatshtëm kosovar bëhet mbështetës ose krah i fortë i lëvizjeve identitare jotipike, të cilat nga një *përkatësi fetare si trashëgimi historike*, ku realisht bën pjesë edhe përkatësia fetare e shqiptarëve të Kosovës, bëjnë *përkatësi fetare aktive*, vepruese, mobile, e cila kërkon ndryshimin e botës sipas parametrave të radikalizmit islamik. Vetëm një identitet i qëndrueshëm kombëtar, në këtë rast identiteti shqiptar (dhe jo një identitet në lëvizje, i paqëndrueshëm dhe i luhatshtëm, siç është identiteti kosovar), mund t’i bëjë ballë kësaj situatë dhe të nxjerrë përfundime të favorshme për botën shqiptare.

Përdorimi politik i fesë

Ndërkohë, faktori fetar shqiptar i Kosovës disa tema nuk ka dashur t’i hapë asnjëherë, por edhe nëse i ka diskutuar kohëve të fundit, është përpjekur ta bëjë këtë disi fshehtas, larg syve të opinionit, ose pa përfshirjen e medias. Diskutimet janë mbajtur dhe vazhdojnë të mbahen nëpër tribuna të mbyllura, shpesh brenda xhamive, pa pjesëmarrjen e atyre që mund të mendojnë ndryshe. Por edhe nëse këto diskutime janë mbajtur në vende publike, janë frekuentuar nga numër i kufizuar intelektualësh, kryesisht të tillë, të cilët në ambientin kulturor të Kosovës janë të njohur si mbështetës të fesë dhe të Kosovës si shtet islamik. Në këto diskutime me palën kundërshtare polemizohet në mungesë, polemizohet në atmosferën e

euforisë fetare, pa u kushtuar vëmendje argumenteve. Disa nga ligjëruesit në këto tribuna paguhen jashtëzakonisht mirë, veçmas në Maqedoni dhe veçmas nëse vijnë nga provenienca intelektuale. Në dukje të parë ata hapin tema të ndjeshme, siç janë raportet e islamit me botën bashkëkohore, pastaj çështje të fesë dhe të globalizmit, apo raportet e fesë me kombin, me shtetin, me historinë, me kulturën kombëtare etj. Mirëpo, shumica e ligjëruesve që marrin pjesë në këto tribuna, para se t'ia nisin fjalës, bëjnë një "dovë" të tipit "bismilahu-rrahmani-rrahim", që vetvetiu diskutimin e fut në kodet dhe fetishet tepër të kufizuara të religjionit. Më pastaj në ato tribuna mund të fliten gjëra vërtet të rëndësishme, që duhet të jenë në vëmendje të opinionit, siç është arsimimi fetar, marrëdhëniet e shtetit me fenë etj., por të gjitha këto janë të intonuara në atë formë, që të jenë të pranueshme vetëm për njërin palë dhe vetëm për ata që përbëjnë praninë më të madhe. Problemi më i madh këtu është *mercenarizmi*. Nuk janë të paktë ata që këto tribuna i keqpërdorin për përfitime materiale, madje duke i modifikuar idetë e tyre sipas nivelit të auditorit dhe sipas interesave të "donatorëve", të cilët shpesh dinë të jenë me burime të dyshimta financiare.

Por nuk është ky problemi i vërtetë fetar i Kosovës. Problemi qëndron në *ndërtimin e dy botëve të ndara*, të cilat nuk komunikojnë mjaftueshëm me njëra-tjetrën, ose disi fshihen nga njëra-tjetra, sepse duket sikur asnjëra palë nuk është e interesuar të ballafaqohet me tjetrën, duke krijuar kështu një *paqe të rrejshme*, ose duke pritur që kalimi i kohës vetvetiu t'i nxjerrë në udhë të mbarë disa gjëra. Apo është edhe diçka tjetër: Kosova laike e konsideron të panevojshëm dhe të simplifikuar një ballafaqim të mundshëm me Kosovën religjioze, pikërisht tani, madje as dje, as pardje, as nesër, sepse ky vend ka pasur, vazhdon të ketë dhe do të

ketë probleme më urgjente se ç'janë problemet e fesë. Më anë tjetër, Kosova religjioze, pjesa fanatike e saj, sheh zhvillime dhe tendenca që shkojnë në favor të saj, qoftë në planin lokal, qoftë në atë global dhe tani për tani duket sikur është e interesuar të qëndrojë në pritje, për t'u ballafaquar një ditë me tërë forcën me pjesën laike të Kosovës. Këto dy botë të ndara hë për hë bashkëjetojnë në Kosovë, pa një komunikim të ndërvetshëm, pa një ballafaqim jokonfliktual, të civilizuar. Në të vërtetë duhet ta pranojmë se në krahun religjioz të Kosovës gjithnjë ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë një rrymë e moderuar, e cili aktualisht shfaqet si amortizator i shkëlqyer i *radikalizmit fetar*, pse jo edhe i fundamentalizmit ekstrem. Ky krah i moderuar përfshin pjesën më të madhe të Bashkësisë së Fesë Islame të Kosovës, strukturat e saj udhëheqëse dhe numrin më të madh të imamëve nëpër xhamitë e shumta, por edhe shtresën më të qëndrueshme të besimtarëve.

Besimtarët tradicionalë të Kosovës, pavarësisht se në shumë pika kanë qenë konservativë, me kohë kanë adaptuar praktika fetare liberale, të ngjashme me ato që janë aplikuar në Turqinë pas periudhës së Ataturkut. Më anë tjetër, Jugosllavia socialiste për një kohë relativisht të gjatë e kishte parim themelor të jetës fetare ndarjen e fesë nga shteti. Kosovarët besimtarë edhe nga ajo praktikë mësuan se përmes xhamisë dhe namazit ishte e rrezikshme të përziheshin në punët e shtetit dhe se ceremonitë fetare nuk u referoheshin punëve shoqërore, por vetëm atyre shpirtërore: mëkatit, sevapit, moralit, amshimit, xhenetit, xhehenemit etj. Natyrisht, kjo nuk i pengoi që një numër hoxhallarësh në Kosovë, të tillë që fillimisht morën arsimim të qëndrueshëm kombëtar, në periudha të caktuara të zhvillonin me xhematin edhe aktivitet politik, në radhë të parë patriotik. Disa syresh madje u gjenden në konflikt të

drejtpërdrejtë me pushtetin, u survejuan, u burgosën dhe u dënuan me shumë vite burg. Por kishte edhe nga krahu tjetër, hoxhallarë spiunë dhe provokatorë, të cilët u bënë krah i pushtetit dhe e ndihmuan atë në aplikimin e masave represive dhe shkombëtarizuese.

Pse po e theksojmë, pra, këtë realitet fetar në Kosovë? Për ta bërë të qartë se praktikrat e institucioneve fetare, por edhe të besimtarëve, shkonin në drejtim të një diversiteti të natyrshëm brenda një tërësie megjithatë kompakte dhe homogjene. Ndoshta çarjet e para në radhët e besimtarëve dhe prijësve fetarë ndodhën pikërisht atëherë, kur tubimet fetare dhe ceremonitë e këtilla u pa se mund të shfrytëzoheshin edhe për punë politike. Çfarë ndodhi pastaj? Në fund të viteve '60 dhe përgjatë viteve '70 në institucionet fetare të Kosovës u kultivua patriotizmi shqiptar, herë racional herë folklorik, i tillë çfarë ishte edhe gjëtu. Në vitet e mëpastajme, përgjatë viteve '80, institucionet fetare, nga njëra anë u gjenden nën trysninë e pushtetit për të aplikuar procesin e diferencimit, ndërsa në anën tjetër, nën trysninë e nacionalistëve, për t'iu kundërvënë pushtetit dhe politikave të tij. Fundi i viteve '80 dhe vitet '90 janë të njohura si periudhë e homogjenizimit të madh të popullsisë së Kosovës. Institucionet fetare dhe praktikrat e fesë u futën edhe në këtë pëshhtjellim, për të dalë në fillim të shekullit XXI si institucione me një lloj *biografie politike kombëtare*. Si e këtillë, feja islame vetvetiu u bë disi e pëlqyeshme dhe në këtë periudhë nuk paraqiti ndonjë pengesë për emancipimin kombëtar dhe për realizimin e projekteve madhore politike. Liderët fetarë të Kosovës, myslimanë dhe katolikë, ishin pjesë e proceseve më të rëndësishme nëpër të cilat po kalonte Kosova.

Por pikërisht këtu lindi një problem, i cili më vonë do të ketë reperkusione të tjera: feja, veçmas feja islame, e cila

gjithnjë ishte konsideruar konservative, por po ashtu e padëmshme për aspiratat politike të komunitetit, përnjëherësh u gjend e hapur ndaj frekuencave politike. Është e vërtetë se politikën në institucionet e fesë islame në Kosovë e futi patriotizmi shqiptar dhe euforia e tij gjithëpërfshirëse. Por tani që Kosova u bë, që realiteti në Kosovë kërkonte qasje tjetër politike, çfarë do të bënte feja dhe institucionet e saj me inercinë e fituar politike? Së pari, do të braktisë patriotizmin, në burimet e të cilit ishte ushqyer deri atëherë dhe, natyrisht, do të ndjekë zhvillimet globale, të cilat ndryshuan shpejt dhe që deri atëherë feja islame në Kosovë nuk i kishte ndjekur. Pra, shtrohet nevoja për një ridimensionim të fesë në Kosovë dhe ky bëhet në kushtet e një pështjellimi të madh politik, në të cilin u fut Kosova pas vitit 1999. Kosova shqiptare ishte një mit, ishte një shenjtëri. Sapo u prek ky mit dhe kjo shenjtëri, gjithandëj u shfaq një krizë e jashtëzakonshme e identitetit, në të cilën u përfshi edhe feja, në këtë rast feja islame.

Po në këtë kohë, brenda vetë komunitetit fetar mysliman të Kosovës u shfaqen diversitete ideore dhe ideologjike. Në të vërtetë, në strukturat organizative dhe në masën e besimtarëve u diferencuan qartë dy rryma, njëra *tradicionale*, siç e thamë, stabile, me fenë islame si traditë e respektueshme dhe përbërës i konstalacionit shpirtëror të besimtarëve; ndërsa tjetra rrymë *fanatike*, fundamentaliste, vehabiste, me përfshirje besimtarësh të moshave të reja, që fenë nuk e quan më traditë të respektueshme dhe as përbërës shpirtëror, por përkushtim ideologjik dhe angazhim funksional politik. Në Kosovë u bë ndarja e qartë e këtyre kontingjenteve të besimtarëve dhe, ndonëse shërbesat fetare i kryejnë në të njëjtin vend, armiqësia dhe refuzimi reciprok nuk duket se do të tejkalohen shpejt. Militantizmi fanatik, që e karakterizon numrin relativisht të

vogël të vehabistëve të rinj, ndonëse ka një shfaqje të jashtme tepër agresive, duket se ende nuk ka gjetur terren të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në Kosovë, e cila, në pikëpamje fetare ende balancon mirë me një traditë tashmë të shtresuar dhe stabile të tolerancës ekumenike.

Në të vërtetë, paraqitja e vehabizmit në Kosovë nuk ka asnjë lidhje me ndonjë traditë fundamentaliste, sepse fenë islame në Kosovë në radhë të parë e “reformoi”, nacionalizmi shqiptar, shumë vjet përpara se të shfaqeshin format e para të krizave të identitetit në mesin e islamistëve ballkanas. Ose, thënë më mirë, e përshtati me rrethanat kosovare, me rrethanat shqiptare. Gjithashtu, ndonjë lidhje ndërmjet luftës së UÇK-së dhe vehabizmit nuk u gjend, edhe përkundër përpjekjeve të pareshtura të Serbisë që luftës në Kosovë t’i japë edhe karakter fetar, karakter të konfliktit të civilizimeve etj. Ndryshe nga lufta në Bosnjë, lufta në Kosovë, as në fillimet as në zhvillimet e saj, nuk e pat asnjë të vetmin element fetar, sepse në këtë luftë përballëshin dy identitete tashmë të konsoliduara, të qëndrueshme, për interesa të pastra kombëtare: identiteti shqiptar dhe ai serb. Në Bosnjë identiteti boshnjak ishte i pakonsoliduar, ishte identitet gjysmë fetar, gjysmë kombëtar dhe prandaj ai krijoi hapësirë për infiltrimin e rrymimeve fetare. Shqiptarët e Kosovës që e bënë luftën nuk kishin asnjë dilemë të këtillë. Madje një numër syresh, për shkak të ndikimit nga ideologjia marksiste-leniniste e Enver Hoxhës mund të ishin ateistë, por në asnjë rrethanë nuk mund të ishin fundamentalistë islamikë. Masivizimi i UÇK-së mund të ketë çuar në radhët e luftëtarëve edhe besimtarë të zakonshëm, por as të tillët, kurrë, nuk e deklaruan, dhe besoj as e kanë pasur në mendje, se luftën e bënë për qëllime fetare. Për shqiptarët, Kosova nuk ishte *fe*, ishte vetëm *komb*. Lufta nuk bëhej për liri fetare, bëhej për liri kombëtare. Për

serbët lufta në Kosovë ishte komb dhe fe përzier, për shqiptarët nuk ishte e tillë në asnjë rrethanë.

Atëherë, si u krijua, pra, hapësira që në Kosovë të gjejë vend radikalizmi fetar mysliman? Nëse jo radikalizmi, atëherë si ndodhi që feja në këtë periudhë, pas vitit 1999 e prapa, të gjejë hapësirë më të madhe, shtrirje, përkrahje, në një mënyrë të bëhet objekt diskutimi, madje në disa raste *pjesë e identitetit të kosovarit*, nëse jo tamam pjesë e identitetit, një preokupim i tij gjithsesi? Realisht, pas luftës, pas vendosjes nën protektorat ndërkombëtar, madje së voni edhe pas pavarësisë, Kosovës i hapej perspektivë tjetër, perspektivë evropiane, perëndimore, atë që e kishte ëndërruar prej kohësh dhe jo perspektivë islamike, orientale. Në Kosovë zbarkoi NATO-ja me një ushtri të jashtëzakonshme perëndimore; zbarkoi UNMIK-u me një përbërje heterogjene kombëtare dhe civilizuese, por gjithsesi elitare në raport me vendet prej nga vinin; zbarkoi Bashkimi Europian që mbahej fort pas “shtyllës” ekonomike, sikundër edhe OSBE-ja që u mor me marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Pra, marrë në përgjithësi, ishte një konstalacion europa-perëndimor, i cili në pikëpamje fetare dhe civilizuese duhej ta çlironte Kosovën nga brengat eventuale, madje duhej t’i ndihte të hiqte paragjykimet e vjetra recidiviste, t’i ndihte të hiqte damkosjet eventuale të propagandës serbe. Mirënjohja ndaj Perëndimit ishte e thellë dhe, sipas logjikës së gjërave, nëse deri atëherë në Kosovë kishte pasur *skepticizëm evropian* ose *skepticizëm perëndimor*, madje edhe *skepticizëm fetar*, tani gjërat ishin kristalisht të pastra: Perëndimi i krishterë kishte ndërhyrë në Kosovë në mbrojtje të popullit të saj me shumicë myslimane, në mbrojtje të shqiptarëve të përbuzur dhe, pavarësisht se ajo quhej ndërhyrje humanitare, ajo ishte ndërhyrje e pastër politike.

Si ndodhi, pra, që pikërisht në këtë kohë dhe në këto rrethana Kosova u desh të përballlej me një rritje të islamizmit, madje edhe të një radikalizmi fetar mysliman, që nuk ishte parë ndonjëherë tjetër në këtë vend? Nuk është për të besuar se Kosova tani kishte arsye të bëhej më religjioze, pra, që shpëtimin nga zhbërja përfundimtare ta lidhte me proveniencën qiellore dhe falënderimin ndaj Zotit ta manifestonte me shtimin e besimit. Jo, nuk ishte kështu. Kosovarët, përkundrazi, u treguan shumë pragmatikë: ngarendën dhe u kthyen në shtëpitë e tyre, shumica me entuziazëm patriotik, por disa edhe me pasionin e grabitjes së pronës së të tjerëve, e disa edhe me domosdonë e mbrojtjes së saj. Kosovarët, në të vërtetë, as pas vitit 1999 dhe as më vonë nuk u bënë më besimtarë nga ç'kishin qenë më parë, dhe as islamistë jo që jo, e aq më pak fundamentalistë. Por, megjithatë, diçka ndryshoi në qenien e tyre, jo te të gjithë, por te një numri syresh gjithsesi: disa ndryshuan praktikën e ushtrimit të fesë, të dytët kërkuan kompensim për krizën e identitetit, kurse disa të tjerë te besimi fetar kërkuan strehë shpirtërore nga pësimet e mëdha të luftës. Numri i këtyre të fundit gjithsesi është i vogël, madje me kalimin e kohës të tillët adaptohen në një besim fetar krejt të veçantë, i cili është shumë i përshpirtshëm dhe jashtëzakonisht human. Ata, me këtë rast, nuk përbëjnë objekt shqyrtimi. Pak më gjatë do të ndalemi te dy fenomenet e tjera që shoqërojnë fenë dhe besimin fetar në shoqërinë kosovare: te format e manifestimit të jashtëm të besimit fetar dhe te kriza e identitetit.

Mercenarizmi fetar

Praktikat e ushtrimit të besimit fetar në Kosovë për një kohë të gjatë kanë mbetur të pandryshuara: namazi, njësoj si vetë besimi, ka qenë çështje krejtësisht individuale. Të reklamohesh se je besimtar, se shkon në xhami, se falë pesë vaktet nuk ka qenë praktikë e mëhershme, ndoshta edhe për shkak se në periudhën e komunizmit, pavarësisht se feja nuk ka qenë e ndaluar në ish-Jugosllavi, nuk quheshin të preferuar të pushtetit dhe të partisë ata që fenë e praktikonin në mënyrë aktive. Së këndejmi ndoshta ka mbetur edhe njëllë fshehtësie, ose mënjanimi nga shfaqjet publike të atyre që ushtrojnë praktikat e besimit fetar. Më anë tjetër, struktura e besimtarëve myslimanë në Kosovë tradicionalisht ka mbetur e pandryshuar dhe ajo përbëhej kryesisht nga njerëzit e moshuar, në zonat rurale nga pleq që nuk bënin më për punët e fushës, ndërsa në zonat urbane nga shtresa e zejtarëve, gjithnjë të moshuar dhe gjithnjë pa arsimim themelor, e aq më pak të avancuar. Burrat me shkollim superior që shkonin në xhami ishin të paktë, ndërsa intelektualët një raritet i vërtetë. Përveç kësaj, në dukjen e jashtme besimtarët dhe ata që ushtronin praktikat fetare nuk dalloheshin nga të tjerët, pra nuk kishin ndonjë shenjë të veçantë. Në periudhën e hershme, pas Luftës së Dytë Botërore, bashkë me luftën kundër analfabetizmit, ishte bërë luftë edhe kundër ferexhesë, kështu që në periudhën e emancipimit të shpejtë të kosovarëve vështirë që gjeje ndonjë grua me ferexhe. Por veshja tradicionale e “mbulimit” të grave ishte ruajtur, një mbulim që nuk nënkuptonte mbulimin e fytyrës, vetëm mbulimin e trupit dhe shaminë e kokës. Kjo nuk quhej *veshje fetare*. Ajo tashmë ishte kthyer në një veshje tradicionale për gratë që kishin braktisur veshjen folklorike, ndonëse pas valës së

emancipimit që përfshiu Kosovën e viteve '70-'80 edhe numri i tyre kishte rënë ndjeshëm. Nga vitet '80 filluan të shfaqeshin edhe burrat me fesin e haxhillëkut, së pari në Maqedoni dhe më pastaj edhe në Kosovë. Në të vërtetë, shkuarja në haxhillëk ishte një praktikë e hershme në Kosovë (më 1971, haxhinjtë sollën linë e madhe nga Meka), por identifikimi publik i atyre që bëheshin të tillë nuk ishte një praktikë e hershme.

Në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 rënia e komunizmit do të sjellë me vete edhe rënien e një sistemi vlerash, çfarëdo që kishte qenë ai dhe sado i deformuar që mund të kishte qenë. Edhe në çështje të fesë u krijua një lloj kaosi, sepse lëvizjet politike patën refleksion të drejtpërdrejtë edhe në konstalacionin fetar individual dhe kolektiv. Keqësimi i gjendjes materiale të popullsisë së Kosovës, por jo vetëm kjo, do të sjellë si rrjedhojë lindjen e *patriotizmit mercenar*, pra të një patriotizmi të tillë që konvertohet pa vështirësi në përfitim material. Homogjenizmi i popullsisë mbi bazën e idesë kombëtare krijoi një ambient të përshtatshëm për lindjen e deformimeve të mëdha, që ndonjëherë shkuan deri në çorodi morale. I kësaj kohe është edhe *mercenarizmi fetar*, i cili u shfaq në fillim si pasojë e varfërisë dhe të rrënimit të të gjitha skemave sociale, ndërsa më vonë edhe si mënyrë për përfitime, por edhe për zgjerimin e rrethit të besimtarëve, respektivisht të praktikuesve të fesë. Bashkësitë fetare, për shkak të lehtësive që kishin kundruall pushtetit dhe policisë serbe, për një kohë të shkurtër u bënë donatorët dhe mbajtësit kryesorë të varfanjakëve të shumtë anë e kënd Kosovës. Shoqatës humanitare "Nëna Terezë", e cila kishte status legal dhe gëzonte mbështetjen e kishës katolike dhe të një numri të konsiderueshëm aktivistësh laikë, shumë shpejt iu bashkëngjitën të tjera shoqata, disa syresh me tingëllim

turko-musliman, të cilat nuk e kishin emrin kumbues siç kishte "Nëna Terezë", por që bënë një punë të heshtur humanitare gjithandej Kosovës. Po atëherë filloi të përflitej se disa nga këto shoqata, bashkë me aktivitetin humanitar, zhvillonin edhe aktivitet fetar herë legal, herë gjysmë legal, ose fare të fshehtë dhe që konsistonte në tërheqjen dhe futjen e nevojtarëve në skemat e tyre të praktikuesve të fesë, kundrejt një pagese simbolike. Burimi i financimit të këtyre shoqatave nuk ishte shumë i qartë, por atëbotë të gjithë konsideronin se situata sociale ishte më emergjente se sa përkuqdesja për këtë anë të çështjes. Një skemë të tillë ndihmash e kam parë vetë në Shqipëri në vitet '90, për studentët kosovarë, por asnjëherë nuk kam dyshuar se prapa kësaj ndihme mund të fshihej një dredhi fetare.

Pas luftës së vitit 1999 situata me mercenarizmin fetar në Kosovë përnjëherësh bëhet dramatike: shoqata të shumta humanitare me parashenjë fetare ia mësyjnë Kosovës nga të gjitha anët, nga Lindja dhe Perëndimi. Nevojat e popullsisë ishin të mëdha, por njëkohësisht edhe mundësitë për t'i manipuluar nevojtarët ishin të pakufishme. Pak nga pak, me kalimin e situatës emergjente, nga skena tërhiqen nevojtarët e vërtetë dhe tani mbesin që të duken dhe të zhvillojnë aktivitet përfituesit e llojllojshëm, të cilët me njërin dorë ofrojnë benificione të ndryshme, kryesisht para, ndërsa me dorën tjetër regjistrojnë përfituesit në shoqata që nuk kuptohet se çfarë janë. Është gabim të mendohet se veprime të këtilla në Kosovën e pasluftës kanë bërë vetëm shoqatat vëhabiste, islamiste, ose vetëm të tilla që vinin nga Arabia Saudite, Kuvajti, Bahreini etj. Nuk ishin më të pakta as shoqatat e sekteve perëndimore, të krishtera, katolike, evangjeliste, baptiste etj., të cilat krijuan rrethet e tyre të mercenarëve dhe të simpatizantëve, duke u mbështetur kryesisht në para, në donacione.

Sikundër që është e njohur, këto shoqata dhe fondacione duket sikur nuk e kanë parësor besimin, respektivisht shtimin e numrit të atyre që *rrugën e Zotit* e gjejnë përmes mënyrës së tyre të ushtrimit të fesë, por më shumë të një dukjeje jashtme, të një shfaqjeje publike, me një fjalë të një marketingu fetar, i cili në rastin e disa shoqatave islamike manifestohet përmes shamisë së kokës të vajzat dhe gratë dhe mjekrave të gjata dhe veshjeve jotipike për djemtë dhe burrat. Burimet e financimit dhe mercenarizmi janë problemet kryesore të kësaj pamjeje fundamentaliste, e cila nga Maqedonia ka filluar të zgjerohet dukshëm edhe në Kosovë. Burimet e financimit kryesisht janë të jashtme dhe sot vështirë kontrollohen në një sistem botëror të qarkullimit të parasë, por ajo që brengos më së shumti është gatishmëria mercenare e kosovarëve për t'i përvetësuar këto praktika fetare, kundrejt një pagese konkrete ose kundrejt një statusi më të mirë ekonomik. Duket se edhe në këto rrethana të reja çuditërisht u ngjall prirja e vjetër shqiptare që identitetin fetar ta shesin ose ta blejnë për dy aspra.

Por a është vetëm e jashtme prania më e madhe e ikonografisë fetare në Kosovë, e numrit të atyre që praktikojnë fenë, e frekuentuesve të tempujve fetarë, pra, përgjithësisht të atyre që quhen besimtarë të rinj? A është e shoqëruar kjo jashtësi me një lëvizje të brendshme, ta quajmë shpirtërore, me një ndryshim esencial në konstalacionin mental të njeriut të Kosovës, i cili, sipas asaj që shihet nga jashtë, tani beson në Zot më shumë se ç'ka besuar ndonjëherë më parë? Një përgjigje e saktë në këtë pyetje është e vështirë, sepse nuk mund të bëhet një ndarje e prerë dhe një identifikim i qartë se kush e praktikon fenë si nevojë shpirtërore, pra kush është religjioz në të gjithë përbërësit e tij mendor dhe shpirtëror, apo kush e ushtron fenë me të tjera motive, përfshirë edhe mercenarizmin. Por,

pavarësisht nga dilemat e këtilla, shtimi i numrit të besimtarëve në Kosovë pas vitit 1999 është evident dhe kjo nuk mund të shpjegohet me asnjë parametër tjetër, përveç se me *krizën e identitetit*. Pra, Kosova gjatë këtyre viteve ka përjetuar, ndër të tjera, edhe krizën e vetëdijes për përkatësi. Pas luftës, njerëzit në Kosovë duket se kanë ndjerë paqëndrueshmëri identitare, kanë ndjerë mungesë plotënie identitare dhe, me kohë, sikur kanë filluar të kërkojnë kompensim për mungesën.

Por çfarë në të vërtetë iu mungon shqiptarëve të Kosovës, që tani duhet t'i kthehen fesë, çfarë duan të kompensojnë me këtë? Pse tani duhet të ndihen sikur iu mungon diçka, sikur kërkojnë diçka që nuk do ta gjejnë në pragmatizmin jetësor, por e kërkojnë në misticizëm? Cilat janë ato dilema që i mendojnë? Pse një numër më i madh kosovarësh tani kërkojnë strehë te Zoti më shumë se ç'e kanë bërë ndonjëherë më parë? Cilat janë problemet e tyre, e bëjnë këtë për shkak të pamundësisë gnoseologjike për të dhënë përgjigje në pyetjet e gjithmonshme për jetën dhe vdekjen, për amshimin, për universin, apo kanë të pazgjidhura shumë çështje pragmatike, krejtësisht tokësore, të cilat i kanë aq të ngatërruara, sa nuk kanë shpresë se mund t'i zgjidhin ndryshe, përveç se me besimin në Zot...?

Përsëri nuk mund të gjejmë një përgjigje plotësisht të saktë, por duket se lufta e fundit ka ndryshuar shumëçka në jetën e njerëzve në Kosovë. Ka ndryshuar, ndër të tjera, edhe filozofinë e jetës, nëse e kanë pasur një të tillë; ka ndryshuar perceptimin e tyre për moralin, i cili nuk është më statik; ka ndryshuar perceptimin e tyre për jetën tokësore dhe jetën e amshueshme; madje edhe për kombin, për shtetin, për lirinë, për të gjitha. Idealet, të cilat dikur i jepnin kuptim jetës, i bënin njerëzit të shpresonin dhe të ëndërronin, tani nuk kanë ndonjë domethënie, ose përbëjnë *zhgënjimin* më të

madh dhe më të rëndë. Kosova e ka pasur kohën e ëndrrave të mëdha, të cilat tashmë janë zhbërë. Njerëzit kanë shpresuar se me lirinë do t'i zgjidhin të gjitha problemet jetësore, por ajo liri nuk u dha asgjë në krahasim me atë që kishin ëndërruar. Kosova, për të cilën u flijuan djem dhe vajza të mrekullueshme, tani është një emër vendi pa shumë vlerë. Kosovën nuk e do më njeri. Ajo është një gënjeshtër e madhe. Gënjeshtër e madhe është edhe liria, gënjeshtër e madhe është edhe kombi, gënjeshtër e madhe është edhe atdheu, shteti, edhe pavarësia. Vetëm një kuptim ka mbetur i paprekur, e ajo është providenca qiellore, është Zoti. Çdo gjë tjetër ka humbur vlerë...

Se feja në këtë rast është pjesë e krizës, pjesë e krizës së moralit, *pjesë e krizës së identitetit* dhe jo rrugë e daljes prej saj, e dëshmon edhe një fakt tjetër: Kosova kurrë nuk ka pasur kaq besimtarë, nuk ka pasur kurrë më shumë njerëz që agjërojnë, nuk ka pasur kurrë më shumë njerëz që falin pesë vaktet, nuk ka pasur kurrë më shumë njerëz që shkojnë në xhami, nuk ka pasur kurrë më shumë vajza dhe gra të reja të mbuluara, nuk ka pasur kurrë më shumë burra dhe djem të rinj me veshje jotipike; por njëkohësisht nuk ka pasur kurrë më shumë amoralitet dhe kaq mungesë vlerash njerëzore, kaq shumë prirje kriminale dhe kaq shumë shfytyrim njerëzor, kaq shumë erozion të brendshëm dhe kaq shumë degradim kolektiv dhe individual. Nuk ka pasur kurrë kaq shumë krim, drogë, prostitucion, trafikim, gënjeshtër, hajni, korrupsion, imoralitet, hipokrizi, gjë që, sipas një logjike elementare, bie në kundërshtim të thellë me frymën e përsëritshme që kultivon secila fe dhe secili besim fetar. Nëse feja nuk është një katalizator i moralit kolektiv dhe individual, atëherë për çfarë shërben ajo? Kjo kundërshti e brendshme, e cila jeton në qenien e kosovarit që një kohë të gjatë, e bën atë të vështirë për një definicion sociologjik, por

një prè fare të lehtë për deformime të llojlojshme. Vetëm një identitet i qëndrueshëm mund ta ndalë këtë erozion pothuajse shkatërrues.

Një brengë më vete përbën fakti se lëvizjet fetare në Kosovë, qofshin islamiste qofshin të krishtera, janë klandestine dhe funksionojnë jashtë rregullave institucionale dhe larg syve të opinionit të gjerë. Ato shprehen me rivalitet njëra kundrejt tjetrës, po aq sa rivalitetin e shprehin kundrejt institucioneve të shtetit, të cilin e shohin të lehtë për ta manipuluar, meqë bëhet fjalë për një shtet të ri dhe të paqëndrueshëm. Derisa Kosova të mos stabilizohet në të gjitha pikëpamjet, grupet religjioze do të përpiqen të krijojnë hapësirë sa më të gjerë dhe status sa më të favorshëm për veten e tyre, në shoqërinë kosovare dhe në shtetin ri të Kosovës, duke përdorur dhe duke i shfrytëzuar të gjitha rrugët, legale ose ilegale. Një Kosovë e pastabilizuar, me qeverisje të keqe dhe me institucione të paqëndrueshme; një shtet me shtetasit e zhgënjyer dhe me kriza të mëdha sociale; njësoj sikundër edhe një identitet i paqëndrueshëm komunitar dhe individual; të gjitha këto përbëjnë terren të përshtatshëm për depërtimin e rrymave radikale fetare, përfshirë këtu edhe fundamentalizmin si manifestim jashtësor i një konfuzioni brenda qenies shpirtërore të kosovarit, tashmë i traumatizuar nga shumësia e gjërave të mbetura në gjysmë të rrugës.

IDENTITETI GJUHËSOR

Vartësia gjuhësore e Kosovës

Gjuha është njeri nga përbërësit kryesorë të identitetit. Nëse një popull gjatë historisë ka arritur të ruajë gjuhën, ai ka arritur të njohë qoftë edhe pjesërisht kuptimin e lirisë. Më anë tjetër, popujt që kanë humbur gjuhën, bashkë me të realisht i kanë humbur të gjitha betejat, pra në një mënyrë kanë shpallur kapitullimin e përhershëm para pushtuesve, para asimiluesve, para integruesve, pavarësisht se me çfarë emri janë quajtur dhe quhen ata që pushtojnë kombe dhe zhbëjnë gjuhët e tyre. Pra, njësia gjuhësore është njësi kombëtare dhe ajo ndërtohet mbi dendësinë më të madhe të komunikimit, ndërsa nevoja për komunikim intensiv vjen si rezultat i jetës në një bashkësi. Në kohët moderne rrathët e komunikimit janë zgjeruar ndjeshëm, kanë pësuar ndryshime të mëdha strukturore dhe, së këndejmi, edhe koncepti i gjuhës si përbërës i identitetit ka ndryshuar, por nuk është mënjeluar tërësisht. Që të ndryshohen disa esenca gjuhësore, duhet të ndryshojë historia e njerëzimit dhe kjo, natyrisht, është e pamundur. Që të ndryshojnë disa funksione gjuhësore në ditët e sotme, së pari duhet të ndryshojë ekzistenca njerëzore dhe kuptimi i saj dhe kjo, natyrisht, hë për hë duket e pamundur.

Kosova ka specifikat e saj gjuhësore dhe ato kryesisht janë të lidhura me rrethanat historike, nëpër të cilat ka kaluar populli i saj. Në trungun e gjuhës shqipe

përgjithësisht vërehen plagë të shumta, në gjuhën e Kosovës gjithashtu. Nga pësimet e mëdha të saj konsiderohen huazimet e shumta, defektet sintaksore, përdegëzimet e mëdha dialektore. Nga arritjet e saj më të mëdha konsiderohet ruajtja e tërësisë, e cila përbën një njësi koherente gjuhësore, pavarësisht nga diferencat e krijuara në dialekte dhe në përçopëzime të tjera. Veçantia e gjuhës shqipe është njëkohësisht edhe madhështia e saj. Një nga sukseset më të mëdha të Kosovës gjatë historisë është ruajtja e gjuhës. Kosova nuk e humbi gjuhën dhe nuk bëri gjuhë tjetër, megjithëqë në periudha të ndryshme iu nënshtrua trysnive të shumta për t'u shkëputur nga *trungu gjuhësor i shqipes*. Humbja e identitetit gjuhësor është humbje e identitetit kombëtar, pra është zhbërje e pakthyeshme. Kosova arriti në ditët e sotme shumë e lënduar, por, së paku, në pikëpamje gjuhësore, edhe përkundër degradimit të paevitueshëm, nuk përjetoi zhbërje.

Pra, shkenca e gjuhësisë thotë se Kosova nuk ka gjuhë të veten, gjuhë të veçantë, madje nuk ka as dialekt, ka vetëm një të folme, ose nëndialekt. Nëndialekti i saj është gegërishtja verilindore, i studiuar mirë në të gjitha degëzimet dhe variantet fonetike dhe morfologjike, që domethënë se e folmja e Kosovës në pikëpamje diakronike është zhvilluar në kuadër të dy njësisive më të mëdha gjuhësore: në kuadër të një dialekti, gegërishtes, dhe në kuadër të gjuhës shqipe si një e tërë. Duke e ditur këtë rrethanë, e folmja e Kosovës nuk përbën as histori më vete: variantet e saj paraqiten si variante të gegërishtes dhe shkrimit të saj i atribuohet po ajo histori që njihet si histori e shkrimit shqip. Nëse insistojmë te rrënjët e saj të veçanta, atëherë ato e përjashtojnë edhe Bogdanin, sepse gjuha e tij është një gegërishte e integruar tashmë në njëfarë tradite të letërsisë së vjetër shqipe dhe nuk insiston në krijimin e

ndonjë varieteti gjuhësor të ndarë ose të veçantë. E folmja e Kosovës mund të bëhej e tillë vetëm pas vitit 1912, kur Kosova mbeti jashtë Shqipërisë londineze, por një mundësi e tillë nuk doli as hipotetike, sepse gjuha dhe shkrimi shqip u ndaluan deri në Luftën e Dytë Botërore, saktësisht deri më 1941. Pas këtij viti, në përdorim zyrtar, por më shumë në institucionet e arsimit, Kosova adaptoi variantin gegë të shkrimit të gjuhës shqipe, sepse, për shkak të rrethanave të njohura, ajo nuk kishte krijuar një variant të vetin të shkrimit. Madje një variant të tillë ajo nuk e kishte pasur as para vitit 1913, kur u pushtua nga Serbia. Si njëri nga katër vilajetet shqiptare, Kosova, me qendrën e saj Shkupin, ose me qytetin e rëndësishëm Prizrenin, nuk kishte luajtur asnjë rol kulturor në botën shqiptare, larg nga roli që luajtën në atë kohë Shkodra, Korça, ose edhe Janina e Manastiri. Pra, në ndalimin e gjuhës shqipe nga Serbia dhe Jugosllavia pas pushtimit të saj më 1913, Kosova hyn me shkrim të paktë shqip, por me një dendësi shumë më të madhe të shkrimit turk, përfshirë këtu edhe një përdorim deri-diku të përhapur të shkrimit të shqipes me alfabet turko-arab ose sllav.

Periodha e Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht se kohë e pushtimit, realisht përcaktoi kahet e zhvillimit të ardhshëm gjuhësor të Kosovës, pra një zhvillim kryekëput i varur nga Shqipëria. Që të ndodhte kështu, nuk duhet përjashtuar edhe ndikimin e rrethanave politike, por më shumë këtë situatë duhet parë si pasojë logjike e zhvillimeve brenda vetë konstalacionit kulturor të Kosovës. Kosova nuk kishte traditë shkrimi, nuk kishte traditë letrare, nuk kishte traditë gjuhësore. Krejt çka mund të bënte, ajo mund të adaptonte përvojën e Shqipërisë, e cila në periudhën e mbretërisë kishte bërë hapa të jashtëzakonshëm në fushën e arsimit, të kulturës, të letërsisë, të publicistikës. Sikundër e kemi shpjeguar edhe më parë, qoftë për inerci, qoftë për

shkak se *pushteti populluer* nuk mund të bënte më pak se ç'kishte bërë fashizmi, në vitet vijuese në Kosovë ndiqet politika e marrjes nga Shqipëria (legalisht, gjysmë-legalisht ose ilegalisht) të krejt korpusit gjuhësor, ose dijes gjuhësore për përdorim praktik në shkollë, pjesërisht në institucionet e kulturës dhe shumë më pak në administratë. Gjuhëtarët e Kosovës, të cilët filluan të paraqiteshin në skenë që nga fillimi i viteve pesëdhjetë, megjithëqë të kontrolluar rreptësisht nga pushteti, nuk mund të bënin gjë tjetër, përveç se të adaptonin me ndonjë vit vonesë normat drejtshkrimore që i kishte vendosur Shqipëria. Kosova nuk kishte potencial të bënte standard të ri gjuhësor dhe as drejtshkrim të ri. Kishte filluar mësimin e shkrim-leximit me abetare të huajtura nga Shqipëria dhe me mësues gjithashtu nga Shqipëria. Tani që marrëdhëniet me Shqipërinë ishin të tendosura, mësuesit e gjuhës ende vjedhurazi shikonin se çfarë thuhej në tekstet që dikur ishin marrë që andej, ndërsa një numër syresh, studentët dhe studiuesit e katedrës së albanologjisë në Beograd, mund të quheshin të privilegjuar, sepse Dançetoviqi kishte autoritet që t'u siguronte literaturë nga Shqipëria, një të tillë literaturë që askush tjetër nuk e kishte në Kosovë.

Por, sido që të ishte, Shqipëria mbetej burimi i vetëm i të gjitha dijeve për këtë fushë. Disa albanologë ose dijetarë të gjuhës, të mbetur në emigracion, si Ernest Koliqi, Krist Maloki, Selman Riza, më vonë Martin Camaj etj. në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore nuk arritën të krijonin ndonjë qendër të studimeve albanologjike jashtë Shqipërisë (Instituti Albanologjik i Prishtinës u hap më 1953 dhe u mbyll 1955) dhe puna e tyre krijuese dhe studimore ishte individuale, pra nuk mund të zëvendësonte atë institucionale, e cila filloi të zhvillohej intensivisht brenda shtetit shqiptar. Unë sot jam i prirë të besoj se Jugosllavia e

kishte një synim të tillë, që të mblidhte të dëbuarit veriorë nga Shqipëria dhe ta rivalizonte shtetin shqiptar në të gjitha fushat, ashtu siç kishte bërë në politikë, duke bërë një qeveri shqiptare në ekzil edhe në Kosovë. Këtij supozimi i jep krah edhe një korrespondencë e Martin Camajt me Krist Malokin, i cili nga Graci synonte të zhvendosej në Beograd, por edhe nga fakti se me Selman Rizën kishin shpenzuar shumë kohë dhe mund, mbase për ta bindur që ta pranonte dhe ta mbështeste një projekt të tillë. Nuk është fshehtësi, Camaj kishte lidhje të forta me shtetin jugosllav. Ai ishte dhëndër i njërit nga personat e rëndësishëm të sigurimit serb, ndërkohë që mbante lidhje të afërta me Koliqin në Romë. Edhe Koliqi nuk ishte person i panjohur për Jugosllavinë dhe as Jugosllavia nuk ishte e panjohur për të. Në kohën e Zogut, si përkrahës i Nolit në Revolucionin e Qershorit, ai kishte kaluar disa vjet në ekzil, pikërisht në Jugosllavinë e atëhershme, një herë në Mal të Zi dhe më pastaj në Tuzëll të Bosnjës, ku jetonte i mirëmbajtur bashkë një shpurë të tërë shqiptarësh. Për idenë time, tani Camaj paraqitet si koordinator i një projekti të këtillë, vetëm se është Selman Riza ai që del jashtë këtij rrethi dhe jashtë këtij sistemi. Vetëm Riza kishte dije dhe autoritet që ta bënte një qendër studimesh albanologjike dhe me këtë, edhe në punë të gjuhës, ta rivalizonte dhe ta shantazhonte Shqipërinë. Edhe ai, i dorëzuar nga Shqipëria në duart e jugosllavëve, për një kohë duket se i ofrohet mundësia për materializimin e ndonjë ideje subversive kundër Shqipërisë, sepse derisa gjendet në burg, në Prishtinë dhe në Sarajevë, gëzon status të privilegjuar. Në Sarajevë mban burgun, por njëkohësisht është edhe lektor i frëngjishtes në universitet. Mund të supozohet se me idenë e rivalizimit të Shqipërisë hapet edhe Instituti Albanologjik i Prishtinës, Selman Riza bëhet drejtor, por dy vjet më vonë Instituti mbyllet dhe Selman Riza dëbohet në Shqipëri, sipas gjasës si i pabindur për t'iu

kundërvënë Shqipërisë në krijimin dhe aplikimin e një standardi gjuhësor ndryshe nga ai i Tiranës. Për një kohë të gjatë Shqipëria dyshon te Selman Riza, e survejon hap pas hapi, një herë e internon në Berat, por nuk e burgos, mbase duke ia njohur meritën për refuzimin dhe konsekuencën që kishte treguar ndaj jugosllavëve. Hetimet rreth tij pezullohen nga organet e sigurimit të shtetit shqiptar disa vjet pas vdekjes. Duket se dështimi i këtij projekti e çon edhe Camajn në Romë, ku edhe për disa vjet vazhdon ta mbajë për grua vajzën e sigurimit të njohur serb. Së fundmi ndahet edhe prej saj dhe Camaj nga Roma shkon në Mynih. Projekti për t'iu kundërvënë Shqipërisë në punë të gjuhës dështon përfundimisht. Pas prishjes së Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe daljes së saj nga Traktati i Varshavës, Titoja rikonfiguron politikën e Jugosllavisë ndaj Shqipërisë, por edhe ndaj Kosovës, njëkohësisht.

Edhe ngjarjet e brendshme gjuhësore në Kosovë afërsisht kanë një rrjedhë të tillë, që në një mënyrë reflektojnë politikën e shtetit jugosllav ndaj Shqipërisë dhe ndaj shqiptarëve të mbetur në Jugosllavi. Më 1952 Kosova vendos të mbajë gegërishten si gjuhë të shkrimit. Pra, bëhet fjalë për një fuqizim të *idesë së ndarjes*, pikërisht atëherë kur Shqipëria po bënte hapat e parë të ndërtimit të standardit të mbështetur në toskërishte. Më 1957, pas një periudhe të dhunës së madhe shtetërore në Kosovë, mbahet një tjetër mbledhje gjuhëtarësh në Prishtinë, në të cilën kërkohet që gjuha e shkruar të jetë sa më afër gjuhës së folur. Me këtë vendim tendenca e ndarjes fuqizohet edhe më tej. Por tani vjen një kohë kur politika duhet të ndryshojë, kështu që më 1964 gjuhëtarët e Kosovës vendosin të ndjekin vendimet e gjuhëtarëve të Shqipërisë, duke *adaptuar* për Kosovën ortografinë e Tiranës të vitit 1956, e cila çonte në përafrimin më të madh të dy dialekteve. Katër vjet më vonë, pra më

1968, mbahet Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e cila mori vendim që në Kosovë të vihej në përdorim zyrtar dhe publik shqipja letrare, e tillë siç ishte kodifikuar në “Projektin e rregullave të drejtshkrimit”, publikuar në Tiranë në vitin 1967. Në të vërtetë, ky ishte një projekt në diskutim publik, i cili synohej të miratohej në momentin përkatës, sikundër që ndodhi në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972.

Pjesëmarrja pasive e Kosovës

Për shkak të rrethanave të brendshme, të cilat nënkuptonin në radhë të parë traditën e munguar për të bërë shkrimin shqip, si dhe potencialin e paqenë studimor, Kosova do të arrijë pothuajse deri në mes të shekullit XX pa variantin e saj të gjuhës letrare, sikundër edhe me një përfshirje të vonuar në proceset gjuhësore shqiptare. Procesi i standardizimit të gjuhës shqipe kishte filluar që nga periudha e Rilindjes Kombëtare, por përpjekjet u intensifikuan pas themelimit të shtetit shqiptar dhe me intensitet të shtuar vazhduan deri në Kongresin e Drejtshkrimit. Ky proces në një mënyrë vazhdon edhe sot e kësaj dite. Për shkak të rrethanave politike dhe historike, veçmas për shkak të vonësive në emancipim arsimor dhe kulturor, me të cilët gjuha lidhet në mënyrë të veçantë, Kosova nuk mund të bënte gjë më shumë, përveç se, për aq sa kishte mundësi, të përfshihej në proceset që zhvilloheshin në Shqipëri. Por edhe ndjekja e këtyre proceseve varej nga çfarësia e politikave që bënte Jugosllavia ndaj Shqipërisë dhe ndaj Kosovës, politika këto që kaluan nëpër faza të ndryshme, disa pak më produktive, disa të tjera thellësisht negative.

Faza e parë e këtyre marrëdhënieve kap periudhën 1941-1948, e cila përfshin kohën e fashizmit dhe idilin e marrëdhënieve të shteteve komuniste Shqipëri-Jugosllavi. Në këtë periudhë Kosova merr çdo gjë nga Shqipëria, abetare, mësuës, shkollë, libra leximi, libra mësimorë, literaturë, gjuhë, drejtshkrim, shkronja për shtypjen e gazetave, pra çdo gjë që ka të bëjë me ngritjen arsimore dhe emancipimin kulturor. Në pikëpamje gjuhësore, sikundër mund të vërejmë nga lënda publicistike e botuar në atë kohë, Kosova përpiqet të aplikojë një gegërishte deri-diku të standardizuar, por me shumë mangësi dhe defekte drejtshkrimore. Megjithatë, në këto vite të marrëdhënieve Kosovë-Shqipëri do të trasohet një rrugë e shkrimit të gjuhës shqipe në Kosovë, e cila do të ndiqet më vonë në variantet më shumë ose më pak të standardizuara.

Faza e dytë, që përfshin periudhën 1952-1964, karakterizohet me një *subversion gjuhësor*, të cilin Jugosllavia përpiqet t'ia bëjë Shqipërisë dhe gjuhës shqipe, duke iniciuar, duke nxitur dhe duke stimuluar procese që do të shkonin në drejtim të ndarjes dialektore të gjuhës letrare shqipe. Meqë Shqipëria tashmë i kishte nisur hapat e përshpejtuar të vendosjes së toskërishtes në themelet e gjuhës letrare të njësuar, Jugosllavia, përmes Kosovës dhe të disa intelektualëve gegë të shpërndarë nëpër botë dhe të pakënaqur me këtë zhvillim, përpiqet të fut dhe të mbajë në konkurrencë variantin e gegërishtes, duke synuar kështu që Kosova të bëhej qendër kulturore dhe politike e një *Gegërie të rebeluar* kundër Tiranës. Jugosllavia edhe ashtu kishte strehuar një numër të konsiderueshëm pjesëtarësh të bandave rebele nga veriu i Shqipërisë, të cilat, duke qenë të lidhura me Jugosllavinë, nuk dihej nëse tashmë ishin më shumë antikomuniste apo antishqiptare. Pikërisht në këtë kohë vjen edhe vendimi i gjuhëtarëve të Prishtinës për ta

afruar drejtshkrimin me gjuhën e folur (1957), parim ky që binte në kundërshtim me proceset e njësimimit dhe të përafrimit gjuhësor.

Faza e tretë kap periudhën 1964-1972. Tani, sikundër e thamë, strategjia politike e Jugosllavisë kundrejt Shqipërisë ndryshon pothuajse rrënjësisht. Nuk synohet që Kosova të përdoret për subversion kundër Shqipërisë, por përmes saj të ruhet një drejtpeshim i Shqipërisë jobllokiste. Titoja bëhet shumë i vëmendshëm ndaj Shqipërisë, sepse rreziku nga Traktati i Varshavës, përmes Shqipërisë eventualisht të rikthyer atje, si dhe përmes Kosovës, tani merr rëndësi më të madhe se aspirata e dikurshme për të bërë Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë. Mbledhja e gjuhëtarëve të Kosovës e mbajtur më 1964, ndonëse me vonesë, e kthen Kosovën në gjendjen përpara tentativës për subversion gjuhësor, duke vendosur që në Kosovë të futet në përdorim ortografia e Tiranës e vitit 1956. Në vitet vijuese Kosova përjeton ndryshime të mëdha, veçmas pas vitit 1966. Kësaj shtate të re, të entuziazmit dhe të përlindjes kombëtare, i përgjigjet Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e vitit 1968, e cila merr vendim që Kosova përfundimisht t'i afrohet Shqipërisë në punë të gjuhës, duke hapur rrugën që katër vjet më vonë, në Kongresin e Drejtshkrimit, të bëhet pjesë e vendimmarrjes.

Nga kjo perspektivë, tani mund të shtrohet pyetja nëse pjesëmarrja e Kosovës në Kongresin e Drejtshkrimit ka qenë përfaqësuese, pra edhe demokratike, apo ka qenë një vendim politik *komunist dhe diktatorial*. Në asnjë variant nuk mund të kontestohet pjesëmarrja e kosovarëve në këtë kongres, sepse ajo ishte një përfaqësi më e mira e kohës, intelektuale dhe profesionale gjuhësore. Por ne tani mund të shtrojmë dilemën nëse kosovarët mund të shpreheshin lirshëm për vendimet e Kongresit, respektivisht nëse mund

t'i kundërshtonin ato. Në të vërtetë, sikundër dihet, Kongresi ishte një akt solemn i kurorëzimit të një procesi, të cilin Kosova e kishte pranuar që më 1968, kur ishte marrë vendimi që në përdorim zyrtar të fuste drejtshkrimi e Tiranës të miratuar një vit më parë. Por as periudha prej atij viti, deri më 1972, nuk ishte karakterizuar me ndonjë kundërshtim ose dilemë. Në Shqipëri mund të shuheshin me forcë zërat kundërshtues, sepse vërtet bëhej fjalë për një diktaturë të egër, por në Kosovë nuk burgosej njeri, nëse kundërshtonte vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit, apo futjen e kësaj gjuhe letrare në Kosovë. Kundërshtues i hapur i standardit të vitit 1972 që atëherë ka qenë një shkrimtar për fëmijë (Rexhep Hoxha) i Kosovës, i cili vazhdoi të shkruante gegërisht edhe për një kohë, dikur hoqi dorë dhe iu bashkua shumicës.

Pra, kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e Kosovës në Kongresin e Drejtshkrimit, kontestimet nuk mund të prekin disa pika themelore. Një, përfaqësia e Kosovës në Kongres vërtet nuk ishte e zgjedhur, ishte e deleguar, mirëpo një proces i këtillë ishte i zakonshëm për kohën dhe për natyrën e mbledhjes. Dy, edhe sikur kosovarët të kishin të drejtë kundërshtimi, ose votimi kundër, këtë nuk do ta bënin, jo vetëm për shkak të atmosferës së diktatit apo të entuziazmit, por ngase ishin të bindur se *njësimi i gjuhës letrare shqipe* ishte i drejtë, madje edhe duke vënë në bazë toskërishten. Tre, edhe përkundër faktit se Kosova kishte arritur të bënte disa gjuhëtarë të autoritetshëm, ajo ende nuk kishte potencial studimor të kundërshtonte asnjë vendim të Kongresit dhe asnjë rregull drejtshkrimore. Katër, potenciali studimor i Kosovës më vonë u rrit dhe u shtua, duke kapur majat e studimeve gjuhësore shqiptare, por kundërshtimet e vendimeve të Kongresit asnjëherë nuk erdhën nga kjo proveniencë shkencore. Pesë, vendimi për të zbatuar edhe

në Kosovë standardin e vitit 1972 mund të ketë qenë politik, komunist, që domethënë jodemokratik, por edhe sikur ky vendim të hidhej në referendum, mbi 90% e kosovarëve do ta miratonin atë.

Ata që morën vendim në nivelet më të larta jugosllave, që Kosova të zbatonte standardin e Tiranës, njësoj sikundër që miratuan pjesëmarrjen e kosovarëve në Kongresin e Drejtshkrimit, nuk ishin të tillë që kërkonin zgjidhjen më të mirë për Kosovën dhe për shqiptarët në Jugosllavinë e atëhershme. Petar Stambolliqi ia miraton Fadil Hoxhës pjesëmarrjen e kosovarëve në Kongresin e Drejtshkrimit. Nuk është për të besuar se ai e bënte këtë për të ndjekur me konsekuencë politikat e Titos rreth barazisë së kombeve dhe kombësive, ose të vetëqeverisjes socialiste. Sikundër e kemi thënë, prapavija ishte politike dhe kishte të bënte me shqiptarët si grupi etnik i tretë për nga madhësia në ish-Jugosllavi, si dhe me rrethanat e brendshme dhe të jashtme të shtetit të atëhershëm jugosllav. Shqiptarët në Jugosllavi kishin arritur në një nivel të tillë të emancipimit dhe të realizimit të të drejtave, sa që për ta mbajtur situatën nën kontroll kishte vetëm një zgjidhje: ndikim sa më të madh në politikëbërjen e Shqipërisë, përmes intensifikimit të marrëdhënieve Kosovë-Shqipëri, ndër të tjera, duke synuar edhe një *pushtim* të ri ekonomik, ideologjik dhe kulturor të Shqipërisë nga Jugosllavia jashtëzakonisht e avancuar dhe tej mase e autoritetshme në botë. Gjuha e përbashkët mund të ishte një mjet i depërtimit të Kosovës, e bashkë me këtë edhe i krejt konstalacionit jugosllav në Shqipëri. Jugosllavia ishte shtet i fuqishëm dhe me pozitë të fortë ndërkombëtare. Mirëpo, në këtë rrethanë ajo e kishte mbiçmuar fuqinë e saj. Edhe përkundër të gjithave, ajo ishte e vetëdijshme për një defekt shumë të madh dhe një pikë tepër të ndjeshme: marrëdhëniet komplekse ndërnacionale dhe çështjet e

pazgjidhura kombëtare. Çështja shqiptare konsiderohej si njëra nga ato çështje të ndjeshme. Avancimi i shpejtë i pakicës shqiptare e kishte tronditur Jugosllavinë. Asaj i duhej bërë koncesione, për ta mbajtur luajale. Më anë tjetër, nëse synohej që shqiptarët të shkëputeshin gjuhësisht dhe kulturalisht nga Shqipëria, përfundimi mund të dilet, në rastin më të mirë, një Maqedoni e re; në rastin më të keq, një Moldavi. Fundja, nëse Kosova avanconte statusin e saj qoftë edhe përmes krijimit të një kombi me gjuhë të re, problemi nuk ishte i Jugosllavisë, derisa ajo të mos kërkonte shkëputjen, por ishte i Serbisë, e cila nuk pranonte ta këmbente “Kosovën e saj” me “Kosovën jugosllave”.

Atëherë, nëse politika kishte rol në vendimet gjuhësore të Kosovës, politika kryesore rreth kësaj çështjeje nuk u bë as në Tiranë, as në Prishtinë, por në Beograd. E ajo politikë, kësaj radhe, nuk shkonte në drejtim të kundërt me proceset e natyrshme të një populli të ndarë, por ishin në konkordancë me interesat e tij. Natyrisht se as Jugosllavia dhe as Serbia nuk e kishin mendjen të shqiptarët, madje politikat e reja vetëm sa i kishin futur përkohësisht në sirtarë projektet e vjetra të zhbërjes së tyre, por ata për herë të parë përballeshin me shqiptarët jo më vetëm si problem politik, historik, demografik, por edhe si *problem kulturor*. Në këtë pikë ata nuk e gjenin dot një modus veprimi, i cili, në njërin anë nuk do të shkonte në kundërshtim me parimet fundamentale të Jugosllavisë, ndërsa më anë tjetër, do të tregohej efikas në pacifizimin e shpejtë të tyre.

Ballafaqimi i Jugosllavisë me problemet kulturore dhe identitare të kombeve të veçanta, përfshirë këtu edhe shqiptarët, nxori si domosdo intensifikimin e procesit të integritimit jugosllav. Në këtë rrethanë, gjuha shqipe në Kosovë dhe në Jugosllavi, tani e standardizuar dhe plotësisht e njëjtë me gjuhën e Tiranës, më shumë se të gjithë

përbërësit e tjerë idnetitarë, duhej të përballej sa me serbokroatishten e avancuar dhe të kudondodhur, po aq edhe me përbërës të tjerë të jugosllavizmës. Deri në vitin 1972 gjuha shqipe as në Kosovë dhe as gjetiu në Jugosllavi nuk ishte gjuhë rivale me serbokroatishten, jo vetëm pse nuk ishte e barabartë (e tillë nuk do të ishte as më vonë), por ajo nuk kishte as kornizë kulturore, nuk kishte koherencë, nuk kishte shtat të formuar. Tani situata kishte ndryshuar: që nga viti 1972 gjuha shqipe do ta fillojë përballjen e saj me gjuhët sllave, një luftë që bëhej në terrenin e saj, prandaj do të ishte tepër e gjatë dhe shumë e vështirë.

Ambienti bilingual

Pra, shkuarja e Kosovës në Kongresin e Drejtshkrimin ishte paraprirë nga një proces i gjatë gjuhësor dhe politik, herë konsekuent dhe herë jokonsekuent. Ky proces nuk ishte i njëjtë me atë të Shqipërisë, ishte më i vonuar, në shumë raste i shkonte prapa atij të Shqipërisë, por kishte edhe specifikat e tij politike dhe kulturore. Disa nga këto specifika politike i përmendëm më sipër dhe derisa ato në një mënyrë u bënë të qarta pas përfundimit të një procesi historik për Kosovën, megjithatë stimuli me i madh politik dhënë drejtshkrimin erdh nga nacionalizmi i shqiptarëve të Kosovës, në këtë fazë të entuziazmit kombëtar, të cilët çdo gjë që vinte nga Shqipëria ishin në gjendje ta përvetësonin pa ndonjë qëndrim kritik. Por, a kishin kosovarët zgjidhje tjetër, edhe sikur të mbanin qëndrim kritik? Sot mbase gjendet ndokush që thotë se Kosova ka mundur të veprojë edhe ndryshe, por atëbotë askujt nuk i shkonte mendja të identifikohet si antikombëtar, madje as atyre që vërtet ishin

të tillë. Zëra kundërshtues nuk u paraqitën as nga radhët e atyre kosovarëve që ishin luajalë ndaj pushtetit, madje as nga Beogradi, apo nga ndonjë qendër tjetër e ish-Jugosllavisë. Përvetësimin e drejtshkrimit nga Tirana të gjithë e quanin proces normal, sepse *Një komb, një gjuhë!* ende kishte mbetur parim i gjithëpranueshëm pothuajse në krejt diskutimet për identitetin të shekullit XX. Por, kosovarët a kishin zgjidhje tjetër? Jo, sepse atëbotë, edhe sikur ta kishin vullnetin politik dhe kulturor, ata nuk kishin potencial intelektual për të bërë një gjuhë të veçantë letrare. Edhe sikur fare të mos ishin përfshirë në procesin gjuhësor që zhvillohej në Tiranë dhe sikur t'i përmbaheshin me fanatizëm traditës së gegërishtes, përsëri do futeshin në një proces retardues, zvetënues, shpërbërës, vetizolues dhe nga një pjesë funksionale e kombit do të shndërroheshin në *enklavë* ose *diasporë*. Që të bëhemi krejtësisht të sinqertë, duhet thënë se kosovarët nuk kishin zgjidhje tjetër, sepse as që mund të bënin një zgjidhje tjetër, as që kishin potencial kulturor për një zgjidhje tjetër. Ata ishin të destinuar të mbaheshin pas Shqipërisë, si e vetmja alternativë, kundrejt shpërbërjes që mund t'u ofrohej, pa ndonjë çmim të lartë. Ata duhej të mbaheshin pas Shqipërisë që ta mësonin gjuhën, që të lexonin literaturë, që të emancipoheshin, që të edukoheshin, që të arsimoheshin. Këtë zgjedhje ata nuk e bënë për të mbështetur një ide abstrakte, as për t'iu gjendur në krah Shqipërisë, por e bënin për veten e tyre dhe për një arsye krejt pragmatike.

Ndërkaq, specifikat kulturore të përvetësimit të standardit në Kosovë kaluan nëpër një zhvillim të njëkohshëm me emancipimin arsimor dhe kulturor, proces ky që kishte parashenjë kombëtare dhe që për kundërshtar, përveç injorancës dhe prapambetjes, kishte joshjen kulturore të jugosllavizmës. Kosova atëbotë ishte përfshirë nga një

idealizëm i madh iluminist dhe kosovarët me nguti bënë letërsi, bënë arte, bënë studime, hartonin disertacione të doktoraturës, lexonin literaturën që vinte nga Shqipëria, përkthenin shqip shkrimtarë botërorë, studime filozofike dhe sociologjike, shumica nga serbokroatishtja, e cila tashmë kishte marrë një hapje të madhe ndaj botës, pas proklamimit të pluralizmit të metodave letrare-artistike dhe studimore. Kjo *dyanësi* kulturore e Kosovës, lidhja e njëhershme kulturore me Shqipërinë dhe Jugosllavinë, i kishte përparësitë e veta, por shkaktonte edhe disa probleme. Kosova ishte në fazën e bashkërenditjes me kulturën kombëtare dhe në këtë proces ajo duhej të hynte me disa vlera të krijuara, ndryshe bashkërenditja do të ishte e mangët, pra nuk do të ishte e tillë, do të ishte më shumë *aneksim kulturor* i Kosovës nga ana e Shqipërisë.

Ndërkaq, Shqipëria i kishte kufizimet e veta politike, ideologjike, por edhe pamundësitë reale për t'u gjendur në rrijedhat bashkëkohore evropiane të zhvillimeve kulturore. Ajo eksportonte në Kosovë kulturë kombëtare me parashenjë patriotike dhe ideologjike, por jo avangardë kulturore. Gjuha letrare ishte identiteti dhe transmetuesi i kësaj kulture. Haptas askush nuk e refuzonte as atë kulturë, as atë gjuhë. Mirëpo, për nivelin e njohjes së saj nga kosovarët, ajo shpesh paraqitej e pamundshme, ndërsa për kërkesat kulturore të krahasueshme me kulturat jugosllave, ajo shpërfaqte kufizime jo të vogla, gjithnjë shikuar nga perspektiva kosovare. Prandaj, një pjesë e mirë e inteligjencies kosovare, deri në vitet '90 e tutje, do të vazhdojë të mbetet e lidhur ngushtë me serbokroatishten. Disa syresh do të ikin nga kjo botë, pa i njohur kurrë mundësitë e gjuhës shqipe dhe pa e kuptuar se ata, vetëdijshëm ose jo, ishin përfshirë tërësisht në kulturën sllave të gjuhës dhe se atje do të mbeteshin përgjithmonë.

Thënë me një fjalë, inteligjencia kosovare e krijuar në vitet '60-'70 ishte bilinguale, *dygjuhësore*, dhe kjo rrethanë do të ndikojë shumë në formimin dhe në arritjet e saj kulturore. Ajo do ta ketë të vështirë të akomodohet në gjuhën shqipe, apo të përfshihet në tërësinë e saj si përbërëse e kulturës kombëtare. Arritjet kulturore të kosovarëve do të mbeten në suaza të kulturës lokale, e cila mund të absorbohej vetëm nga kosovarët, por jo nga shqiptarët e tjerë, për shkak të mungesave të mëdha gjuhësore. Madje, një numër studiuesish dhe intelektualësh kosovarë, disa prej të cilëve me potencial të mirë intelektual, të mësuar me shkrimin e serbokroatishtes, do të mbeten të papërdorshëm në gjuhën shqipe, për shkak të gjuhës që i prin një mendimi jo shqip. Një pjesë e tyre, që nga viti 1981 e prapa, qëkur iluzioni Jugosllavi pësoi thyerje të pariparueshme, u riorientuan në pikëpamje vetëdijesore dhe bënë përpjekje të jashtëzakonshme që gjuhësisht të përfshiheshin në një kulturë të integruar kombëtare. Ky do të jetë edhe ideali i tyre politik, krahas atij kulturor. Por një numër syresh nuk do të arrijnë të adaptohen asnjëherë dhe gjithmonë do të mbeten *hibridë kulturore*, një si tejzgjatje në kohë e një deformimi që tashmë ishte dashur të tejkalohet. Ata tashmë janë identifikuar si kontingjent kulturor, i cili qëndroi i heshtur në rrethanat e homogjenizimit dhe filloi të rizgjohej sapo e pa të mundshme një gjë të tillë, në rrethanat e reja të të ashtuquajturve integrame rajonale. Ata, të nxitur dhe të stimuluar edhe nga përkrahësit evropianë të ideve të zhbërjes së kulturave dhe gjuhëve të vogla, përsëri kanë filluar të akomodohen në një lidhje varshmërie kulturore nga qendrat e dikurshme jugosllave.

Ndërkohë, atmosferën e përgjithshme gjuhësore në Kosovë, që nga Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, veçmas pas Kongresit të Drejtshkrimit, do ta karakterizojë entuziazmi,

ndonjëherë krejt i arsyeshëm, ndonjëherë jo edhe aq racional. Për entuziastët gjuha letrare ishte vetë kombi. Për shumicën, Kosova detyrimisht duhej të futej në këtë proces, për arsye patriotike, për arsye politike, për arsye identiteti, për arsye të bashkërenditjes dhe integritetit kulturor. Funkzioni patriotik i gjuhës së njësuar ishte funksioni më i akceptueshëm dhe më i përdorshëm. Njerëzit, atëbotë, nuk e kishin shumë të qartë se çfarë ndikimi mund të kishte standardi i përbashkët i shqipes në integrimet kulturore shqiptare, ose në funksionimin e njësisë koherente kombëtare, por ata e dinin se gjuha ishte identitet dhe se në atë identitet ata nuk donin të ishin të ndarë nga Shqipëria.

Kjo atmosferë gjuhësore në Kosovë pat rëndësi të madhe për neutralizimin të skeptikëve dhe të kundërshtarëve racionalë apo joracionalë, ose të atyre që tashmë ishin rreshtuar në krahun e refuzimit, si kreatorë ose ithtarë të një *subversioni gjuhësor*. Edhe më shumë se kaq, kjo atmosferë krijoi vijën e ndarjes së paevitueshme të gjuhës shqipe me gjuhët sllave. Ndarja ishte e domosdoshme, sepse Kosova kishte rrezik serioz të akomodohej në një deformim gjuhësor të përhershëm, i cili mund t'i shkaktonte probleme qoftë variantit të Kosovës, qoftë gjuhës shqipe në tërësi; si kulturës lokale të Kosovës, po ashtu edhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Në atmosferën e entuziazmit gjuhësor në Kosovë, kjo vijë e ndarjes u përvijua qartë dhe kosovarët, shumica syresh, me ose pa vetëdije, u vendosën në mbrojtje të shqipes nga gjuhët sllave. Mirëpo, procesi, për shumë arsye, do të jetë i gjatë dhe shumë i vështirë, sepse sllavizimi i disa përbërësve gjuhësor të shqipes në Kosovë kishte ndodhur bashkë me një proces të gjatë politik, arsimor dhe kulturor dhe në rrethanat e një vetëdijeje të munguar kosovare për identitetin gjuhësor.

Atmosfera e entuziazmit, sikundër që ndodh zakonisht, kishte edhe anët e saj të dëmshme, të shëmtuara dhe qesharake. Dëmi më i madh iu bë pasurisë gjuhësore autentike, e cila u braktis pothuajse përnjëherësh, sepse kosovarët, përveç që nuk arritën ta kuptonin drejtë çështjen e standardit, kishin mungesa të mëdha në punë të gjuhës në përgjithësi. Mbi kornizën edhe ashtu shtrënguese për nga vetë natyra të standardit, ata vendosën një dogmë, e cila nuk ishte as politike, as ideologjike, por më shumë *euforike dhe idealiste*. Më anë tjetër, dogmën mund të mos e impononte aq shumë standardi, sa e impononte mosdija ose mungesa e kulturës gjuhësore. Ta zëmë, askund nuk ishte thënë se veprat letrare të autorëve kosovarë, të shkruara para kësaj kohe, duhej të ktheheshin në gjuhën e sotme letrare. Këtë e bënë shumica e autorëve kosovarë të asaj periudhe, madje edhe në raste të tilla, kur brenda rrëfimit letrar përfshihej dialogu autentik. Tani dilte se këto personazhe në malet e Rugovës dhe në kodrinat e Drenicës flitnin toskërisht, një toskërishte të shëmtuar gjithsesi, e cila nuk ishte as standard dhe as gjuhë e kultivuar e letërsisë. Askund nuk shkruante, bie fjala, që gazetari i TVP-së, me mikrofon në dorë dhe me kamerën prapa të futej në arat me grurë dhe atje të intervistonte fshatarin, duke i bërë pyetje në gjuhën letrare, të cilën ai nuk e kuptonte dhe e shikonte me habi të madhe. Në raste të tjera, në komunikim publik dhe në jetën shoqërore, madje edhe në atë private dhe familjare, ishte gjithnjë e më i madh numri i atyre që drejtshkrimin e identifikonin me drejtshqiptim, duke vënë kështu në qarkullim një gjuhë të folur krejtësisht të deformuar në trajta, në theks dhe në intonacion.

Pra, marrë në përgjithësi, edhe pas vitit 1972 situata gjuhësore në Kosovë nuk ishte e lehtë. Kosova kishte bërë hapin e madh, kishte pranuar standardin e vendosur me

këtë rast, por përvetësimi i tij shkonte nëpër një rrugë me shumë pengesa dhe vështirësi. Kjo ndodhte ngase Kosova ishte ambient gjuhësor bilingual, ku serbokroatishtja, duke qenë gjuhë shtetërore, kishte përparësitë e saj administrative, publike dhe kulturore. Më anë tjetër, Kosova iu bashkëngjit dhe iu bashkërendit gjuhës letrare dhe standardit, por nuk mori pjesë në procesin e tërësishëm të ndërtimit të kësaj norme gjuhësore. Edhe ashtu procesi i pranimit dhe i aplikimit të gjuhës së njësuar shqipe në Kosovë, edhe ashtu i vonuar, kishte shkuar me pengesa të mëdha, në radhë të parë të natyrës politike. Kosova u fut në procesin e përvetësimit të gjuhës së njësuar shqipe ende pa u akomoduar si duhet në ndonjë variant të saj të gjuhës së shkruar, ose pa arritur ta përvetësojë në masë të mjaftueshme standardin pararendës të gegërishtes. Prosesi i përvetësimit të gjuhës letrare dhe standardit, që vetvetiu duhej të supozonte një kulturë gjuhësore, në Kosovë ndodhte në rrethanat e mungesave të mëdha në rrafshin e kësaj kulture. Entuziazmi gjuhësor, krahas anëve pozitive, përveç që nuk kultivonte frymën kritike në përvetësimin e normës, krijonte edhe deformime të reja, ndonjëherë tipike për një ambient gjuhësor të prapambetur. Së fundi, vështirësitë e Kosovës me gjuhën letrare dhe standardin paraqiten shumë komplekse dhe ato janë të natyrës psikologjike dhe etnopsikologjike, individuale dhe kolektive, historike dhe bashkëkohore, politike dhe shoqërore, arsimore dhe kulturore, emancipuese dhe civilizuese.

Prapambetja gjuhësore e Kosovës

Po të mbetej Kosova jashtë zhvillimeve gjuhësore mbarëshqiptare, çfarë do të ndodhte në të vërtetë? Para se të përpiqemi të japim përgjigje në këtë pyetje, është e nevojshme t'u bëhet një vështrim sado përciptazi zhvillimeve gjuhësore kosovare, si fenomen i mëvetësishëm, i tillë çfarë paraqitet ai. Kosova, sikundër e kemi thënë, nuk dha ndonjë kontribut të veçantë kulturor në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, ndryshe nga kontributet e saj politike dhe luftarake, që ishin shumëfish më të avancuara. Më anë tjetër, procesi i islamizimit të Kosovës në Perandorinë osmane ndodhi shumë shpejt dhe ai përfshiu jo vetëm besimin fetar, por edhe jetën sociale në përgjithësi. Me një fjalë, Kosova arrin në fillim të shekullit XX me mënyrën e jetës orientale, me kulturë orientale, me mentalitet oriental dhe, natyrisht, me një ndikim të madh të botës orientale në gjuhën e saj. Nën Perandorinë Osmane, Kosova asnjëherë nuk e kultivoi gjuhën shqipe, nuk e shkroi atë, e në ndonjë rast u përpoq të merrte gjësendi nga qendrat e tjera kulturore shqiptare. Prandaj varianti i saj i gjuhës shqipe ishte i pakultivuar, i mbushur përplot me orientalizma, që reflektonte mënyrën e jetës së folësve të saj. Kosovarët, shikuar edhe nga këndvështrimi i gjuhës shqipe, ishin gjuhësisht të prapambetur. Në turqisht, ndoshta edhe në arabisht dhe persisht mund të ishin më të avancuar, por në shqip jo që jo.

Pra, përveç që nuk trashëgoi një traditë të kultivimit të gjuhës, Kosova mbeti peng edhe i proceseve të reja frenuese. Nga Perandoria Osmane, pa një proces deorientalizimi dhe emancipimi, Kosova ra nën një pushtim të ri edhe më të egër, nën pushtimin serb dhe jugosllav. Gjuha shqipe, që ishte e ndaluar në përdorim zyrtar në kohën e Turqisë,

vazhdoi të mbetet e ndaluar edhe në mbretërinë jugosllave. Tani, në rrethana të reja politike dhe shoqërore, ndikimeve turke dhe orientale iu shtuan ndikimet sllave. Prandaj, varianti kosovar i gjuhës shqipe arriti deri në Luftën e Dytë Botërore tërësisht i pamundur, një gjuhë shqipe e çoroditur nga ndikimet e gjuhëve orientale dhe sllave, me anë tjetër, një variant shqip krejtësisht i pazhvilluar, që pasqyronte një jetë sociale kryekëput rurale, krejt të paemancipuar. Por fenomenet negative të variantit kosovar të gjuhës shqipe nuk përfundojnë këtu. Për shkak të situatave politike, varianti kosovar i gjuhës shqipe vazhdon të mos komunikojë intensivisht me pjesën tjetër të arealit gjuhësor shqiptar. Prandaj disa fenomene gjuhësore jotipike zhvillohen brenda vetë këtij varianti. Por edhe marrjet një herë nga gegërishtja e standardizuar dhe pastaj nga gjuha e njësuar letrare, janë të vështira dhe jo gjithmonë efektive. Midis Kosovës dhe burimit të saj gjuhësor, qoftë gegërishtes standarde më herët, qoftë të gjuhës së njësuar letrare më vonë, ishte vendosur një kufi politik, që nuk kalohej aq lehtë.

Kështu, që nga viti 1967, ose 1972, e deri më 1991 Kosova jetoj iluzionin e saj gjuhësor. Përgjatë atyre viteve vazhduan përpjekjet për përvetësimin e standardit, në institucionet arsimore dhe kulturore, në medie dhe përgjithësisht në jetën publike. Fushata antishqiptare e vitit 1981 e prapa, zyrtarisht nuk e kontestoi aplikimin e standardit në Kosovë, ndonëse pat edhe synime të atilla që ndërmjet gjuhës letrare dhe nacionalizmit shqiptar të viheshin lidhje të dënueshme ideologjike dhe politike. Por atmosfera e përgjithshme në Kosovë tani u bë tepër e rëndë dhe aspak produktive për çfarëdo ndërmarrje dhe veprimtari kulturore, përfshirë këtu edhe *lëvizjen gjuhësore*, e cila, për shkak të apostrofimit politik, mbeti tërësisht pezull, u neutralizua, pra humbi në dinamikë dhe intensitet.

Gjithsesi, goditjen më të rëndë kjo lëvizje e mori me ndërprerjen e të gjitha marrëdhënieve me Shqipërinë. Gjuha e njësuar letrare në Kosovë tani ishte ndarë nga modeli, ishte ndarë nga burimi i saj. Kontaktet shkencore u ndërprejnë. Komunikimi gjuhësor nuk u zhvillua më përmes literaturës bazë, por përmes informacionit medial, i cili rëndohet shumë, bëhet më i vështirë. Gjenerata e albanologëve, tashmë e formuar në Kosovë, përjashtohet nga të gjitha proceset tërësore gjuhësore, përfshirë edhe diskutimet për modalitetet e zbatimit të normës drejtshkrimore. Literatura nuk këmbëhet, libri nga Shqipëria nuk vjen në Kosovë, botimi i letërsisë së Shqipërisë bie ndjeshëm. Pra, me një fjalë, gjuha në Kosovë përjeton edhe një ngecje të re, ngjashëm siç kishte ndodhur më 1948.

Ndodhi si ndodhi dhe më 1991, Kosova dhe Shqipëria pothuajse papritmas u gjenden më pranë njëra-tjetrës, ndonëse në rrethana politike tepër konfuze dhe aspak produktive për zhvillime kulturore. Fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë dhe rënia e diktaturës në Shqipëri krijuan disa mundësi për lëvizje të njëanshme, të një qarkullimi të kufizuar dhe mjaft të vështirë të shqiptarëve të Kosovës në drejtim të Shqipërisë. Takimi i serishëm i kosovarëve me Shqipërinë, pas një periudhe të gjatë, kësaj radhe pa qenë nën vëzhgimin e kujdesshëm të organeve të sigurimit, u zhvillua në rrethana të një keqkuptimi të dyanshëm. Ndër shumë defekte të tjera, ky ritakim i kosovarëve me Shqipërinë kishte brenda edhe *keqkuptimin gjuhësor*, ose një *refuzim gjuhësor* të tërësishëm të Kosovës nga ana e Shqipërisë. Duket se keqkuptimi dhe refuzimi kishin të tjera arsye, por gjuha ishte argumenti sipërfaqësor, argumenti i parë dhe i ndjerë më së lehti, i afishuar vetvetishëm, pa pasur nevojë që të kërkohet në brendi. Shqipëria nuk e

honepste gjuhën e kosovarëve, e refuzonte, e përqeshte, e urrente atë, thuaja se bëhej fjalë për një gjuhë-përbindësh.

Më anë tjetër, kosovarët, që kishin jetuar me iluzionin se kishin bërë përparime të ndjeshme në përvetësimin e gjuhës letrare, përnjëherësh e panë veten të tallur dhe përçmuar, inferiorë në të gjitha pikëpamjet. Iluzioni i tyre gjuhësor, i kultivuar që nga Kongresi i Drejtshkrimit dhe prapa, u rrënuar përfundimisht. Defektet gjuhësore kosovarët mund t'i kishin ndjerë edhe vetë, por në një mënyrë kaq të vrazhdët nuk ua kishte përplasur në fytyrë asnjëri. Iluzioni tjetër, se Shqipëria i kishte ndjekur zhvillimet kulturore në Kosovë, në fushën e letërsisë, të muzikës, të teatrit, të arteve figurative etj., ishte një kotësi edhe më e madhe, sepse Shqipëria londineze mund të ishte sadopak e mëshirshme ndaj diasporës, siç i quante ajo shqiptarët e mbetur jashtë kufijve të saj, por në asnjë mënyrë nuk i pranonte ata si të barabartë në terrenin e saj kulturor. Arsyet përse ndodhte kështu, përveç se historike, ishin edhe ideologjike. Mirëpo, gjuha kishte qenë dhe vazhdonte të ishte një kamuflazh i mirë, një argument që funksiononte mrekullisht. Më anë tjetër, për shkak të *refuzimit gjuhësor* të Tiranës, kosovarët kishin gjetur mënyrë t'i minimizonin, ose t'i anashkalonin, ose t'i heshtnin defektet e tyre reale rreth gjuhës. Ata filluan të akomodoheshin në këto defekte gjuhësore, duke e quajtur gati të pamundur një komunikim të ndërvetshëm tërësisht të barabartë. Disa kosovarë, të lënduar nga arroganca gjuhësore e Tiranës, filluan të futnin në përdorim të folmen e tyre lokale, e cila tashmë nuk ishte as variant i gegërishtes deri-diku i standardizuar në një kohë pak më të largët, por një nëndialekt krejtësisht i pamundur që të përdorej si gjuhë e shkrimit. Të tjerë kosovarë filluan t'i mbanin iso kontestimit të kryehershme të vendosjes së toskërishtes në bazën e gjuhës letrare, me shpjegimin se kosovarët nuk

mund të përvetësonin një standard gjuhësor të imponuar dhe të panatyrshëm për të folmen e tyre.

Konvergenca dhe divergjencat

Në të vërtetë, të gjitha mosmarrëveshjet rreth gjuhës ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë përmblihen në një pikë: cili është orientimi identitar i shqiptarëve, a është ai konvergjent apo divergjent, sepse gjuha nuk është dhe nuk mund të jetë e ndarë nga identiteti, nga përbërësit identitarë, sikundër që nuk mund të jetë e ndarë nga historia, nga kultura dhe nga synimet politike të një kombi. Për të gjitha këto kemi folur ose do të flasim ndaras, por me këtë rast nuk mund të mos themi se *kosovarishtja* si gjuhë është e paqenë, pra inekzistente. Këtë duhet ta sqarojmë një herë e mirë për të gjithë ata që pretendojnë t'i përdorin problemet gjuhësore të kosovarëve për të ndërtuar një identitet të ri. Nuk është parë diku deri sot që identiteti të ndërtohet përmes mungesave ose mangësive. Ai ndërtohet mbi anë pozitive, mbi vlera dhe jo mbi mungesën e tyre. Thënë ndryshe, kosovarët dashkan të përfshihen në një skizmë gjuhësore dhe bëkan gjuhë më vete mbështetur mbi një inat me Shqipërinë, ose për shkak të kompleksit të inferioritetit, ndjesi këto gjithsesi negative; pastaj për t'ia përshtatur gjuhën mosdijes dhe paaftësisë së tyre për të zotëruar standardin; apo që të legjitimojnë paaftësinë e tyre që të mënjanojnë depërtimet sllave në leksik dhe sintaksë; dhe, e fundit, për të përfillur një traditë gjuhësore të dyshimtë, për të mos thënë krejtësisht negative.

Pra, identiteti i ri nuk mund të ndërtohet mbi një gjuhë të paqenë, as mbi një gjuhë të *sendërgjuar*, siç do të thoshte

Konica. Kosovarishtja, që të bëhet krah i identitetit kosovar, duhet të ekzistojë si gjuhë e shkrimit dhe e kulturës, gjuhë e një komunikimi intensiv në përmasa tërësore. A ishte dhe a mund të bëhet ajo e tillë? Në asnjë rrethanë, sepse ajo është e folme nëndialektore, e dekompozuar në një numër variantesh lokale, ku asnjëra nuk ka forcën kulturore dhe komunikuese ta mbisundojë tjetrën. Më anë tjetër, duke qenë gjuhë lokale dhe nëndialektore, ajo nuk e ka të konsoliduar variantin e saj të shkrimit, madje shkrimi i saj mund të përmbledhet në jo më shumë se dhjetë vëllime mesatare përrallash, gojëdhënash, anekdotash dhe këngësh popullore. Me një fjalë, tradita gjuhësore e Kosovës është e përmbledhur në tërësi në vëllimet e folklorit, që Anton Çetta i kishte bërë dikur në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Ajo është krejt tradita gjuhësore e mëvetësishme e Kosovës, me shumë barbarizma turke dhe sllave dhe me trajta gramatikore të ndikuara nga këto gjuhë. Madje, sikundër e thamë, kjo e folme nuk paraqitet e integruar as brenda vetë Kosovës, sepse ajo ndryshon nga zona në zonë, që dëshmon se, në të kaluarën, Kosova, as si e tillë, nuk ka funksionuar si një e tërë, gjuhësisht kompakte. Përveç kësaj, një gjuhë e tillë paraqitet tepër e pazhvilluar, sepse flet vetëm për një jetë rurale, në një kohë që jeta urbane e Kosovës pothuajse nuk ka pasur traditë të hershme shqiptare.

Atëherë, pra, cila dilemë mbetet? Le ta pranojmë si të mirëqenë idenë se Kosovës do t'i binte më mirë dhe do t'i shkonte më për shtat vendosja e gegërishtes në bazën e standardit të gjuhës shqipe, sepse një standard i tillë do të korrespondonte me lehtë dhe do të qëndronte më afër me Kosovën dhe me të folmen e saj. Kjo është rrethanë objektive dhe unë e pranoj si të tillë, megjithëse më parë më duhet t'i bëj të njohura disa dilema të mia rreth gegërishtes, nëse ajo do të ishte *gjuhë-kornizë*, e cila do të mund t'i merrte përsipër

të gjitha funksionet e domosdoshme të gjuhës standarde. Këto dilema m'u përforcuan, ndërsa tash së voni, në kontekst të shijimit të gjuhës, kam marrë të rilevoj letërsinë e autorëve gegë, në radhë të parë Mjedën, Fishtën, Koliqin, Camajn dhe Pashkun, si dhe vëllimet e shumta të letërsisë popullore, më së shumti përrallat, poezinë lirike dhe epiko-lirike. Në disa raste këtë poezi e kam krahasuar me poezinë popullore të Shqipërisë së jugut dhe me atë arbëreshe. Në përgjithësi, gjuha e vargnimit epik, njësoj si gjuha tradicionale e komunikimit, është gjuhë me nocione që kufizohen me bëmat e lidhura me trimërinë ose vdekjen, pra një gjuhë *hijerëndë*, e palakueshme, e vështirë për komunikim të shpejtë dhe racional. Protagonistët e kësaj gjuhe janë tipa të ashpër, të vendosur, kryesisht me jetë sociale rurale. Te arbëreshët jeta sociale është kalorësiake, madje aristokrate. Poezia lirike gege është kryesisht buklike dhe elegjiake, pavarësisht se cilit lloj të lirikës i përket. Mjeda dhe Fishta ndoqën këtë logjikë gjuhësore, kur bënë veprat e tyre më të mira. Koliqi, ndërkaq, në krijimtarinë e tij të hershme, u përpoq ta urbanizonte këtë gjuhë, por ajo, për shkak të natyrës së saj buklike dhe rurale, në tregimet e tij shpesh e nxirrte "në piknik" jashtë Shkodrës, që atje të gjente ambientin e vet më të përshtatshëm. Krijimtaria e tij e mëvonshme, njësoj si ajo e Camajt dhe e Pashkut, mbetet peng i *moszhvillimit gjuhësor*. Në të vërtetë, sikundër mund të vërehet, letërsia e Camajt dhe e Pashkut ka brenda një shpërputhje të ndjeshme gjuhësore, ose një kundërshti të papajtueshme: asociacione ultramoderne, përimtime dhe analiza të holla psikologjike, të gjitha këto të shprehura me një gegërishte që esencën e saj kuptimore e shpreh vetëm ose kryesisht përmes rrathëve kuptimorë të ambientit epik apo rural. Pashku, madje, në këtë pikë nuk ishte aspak këmbëngulës, sepse tregimet e tij, të shkruara kryesisht në vitet '60, me rastin e ribotimit në

kompletin e veprave lejoi që të ktheheshin në gjuhën e sotme shqipe nga një person që nuk e njihnte mirë as gegërishten, as gjuhën e sotme.

Megjithatë, dilemat e mia rreth gegërishtes janë perceptim subjektiv dhe nuk pretendoj të tumiret nga mbështetësit e saj, por pamundësitë e saj për të qenë gjuhë e komunikimit modern sa vijnë e shtohen, edhe për faktin se gegërishtja, duke qenë e përjashtuar nga procesi i standardizimit dhe i zhvillimit, në esencën e saj ka mbetur gjuhë e një tradite tashmë të lënë në harresë dhe të tejkaluar. A i është bërë e padrejtë? Mundet, por ky proces tashmë ka marrë fund dhe nuk mund të kthehet prapa me asnjë çmim, jo vetëm pse është proces që nuk mund të përsëritet, por as nuk ka ku të kthehet. Ku do të kthehej, te cila gjuhë, te cili variant? Te gegërishtja tradicionale, konservative, të cilën nuk e njohin mirë as ata që e adhurojnë? Zhvillimet gjuhësore te shqiptarët në gjysmën e dytë të shekullit XX, për shkak të zhvillimeve shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore, kanë qenë aq dinamike (të ndodhura kryesisht në kuadër të standardit), saqë do të ishte krejt e pamundur jo më një kthim prapa, por as një ndalje sado e vogël në mes të rrugës.

Skizma kosovare e gjuhës

Duke i marrë në dijeni të gjitha këto rrethana, a do të ishte sot e mundur një si skizmë kosovare e gjuhës, që, thënë ndryshe, do të nënkuptonte një dalje të Kosovës nga marrëveshja gjuhësore e vitit 1972? Arsyja kryesore përse Kosova do të bënte këtë, do të ishte një vlerësim kritik i shkallës së përvetësimit të standardit nga kosovarët në dyzet vitet e shkuara dhe, pasi që ky vlerësim do të dilte negativ,

atëherë hapi i radhës do të ishte marrja e masave që kjo gjendje të mos vazhdonte kësaj rruge. Sikundër mund të vërehet, ithtarë të kësaj skizme në Kosovë nuk gjenden me shumicë, së paku jo të tillë, të cilët do të futeshin në prishjen e kësaj marrëveshjeje gjuhësore gjithëshqiptare të prirë nga vetëdija se gjërat nuk shkojnë mirë, e aq më pak të tillë që këtë do ta bënin për shkak të idesë së Kosova, duke u bërë shtet, duhet të krijojë identitet të veçantë dhe, duke bërë identitet të veçantë, duhet të bëjë edhe gjuhë të veçantë.

Para se të diskutojmë vlerësimin e situatës gjuhësore në Kosovë në raport me standardin, pra me shkallën e përvetësimit të tij, më duket se është e nevojshme të rikujtojmë disa gjëra rreth marrëveshjes së vitit 1972 në raport me Kosovën, pra me përfshirjen e saj në këtë marrëveshje dhe me mundësinë që Kosova të dalë prej saj. Tashmë e kemi thënë se në Kongresin e Drejtshkimit Kosova ishte përfshirë me një vendim politik, i cili atëbotë u mor nga strukturat komuniste të Shqipërisë, të Jugosllavisë dhe të Kosovës. Nuk është e besueshme se mund të ketë pasur një diskutim dhe një marrëveshje të fshehtë të këtyre strukturave rreth pjesëmarrjes së Kosovës në këtë tubim gjuhësor. Më e besueshme është se vendimi u mor duke ndjekur secila palë interesat e veta, kështu që vendimi, në formën e tij përfundimtare, ndonëse është komunist, del i favorshëm për Kosovën dhe, si të tillë, do ta quaja liberal-komunist. Më anë tjetër, edhe përkundër faktit se merr pjesë në Kongres, Kosova nuk e ka as forcën, as të drejtën, por as vullnetin që t'i prijë ndonjë *fraksioni gjuhësor* brenda këtij tubimi. Pjesëmarrja e Kosovës në Kongres mund të kontestohet nga kjo perspektivë, por përkrahja masive që morën vendimet e Kongresit të Drejtshkimit në Kosovën e atyre viteve, flet për një *vullnet gjuhësor* të përfaqësuar drejtë. Por, e zëmë se përsëri kemi të bëjmë me njëmendësi

komuniste dhe prandaj vendimet e Kongresit duhet quajtur të diskutueshme.

Atëherë, çfarë duhej të bënte Kosova? Kujt t'i bashkëngjitej? Ku t'i gjente aleatët brenda botës shqiptare? Arshi Pipën në Nju-Jork apo Martin Camajn në Romë ose Mynih? Mirëpo, kundërshtimi i tyre i standardit, i pari më aktiv dhe i dyti krejtësisht pasiv, mund të përbënte *temë për diskutim*, por në asnjë mënyrë nuk përbënte konsensus të gegërishtfolësve për ta kundërshtuar standardin ose vendimet e Kongresit. Prandaj Kosova as sot nuk mund të gjejë një rrugë tjetër, përveç se t'i shtojë në numër zërat që kërkojnë rishqyrtimin e standardit. Themi në numër, sepse në Kosovë mund të gjenden mbështetës të kësaj ideje, mund të gjenden përkrahës, përfshirë këtu edhe ndonjë militant, por nuk mund të gjenden gjuhëtarë, qoftë edhe një i vetëm, që e përkrah këtë ide, që do t'iu bëhej ndihmë atyre shkodranëve ose atyre gegëve të tjerë që tashmë e kanë shtruar zëshëm këtë kërkesë. Kundërshtarët e standardit në Kosovë dhe gjithandej Gegërisë janë ushtarë pa gjeneralë, ose pa komandantë. Dhe, që është gjithsesi e rëndësishme, kundërshtarët e standardit në Kosovë nuk mund t'i bëjnë ballë vetëm situatës që kërkojnë ta krijojnë, por duhet të kërkojnë ndihmën e Shkodrës, që domethënë se Kosova as që mund të mendohet ta revidojë standardin duke futur në përdorim variantin e vet të gjuhës, por një gegërishte, të cilën gjithashtu e ka me mungesa të mëdha.

Në një rrethanë të tillë, cili, pra, do të ishte *identiteti gjuhësor* i Kosovës? Përsëri një identitet gjuhësor i importuar, i bartur, i shartuar, funksionalisht i pamundur. Më i afërt se standardi aktual ndoshta po në dukje të parë, por më me shumë probleme se ai, sepse skizma eventuale e Kosovës aty-këtu do të gjente një mbështetje deklarative ndër të gjitha hapësirat e Gegërisë, por nuk do ta gjente mbështetjen

substanciale, diturore, profesionale dhe aq më pak do të gjente mbështetje nga përdoruesit e asaj gjuhe, të cilët në Shqipëri dhe në Kosovë janë gjithnjë e më të paktë. Vetë ata që kërkojnë të bëjnë revidime e korigjime të këtilla, nuk dinë ta shkruajnë gegërishten dhe shkrimin e saj e degradojnë në një të folme lokale, të lagjes apo të fshatit të vet. Madje, edhe më keq se kaq, skizma kosovare e gjuhës standarde, njësoj si skizma geqe në përgjithësi është bërë një lloj azili për të gjithë keqshkruesit e shqipes. Nuk ka ndodhur deri më sot diku në botë që keqshkruesit të prishin standarde dhe të vendosin standarde të reja gjuhësore.

Më anë tjetër, prirja për të njohur *lirinë matanë rregullave* nuk është liri qenësore, është liri e kufizuar në vetë kuptimin e saj, sepse ajo ka prirje të kthehet në dhunë të individit ndaj kolektivitetit. Në Kosovë kjo tashmë është vërtetuar më shumë se një herë: skizmatikët e gjuhës standarde, me insistimin e tyre për t'i shkelur rregullat pa asnjë kriter gjuhësor, cenojnë lirinë gjuhësore të shumicës, tek e cila ekziston konsensusi gjuhësor për një gjuhë me rend dhe rregull. Ky perceptim nuk supozon dhunë të *shumicës gjuhësore* kundrejt *pakicës gjuhësore*, as kufizim lirie, por zbatim normativ të një rregulli, derisa ajo të mos ndryshohet. Askush nuk duhet t'i ndalojë skizmatikët t'i diskutojnë problemet gjuhësore, por është kundër konceptit bashkëkohor të lirisë nëse dikush kërkon që një gjuhë *zhargon ose argo* ta vendosë në pedestalin e gjuhës me përdorim të gjerë publik, pa konsensusin paraprak. Nëse dikush kërkon të jetë i vëmendshëm kundrejt lirisë së tjetrit, njësoj siç kërkon që në emër të lirisë të krijohet hapësirë për zhargonin e tij, do të duhej që atë zhargon (derisa të mos marrë statusin e gjuhës për përdorim publik) ta mbajë në rrethin e gjedhes personale, si një gjuhë-agjens me rrezikshmëri për ambientin publik dhe rrethin shoqëror.

Kosovarishtja, përmbledhje gabimesh gjuhësore

Por tani, me pak fjalë, le të shohim se në ç' gjendje është gjuha në Kosovë dhe cilat ndërmarrje të shpejta i kërkon ajo. Së pari do bërë të qartë se gjuha shqipe në Kosovë nuk e ka asnjë urgjencë, që lidhet me diskutimin rreth normës letrare. Të gjitha urgjencat e saj, nëse ka diçka të tillë që lidhet me gjuhën, është bërja e gjuhës shqipe si gjuhë shtetërore, funksion ky të cilin gjuha shqipe nuk e ka pasur kurrë në Kosovë. Ata që janë ankuar dhe ankohen vazhdimisht se Kosova nuk e përvetëson dot këtë standard, kanë filluar të humbin edhe argumentet që i kishin më parë, sepse viteve të fundit, edhe përkundër të gjitha vështirësive, edhe përkundër të gjitha pengesave, Kosova ka njohur një zhvillim gjuhësor shumë më dinamik se në të gjitha fushat e tjera. Pavarësisht nga vërejtjet që nuk i kemi të pakta, shkalla e përvetësimit të standardit ka njohur një rritje cilësore edhe në gjuhë të shkruar, edhe në gjuhë të folur, te të gjitha kategoritë shoqërore. Hallka më e dobët në këtë proces mbetet sistemi shkollor, i cili, për shkak të mungesave që ka, vazhdimisht rigjeneron mosdije.

Më anë tjetër, Kosova është futur në procese të reja, pas një degradimi të madh që e kishte përjetuar para vitit 1999. Periudha dhjetëvjeçare e deinstitutionalizimit pothuajse e kishte nxjerrë gjuhën shqipe jashtë përdorimit publik. Por edhe pas vitit 1999, situata gjuhësore në Kosovë vazhdoi të ishte e rëndë, disa vite me radhë, për shkak se administrata ndërkombëtare e përplasi Kosovën nga një bilinguizëm që tashmë ia kishte marrë frymën, në një bilinguizëm të ri, jo të urreyer, por po aq i papërballueshëm për Kosovën gjuhësisht të traumatizuar. Tani në përdorim zyrtar në Kosovë u vendos gjuha angleze, asaj i takonte përparësia në të gjitha nivelet e komunikimit, ndërsa gjuha shqipe përsëri bëhet

gjuhë e dytë, siç ishte dikur në raport me serbokroatishten. Cilësia e njohjes së gjuhës angleze nga kosovarët, si edhe nga një numër ndërkombëtarësh, paraqitet problematike, por edhe më problematike dilte njohja e shqipes nga një ushtri e tërë përkthyesish, të cilët vihen në shërbim të administratës ndërkombëtare. Me një fjalë, vitet e administratës së UNMIK-ut në Kosovë janë vite të lëndimit të madh të gjuhës shqipe, të anashkalimit, të shkeljes dhe të nënçmimit të saj.

Tërheqja e shkallëshkallshme e bashkësisë ndërkombëtare nga Kosova ka krijuar mundësi të reja për politika gjuhësore, sikundër që, më anë tjetër, e vë gjuhën e Kosovës përball detyrave për të përmbushur zbrazësitë e krijuara. Së pari, statusi i gjuhës shqipe në Kosovë duhet të ndryshojë dhe me Kushtetutën e Kosovës të bëhet i tillë, siç është gjuha e shumicës në të gjitha vendet e rajonit dhe të BE-së. Diskriminimi i gjuhës shqipe, për t'iu lënë hapësirë gjuhëve të minoriteteve dhe gjuhës angleze si gjuhë *protektorësh*, është një situatë e paparimtë dhe frenuese për një zhvillim normal gjuhësor. Duke marrë për bazë përqindjen e popullsisë shqiptare, që kap shkallën rreth 95%, imponimi i serbishtes si gjuhë zyrtare në tërë territorin e Kosovës del qesharak dhe thellësisht i papranueshëm. Më anë tjetër, statusi i anglishtes duhet të ndryshojë, për shkak se përparësia që i jepet asaj në dokumente zyrtare, asfikson gjuhën shqipe edhe ashtu me përvojë jo të mjaftueshme në këtë fushë, sikundër që diskriminon përdoruesit e saj.

Nuk është e besueshme se Kosova në një të ardhme të afërt do të ketë ndonjë *ligj për gjuhën*, sepse një ligj i tillë ngatërron Kosovën me bashkësinë ndërkombëtare, por më e pritshme mund të duket nëse Kosova në nivel institucional përpunon dhe zbaton disa segmente të politikave gjuhësore. Dy janë fushat ku ajo do të duhej të vepronte, përmes

projekteve me përfshirje të gjerë: arsimit dhe administratës. Institucionet si Akademia e Shkencave dhe e Arteve, Instituti Albanologjik, Dega e Gjuhës Shqipe në Fakultetin Filologjik etj., do të mund të bëheshin bartës të një projekti afatgjatë të edukimit dhe arsimit gjuhësor plotësues për mësuesit dhe pjesëtarët e administratës civile, lokale dhe qendrore. Për një ndërmarrje të këtillë, së pari duhet hequr dilemën artificiale dhe askund të ngjashme, të cilën ia ka imponuar Kosovës bashkësia ndërkombëtare, se kultivimi dhe përkujdesja për gjuhën shqipe është nacionalizëm. Gjuhës shqipe në Kosovë duhet t'i hiqet kjo embargo dhe vetë kosovarët nuk do të duhej të binin pre e këtij paragjykimi. Ata duhet ta kuptojnë se një shtet të qëndrueshëm e përbëjnë institucionet e qëndrueshme, të cilat në themel kanë veprimin e mbështetur mbi një kod gjuhësor, të ndërtuar sipas një marrëveshjeje gjuhësore dhe të zbatueshëm sipas saktësisë kuptimore të po asaj gjuhe. Pa këtë kusht gjuhësor institucionet e shtetit janë të luhatshme dhe kuptimi i tyre për qytetarin është i paqëndrueshëm, madje i pakuptimtë.

Ndërkohë, në raport me Shqipërinë, rreth standardit, mendoj se dy gjëra mbeten të sqarohen dhe të marrin një zgjidhje. E para, kundërshtarët e standardit në Shkodër, në Tiranë ose gjetiu në Shqipëri, apo ata që kërkojnë revidimin e tij, do të duhej të pushonin së kërkuari aleatë në Kosovë; dhe, e dyta, standardi i vitit 1972 do të duhej të rishikohej dhe të korrigjohet, pra të reformohej në ato pika ku paraqitet e domosdoshme, tani edhe për shkak të funksionit të ri që ka ky standard në shtetin e ri të Kosovës. Në rastin e parë, kundërshtarët e standardit, sado qofshin dhe kushdo qofshin ata, pavarësisht nëse janë nga Kosova apo *azilantë gjuhësorë* nga Shqipëria, është pak e besueshme se mund të kenë arritur gjë më shumë, sesa t'i bëjnë ndonjë dëm të

papërfillshëm shkallës së përvetësimit të standardit dhe ngritjes së kulturës së gjuhës në Kosovë. Por, më anë tjetër, në fushën e reformës së mëtejshme gjuhësore, çështjet paraqiten më problematike, më të ngatërruara përbrenda vetë lagjes së gjuhëtarëve: njëra palë kërkon ndryshime të shpejta, duke i arsyetuar ato me dinamikën e zhvillime gjuhësore në truall të shqipes, sikundër edhe me të metat që tashmë janë evidencuar në disa pika të ndjeshme të standardit; pala tjetër, ndërkaq, paraqitet jofleksibile, dogmatike, antireformuese dhe konsideron se një ndërhyrje në standard mund të jetë vetëm fillimi për ndryshimin e tij, prandaj janë bërë barrikadë e mosndryshimeve, sado të domosdoshme qofshin ato. Nuk është ndonjë fshehtësi e madhe nëse themi se ata, bashkë me dogmën gjuhësore, përpiqen të ruajnë edhe dogmën ideologjike.

Krahas kësaj, duke parë se disa gjuhëtarë të Kosovës janë më të zëshëm rreth nevojës së ndryshimeve, të një lagje gjuhëtarësh të Shqipërisë është paraqitur teza e zhvillimeve gjuhësore me *dinamikë të diferencuar*. Kjo afërsisht ka këtë kuptim: Kosova dhe Shqipëria janë përcaktuar për ruajtjen dhe kultivimin e standardit gjuhësor, por secila palë është e lirë të ndërmarrë hapa të pavarur për shkallën e ndryshimeve dhe dinamikën e tyre, përfshirë këtu edhe kërkesat gjithnjë e më të zëshme që Kosova të bëjë vetë si të dojë me gjuhën e saj, ndërsa Shqipëria do të ndjekë ato zhvillime që për veten e saj i konsideron të favorshme. Më anë tjetër, si përgjigje ndaj zërave që kërkojnë braktisjen e standardit, në Kosovë tashmë është shfaqur grupi i gjuhëtarëve konservativë, të cilët mbështesin dogmën gjuhësore të grupit të gjuhëtarëve të Tiranës, ndërkohë që rrethin e tyre e zgjerojnë *naivistët gjuhësorë* kosovarë, të cilët, ta zëmë, duke dashur të shqiptarizonin në mënyrë artificiale toponiminë e Kosovës, në disa raste bënë emërtime të

çoroditura, kurse në disa raste të tjera i bartën emërvendet e Shqipërisë në Kosovë, pa e kuptuar se me këtë veprim shqiptarët e Kosovës i bëjnë ardhacakë dhe kolonizatorë. Së fundi është shfaqur edhe nisma për formimin e një këshilli ose komisioni gjuhësor ndërparlamentar Shqipëri-Kosovë, me fuqi vendimmarrëse për gjuhën shqipe në të dy shtetet.

Sido që të jetë, duket se Kosova, edhe për një kohë, do të jetë e privuar nga kënaqësia e të folurit dhe e shkrimit të një gjuhe kultivuar, madje një pjesë e kosovarëve nuk do të dinë se ekziston një ndjenjë e këtillë. Megjithatë, pas vitit 1999 përvetësimi i standardit në Kosovë ka ndryshuar shumë: është më i shpejtë dhe më gjithëpërfshirës. Ndërkohë, një shkallë më e lartë e përvetësimit të standardit në Kosovë, gjatë këtyre viteve, ka krijuar *tregun shqiptar të librit* dhe *tregun shqiptar të medias elektronike*, faktorë këta shumë të rëndësishëm që favorizojnë zhvillime të tjera edhe më cilësore. Hapësira e qarkullimit gjuhësor është zgjeruar dhe bashkë me këtë edhe hapësira e qarkullimit të ideve, hapësira e mendimit gjithashtu, njësoj si hapësira kulturore, artistike, shkencore etj. Vetë hapësira e mendimit gjuhësor ka një shtrirje jashtëzakonisht të gjerë dhe favorizon diskutime që ofrojnë zgjidhje më të qëndrueshme.

Më anë tjetër, shpikja e identitetit kosovar, identitet që domosdo nënkupton edhe gjuhë më vete për Kosovën, është faktor ngadalësues në këtë dinamikë. Sipas mbështetësve të kësaj ideje, ky identitet do të duhej të ndërtohej mbi *mohimin gjuhësor*, pra të një mundësie aproksimative të kundërshtimit plebishitar të Kosovës ndaj standardit aktual. Është e njohur se identitetet zakonisht nuk ndërtohen mbi postulatet e mohimit, por të pohimit, që domethënë se identitetet kërkojnë të stabilizohen mbi rrugë që shpjen diku dhe jo mbi rrugë që nuk shpjen askund. Deri më tani ithtarët e *kosovarizmës* janë përpjekur t'i paraqesin mungesat

gjuhësore si vlerë identitare, që në të vërtetë nuk është dhe nuk mund të jetë e tillë. Alternativa gjuhësore që ofrojnë ithtarët e identitetit kosovar nuk është gjë më shumë se një përmbledhje gabimesh gjuhësore, një doracak shkarjesh, edhe si i tillë i pahartuar, pra i mbetur në tentativë. Nuk është për të besuar se Kosova mund të ndërtojë identitet gjuhësor të mëvetësishëm, të ndarë, qoftë edhe vetëm kundërshtues, duke i thurur lavde dhe duke i ngritur lapidar mosdijes gjuhësore.

TRASHËGIMIA KULTURORE JOIDENTITARE

Trashëgimi e pushtuesve

Nëse dikush ka krijuar një përfaqësim për Kosovën duke u mbështetur në literaturën serbe, në këngët popullore, në mitet dhe legjendat, në historiografinë romantike dhe në krijimtarinë tjetër imagjinare, atëherë në perceptimet dhe përfaqësimet e tij ky vend do të ngjante me një *muze fantazmash*, ku njerëzit nuk bëjnë jetë reale. Në këtë përfaqësim, Kosova është një vend ku fantazmat e mesjetës, të riinkarnuara, ecin rrugëve në pikë të ditës, sekush pa kokë, tjetri me heshtën e ngulur në shpinë, tjetri me parzmoren e shqyer, ndonjë tjetër me gropat e syve të përgjakura, ndërsa rreth e rrotull nuk ka ara ku mund të mbillet e të korret, as livadhe ku mund të kullosin bagëtia e të kositet bari, por vetëm fushëbeteja me kufoma të masakruara, me kuaj të ngordhur, me tenda të djegura, me shpata, përkrenare e flamuj të shpërndarë tutje-tëhu, gjithandëj po kjo pamje, sa të zë syri dhe sa ta përfshin mendja.

Në një vend të tillë është vështirë të jetohet, sepse në këtë perceptim imagjinar bota ka mundësi të të shohë në dy forma: ose si fantazmë e ngritur nga varri, ose si dhunues i varreve dhe i krejt asaj fantazmagorie. Meqë fantazmat e ngritura nga varri kanë përkatësi nacionale serbe, atëherë shqiptarëve, si njerëz që kanë zënë strehë mbi varreza, nuk

mund t'u ndahej ndonjë rol tjetër, përveçse ai i dhunuesve të varreve dhe i krejt asaj ikonografie mesjetare, mjegulluese dhe mendjeshkarë. Sipas këtij përfytyrimi, pra, Kosova do të duhej të ishte e mbushur cep më cep me murana e me kështjella e me pallate, me rrugë me kalldrëme që çojnë nga një kala në tjetrën, e me katedrale e kambanore e me kalorës të bronztë, tek u bëjnë roje përjetësisht ngjarjeve të një historie të kahershme, që nuk do të harrohet kurrë.

Por, në të vërtetë, Kosova nuk ngjan aspak e tillë. Në pamje të reliefit dhe të natyrës, ajo është një vend i zakonshëm ballkanik, në përgjithësi një hapësirë e ngushtë, më një anë një rrafshnaltë gjithandej e rrethuar kodrinash dhe malesh, më anë tjetër një si luginë me lumenj si përroska, tek rri e ngjitur pas masivit gjigant të maleve të larta. Shqiptarët e shumtë dhe serbët e paktë që kanë jetuar aty prej shekujsh duket se as që e kanë pasur mendjen te historia, te mitet dhe legjendat që janë thurur për vendin e tyre. Në përgjithësi ata kanë bërë jetë të vështirë, me shumë mungesa dhe me shumë vuajtje. Perandoritë kanë ardhur dhe kanë shkuar, kanë bërë luftëra të mëdha ose të vogla, por në pamjen e Kosovës nuk kanë ndryshuar ndonjë gjë të madhe. Përfytyrimin për Kosovën si vend me një përqendrim të jashtëzakonshëm monumentesh të trashëgimisë kulturore dhe historike e kanë krijuar ata që kurrë nuk kanë jetuar në Kosovë, në radhë të parë serbët e kohës së romantizmit dhe më pas, të kohës së nacionalizmit politik. E kundërta e kësaj është Kosova pothuajse e zhveshur nga monumentet e trashëgimisë kulturore materiale: nuk ka kala, nuk ka kështjella, ka vetëm tri kisha serbe dhe po aq xhami turke, për të cilat thonë se kanë vlera historike dhe arkitektonike.

Në këtë trashëgimi kulturore shqiptarët thuajse nuk kanë asgjë dhe, ndonëse historianë të paanshëm e kanë

vërtetuar se ata kanë qenë të pranishëm në këtë hapësirë prej Ilirisë dhe prapa, duket sikur ata, përgjatë dy mijë vjetëve, kanë jetuar në tokë të huaj, në shtëpi të huaj. Trashëgimia kulturore e Kosovës, ajo që shihet dhe ajo që është valorizuar, është *trashëgimi e pushtuesve*. Ata kanë luftuar mes vete që ta dominojnë këtë hapësirë dhe kjo trashëgimi është dëshmi e dominimit të njëres apo të palës tjetër. Të rralla mund të jenë vendet si Kosova, ku banorët vendas përjashtohen nga e drejta për të pasur diçka të tyre në këtë trashëgimi. Sipas perceptimit historik të dëshmimeve monumentale, shqiptarët nuk ekzistojnë. Ata janë të paqenë në Kosovë, ata nuk kanë ekzistuar kurrë, ose, që është më kapshme për mendjen e njeriut, kanë qenë ose serbë, ose turq. Ose kanë ardhur në shekujt e vonë, si mercenarë të Turqisë, kanë zbritur nga malet e Shqipërisë dhe kanë pushtuar tokat pjellore, gjithandej Kosovës dhe Maqedonisë, deri në kufi me Serbinë dhe Bullgarinë. Kjo pjesërisht edhe mund të ketë ndodhur, sepse raste të ngjashme ka mjaft në historinë e Europës, por nuk është e qartë përse historianët sillavë këtë fakt e lënë në kufij të legjendës, ndërsa koha e ndodhjes, sipas tyre, nuk është aq e largët.

Atëherë, në një rrethanë të këtillë, pyetjet që bëhen zakonisht janë këto: Çfarë në të vërtetë është trashëgimia kulturore e Kosovës. Çka përfshin ajo? A është ajo trashëgimi vetëm fetare apo vetëm civilizuese, apo fetare dhe civilizuese njëkohësisht? A është nacionale apo *mbinacionale*? A është identitare apo *mbiidentitare*? Dhe, së fundi, a është trashëgimia e Kosovës konflikt civilizimesh apo bashkëjetesë e tyre?

Në sqarimin e këtyre problemeve as kosovarët dhe as të tjerët që kanë folur për Kosovën nuk kanë shkuar shumë larg, sepse pothuajse të gjithë pa përjashtim e kanë pranuar konceptin serb të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Shqiptarët, bashkë me mbështetësit e paktë të tyre, tezat serbe për trashëgiminë kulturore të Kosovës ndonjëherë mekanikisht i kanë kthyer në anë të kundërt, pra në anën që është konsideruar si e favorshme për ta, por pa ndryshuar asgjë në esencë, pa ndryshuar konceptin, pa ndryshuar perceptimin. Të huajt, ata që erdhën në Kosovë pas vitit 1999, ose që e shikuan Kosovën nga distanca, nuk mbajtën qëndrim të paanshëm rreth asnjë çështjeje, madje Kosovën e panë vetëm në kontekst të historisë dhe të trashëgimisë serbe, sikundër e thamë, duke i bërë shqiptarët disi të paqenë, ose imagjinarë. Më anë tjetër, ata pranuan idenë se Kosova historike dhe kulturore ishte serbe, pa mëdyshje, pa dilemë, pa asnjë hamendje, ndërsa shqiptarëve iu ndanë hise aktualitetin e zhveshur, pa diakroni, pa histori, pa trashëgimi. Natyrisht që për vendimet politike më të rëndësishme, para dhe pas 1999-ës, me rëndësi parësore ishte prania e përqendruar e shqiptarëve në Kosovë, por një numër koncesionesh iu bënë palës serbe pikërisht për shkak të historisë së mjegullt, sentimentit fetar dhe trashëgimisë kulturore. Më në fund, edhe historia, edhe feja përqendrohen në një pikë, në trashëgiminë kulturore, e cila në Kosovë është e dominuar nga identiteti serb, madje, sipas bindjes së përhapur gjerësisht, Kosova, me tërësinë e saj, qëndron në themel të këtij identiteti.

Identifikimi antishqiptar

Po shqiptarët çfarë duhet të bëjnë, si duhet ta shikojnë këtë trashëgimi? A është ajo e tyre apo nuk është? A është ajo vlerë kulturore e Kosovës, apo është një trashëgimi negative, gjurmë e një pushtuesi të urryer? Qëndrimi i

shqiptarëve për trashëgiminë kulturore të Kosovës është mjaft konfuz, sepse, sikundër e thamë, referencat historike të asaj trashëgimie për këtë komunitet janë referenca kontradiktore. Së pari do përkujtuar se trashëgimia kulturore e Kosovës, ajo materiale, e qëndrueshme, e dëshmuar, edhe atëherë kur funksionon si kujtesë kolektive, por edhe atëherë kur nuk funksionon si e tillë; edhe atëherë kur merr pjesë në përbërësit e identitetit, por edhe atëherë kur nuk merr pjesë; edhe atëherë kur është relikte historike, edhe atëherë kur është identitet funksional; pra, në të gjitha këto raste, qofshin kontradiktore ose përjashtuese, ajo ka historinë e saj çuditërisht të lëvizshme, disi të paqëndrueshme, sikur gurët dhe muret që e përbëjnë atë të kishin një përbërje fluide, të ëndërrt, fiktive. Nuk do mend, kontestimet e shumta në planin e dëshmive historike e kanë krijuar një situatë të këtillë, ndërsa në plan tjetër kanë nxitur pasione të forta, ndonjëherë të pangjashme. Në të gjitha këto rrethana, ndaj shqiptarëve, pothuajse gjithnjë, është marrë qëndrim përjashtues, madje edhe së fundi shikohen si *uzurpatorë të padrejtë* të një toke që nuk u takon atyre. Vetë shqiptarët nuk kanë krijuar ndonjë mit për Kosovën, nuk kanë as ndonjë pasion të madh ndaj trashëgimisë së saj, sepse ata e duan Kosovën për aq sa e duan, si një vend ku duhet të jetojnë dhe jo një vend për ëndrra dhe fantazmagori. Madje, duhet ta pranojmë se shqiptarët emocionalisht nuk janë të lidhur për asnjërin shtresim të trashëgimisë kulturore, as për atë iliro-romake, as për atë turke, e aq më pak për atë serbe.

Pra, trashëgimia e Kosovës është konfuze në përbërjen e saj, si trashëgimia e çdo vendi tjetër, ku ka pasur lëvizshmëri të madhe përkatësish historike dhe etnike. Historikisht ajo u takon tri perandorive të ndryshme, më të fuqishmet në Europë në kohën e tyre: Perandorisë Romake, Perandorisë

Bizantine dhe Perandorisë Osmane. Etnikisht ajo është e ndarë ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Në të vërtetë, dallimi esencial ndërmjet këtyre dy etnive sa i përket Kosovës, është *e drejta historike* mbi këtë tokë të vogël: kujt i takon ajo, në mbështetje të dëshmive të mbetura trashëgim? Por, sikundër e dimë, dëshmitë e mbetura që gjithkund konsiderohen si trashëgimi kulturore materiale me vlerë muzeale, në Kosovë nuk janë vetëm të tilla, pra nuk qëndrojnë të pavarura nga korpusi i ideve, në emër të të cilave shpesh është luftuar dhe është derdhur gjak. Pikërisht për këtë arsye, trashëgimisë kulturore të Kosovës nuk mund t'i qasemi me koncepte universale, por duhet parë dhe analizuar në specifikat e saj atipike, gjithnjë duke synuar që ajo gradualisht të zhvendoset nga terreni historik dhe politik dhe të vendoset në terrenin kulturor, atje ku e ka vendin.

Por, për një çast le t'i kthehemi historisë për një sqarim elementar: në të tri rastet e perandorive të përmendura, të cilat kanë lënë gjurmë në Kosovë dhe rreth të cilave grinden shqiptarët dhe serbët, shqiptarët kanë qenë popull i pushtuar. Mirëpo, në kuadër të atyre perandorive dhe në kuadër të atyre civilizimeve, ata kanë funksionuar dhe kanë lënë gjurmët e tyre. Natyrisht që këto gjurmë shqiptarët i theksojnë, ndërsa serbët i kontestojnë. Ta zëmë, në Kosovë janë të dukshme gjurmët ilire-romake, por serbët, gjatë sundimit të vonë i kanë zhdukur shumicën e tyre, e para, për të kontestuar vazhdimësinë ilire-shqiptare; dhe, e dyta, për ta promovuar me shumë fanatizëm të drejtën e tyre historike mbi Kosovën. E vërteta, ajo që i ka fuqizuar serbët në këtë trashëgimi historike ka qenë pikërisht Bizanti, identifikimi i serb me atë histori, me atë fe dhe me atë kulturë. Bizanti nuk ka qenë serb, ka qenë një *perandori multietnike*, me shumë prurje orientale. Nuk ka qenë as kulturë dhe as civilizim perëndimor, por shfaqja në lindje e

Perandorisë Osmane dhe luftërat e zhvilluara me të, të gjitha këto kanë bërë që ajo të identifikohet si përkatësi e krishterë, respektivisht si identitetet europian. Vetë ndarja e Perdanorisë Romake dhe më pastaj edhe e kishës, ka ardhur si pasojë e diferencave të madha brenda këtyre përbërësve shtetërorë dhe fetarë. Ardhja e osmanëve nga Azia i rrafshon këto dallime dhe i bashkon europianët e krishterë për një luftë të përbashkët. Dhe, në këtë garë për identitetet dhe trashëgimi, shqiptarët përjetojnë humbjen e radhës: përvetësojnë besimin fetar mysliman dhe identifikohen me trashëgiminë turko-orientale.

Duke kaluar nëpër situata të këtilla, pra, shqiptarët e Kosovës nuk kanë qenë të lidhur emocionalisht me trashëgiminë kulturore dhe historike të Kosovës, as më herët, as tash së fundi. Një numër syresh krejt vonë janë konvertuar në myslimanë liberalë, kështu që tempujt fetarë të krishterë, katolikë dhe ortodoksë, i kanë respektuar barabar. Ishte Serbia, nacionalizmi serb, shovinizmi serb ai që futi zjarr në krejt këtë situatë. Ajo i instrumentalizoi institucionet e fesë, që njëkohësisht ishin edhe pronarë të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Krishterimin si besim fetar dhe si civilizim europian ajo e bëri krishterim serb dhe civilizim serb, tashmë jo si vlerë, por si kundërvënie ndaj shqiptarëve me shumicë të islamizuar. Shqiptarët e Kosovës, që të mos ndiheshin të përjashtuar, duhej që të mbaheshin diku dhe u kapën në dy fille identitare: në trashëgiminë iliro-romake dhe në kontestimin e përkatësisë sllave të monumenteve të kultit ortodoks. Por trashëgimia iliro-romake pothuajse ishte zhdukur në Kosovë: aty ku ishte zbuluar, ishte shkatërruar; aty ku shiheshin gjurmë, rrafshoheshin dhe mbuloheshin me dhë, që kurrë më të mos shfaqeshin më. Me një fjalë, trashëgimia iliro-romake nuk u valorizua, përkundrazi u zhduk, u shpall si antiserbe, sepse

ajo kontestonte të drejtën historike të Serbisë në Kosovë. Më anë tjetër, ideja se edhe shqiptarët ishin pjesëtarë të trashëgimisë fetare ortodokse, ndonëse kishte mbështetje dhe dëshmi, nuk funksionoi asnjëherë si duhet.

Ndërkaq, nga ndonjë lidhje e mundshme e identitetit me trashëgiminë e Perandorisë Osmane përmes monumenteve të kultit ose të kulturës materiale, shqiptarët e Kosovës e përjashtuan veten në mënyrë kategorike, sepse, për shkak të paragjyqimeve evropiane dhe stigmatizimit serb, ata nuk deshën asnjëherë të identifikoheshin me atë trashëgimi. Prandaj, marrë në përgjithësi, shqiptarëve nuk iu mbeti gjë tjetër nga Kosova, përveç vetëdijes se ajo tokë kishte qenë gjithmonë e tyre, se dëshmitë për këtë ishin varrosur nën tokë, sikundër edhe një refuzim permanent i krejt asaj që tashmë ishte identifikuar si trashëgimi serbe. Në luftën e fundit shqiptarët dogjën disa kisha serbe, veçmas të ashtuquajturat *kisha politike*, të ndërtuara në kohët e reja, për të dëshmuar dominimin serb në Kosovë, kryesisht të nxitur dhe të provokuar nga Serbia, nga lidhja në një tërësi që bënte ajo, të fesë, të kombit, të shtetit, të ushtrisë, të klerit, të policisë, pra të gjithë së bashku të përfshirë në *identifikimin antishqiptar*. Shqiptarët krejt vonë e kuptuan se kjo nxitje ishte një grackë dhe se me veprimin që bënin, me djegien e kishave serbe, tumirnin të gjitha supozimet propagandistike të Serbisë për shqiptarët si tribalë, si barbarë, si fundamentalistë islamikë. Ata, gjithashtu, bënë një akt jocivilizues dhe të rrezikshëm për mentalitetin e krishterë perëndimor: çuan dorë mbi monumentet e identitetit civilizues evropian, ashtu siç kishte bërë dikur perandoria e errët e turqve selxhuk.

Megjithatë, edhe përkundër të gjitha situatave dramatike, shqiptarët qëndruan pezull, u mbajtën ashtu siç u mbajtën, por nuk e krijuan identitetin e tyre kulturor mbi

mohimin e kësaj trashëgimie. Ky qëndrim pezull do të vazhdojë ende, dhe konflikti do të jetë latent, dhe civilizimet do të duket sikur janë gati të ndeshen për betejën vendimtare, derisa në Kosovë të mos vendoset *baraspesha* e domosdoshme ndërmjet trashëgimisë së mohuar shqiptare dhe trashëgimisë së mbitheksuar serbe. Kjo baraspeshë është e domosdoshme, jo më si shtegdalje e vetme e *depoltitizimit* të trashëgimisë kulturore të Kosovës, por edhe si e vetmja zgjidhje që Kosova të mos mbetet peng e fantazmagosrisë mesjetare, e muranave dhe e varrezave, por të shndërrohet në një vend normal jetësor, ku njerëzit mund të bëjnë jetën e tyre në rrethana krejt tokësore. Që të vendoset kjo baraspeshë, është e nevojshme që, përveç ndryshimeve konceptuale, të bëhet edhe valorizimi i barabartë i trashëgimisë kulturore me parashenjë shqiptare ose *e besuar si shqiptare* (siç është ajo serbe, *e besuar si serbe*), e kjo është trashëgimia ilire, që pothuajse në tërësi është e paeksploruar dhe dergjet nën dhë, e mbuluar nga harresa.

Trashëgimia konfliktore

Në këtë drejtim, sipas asaj që shihet tani, pengesën më të madhe e paraqesin konceptet dhe kuptimet e deformuara, të cilat janë ngulitur thellë qoftë në vetëdijen ballkanike, qoftë në perceptimin europian për Kosovën. Nga këto kuptime të deformuara, që ndikojnë ta bëjnë Kosovën vend të historisë, por jo edhe vend të jetës normale, duhet dalluar dy: se trashëgimia kulturore e Kosovës ka *funksion politik*, e para; dhe, e dyta, se trashëgimia kulturore e Kosovës paraqet jo *bashkëjetesë civilizimesh*, siç ndodh gjithkund tjetër, por konfliktin e tyre. Në të dy rastet, shqiptarëve të Kosovës

konceptet e këtilla u janë imponuar. Pra, ata nuk e kanë prodhuar vetë një botëkuptim të këtillë. Madje, mund të them pa e tepruar se kosovarët nuk kanë prodhuar ndonjë botëkuptim të tyre për trashëgiminë kulturore, por ata kanë reaguar emocionalisht ose janë kundërpërgjigjur sipas rastit, madje shpesh duke rënë pre e deformimeve të këtilla të imponuara. Atyre u është thënë dhe u është përsëritur me mijëra herë se Kosova është Jerusalemi serb, për shkak të miteve të tyre që lidhen me këtë trashëgimi. Kosovarët janë përpjekur të kundërpërgjigjen, shpesh me nervozizëm, ndonjëherë pa takt, jo gjithnjë duke bërë diferencimin e qartë midis asaj që u është imponuar si koncept i deformuar dhe asaj që përbën konceptin e drejtë, shkencërisht të pranueshëm të trashëgimisë. Ata kanë parë sesi me mijëra herë identifikohet në mënyrë tendencioze trashëgimia fetare serbe me atë kulturore, pastaj trashëgimia kulturore me atë nacionale, pastaj se si ngatërrohet identiteti fetar me atë nacional, si ngatërrohet miti me realitetin, të gjitha këto me një qëllim përfundimtar: të shfrytëzohet trashëgimia kulturore si argument politik për mbajtjen e Kosovës nën sundimin serb. Në shumicën e rrethanave, shqiptarët e Kosovës nuk kanë bërë gjë tjetër, pos që janë përpjekur të kundërpërgjigjen, shpesh pa ndonjë argumentim dhe pa gjeturi. Në politizimin e trashëgimisë, thënë me një fjalë, shqiptarët janë tërhequr për hunde dhe në këtë mënyrë vazhdojnë të tërhiqen edhe tani.

Derisa problemi i politizimit të trashëgimisë kulturore të Kosovës del i qartë dhe pa ndonjë nevojë të madhe të argumentohet, një çështje tjetër që lidhet me pasqyrën dhe gjendjen reale në terren dhe që trashëgiminë kulturore të Kosovës e paraqet si konflikt civilizimesh, në këtë pikë sqarimet dhe argumentimet më të thelluara paraqiten të domosdoshme. E anashkalojmë faktin se ishte propaganda

serbe ajo që i ka mëshuar fort idesë së trashëgimisë kulturore të Kosovës si konflikt ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes, ndërmjet Europës dhe Azisë, ndërmjet krishterimit dhe islamit, pra ta harrojmë për një çast këtë ngarkesë të madhe nën të cilën vihet trashëgimia kulturore e Kosovës dhe le të shikojmë si paraqitet gjendja në terren. Realisht, trashëgimia kulturore e Kosovës qëndron e ndarë në dy korpusë fetare: në njërin anë kemi kishat serbe, që kanë vlera të rëndësishme për artin bizantin dhe identifikohen me krishterimin, bashkë me këtë edhe me trashëgiminë e civilizimit evropian, sikundër edhe me vetë identitetin e kombit serb; kurse më anën tjetër qëndron korpusi i monumenteve orientale, xhamia, hamame, kulla, që janë identifikuar si trashëgimi shqiptare, të cilat paraqesin vlera periferike për vetë kulturën orientale, ndërsa për shqiptarët, një pjesë e tyre, janë të identifikuar si kulturë fetare dhe jo nacionale. Së pari, në aspektin kulturor dhe historik, kjo është një gjendje defektore e monumenteve kulturore në terren, sepse përbrenda përmban kontradikta të papajtueshme dhe shkapërcime atipike, situatë kjo që nuk mund të vihet në drejtpeshim as faktik, as konceptual. Elementet e pabarazisë janë: shqiptarët nuk identifikohen me fenë, serbët identifikohen me fenë; shqiptarët nuk kanë vlera, serbët kanë vlera; shqiptarët janë orientalë, serbët janë oksidentalë; shqiptarët kanë trashëgimi aziatike, serbët kanë trashëgimi evropiane. Është e qartë se të këtyllë kanë dashur ta paraqesin veten serbët dhe të këtyllë kanë dashur t'i paraqesin shqiptarët. Propaganda e tyre shkencore, pseudoshkencore, politike, diplomatike etj. ka prodhuar realitetin në terren, i cili nëse nuk i përgjigjet qind për qind kësaj situatë, në një masë të madhe e vërteton atë. Pse ka ndodhur kjo? Ku qëndron arsyeja? Trashëgimisë kulturore të Kosovës i mungon diçka, i mungon një komponentë e rëndësishme që të drejtpeshojë midis historisë dhe realitetit,

që të jetë e harmonishme dhe që tradita të bashkëjetojë me bashkëkohësinë.

Ndërmjet korpusit të monumenteve mesjetare serbe dhe korpusit oriental shqiptar; midis kishave serbe dhe xhamive shqiptare, *mungon antika dhe mesjeta shqiptare*. Ajo nuk është, ajo është shlyer nga realiteti monumental i Kosovës. Kosova është hapësira e vetme në rajon që nuk ka kështjella mesjetare, ose ka aq pak dhe i ka aq të shkatërruara, sa nuk dëshmojnë gjë (shembulli i Novobërdës). Kosova e ka antikën e mbuluar nën dhe. Pra, mungon korpusi i monumenteve kulturore që do të qëndronte në mes të dy korpuseve të tjera dhe që do të krijonte një drejtpeshim të natyrshëm. Zhdukja sistematike e monumenteve mesjetare joserbe, sikundër edhe zhdukja ose lënia nën dhë e monumenteve antike, që ka qenë politikë afatgjate e Serbisë në Kosovë, ka lënë të duket në sipërfaqe një situatë jotipike, kështu që Kosova, nga një vend ku kanë bashkëjetuar në harmoni civilizimet, të dalë sikur ajo është djep i konfliktit të tyre.

Kjo është fitore e dhunshme e politikës mbi trashëgiminë kulturore, duke e deformuar pamjen dhe funksionin e saj. Dhe çështja shtrohet: Përse edhe sot vazhdohet i njëjti avaz, përse edhe sot trashëgimia vazhdon të perceptohet po me këto koncepte, me konceptet politike serbe të trashëgimisë së Kosovës, si konflikt i pabarabartë civilizimesh dhe vlerash, si konflikt ndërmjet popujve dhe si konflikt ndërmjet historisë dhe realitetit? Kjo ndodhë për shkak se kosovarët ende nuk e kanë thënë fjalën e tyre rreth këtij problemi, ende nuk e kanë ndërtuar tamam idenë e tyre për Kosovën si shtëpi e përhershme, jo e marrë me qira, si azil i përkohshëm. Ata ende nuk i kanë ndërtuar konceptet e tyre as për trashëgiminë kulturore, sepse ende prihen jo nga ideja e *ndërtimit* por nga ideja e *refuzimit*, dhe refuzimi nuk

është gjë tjetër, përveç se pohim i të kundërtës. Kosovarët do të duhej ta ndërtonin Kosovën që *nga themeli i emrit të saj*, për të hequr qafe një herë e mirë, nga vetëdija e gjeneratave të ardhshme, se ky vend është muze i fantazmave, se ky vend është tokë e huaj, se ky vend është tragjik në të kaluarën dhe në të tashme, prandaj është i pamundur për jetë. Që të çlirohet nga kjo trashëgimi, së paku për veten e tyre, jo për serbët, ndoshta jo as për bashkësinë ndërkombëtare, por ekskluzivisht për veten e tyre, kosovarët duhet t'ia ndryshojnë emrin Kosovës, ta mbyllin një herë e përgjithnjë kapitullin e trashëgimisë së errtë, të trashëgimisë konfliktuale, të trashëgimisë negative. Dhe ta riemërtojnë Kosovën, ta ripagëzojnë, ta quajnë si të duan, Dardani ose me ndonjë emër tjetër, ekskluzivisht jo për shkak të trashëgimisë serbe, as të mitit serb; ekskluzivisht jo për shkak të trashëgimisë turko-osmane, as të historisë së tyre pushtuese, por, më në fund, për të bërë një ndarje me një të kaluar që zë frymën, që krijon siklet dhe angushti deri në mbytyje.

Instrumentalizimi politik

Emblemën më të shëmtuar politike trashëgimisë kulturore të Kosovës ia vuri plani i Ahtisaarit. Në të vërtetë, filozofia e këtij plani konsiston në ruajtjen e pamundshme të të gjitha kontradiktave që i ka Kosova, vetëm njëllor zhvendosje e tyre, në gjendje të ngrirë, matanë kohës së tashme. Ky plan ose kjo pako e lë Kosovën të tillë siç ishte, pa zgjidhur asnjë problem të saj, duke bërë që kundërthënia shekullore e Kosovës ndërmjet realitetit shqiptar dhe mitit serb të mos zgjidhet as tani. Ahtisaari ua njeh shqiptarëve të

sotmen e Kosovës në katër anekset e parë të pakos së tij, që flasin për çështje politike, juridike etj., pavarësisht se aty ka zgjidhje që e bëjnë Kosovën shtet jofunksional, siç është decentralizimi etj. Por në aneksin e pestë, ku flitet për trashëgiminë kulturore, Ahtisaari i përmbys të gjitha këto dhe Kosovën përsëri e zhvendos në histori, ose, thënë më mirë, e kthen atje ku e dëshirojnë serbët, në mitologjinë e tyre kombëtare. Përmes këtij plani, përmes mënyrës si u trajtua trashëgimia kulturore dhe fetare serbe në Kosovë, nacionalizmit serb iu njoh e drejta e patjetërsuar jo më mbi monumentet kulturore (sepse këtë nuk do t'ua mohonte njeri), por mbi idetë për Kosovën si *tokë e shenjtë*, ose, që është edhe më keq, që, për shkak të trashëgimisë kulturore dhe fetare, Serbia gjithnjë ta konsiderojë Kosovën e ndarë prej saj si padrejtësi të çastit, për shkak të raportit të forcave, por jo si një zgjidhje të qëndrueshme. Më anë tjetër, aneksi V i planit të Ahtisaarit, ndër të tjera, i vë shqiptarët në pozitë të *fajtorit historik*, të uzurpatorëve të një të drejte që nuk u takon: sipas këtij plani, Kosova vazhdon të jetë serbe, të identifikohet si pjesë e kulturës dhe trashëgimisë serbe, ndërsa shqiptarët, për shkak të trashëgimisë së pavalorizuar, janë banorë ilegalë ose gjysmë legalë të kësaj hapësire.

Në të vërtetë, ky aneks i planit do të duhej të promovonte konceptin evropian të trashëgimisë kulturore, por nuk e arrin këtë për dy arsye kryesore: e para, nuk e percepton trashëgiminë kulturore serbe si prodhues potencial të nacionalizmit serb në rrafshin e ideve; dhe, e dyta, nuk arrin që trashëgiminë kulturore të Kosovës ta heqë nga politika dhe ta zhvendosë në histori. Në Europë nuk ndodhë më që monumentet e kulturës të përcaktojnë politikën e një shteti, as mitet, as legjendat. Serbisë, me këtë plan, me këtë aneks, i është lënë pikërisht kjo mundësi dhe i është njohur kjo e drejtë, që politikën për Kosovën ta ndërtojë edhe më tej mbi

një të drejtë të njohur ndërkombëtarisht për përkatësinë serbe të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ky është instrumentalizim i pashembullt i kulturës në funksion të politikës dhe në këtë pikë Ahtisaari dhe ekipi i tij kanë rënë pre e konceptit ballkanik, respektivisht serb të trashëgimisë, që konsiston pikërisht në këtë instrumentalizim dhe keqpërdorim të saj. Një zgjidhje krejtësisht logjike dhe gjithësesi më produktive do të ishte mospërfshirja e trashëgimisë në asnjë plan, në asnjë pako politike dhe statusore. Ajo do të duhej të perceptohej si trashëgimi kulturore e Kosovës dhe asgjë më shumë se kaq, siç perceptohet kjo trashëgimi në çdo vend tjetër të Europës, me një ligj që sanksionon mbrojtjen e saj. Në pakon e Ahtisaarit vetëm ky fakt ka mundur të potencohet, pra një obligim i thënë tekstualisht se trashëgimia serbe në shtetin e Kosovë duhet të gëzojë të drejtën e mbrojtjes ligjore, të rregullt, sipas standardeve evropiane, pa ndonjë sforcim dhe pa ndonjë specifikë. Një trajtim i këtillë do ta kthente në suaza normale trashëgiminë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë, nuk do ta mistifikonte atë, nuk do ta bënte argument për politikën, sikundër që do t'i vendoste në raporte normale shqiptarët dhe serbët kundrejt një historie krejtësisht të mitizuar.

Për një pjesë të opinionit të huaj, që nuk ka shumë informacion dhe që nuk e njeh Kosovën më nga afër, mund të duket pak e paqartë, përse në bisedimet për statusin e Kosovës, si një pikë e veçantë u përfshi edhe trashëgimia kulturore. Madje, mund të krijohet edhe një përshtypje e gabuar rreth kësaj çështjeje, sepse të gjithë tashmë e dinë se bëhet fjalë për trashëgiminë kulturore serbe, ndaj së cilës shqiptarët e Kosovës, veçmas në pranverën e vitit 2004, manifestuan armiqësi të hapur, shumë agresive. Meqë kjo trashëgimi kulturore serbe në Kosovë është kryekëput fetare-ortodokse; meqë një trashëgimi të këtillë e kanë edhe disa

popuj të botës, përfshirë edhe një pjesë të vetë shqiptarëve dhe meqë pjesa dërmuese e shqiptarëve të Kosovës janë të besimit fetar mysliman, atëherë mundësia për një keqkuptim përmasash tragjike është jashtëzakonisht e madhe. Që ky keqkuptim të mos ndodhë, rreth trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë duhet pasur të qartë disa gjëra.

E para, është e ditur se trashëgimia kulturore serbe në Kosovë, më shumë se kulturore dhe fetare, ka qenë dhe mbetet politike. Që nga shekulli XIX, duke u mbështetur në këtë trashëgimi historike dhe fetare dhe duke e instrumentalizuar atë politikisht deri në skajshmëri, serbët kanë ndërtuar mitin e tyre për Kosovën, një mit mesjetar, që mbështetet mbi shovinizëm dhe ekspansionizëm dhe që në koncept e ka konfliktin e civilizimeve. Pra, duke u shërbyer me këtë mit, serbët e kanë shpallur Kosovën “tokë të shenjtë”, nga e cila nuk duhet të heqin dorë në asnjë rrethanë. Në dy shekuj e këndej, ky mit ka qenë alibia kryesore serbe për t’i zhbërë shqiptarët nga Kosova. Përveç kësaj, memoria serbe për Kosovën nuk buron që nga mesjeta, siç pretendohet tani, por që nga shekulli XIX, kur fillon lëvizja nacionale serbe dhe romantizmi i tyre nacional. Kjo memorie është më shumë mitike-fetare dhe më pak historike. Prandaj monumentet serbe të kultit në Kosovë, nga vetë serbët nuk janë konsideruar asnjëherë vetëm si vende të kultit, as si trashëgimi kulturore ose historike. Ato janë ngritur në *simbole mitike* të kombit serb, i cili, përmes këtyre tempujve, lidhet me proveniencën qiellore. Kjo mitologji, sikur të mos ishte keqpërdorur politikisht, do të dukej interesante për studime antropologjike. Mirëpo, nga ana tjetër, në vetëdijen nacionale serbe kjo mitologji panatyrshëm zhvendoset në kohë: në programin e tyre nacional Kosova thërret zërat e mesjetës për kryqëzata të vazhdueshme, për çlirimin e “tokës së shenjtë”. Në këtë kuadër do vërejtur se programi nacional serb, i

ndërtuar mbi këtë amalgamë mitologjike, fetare dhe historike, ka mbetur i konservuar deri në ditët e sotme.

E dyta, shqiptarët e Kosovës, duke u përballur vazhdimisht me këtë mit serb për Kosovën dhe duke përjetuar në lëkurë të tyre një mijë e një negativitete të tij, doemos që kanë krijuar kujtesën e tyre historike. Veprimi serb natyrshëm që ka nxitur reaksionin shqiptar. Në këtë kuadër, shikuar historikisht, edhe feja duhet ta ketë luajtur rolin e saj. Mirëpo, aktualisht, shqiptarët e Kosovës nuk ushqejnë urrejtje për monumentet e kultit serb në Kosovë për shkak të bindjeve të tyre fetare, por për shkak të kujtesës së tyre negative historike dhe aktuale, që lidhet me dijeninë e tyre se Serbia e ka ndërtuar mitin e saj për Kosovën pikërisht duke u mbështetur në këto monumente të kultit. Përveç kësaj, në mbamendjen e shqiptarëve të Kosovës këto monumente janë *identifikuar* me politikat serbe ndaj Kosovës, jo pse kështu kanë dashur ata, por nga se serbët vazhdimisht e kanë imponuar këtë gjë. Shqiptarëve të Kosovës u është mbushur mendja se aty ku është një kishë serbe, aty është nacionalizmi dhe shovinizmi serb. Në këtë pikë, ata e kanë një përvojë të hidhur edhe nga lufta e fundit dhe periudha para saj. Në kohën e sundimit të Milosheviqit, kisha serbe në asnjë rrethanë nuk u distancua nga politikat gjenocidale dhe krimet. Kisha serbe e shfrytëzoi Milosheviqin dhe politikat e tij në Kosovë që të ndërtonte kisha të reja, aty ku më së paku kishte nevojë për to: pranë rrugëve magjistrale, në vendbanime pothuajse të pastra shqiptare etj. Për shqiptarët, ato kisha të reja nuk kishin ndonjë kuptim tjetër, përveç provokimit të hapur. Gjatë luftës së fundit, ndërkaq, shumë kisha dhe manastire serbe në Kosovë ishin strehë dhe depo armësh të paramilitarëve serbë. Kjo kujtesë nuk shlyhet aq lehtë.

Agresioni kulturor i Ahtisaarit

Por, mbi të gjitha, në planin kulturor, dokumenti i Ahtisaarit ka diçka që nuk shkon, madje ka diçka që i lëndon kosovarët, që i prek në sedër dhe i fyen, që trashëgiminë kulturore serbe ua bën edhe më refuzuese, që asnjëherë të mos e konsiderojnë të pranueshme për identitetin e tyre shtetëror. Që të jemi më të qartë, palni i Ahtisaarit vendosi *zonat e sigurisë* përreth monumenteve kulturore serbe, me një përshkrim të qartë të hapësirës që iu takon atyre dhe me një lloj sovraniteti të brendshëm, i cili nuk mund të cenohet në asnjë rrethanë. Vetë prania e NATO-s në Kosovë dhe angazhimi i saj parësor në sigurinë e enklavave dhe të kishave serbe, këtij plani i jepte karakter ndërkombëtar, ndërkohë që kalimi gradual i kompetencave të sigurisë nga NATO-ja te policia e Kosovës nuk nënkupton një dalje të përhershme nga kjo situatë: sapo të ndodhë ndonjë incident, real ose i inskenuar, policia e Kosovës, e monitoruar kujdesshëm, do të përjashtohet nga mbajtja e këtyre zonave të sigurisë dhe NATO përsëri do të marrë funksionin e *rojave të shpirtrave*. Pra, nga mënyra si është rregulluar kjo materie me planin e Ahtisaarit, bëhet e qartë se për monumentet fetare serbe është gjetur një zgjidhje e pashembullt në botë, një eksterritorialitet me garanci të fortë ndërkombëtare, në pikëpamje kulturore krejtësisht i panevojshëm, në pikëpamje politike një vazhdim permanent, i pandryshuar, i politizimit të kësaj trashëgimie, për efekt të një *agresioni kulturor* kundër shqiptarëve në përgjithësi dhe Kosovës si shtet i tyre.

Vetë koncepti i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë përmes zonave të sigurisë është i paqëndrueshëm, jociwilizues, është fyes dhe denigrues. Nuk mund të bëhet një shtet normal, i respektuar nga vartësit e tij

dhe nga bashkësia ndërkombëtare, nëse në dokumentin bazë, mbi të cilin pastaj do të nxirren kushtetuta dhe ligjet themelore, figuron një aneks, i cili, me kontekstin dhe nëntekstin e tij, shqiptarët e Kosovës i stigmatizon dhe i vë në shtyllën e turpit, si popull barbar, si kope tribalësh, që nuk i njohin dhe respektojnë vlerat civilizuese. Natyrisht që, shikuar nga kjo prizëm, dokumenti i Ahtisaarit është ngadhënjim i konceptit serb mbi Kosovën dhe shqiptarët, i propagandës dhe i këndvështrimit të tyre negativ, i cili, sikundër që tashmë mund të kuptohet, është bërë i pranueshëm edhe në përmasa ndërkombëtare. Nuk vihet në dyshim nëse me këtë dokument Kosova bëhet shtet ose jo, por çfarë shteti bëhet dhe mund të funksionojë ai në botën bashkëkohore me një stigmë të tillë. Kurse aneksi V i këtij dokumenti është pikërisht stigmë, ose edhe më shumë se kaq, një akuzë *sui generis* e botës ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, një e tillë akuzë që rri e hapur kundrejt të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes njëkohësisht. Ajo është *pesha e kryqit*, që Kosova duhet ta bart mbi supë për një kohë të gjatë. Nuk janë këtu me rëndësi zgjidhjet teknike që janë propozuar për mbrojtjen e monumenteve serbe të kultit dhe të trashëgimisë kulturore. Nuk kanë rëndësi primare zonat e sigurisë, nëse ato do të shtrihen në kaq metër ose kilometër, ndonëse edhe në këtë pikë është bërë një lojë, sepse bashkë me dokumentin nuk janë publikuar hartat. Për këtë pikë janë zhvilluar diskutime të kota. Duke u përqendruar në këto kotësi teknike, qëllimisht ose jo, vëmendja është zhvendosur nga problemi themelor, që është vetë koncepti i zonave të sigurisë, i cili bie në kolizion me konceptin e civilizimit. Kush do të pranonte sot në botë të bëhej shtet, duke ia mohuar vlerat civilizuese popullit që e përbën atë? Ose, si mund të pranohet me zemërgjerësi një dokument, i cili me nëntekstin e tij të thotë në mënyrë shumë të vrazhdët: ja, bëhu shtet, por shtet tribalësh, ama! Sepse, po mos të na

quanin dhe të na kundronin si barbarë, nuk do të kërkonin një sistem të tillë të mbrojtës për monumentet e kulturës. Po mos të na quanin dhe të na kundronin si fundamentalistë, nuk do të kërkonin një sistem të tillë mbrojtës të objekteve të kultit të krishterë. Po të kishin besim te sjellja e civilizuar e kosovarëve, te vetëdija e tyre për vlerat kulturore dhe për tolerancën e tyre fetare, në asnjë rrethanë nuk do të propozoheshin masa të këtylla mbrojtëse për të mbrojtur një trashëgimi fetare dhe kulturore.

Po i rendisim këtu edhe disa pika, të cilat ilustrojnë një rrethanë kryekëput paradoksale. Së pari, dokumenti i Ahtisaarit, kur bën fjalë për trashëgiminë kulturore të Kosovës, fillim e fund e ka synim themelor mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë dhe jo mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës, siç është bërë përpjekje të thuhet herë pas here. Se kjo trashëgimi është konsideruar vetëm serbe dhe jo e mbarë Kosovës, pra e ndarë shumë qartë në baza etnike, ndër të tjera e dëshmon përcaktimi i zonave mbrojtëse përreth objekteve më të rëndësishme të kësaj trashëgimie. Këto zona mbrojtëse, ose zona të sigurisë, shqiptarëve të Kosovës iu thonë qartë: Kjo nuk është e juaja! As në pikëpamje historike, as kulturore, madje as hapësinore dhe territoriale. Prandaj, koncepti i unitetit kulturor të Kosovës me dokumentin e Ahtisaarit ka pësuar fiasko. Edhe ideja se trashëgimia kulturore e Kosovës është një dhe e pandarë, tashmë është kthyer në iluzion.

Së dyti, duhet thënë qartë se në dokumentin e Ahtisaarit asnjë objekt joserb, ose që nuk pretendohet prej tyre, nuk është përfshirë në këtë mbrojtje të veçantë. Në dukje të parë, përjashtim bën Prizreni. Në pikën 4.1.7 të Aneksit V të këtij dokumenti, ndër të tjera, thuhet: "Zona e mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të përcaktohet nga organet komunale në bashkëpunim me Këshillin

Implementues dhe Monitorues dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objektet otomane, katolike, të folurën dhe objektet tjera të rëndësisë së veçantë historike dhe kulturore". Mirëpo, në të njëjtin paragraf është thënë qartë se në këtë zonë të mbrojtur duhet të përfshihen Levishka, Marashi, shkolla e priftërinjve serbë etj. Arsyeja përse është vepruar kështu, është se objektet e trashëgimisë serbe në këtë qytet kanë një shtrirje të tillë, që nuk mund të ndahen dhe të futen në një zonë të mbrojtur, pa përfshirë aty edhe objekte joserbe.

Së treti, Ura e Gurit në Vushtrri nuk është gjendur në këtë dokument pse në themelet e saj na qenka urë romake ose dardane, por ngase serbët e pretendojnë atë dhe e quajnë Ura e Vojnoviqëve. Po e njëjta gjë ka ndodhur edhe me kullën e Isa Boletinit, e cila është futur në zonë të mbrojtur për shkak të afërsisë që ka me kishën serbe dhe për shkak se është e rrethuar me prona të asaj kishe, të cilat janë bërë të sajat në një kohë jo shumë të largët të shpronësimit të shqiptarëve. (Kishën e kishin ndërtuar çipçinjët serbë të Isa Boletinit, ndërsa më vonë ajo u bë qendër e punimit të ikonave.) Edhe Novobërda është bërë zonë e mbrojtur për shkak të pretendimeve të reja serbe për këtë qytet mesjetar, sepse, po të ishte historia në anën e tyre, kalaja e Novobërdës nuk do të ishte bërë rrënojë që në kohën e sundimit të tyre në Kosovë.

Së katërti, sekush pretendon se edhe vendbanimi antik i Ulpianës, edhe pse i përfshirë në komunën e re të Graçanicës, gjoja do të gëzojë mbrojtjen përkatëse. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Në nenin 4 të aneksit III për decentralizimin, aty ku flitet për "Kompetencat e zgjeruara vetanake komunale" tekstualisht thuhet se komunat e Mitrovicës së Veriut, e Graçanicës dhe Shtërpçës do të kenë kompetenca shtesë edhe për "mbrojtjen dhe promovimin e

trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe dhe tjetër brenda territorit komunal". Po u përkthye në gjuhën praktike, kjo do të thotë një përshëndetje e fundit me vendbanimin antik të Ulpianës, sepse komuna e serbe e Graçanicës është e pritshme se do t'i nxisë ndërtimet në zonën 40 hektarësh të këtij vendbanimi antik, ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën jo shumë të largët me të gjitha vendbanimet antike dhe mesjetare joserbe në Kosovë.

Së pesti, Gazimestani, një dëshmi se bashkësia ndërkombëtare në Kosovë është gjetur tërësisht e hutuar, pa asnjë ide të qartë se ku gjendet dhe se deri në ç'pikë shkojnë manipulimet serbe me trashëgiminë kulturore. Pra, bëhet fjalë për një monument që shënon gjoja vendin e Betejës së Kosovës të vitit 1389, një pirg me lartësi 25 metër, i ndërtuar në vitin 1953, pranë rrugës Prishtinë-Mitrovicë, një obelisk ose pirg që ka formën dhe pamjen e një kulle mesjetare, në hyrjen e të cilit janë gdhendur vargjet e këngës popullore serbe për "nëntë Jugoviqët", një metaforë e pësimeve dhe viktimizimit serb në Betejën e Kosovës, që, e ngritur në përmendore, duhet të marrë një konotacion më të gjerë dhe më bashkëkohor. Pikërisht te konotacioni bashkëkohor qëndron arsyeja për një refuzim të fuqishëm të shqiptarëve ndaj këtij monumenti, sepse ai tashmë ka humbur kuptimin fillestar dhe është shndërruar në simbol të Miloshviqit dhe nacionalizmit serb. Sepse pikërisht në këtë vend, më 1989, në 600-vjetorin e Betejës së Kosovës, Milosheviqi shpalli programin e luftërave në Ballkan. Tani ky pirg i Gazimestanit, që nuk ka asnjë vlerë monumentale, sepse është ndërtuar më 1953; që deri në vitin 1989 nuk kishte asnjë rëndësi as për vetë serbët, sepse ishte lënë ta mbulonin shkurret e drizat, përnjëherësh bëhet monument kulturor i rëndësisë së veçantë për Kosovën, me zonë sigurie përreth dhe me polici që duhet ta ruajë 24 orë pa ndërprerje. Në të

vërtetë, kujt i referohet kjo përmendore dhe pse duhet ruajtur atë? Atë nuk duhet ruajtur as për vlerat e veçanta që ka, as për faktin që shënon vendin e supozuar të Betejës së Kosovës të vitit 1389, por duhet ruajtur si përmendore me konotacion bashkëkohor gjenocidal, si vend tipik i ringjalljes së fantazmave të kohëve të errëta.

Rikonfigurimi identitar

Në përgjithësi, janë këto rrethana, të hershme dhe më të vona, të cilat kanë venë në dyshim mundësinë e ndërtimit të një identiteti të mëvetësishëm mbi një korpus të këtillë të trashëgimisë kulturore. Trashëgimia kulturore e Kosovës nuk është e një tërësie, pra paraqitet mjaft kontraverze, me referenca kuptimore kundërthënëse, e cila nuk ka lënë mundësi për krijimin e një identiteti të diferencuar territorial, mbikombëtar. Më anë tjetër, edhe në pikëpamje të trashëgimisë monumentale, Kosova është *aneks kulturor*, pikërisht ashtu siç e ka përkufizuar në mënyrë cinike pakoja e Ahtisaarit. Ajo është vazhdimësi ose pjesë e disa kulturave materiale, e disa trashëgimive kulturore, qendrat e të cilave gjendeshin jashtë saj. Ajo nuk ka qenë qendër kulturore as politike e Perandorisë Romake, por e një province të saj. Në pikëpamje kulturore, ajo nuk kishte qenë asnjëherë më shumë se një periferi e kulturës së lashtë greke ose romake, por, më anë tjetër, kjo trashëgimi, e kthyer në argument nacional dhe të identitetit të shqiptarëve ka marrë të tjera vlera, madhësi pagode dhe rëndësi të papërfytyrueshme. Po kështu, me gjithë pretendimet e mëdha serbe, Kosova nuk ka qenë as qendër kulturore e Perandorisë Bizantine, por e një principate ose disa principatave të saj. Kultura bizantine

e Kosovës është periferi e kulturës qendrore bizantine, pra është variant i saj periferik. Mirëpo, e kthyer në argument nacional dhe të identitetit të serbëve, kjo kulturë mori vlera të tjera dhe përmasa të papërfytyrueshme. Po kjo mund të thuhet edhe për kulturën monumentale turko-osmane, sepse monumentet e kësaj kulture, të cilat janë të pranishme në Kosovë, nuk paraqesin ndonjë vlerë për tërësinë e kësaj kulture. Ndonjë xhami e Prishtinës ose e Prizrenit nuk paraqet asgjë në krahasim me Ajo Sofinë e Stambollit ose me xhaminë e Sulltan Sylejmanit në Edrene.

Pra, marrë në përgjithësi, nuk janë vlerat reale ato që kanë përcaktuar funksionin identitar të kësaj trashëgimie, por perceptimi nacional-romantik i tyre, i cili i ka ngritur ato në nivel të përfytyrimeve fantastike. Që të krijohej një unitet historik i kësaj trashëgimie, si trashëgimi e përbashkët e Kosovës, tashmë e kemi thënë përse kishte qenë e pamundur. Deformimet në perceptim në esencë kanë qenë politike, por, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e tyre, ato u kthyen dhe u bënë edhe historike. Tani, që Kosova të ndërtojë *identitet territorial*, do të duhej t'i pajtonte ose t'i tejkalonte këto dallime në perceptim, gjë që është e pamundur, për shkak të kundërshtive të mëdha që ka përbrenda. Në radhë të parë është kujtesa historike ajo që pengon një proces të këtillë, por janë edhe dallimet identitare, përjashtuese për njëri-tjetrin. Një pjesë të identitetit të tyre shqiptarët e Kosovës e kanë ndërtuar mbi *idenë e refuzimit serb*; një pjesë të identitetit të tyre serbët e kanë ndërtuar mbi shovinizmin antishqiptar. E zëmë se këto dallime do të tejkalohen dhe se shqiptarët, të cilët janë shumicë në Kosovë, me kohë do të lirohen nga kujtesa negative që kanë për trashëgiminë kulturore dhe fetare serbe dhe pak nga pak do ta pranojnë atë trashëgimi si pjesë përbërëse të identitetit kulturor të Kosovës. Por ai identitet

çfarë do të jetë, një konglomerat, amalgamë papajtueshmërisht të shfaqura publikisht, apo një vello mjegulle, që mbulon përposhtë kundërthënie të jashtëzakonshme? Nuk do mend, kosovarët do të mësojnë tolerancë, por toleranca nuk është dhe nuk mund të bëhet identitet.

Por ajo që tani më duket interesante për t'u marrë në shqyrtim është ndërtimi i mundshëm i një *identitetit të ri kosovar* mbi trashëgiminë ilire. Tashmë e kemi thënë se trashëgimia ilire, ose iliro-greke, ose iliro-romake në Kosovë nuk është eksploruar dhe nuk është valorizuar. Deri në vitin 1999 Serbia nuk donte që të bëhej kjo, madje nuk e lejonte diçka të tillë të ndodhte, sepse ajo përkujdesej me shumë vigjilencë që monumentet me parashenjë ilire të mos errësonin trashëgiminë mesjetare serbe dhe të mos krijonin hamendësime rreth të drejtës historike mbi Kosovën. Që Kosova ta valorizonte vetë këtë trashëgimi, nuk kishte as ndonjë interesim të veçantë (sepse nacionalromatizmi tashmë e kishte kryer funksionin e tij), por as mundësi materiale, sepse eksplorimet dhe hulumtimet në këtë fushë janë të shtrenjta, në një kohë që bashkësia ndërkombëtare i kishte caktuar prioritet rindërtimin e monumenteve fetare serbe të dëmtuara gjatë luftës dhe më 2004. Edhe donatorët e huaj qartësisht i ndanë rolet rreth rindërtimit të monumenteve të dëmtuara gjatë luftës: perëndimorët e përqendruan vëmendjen te trashëgimia kulturore dhe fetare serbe, ndërsa fondacionet turke dhe arabe u morën me xhamitë dhe trashëgiminë tjetër orientale.

Më anë tjetër, në këndvështrimin shqiptar, substrati i hershëm monumental i Kosovës, nga lashtësia, nga antikiteti dërgonte mesazhe krejtësisht të qarta dhe njëkahore deri në ditët e sotme: se Kosova, që në krye të herës kishte qenë pjesë e një tërësie, pra ishte Dardani dhe Dardania ishte

pjesë e Ilirisë, se këtu vërtetohej me saktësi të madhe vazhdimësia ilire-shqiptare, sepse vetë emri i Dardanisë (dardhë) për gjuhëtarët shërbente si njëra nga dëshmitë e qëndrueshme të kësaj vazhdimësie. Ky perceptim i trashëgimisë së Kosovës ishte i rëndësishëm për krijimin e vetëdijes nacionale të shqiptarët e Kosovës dhe ndodhi paralelisht me proceset e tjera identitare, që u zhvilluan në këtë hapësirë diku nga vitet '60-'70 të shekullit të kaluar. Shqiptarët e Kosovës, me formim të vonë të identitetit dhe gjithnjë nën tryshinë serbe, i mëshonin fort këtij fakti, pra prejardhjes ilire të shqiptarëve dhe të qenit e Dradanisë si pjesë e Ilirisë. Ky perceptim, gjithsesi me bazë historike, por me referenca nacionalromantike, në mënyrë të shkëlqyer korrespondonte me idealin politik të shqiptarëve të Kosovës: Kosova kishte qenë ilire, kishte qenë pjesë e Ilirisë, e cila kishte përfshirë tërë Ballkanin dhe më shumë se aq, ndërsa tani Kosova ishte shqiptare dhe duhej të bëhej pjesë e Shqipërisë, edhe me të drejtën e saj historike. Ky ishte raporti më i konsoliduar identitar i kosovarëve me trashëgiminë historike të Kosovës dhe ky perceptim duhej të vërtetohej edhe në terren, pra në eksplorimet arkeologjike të trashëgimisë monumentale. Por Serbia, përmes ndikimit të fuqishëm politik dhe shtetëror që kishte, nuk lejonte të bëhej shumë në këtë drejtim. Pavarësisht në kishte Kosova autonomi më të ngushtë apo më të gjerë, Serbia pa pra mbajti nën kontroll rigoroz gjurmimet arkeologjike, muzetë dhe eksponatet muzeore, gjithnjë duke vigjiluar mbi të gjitha referencat e mundshme që kjo trashëgimi mund të dërgonte në ditët e sotme.

Në këtë e sipër, aty nga fillimi i viteve '90, me t'u formësuar vizioni i një Kosove të pavarur, si një zgjidhje politike më e përshtatshme ndër opsionet në qarkullim, *trashëgimia dardane* e antikitetit filloi të dilte nga mjegullnaja

e kohëve të lashta dhe të merrte një konotacion të ri. Mesazhet themelore të kësaj trashëgimie mbeten ato që ishin, pra, se bëhej fjalë për një trashëgimi ilire, se Dardania në antikitet kishte qenë njëra nga krahinat ilire etj., por në mënyrë të veçantë u nuancua fakti se Kosova e sotme, si entitet, si tërësi territoriale, kishte një ekuivalent historik të kryehershëm, pra që në kohën iliro-romake. Së këndejmi, zgjidhja politike për një Kosovë të pavarur fuqizohej edhe me këtë trashëgimi të njëmendtë historike ose pak historike-romantike, siç ishin zakonisht idetë nacionale gjatë gjithë kësaj periudhe. Kjo ide edhe mund të funksiononte dhe Kosova pas vitit 1999, dhe Kosova pas vitit 2008 lehtësisht mund të *rikonfiguronte identitetin* e saj, së paku për shqiptarët, në mënyrë që ajo të mos mbetej peng i një trashëgimie negative, por të formësonte një identitet që do të shkonte drejt konsolidimit.

Doemos që pengesë kryesore për një zgjidhje të këtillë do të ishte bashkësia ndërkombëtare, e cila, përveç që e bëri Kosovën shtet si kompromis të të gjitha kompromiseve, u përkujdes më së shumti që nga ky entitet të krijonte një amalgamë pothuajse të pamundur identitetesh, trashëgimish dhe synimesh politike. Këto kompromise, sikundër e kemi thënë, i dhanë përparësi trashëgimisë historike serbe, duke i bërë shqiptarët të ndjehen sikur jetojnë në një Kosovë të huaj, në një Kosovë të përkohshme ose të marrë me qira. Shqiptarëve të Kosovës iu dha e sotmja, mbase edhe e nesërmja, por iu mor historia. Për pragmatizmin bashkëkohor kontemporan kjo nuk duket keq, por për rrethanat ballkanike, madje edhe europiane, kjo duket joserioze, e paqëndrueshme, kalimtare, e pangulitur. Të gjitha shtetet evropiane serioze kanë histori, ndërsa Kosova, në perceptimin ndërkombëtar, do të qëndrojë

gjithnjë në një dualizëm të papajtueshëm: shtet shqiptar me trashëgimi serbe.

Që të ndërpritej kjo anomali, as vetë shqiptarët nuk ditën të bënin atë që duhej, sepse u ngatërruan politikisht në ato segmente që zakonisht quhen mbipolitike dhe mbipartiake. Me rastin e shpalljes së pavarësisë më 2008 kosovarët kishin rastin të ndërprisnin *vazhdimësinë negative* të perceptimit të Kosovës si shtet i kompromisit. Bashkë me flamurin dhe stemën, ata duhej të bënin edhe *emrin*, pavarësisht se me këtë rast një krahu politik mund t'i njihej merita për një vizion të hershëm të Kosovës si Dardani. Natyrisht që bashkësia ndërkombëtare do ta kundërshtonte këtë zgjidhje, por ajo, për një periudhë kohore, do të mund të funksiononte si zgjidhje paralele, derisa një ditë, pas daljes së Kosovës nga përkujdesja ndërkombëtare, ky emërtim do të fuqizohej edhe me zgjidhjet përkatëse kushtetuese.

Por nuk kanë qenë dhe nuk janë vetëm këto dy pengesa, për ta funksionalizuar Kosovën si shtet në kuptimin e plotë të fjalës. Vetë kosovarët kanë shumë dilema rreth Kosovës, rreth shtetit që kanë bërë, rreth qëndrueshmërisë së tij, rreth dashjes, rreth patriotizmit të tyre, i cili tashmë është bërë disi i mjegullt dhe nuk ka një adresë të saktë kujt t'i referohet. Kosova e tyre ka nevojë për dashurinë e tyre, për idealizmin e tyre, por ai mungon, disi është lënë të rrijë në heshtje deri në një shfaqje të re. Kosovarët kanë qenë të gatshëm për sakrificat të jashtëzakonshme deri në çlirimin e Kosovës, deri në dëbimin e Serbisë nga Kosova, por më tej qëndruan pezull, ndoshta duke pritur një nxitje të re. Edhe në pikëpamje të trashëgimisë historike dhe kulturore, Kosova del një çështje e lënë në udhëkryq.

KULTURA, LETËRSIA, ARTET

Identiteti deficitar

Identiteti i mëvetësishëm kulturor i Kosovës u krijua dhe vazhdoi të ishte funksional përgjatë viteve sa ajo ishte pjesë e ish-Jugosllavisë. Në pikëpamje kulturore, Kosova nuk mund t'i përkiste ndonjë entiteti tjetër të këtij shteti, jo pse ishte krahinë autonome, por për faktin se popullsia e saj shumicë nuk ishte popullsi sllave. Ajo kishte gjuhë tjetër, të tjera tradita, trashëgimi tjetër kulturore dhe një përbërje etnopsikologjike të ndryshme nga të gjithë popujt e tjerë që përbënin ish-Jugosllavinë. Ideja se Kosova mund të bënte një kulture të veten, nis me situatën pas Luftës së Dytë Botërore, kur analogjia e të drejtave me periudhën e fashizmit e avancon ndjeshëm statusin kulturor dhe arsimor të Kosovës dhe të shqiptarëve të saj. Për shkak të specifikave që i përmendëm më sipër, pavarësisht nga shtrëngesat e vazhdueshme politike që i vihen Kosovës në periudha të ndryshme, një si autonomi kulturore pothuajse gjithnjë i mbetet asaj. Ta zëmë, pas vitit 1944-45 dhe më vonë, Serbia i merr të gjitha kompetencat ushtarake, administrative, arsimore dhe kulturore në Kosovë dhe, bashkë me këtë, edhe kompetencat e botimit të teksteve shkollore dhe të literaturës tjetër, kështu që botimet shqip të asaj kohe mbajnë siglën e Serbisë dhe si vendbotim e kanë Beogradin, por gjuha e tyre nuk mund të ishte gjuhë tjetër, përveç se shqip. Me kalimin e viteve, idetë e Titos për një socializëm

liberal dhe për Jugosllavinë si bashkësi e kombeve dhe kombësive të barabarta, edhe në Kosovë krijuan atmosferë më produktive kulturore.

Por a mund të bëhej dhe si mund të bëhej kulturë kombëtare në një hapësirë dhe në rrethanat çfarë ishte Kosova? Nga njëra anë ajo kishte trashëguar një prapambetje të paparë, një analfabetizëm gati të qindpërçindtë të popullsisë shqiptare. Lidhjet arsimore dhe kulturore me Shqipërinë, të cilat u krijuan në kohën e fashizmit dhe funksionuan deri me 1948, u këputën në mënyrë të vrazhdët dhe të pashpresë. Në njërin krah Kosova kishte burimin e saj të identitetit dhe të qenësisë, pra Shqipërinë e ndarë me një kufi të pakalueshëm; ndërsa në krahun tjetër kishte një shtet aneksionist, armiqësor dhe kërcënues deri në zhbërje. Por, mbi të gjitha, në substancën e saj ajo kishte një injorancë dhe prapambetje të madhe. Dy ishin situatat e favorshme, të cilat bënë që Kosova në këtë periudhë të kultivonte një identitet të saj kulturor: e para, ndarja e Jugosllavisë nga blloku socialist dhe bashkë me këtë edhe përvetësimi i politikave kulturore më liberale; dhe, e dyta, përkatësia kombëtare dhe gjuhësore jo sllave e shqiptarëve të Kosovës, që pamundësoi integrimin e shpejtë dhe masiv të tyre në identitetin jugosllav.

Në një rrethanë të këtillë, Kosova nuk kishte shume zgjidhje. Do të bënte *kulturë jugosllave të integruar* në pikëpamje politike dhe ideologjike, por njëkohësisht do të bënte edhe kulturë autentike, deri-diku të pavarur, që i takonte vetëm asaj dhe i referohej në mënyrë gati iluzore kulturës gjithëkombëtare. Kultura e saj mund të mbetej në njëfarë mase autentike, për shkak të gjuhës dhe identitetit të papërfshirshëm në asnjërën nga kulturat sllave. Po të vazhdonte gjatë kjo gjendje, sikur shqiptarët në Jugosllavi të ishin popullsi më e koncentruar dhe sikur në Jugosllavi të

mos ndodhte viti 1966, Kosova detyrimisht do të ndiqte rrugën e krijimit të një identiteti krejtësisht të veçantë kulturor. Këtë situatë do ta ndihmonte edhe shkëputja e lehtë e Kosovës nga trashëgimia e munguar kulturore, me lidhjet e munguara kulturore me Shqipërinë dhe përgjithësisht me botën shqiptare. Që nga Bogdani e prapa, Kosova nuk i kishte dhënë pothuajse asgjë kulturës kombëtare shqiptare. Ajo e kishte njohur Rilindjen Kombëtare si lëvizje politike, por jo si lëvizje kulturore. Në këtë lëvizje politike kishte marrë pjesë në masë të gjerë dhe në mënyrë shume aktive, por në pikëpamje kulturore kishte mbetur e lidhur tepër ngushtë me Turqinë dhe botën orientale. Mungesat e këtylla kulturore të Kosovës, përfshirë edhe shkallën e ulët të integritimit në kulturën shqiptare, krijojnë terren të përshtatshëm për *mëvetësi kulturore*, për identitet të ndarë. Por, që ta bënte këtë, asaj i duhej një potencial kulturor, të cilin ajo nuk e kishte, sikundër edhe një shkëputje më e tejzgjatur me Shqipërinë. Shkëputja me Shqipërinë kishte ndodhur më 1912-13, për disa vjet ndarja nuk ishte stabilizuar, më vonë kosovarët kishin gjetur mënyrë ta bënin poroz kufirin e ndarjes arsimore dhe kulturore, për të arritur kështu të periudha 1941-1948, kur ndodh një kthesë e rëndësishme dhe varshmëria kulturore e Kosovës kundrejt Shqipërisë bëhet e pakthyeshme. Përgjatë viteve 1948-1966 Kosova përsëri rrezikon shkëputje, mëvetësi dhe krijimin e një *identiteti të dhunshëm kulturor*, por duket se politikë jugosllave nuk mund ta përballonin një projekt të këtillë jotipik, në kuadër të një ideologjie dhe koncepti politik që tashmë kishte njohur zhvillime të reja.

Megjithatë, mbi substratin e kulturës jugosllave të shtresëzuar në kulturën shqiptare të Kosovës në vitet e rënda të ndarjes së thellë me Shqipërinë, fillon të njohë një lloj vazhdimësie një identitet i përzier kulturor, një kulture

shqiptare e integruar në të gjithë përbërësit kulturorë të Jugosllavisë. Ky ishte ideali i ri politik i ithtarëve të Jugosllavisë, të cilët ëndërronin nëse jo një komb-hibrid që do ta mbante më këmbë shtetin jugosllav të rrezikuar vazhdimisht nga nacionalizmi kombeve të veçantë, atëherë së paku një kulturë tërësisht të integruar, një *mbikulturë*, e cila do të zinte vend mbi kulturat e veçanta kombëtare. Kjo kulturë e integruar duhej të ishte pararendëse e integrimi të tjera dhe një si mburojë e jugosllavizmës nga nacionalizmi i kombeve dhe kombësive të veçanta. Ideja për të bërë një kulturë të tillë të integruar nuk do ta lëndojë kulturën serbe ose kroate, jo vetëm pse ato ishin me të mëdhatë në ish-Jugosllavi, por më shumë për faktin se në këto dy kultura të bashkuara ndërvetshëm duhej të integroheshin edhe kulturat e tjera të popujve më të vegjël. Pra, jugosllavizma, edhe brenda vetë popujve sllavë kishte prapavijën e saj diskriminuese, ta zëmë për sllovenet, apo malaziasit, njësoj si për boshnjakët dhe maqedonasit. Për shqiptaret, më një anë, ajo paraqitej e pamundur, kurse më anë tjetër i tejkalonte shkallët e diskriminimit të popujve të tjerë, sepse ishte një kulturë, e cila përmes procesit të integritit lëndohej në esencën e saj, në përbërësit e saj themelorë. Një pjesë të mirë të identitetit të saj kultura shqiptare e Kosovës e kishte ndërtuar dhe duhej ta ndërtonte mbi *refuzimin sllav*, prandaj një integrim i saj në kulturën jugosllave vetvetiu nënkuptonte mënjanimin e kësaj pjese të identitetit. Së këndejmi, paraqitej e integrueshme në kulturën jugosllave ajo pjesë e kulturës shqiptare që nuk e theksonte identitetin e saj kombëtar, që në substancën e saj nuk kishte asgjë nacionaliste, madje as nacionale, ose, së paku, të mos e kishte komponentën e diferencimit me kulturat sllave. Prandaj, të integrueshëm në kulturën jugosllave paraqiten autorët kosovarë me *identitet deficitar*, pa shenja identifikues të autoktonisë, ose me modernitetin si referencë kuptimore.

Importimi i modeleve

Megjithatë, Kosova u fut në procesin e bërjes së kulturës, të letërsisë dhe të arteve me një trashëgimi të zymtë, të rëndë, gati të pamundur. Ajo duhej që njëherësh të bënte letërsi dhe të krijonte lexuesin; të bënte art figurativ dhe të krijonte recipientin ose vizitorin e ekspozitës; të bënte muzikë dhe të krijonte dëgjuesin; të bënte teatër dhe të krijonte shikuesin. Ky proces ishte i vështirë për shkak të shumë mungesave, por, mbi të gjitha, për shkak të situatës komplekse politike dhe kulturore në të cilën gjendej Kosova. Edhe sikur ta kishte të lejuar të bënte kulturë të pastër nacionale, Kosova do ta kishte të vështirë ta realizonte atë synim, për shkak të traditës së munguar, për shkak të ambientit të prapambetur kulturor, për shkak të trysnisë politike, për shkak të rrethimit kulturor tepër të vështirë për t'u përballur, duke mbrojtur me çdo kusht substancën identitare të kulturës kombëtare. Shekulli XX nuk ishte shekull i integrimi dhe ideal i shumicës së krijuesve ishte krijimi i vlerave që pasurojnë kulturën kombëtare. Rruga e krijimit të vlerave universale nuk shkonte drejtpërdrejtë, por vetëm përmes kulturave kombëtare. Në këtë kuptim, për konceptin kulturor të shekullit XX, në Jugosllavi dhe më gjerë, Kosova ishte *kulturë kombësie*, kulturë pakice kombëtare, kulturë që i takonte një tërësie matanë kufirit shtetëror. Pakicat kombëtare në përgjithësi, veçmas në Jugosllavinë e atëherëshme, e kishin ideal mosshkëputjen nga trungu i kulturës kombëtare, respektivisht krijimin e vlerave të integruara në kulturën amë. Shqiptarët e Kosovës dhe të Jugosllavisë në përgjithësi kishin një *shtet amë* dhe një kulturë amë. Kombi dhe shteti ishin të ndarë me një qartësi të madhe. Shteti ishte Jugosllavia, të cilën shqiptarët në përgjithësi nuk e donin, kurse përkatësia e tyre kombëtare

ishite shqiptare, me të cilën, përveç gjuhës, kulturës, historisë, i lidhte edhe sentimentin. Në pikëpamje kulturore kjo donte të thoshte se shqiptarët e Kosovës i takonin kulturës së përbashkët shqiptare, ndërsa pjesëmarrja e tyre në kulturën jugosllave, nëse mund të thuhej se ekzistonte një e tillë, ishte një domosdo politike, fat i historik, pasojë e rrethanave, pra jo një përcaktim i tyre i vullnetshëm. Në shekullin XX e drejta e pakicave nuk matej me krijimin e rrethanave për integrim, që domethënë asimilim, por me krijimin e kushteve dhe rrethanave për ruajtjen e identitetit dhe lidhjeve sa me të forta me kulturën amë. Në shekullin XX identiteti kombëtar, identiteti kulturor mund të forcohej, të konsolidohej, por nuk mund të krijohet rishtas. Ai ishte i trashëguar dhe vetëm gjaku i shprishur krijonte identitet të ri, respektivisht asimilohej, konvertohej, humbte një identitet dhe krijonte një identitet tjetër.

Prandaj, në pikëpamje kulturore Kosova nuk mund të kishte shumë dilema. Askush në Jugosllavi, pas vitit 1966, nuk ia mohonte Kosovës *përkatësinë shqiptare*, sikundër që vazhdimisht i vihej në dijeni se për lidhjet kulturore me shtetin amë nuk kishte pengesa të tjera, përveç atyre politike dhe ideologjike, për të cilat fajin e mbante Shqipëria dhe regjimi i saj diktatorial. Kjo rrethanë, sikundër edhe përqendrimi i madh i shqiptarëve në Jugosllavi, pastaj politika liberale kulturore dhe nacionale, si dhe shkëputjet kulturore me Shqipërinë, te disa eksponentë të kulturës shqiptare në Kosovë dhe në Jugosllavi krijuan disa parakushte për një *iluzion kulturor* krejtësisht të pamundshëm: se Kosova mund të bënte kulturë më vete; se ajo mund të krijonte identitet të veçantë kulturor; se kultura e saj mund të avanconte më shumë se ajo e Shqipërisë; se Kosova mund të bëhej avangardë e kulturës shqiptare; se në Prishtinë tashmë ishin krijuar të ashtuquajturit qarqe

kulturore të ngjashëm me kryeqendrat jugosllave; me një fjalë, se kultura e Kosovës mund ta rivalizonte kulturën e Shqipërisë, së paku në avangardizëm dhe modernitet.

Vetëm se në këtë observim kulturor, edhe atëherë edhe sot, ekzistonte një problem: në atë kulturë kosovare, të sendërtuar qoftë si letërsi, si art figurativ, ose si performancë muzikore apo teatrore, ishte e vështirë të përcaktohej se çfarë kishte më shumë, kulturë autentike, kulturë jugosllave apo kulturë kontemporane? Ata që atëbotë modernitetin e shihnin tek vinte me trenin e mëngjesit nga Beogradi në Fushë-Kosovë, nuk e kishin për gjë që në Kosovë poezinë, pikturën, apo teatrin ta bënin ose si profesorët e tyre jugosllavë, ku i kishin kryer studimet, ose si modelet e tyre krijuese, që gjithashtu e gjenin me shumicë në qendrat më të mëdha kulturore të ish-federatës jugosllave. Si njohës të mirë të gjuhës serbokroate dhe lexues të rregullt të letërsisë dhe publicistikës jugosllave, kosovarët për një kohë të shkurtër arritën të ndiqnin zhvillimet bashkëkohore në kulturën jugosllave, e cila tashmë njihej për kapjen e shpejtë të rrjedhave europaerëndimore. Duke kapur këto rrjedha dhe shpesh duke u bërë imitues të tyre, disa artbërës kosovarë krijuan iluzionin e kulturës kosovare si kulturë e integruar në Jugosllavi, e cila diferencuhej qartë nga kultura e Shqipërisë. Pas një kohe disa syresh do ta kenë vërejtur të vërtetën e trishtuar se tashmë kishin bërë një provë, ndoshta edhe një eksperiment kulturor, të bërjes së kulturës pa recipientë. Sikundër që do të shihet më vonë, krijimin e recipientit kulturor ata e kishin lënë në dorë të askujt, që domethënë e kishin braktisur atë, ose e kishin lënë në dorë artistit socrealist të Shqipërisë. Por le të shkojmë me radhë.

Disidenca e munguar

Do të hedh një vështrim të shpejtë dhe të bëj të njohur situatën kulturore në Kosovë, siç e kam parë unë, që nga vitet '60 e këndej, që nga koha e njohjes së parë me këto zhvillime dhe, më vonë, si i përfshirë në krejt këtë proces. Le të nisim me letërsinë. Dy nga shkrimtarët më të parë në Kosovë, Esad Mekuli dhe Hivzi Sulejmani, janë shkrimtarë bilingualë dhe vijnë nga një trashëgimi kulturore me ide proletare. Esad Mekuli poezitë e para i shkroi që në vitet '30, si student në Beograd, i pëlqente ta krahasonin me Migjenin, por e vërteta është se poezitë më të mira i kishte shkruar serbisht dhe më pastaj i kishte "rikënduar" në shqip. Një njeri me merita të jashtëzakonshme në bërjen e letërsisë së Kosovës, përmes revistës "Jeta e re". Hivzi Sulejmani mund të konsiderohet prozatori më i rëndësishëm i viteve të fillimit, por tregimet dhe romanet i shkruante serbisht dhe sekush ishte gjendur pastaj që i kishte përkthyer në gjuhën shqipe. Kishte qenë prokuror publik në vitet e para të pasluftës, pastaj ishte zhgënjyer, ishte tërhequr nga jeta publike dhe ne e quanim disident, jo pse ai ishte vërtet i tillë, por nga se na pëlqente që, përveç *disidencës nacionale*, të kishim edhe njëfarë *disidence krijuese*. Megjithatë, romanin e parë në Kosovë e boton Sinan Hasani, atëherë dhe më vonë i njohur si pro-serb i madh. Në përgjithësi, letërsia e kësaj gjenerate të shkrimtarëve, në fillimet e saj i takon shkollës së realizmit socialist.

Por më vonë letërsia në Kosovë njih zhvillime të tjera. Që në vitet e hershme të pasluftës, Jugosllavia pranon pluralizmin e metodave dhe të shkollave letrare. Kjo rrethanë i krijon mundësi letërsisë në Kosovë të emancipohet shpejt. Poetë dhe tregimtarë kosovarë zgjerojnë rrethin tematik dhe pasurojnë shprehjen e tyre

letrare. Meqë tashmë shkëputja me Shqipërinë ishte e tërësishme, ata, shkrimtarët e gjeneratave të para, mësimet e letërsisë i marrin kryesisht në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, ku përveç se kanë mundësi të lexojnë letërsinë shqipe të traditës, mësojnë edhe letërsi jugosllave dhe letërsi botërore. Poezia e poetëve të rinj dhe proza e tregimtarëve që sapo kishin mësuar mjeshtërinë e shkrimit, fillon rrugën e vështirë të kërkimit të identitetit kulturor dhe letrar. Metafora bëhet e gjithëpushtetshme në poezinë kosovare; përjashtohet narracioni, sepse ai kërkon ballafaqim me rrathtë kuptimorë më eksplicitë. Për shkak të kësaj rrethane, por edhe për shkak të mungesës së traditës letrare, proza zhvillohet më ngadalë. Brenda saj lëvizin tendenca të kundërta, herë realiste, madje socrealiste; herë moderniste, madje ultramoderniste. Ndërkohë, pasi ka bërë hapat fillestarë nën ndikimin e fuqishëm të letërsisë jugosllave, në vitet '60 letërsia e Kosovës zë të konsolidohet dhe ta qartësojë pozicionin e saj të identitetit. Letërsia kosovare, veçmas poezia, krijon rrethin e saj tematik, *rrethin e metaforave dhe të simboleve*, përmes të cilëve ligjëron figurativisht për idealin e saj: lirinë nacionale, për të cilën guxon të thotë se nuk është realizuar bashkë me lirinë sociale. Për herë të parë këtë e thotë poezia, e cila, duke shfrytëzuar të folurit e figurshëm dhe përmes korpusit të simboleve të deshifrueshëm vetëm në gjedhen tematike të Kosovës: guri, zogu, kulla etj., dërgon të njëjtin mesazh në dy adresa të ndryshme: te lexuesi i kosovar në formim e sipër dhe te lexuesi kureshtar jugosllav.

Lexuesi kosovar, i papërvojë në punë të artit, i tillë çfarë ishte dhe aq sa ishte, njësoj si shumica e lexuesve të poezisë programatike, tashmë kishte krijuar kodin e komunikimit të tij me artin e poetëve të vet: ajo poezi i duhej për mesazhet që barte, për idetë dhe jo për artin që kultivonte. Lexuesi dhe

në përgjithësi recipienti kosovar nuk e konsumonte poezinë për përjetim artistik, ose jo aq për përjetim artistik, por për *funkcion misionar*, për të përmbushur një vakuum idesh dhe perceptimesh, që nuk i gjente në veprimtaritë e tjera shoqërore, në llojet e tjera të shkrimit, madje as te dijet e tjera: nuk ia ofronte as politika, nuk ia ofronte as shkrimi i historisë, as publicistika. Simbolet dhe metaforat janë të deshifrueshme, ato kryesisht i referohen lirisë dhe qëndresës kombëtare, por gjithmonë të tilla që nuk venë në sprovë politike as krijuesin, as përdoruesin e tyre.

Madje, në Kosovë tashmë ishte krijuar ideja se, me një autocensurë të vogël, krijuesit mund të bashkëjetonin me kufizimet tematike dhe ideore, pra një lloj kohabitacioni i paparë ndërmjet mungesës së lirisë dhe vullnetit individual dhe grupor për të mos e vënë në sprovë shtetin dhe aparatit e tij represiv. Prandaj në Kosovë nuk pat disidencë të mirëfilltë letrare, qoftë për shkak se shkrimtarët e Kosovës nuk ishin "rritur" për disidencë ideologjike përmasash jugosllave (të tillë nuk pat as në letërsitë e tjera, sepse programi letrar i Kërlezhës, në marrëveshje me Titon, i shpallur që në vitet '50, përjashtonte mundësinë e ndeshjes së shkrimtarit me shtetin për shkaqe ideologjike); apo më shumë për faktin se edhe disidenca kombëtare kishte një lloj lirie pothuajse të mjaftueshme të manifestimit. Madje, nëse shikojmë më me vëmendje këtë çështje, pra mungesën e disidencës së vërtetë letrare në Kosovë, do të vërejmë dy fenomene shumë interesante dhe aspak tipike për rrethanat e letrare në një vend komunist. Në Kosovë, përgjatë gjithë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, mund të gjeje aty-këtu ndonjë shkrimtar të burgosur ose që e kishte të ndaluar botimin, madje emrat e tyre diheshin nga të gjithë që punonim nëpër redaksi. Mirëpo, rënia e shtetit më 1991 nuk nxori në dritë asnjë emër që ia vlente, e aq më pak ndonjë

vepër që mund të ishte mbajtur e fshehur, për t' u botuar në rrethanat pas rënies së komunizmit. Dhe nuk bëhej këtu fjalë vetëm për disidencë ideologjike, por edhe për disidencën kombëtare. Më anë tjetër, në Kosovë tashmë njihej edhe fenomeni jotipik i shkrimtarit, i cili i shërbente shtetit dhe aparatit të tij partiak ose politik, por njëherësh në veprën e tij manifestonte një shkallë të lartë të angazhimit nacional. Ta zëmë, në Kosovë do të ndodhte të kishe disa poetë të përfshirë në jetën politike, anëtarë komitetesh dhe strukturash të tjera, por në poezi, për nga shkalla e angazhimit kombëtar, ata ua kalonin edhe atyre që dergjeshin burgjeve.

Ky fenomen i komplikuar letrar bëri që në Kosovë të mos funksiononte disidenca letrare dhe në këtë pikë të shkohej edhe ndonjë hap më larg: që ndonjëri nga studiuesit jo pa dije letrare ta quante Jugosllavinë *kuadër ideal*, në të cilin ishin realizuar të gjitha synimet kombëtare të shqiptarëve. Natyrisht, ky ishte një perceptim i gabuar, sepse, ta zëmë, po t'ia hiqje poezisë së Kosovë angazhimin tematik kombëtar në vijën e programit nacional të lirisë, pra të daljes nga Jugosllavia, si dhe korpusin e metaforave që lidhej me këtë angazhim tematik, asaj do t' i mbetej aq pak, sa nuk do t' ia vlente të thuhej se Kosova kishte ndopak poezi a letërsi. Madje, edhe përkundër modernizimit që përjeton poezia e Kosovës nga gjenerata e dytë dhe e tretë e poetëve, ajo nuk do të arrijë pothuajse asnjëherë të lirohet nga ky angazhim tematik, sa për shkak të traditës që tashmë e kishte krijuar, po aq edhe për shkak të ndjeshmërisë që manifestonin vetë poetët kundrejt një tematike të këfillë. Për shkak të kësaj rrethane, pra të këtij kufizimi tematik, një pjesë e mirë e poezisë së Kosovës e krijuar në këtë periudhë, do ta ketë një lloj *afati të skadimit* më të theksuar se llojet e tjera të krijimtarisë. Madje, pas vitit 1999, për shkak të

zhbërjes së pakthyeshme të idealit poetik utilitar dhe për shkak të rikonfigurimit të hapësirës kulturore dhe letrare shqiptare, poezia e Kosovës pothuajse do të pushojë së ekzistuari, aq minore dhe e parëndësishme që do të bëhet në vetë qenien e saj.

Iluzionet krijuese

Në fushë të prozës tregimtare dhe romanore zhvillimet në Kosovë do të shkojnë pak më ndryshe. Në vitet '60 në letërsinë e Kosovës shfaqet një plejadë prozatorësh të rinj, kryesisht tregimtarë dhe ndonjë romancier pa përvojë letrare, të cilët krijojnë idenë se ky lloj letrar në Kosovë do të njohë zhvillime interesante. Mirëpo, situata do të ndryshojë shpejt. Derisa poezia arrin të konfigurohet në planin tematik dhe të shprehjes së figurshme, proza e Kosovës për një kohë të gjatë nuk do të arrijë t'i konsolidojë tre faktorët e saj kryesorë, të brendshëm dhe të jashtëm njëkohësisht: gjuhën, rrëfimin dhe lexuesin. Në të vërtetë, proza e Kosovës nëpër faza të ndryshme të zhvillimit të saj, reflekton më së miri mungesën e traditës letrare, sikundër edhe situatën konfuze kulturore dhe letrare që mbretëronte në Kosovë, përgjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX.

Kështu, duke njohur nivelin e lexuesit të Kosovës, të cilit mund t'i referohej proza tregimtare dhe romanore, ishte e pritshme që ky lloj i letërsisë në fillim të kishte një zhvillim tradicional, madje primitiv, një rrëfim dhe një gjuhë që mund të ishte i afërt me tregimet popullore, me anekdotat dhe me meseletë e odave. Një krah i shkrimtarëve të Kosovës për shumë vite i qëndroi besnik kësaj mënyre të shkrimit, disa syresh arritën të tërhiqnin dhe të mbanin rreth vetes

shumicën e lexuesve të paemancipuar, duke ofruar një lëndë letrare pa vlerë artistike. Tematika e kësaj proze ishte realiste, me refleksione të pakta dhe me përshkrime të thjeshtëzuara, me ambient kryesisht rural dhe me personazhe që përpëliteshin të bëheshin karaktere, por nuk ia dilnin. Në këtë rrjedhë u zhvillua proza e hershme e Kosovës, u shkruan një numër romanesh dhe më shumë tregime, që bënë fjalë për një botë të varfër përjetimesh dhe me bëma heronjsh të paletrarizuar, një lëndë bruto, e papërpunuar artistikisht, e cila kalonte nga një ambient i paemancipuar, në një letërsi të paemancipuar dhe te një lexues i paemancipuar.

Afërisht kjo do të duhej të ishte *letërsia autentike* e Kosovës, e tillë që do të duhej të lidhej me identitetin e saj, një letërsi fshatarake, naiviste, që nuk sublimon asnjë përvojë letrare, që nuk kishte dijeni për asnjë rrjedhë letrare, për asnjë zhanër, që nuk e njihte gjuhën e rrëfimit, veçmas gjuhën, e cila paraqitet e varfër në leksik, me barbarizma turko-sllave, me kalke të shumta dhe me një sintaksë të pamundshme të frazës. Me një fjalë, ishte një letërsi, një prozë primitive për një lexues primitiv, të mbyllur, të izoluar në pikëpamje kulturore dhe letrare. Ky ishte një rrezik i madh për letërsinë e Kosovës, ishte rrezik për emancipimin kulturor të kosovarëve, të cilët filluan ta konsumonin këtë letërsi përmes institucioneve të arsimit, përmes botimeve, përmes shtypit dhe të përkohshmeve letrare. Madje, disa autorë të kësaj proze dhe të kësaj letërsia për një kohë të gjatë u lavdëruan nga kritika letrare, e cila pretendonte të quhej e emancipuar për veten dhe emancipuese për letërsinë. Poezia ishte një gjë tjetër. Ajo kishte krijuar hapësirën e saj bredhëritëse, rrethin e saj tematik dhe korpusin e metaforave, ca të huajtura nga letërsia jonë e traditës, ca të tjera nga poezia jugosllave ose botërore. Proza nuk mund të funksiononte me marrje të tilla. Ajo duhej të

konsolidonte një numër komponentësh, përfshirë edhe komponentin kulturor të lexuesit.

Pothuajse në të njëjtën kohë me këtë tendencë letrare, ta quajmë *tradicionale*, në letërsinë e Kosovës shfaqen shenjat e *modernitetit*, pra e një letërsie që synon të avancojë në pikëpamje artistike. Por edhe këtu ndodhin shartime të panatyrshme: një ambienti kulturor pothuajse analfabet, kërkohet t'i imponohet një art modernist, elitar. Është një diskrapancë që në mënyrë të panatyrshme përplas realitetin kosovar me iluzionet krijuese. Nuk është vetëm lexuesi, recipienti, që nuk i shkon prapa këtij arti, është vetë ambienti që nuk i përshtatet. Kjo ndodh në Kosovë pothuajse në të gjitha fushat e krijimtarisë, në letërsi, në artet figurative, në teatër, në muzikë. Ta zëmë, në poezi shfaqen tendenca formaliste, të cilat kuptohet se nuk lindin nga një shtyrje e natyrshme autentike e ambientit letrar, por janë të huajtura, të përvetësuar. Në prozë shfaqën dhe zhvillohen tendenca të antiromanit, sikundër edhe në dramë të antidramës, pothuajse po në atë kohë kur ato lulëzojnë në metropolet e Europës, prej nga barten përmes komunikimeve kulturore jugosllave. Në artet figurative pothuajse në tërësi është braktisur realizmi dhe gjerësisht është përvetësuar arti abstraksionist. Muzika synon po ashtu majat e modernitetit, me riprodhimin e "tingujve kozmikë" dhe çudira të tilla. Në teatër vihet "Duke pritur Godonë" e Beketit, vetëm pak kohë pasi shfaqja kishte njohur suksese të mëdha në Paris dhe në metropolet kulturore europiane.

Po kaq i pamundur për recipientin kosovar del edhe arti figurativ i Kosovës i atyre viteve, i cili ishte futur në rrugën e një abstraksioni të thellë, me referenca kuptimore skajshmërisht aproksimative. Pothuajse secili nga piktorët, skulptorët apo grafistët kosovarë, nga studimet e bëra në Beograd, Zagreb ose Lubjanë, sillte në Kosovë punë të bëra

nën përkujdesjen e profesorëve të njohur. Disa syresh, madje, kishin bërë edhe specializime në metropolet europiane të artit. Por në Kosovë, në shumicën e rasteve, ata sjellin imitime të modeleve, ose epigonizëm të thellë artistik. Kosova elitare, e tillë çfarë është dhe e tillë sa është, i mirëpret, u bën elozhe dhe i inkurajon të vazhdojnë këtë rrugë, madje duke u krijuar mundësi që të jetojnë mirë, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Vetë shteti, institucionet e tij, njerëzit e politikës, që të gjithë janë të interesuar që ky art të funksionojë. Por ai ka një problem përjetësisht të pazgjidhur: ky art elitare, duke qëndruar shtrembër në raport me realitetin e Kosovës, arrin të fitojë numër tepër të kufizuar recipientësh, të cilët, sado që shtohen nga sezoni në sezon, nga viti në vit, janë gjithmonë po ata, një shtresë, një klasë snobësh, disa edhe artdashës të vërtetë, të cilët nuk dinë ku të ngarendin më parë, të shfaqja, te ekspozita, te koncerti, herë ngase duan të duken, herë të tjera ngase mund të ndjejnë edhe nevojë reale të konsumojnë vlera të tilla. Vetëm se ata janë të paktë në numër dhe shpesh, disave syresh, iu vjen erë e rëndë jugosllavizëm.

Por Kosova kishte edhe një problem tjetër, me të cilin nuk desh pothuajse asnjëherë të ballafaqohej tamam: ajo nuk kishte ambient kulturor, i cili mund t'i përvetësonte në mënyrë kreative tendencat e këtilla; ajo nuk kishte lexues të formuar, nuk kishte konsumues të emancipuar të artit. Synimi i një pjese të krijuesve të Kosovë për të bërë art elitare ndeshje me një shpërputhje, me pamundësinë e gjetjes së valëve të njëjta, të kodit të komunikimit me recipientin. Në një pikëpamje, ky synim i krijuesve drejt modernitetit kishte rëndësi të madhe, jo vetëm pse një bashkëkohësim të artit në përgjithësi e lakmonte gjithësecila kulturë kombëtare e botës lindore, por më shumë për faktin se këto lëvizje do të duhej ta çlironin artin kosovar nga kufizimet e një kulture të vogël e të

mbyllur, pastaj nga trysnia ideologjike e socrealizmit dhe nga tradicionalizmi konservativ, ku ishte tendencë të akomodohej. Por, më anë tjetër, kjo ishte një ikje e krijuesve kosovarë nga realiteti i vrazhdët, ishte një refuzim i tij, por krejtësisht e pamundur që, përmes këtij injorimi, ai realitet të mbisundohej ose të ndryshohej. Më shumë ngjante me një imitim të atyre ambienteve kulturore, ku nevoja e përfaqimit të modernes kishte lindur si imanencë konceptuale dhe artistike, ndërsa këtu ishte një sendërgjim krejt i panatyrshëm, ndonjëherë madje qesharak për kontekstin e rrethanave. Bie fjala, shfaqjen "Duke pritur Godonë" të Beketit e kam parë në Teatrin e Krahinor në ndonjërin nga reprizat e saj të shumta, kur sapo kisha ardhur si student në Prishtinë dhe, nga kjo perspektivë, e shoh veten në grumbullin e një numri shikuesish që hynin e dilnin nga dera e këtij teatri, ndërsa po pranë këtij tempulli të artit atëbotë rridhte e qelbur përroska e kanalizimit të hapur të Prishtinës. Por ky nuk ishte i vetmi paradoks. Shfaqjen nuk e kuptonin as shikuesit, madje as kritika që atëbotë shkruhej në "Rilindje". Ndërsa shfaqja numëronte reprizat e shumta, njëzet, tridhjetë, nuk e di sa, askush nuk e thoshte, as e merrte vesh se kush ishte Godoja i Beketit dhe çfarë kuptimi kishte "loja gjuhësore" që ai bënte me anglishten në një ambient frëngjishtfolës. Ndonjë vit më vonë vihet në skenë drama "Sinkopa" e Anton Pashkut, të cilën, më sa u vërejt, nuk e mori vesh as publiku, as kritika, madje as vetë regjisorin e shfaqjes.

Anakronizëm dhe modernitet

Meqë e kemi fjalën te teatri, do të sjell këtu një situatë përvojë, për mendimin tim interesante, e cila i shpjegon disa

zhvillime kulturore në Kosovën e atyre viteve. Kosova atëbotë jetonte midis kontradiktave të mëdha, duke u dyndur, në një kohë shumë të shkurtër, nga një skaj në tjetrin, nga prapambetja në emancipim, nga tradicionalizmi në modernizëm, nga ambienti oriental-anadollak në europeanizëm, nga minderet në kanape, nga nallanet në këpucë me take, nga benevrekët në minifunde. Koha ishte shumë e shkurtër për transformime rrënjësore, kështu që mund të ndodhte shpesh që zhvillimet emancipuese dhe modernizuese, përveç që ndodhnin në situata jotipike, merrnin me vete edhe shfaqje anakronike, ndonjëherë edhe devijante. Arti, krijimtaria në përgjithësi, që të ishte autentike, e kishte shumë të vështirë t'i ndiqte këto ndryshime, pa trazime të brendshme dhe pa shkarje në njërin krah ose në tjetrin. Gjithmonë ekzistonte mundësia e ngecjes në tradicionalizëm, ose e avancimit të tepruar, e humbjes së ndjenjës së realitetit.

Pra, e kishim fjalën te teatri. Nuk e mbaj mend saktësisht, por diku nga mesi viteve '60, mund të ketë qenë viti 1964-65, ndërsa isha nxënës i shkollës fillore në Krajë, ndodhi ta shihja shfaqjen e parë teatrore në jetën time. Në të vërtetë, më parë kisha parë shfaqje me partizanë, ose ndonjë skeç, që, bashkë me nxënës, i përgatiste mësues Hysi për festa të ndryshme, veçmas për 1 Maj. Tani bëhej fjalë për një shfaqje të vërtetë të Teatrit Popullor Krahinor, pra të teatrit të Prishtinës, i cili erdh në Krajë me një autobus dhe me një kamion, e vendosi skenën në një ambient të hapur, në oborrin e shkollës, dhe improvizoi aty shfaqjen "Nuk martohem me parë" të Myrteza Pezës. Nxënësit dhe bashkëfshatarët e mi e shikuan shfaqjen, duke mos e pëlqyer edhe aq shumë, sepse te ne martesat bëheshin me shkuesi, por jo me para dhe me shitblerje vajzash. Pra, ishte Teatri Popullor Krahinor ai që e kishte bërë këtë shfaqje, e shëtiste

gjithandej hapësirave shqiptare të ish-Jugosllavisë dhe kjo ndodhte vetëm tri ose katër vjet para se po në skenën e këtij teatri të vihej “Duke pritur Godonë” të Beketit. Krahasoni tani “Nuk martohem me pare” me “Duke pritur Godonë”, jo në kontekst të vlerave artistike, sepse në këtë pikë nuk mund të bëhen krahasime, por nga një plan tjetër, nga referencat për publikun. Pra, ku ishte Kosova, në cilën hemisferë të tokës? Si mund të krijohet një *identitet kulturor* me një kontradiktë të këtillë brenda perceptimit artistik, të një realiteti krejtësisht të dyzuar, madje përjashtues për njëri-tjetrin?

Një sintezë, gati të pamundur, të këtyre kundërshtive do të arrijë ta bëjë Muharrem Qena me shfaqjen “Erveheja”, enigma e suksesit të së cilës ende hijezon të gjitha shfaqjet e teatrit kosovar. Me këtë vepër arti Kosova ishte në rrugë të krijimit të identitetit kulturor krejtësisht të mëvetësishëm, të pangjashëm me asnjë kulturë tjetër në hapësirat e ish-Jugosllavisë, madje e veçantë edhe në raport me Shqipërinë. Me 120 reprizat e mbajtura në Prishtinë, me sallën e mbushur plot; dhe me turnetë e shumta gjithandej Kosovës ku gjendej një sallë dhe një skenë, “Erveheja” krijoi kulturën teatrore të Kosovës. Pse ndodhi kështu? Ku qëndron enigma?

Subjekti i “Ervehesë” ishte tradicional, por në shumë pika i afërt me Kosovën. Nga tradicionalizmi dhe orientalizmi, ku mund ta zhvendoste subjekti, shfaqjen e nxirrte mrekullisht shprehja e avancuar skenike, që nga loja e aktorëve, rituali e deri skenografia, kostumet dhe dritat. Me këtë shfaqje Kosova bënte përpjekje të dilte nga provincializmi, nga ngushtësia e një ambienti të prapambetur dhe po merrte rrugën emancipimit. Pra, konteksti i kësaj shfaqjeje nuk ishte vetëm teatror dhe artistik, ishte edhe kulturor, edhe shoqëror, edhe politik. Ajo

ishite shenjë e një Kosove që po zgjohej, që po ndryshonte raportet me trashëgiminë e saj tradicionale, me ideologjinë dhe dogmën socialiste, sikundër edhe me kulturat dhe popujt e tjerë të hapësirës së atëhershme jugosllave. Ajo ishte shfaqje e identitetit të veçantë të Kosovës në mesin e atyre kulturave. Ajo, në njëfarë mënyre, ishte shoqëruese, mbase edhe pararendëse e atyre zhvillimeve që do të shënojnë fundin e viteve gjashtëdhjetë, të epokës së lënies dhe harresës, të diskriminimit të Kosovës; dhe fillimin e një epoke tjetër, të zgjimit të Kosovës dhe të ndryshimit të raporteve të saj me veten dhe të tjerët. "Erveheja", në planin kulturor, ishte zgjim kombëtar, e tillë çfarë ishin në planin politik demonstratat e vitit 1968. Ajo ia hoqi Kosovës kompleksin e inferioritetit kulturor dhe e bëri të barazueshme me të tjerët. Me një shfaqje si "Erveheja", Kosova nuk mund të ishte më "zonë e errët", një vend i braktisur dhe i harruar edhe nga Zoti. Me një zë të tillë që vinte nga arti, Kosova nuk mund të mos përfillej e të mos merrej në konsideratë. Sepse mesazhi që vinte nga kjo shfaqje, ishte jashtëzakonisht i qartë: Kosova nuk e pranonte më "dënimin e pamërituar", një dënim për fajin që nuk e kishte bërë. Rrëfimi i "Ervehesë" ishte një zë i protestës kundër padrejtësisë, kundër nëpërkëmbjes së dhunshme. Ajo fshikullonte brenda dhe jashtë. Godiste moralin e rrejshëm të një shoqërie, sikundër që godiste po me kaq forcë edhe kontekstin e gjerë, në të cilin ishte vendosur një fat i përdhunuar. Kosova politike e asaj kohe, ishte Erveheja e dënuar pa hak. Ishte ky mesazh, i cili nga arti i sofistikuar dilte në rrafshin shoqëror dhe politik. Ata që e shikuan "Ervehën" jashtë Kosovës, doemos që e kapën këtë mesazh. Publiku brenda Kosovës, ndoshta, nuk e kishte krejt të qartë këtë porosi që vinte nga skena, por ai e ndjente se "Erveheja" ishte pjesë e tij, ishte një rrëfim që fliste për të, për dhembjen njerëzore, e shkaktuar nga padrejtësia. Edhe

nëse nuk i kapte mesazhet e tjera largvajtëse, kjo i mjaftonte, sepse “Erveheja” fliste sa për fatin individual, aq edhe për fatin kolektiv, madje edhe për fatin e njeriut në përgjithësi. Dhe arti i vërtetë pikërisht këtë e synon.

Në vitet '70, shfaqja “Erveheja” bëri një turne në Shqipëri. Nuk e di sa herë u dha shfaqja dhe çfarë publiku e ndoqi atë. Sigurisht publik i kontrolluar dhe i kufizuar. Nuk kam parë asgjëkund një fjalë të vetme të shkruar për të dhe nuk kam dëgjuar, vite më vonë, ta kujtojë njeri, që e ka parë, që e ka pëlqyer apo nuk e ka pëlqyer. Diçka krejt e paqenë, që zhduket pa gjurmë. Shfaqja duhet të jetë quajtur dekadente në diskutimet e mbyllura artistike, nëpër mbledhje partiake apo në tubimet e frontit. Por gjithnjë më ka bërë përshtypje paaftësia, ose jogatishmëria e krijuesve të Shqipërisë që të ushtrojnë një memorie tjetër, individuale ose kolektive, të ndryshme nga mbamendja e pushtetit, e regjimit diktatorial. Por çuditërisht ndodhë që, në këtë rast, kujtesa e lirë, e pakontrolluar dhe e pacensuruar artistike dhe kulturore e Shqipërisë ndaj Kosovës të ishte identike me atë të të pushtetit, që domethënë se, ndonjëherë, refuzimi ishte kthyer në vetëdije të konsoliduar, të qëndrueshme, të përhershme. As me rënien e diktaturës nuk ka ndryshuar kjo vetëdije. Kështu disi ndodhi edhe me shfaqjen “Erveheja”, të cilën teatri i Shqipërisë nuk e pati dhe as që do ta ketë ndonjëherë.

Dualizëm dhe dikotomi

Për të treguar se, edhe përkundër të gjitha attributeve që i mori, arti kosovar u konsolidua ose nuk u konsolidua, duke u gjendur në disa rrethana çuditërisht paradoksale dhe

duke zhvilluar disa raporte specifike me atë që quhet art kombëtar, do të marrim tre shembuj dhe do të rrëfejme për secilin veç e veç. Pjesë e këtyre raporteve vazhdon të jetë i ashtuquajtimi art elitar i Kosovës, në të cilin u përpoqën të futeshin pothuajse shumica e krijuesve. Rastin e parë e parë e përbën një pikturë e Muslim Mulliqit, rastin e dytë kënga “Baresha” e Rexho Mulliqit dhe rastin e tretë vepra letrare e Anton Pashkut.

Një pikturë e Muslim Mulliqit, me format të madh, ishte e vendosur në njërin nga ambientet e godinës së sotme të Kuvendit të Kosovës, në sallën ku dikur mbaheshin mbledhjet e Këshillit Ekzekutiv, pra të qeverisë së dikurshme të Kosovës. Piktura ishte e fazës blu të këtij autori, ishte një tablo abstrakte, me një kombinim të harmonishëm të ngjyrës së bardhë dhe të kaltër. Nuk do mend, ata që mbanin mbledhje në atë sallë, nuk besoj se e kuptonin gjë nga piktura e Mulliqit, por atë e mbanin aty, sepse një pikturë e tillë krijonte imazhin e një ambienti kulturor të emancipuar. Meqë në atë sallë mbaheshin të gjitha takimet e rëndësishme qeveritare, ajo pikturë shihej shpesh në TV. Pas vitit 1990, me rrënimin e institucioneve të Kosovës, pamja e sallës dhe e pikturës u zhdukën dhe, pas vitit 1999, kur pamja e sallës u soll përsëri në TV, piktura e Mulliqit nuk ishte më. Disa vjet më vonë, me rastin e rinovimit të godinës së Kuvendit, në ambientet e brendshme të kësaj godine u vendosen ca piktura murale, që u bënë problem, jo për shkak vlerave të munguara, por nga se kishin përmbajtje të papërshtatshme për pjesëtarët minoritarë të Kuvendit. Para se pikturat të mbuloreshin, u zhvillua një debat i ashpër, por asnjëri nuk bëri një krahasim midis pikturës abstrakte të para tridhjetë vjetësh të Mulliqit dhe pikturave naive që së fundi stolisin godinën e Kuvendit. Pra, thënë ndryshe, Kosova jetoi *idilin e saj të artit*

elitar, nuk e kuptoi atë, nuk u emancipua bashkë me të, por dikur mësoi ta respektonte atë. Më vonë, me përmbysjet politike dhe sociale, ky idil u zhduk pa kthim.

Diku në vitet '70, u mor një vendim që Festivali "Akordet e Kosovës" të ndryshonte vendin e mbajtjes dhe, në kishte mundësi teknike dhe organizative, të mbahej në qendra të ndryshme të Kosovës, pra edhe jashtë Prishtinës. Në një nga ato vite, njëri nga këto festivale u mbajt në Mitrovicë dhe aty u këndua për herë të parë kënga "Baresha" e Rexho Mulliqit, gjithsesi sot kënga më e popullarizuar e Nexhmije Pagarushës, një këngë që dëgjohet me ëndje nga të gjitha moshat dhe që në Kosovë e dëgjon ngado që sillesh. Me rastin e interpretimit të parë, kënga nuk u duartrokit, nuk u pëlqye nga publiku, përkundrazi u fishkëllye, pra u refuzua në një mënyrë shumë të vrazhdët. Tridhjetë vjet më vonë kjo bëhet kënga më e preferuar në Kosovë, e gjithpranueshme, nga të gjitha gjeneratat. Kënga është një përpunim i hollë i melosit popullor, të tillë që e bënte në mënyrë të shkëlqyer Rexho Mulliqi. Është ky një rast i rrallë, kur një vepër arti tridhjetë vjet më vonë e gjen vendin e vet te recipienti kosovar.

Shembulli i fundit është nga letërsia. Bëhet fjalë për Anton Pashkun, prania e të cilit prej gjysmë shekullit në letërsinë e Kosovës ka ndjekur një konstantë të përbërë prej dy vijash paralele: është miratuar gjerësisht nga kritika dhe studimet letrare në Kosovë dhe, po me kaq vendosmëri, është refuzuar nga lexuesit. Ideja se lexuesi i Kosovës, në kohën kur u shkrua vepra e Pashkut, nuk ishte emancipuar në shkallën e mjaftueshme për një komunikim tërësor me veprën e tij dhe se duhet të kalonte një kohë më e gjatë në procesin e emancipimit që ai të vihej në raport më të drejtë me vlerat e kësaj vepre, kishte një mbështetje në kohën kur u shkrua vepra, ndërsa tani nuk funksionon më, madje mund

të thuhet se është braktisur edhe nga ata që kanë qenë ithtarë të këtij iluzioni. Pashku është po atje ku ka qenë në fillim – i pranuar gjerësisht nga kritika dhe profesionistët e letërsisë, por i mohuar nga lexuesit.

Pashku edhe sot paraqitet i pakomunikueshëm për lexuesin e gjerë, por vazhdon të jetë tërheqës për lexuesin profesionist. Në Kosovë ai nuk ribotohet, përveç se në rastet kur tirazhi garantohet se do të shitet për shkak të përfshirjes në programet shkollore. Lexuesi në Kosovë, as sot, tridhjetë vjet pasi është rrumbullakuar së shkruari vepra e tij, nuk tregon interesim për Pashkun. Cilat janë arsyet? Disa duan të thonë se ai qëndron në disproporcion të madh me nivelin e lexuesit, veçmas të atij në Kosovë, sepse Pashku do lexues të kultivuar, të ngritur, me dije letrare, lexues profesionist. As propaganda e madhe e kritikës nuk ka ndihmuar shumë. Apo çështjen duhet shikuar pak më ndryshe, se Pashku përqafoi atë metodë letrare, e cila nuk ka shumë lexues në mbarë Europën. Jam i prirë të besoj se lloji i letërsisë që bënte Pashku, nuk pat popullaritet për një kohë të gjatë as në ambientet letrare më të avancuara se ky joni. Ai shkroi antiroman dhe antidramë, një modë letrare e cila edhe në vendet me letërsi të avancuar nuk jetoj gjatë. Pashku e përqafoi këtë mënyrë shkrimi pothuajse po atëherë kur ajo ishte trend në qarqet letrare evropiane. Në ish-Jugosllavi, kjo metodë letrare u përqaftua shpejt, sa për motive letrare, po aq edhe për shkak të kundërvënies realizmit socialist. Mirëpo, ndodhi që edhe në vendet e origjinës, kjo metodë letrare u braktis shpejt. Edhe Anton Pashku e braktisi atë, jo duke ndryshuar mënyrën e shkrimit, por duke heshtur, duke mos shkruar më.

Mbyllje dhe elitarizëm

Përveç disa anëve pozitive, siç është modernizimi i shprehjes dhe kundërshtimi i kryehershëm i realizmit socialist, ky lloj arti ishte edhe një fatkeqësi për Kosovën, sepse ai dilte jashtë rrjedhave funksionale: ai pothuajse asnjëherë nuk do të arrijë të ambientohet në Kosovë dhe do ta lërë këtë vend me një identitet të ngatërruar kulturor, madje mund të thuhet se me një arrogancë mendjelehtë do ta braktisë atë në rrugën e emancipimit. Thënë ndryshe, kjo letërsi, ky art figurativ, kjo muzikë, ky teatër, bëhej për një të ashtuquajtur elitizëm ose elitarizëm, që në Kosovën e paemancipuar, në disa rrethana, ishte një shtirje, një imitim dhe një pozë false, një mbyllje e artit dhe letërsisë ndaj recipientit, ndërsa në disa rrethana të tjera ishte edhe një kundërvënie funksionit utilitar, që kishte filluar të merrte një pjesë e letërsisë dhe artit në Kosovë. Në të vërtetë, ndodhi ajo që mund të pritej: derisa një pjesë e letërsisë dhe artit të Kosovës shihte ëndrra artistike me sfond moderniteti europian, madje duke u futur edhe në diskutime të tilla nëse letërsia dhe arti duhej të kishin funksion shoqëror ose jo, la në harresë lexuesin dhe recipientin kosovar, i cili sapo kishte filluar të ndihej i gjallë dhe kërkonte ekuivalentin e vet letrar dhe artistik. Ky lexues dhe recipient kishte tri burime ku mund të ushqehet: letërsinë e traditës, veçmas atë të Rilindjes Kombëtare; letërsinë dhe artin e realizmit socialist të Shqipërisë; si dhe një pjesë të artit dhe të letërsisë pothuajse pa asnjë vlerë të Kosovës, të cilin e kishin braktisur krijuesit më të mirë dhe bëhej sipas një modeli të kombinuar romantizëm nacional – realizëm socialist.

Me aq liri dhe hapje ndaj Shqipërisë, sa përjetoi Kosova në fund të viteve '60 dhe më tej, komunikimin më intensiv letrar e përjetoi me letërsinë e Rilindjes Kombëtare. Kosova

sapo kishte kaluar kurset kundër analfabetizmit, ishte në ndërtim e sipër të një sistemi shkollor, bënte libra leximi dhe tekste shkollore, disa të adaptuara nga Shqipëria, disa nga Jugosllavia, por literatura bazë e emancipimit ishte letërsia e traditës. Përveç nevojës normale të njohjes, ajo letërsi tërhoqte edhe për shkak të ekuivalenteve kuptimore dhe referencave që kishte me realitetin kosovar. E kam thënë edhe herë tjetër: letërsia e Rilindjes Kombëtare njohu në Kosovë lexuesin e vet të vërtetë, të tillë që nuk e kishte njohur askund tjetër dhe në asnjë kohë tjetër. Kur ishte shkruar dhe kur referencat e saj kuptimore ishin ndjerë vërtetë, ajo nuk kishte pasur aq shumë përhapje, shtrirje, lexim, për shkak të rrethanave të njohura. Kur ishte bërë Shqipëria, ajo ishte lexuar me ëndje, kishte shërbyer si bazë e edukimit kombëtar, por nuk ishte ndjerë dhe nuk ishte përjetuar, si në kohën kur ishte shkruar. Kosova, ndërkaq, e lexonte letërsinë e Rilindjes me pasion të madh, sepse i përshtatej në të gjitha pikëpamjet, por, mbi të gjitha, i përshtatej në përmbajtje dhe në nivel artistik. Ajo ishte letërsi e fëmijërisë së një kombi. Edhe Kosova ishte në të tillë nivel kulturor. Ajo ishte letërsi programatike. Edhe Kosova ishte futur në *procesin e përfshirjes*, jo të bërjes. Ajo, atëbotë, nuk po bëhej e mëvetësishme, sepse, po të bëhej e tillë, Kosova mbase do të gjente një tjetër letërsi programatike dhe jo atë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe do të kërkonte një program tjetër kombëtar dhe jo atë të Rilindjes. Ajo, me vonesë të madhe, po përfshihej në një proces, të cilin një pjesë e kombit e kishte kaluar shumë më herët, ndërsa asaj i kishte ardhur radha tani. Kjo duhej të ndodhte, sepse pa këtë substrat, Kosova nuk mund të përfshihej në identitet. Përfshirja e saj e vonuar duhej të ndërtohej mbi kë tjetër, përpos mbi idetë e Rilindjes Kombëtare, të cilat, të bartura përmes letërsisë dhe literaturës tjetër, ishte lektura e parë emancipuese për Kosovën, e bërjes së saj, e përfshirjes

së saj në identitetin shqiptar. Deri në atë periudhë Kosova nuk e kishte njohur letërsinë e Rilindjes, rrallë kishte komunikuar me të. Tani ajo, për herë të parë, futej në sistemin edukativ dhe arsimor, në të gjitha nivelet e shkollimit. Kosova jo që do ta lexojë, por do ta gëlltisë këtë letërsi, si e babëzitur. Siç e thamë, ajo do të luajë rol të jashtëzakonshëm në përfshirjen identitare të Kosovës në tërësinë shqiptare, por, më anë tjetër, atëherë dhe në fazat më të vona, idetë e Rilindjes Kombëtare dhe letërsia e saj do të bëhen derë e hapur, përmes të cilës do të hyjnë në Kosovë, pa trokitur, ideologjia komuniste dhe realizmi socialist i Shqipërisë. Në fazat më të vona, idetë e Rilindjes Kombëtare në Kosovë, të pazhvilluara, të keqpërdorura, gjithashtu do të bëhen sinonim i primitivizmit dhe i gënjeshtrove patriotike, azil ku do të gjejnë strehë shumë deformime ideore dhe politike.

Ndërkohë, marrëdhëniet kulturore dhe letrare Kosovës-Shqipëri kalojnë nëpër faza të ndryshme kundërthëniesh dhe zhvillimesh jotipike. Këto marrëdhënie, përgjatë gjysmës së dytë të shekullit XX kanë qenë komplekse, ndonjëherë kundërthënëse. Kështu, në vitet pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë të atij shekulli, në Shqipëri fillon të konsolidohet letërsia e realizmit socialist. Kjo ishte një letërsi e shkëputur nga përvoja e shkrimit e periudhës pararendëse dhe përmes ideve nacionale përpiqet të lidhet me letërsinë e Rilindjes. Ajo ishte letërsi e drejtpërdrejtë, që kishte një shkallë të lartë komunikimi me lexuesin. Lesuesit të Kosovës kjo letërsi i përshtatej në shumë pikëpamje: në ide, në aftësitë perceptuese, në shkallën e abstraksionit, pra në të gjithë përbërësit, ku lexuesi kosovar kishte mungesa dhe, për këtë arsye, nuk mund t'i plotësonte nevojat kulturore me letërsinë e Kosovës. Më anë tjetër, duke qenë e lidhur me idetë nacionale të Rilindjes, kjo letërsi komunikonte me

idealet kombëtare të lexuesit të Kosovës. Natyrisht që ajo letërsi ishte edhe socialiste, kishte brenda kooperativizëm dhe ateizëm, por ky fakt për lexuesin e Kosovës ishte më pak i rëndësishëm, ndonëse nuk mund të thuhet se kosovarët tashmë ishin të paprekur nga kjo ideologji. Pra, duke qenë letërsi nacional-socialiste, letërsia e Shqipërisë në Kosovë konsumohet jo për të përmbushur kritere estetike, por kryesisht për utilitarizëm kombëtar dhe politik. Kjo rrethanë bëri që letërsia e Shqipërisë të ushtrojë ndikim të madh në Kosovë dhe ajo, bashkë me Radio-Tiranën, u bë në mjetin më i fuqishëm i propagandës. Po u shikua nga kjo distancë kohore, nuk është vështirë të kuptohet se në Kosovë imazhin idealist të Shqipërisë socialiste e kanë ndërtuar pikërisht letërsia e shkrimtarëve më të mirë të Shqipërisë. Ky imazh ka qenë aq mbresëlënës, sa që, me rastin e vizitave të rralla ose pas rënies së diktaturës në Shqipëri, të paktë ishin ata kosovarë që u besonin syve të tyre. Ata me ngulm kërkonin të shihnin Shqipërinë e idealizuar të letërsisë që e kishin lexuar.

Në tjetrën anë, sikundër e thamë, letërsia e Kosovës, pjesa më e mirë e saj, e rrezikuar nga censura dhe autocensura, i futet aventurës së mbylljes, ose të shkallës më të ulët të komunikimit, duke përdorur metaforën si mjet të përcjelljes së mesazhit. Por *edukimin letrar* të lexuesit, ajo ia lë letërsisë së Shqipërisë. Kjo rrethanë nxori si rezultat një situatë jo të natyrshme: shkrimtarët e Shqipërisë u bënë më popullorë në Kosovë se sa në vendin e tyre. Ndërkohë, shkrimtarët e Kosovës, pjesa më e mirë e tyre, mbeten pa lexuesin popullor dhe u orientuan nga lexuesi elitar, nëse mund të thuhet kështu. Por kishte edhe një letërsi tjetër në Kosovë, e cila u shkrua sipas modelit të letërsisë socrealiste të Shqipërisë. Mirëpo, ajo ishte letërsi e dobët dhe nuk u mirëprit nga lexuesi, i cili, në vend të kopjes së zbehtë, kishte

mundësi ta merrte originalin. Për t'u treguar integralistë dhe patriotë, dhe për t'i bërë oponencë jugosllavizmës, autoritetet arsimore të Kosovës në planprogramet e shkollave futen më shumë vepra të autorëve nga Shqipëria. Arsye ishte edhe përshtatshmëria e kësaj letërsie me nivelin kulturor dhe dijen letrare të nxënësve, apo të sajuesve të programeve dhe të teksteve shkollore.

Politika e ndarjes dhe refuzimit

Veprat e para të letërsisë së Kosovës në Shqipëri filluan të botoheshin nga fundi i viteve gjashtëdhjetë dhe fillimi i viteve shtatëdhjetë. Në këtë pikë Kosova nuk kishte menduar ndonjëherë për reciprocitet, sepse një marrëdhënie të tillë as e synonte, as ia kishte anën. Kosova importonte nga Shqipëria libra origjinalë, libra të përkthyer, letërsi për fëmijë, libra shkencorë, doracakë, fjalorë, literaturë historike, klasikët e marksizmit, çdo gjë, përveç librave të Enver Hoxhës dhe literaturës partiake. Nga Kosova në Shqipëri shkonte një letërsi e paktë, jo vetëm pse letërsia origjinale ishte e paktë në Kosovë, por më shumë për arsye se kjo letërsi në Shqipëri kërkonte një kujdes të veçantë ideologjik. Para se të fillohej të botoheshin libra nga autorët kosovarë, gazeta "Drita" dhe revista "Nëntori" botonin poezi të autorëve të veçantë, kryesisht përmbajtje të afërta me konceptin letrar të realizmit socialist, ose të nacional-romantizmit. Ndodhë kështu që në Shqipëri botohen poetë, emrat e cilëve në Kosovë nuk thonë ndonjë gjë. Autorët më të mirë ose nuk botohen fare, ose prezantohen me krijimet e tyre më të dobëta. Megjithatë, poezia e Kosovës në Shqipëri fillon të jetë e pranishme, përkundër gjinive të tjera letrare

që injorohen pothuajse tërësisht. Nga fundi i viteve shtatëdhjetë dhe fillimi i viteve tetëdhjetë fillon një interesim më i gjerë për letërsinë e Kosovës. Por gjithsesi kriter themelor është *përshtatshmëri ideologjike* e tekstit. Pozicioni politik dhe ideologjik i autorëve shpesh nuk ishte shumë i rëndësishëm, karshi përmbajtjeve të përshtatshme, që ishte kriter themelor i botimit. Autori mund të ishte anëtar i forumeve politike dhe partiake në Kosovë dhe në Jugosllavi, por ky fakt nuk bëhej pengesë që vepra e tij të botohej në Shqipëri. Pengesë mund të ishte përmbajtja e tekstit dhe mënyra e shkrimit. Në këtë pikë censorët e letërsisë në Tiranë nuk lëshonin pe. Kjo mënyrë e botimit selektiv, duke u mbështetur kryesisht në përshtatshmërinë ideologjike dhe jo në vlerat letrare, do të krijojë në Shqipëri një pasqyrë të shtrembëruar për letërsinë në Kosovë. Edhe qëndrimi negativ që merr Shqipëria ndaj gjuhës së kosovarëve ka po këtë burim, sepse në Shqipëri nga Kosova qarkullon një letërsi e dobët, me gjuhë të shkruar keq.

Në këtë e sipër, pushteti i atjeshëm, gjatë fushatave të tij të gjata kundër “shfaqjeve të huaja”, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e vë theksin edhe te dekadentizmi i letërsisë që vjen prej Kosovës dhe te nevoja që me përmbajtjet e saj të merren në mënyrë të kujdesshme botuesit, shkrimtarët dhe bërësit e tjerë të punëve letrare. Pra, në Shqipëri, në këtë periudhë, mbi letërsinë e Kosovës hidhet një dyshim, i cili nga ideologjia gradualisht kalon edhe në segmente të tjerë të saj, siç janë përmbajtjet, metodat, shkalla e komunikimit etj., që ndryshe quhen hermetizëm, dekadentizëm e kështu me radhë. Te një masë njerëzish në Shqipëri krijohet ideja se letërsinë e Kosovës duhet ta botojmë sa për sy e faqe, sepse kosovarët i kemi vëllezër, por duhet qëndruar larg nga përmbajtjet që ofron ajo. Nuk duhet lënë pa përmendur me këtë rast se, edhe

përkundër kësaj, një numër shkrimtarësh të Shqipërisë lexojnë me kujdes letërsinë që krijohet në Kosovë. Mirëpo, ndërprerja e marrëdhënieve kulturore Kosovë-Shqipëri në fillim të viteve tetëdhjetë, sikundër ashpërsimi i luftës ideologjike, do të ndikojë që këta lexues të jenë gjithnjë e më të paktë edhe nga lagja e shkrimtarëve, ndërkohë që në Kosovë zhvillimet në letërsi bëhen shumë dinamike.

Më anë tjetër, në Prishtinë vazhdon të funksionojë ideja se çdo gjë që vjen nga Shqipëria ka vlerë letrare, ide kjo që çon në skajshmërinë tjetër, te njëfarë vetëmohimi pothuajse të tërësishëm të letërsisë së Kosovës, apo te vlerësimi i gabuar i autorëve, të cilët në hapësirën letrare të Shqipërisë nuk paraqitnin asgjë. Në këtë pikë rol negativ ka luajtur një pjesë e kritikës sonë, e cila i ka glorifikuar autorët që në Shqipëri ishin model i keq i realizmit socialist. Kështu, krahas Kadaresë, Agollit, Petro Markos dhe poetëve si Fatos Arapi, Xhevahir Spahiu etj., të cilët kritika jonë letrare i vlerësoi jashtëzakonisht mirë, u botuan dhe u vlerësuan edhe autorë dhe veprat e tyre që i bënë shërbim të keq atmosferës dhe ambientit letrar në Shqipëri. Ta zëmë, më të njohur do të bëhen në Kosovë autorët si Ali Abdihoxha, Sterio Spasse dhe Fatmir Gjata, madje edhe Jakov Xoxa, se sa në Shqipëri. Një pjesë e kritikës në Kosovë nuk kishte një qëndrim konstruktiv ndaj kësaj letërsie, sepse i bënte elozhe një letërsie që konsiderohej e parëndësishme ose si model i keq i realizmit socialist. Ta marrim romanin “Kënetë”, që në Kosovë u quajt një nga kryeveprat e prozës shqipe. Në Shqipëri ajo ishte vepër-model e qërimit të hesapeve me armiqtë e klasës, respektivisht me inteligjencien shqiptare, e cila u masakrua deri në varrosje për së gjalli në Kënetën e Maliqit.

Sido që të jetë, autorët e Shqipërisë u bënë të njohur dhe të gjithëpranueshëm në Kosovë, ndërkohë që shkrimtarët e

Kosovës ose nuk njiheshin fare, ose konsideroheshin si autorë minorë në Shqipëri. Në këtë pikë, në Kosovë rol të turbullt kanë luajtur botuesit, planprogramet mësimore dhe një pjesë e kritikës. Në Shqipëri të gjitha fajet i lihen diktaturës. Por, nëse e shikojmë më nga afër këtë problem, nuk do të nxjerrim gjithmonë përfundimin se përzierja e drejtpërdrejtë e diktaturës dhe instrumenteve të saj ishte i vetmi faktor ndikues për të krijuar bindjen se Kosova bën letërsi minore, në krahasim me atë të Shqipërisë. Duhet ta pranojmë se politika e ndarjes dhe e refuzimit, sikundër edhe ajo e vetëmjaftueshmërisë, kishin ndikimin më të madh, por jo të vetëm. Kjo politikë dhe ideologjia e saj, krijoi edhe bindjen te shumica e njerëzve në Shqipëri, se e vërteta rreth Kosovës, është e tillë siç thotë Partia. Për pasojë, një pjesë e shkrimtarëve të Shqipërisë besonin, madje ende besojnë, se letërsia e Kosovës, pjesa e saj më e mirë, ka mungesa të ndjeshme në vlera, është edhe mendjeturbullt, jokomonukative dhe dekadente. Thënë me një fjalë, në Shqipëri, edhe pas viteve nëntëdhjetë, kishte një konfuzion të madh rreth letërsisë së Kosovës dhe ajo, pjesa më e mirë e saj, vazhdoi të refuzohej po me ato arsye të qarta që i kishte vendosur sistemi i mëparshëm, duke i shtuar kësaj edhe mungesën e gatishmërisë institucionale për ta pranuar këtë letërsi si pjesë integrale e letërsisë shqipe. Në disa raste edhe një mungesë e përgatitjes letrare për ta akceptur atë.

Gjuha në komunikimet kulturore

Pas vitit 1990, me rënien e sistemit dhe me fillimin e shpërbërjes së shteteve ku bënë pjesë, shqiptarët e Shqipërisë, shqiptarët e Kosovës dhe shqiptarët e

Maqedonisë u gjenden përballë njëri-tjetrit, të pambuluar nga institucionet e shtetit dhe të sistemit. Tani ata mund t'i zbulonin e t'i thoshin njëri-tjetrit gjëra që nuk i kishin thënë më parë, të shqiptonin kritika, të talleshin, të refuzoheshin, të urreheshin, të akuzoheshin ndërvetshëm, të kërkonin fajtorin për të ligat që i kishte pllakosur gjatë historisë, pra, të lirë deri në marrëzi. Në fushën e kulturës kjo liri u manifestua me zhbërjen e sistemit të vlerave, kështu që në një çast, në pikëpamje kulturore, letrare dhe artistike Kosova dhe Shqipëria u gjenden ballë përball në një marrëdhënie pa konsiderata dhe mistifikime. Kështu, ndodhte, ta zëmë, që profesorin e universitetit, të cilin e mbaje mend tek mbushte auditorët në Prishtinë, ta shihje duke kaluar rrugëve të Tiranës me biçikletën përdore me gomë të shpuar; ta shihje shkrimtarin e njohur për fëmijë ndërsa shiste banane në ndonjë cep trotuari; ose ta shihje aktoren e njohur të filmit dhe teatrit, solisten e ndonjë ansambli tek flirtonte me ndonjë gatarbajter kosovar gjysmanalfabet. Që kishin rënë mitet e një sistemi, kjo nuk ishte gjë e keqe, por bashkë me të kishin rënë edhe vlerat dhe kjo ngjante me një katastrofë kulturore, të cilën askush nuk dinte si duhej riparuar.

Atëbotë, një numër kosovarësh, veçmas të fushës së artit dhe të kulturës, të prirë nga entuziazmi që kishin rënë të gjitha pengesat e komunikimit kulturor, ia mësyn Tiranës për të njohur dhe për t'u bërë të njohur, për të krijuar hapësirë për vete dhe për veprat e tyre, për të krijuar lidhje të reja kulturore, e, ndonjëri syresh, edhe për të bërë tregti me Shqipërinë e cullakuar. Në këtë mësymje të disa krijuesve kosovarë drejt Tiranës kishte edhe idealizëm, por kishte edhe djallëzi dhe horllëk, sepse nuk ishin të paktë ata që gjendjen kaotike në Shqipëri donin ta shfrytëzonin për promovime të shpejta. Por, sikundër u pa, edhe përkundër rënies së diktaturës dhe humbjes së funksionit të bunkerëve,

Tirana tani përballë me një bunkerizim të vetëdijes, të koncepteve, përfshirë këtu edhe *paragjykimet recidiviste* ndaj Kosovës. Regjimi i kaluar kishte bërë politikë kulturore ndaj Kosovës në dy binarë paralelë: në anë formale dhe të dukshme, ishte mirëpritur bashkëpunimi kulturor me Kosovën, ishte konsideruar i suksesshëm dhe pozitiv; në anë joformale dhe të padukshme, përveç që kultura në Kosovë ishte quajtur dekadente dhe me probleme të mëdha ideologjike, në ambientet krijuese dhe artistike asaj i vishej edhe shumë prapambetje dhe primitivizëm.

Gjuha ishte njëri nga problemet reale që kishte Kosova, për të cilin dihej se ekzistonte, por veçmas ra në sy me rastin e ballafaqimit kulturor me Shqipërinë. Gjuha në Kosovë, sikundër e kemi thënë, çalonte në shumë pika. Përveç ambientit bilingual, i cili kishte ndikuar në tronditjen e disa strukturave vitale të saj, ndërprerja e komunikimit me Shqipërinë pas vitit 1981 kishte krijuar hapësirë të përshtatshme për depërtime edhe më të fuqishme sllave në gjuhën e Kosovës, dukshëm më shumë në leksik dhe sintaksë. Jo për shkak të standardit të papërshtatshëm, siç thonë disa, por për shkak të kohës së shkurtër të mësimin të tij institucional, për shkak të traditës së munguar dhe të zhvendosjes së gjuhës shqipe *në margjinë të jetës qytetare*, viteve të fundit gjuha e Kosovës kishte degraduar shumë. Standardi i përvetësuar dhe i mësuar përmes sistemit arsimor kishte humbur bazën e tij kulturore dhe letrare dhe ishte kthyer në një variant të dialektizuar dhe të degjeneruar të standardit zyrtar. Kjo ishte situata aktuale gjuhësore e Kosovës, ndërkohë që, në raport me Shqipërinë, e shkuara e saj paraqitej pothuajse pa histori. Historia e gjuhës në Kosovë nuk kishte histori shkrimi, kishte vetëm histori variantesh dialektore. Edhe rruga e saj në gjysmën e dytë të shekullit XX kishte qenë kontradiktore, me ndërprerje dhe

zhvendosje nga njëri variant i shkruar në tjetrin. Letërsia e Kosovës e shkruar në këtë gjuhë kishte probleme të shumta, sepse letërsia është gjuhë dhe me një gjuhë të pazhvilluar, nuk bëhet letërsi bashkëkohore, aq më pak moderne.

Pra, problemi i gjuhës në Kosovë ishte real, si në letërsi, ashtu edhe në komunikim të përditshëm, por assesi nuk ishte i tillë, sa të krijonte refuzim deri në përçmim për kosovarët. Gjuha ishte më shumë një argument i kërkuar, i cili, po të mos gjendej, do të zëvendësohej me një tjetër. Ose, thënë më ndryshe, *refuzimi ideologjik*, i ndërtuar nga sistemi diktatorial, ishte shndërruar në refuzim gjuhësor. Apo, refuzimi historik i Kosovës, i ushqyer për një kohë të gjatë, në një çast të papërshtatshëm të marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë ishte shndërruar në *refuzim gjuhësor*. Në rrethanat e krijuara, refuzimi i Kosovës nga ana e Shqipërisë nuk mund të quhej më refuzim historik, sepse një refuzim me emër të tillë do të ishte shumë lëndues. Nuk mund të quhej as refuzim ideologjik, sepse shkaqet politike për një refuzim të tillë kishin rënë përfundimisht. Por refuzimi kishte mbetur. Është gabim të mendohet se ai vinte vetëm nga Shqipëria. Nuk ishte se Kosova kishte luajtur rolin e engjëllit në këto marrëdhënie. Përkundrazi, edhe Kosova kishte historinë e saj të përzierjes në punët e Shqipërisë, ndonjëherë duke iu prirë ngjarjeve më epilog tragjik. Pra, refuzimi ekzistonte, vetëm që tani i duhej dhënë një emër tjetër dhe ai do të marrë konotacionin e *refuzimit gjuhësor*, por në të vërtetë ishte refuzim shumëplanësh, i cili me eufemizëm mund të quhet *refuzim kulturor*.

Dhe tani vijmë te një rrethanë më afër situatës së krijuar me letërsinë. Në Shqipëri mendojnë se shkrimtarët e Kosovës, jo veç e veç, por të gjithë së bashku, kanë probleme serioze në punë të gjuhës. Nëse këtë nuk e thonë publikisht aq shpesh dhe aq qartë, e diskutojnë dëndur në biseda

joformale. Por asnjëherë deri më sot kjo çështje nuk është shtruar dhe nuk është diskutuar me kujdes, në mënyrë të paanshme dhe argumentim të qëndrueshëm. Përkundrazi, çështja është lënë në dorë të gazetarëve, ose të disa publicistëve të gjuhës dhe të letërsisë. Më anë tjetër, në Kosovë, bëhet gjithnjë e më e pranueshme ideja se integrimi kulturor, gjuhësor, letrar etj. është pothuajse i pamundur, sepse Shqipëria, kryesisht për shkak të gjuhës, tregohet refuzuese ndaj Kosovës. Natyrisht që kjo situatë kaq kundërshtuese kërkon një analizë të themeltë dhe shteruese, profesionale, gjuhësore dhe letrare njëkohësisht. Kësaj radhe mjafton të themi se problemi i gjuhës, sa është real, po aq paraqitet i simplifikuar. Nuk duhet mohuar se një numër shkrimtarësh të Kosovës kanë probleme serioze me gjuhën, por ata nuk janë shkrimtarë përfaqësues; se të tillë shkrimtarë që nuk kanë ndjeshmëri të mjaftueshme për gjuhën ka në secilën letërsi, përfshirë edhe letërsinë që bëhet në Shqipëri. Megjithatë, këtu ekziston një dallim. Nuk do mend, gjuha standarde në Shqipëri, edhe në përdorim letrar, e ka arritur një *nivel standard* të përdorimit, kështu që në këtë pikë edhe shkrimtarët e dobët paraqitën jashtësisht të pranueshëm. Në brendi kjo është gjuhë e kooperativizuar, gjuhë e realizmit, madje e realizmit socialist, pa depërtime abstrakte. Pikërisht *standardi i kooperativizuar*, që aplikohet gjerësisht në Shqipëri dhe që konsiderohet si kriter për komunikim standard, bën që të bjerë shkalla e fleksibilitetit, respektivisht bëhet kriter për refuzim të përmbajtjeve, të cilat mund të jenë më depërtuese në abstragimet filozofike dhe meditative. Duhet ta pranojmë se një pjesë e letërsisë së Kosovës asnjëherë nuk do të lexohet më ëndje në Shqipëri, ndonjëherë për shkak se nuk e ka arritur standardin e gjuhës së komunikimit letrar, herë të tjera për shkak se është një prurje letrare që del jashtë konceptit të thjeshtëzuar të letërsisë së realizmit socialist, i cili në disa segmente

brendaletrare vazhdon të mbahet ende në Shqipëri, edhe pas rënies së komunizmit.

Edhe përkundër të gjitha refuzimeve, në raportet letrare-kulturore të Shqipërisë me Kosovën ekzistojnë disa situata gjuhësore, të cilat janë tejkaluar lehtësisht, kur në këto marrëdhënie kanë ekzistuar disa interesa mbigjuhësore, t'i quajmë kushtimisht. Ta zëmë, për shkak të interesave të tregut të librit, shtëpitë botuese të Shqipërisë kanë filluar të botojnë gjithnjë e më intensivisht librin nga Kosova, qoftë letërsi, publicistikë, apo edhe ndonjë fushë tjetër. Pak më larg se ky pragmatizëm kanë shkuar përkthimet dhe kritika letrare. Është e ditur se në vitet '70 dhe '80 në Kosovë u bë përkthimi në shqip, kryesisht nga serbokroatishtja, i letërsisë botërore bashkëkohore, vepra dhe autorë që në Shqipëri nuk ishin të lejuar nga sistemi. Këto përkthime në shqip nuk ishin përkthime-model, madje shpesh nuk i plotësonin kriteret elementare të përkthimit letrar. Mirëpo, pas viteve '90, kjo letërsi e përkthyer në Kosovë u bë shumë e preferuar ndër përkthyesit e Shqipërisë, të cilët vënin pranë origjinalit botimin e Kosovës dhe nxirnin si të përkthyerë rishtas vepra autorësh të ndryshëm, që në të vërtetë nuk ishin gjë tjetër, përpos përkthimet e Kosovës me një redakturë më të kujdesshme gjuhësore. Po kaq të preferuar në Shqipëri u bënë librat e kritikës dhe të studimeve letrare. Në të vërtetë, në Kosovë, që në vitet e hershme kishte ndodhur një huajtje ose përshtatje metodash bashkëkohore të kritikës dhe të studimeve letrare. Teknologjia e kësaj përshtatjeje ishte dhe vazhdon të jetë relativisht e thjeshtë: merret një autor i shkollës së avancuar të studimeve tekstore, pavarësisht si e ka emrin, Bart, Zhenet, Todorov, Çomski apo Jakobson dhe metodologjia e tij transplantohet në një tekst origjinal, pavarësisht cili është ai, i traditës ose i letërsisë

bashkëkohore dhe pavarësisht nëse teksti letrar, me mungesat ose vlerat artistike e përballon një analizë të këtillë. Kjo mënyrë e studimit të letërsisë u bë shumë e përhapur në Kosovë dhe, së këndejmi, jo si metodë, sepse këtu nuk ka metodë por vetëm si teknikë, u bart edhe në Shqipëri, qoftë përmes studimeve të autorëve kosovarë, qoftë përmes përkthimeve që gjithashtu, në shumicën e rasteve, u bënë po ashtu nga kosovarët. Në të dy rastet, për shkak se utilitarizmi qëndron mbi paragjykimet, gjuha e autorëve kosovarë nuk paraqet problem për recipientin e Shqipërisë.

Pra, thënë me një fjalë, një integrim i tërësishëm letrar, artistik, ose përgjithësisht kulturor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë as që do të ndodhë ndonjëherë, sepse rrugët e ndryshme nëpër të cilat kanë ardhur deri në ditët e sotme të dy krahët e letërsisë dhe të kulturës sonë, do të ruajnë edhe më tej dallime dhe veçanti. Këto kundërthënie bëjnë pjesë sa në rrafshin e komunikimit, po aq edhe në formacionet letrare-artistike. Fakti se këto dy pjesë të letërsisë shqipe janë zhvilluar në rrethana të ndryshme historike, shoqërore dhe politike, shpesh me pengesa të mëdha në komunikim të ndërvetshëm, ka nxjerrë si rezultat konsolidimin e *dy përvojave letrare dhe kulturore*. Pra, bëhet fjalë për një letërsi, për një kulturë, por për dy përvoja. Studimi dhe theksimi i këtyre dallimeve nuk çon te një çintegrim i ri, siç pandehet ndonjëherë; përkundrazi, letërsinë shqipe dhe kulturën shqiptare e bëjnë më normale, më të afrueshme me lexuesin e saj të krejt hapësirës shqiptare.

Kosovarizmi kulturor

Pas vitit 1999 proceset e integrimi shqiptare, përfshirë edhe integrimet kulturore, nuk shkuan ashtu siç mund të ishin menduar nga idealistët. Dështimet ishin të dyanshme, si nga Kosova, ashtu edhe nga Shqipëria. Në deklaratat asgjë nuk mungonte, çdo gjë ishte në vendin e vet. Midis Kosovës dhe Shqipërisë nuk kishte kufi real, një kufi që do të krijonte pengesa për qarkullim dhe lëvizje të lirë. Por ekziston një kufi i brendshëm, një *ndarje kuazipolitike*, që në të vërtetë është ndarje kulturore dhe, bashkë me këtë, kap edhe ndonjë segment tjetër të jetës reale. Lidhjet kulturore të Kosovës me Shqipërinë kishin filluar shumë kohë para se të zhvilloheshin ngjarjet politike me parashenjë integruese ose përbashkuese dhe, çuditërisht, mbeten në një shkallë të pazhvilluar, pavarësisht nga rrethanat e reja politike që u krijuan. Madje, duket sikur tani gjërat janë më keq se dikur, sepse nuk ka më idealizëm, nuk ka më shtirje, ka rrethana reale dhe ballafaqim të pakëndshëm me dështimet dhe prirjet negative në të dy anët. Ato që mund të quheshin dallime brendashqiptare në përbërësit etnopsikologjikë, ose lëvizje, luhate apo anime nga boshti i identitetit, pothuajse tërësisht kaluan në planin kulturor.

Pas luftës së vitit 1999, Kosova dhe Shqipëria u gjenden përballë njëra-tjetrës pa pengesa reale për integrim kulturor, por disi të frikësuar se mund të prishin diçka hipotetike brenda njëra-tjetrës. Në të vërtetë, ishte inercia e ndarjes së kahershme, e cila tani sikur ishte kthyer në *idil të ndarjes*, pra në një akomodim të rehatshëm brenda ngushtësisë dhe vogëlsisë së vet. Pengesa e parë ishte Kosova e prapambetur në pikëpamje kulturore. Shqipëria kishte mungesa të mëdha në punë të kulturës, kishte probleme ideore dhe ideologjike, probleme institucionale, probleme të transicionit. Por

Kosova ishte edhe më keq. Për shkak të rrethanave të njohura, ajo kishte trashëguar një prapambetje kulturore, injorancë dhe akulturim. Hovi kulturor dhe emancipues i gjysmës së dytë të shekullit XX ishte ndërprerë disa herë, kishte përjetuar rënie dhe ngritje, varësisht nga zhvillimet politike. Ngecjen më të madhe ia shkaktoi deinstitutionalizimi i viteve '90, i cili vinte pas një dhjetëvjeçari pararendës të ndalimeve të mëdha në kulturën shqiptare, pas vitit 1981. Më anë tjetër, pas luftës së fundit, për shkak të mungesës së një programi kulturor kombëtar, por më shumë për shkak se bashkësia ndërkombëtare që u vendos në Kosovë pati një koncept rrënues ndaj kulturës shqiptare si burim i nacionalizmit dhe, në përballjen e dy kulturave, asaj serbe dhe shqiptare, i dha përparësi kulturës serbe; pra, për shkak të këtyre rrethanave Kosova dështoi të ndërmernte një lëvizje për emancipim kulturor. Po të zhvillohej një lëvizje e tillë, Kosova edhe mund të zgjidhte nëse do të mbetej ose jo e varur nga Shqipëria në pikëpamje kulturore, në do të ndërtonte partneritet me Shqipërinë, ose do të merrte rrugën e pashkelur të krijimit të një identiteti të mëvetësishëm kulturor.

Por çfarë ndodhi në të vërtetë? Kosova, e cila pothuajse gjithnjë kishte pasur një zhvillim kulturor më të ngadalshëm dhe në disa fusha ishte sjellë si e varur nga Shqipëria, me t'u gjetur në situatën e ëndërruar prej kohësh, pra pa kufij dhe pa kufizime, tani e preokupuar më shumë me të tjera joshje, humbi idealizmin e dikurshëm dhe kërkoi të zhvillonte marrëdhënie mbi bazat e partneritetit dhe ndërsjellshmërisë. Kush?! Kosova, pra, ajo që, një herë e një kohë, çdo gjë të Shqipërisë e donte më shumë se veten e saj. Në këtë sjellje të Kosovës kishte pak mburrje dhe pak krekosje, kishte edhe ndoca arrogancë dhe pafytyrësi, sikundër që, më anë tjetër, nga Shqipëria gjithnjë e më shpesh vinin mesazhe

paternalizmi, injorimi dhe mospërfilljeje. Realisht, Kosova e sapodalë nga lufta dhe nga një zhbërje e gjatë institucionale, nuk kishte aq shumë çfarë të ofronte në një marrëdhënie reciprociteti. Edhe Shqipëria, po të mos ishte e prirë për refuzim, mund të zhvillonte një numër projektesh me synim emancipimin kulturor të Kosovës, ose, që të mos dukej një ofertë ofenduese, mund të ndihmonte ribërjen institucionale. Ndodhi e kundërta. Që të dyja palët u pozicionuan keq.

Administratës ndërkombëtare të instaluar në Kosovë kjo situatë kulturore ndërshqiptare iu duk e favorshme, për t'i orientuar proceset kulturore të Kosovës në një drejtim tjetër, andej nga supozohej se nuk do të përballej jo më me nacionalizmin e frikshëm ballkanik, por as me kulturë nacionale të integruar. Ajo e dinte se një lëvizje kulturore me përqendrim gjithëshqiptar në Kosovë; një lëvizje kulturore që do ta nxirrte Kosovën nga provincializmi kulturor; një lëvizje kulturore që do të zhvillohej si proces normal i integritetit, ashtu siç ndodhë zakonisht, do t'i paraprinte një procesi të mëvonshëm politik. Prandaj ajo u ngut të bënte në Kosovë institucione kulturore jo profesionale, institucione sa më pak kulturore dhe sa më shumë administrative, pra menaxheriale, në mënyrë që interesat dhe joshjet materiale dhe financiare të mbisundonin interesat krijuese. Vetë pjesëtarët e komuniteti kulturor të Kosovës e ndihmuan këtë situatë, sepse me të shpejtë u bënë ca ngarendas të çoroditur pas favoreve që krijonte kjo mënyrë e organizimit kulturor.

Ndërkohë, po kjo administratë ndërkombëtare, pasi e tejkaloi me sukses fazën e emergjencës kulturore pa bërë asgjë, ose duke krijuar më shumë konfuzion kulturor, në çastin e përshtatshëm të zbrazësisë së madhe kulturore të Kosovës, hodhi në veprim kontingjentet e të ashtuquajturve *krijues multietnikë*, tashmë të përgatitur përmes programeve të joshjes dhe të shpërblimit, që nuk janë as krijues, që nuk

janë as protagonistë kulturorë, por thjeshtë mercenarë, parangrënës të tmerrshëm, me energji të madhe negative, të cilët ngarendin poshtë e lart Kosovës, nuhasin paranë e donatorëve, sajojnë projekte që, në esencë, duhet të *denacionalizojnë* kulturën e Kosovës, ta bëjnë atë një kulturë pa identitet, pa vlera, kulturë multietnike, ose kulturë të riintegruar në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Tashmë të tillët kanë filluar të identifikohen qartë në hapësirën kulturore të Kosovës, sepse të qëndruarit në anonimitet ose në prapaskenë nuk sponsorizohet më.

Nga kjo lëvizje kulturore e sponsorizuar janë shfaqur së pari edhe të ashtuquajturit sajues të identiteti kosovar. Po ta shikosh mirë përkatësinë e tyre shoqërore, nuk është vështirë të vërehet se të tillët janë kryesisht trashëgimtarë botëkuptimorë (ndonjëherë edhe biologjikë) të vijës jugosllave në politikën dhe kulturën e Kosovës. Ithtarët dhe mbështetësit e identitetit kulturor kosovar në radhë të parë kanë synim zhvendosjen e drejtimit të integritetit të Kosovës nga jugu në veri, nga Shqipëria në drejtim të Serbisë, një rrugë për mendjen e tyre më e shkurtër për në Europë. Dhe më dobiprurëse. Në të vërtetë, kjo lëvizje e sponsorizuar do të ketë jetë të shkurtër dhe do të reshtë së funksionuari po atë çast që do të shterën fondet e donatorëve. Suksesi i tyre më i madh, nëse e kërkojnë një të tillë, është ndihma e madhe që i kanë dhënë çintegritetit kulturor shqiptar, i cili edhe ashtu funksiononte me vështirësi. Në këtë sinkopë kohore ata gjetën hapësirën e përshtatshme për t'u promovuar, për të tërhequr vëmendjen, për t'u faktorizuar, për t'u bërë *një gjë nga një asgjë*.

Vetëm se në këtë çrregullim kulturor dhe identitar të Kosovës, përveç kosovarit përfitues që mëton të jetë bartës i këtij procesi, nuk duhet lënë në harresë edhe kosovarin krenar, i pakompromis, ndonjëherë kryengritës, madje

kokëshkretë, i cili në një proces të gjatë të vartësisë nga të tjerët dhe të përballjes së vazhdueshme me nënçmimin, me kohë e ka ndërtuar refuzimin si mënyrë e mbrojtjes së identitetit të tij, që në të vërtetë është pjesë e mënyrës së tij gati instiktive e ruajtjes së pacenueshmërisë së hapësirës së tij jetësore. Kjo vetëdije, e rishfaqur në formë recidiviste nga periodha e refuzimit shumëplanësh të Serbisë, nuk do mend se është pak e egër dhe e papërshtatshme si sjellje në raportet e tjera kulturore dhe politike, por, sikundër mund të vërejmë, është një *lëvizje refuzuese*, e cila nga politika, pak nga pak, mund të kalojë edhe në fushat e tjera të jetës. Lëvizja refuzuese ndaj çrregullimit kulturor do të kishte tjetër konotacion nga refuzimi i tashëm, i cili, ndër të tjera, ndonjëherë manifestohet edhe si rebelim gati instiktiv kundrejt paternalizmit kulturor të Shqipërisë së pavëmendshme. Megjithatë, identiteti në tërësinë e tij nuk krijohet mbi parametra negativë; ndërtohet mbi vlera, të cilat duhet të krijohen para se të mbrohen.

Sido që të jetë, kosovarët tashmë e kanë kuptuar se nuk kanë alternativë tjetër, përveç se të përfshihen në lëvizje kulturore gjithëshqiptare, sepse hapësira e tyre kulturore është tepër e kufizuar, potenciali i tyre kulturor është tepër i kufizuar, alternativat e tjera kulturore i kanë tepër të kufizuara. Zbrazësitë e krijuara për shkak të rrethanave të përmendura më sipër tani janë duke u mbushur me improvizime dhe sajesa krejtësisht afatshkurtra. Pjesa me vlerë e letërsisë së Kosovës synon të integrohet me të Shqipërisë, me botime, me organizim letrar, me vlerësime, me lexues, me të gjitha. Letërsia kosovare pothuajse nuk ekziston më, as si traditë e ndarë, as si përvojë shkrimi. Disa studiues të saj janë përpjekur të improvizojnë një të ashtuquajtur *qark letrar të Prishtinës*, por as ata nuk e kanë të qartë se kush mund të futet brenda tij, cilat veçanti e

diferencojnë dhe cilën përvojë letrare e kultivojnë shkrimtarët përfaqësues. Nëse dikur ka ekzistuar një letërsi e Kosovës, si përvojë e ndarë në kuadër të letërsisë shqipe, tani kjo përvojë shkon drejtë unifikimit, sepse, së pari, kanë pushuar rrethanat e jashtme që e kanë kushtëzuar ekzistimin e saj; së dyti, përvoja gjuhësore, e tillë çfarë ishte, e krijuar në periudhën e autonomisë, është tretur nën mbishtresimet e tjera; dhe, së treti, nuk kultivohet më ndonjë tërësi përmbajtësore e diferencuar, e ndërtuar përmes referencave metaforike, abstragimeve, aluzioneve, tërthorësive etj. Po kjo mund të thuhet edhe për artet e tjera: ekzistojnë individë krijues që përpiqen të funksionojnë në një ambient të vështirë kulturor, por nuk ekzistojnë shkaqet që do t'i bënin ata të konstituonin një përbashkësi të ndarë. Abstraksioni si mundësi e shpëtimit nga kufizimet ndëshkuese, si azil ku nuk depërtonin kufizimet politike dhe ideologjike, tani paraqitet i panevojshëm. Në rrethana të reja, abstraksioni duhet të njohë depërtime të reja në fushën e mendimit. Po kjo vlen edhe për të shprehurit metaforik. Korpusi i simboleve të rezistencës dhe të lirisë, i tillë çfarë ishte përdorur dikur, është jofunksional dhe tani duhet të zhvendoset nga një rreth kuptimor në tjetrin, nga plani lokal në atë universal, nga plani real në atë metafizik. Paralelizmat historike, të cilat dikur u përdorën gjerësisht për të krijuar kontekstin aktual të rrëfimit, nuk i shërbejnë më askujt. Vetë *Kosova nuk është më metaforë*, nuk është as simbol. Është një vend real, ku funksionojnë parametra realë të kuptimeve të bartura ose të drejtpërdrejta.

Në të vërtetë, problemi i Kosovës me letërsinë dhe artet nuk qëndron më në krijimin e ndonjë *veçantie identitare*. Është interesant se ithtarët e kosovarizmit idetë e tyre i ndërtojnë mbi një parim kontradiktor: në njërin anë janë shumë të zëshëm, madje të zhurmshëm në diferencimin

identitar me Shqipërinë edhe përmes kulturës dhe arteve, ndërkohë që janë shumë luajalë ndaj integriteteve të tjera, të krahut të kundërt, qofshin këto edhe integritete rajonale, ose rrugë gjoja më të përshtatshme për integritete europiane. Mbrojtës të *kosovarizmit kulturor* paraqiten edhe provincialët, të cilët për një kohë jetuan mirë me iluzionin e krijuesve të mëdhenj në hapësirë të vogël. Ata nuk e duan ose i frikësohen konkurrencës së hapësirës së përbashkët kulturor shqiptar. Në ngushtësinë e hapësirës kulturor ata gjejnë kompensim për mungesat e veta, por njëkohësisht i realizojnë disa privilegje. (Braktisja e parimeve përmes privilegjeve është sprovuar edhe më parë. Ta zëmë, pas vitit 1981, nga programet mësimore të shkollave në Kosovë u kërkua të hiqeshin të ashtuquajturat përmbajtje nacionaliste, ku, përveç shkrimtarëve të Shqipërisë, përfshiheshin edhe disa krijime të shkrimtarëve të Rilindjes. Që të mbështeteshin këto ndryshime edhe nga shkrimtarët, pushteti përdori një taktikë djallëzore, por naive: futi në programet mësimore shumë përmbajtje të reja të shkrimtarëve të Kosovës. Një numër syresh, kur e panë se fushata antishqiptare mund t'iu sillte privilegje, i pranuan në heshtje programet e reja të letërsisë.)

Pra, kultura dhe artet në Kosovë, me rrjedhën e tyre të natyrshme shkojnë drejt krijimit të një hapësire të përbashkët kulturor shqiptar, si treg unik kulturor. Kundër këtij procesi janë ithtarët e kosovarizmit kulturor, të cilët janë duke ndihmuar në të gjitha mënyrat që Kosova të vuajë një çrregullim të madh kulturor. Në emër të veçantive kulturor të Kosovës, ata synojnë zhbërjen e njësisë kulturor kombëtare. Paradoksalisht ata mbështesin krijimin e tregjeve unike të hapësirave më të gjera rajonale dhe europiane, ndërkohë që janë kundër tregut unik kulturor shqiptar. Kultura e Kosovës tashmë ka filluar ta

vuajë ngushtësinë e tregut të saj. Më anë tjetër, për shkak të mungesave në emancipim, për shkak të mungesës së traditës, por edhe për shkak të përmbajtjeve të papërshtatshme kulturore dhe zërave disonantë, recipienti i Kosovës nga një *recipient i munguar* gradualisht po kthehet në *recipient refuzues*. Po kaq të dëmshme për kulturën e Kosovës kanë qenë ndërhyrjet e fondacioneve të jashtme, të cilat, më një anë, kulturën e Kosovës e kanë perceptuar vetëm si trashëgimi historike ose etnografike, pra si një relikte muzeore dhe jo si një veprimtari aktive, dinamike. Më anë tjetër, janë pikërisht këto fondacione që tashmë janë duke e shtyrë pothuajse dhunshëm kulturën e Kosovës drejt hapësirës së rikrijuar kulturore jugosllave, ku ajo nuk e ka pasur vendin as atëherë kur Jugosllavia ishte shtet i vërtetë.

PJESA III

IDENTITETI POLITIK

PENDESA E THELLË E NDËRHJRJES

Rrethanat dhe konteksti

A kishte një rend dhe një logjikë gjërash në hapjen e çështjes së identitetit kosovar? Cili ishte momenti politik i hapjes së kësaj çështjeje dhe si ndodhi që një dilemë e refuzuar në mënyrë kategorike, megjithatë, të gjejë hapësirë në shqyrtimet mediale? Ku e gjente mbështetjen? Te cilët njerëz, te cila proveniencë intelektuale, te cila shtresë e shoqërisë? Kush ishin sponsorët e saj? Kush e donte identitetin pa shtet dhe kush e donte shtetin pa identitet? A ishte bërë Kosova shtet përmes një identiteti të konsoliduar kombëtar, apo duhej të ndodhte e kundërta, që Kosova të konsolidohej si shtet, së pari duhej të bënte kombin e saj? Pse identiteti kosovar u bë çështje politike dhe diskutimi nuk mbeti në nivele akademike? Pra, a bëhet fjalë për një identitet politik, me urgjencë politike, me reflektime politike, apo bëhet fjalë për një trashëgimi historike të lënë në heshtje, të injoruar, të ndrydhur? A është identiteti kosovar në të njëjtën kohë mburojë kundër nacionalizmit shqiptar, kundër primitivizmit nacionalist në përgjithësi, apo më shumë një shpikje identitare pa referencë të qartë, një prodhim hibrid i shoqërisë civile me parashenjë anacionale? A ka bazë historike kombi kosovar? Kujt i shërben ai më shumë, shtetasve të Kosovës, integralistëve shqiptarë, apo provincialistëve? Bashkësisë ndërkombëtare apo Serbisë? A ka histori identiteti kosovar? A ka Kosova potencial vlerash

që të bëjë komb? A mund të ndërtohet kombi mbi postulatet e refuzimit dhe të mohimit? Pse ka asimetri në parime? Në të vërtetë, kombi dhe identiteti kosovar a është spekulim medial apo një situatë reale?

Në të gjitha këto pyetje do të jetë vështirë të përgjigjemi, nëse nuk bëjmë një analizë të rrethanave, të cilat çuan deri te një zgjidhje e këtillë e çështjes së Kosovës, zgjidhje e cila, për shqiptarët dhe për një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare mund të quhet optimale, por assesi ideale. Në të vërtetë, idealja në politikë nuk ekziston, sepse ajo, si art i së mundshmes, gjithmonë prodhon kompromise më shumë ose më pak të dhimbshme, varësisht se nga kush vështrohet dhe varësisht si perceptohet. Në rastin e Kosovës, nëse situatën e shikojmë nga këndvështrimi pararendës, pra i gjendjes para vitit 1999, zgjidhja na del të jetë në kufijtë e një mrekullie, pra një idealitet, sepse nga gjendja ku ishte, nga pozita ku ishte, nga kufijtë e zhbërjes, Kosova u zhvendos në kufijtë e optimalet, të asaj që mund të quhet zgjidhje e pranueshme ose relativisht e kënaqshme. Por, në këtë e sipër, nuk duhet lënë mënjanë faktin se Kosova një pjesë të historisë së saj më të re, përveç mbijetesës, ia dedikon edhe idealizmës, që domethënë se përjashtimi i idealeve tangentonte Kosovën në pikat e saj më të ndjeshme.

Kosova për shqiptarët nuk ishte mit dhe histori e vagullt, siç ishte për serbët. Ajo ishte ëndërr për liri, për jetë të dinjitetshme. Ajo ishte ideal i njeriut tokësor, që kërkonte zgjidhje të tilla, të cilat duhej të supozonin një kthesë në histori, jo për shkak të historisë dhe të gjedhes së saj, por për shkak të jetës së njerëzve. Bota tashmë e dinte se shqiptarët në tërësi, e aq më pak shqiptarët e Kosovës, nuk kishin qenë në gjendje të përcaktonin vetë rrjedhën e ngjarje gjatë historisë, por në masë të madhe ishin varur nga raporti i forcave në një kontekst më të gjerë. Vetë shqiptarët ishin të

bindur se në kthesat e mëdha të ngjarjeve nga Kongresi i Berlinit e prapa, Europa e krishterë ua kishte bërë me të padrejtë, shpesh duke sakrifikuar ekzistencën e tyre për zgjidhje politike në dobi të fqinjëve agresivë, hakmarrës dhe gjakpirës. Një pjesë e botës ishte në dijeni të kësaj historie, por pjesa më e madhe e saj nuk e kishte mendjen as te historia dhe as te ëndrrat e shqiptarëve. Ata, pra bashkësia ndërkombëtare dhe fuqitë vendimmarrëse, papritmas u gjetën përpara një fakti tragjik, se në Europën e vlerave civilizuese, brenda një periudhe të shkurtër kohore, mund të zinte vend, madje edhe të përsëritej, ideja e zhbërjes së popujve, si në rastin Bosnjës, ashtu edhe të Kosovës. Për të qenë situata edhe më lënduese, në të dy rastet bëhej fjalë për popullsi myslimane dhe indiferenca e botës perëndimore mund të interpretohej si miratim i heshtur i një gjenocidi mbi këtë popullsi.

Në të vërtetë, sikundër u vërejt, Perëndimi nuk ishte unik në këtë qëndrim. Një pjesë e opinionit publik brenda këtyre shteteve ruante traditën e vjetër të Europës konservatore, e cila një segment të identitetit të saj e tërhiqte nga bëmat e kalorësve të kryqëzatave dhe të historive mesjetare me “luftëra të shenjta” kundër botës lindore. Të qenit myslimanë e kosovarëve dhe të qenit të krishterë e serbëve, njësoj si në rastin e Bosnjës, për një pjesë të opinionit në Perëndim, që paraprakisht e kishte të zgjidhur anën e mbështetjes. Vetëm se brutaliteti serb kishte kaluar masën. Ishte një arrogancë, e cila sfidonte të gjitha parimet morale të një bote të civilizuar. Më anë tjetër, ndikimi amerikan dhe depërtimi i filozofisë së re të një bote të lirë, e kishte fuqizuar ndjeshëm frymën *reformatore* në mbarë Europën tradicionale. Tani veprimi duhej bërë, popullsinë civile duhej shpëtuar, rasti i Bosnjës nuk duhej të përsëritej. Natyrisht, kjo nuk nënkuptonte asnjë zgjidhje politike, ose

thënë më qartë, ndërhyrja bëhej për arsye humanitare dhe jo për t'i dhënë zgjidhje politike një problemi. Kosova duhej të gjente zgjidhje politike, të tillë që nuk do të ishte e përcaktuar nga ndërhyrja, por e tillë që do të pamundësonte përsëritjen e situatave të ngjashme në një të ardhme. Neutraliteti politik i ndërhyrjes ishte i padiskutueshëm, që, në një mënyrë, nënkuptonte se statusi i Kosovës jo vetëm që nuk zgjidhej me këtë ndërhyrje, por as nuk përcaktohej në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shikuar nga këndvështrimi i Kosovës, pavarësisht nga dilemat morale, fetare, civilizuese, ushtarake dhe politike të Perëndimit, shqiptarët u gjetën të kënaqur me ndërhyrjen e vitit 1999. Ata manifestuan një mbështetje të jashtëzakonshme për të gjitha veprimet e komunitetit ndërkombëtar. Kosovarët mbështeten aksionet e NATO-s edhe atëherë kur në ato aksione gabimisht u vranë familjarët e tyre. Ata vajtonin të vrarët nga këto gabime dhe në të njëjtën kohë luteshin që aksionet të vazhdonin. Kosovarët mbështeten pa rezervë edhe të gjitha veprimet e bashkësisë ndërkombëtare pas ndërhyrjes së NATO-s, përfshirë edhe administrimin e OKB-së. Ishte një besim pa kushte, i cili nuk u vu në dyshim për asnjë çast. Nuk u shpreh rezervë, aq më pak u kontestua, cilido veprim i qendrave vendimmarrëse. Kosovarët nuk i pëlqyen disa gjëra, të cilat ndodhën shpejt, pa dëshirën e tyre, por nuk patën sesnin e reagimit në një rrethanë të entuziazmit në njërin anë, dhe të konfuzionit të madh, në anën tjetër. Ta zëmë, ata nuk mund ta pëlqenin vendosjen e trupave ruse në Kosovë, ose një ndarje, çfarë ndodhi, e zonave ushtarake të KFOR-it, por ata nuk u pyetën ndonjëherë, ndërkohë që tashmë e kishin humbur orientimin politik, kishin humbur sensin e reagimit, për të kundërshtuar cilindo veprim të bashkësisë ndërkombëtare. Kosovarët ishin viktimë dhe çdo veprim i tyre duhej të sillej

në këto suaza. Ata ishin objekt i ndërhyrjes humanitare, duhej të merrnin pamje të përvuajtur, ndërkohë që politikisht kishin pak gjasa të bënin një zë që mund të dëgjohej. Më anë tjetër, ashtu siç ndodhë zakonisht në rrethana të tilla, ata ishin jashtëzakonisht të përçarë politikisht, madje deri në atë shkallë, sa të rrezikonin një luftë civile përmasash të frikshme.

Mungesa e strategjisë

Pra, në kontekstin e zhvillimeve pozitive të vitit 1999, ishte e pritshme që, pas vuajtjeve me rrezik zhbërjeje, Kosova mund të ëndërronte një *zgjidhje ideale*, sepse angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare kishte qenë i paprecedent, i veçantë, planetar, i papërsëritshëm. Një pranverë të tërë, bota ishte zgjuar dhe ishte ngrysur me lajmet për Kosovën. Një depërtim të tillë politik dhe medial Kosova as që kishte mundur ta ëndërronte. Por ajo që ëndërronte tani Kosova, ishte një zgjidhje politike pozitive, e favorshme, e cila doemos që duhej t'i përshtatej dhe të ishte ekuivalente me nivelin e këtyllë të angazhimit ndërkombëtar. Nuk mund të ishte një zgjidhje politike zhgënjyese, sepse një zgjidhje e tillë do të ishte në disharmoni me këtë angazhim. Kosovarët kishin arsye të besonin se angazhimi model i bashkësisë ndërkombëtare, për të sanuar situatën emergjente, do të sillte si rrjedhojë logjike një zgjidhje politike gjithashtu model. Fundja, Kosova kishte bërë një luftë dhe sado të paqarta të ishin të arriturat e saj në fushëbetëje, në rrethanat e zgjidhjeve politike të pafavorshme, ajo përsëri mund ta kthente situatën në fillimet e një konflikti të ri.

Shumë herë e kam pyetur veten: Cilat zgjidhje politike i mendonin kosovarët në ato ditët e para të mrekullueshme të lirisë, ndërsa ktheheshim të ngazëllyer në Kosovë? A kanë menduar gjë dhe çfarë kanë menduar? Si e kanë përfytyruar ata Kosovën e viteve të ardhshme? Pse ndodhi zhgënjimi dhe kur ëndrrat filluan t'ia linin vendin një realiteti të vrazhdët? A kishin kosovarët një vizion politik pas 12 qershorit 1999? Kur filloi të komprometohet çështja e Kosovës në sytë e botës? Pse ndodhi komprometimi? Pyetje të këtilla mund të ketë bërë secili prej nesh në vitet që pasuan ndërhyrjen e madhe ndërkombëtare, por gjithsesi të paktë kanë qenë ata që janë preokupuar me këto çështje që në ditët e para të asaj vere të jashtëzakonshme, e cila erdh pas dëbimit të Serbisë nga Kosova. Ato ditë Kosova kishte shumë emocione dhe pak racionalitet. Kishte shumë emergjence dhe krejt pak komoditet politik, për ta analizuar gjendjen e saj, pas një shkundullime të këtillë. Kishte të vrarët dhe të zhdukurit dhe të humburit, kishte rindërtimin e domosdoshëm për një dimër të ashpër që do të vinte shumë shpejt. Por ishin emergjente edhe vjedhjet dhe uzurpimet, të cilat duheshin bërë sa më shpejt, përpara se në Kosovë të vendosej rendi dhe ligji. Po kaq të ngutshme Kosova i kishte edhe hakmarrjet e vogla dhe të mëdha, ndaj serbëve dhe ndaj vetë shqiptarëve, sepse situata pas një lufte nuk mund të kalonte pa tronditje të kësaj natyre.

Të ndërtoje një vizion të qartë politik për të ardhmen e Kosovës në rrethana të këtilla, ishte pothuajse e pamundur. Situatë tepër e ngutshme dhe tepër emocionale, tepër e rrëmbyer dhe tepër konfuze. Më anë tjetër, tashmë ekzistonte një agjendë për Kosovën si protektorat ndërkombëtar, e administruar nga OKB dhe me NATO-n si garanci e sigurisë së brendshme dhe të jashtme. Edhe idetë e mëhershme se çfarë mund të ishte Kosova pas kësaj lufte,

pothuajse ishin zhbërë, ishin davaritur, kishin humbur rëndësinë e tyre. Kjo ndodhte edhe për një arsye tjetër, sepse në brendi, në konstalacionin e brendshëm politik të Kosovës gëlonte një mospajtim i thellë midis dy krahëve politikë të armiqësuar së tepërmi gjatë luftës, UÇK-së dhe LDK-së. Askush nuk ia mohonte UÇK-së kontributin e jashtëzakonshëm që kishte dhënë në këtë çështje, sepse ajo, me luftën e saj, me strategjinë e saj, kishte arritur ta vendoste Kosovën në agjendën ushtarake dhe politike të fuqive më të mëdha të botës. Mirëpo, më anë tjetër, në pikëpamje politike, Lidhja Demokratike e Kosovës, ndonëse kishte pësuar goditje pothuajse të pariparueshme, gëzonte një mbështetje substanciale, sepse ajo tashmë kishte marrë atributet e një lëvizjeje politike qytetare gjithëpërfshirëse, e qëndrueshme karshi proveniencës neokomuniste, marksiste-leniniste, revolucionare, që manifestonte UÇK-ja. Ishte e ditur se LDK-ja si strukturë politike kishte dështuar në luftë, ndonëse një pjesë e mbështetësve të saj ishin përfshirë në organizimin luftarak të UÇK-së. Por ajo ruante argumentin e fuqishëm të lëvizjes qytetare të rezistencës paqësore, e cila, edhe përkundër zhvillimeve të pafavorshme për të, gëzonte simpati të brendshme dhe të jashtme, sepse ishte e vetmja mburojë ideore, ideologjike dhe politike kundër *revolucionit politik dhe social*, i cili tashmë ishte përvijuar qartë në strategjinë politike, jopublike, i UÇK-së.

Në të vërtetë, ndërsa LDK-ja kishte bërë të njohur idenë e saj për Kosovën si shtet të pavarur shumë kohë përpara, duke e çuar këtë çështje deri në kundërthënie të papajtueshme ndërmjet idesë dhe realizimit, UÇK-ja nuk kishte bërë publike ndonjë strategji të saj për Kosovën e pasluftës. Gjatë ditëve të bombardimeve të NATO-s, ndonjëri nga liderët e saj mund të kishte bërë ndonjë prononcim skandaloz për qëllimet

përfundimtare të luftës së Kosovës për bashkim me Shqipërinë, por tërheqja kishte qenë e menjëhershme, sepse reagimi i faktorit ndërkombëtar kishte qenë shumë i prerë, refuzues dhe kërcënues njëkohësisht. Pas këtij rasti, UÇK-ja u tërhoq në heshtje dhe në periudhën vijuese nuk adaptoi ndonjë strategji për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës. Një strategji dalëse nuk e kishte as bashkësia ndërkombëtare. Të gjithë e dinin se administrimi ndërkombëtar, sado që të zgjaste, kishte një limit kohor. Kosova duhej të merrte një *zgjidhje*, sepse administrimi ndërkombëtar nuk ishte *zgjidhje*, as e përkohshme, as përfundimtare. Administrimi ndërkombëtar ishte një qëndrim pezull, një *status quo*, një intermexo, një hapësirë e përshtatshme për të filluar ndërmarrjen e komplikuar të zgjidhjes së statusit përfundimtar.

Misioni i shëmtuar i OKB-së

Çështja që duhet diskutuar tani ka të bëjë me hipotezën, nëse kosovarët mund të përpunonin një strategji pararendëse për zgjidhjen e drejtë të statusit të Kosovës, pas ndërhyrjes së NATO-s më 1999. Në këtë hapësirë shqyrtimi paraqitet parësor fakti se Kosova nuk bëri *luftë fitimtare*, pra nuk e fitoi luftën dhe nuk e çliroi Kosovën pa ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare. Një fitore e tillë ushtarake, me territor të lirë të qëndrueshëm dhe me aftësi për të mbrojtur atë territor, do t'i jepte të drejtë Kosovës të bëhej faktori kryesor në negociatat që do ta pasonin atë luftë. Mirëpo, kjo nuk kishte ndodhur. Kosova kishte nisur një luftë çlirimtare gati vetëvrasëse, si alternativë e vetme kundrejt pushtimit serb, që ishte bërë i padurueshëm, i papërballueshëm,

gjenocidal. Lufta e saj as te optimistët më të mëdhenj nuk kishte supozuar fitore në fushëbetejë, por një detyrim të Serbisë dhe të bashkësisë ndërkombëtare për t'u futur në një proces negociator dhe për të gjetur zgjidhje politike. Edhe vetë Serbia, ndonëse e përgatitur mirë ushtarakisht, nuk do të mund ta përballonte për një kohë të gjatë një luftë guerile në Kosovë dhe, më vonë, në brendi të territorit të saj. Por, mbi të gjitha, mënyra si ishte sjellë Serbia përgjatë viteve '90 në Kosovë dhe në mbarë hapësirën jugosllave, kishte krijuar argumente të mjaftueshme për stigmatizimin e saj. Më anë tjetër, Kosova shihej si konflikti i fundit në ish-Jugosllavi, të cilin Serbia nuk e zhvillonte për ristrukturim të ish-federatës jugosllave, por tani për ristrukturim të vetë Serbisë. Nëse luftërat në Kroaci dhe Bosnje ishin zhvilluar për Serbinë e madhe, tani në Kosovë lufta bëhej për Serbinë reale. Humbjet në fushëbetejë dhe ndërhyrjet e bashkësisë ndërkombëtare e kishin çuar Serbinë deri në kufijtë e saj kushtetues, e tillë siç kishte qenë në kuadër të federatës jugosllave. Me Kosovën kishte filluar zhbërja e vetë Serbisë dhe prandaj aleatët e saj, në Perëndim dhe në Lindje, u bënë tepër agresivë.

Pra, ishin krijuar të tilla rrethana që Kosova, realisht, nuk do të ishte subjekt relevant në marrëveshjet për të ardhmen e saj. Ajo ishte objekti pasiv, deri-diku mund të ishte edhe subjekt pjesëmarrës, por asnjëherë nuk do të ishte subjekti aktiv vendimmarrës. Ky perceptim nuk do t'i ndahet Kosovës as përpara dhe as pas luftës së vitit 1999. Në procesin e Rambujesë u pa se Kosova nuk kishte pothuajse asgjë, përveç një guerileje gati vetëvrasëse dhe një lëvizje politike pa asnjë koncept. Grumbulli i kosovarëve në Kështjellën e Rambujesë ishte bërë bashkë me një diktat të fuqishëm të aleatëve perëndimorë, për të vendosur balanca ndërmjet rrymave të ndryshme politike. Kosovarët pranuan

marrëveshjen jo të prirë nga ndonjë opsion politik apo nga ndonjë vizion i qartë, por nën trysninë e aleatëve dhe me të vetmen shpresë se Serbia nuk do ta nënshkruante atë marrëveshje. Po në këtë proces kosovarët kishin dëshmuar mungesë uniteti, sikundër edhe paqartësi konceptesh politike dhe mungesën e një vizioni të qartë për Kosovën.

Mungesa e unitetit të kosovarëve ishte një ogur i keq për të ardhmen. Konflikti ndërmjet rrymave politike ishte aq i fuqishëm, sa që në Kosovë, në terren, rrezikonte luftën civile. Me këtë rast bota nuk e pat të vështirë të vërente se kosovarët nuk ishin të gatshëm për shtet, as për pavarësi dhe as për ndonjë zgjidhje tjetër politike, që do të nënkuptonte përjashtimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare. Një elitë e këtillë politike, me ndasi dhe kundërshti të këtilla, mund ta mbante Kosovën në gjendjen e një konflikti të vazhdueshëm, sikundër që mund t'i kthehej edhe Shqipërisë si bumerang, sepse të gjithë e dinin se që andej buronin të gjitha përçarjet dhe mosmarrëveshjet në botën shqiptare. Një elitë e këtillë politike, çfarë e kishte Kosova në Rambuje, herëdokur, do të shkatërronte edhe Maqedoninë. Kjo tashmë ishte një gjë e pritshme.

Supozimi se Shqipëria mund të vendoste një rregull, nëse e merrte nën përkujdesje Kosovën, nuk mund të pranohej as si ide periferike, jo vetëm për shkak se do të prisheshin balancat ballkanike, siç thuhet ndonjëherë, por thjeshtë për shkak të paaftësisë së shqiptarëve për t'i menaxhuar lëvizjet politike brenda vetë mileut të tyre. Më 1997 Shqipëria kishte bërë luftë civile për pushtet, i kishte shkatërruar të gjitha institucionet dhe mbahej në këmbë me një përkujdesje pak të sinqertë dhe pak cinike të bashkësisë ndërkombëtare. Po të nxirrje idenë që Kosova, ta zëmë, e paaftë të qeveriste veten, t'i jepej Shqipërisë nën përkujdesje,

sado hipotetike të ishte kjo mundësi, do të shkaktoje një nënqeshje të faktorit vendimmarrës.

Thënë me një fjalë, shqiptarët ishin gjendur në prag të vendimeve të mëdha politike pa asnjë përgatitje, madje në një si ecje kuturu, e cila nuk dihej se ku mund t'i çonte. E vetmja shpresë e tyre ishte drejtësia qiellore dhe aleatët, të cilët çuditërisht dolën në sipërfaqe për një kohë të shkurtër, të gatshëm të merrnin përgjegjësitë ta menaxhonin një krizë, sa për hesapin e tyre, po aq edhe si akt moral i ndihmës për një popull, i cili tashmë, nëse nuk vihej në rrugë të mbarë, rrezikonte një zhbërje të pashembullt. Nuk është e miradijshme, që në këtë kuadër, të diferencohen shtetet tashmë të identifikuar si aleatë të mëdhenj të shqiptarëve, sepse edhe ato shtete të fuqishme që nuk morën rol prijës, patën ndikim të jashtëzakonshëm, duke mos kundërshtuar vendimet e rëndësishme. Megjithatë, duket se SHBA-ja dhe Britania e Madhe do ta marrin botërisht rolin e *engjëjve mbrojtës* për shqiptarët e pafuqishëm dhe të hutuar politikisht. Mbajtja pas mbështetjes së tyre do t'i çojë kosovarët të zgjidhjet që nënkuptonin garancinë e po atyre që kishin sugjeruar zgjidhjet e tilla. Kosovarët vetëm në një pikë ishin në një mendje: nuk e donin Serbinë dhe, duke mos qenë të gatshëm politikisht të ofronin një zgjidhje për Kosovën, akceptuan referendumin si alternativë përfundimtare.

Kjo ndodhi në Rambuje. Më 12 qershor 1999 askush në Kosovë nuk e dinte sesi do të dukeshin zhvillimet e ardhshme. Madje, shumica nuk e dinin se ç'kuptim kishte protektorati ndërkombëtar i OKB-së, përfshirë këtu edhe subjektet dhe partitë politike, ndonjëra prej të cilave fuqizoi organizimin në terren, për të vendosur kontroll mbi Kosovën pa pushtet. Më vonë u pa se protektorati ndërkombëtar i kishte rregullat e sjelljes si një pushtim, por në vend të një

shteti, të një mbretërie ose të një perandorie, në mbajtjen e gjendjes nën pushtim participonin pothuajse të gjithë shtetet anëtare të OKB-së. Kjo e bënte çështjen shumë të komplikuar në vendimmarrje, më një anë, ndërsa më anë tjetër, sillte në Kosovë përvoja shumë heterogjene në ngritjen e institucioneve dhe vendosjen e rendit demokratik. Në këtë lojë u fut edhe Europa, duke marrë përgjegjësi në disa fusha, siç ishte ekonomia përmes të ashtuquajturës shtyllë IV e UNMIK-ut, ose mediet, organizimin politik dhe demokratizimin përmes OSBE-së. Por, në atë zallamahi botërore përvojat europiane të kolonizimit ose u përshtaten me ato të OKB-së, ose u neutralizuan plotësisht. As prania amerikane në disa segmente, siç ishte mbajtja e vazhdueshme e pozitës së zv/shefit të UNMIK-ut, nuk pat ndonjë domethënie, kaloi pa u vërejtur, ngase iu përshtat rrethanave.

Kosovarët as që kishin idenë se çfarë po ndodhte në të vërtetë. Atyre nuk iu shkonte mendja se vendosja e një administrate prej mijëra njerëzish nënkuptonte, në radhë të parë, zgjatjen disaveqëzore të status quo-së, pra mbajtjen e gjendjes pezull, sepse, tani e tutje, mbajtja e Kosovës në këtë gjendje nuk do vinte vetëm si rezultat i situatës në terren, as vetëm si rezultat i vështirësive politike për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për statusin e saj, por do të varej edhe nga interesat e këtij misioni ndërkombëtar, pra i mafies së OKB-së. Me t'u vendosur në Kosovë, ky mision do të diktojë vetë tempin e zhvillimeve politike, do t'i krijojë vetë të ashtuquajturat zona të rrezikshmërisë së lartë; vetë do t'i mbajë të acaruar raportet me banorët vendas, kur kjo mund t'u shkonte për shtat; do të nxisë situata konflikti ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve; do të hyjë në marrëdhënie me Beogradin, duke anashkuar Prishtinën, të gjitha këto me synim që vetë të bëhet zot i situatës. Ta zëmë, nëse situata politike në Kosovë merrte rrugën e zgjidhjes së

shpejtë politike, misionit të OKB-së nuk i duhej një zgjidhje e tillë, sepse ai kërkonte ta zgjaste kohën e mbetjes në Kosovë. Nëse, bie fjala, situata në Mitrovicën e veriut dhe në komunat bri saj qetësohej dukshëm, duke shpartalluar bandat dhe duke vendosur rendin dhe ligjin, për misionin e OKB-së kjo nuk ishte zgjidhje, jo pse problemi ishte politik, siç shpreheshin ata, por nga se me qetësimin e situatës binte shkalla e rrezikshmërisë së misionit dhe, bashkë me këtë, përgjysmoheshin edhe të ardhurat. Pra, interes i misionit të OKB-së nuk ishte më Kosova, ishte vetë misioni.

Kosova e shumë pamjeve

Marrë në përgjithësi, situatat e krijuara para dhe pas 12 qershorit 1999, të cilat e vendosen Kosovën në qendër të vëmendjes ndërkombëtare, sado që u dukën joshëse dhe përkëdhelëse për sedrën e lënduar kosovare, më anë tjetër, ky përqendrim i vëmendjes dhe kjo dyndje e madhe e botës në një hapësirë prej jo plot njëmbëdhjetë mijë kilometrash katrorë, tërthorazi bënte të ditur se edhe komplikimet rreth statusit të Kosovës do të ishin të përmasave të ngjashme. Një thjeshtësi më e madhe e situatës do t'i ndihmonte Kosovës, që më shpejt të merrte rrugën e zgjidhjes. Kjo nuk ndodhi, sikundër që nuk ndodhi as ndonjë kërkesë për një zgjidhje më të shpejtë nga vetë kosovarët, të cilët, përveç lojalitetit, nuk i ofruan asgjë bashkësisë ndërkombëtare. As kundërshtim, as mosbindje. Strukturat politike kosovare vetëm në një pikë vendosen raporte të partneritetit të vërtetë me ndërkombëtarët: në keqmenaxhimin e resurseve dhe në implikimet mafioze. Në këtë pikë, të dyja palët krijuan lidhje varshmërie me njëra-tjetrën. Kosova shumë shpejt u bë

poligon ndërkombëtar i strukturave të degjeneruara të vjedhjes dhe keqpërdorimit, të mashtrimeve financiare dhe të kontrabandës, të trafikeve ilegale dhe pastrimit të parave. Në këtë vorbull u përfshin të gjithë. Duke marrë nën kontroll segmente të caktuara të ekonomisë, të tregtisë, të doganave, të privatizimit etj., politikanët e Kosovës, së bashku me segmentet e caktuara të administratës ndërkombëtare, brenda një kohe shumë të shkurtër u bënë njerëz shumë të pasur. Zgjidhja e shpejtë e statusit të Kosovës nuk iu shërbente as atyre.

Kosova tani bënte disa jetë paralele. Çdo ditë ajo zbulonte dëshmi të reja të krimeve të tmerrshme, të cilat as që ishin marrë me mend gjatë kohës së luftës: fëmijë të ngulur në hanxharë, gra të dhunuara, kufoma të djegura ose të degdisura nëpër Serbi, për të fshehur gjurmët e krimit. Edhe disa vjet pas luftës, njerëzit do të gjenin vajza e gra të mbytura nëpër puse dhe nëpër lumenj, kufoma pa varre dhe varre pa emër. Kosova i kaloi vitet e para të lirisë me varrime dhe rivarrime. Një numër djemsh dhe burrash ishin kapur dhe mbaheshin peng nëpër burgjet e Serbisë. Sekush shpresonte se ndër ata të burgosur gjendeshin edhe të afërmit e tyre. Do të zhvillohet një tregti e paparë ndonjëherë: serbë nga Serbia ose që dikur kishin jetuar në Kosovë, në bashkëpunim me shqiptarë nga Kosova ose nga Lugina e Preshevës, do të bëjnë telefonata anonime ndër familjet e të zhdukurve, duke kërkuar shuma marramendëse parash, për t'ua gjetur të afërmit e tyre. Në shumicën e rasteve e gjithë historia përfundonte si mashtrim ordiner. Kjo ishte Kosova e njërës pamje.

Pamja tjetër e Kosovës nuk ishte kaq e zyrtë dhe kaq dëshpëruese. Ishte folklorike, por brenda kishte edhe një krenari të ligjshme. Anë e kënd Kosovës shënoheshin vendet e betejave të UÇK-së. Mbaheshin fjalime të zjarra

patriotike, kujtoheshin të rënët, ngriheshin lapidare. Ikonografia e këtyre tubimeve gjithmonë ishte e njëjtë dhe fjalët që thuheshin buronin nga literatura patriotike e trashëgimisë së hershme ose më të vonë, e reduktuar në fjalor dhe në mesazhe. Edhe këtu filloi të zhvillohej një biznes: disa poetë, për para, shkruanin vargje për heronjtë, dëshmorët dhe martirët e luftës, ua jepnin këngëtarëve dhe ata, gjithashtu për para, këndonin pa përtesë për trimëritë e papara të atyre që kishin rënë për lirinë e Kosovës. Nga Shqipëria, skulptorë të realizmit socialist bënë buste dhe shtatore të heronjve, që u vendosen në sheshe dhe gjetiu anë e kënd Kosovës, ani që në shumicën e rasteve pamja e këtyre trimave do të jetë e ngjashme me të Vojo Kushit apo të ndonjë partizani tjetër të Shqipërisë.

Një pamje tjetër e Kosovës ishte ajo e shkatërrimeve dhe uzurpimeve. Ç'është e vërteta, kësaj meseleje ia kishin nisur vetë serbët, të cilët gjatë bombardimeve të NATO-s, në zonat e luftës dhe gjithandej Kosovës, kishin vjedhur dhe plaçkitur çdo gjë që iu vinte ndoresh. Vlera e këtyre plaçkitjeve nuk do të dihet kurrë, sepse ato fillonin me shumatat e mëdha të parave që ua morën shqiptarëve në raste pushkatimesh, ose në çdo rrethanë tjetër të ngjashme, pastaj të stolive dhe të gjërave të tjera të çmuara, për t'i dhënë fund kësaj piraterie me djegie masive të shtëpive, veçmas në disa zona të Dukagjinit, të Drenicës etj. Kosovës së qershorit të vitit 1999 i vinte era shkrumb dhe një duhmë e rëndë, që nuk dihej në ishte erë e kufomave të pavarrosura, apo e bagëtisë së vrarë e të ngordhur. Nuk do mend, hakmarrja e shqiptarëve ndaj serbëve, në disa raste, do ta tejkalojë logjikën dhe arsyen, por ajo kurrë nuk do të arrijë përmasën e brutalitetit që serbët kishin bërë ndaj shqiptarëve.

Vetëm se, inercia e shkatërrimeve dhe e uzurpimeve nuk u ndal te pronat e serbëve. Duke shfrytëzuar situatat pa

pushtet, kosovarët në masë të madhe vodhën njëri-tjetrin dhe më pastaj, si e kaluan këtë fazë, ia nisën tregtisë së madhe të pronave me serbët. Dëmet që i shkaktuan Kosovës ishin të jashtëzakonshme, sepse shuma të mëdha parash nga Kosova shkuan në drejtim të Serbisë. Të prirë nga një babëzi e çuditshme, kosovarët bënë një garë të paparë në blerjen e pronave serbe, duke ua ngritur çmimet dhe duke ligjëruar si prona private të serbëve hapësirat e mëdha të pronave shoqërore. Në këtë lojë të çmendur përfitimesh u fut edhe agjencia e OKB-së për pronat, e cila, gjatë gjithë atyre viteve bëri lojë të shëmtuar: njohu dokumentet serbe të periudhës së shpronësimit të madh të shqiptarëve dhe, po ashtu, u dha legalitet dokumenteve kadastrale të nxjerra nëpër Serbi, me vula të Kosovës dhe me data të falsifikuara. Dhe kështu, OKB-ja u bë kontrabanduesi më i madh i pronave në Kosovë.

Pra, Kosova e këtyre jetëve paralele; Kosova e plagëve të dhembshme; Kosova e krenarisë dhe idealeve të mëdha; Kosova e ngazëllyer për lirinë e fituar dhe dëshpëruar pse liria nuk jepte zgjidhje për çdo gjë; Kosova e virtyteve më të larta, të njëkohshme me cenet dhe veset më të shëmtuara njerëzore, gjatë viteve të para të pasluftës nuk mund të ofronte asgjë të qartë, aq më pak një zgjidhje politike, e cila vetvetiu do t'i marginalizonte opsionet negative, qofshin ato të Serbisë, apo të një pjese të bashkësisë ndërkombëtare. Kosova nuk ishte vetëm protektorat ndërkombëtar në pikëpamje politike dhe administrative. Ajo kishte mbetur pezull në të gjitha pikëpamjet, e tërhequr nga një ekstrem në tjetrin, nga një mori kundërshtish dhe kundërthëniesh. Ajo nuk ofronte asnjë zgjidhje për veten e saj, ofronte lojalitet ndaj bashkësisë ndërkombëtare dhe asgjë më shumë. Në sytë e kësaj bashkësie ajo nuk kishte identitet, sepse kjo bashkësi ndërkombëtare ishte politike, i maste vlerat me kut

politik, ndërsa Kosova nuk kishte identitet politik. Ajo kishte qenë një krahinë autonome jugosllave; i qe hequr autonomia në mënyrë të njëanshme nga Serbia; në këtë e sipër ishin shkelur të drejtat e njeriut; më pastaj ishin kërkuar zgjidhje politike, por ato nuk ishin gjetur; kishte plasur një sherr i madh ndërkombëtar, ishte shkaktuar një krizë humanitare; kishte ndërhyrë NATO-ja dhe ja tani ku ishte: pa status, pa të nesërme të qartë, vetëm me të sotmen të karakterizuar me një transicion kaotik dhe shumëplanësh njëherësh.

Rrënimi i imazhit

Gjatë pranverës së vitit 1999, ndoshta pak edhe më herët, mediet botërore e tashmë e kishin krijuar pamjen e Kosovës dhe të kosovarëve si *viktimë ideale*. Pamjet e shpërndara anë e kënd botës mund të ishin të ndryshme, por ato flitnin për të njëjtën gjë: për kosovarët e përvuajtur, të dëbuar nga shtëpitë e veta, në një karroceri traktori të mbuluar me plasmas, me dy-tre fëmijë sypërlotur mbështjellë me ndonjë batanije të vjetër, me një tjetër fëmijë në djep ose tek ishte kapur pas gjirit të së ëmës, me pleq të parruar e thatimë e me plaka tek fshijnë lotët me cepin e shamisë. Afërsisht, ky ishte *imazhi botëror* i Kosovës së pranverës së vitit 1999. Pamjet mund të ishin më pak ose më shumë mbresëlënëse, më pak ose më shumë kreative, por në esencë ato pasqyronin një viktimë të urtë e të përvuajtur, e cila nuk kishte përse të thoshte asgjë, nuk kishte përse të fliste, nuk kishte përse të mendonte. Ajo ishte e destinuar të vuante dhe asgjë më shumë se kaq. Bota i qe nënshtruar këtij përfytyrimi dhe kosovarët duhej ta luanin këtë rol, në të

gjitha variantet e një tragjedie njerëzore. Dhembja ishte e madhe, tronditëse, që lëndonte në sedër dhe e bënte përgjegjës çdo njeri të pushtetshëm të botës, çdokënd që i konsideronte pjesë të veten vlerat e civilizimit, çdo njeri që kishte ndjenja humane. U mor vesh, kosovarët nuk kishin nevojë ta aktronin situatën e tyre tragjike. Vuajtja e tyre ishte reale. Reale ishte edhe ndërgjegjja e lënduar botërore, kundrejt një tragjedie të këtillë. Askush nuk luante me gjëra kaq të frikshme, të zymta, çnjerëzore.

Askush nuk e kishte besuar se Europa, modeli botëror i civilizimit dhe vlerave humane, ndonjë pjesë e saj, ende fshehte në vete pikëpamje dhe pasione gjenocidale. Që nga Lufta e Dytë Botërore dhe prapa, ajo ishte munduar në të gjitha mënyrat të shëronte kompleksin e antisemitizmit. Tani historia po përsëritej në variantin më të keq. Më anë tjetër, tragjedia e Bosnjës kishte lënë të kuptohet se bota perëndimore kishte paragjykimet e saj nacionale dhe fetare. Një përsëritje e tragjedisë së Bosnjës do të dërgonte një porosi të keqe për historinë: se Europa, për shkak të paragjyqimeve fetare, ishte treguar indiferente ndaj gjenocidit mbi të vetmit popuj myslimanë të kontinentit të vjetër. Në të vërtetë, të gjithë e dinin se ishin këto paragjyqime fetare të Europës, që e kishin çuar situatën deri në këtë pikë. Ajo tashmë kishte toleruar marrëzira të pakufishme të Serbisë ortodokse (edhe të shteteve të tjera të kësaj provenience fetare, përfshirë edhe Rusinë), vetëm e vetëm pse objekt i pasionit të saj fashist ishin boshnjakët dhe shqiptarët, që të dy popuj me shumicë myslimane. (Edhe tani që po flasim, në Bashkimin Europian duket se askujt nuk i bën përshtypje fakti se kryesisht janë shtetet ortodokse të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.)

Sido që të jetë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, stereotipi i viktimës kosovare tashmë ishte krijuar dhe ai

shëtiste nga një cep i botës në tjetrin. Së fundi atij stereotipi iu shtua edhe *imazhi i kthimit*, respektivisht i hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë dhe entuziazmi i paparë dhe mbresëlënës i kosovarëve mirënjohës. Me këtë kthim, kuadri ishte plotësuar. Ideja e humanizmit kishte ngadhënjyer mbi brutalitetin, mbi çnjerëzoren. Viktimës i ishte ofruar mbrojtja, jo drejtësia. Drejtësia për viktimën ishte çështje politike, mbrojtja e viktimës ishte çështje humanitare. Kosovari, viktimë e urtë, tani mund të kthehej në shtëpinë e tij të djegur, të ishte mirënjohës për këtë mrekulli dhe në cep të oborrit të priste ndonjë organizatë humanitare, e cila do ta furnizonte me bukë dhe me gjësendet e tjera të nevojshme. Ai duhej të ishte falënderues, kaq mund të thoshte para ndonjë kamere televizive, asgjë tjetër. Ai nuk kishte nevojë të mendonte, nuk kishte nevojë të fliste, nuk kishte nevojë as për politikë, as për bëma të tjera që trazojnë mendjen dhe shpirtin.

Pra, bëhej fjalë për imazhin e një viktime ideale, sikur kosovarët të mos ishin qenie të kësaj bote, me ndjenja dhe me pasione, por ndonjë komunitet i çuditshëm murgjish budistë. Më anë tjetër, nën pamjen e njeriut të urtë dhe mirënjohës, kosovari fshihte pasione të zakonshme njerëzore, ca më të ulëta e ca më të larta, vese dhe virtyte, mendime dhe ide, kërkesa politike dhe observime individuale. Mbi të gjitha, ai mbante me vete një të kaluar të vështirë, traumatike, me shumë vuajtje dhe padrejtësi. Ai kurrë nuk ishte mësuar t'i besonte drejtësisë që vendosej përmes ligjit, por asaj drejtësie që vendosej ose sipas kanunit, ose sipas mendjes së tij. Në kujtesën kolektive të Kosovës shteti kishte qenë armiku më i madh i kosovarit. Prej tij vinte padrejtësia, prej tij vinte dhuna, prej tij vinte vdekja. Dhe nuk ishte vetëm kjo. Një memorie frustuese ua rëndonte ndërgjegjen kosovarëve: serbët ua kishin vrarë

gjyshërit, serbët ua kishin vrarë baballarët, edhe ata prej serbëve ishin kërcënuar të vriteshin dhe po prej serbëve ishin vrarë ose mund të vriteshin edhe nipërit e tyre. Të jetoje me një kujtesë të tillë nuk ishte e lehtë. Nuk ishte e lehtë të jetoje pranë fqinjit serb, të cilit dikur ia kishe hapur derën e shtëpisë, ndërsa ai, sapo i qe shfaqur rasti, kishte vënë një maskë në fytyrë, ose pa të fare, dhe i kishte vrarë të gjithë pa përjashtim. Tashmë dihej, në Kosovë më së keqi e kishin pësuar ata që iu kishin besuar fqinjëve të tyre serbë: ata ua kishin vrarë fëmijët, ata ua kishin dhunuar gratë, ata i kishin bërë mizoritë më të përbindshme. Pse? Nuk kishte ndonjë shpjegim tjetër, përveç se një urrejtje patologjike mbi baza nacionale dhe fetare.

Sipas rregullave civilizuese, hakmarrja individuale përjashton ligjin dhe drejtësinë, sepse, thuhet, drejtësia nuk vihet në vend, nëse një krim ndëshkohet me një krim tjetër. Kosovarët, tradicionalisht, nuk i kanë besuar drejtësisë institucionale, sepse shteti, cilido që i ka sunduar, nuk ka ofruar drejtësi të paanshme. Në rrethanat e pasluftës është vështirë të thuhet se kosovarët deshën ta vendosnin drejtësinë sipas rregullave të tyre, sipas Kanunit ose sipas pasionit primitiv të hakmarrjes. Ata thjeshtë iu nënshtruan inercisë, e cila i ka shtyrë në hakmarrje të gjithë ata që e kanë pësuar në një mënyrë të ngjashme. Kosovarët u sollën njësoj, siç janë sjellë pothuajse të gjithë popujt e Europës pas Luftës së Dytë Botërore: ku arritën i vranë dhe i dëbuan pushtuesit dhe kuislingët. Edhe gjyqet që u bënë, nuk ishin gjë më mirë se hakmarrje nga pasioni. Atëherë, përse nga kosovarët kërkohet të silleshin ndryshe? Doemos që ata do të vrisnin ndonjë serb të pafajshëm dhe këtë mund ta bënin për tri arsye: e para, sepse nuk e sundonin dot pasionin e urrejtjes për mizoritë që ata kishin bërë në pranverën e vitit 1999 dhe më herët; e dyta, sepse kishin të akumuluar një kujtesë

negative, e cila përfshinte një periudhë të gjatë kohore të jetës së përbashkët; dhe, e treta, sepse donin një zgjidhje politike për Kosovën të pandikuar nga faktori serb.

Por çfarë ndodhi në të vërtetë? Bashkësia ndërkombëtare, veçmas Europa sqimatare, nuk e akceptoi një sjellje të këtillë të kosovarit. Ajo nuk desh që kosovari të ndryshonte pamjen e viktimës së urtë. Ai duhej përjetësisht të mbetej i tillë, i urtë, i padëmshëm, i dëgjueshëm. Ajo nuk desh që ndërhyrja, në të cilën kishte marrë pjesë edhe ajo, të bëhej mbulesë për krime hakmarrëse ndaj serbëve. Ajo nuk desh të ndodhte kjo, sepse kishte marrë pjesë në ndërhyrje me shumë dilema dhe hezitime. Ata që kishin qenë të vendosur për ndërhyrje, edhe gjatë ditëve të aksioneve ushtarake ishin përballur me kritika të ashpra. Tani kosovarët kishin krijuar argumente për kundërshtarët e tyre. Por, mbi të gjitha, bëhej pyetja: A ia kishte vlejtur? Shumica do të thonë jo, sepse në Ballkan të gjithë janë të njëjtë, si kriminelët, si viktimat, sepse edhe viktimat, sapo t'u krijohet mundësia, bëhen kriminelë. Natyrisht që ky ishte një barazim i shëmtuar, i padrejtë, por, mbi të gjitha, ishte një justifikim për hezitimin dhe pendesën. Edhe sikur kosovarët të mos bënin asnjë veprim kundër serbëve, Europa do të kërkonte një arsye për t'u penduar. Nëse nuk do të ishin serbët e dëbuar, ndonjëri edhe i vrarë dhe shtëpitë e tyre të djegura, do të gjendeshin romët, dhe nëse nuk ishin romët, do të gjendeshin goranët, turqit, kushdo qoftë. Për t'u penduar gjithmonë gjendet një arsye. Më në fund, për pendesën dhe sedrën e lënduar të Europës, nëse nuk gjendej dikush tjetër, do të shprehej Brizhit Bardo për mizoritë e të dyja palët ndaj kafshëve. Pra, idesë së pendesës, në çfarëdo mënyre i duhej dalë në fund.

Më anë tjetër, duke pasur parasysh këtë rrethanë, realisht kosovarët do të vënë në pozitë të pakëndshme miqtë dhe

përkrahësit e tyre më të mëdhenj, anë e kënd botës, sepse jo çdo veprim i tyre ishte racional, madje as nën pasionin e hakmarrjes, por më shumë me ndonjë llogari fitimprurëse. Në Prishtinë dhe në ndonjë qendër tjetër urbane do të vritet ndonjë plakë serbe, vetëm e vetëm për t'ia uzurpuar banesën. Bëhen edhe veprime të tjera joracionale, të padinjitetshme, ndërkohë që media botërore vazhdon të jetë e fokusuar në Kosovë, duke ndjekur hap pas hapi çdo veprim të kosovarëve. Ishte një monitorim i paparë, i kujdesshëm deri në detaje, shpesh tendencioz, por gjithnjë i arsyeshëm: ata që kishin ndërhyrë, kishin edhe të drejtën e vëzhgimit. Ata mbanin edhe të drejtën e pendesës, njësoj si të drejtën e kërkimit të idealitetit. Ndërsa kosovarët ishin larg të qenit idealë. Ishin një komunitet që kishte vuajtur mungesën e emancipimit dhe të arsimimit, mungesën e institucioneve dhe perceptimin pozitiv të shtetit dhe të ligjeve të tij. Në të vërtetë, perceptimi i kosovarit për rregull dhe ligj ishte negativ, sepse në mbrojtje të rendit dhe ligjit kishte qëndruar gjithmonë një shtet armiqësor, i cili sistemin e drejtësisë dhe ligjin e kishte përdorur jo për të vendosur rregull në jetën e njerëzve, për t'i mbrojtur të drejtat e tyre, por për t'i shkelur ato. Nga ky perceptim negativ i shtetit kosovarët vështirë që do të lirohen ndonjëherë.

Perceptimi i gabuar i konfliktit

Edhe përkundër faktit se kishte shpëtuar nga një luftë pothuajse shfarosëse, i kishte shpëtuar një gjenocidi kërcënues dhe pothuajse zhbërës dhe kishte hequr qafe një zgjedhë të urryer prej shumë kohësh; pra, edhe përkundër të gjithave, Kosova nuk kishte status të përcaktuar, që

domethënë nuk dihej se çfarë ishte. E ardhmja e saj dukej krejt e paqartë, edhe pas angazhimit të jashtëzakonshëm të bashkësisë ndërkombëtare. Ndërhyrja e NATO-s thuhej se kishte qenë kryekëput humanitare, pra e tillë që nuk prejudikonte statusin. Rezoluta 1244 e KS të OKB-së e vendoste Kosovën nën protektoratin e OKB-së, ndërsa zgjidhjen duhej kërkuar te Konferenca e Rambujesë, e cila nuk e kishte bërë hapin vendimtar të përkufizimit të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Madje, tani në Kosovë dhe rreth saj ishte krijuar përshtypja se çdo gjë që bëhej kishte vetëm një qëllim: ta pamundësonte pavarësimin e Kosovës në çdo variant dhe në çdo mënyrë. Këtë punë dukej sikur e kishin prioritet edhe trupat e NATO-s. Pas dëbimit të forcave serbe, trupat e NATO-s nuk e kishin preokupim themelor akomodimin e viktimave, që në këtë rast ishin shqiptarët, por pikërisht të kundërtën: lëvizjen e patrazuar të kriminelëve serbë, të cilët, nën mbrojtjen e blinduar të trupave të KFOR-it shëtisnin nga njëra enklavë në tjetrën, me tre gishta përpjetë, duke provokuar mllëf dhe urrejtje të shqiptarët. Konsideratat e jashtëzakonshme për trupat e NATO-s tashmë ishin dvarë edhe për shkak të Mitrovicës. Kosovarët nuk e kishin të vështirë ta akceptonin, se trupat e NATO-s më me kujdes e ruanin urën mbi Ibër dhe, bashkë me të, edhe enklavën serbe në Mitrovicën e veriut, përfshirë edhe paramilitarët e armatosur, sesa kufirin e Kosovës me Serbinë, në Zubin-Potok ose Leposaviq. Të njëjtën gjë bënte edhe administrata e OKB-së, pra UNMIK-u, e cila kujdesej me fanatizëm të jashtëzakonshëm që Kosova të mos bëhej shtet, por më shumë të ruante një *status quo*, pa zgjidhje, një qëndrim pezull, as në qiell, as në tokë.

Me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, de jure Kosova u bë protektorat ndërkombëtar, por në funksionimin e këtij mekanizmi kishte aq shumë implikime, sa që konfigurimi i

saj statusor dukej krejtësisht i çoroditur. Me qëllim që të ruheshin balancat e brendshme të mekanizmit veprues të OKB-së, në Kosovë kishte zbarkuar administrata më e komplikuar dhe më e pamundur që ishte parë ndonjëherë. Në bërjen e kësaj administrate kishin marrë pjesë të gjitha shtetet anëtare të OKB-së, e kjo në një mënyrë donte të thoshte se Kosova duhej të bënte një administratë publike dhe të vendoste një rregull civil, duke u mbështetur në një përvojë shumë heterogjene, thënë më mirë, duke u mbështetur në përvojën e bërjes së shteteve sipas modeleve që nuk i shërbenin askujt dhe që nuk kishin ndonjë domethënie për botën bashkëkohore. Për Kosovën mund të kishte kuptim, ta zëmë, që një suedez ose një gjerman të vinte në ndonjë komunë dhe të tregonte se si mund të organizohej në mënyrë efikase pushteti lokal; se si mund të vendosej rendi dhe ligji, si mund të rregulloheshin çështjet infrastrukturës, të pronës etj. Një francezi do t'i shkonte që të mbante një post të rëndësishëm në departamentin e kulturës, ta zëmë, aty ku zuri fill më vonë profilizimi i administratës kulturore, sepse përvojat e tij kulturore në Francë mund të kishin domethënie për Kosovën.

Po çfarë ndodhi në të vërtetë? Diçka që nuk ishte marrë me mend dhe nuk ishte parë kurrë deri atëherë. Edhe përkundër faktit se për shumë kohë kishte qenë e privuar nga të liritë qytetare; edhe përkundër shkeljeve të rënda dhe abuzimeve sistematike me liritë dhe të drejtat e njeriut; edhe përkundër dhunës së vazhdueshme që ishte ushtruar decenie me radhë; edhe përkundër ngecjes në zhvillim, prapambetjes, luftës shkatërrimtare dhe të gjithë faktorëve frenues që e kishin lënë Kosovën në një gjendje të mjeruar; në krejt këtë kontekst Kosova ishte në Europë dhe standardet e matjes së prapambetjes së saj, të robërisë, të shkeljes së të drejtave dhe çdo gjë tjetër që kishte të bënte më

këto, ishin thellësisht europiane. Pra, nuk ishin as afrikane, as aziatike dhe as latino-amerikane. Edhe robëria e saj, ndonëse shpesh i tejkalonte parametrat civilizues europianë, megjithatë kishte kontekst europian dhe vetëm si e tillë mund të kuptohej. Edhe lufta që ishte bërë, edhe angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare për të gjetur një zgjidhje kishte kuptim vetëm në një shkallë më të lartë të observimeve të teorive politike. Kosova, në esencë, nuk ishte konflikt primitiv. Për ta kuptuar burimin e këtij konflikti, njësoj si përmasat, interferencat dhe pasojat largvajtëse, duhej të kishte një arsimim elementar politik dhe një dije historike sadopak europiane. Mbi të gjitha, që të inkuadroheshe disi në jetën qytetare të Kosovës; që të vendosje një raport çfarëdo qoftë me njerëzit e të gjitha shtresave shoqërore në Kosovë, duhej të kishte një kulturë elementare europiane, të sjelljes, të komunikimit etj. Kosovari mund të kishte dhe gjithësesi duhej të kishte nivel më të ulët kulturor dhe arsimor në raport me shumicën e qytetarëve evropianë me një zhvillim normal, por ai dinte të përcaktonte hierarkinë e vlerave dhe të sillej në mënyrë të diferencuar karshi niveleve të kësaj hierarkie. Prandaj, për kosovarin ishte e pakuptueshme dhe disi absurde, që në krye të departamentit të kulturës, ta zëmë, për vite me radhë në Prishtinë të qëndronte një person nga Kili, për të cilin puna më e rëndësishme që bëri, konsiderohej shfaqja orë e çast e prapanicës në sytë e bashkëpunëtorëve. Ose, më vonë, e një tjetri nga India, i cili ishte shumë i dhënë pas ritualeve dhe sekteve. Për kosovarin nuk ishte e lehtë ta kuptonte, si mund të ndodhte, ta zëmë, që komunikacionin në qendër të Prishtinës mund ta rregullonte një polic nga Fixhi, i cili betohej se semaforin e parë në jetën e tij e kishte parë pikërisht në Prishtinë. Apo, si mund ta shikonte kosovari me miratim faktin se njësi speciale e policisë për ndërhyrje të shpejta, pra një njësi elite në çdo polici të botës, për shumë

vite në Prishtinë ishte një njësi nga India, policë të mbështjellë me xhybe dhe me çallma rreth kokës, ndërsa në vend të shkopinjve të gomës, ishin të pajisur me shkopinj bambuje.

Por edhe Europa, në mënyrën e vet, ishte inkuadruar mirë në kontekstin e kësaj loje të përgjithshme. Ndonjë person europian që mund të kishte lidhje të hershme me shqiptarët, mënjanohet me kujdes, që të mos binte në sy si i anshëm. Të tillët, edhe nëse mund të kishin gjetur punë për një kohë në Kosovë, duhej të ishin të kujdesshëm, që të mos shfaqeshin si proshqiptarë, ndërkohë që për avancimin e tyre në ndonjë post me përgjegjësi, fakti se kishin ndonjë lidhje me shqiptarët paraqitej si pengesë serioze. Në anën tjetër, u hulumtuan dhe u gjetën me një shpejtësi të jashtëzakonshme të gjithë ata që kishin lidhje të tërthorta ose të drejtpërdrejta me serbët, lidhje kulturore, çfarëdo lidhjeje tjetër, mjaftonte që kjo të arsyetohej me nevojën e trajtimit të tyre si viktimë të situatës së re të krijuar në Kosovë. Nëpër metropolet e Europës u kërkuan dhe u gjetën gra e burra që dinin serbisht, që kishin njohje me qarqet politike dhe kulturore të Beogradit dhe që ishin të afërt me pikëpamjet nacionaliste serbe për Kosovën. Të tillët u sollën në Kosovë në poste vendimmarrëse, veçmas për bërjen e të ashtuquajturve institucione multietnike, ku bënë pjesë, përveç administratës, edhe institucionet arsimore, kulturore, të informimit etj. Kështu, një gjerman pa titull universitar dhe me një karrierë të dyshimtë profesionale do të merrte përsipër ringritjen e sistemit arsimor në Kosovë, për ta çuar arsimin shqip, për dy-tri vjet, pothuajse në zhbërje, në mënyrë që pas kësaj “përvoje” të fituar në Kosovë, pa pikë turpi të përfundonte në Beograd, në një fondacion për zhvillimin e arsimit në Serbi, ose diçka e tillë. Nuk ishte se shqiptarët e Kosovës nuk e shihnin, ta zëmë, se çfarë po

ndodhte me sistemin e arsimit në Kosovë, me Universitetin, me Akademinë, me institutet etj. nën drejtimin arrogant dhe të papërgjegjshëm të një Daxneri, por ata i kishin dy çështje të pazgjidhura në raport me këto bisha antishqiptare: e para, këta të huaj ishin fuqiptotë dhe të pakontestueshëm në marrjen e çfarëdo vendimi; dhe, e dyta, vetë shqiptarët nuk kishin ndërtuar një qëndrim të qartë politik, se si duhej të silleshin me persona të këtillë, në duhej të mbanin qëndrim të rezervuar, t'i mbështetnin ose të silleshin në mënyrë përjashtuese. Në të vërtetë një qëndrim i përgjithshëm politik ekzistonte dhe ai çonte në drejtim të një kooperativiteti të ngushtë më bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, pa specifikuar rastet dhe situatat. Kaq mjaftonte që situatat si e Daxnerit të mos merrnin një kundërshtim të përgjithshëm në formën e refuzimit.

E ngjashme ishte situata edhe me disa fusha të tjera, bie fjala, me dokumentet personale të qytetarëve. U ndërtua një mënyrë dhe një procedurë e pajisjes me dokumente të këtilla, e cila, në shumë raste, qytetarin e zakonshëm ose e çonte te administrata paralele serbe që vazhdonte të operonte në Kosovë, ose e bënte të hiqte dorë përfundimisht nga ideja e pajisjes me dokumente personale. Të gjithë e dinin situatën e papërballueshme në këtë sektor, por të paktë ishin ata që kishin dijeni se në krye të këtij shërbimi në Kosovë ishte vënë një ukrainas, ndërsa një serb ishte bashkëpunëtori i tij më i afërt. Të gjithë e dinin, ta zëmë, se koncepti i parë i programit multietnik i Radio-Kosovës e kishte një strukturë gjuhësore diskriminuese për shqiptarët, por të paktë ishin ata që e dinin se hartuese e këtij koncepti ishte një përkthyes francez e shkrimtarëve të njohur serbë, e cila për vite me radhë në Prishtinë ishte një bërthamë e nacionalizmit serb, që ua shkonte edhe vetë serbëve më ekstremistë.

Shpërputhjet etike dhe politike

Kush ishin, pra, këta njerëz, të cilët zbarkuan në Kosovë në vitin 1999 e prapa, që ta bënin Kosovën protektorat të OKB-së? Për një arsye ose për një tjetër, kosovarët nuk u shprehën pothuajse asnjëherë krejt qartë për punën e këtyre njerëzve, për ngritjen e tyre arsimore, për moralin e tyre, për bëmat e tyre të përditshme, për sjelljet e tyre, për të gjitha. Nuk u shprehën, sepse për shumë kohë nuk e dinin as vetë nëse kishin kapacitete intelektuale, arsimore, kulturore dhe të tjera për ta bërë këtë. Nuk u shprehën, sepse nuk ishin të sigurt nëse kishin të drejtë morale ta bënin këtë. (Kishin lutur botën që t'i ndihmonte dhe ajo e kishte bërë këtë.) Dhe nuk u shprehën, sepse bazë të çdo krahasimi ata duhej të merrnin pushtetin serb, me të cilin kjo administratë ndërkombëtare, sado e shëmtuar që mund të ishte, nuk mund të krahasohej në asnjë mënyrë. Por kishte edhe një arsye tjetër, përse reagimi i faktorit shqiptar ishte i squllur, anemik, i papërfillshëm. Subjektet politike shqiptare tanimë nuk ishin vënë në raporte partneriteti me faktorët relevantë të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, por në raporte vasaliteti. Ato bënin garë se kush do të tregonte lojalitet më të madh dhe të bëhej sa më kooperativ me secilin zyrtar ndërkombëtar, duke filluar nga roja pakistaneze në portën e institucionit e deri te shefi filipinas që mbahej me të madhe dhe kapardisej në zyrën e tij me kondicioner dhe mobilieri të shtrenjta. Lidhja Demokratike e Kosovës, ta zëmë, e konsideronte pjesë të programit të saj dhe të filozofisë së saj politike *bashkëpunimin nënshtrues* me ndërkombëtarët. Kundrejt saj, strukturat e dala nga lufta, pavarësisht në ishin të përfshira në ndonjë formë organizmi ose jo, mbanin atributin e refuzuesve të bashkëpunimit dhe të sjelljes kundërshtuese. Kjo i bëri disi me kompleks këta të dytët,

sikur bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare, përveç që sillte përkrahje dhe privilegje të kuptueshme, krijonte edhe imazh pozitiv në rrethin kosovar: sikur i bënte më të kultivuar, më të sjellshëm, më të arsimuar, pra ua hiqte atributet e njerëzve të pagdhendur, që ata dukej se e vuanin jashtëzakonisht shumë. Thënë ndryshe, ndër kosovarët zhvillohej një garë e shëmtuar e pëlqimit në sytë e ndërkombëtarëve, e cila kurrë nuk do të marrë as mirënjohjet, as nderet e pritshme.

Po kënd respektonim dhe kujt i bënim ndere kosovarët? Burra dhe gra me raca, mentalitete, kulturë dhe traditë jashtëzakonisht heterogjene. Kjo përzierje ishte në vetë natyrën e misionëve të OKB-së. Por a ishte vetëm kjo? Disa syresh ishin të sprovuar me misione të këtilla dhe në Kosovë gjetën një parajsë të vërtetë. Nuk kishte dhunë ndaj të huajve dhe rrezikshmëria për jetën ishte pothuajse zero. Vetë implikimet e tyre në krim (kontrabandë, korrupsion, trafikim etj.) kanë mundur ndonjëherë t'i bëjnë objekt ose cak sulmesh, por në përgjithësi ishin të mirëpritur dhe respektoheshin edhe kur me asnjë veprim të tyre nuk e meritonin këtë. Kishin rroga të mëdha dhe, për kushtet e Kosovës, bënin jetë luksoze. Zunë me qira shtëpitë më të mira dhe bënin shërbëtoresha e truproja vajza e djem të hijshëm dhe me edukatë, që dinin anglisht, por më me rëndësi ishte gatishmëria e tyre për shërbime të të gjitha llojeve. Dhe këto shërbime ata nuk e kishin për gjë t'i kërkonin pothuajse pa përjashtim. Sepse, shumica syresh, ishin horra dhe kodoshë të sprovuar, homoseksualë, kurva me damkë, të cilët gjysmën e jetës e kishin çuar nëpër bordelet e botës, gjithnjë duke bërë jetë të shturur, më shumë të dehur se esëll. Shumicën e kohës e shkonin nëpër restorante dhe kafene, duke ngrënë dhe duke pirë si të babëzitur. Në këtë e sipër, bënin politikën për Kosovën dhe planet për të ardhmen e

saj. Secili kishte një preokupim kryesor: që misioni i OKB-së në Kosovë të zgjatej sa më shumë dhe “rrezikshmëria” e misionit të mos zvogëlohej, në mënyrë që shpërblimet të preknin kuotat më të larta dhe ta gjenin arsyeshmërinë. Edhe po të mos ndodhte ndonjë Mitrovicë e veriut, ata do ta shpiknin një të tillë, sepse ajo iu duhej, në mënyrë që tensionet t’i mbanin të larta në vazhdimësi.

Por nuk ishte vetëm kjo. Shoqëria tradicionale e Kosovës e kishte shumë të vështirë të përballej me këta njerëz pa vlera dhe pa integritet moral. Ata silleshin si kolonizatorët e dikurshëm, por nuk mund të bëheshin as të tillë, sepse nuk ishin zotërinj dhe zonja, nuk kishin edukatë të tillë. Ata ishin plebej, që imitonin në mënyrë të shëmtuar aristokratët e dikurshëm të kolonive. Prej tyre kishin marrë vetëm arrogancën dhe mosdhënien llogari për punët e tyre. Prej tyre mund të kishin marrë edhe ndonjë ves tjetër, por asnjë veti. Pothuajse asnjëri prej tyre nuk bënte jetë të rregullt familjare. Ishin të dhënë pas orgjive, seksit dhe drogës. Asgjë nuk punonin. Shumica as nuk dinte saktësisht se çfarë duhej të bënte. Ata nuk kishin dije profesionale për asnjë punë tamam. Edhe shkollimi i tyre, në shumicën e rasteve, ishte i dyshimtë. Përmes përvojës së gjatë dhe trajnimeve, ata ishin aftësuar të shkruanin raporte, raporte pa fund, që nuk shërbenin për asgjë. Shumica e atyre raporteve nuk do të lexohen kurrë. Disa syresh do të lexohen, për aq sa të shërbenin për të shkruar raporte të reja, ose raporte përmbledhëse, të cilët po ashtu nuk do t’i lexonte njeri.

Për një kohë ata bënë jetë të mbyllur në sektin dhe në enklavën e tyre të përzgjedhur dhe të diferencuar qartë nga vendasit. Por dihej se kjo nuk mund të zgjaste gjithmonë. Të parët që u vunë në shërbim të tyre ishin vajza dhe djem të shkathhtë dhe nevojtarë. Nuk ishte shaka të merrje një punë

në UNMIK, në OSBE ose kudo gjetkë. Nuk kishte rëndësi se çfarë pune, roje, shofer, përkthyes, gjellëbërëse, pastruese, asistente, sekretare. Të gjithë paguheshin mirë dhe në Kosovën e shkatërruar ekonomikisht, të tillë që kishin nevojë për punë dhe këndellje financiare ishin pothuajse të gjithë. Prandaj edhe gara për një punë të tillë ishte e jashtëzakonshme. Mundësia e zgjedhjes gjithashtu. Nuk kishte konkurse legale, kishte vetëm shije dhe parapëlqim të personave vendimmarrës. E pëlqenin një vajzë, e merrnin. Ishte e bukur, e merrnin. Ishte e lirë në sjellje, e merrnin. Nuk dinte të bënte asgjë, prapë e merrnin, sepse cilësitë profesionale nuk ishin vendimtare. Këta të rinj duhej të dinin të bëheshin shumë të mençur, që t'i gëzonin privilegjet e ofruara dhe të mos binin në grackat e këtyre banditëve me emblema të OKB-së, OSBE-së dhe të sa e sa shoqatave humanitare dhe OJQ-ve. Jo të gjithë do të dinë të sillen në një situatë të këtillë. Sekush do të përfundojë i vvarë në mënyrë enigmatike, sepse mund të kishte zbuluar diçka që nuk duhej. Ndonjë vajzë do të përfundojë e vetëvrasë, nga dijenia se është infektuar me sidë. Disa të tjerë do të përfundojnë rrugëve të botës, në misione të ngjashme me atë të OKB-së në Kosovë, duke ua bërë të tjerëve atë që ua kishin bërë atyre në një kohë të shkuar. Një numër djemsh dhe vajzash të reja do të martohen dhe do të ç'martohen, do të ikin dhe do të kthehen, me një fjalë do të bëhen qytetarë të botës, ashtu sikundër i deshëm dhe nuk i deshëm vetë në fëmijët tanë.

Që të mos duket sikur çdo gjë është e projektuar qëllimisht me nuancat më të errëta, duhet pranuar faktin se në fazën e emergjencës, e cila përfshiu periudhën vjeshtë-dimër 1999-2000, bashkësia ndërkombëtare ndihmoi Kosovën në masë të mjaftueshme, për të mos vuajtur nga mungesat elementare. Ndihmuan me ushqime, me

veshmbathje, me tenda, me shtroja dhe mbuloja, me material ndërtimor. Vetëm se duhet ditur një gjë: një vit më vonë, po të hyje në shtëpinë e kujt do që ishte prekur nga lufta, nuk gjeje pothuajse asgjë nga ajo që një vit më parë me shpirtgjerësi i qe dhuruar Kosovës. Sepse çdo gjë kishte qenë për një përdorim. Sepse cilësia e secilit gjësend të dhuruar (përveç materialit ndërtimor, që edhe ky mund të ishte me Ukraina dhe i kontaminuar me radioaktivitet) ishte nën standardin e Kosovës. Sepse, edhe në këtë fatkeqësi të njerëzve, bota luante teatro: dikujt i jepte, dikujt s'i jepte; dikujt ia falte, dikujt ia shiste. U vu në veprim një korrupsion i paparë, i përmasave që Kosova nuk e kishte njohur kurrë më parë. Edhe manifestimi i këtij korrupsioni ishte brutal, i drejtpërdrejt, pa ekuivoke. Jepje një shumë parash, shtëpia e djegur, si me magji, kalonte nga njëra kategori në tjetrën. Nuk bëheshe bashkëpunëtor në korrupsion, mbetje nën tendë me gjithë kalamaj, pa i ardhur keq askujt, as vendorëve, as ndërkombëtarëve. Prandaj, shumat fantastike, miliardësh, të cilat janë përmendur ndonjëherë si ndihmë për Kosovën, në masën më të madhe janë kthyer nga kanë ardhur, sepse kosovarët kanë marrë minimumin e tyre. Ndonjëherë njerëzit kanë shfaqur publikisht shqetësimin e tyre për këtë situatë, gjithmonë me arsyetimin se Kosovës po i faturohet një ndihmë që ajo nuk e mori kurrë. Por shqetësimi gjithmonë doli i kotë, sepse askush nga bashkësia ndërkombëtare nuk pranoi të thoshte qoftë edhe një herë, se sistemin e korrupsionit në Kosovë e instaloi bashkësia ndërkombëtare (kosovarët ishin vetëm shërbëtorë të vegjël të tyre), pikërisht ata që sot e përqeshin dhe e tallin Kosovën nëpër të gjitha dyert e botës. Nuk është se kosovarët ishin aq të ndershëm dhe aq naivë, sa të mos dinin të vidhin e të mashtronin. Këtë nuk duhet kërkuar prej askujt në Ballkan, sepse të gjithë ballkanasit, kush më shumë e kush më pak, këtë punë dinë ta bëjnë. Por një vjedhje kaq

masive dhe kaq e drejtpërdrejtë nuk ishte parë kurrë në Kosovë. Dhe as mund të shihej, sepse në Kosovën e varfër e të shkretuar aq shumë para nuk kishin qarkulluar kurrë nëpër duart e njerëzve.

BETEJA E HUMBUR PËR STATUS

Diskursi negativ

Po çfarë ishin kosovarët përball këtyre njerëzve të ardhur nga skajet më të ndryshme të botës? Për ta kuptuar këtë, ka qenë e domosdoshme të lexoje atë që shkruhej për Kosovën gjatë këtyre viteve. Për jo plot njëmbëdhjetë mijë kilometër katrorë u shkruan më shumë se për hapësira të pamatura të një kontinenti të tërë. U shkruan libra, artikuj gazetash, analiza, komente, intervista, relacione, raporte, pra një mori e jashtëzakonshme tekstesh formatesh dhe qëllimesh të ndryshme. Tekstet ishin dy llojesh, një numër syresh për përdorim publik, pra të tillë që i dedikoheshin opinionit të gjerë dhe, natyrisht, tekste që do të kenë pasur lexim më të kufizuar, për përdorim intern, siç thuhet zakonisht për tekstet që nuk i dedikohen opinionit të gjerë, që arkivohen nëpër dosje administrative të shërbimeve të ndryshme, përfshirë edhe shërbimet sekrete. Vetëm përmbledhja e informacionit për tekstet e botuara në këtë periudhë për Kosovën, do të kërkonte një punë shumëvjeçare të një instituti ose të një grupi njerëzish të specializuar, ndërkohë që leximi dhe analiza e këtyre teksteve paraqitet e pamundur, në radhë të parë për shkak të volumit, por edhe për shkak të profilizimeve të shumëllojshme përmbajtësore: aty ka politikë, histori, diplomaci, strategji ushtarake, raporte spiunimi, traditë, trashëgimi, jetë shoqërore, marrëdhënie ndëretnike, kulturë,

etnologji dhe etnografi, deri edhe studime të tilla përimtuese që nuk besohet se do të mund t'i shërbejnë dikujt as sot, as në shekujt e ardhshëm.

Në këtë mënyrë, Kosova u vu përball njerëzve me dije të ndryshme dhe me qëllime të ndryshme. Disa syresh ishin njerëz të shkrimit, kryesisht gazetarë, pra publicistë dhe bërës të politikave dhe të opinionit publik në vendet e tyre. Shkrimet e tyre, qofshin libra apo tekste gazetash, duhet marrë para sysh në çfarëdo rrethane, sepse konsiderohen me peshë, kanë informacion, kanë seriozitet në qasje, përdorin referenca të vlershme, mbështeten në analiza të argumentuara, bëjnë observime serioze, madje edhe kur janë krejt tendencioze. Askush nuk mund ta dijë as për afërsisht se sa tekste të këtilla janë shkruar për Kosovën në këto 10-15 vjet, sikundër që askush nuk mund ta thotë se me çfarë përqindje marrin pjesë këto tekste në morinë e përgjithshme të shkrimeve për Kosovën. Megjithatë, tekste të këtilla ekzistojnë, ato janë shkruar dhe, në disa raste, e kanë nderuar Kosovën me dijen dhe angazhimin e tyre profesional, qofshin nga fusha e historisë, politikës, diplomacisë, të së drejtës, marrëdhënieve ndërkombëtare etj.

Edhe përkundër vlerës së qëndrueshme që mund të kenë, një pjesë e këtyre studimeve ose shkrimeve shkencore-publicistike vuajnë nga një e metë elementare: pothuajse asnjëri syresh nuk merr në shqyrtim (të mos themi në konsideratë) dijen vendore për një çështje të caktuar. Pra, asnjëri, ose pothuajse asnjëri nuk e konsulton këtë dije dhe të dhënat e saj, sadopak burimore dhe sadopak të verifikuara qofshin ato. Ndërsa i lexon këta libra për Kosovën, pastaj e shikon edhe literaturën e shfrytëzuar, sheh edhe referencat, të krijohet përshtypja se këta autorë nuk janë shkencëtarë dhe dijetarë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por më shumë ngjajnë me eksplorues të kohëve të shkuara, që kanë marrë

përsipër t'ia bëjnë me dije botës zbulimin e një toke të panjohur. Ne që jetojmë dhe që kemi jetuar në Kosovë edhe para vitit 1999, pra edhe para vitit se bota ta "zbulonte" Kosovën, i dimë më mirë se çdokush tjetër të metat dhe defektet e shkencës sonë. I dimë mangësitë dhe kufizimet e saj. Por ka qenë një traditë e hershme, ta zëmë, e antropologëve të botës që, kur kanë shkruar për ndonjë fis të Amazonës, bashkë me përshkrimin vizual të asaj që kanë parë, pa përjashtim do të kenë bërë përpjekje të depërtojnë edhe në strukturën e organizimit të tyre social, përfshirë edhe të kuptuarit sado të përciptë të mitologjisë së jetës së tyre, gjuhës, rriteve etj. Pra, këta antropologë në shkrimet e tyre përpiqen të sjellin para dijes shkencore disa të dhëna ose fakte empirike, bie fjala pamjen e ndonjë totemi, ndonjë fjalë nga gjuha e tyre, përshkrimin e ndonjë rituali etj.

Kurse për Kosovën nuk e kanë për gjë të shkruajnë në mënyrë krejt abstrakte: të shkruajnë për gjeografinë e saj pa ditur asnjë emër lumi, asnjë emër fushe, asnjë emër mali; të shkruajnë për historinë e saj pa ditur saktë asnjë ngjarje historike; të shkruajnë për aktualitetin e saj pa ditur asgjë për banorët që e popullojnë atë vend; të shkruajnë për trashëgiminë, kulturën, etnopsikologjinë pa ditur asgjë për muzikën, letërsinë, pikturën, arkitekturën popullore, artizanalet, zejet, pra asgjë. Asnjëri nga këta studiues dhe publicistë, pothuajse asnjëri, nuk i mësoi dy fjalë të gjuhës shqipe, qoftë për kureshtje, qoftë për të shfrytëzuar atë të paktë literaturë që mund të gjendet në këtë gjuhë. Madje, në kuadër të këtyre librave ndonjëherë do të gjeni shqetësimet dhe brengat e këtyre autorëve për problemet gjuhësore që ka Kosova në raport me gjuhën letrare dhe standardin shqip, por nuk do të gjeni qoftë edhe një referencë burimore për gjuhën shqipe të ndonjë albanologu ose linguisti shqiptar. Edhe me këtë rast do ta përsërisim zëshëm se dijet

shqiptare kanë mungesa të shumta, por në çështje gjuhësore është e pranuar botërisht se studimet albanologjike nuk qëndrojnë më poshtë se studimet e gjuhëve të tjera të Ballkanit.

Natyrisht që, në këto libra dhe botime për Kosovën, mungesat e literaturës burimore, sikundër edhe të vëzhgimeve empirike, është gjetur një mënyrë e përshtatshme që të kompensohen. Sjellja është tipike megalomane: nëse dijen për një çështje të caktuar nuk e ke bërë të njohur në gjuhën që e përdor unë dhe në formën e përshtatshme për mua, atëherë ajo dije nuk ekziston, sepse unë nuk di gjë për të. Kjo mënyrë e sjelljes së dikurshme e Europës kundrejt Ballkanit, njësoj sikundër edhe ndaj popujve të kolonizuar, ka zënë fill në shekuj më të hershëm dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite në përmasa më të gjëra. Prandaj ballkanasit është dashur të bëjnë garë, që të vërtetat e tyre historike dhe politike t'ia ofrojnë Europës mospërfillëse (por vendimmarrëse) në formën që do t'i dukej asaj më e përshtatshme.

Që këndeje zë fill një garë e shëmtuar e serbëve, ta zëmë, që "të vërtetën e tyre" për Kosovën ta dizajnojnë në formë sa më të përshtatshme për euoperëndimorët, pa i dhënë rëndësi aq shumë me këtë rast të vërtetës shkencore, sa faktit që e "vërteta e tyre" të jetë e arritshme njësoj si për historianin britanik, ashtu edhe për diplomatin francez, për studiuesin gjerman apo për publicistin italian. Në këtë pikë, në raport me shqiptarët, serbët kanë pasur përparësi të mëdha, ngase tashmë kishin arritur të zgjonin kureshtjen europiane që në fillim të shekullit XIX; ngase propagandën e kishin bërë dhe e kishin koordinuar që herët përmes institucioneve shtetërore; apo edhe për faktin se interesat e tyre në mënyrë ideale qenë përputhur me interesat e një fuqie të madhe, siç ka qenë dhe vazhdon të jetë Rusia (dhe

ndonjë tjetër aleate e saj), e cila në shumë raste kishte luajtur rolin e sponsorizuesit të hapur të interesave politike të Serbisë. Ironia qëndron pikërisht në faktin se një “e vërtetë” e sponsorizuar nga Rusia, e ambalazhuar dhe e dizajnuar në mënyrë të përshtatshme për sytë e perëndimorëve, përvetësohet pa asnjë rezervë dhe i jepet statusi i të vërtetës së pakontestueshme. Dhe kjo nuk ndodh as në kohën e largët të Paqes së Shën Stefanit apo të Kongresit të Berlinit, në kohën e turbullt të Luftës së Parë Botërore ose të traumave çrregulluese të “luftës së ftohtë”, por ndodh në vitin 2000, 2005, 2010, pra në një kohë krejt moderne dhe me qartësi të jashtëzakonshme argumentimi. Edhe në këtë kohë, pra, librat për Kosovën të gjitha mungesat autentike të vërtetimit empirik dhe të literaturës shkencore përpiqen t’i kompensojnë përmes literaturës njëburimore, në këtë rast serbe. Nuk ka libër për Kosovën, i botuar përgjatë dhjetë viteve të shkuara, i cili versionin serb të historisë së Kosovës, ndonjëherë me korrigjime të pakta dhe ndonjëherë pa to fare, nuk e merr si të mirëqenë.

Natyrisht, kjo nuk është vetëm grackë shkencore, e dijes, madje më së paku është e tillë, por në rend të parë është *grackë morale*: përse në një konflikt, siç ishte ai i Kosovës, një europaerëndimor u dashka t’i japë përparësi ose t’ia mbajë anën njërës palë? Nga vjen e drejta morale e një perëndimori për ta bërë këtë? Nga e krijon ai sigurinë se në këtë rast është duke vepruar “sipas të drejtës së Zotit”? Cilat dije ia sugjerojnë këtë? Edhe nëse ia sugjeron e drejta historike njëmijë vjeçare e njërës palë, a ia sugjeron e drejta historike dymijë vjeçare e palës tjetër? Fundja, kush ka të drejtë në këtë botë të marrë rolin e Perëndisë, dikë të shpërblejë dhe dikë të ndëshkojë për arsye që as Perëndia vetë mund t’i kuptojë? A është ky moral i krishterë, i cili qëndron në themelet e civilizimit european? A është ky

mësimi i doktrinės së shenjtë? A janë këto parimet, mbi të cilat është ndërtuar rendi botëror, ky i riu dhe ai i mëhershmi?

Pikërisht, a guxojmë të shkojmë një hap më tej në këtë analizë (pa marrë me vete një mallkim) dhe të themi se në themel të këtij qëndrimi të padrejtë qëndron pikërisht morali katolik dhe jo ai reformatör. Është morali katolik europian që ka ndëshkuar popuj të ndryshëm të botës dhe shqiptarët midis tyre. Me cilën logjikë, me cilën të drejtë? Me moralin se ai që ka sunduar një herë në këtë botë, ka të drejtë që ta bëjë këtë gjithherë. Se ai që ka qenë një herë zotëri, ka të drejtë që i tillë të jetë gjithmonë, përkundër atij tjetrit, i cili një herë ka qenë rob dhe i tillë mund të mbetet pafundësisht? Kjo është filozofia tradicionale e Europës katolike, e cila ndërtoi rendin e vjetër botëror. Në këtë rend botëror ne ishim të varfër dhe të tillë duhej të mbetnim. Në këtë rend botëror ne ishim robër dhe të tillë duhej të mbetnim. Në atë rend botëror ne ishim të pushtuar dhe të tillë duhej të mbetnim. Në atë rend botëror ne ishim skllevër dhe të tillë duhej të mbetnim. Në atë rend botëror ne ishim primitivë, të padenjë për liri dhe të tillë duhej të mbetnim.

Paragjykimet përmbi arsye

Pra, shkrimet për Kosovën, librat kryesisht, kishin një injorim permanent të *çështjes shqiptare* dhe një mbështetje të pakursyer të *çështjes serbe*. Shkrimet më pozitive dhe më të favorshme për Kosovën ishin të tillët që merrnin pozicion neutral, ndërkohë që të gjeje një mbështetje të plotë për çështjen shqiptare ishte pothuajse e pamundur. Edhe në shkrimet më pozitive në esencë nuk kontestoheshin asgjë serbe

për Kosovën, as historia, as trashëgimia kulturore dhe fetare, asgjë, vetëm se, si favor shqiptar merrej gjendja faktike, pra aktualiteti numerik i shqiptarëve, të cilët kishin arritur ta dominonin një hapësirë dhe ndryshimi eventual i kësaj gjendjeje binte ndesh me të gjitha parimet jo më të politikëbërjes, por edhe të civilizimit bashkëkohor. Ky ishte i vetmi favor që u bëhej shqiptarëve në trajtimin e çështjes së Kosovës. Nuk do të ketë as simpati elementare ndaj shqiptarëve të Kosovës, as ndaj shqiptarëve në përgjithësi. Do të ketë pak mëshirë dhe mirëkuptim dhe asgjë më shumë se kaq. Në të vërtetë, këto ndjenja të përziera pozitive do të jenë të pranishme në fillim, në vitet e para pas luftës, ndërsa më vonë, me kalimin e kohës edhe këto do të zhbëhen dhe vendin e mëshirës do ta zërë cinizmi, ndërsa vendin e mirëkuptimit do ta zërë refuzimi dhe tallja permanente.

Si duhet shpjeguar, pra, një situatë të këtillë? Pse ndodhi një zmbropsje kaq e shpejtë e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës, një pendesë e saj? Pse kosovarët u bënë kaq refuzues për bashkësinë ndërkombëtare, për Europën në rend të parë, sa që tani të ndodhë një mësymje gati masive kundër tyre? A është kjo pendesë e tyre për aktin e ndërhyrjes, apo një faj kryekëput kosovar? Çfarë bënë kosovarët që nuk duhej ta bënin? A e merituan ata këtë përkujdesje të botës? A ditën ta çmonin? A qenë mirënjohës sa duhej? Dhe, mbi të gjitha, pse kaq shpejt bota u kthye kundër tyre? Këto janë pyetje që i sillen nëpër mendje secilit kosovar dhe secili do të përpiqet të gjejë përgjigjen më bindëse dhe më të argumentuar.

Në të vërtetë, përgjigja më e shpejtë, që i rri më pranë pothuajse secilit prej nesh, ka të bëjë me Serbinë dhe me fenë. Pavarësisht se këto janë shpjegime të lehta, nuk mund të përjashtohen në mënyrë aq shpërfillëse, sepse shpesh

është në logjikën e gjërave, që përgjigjet e vështira të gjenden në gjërat më të thjeshta. Pra, duket sikur me ndërhyrjen në Kosovë bashkësia ndërkombëtare, në këtë rast veçmas Europa, e shtrënguar nga rrethanat dhe e nxitur nga SHBA-ja, bëri një "ekskursion" jashtë rregullave, kodeve dhe moralit të saj, në mënyrë që, për një kohë të shkurtër të kthehej përsëri atje ku kishte qenë: te pendesa e saj e thellë për ndërhyrjen në Kosovë. Serbia pat një ndikim të jashtëzakonshëm në një sjellje të këtillë rreth Kosovës. Por, si ishte e mundur që ajo të kishte një ndikim të tillë në një botë të madhe, ku interesat e popujve dhe shteteve shpesh nuk puqen mes veti...? Pse në këtë pikë, pra në pikën e mbështetjes së Serbisë dhe të refuzimit të Kosovës përputhen interesat e papërputhshme të shumë vendeve, të shumë shteteve dhe të shumë popujve të Europës? Ku qëndron enigma? A mund të lidhet kjo vetëm me trashëgiminë, me historinë, apo edhe me rrethanat e sotme politike në Europë?

Tani këto janë çështje të vështira dhe nuk do t'i zgjidhim aq lehtë as sot, as në të ardhmen, sepse, fundja, qëllimi ynë nuk është të bëjmë analiza për politikën e ngatërruar të botës, por do të përpiqemi të japim disa përgjigje, të cilat na kanë qëndruar pranë, por çuditërisht na janë dukur disi të fshehta. Do t'u kthehemi përsëri shkrimeve për Kosovën (librave, komenteve, analizave, intervistave) dhe atje do të gjejmë, diku të shfaqur haptas e diku të fshehur midis rreshtave, idetë fundamentale dhe të pandryshuara të diskursit europian për Kosovën. Në disa raste ato janë ide të avancuara, bashkëkohore, moderne, që prihen nga parime dhe vlera universale, nga një këndvështrim substancial humanitar dhe demokratik. Por, në raste të tjera shkrimet dhe observimet janë thellësisht recidiviste, ku nxjerrin krye ide të vjetra, ndonjëherë për kombin, ndonjëherë për fenë,

ndonjëherë për rendin botëror, madje ide që ndonjëherë përfundojnë në intolerancë dhe racizëm të hapur.

Por, pavarësisht nga kjo shumësi idesh dhe këndvështrimesh, a nuk ishte jokorrekte moralisht që mbi një Kosovë kaq të vogël, me kaq pak njerëz dhe me kaq shumë vuajtje, të sulen aq shumë vëzhgues dhe observues, të kalojnë çdo detaj të saj nëpër një skaner gjigant, me një monokël fantastik sipër, nëpër të cilin shikon e gjithë bota? A nuk ishte kjo e padrejtë? Pse ky vëzhgim dhe hulumtim kaq përimitues mbi një Kosovë kaq të vogël dhe pa brekë, ose me brekë të shqyera, e sapo dalë nga lufta, me plagë nëpër trup dhe në shpirt, e lodhur, e paushqyer, e paarsimuar dhe e paedukuar si duhet...? Pse ky vëzhgim kaq i detajuar dhe kaq dyshues për një Kosovë kaq të vogël? Ç'gjë e mistershme mund të fshihej brenda saj? Fundja, pse bota lodhej me aq shumë shkrime për një Kosovë të tillë? Ç'ishte ajo Kosovë? Asgjë. Dy milionë banorë të drobitur e të shkallmuar, ç'domethënie mund të kenë ata në një botë kaq të madhe?

Nga këndvështrimi i Kosovës, i njerëzve që jetonin dhe vuanin brenda saj, ishte e padrejtë kjo mësymje e botës për t'ia parë asaj me çdo kusht bythën jashtë. Nga këndvështrimi i njerëzve që bënë jetën e tyre në Kosovë ka qenë dhe vazhdon të jetë jashtëzakonisht e bezdisshme që dikush të rrijë gjithnjë matanë gardhit dhe të shikojë ditë e natë se çfarë bën ti në oborrin e shtëpisë tënde. Ose edhe më keq: të vërë syrin në një plasë dere dhe të shohë se çfarë bën ti në dhomën tënde të gjumit, në banjë, në ndonjë të ndarë tjetër, çfarë bën ditën dhe çfarë bën natën, çfarë bën me gruan dhe çfarë bën pa gruan, si fle, si ha, si hap me gojë, si mbyll sytë, si pirdhesh, si i fshin hundët. Nuk bëhet fjalë më për privatësi, bëhet fjalë për përfshirje detajesh, që nuk i hyjnë askujt në punë, sepse, fundja, të gjithë njerëzit e botës

nevojat biologjike i kryejnë njësoj ose ngjashëm, por më shumë bëhet fjalë për kërkimin dhe gjetjen me çdo kusht të detajeve të *flagrancës*. Të gjithë njerëzit e botës, kur hanë fasule, faqe me nder, lirojnë gazra. Përse, atëherë, kur duhej të pirdhej një kosovar, për observuesit e kujdesshëm të botës ky veprim duhej të kishte kuptim tjetër dhe të merrte konotacion politik, historik, fetar, kulturor, etnografik, civilizues, madje kuptime krejt të mjegullta konceptesh dhe idesh të konfliktit të civilizimeve, të luftës së botëve. Kosovari, me këtë rast, nuk u privua vetëm nga privatësia, nga e drejta e tij që të bëjë jetë normale, por u vendos nën një vëzhgim të padrejtë, cenues për lirinë e tij, cenues për dinjitetin e tij. Aq më tepër, kur dihej se ky vëzhgim nuk ishte pozitiv, se çfarëdo që të bënte ai, edhe nëse kishte sjellje të shkëlqyer, insistimi i vazhdueshëm në kërkim të *flagrancës* doemos që do ta nxirrte vëzhguesin atje ku ai e kishte synimin.

Në fillim, më pak gjatë operacioneve të luftës të viteve 1998 dhe 1999 dhe më shumë menjëherë pas kësaj periudhe, burra dhe gra të botës u futën në çdo pore të jetës kosovare. U futën nën tendat e refugjatëve dhe panë njerëz që nuk lahen e nuk ndërrohen, panë fëmijë pa përkujdesje, që pshurren në brekë dhe bëjnë nevojën e madhe një hap matanë tendës; panë burra që rrinë të menduar dhe pinë duhan, sikundër që panë edhe plaka që ofshajnë dhe rënkojnë, duke përmendur orë e çast emrin e Allahut. Kaq iu desh dikujt që të dilte e të thoshte se këta ngjajnë me fise aziatikësh, se ashtu e bëjnë jetën nën tenda, duke pjekur bukë ose fli nën saç, pamje këto që bota i kishte parë një herë te kurdët, tek irakianët, tek afganët, madje edhe te boshnjakët. Pra, këta qenkan njësoj! Ata nuk deshën të dinin se të vuajturit e botës, kudo që të jenë, i ngjajnë njëri-tjetrit, pavarësisht se çfarë feje kanë, çfarë trashëgimie dhe çfarë

filozofie jetësore. Nga mund ta dimë ne, si do të sillej dhe si do të dukej një europerëndimor, si i zhvendosur ose si refugjat, kur një të tillë nuk kemi pasur rast ta shohim asnjëherë. Bota tashmë e kishte krijuar stereotipin e të shpërngulurit, e të zhvendosurit, e refugjatit dhe u ngut që në atë skemë, në atë stereotip ta fuste dhe ta vendoste edhe kosovarin. Të gjithëve iu kujtohen dy pamje, të cilat e kanë qarkulluar botën cep më cep: masakra e Jasharajve në Prekaz dhe masakra e Reçakut. Që të dyja ishin pamje që nuk lënë askënd indiferent. Por edhe në këtë dhembje njerëzore, ku nuk do të duhej të kishte paragjykime, u përbiruan dy *stigma* recidiviste, të pashembullta për nga insistimi: pamja në sfond e të masakruarve të Jasharajve, të 54 vetave të një familjeje, burra, gra dhe fëmijë, shoqërohet me profilin e një hoxhe, të cilit i dridhet mjekra dhe një lot i rrëshqet faqes teposhtë. Po kaq të masakruar edhe në Reçak, të renditur ndër arkivole, do të vendosen në hapësirën e një xhamie, të xhamisë së fshatit. Natyrisht, as sot dhe as kurrë nuk mund të mohojmë se hoxha dhe xhamia kanë qenë pjesë të atij realiteti, por mbitheksimi i tyre në një rrethanë të tillë është fitore e dhimbshme e paragjykit mbi arsyen. Unë as sot e kësaj dite nuk e kuptoj, përse sajuesit perëndimorë të paragjykimeve janë kaq mizorë, kaq insistues, kaq të paskrupullt, të tillë që nuk marrin parasysh asnjë kufizim moral, vetëm që të arrijnë atë që synojnë.

Pastaj u krye lufta dhe po këta burra e gra, si punëtorë humanitarë të shoqatave dhe të fondacioneve të ndryshme, si reporterë e si gazetarë, si njerëz që kishin fituar besimin e madh të kosovarëve, u kthyen dhe u rikthyen bashkë me ta në Kosovën e djegur dhe të shkatërruar, panë atë që panë dhe regjistruan çdo detaj të sjelljes së tyre. Çfarë bënë, në të vërtetë, kosovarët në këtë rrethanë? Bënë atë që do të bënte çdokush pas një lufte të tillë. Ngarendën që të ktheheshin në

shtëpitë e veta, më shpejt dhe në mënyrë më masive se ç' do ta bënte shumëkush tjetër. Në këtë e sipër plaçkitën ndonjë gjë dhe vodhën ndonjë gjësend të vlefshëm, megjithëqë në Kosovë pak kishin mbetur gjëra të tilla, sepse serbët vendorë, si civilë ose të veshur si policë apo si paramilitarë, sikundër edhe vetë ushtria dhe policia e rregullt, pra që të gjithë pa përjashtim e kishin plaçkitur Kosovën deri në rrjepje.

Megjithatë, duhet pranuar se kosovarët në ditët e para pas luftës e vodhën njeri-tjetrin, ashtu siç bëjnë zakonisht të gjithë njerëzit e botës në një rrethanë të këtillë. Pastaj iu sulën atyre pak serbëve të mbetur dhe pasurisë së tyre. Disa syresh i vranë dhe dogjën një numër të konsiderueshëm shtëpish. Në shumicën e rasteve kjo ndodhi për hakmarrje, nga mllefi, por ndonjëherë edhe për interesa meskine, kryesisht pasurore. Ishte kjo gracka, pusia, në të cilën ishin pritur kosovarët prej muajsh. Këto *viktima të idealizuara*, që gjatë gjithë jetës së tyre kishin vuajtur dhe e kishin pësuar, që e dinin mirë se ç'kuptim kishte shtypja, urrejtja, dëbimi, vrasja, a thua si do të silleshin me kundërshtarët e vet pikërisht tani, kur kishin filluar ta merrnin veten, kur ishin në pozitë më të favorshme? Kjo i interesonte shumëkujt. A do të ishin në gjendje kosovarët të bënin jo atë që i nxit urrejtja e tyre, pasioni i tyre për hakmarrje, por atë që e kërkon bota, e cila kishte investuar kredibilitetin e saj, duke bërë një veprim të pashembullt të ndërhyrjes për parime morale? Së paku, kështu thoshte ajo.

Në të vërtetë, kosovarët nuk bënë asgjë që ishte kundër natyrës njerëzore. Është e njohur se viktima, kur merr forcë, në shumicën e rasteve hakmerret ndaj atij që i ka shkaktuar vuajtje. Është po ashtu e njohur se, në rrethana konfuze çfarë janë rrethanat e luftës, nuk mund të ketë një vijë të qartë diferencimi ndërmjet viktimës dhe kriminelit, sepse që të dy

marrin dhe japin ndërmjet veti. Këto janë gjëra që ndodhin dhe që janë të njohura në parim. Por, më anë tjetër, askush nuk u ndal ta shihte pak më qartë konstalacionin e situatës kosovare. Askush nuk desh t'ia dinte se cilat kishin qenë vuajtjet e këtyre njerëzve, sa monstruoze kishin qenë krimet, sa kishin zgjatur ato dhe çfarë kishte qenë pjesëmarrja serbe në krime dhe në fajësi për vuajtje. Është e vërtetë se në Kosovë u gjetën një numër personash serbë të vranë pa shkas. Natyrisht që këto ishin vrasje irracionale, madje nuk ishin as hakmarrje të zakonshme. Ishin vrasje nga pasioni, nga urrejtja, nga ndjenjat e ulëta. Të vrasësh të pafajshmin gjithnjë është kështu. Nuk do të shtrojmë këtu pyetjen se nga cilat motive dhe nga cilat ndjenja të parët serbët i vranë shqiptarët e Kosovës, por do të shtrojmë një pyetje pak të pazakontë, që harrohet vazhdimisht: Si u sollën serbët e Kosovës me fqinjët e tyre shqiptarë, para dhe gjatë luftës? Kur doni që të fillojmë? Nga historia më e hershme apo nga historia më e vonë? Nga cili vit? Nga vitet e largëta 1878-81, pak më të vona 1912-13; nga vitet që të gjallët jo të shumtë akoma i mbajnë mend 1944-45, 1953-56; apo nga vitet që i mbajmë mend pothuajse të gjithë, 1989-1999. Pra, kemi të bëjmë me një "tkurrje" brenda një tërësie të historisë, respektivisht të kujtesës kolektive dhe të realitetit flagrant. Mua nuk ka nevojë të më thotë njeri, ta zëmë, se raportet e mia me serbët i ngarkon kujtesa historike, i ngarkon historicizmi, i ngarkon memoria negative. Nëse këto raporte i ngarkon diçka, ai është realiteti, të cilin e kam parë dhe e kam përjetuar vetë. Unë i kam parë serbët e Kosovës se si të gjithë pa përjashtim vihen në anën e Milosheviqit. Përse ndonjëri syresh, nga ata që unë i kam njohur, që dikur punonin në "Jedinstvo", në institucionet e kulturës, që ishin shkrimtarë, gazetarë, piktorë, profesorë universiteti, përse qoftë edhe njëri prej tyre, një i vetëm, nuk doli të thoshte, që nga viti 1981 e prapa, se kjo mësymje ndaj shqiptarëve po

bëhet me tepri dhe është e padrejtë? Përse ndonjëri syresh nuk doli të thoshte më 1998-99 se nuk duhet vrarë shqiptarët e pafajshëm. Përse asnjëri, pothuajse asnjëri, gjatë luftës nuk doli t'í mbronte fqinjët e tij shqiptarë? Përkundrazi. Dihen aq shumë raste të pjesëmarrjes së fqinjëve serbë në vrasjen e fqinjëve shqiptarë. Çfarë deshën ata, realisht, nga shqiptarët? Pjesa më e madhe e tyre ishin kolonë, që jetonin në toka të uzurpuara, në çdo rrethanë ishin më të pasur se shqiptarët, kishin përkujdesjen e shtetit për çdo gjë, punësim, shkollim, infrastrukturë, pozita udhëheqëse. Në të vërtetë, ata, pra serbët e Kosovës ishin aq shovinistë të çmendur, sa që, kur bëhej fjalë për Kosovën, asgjë nuk u mjaftonte, përveç zhdukjes fizike të shqiptarëve dhe kjo, mundësisht, të bëhej në mënyrë sa më barbare.

Po shqiptarët a ishin engjëj? Natyrisht që jo, sepse në Ballkan nuk gjen dot të tillë. Mirëpo, ata nuk patën mundësi reale, nuk patën kohë të favorshme historike që të ushtronin gjenocid dhe dhunë sistematike mbi serbët. Koha e vetme, kur shqiptarët patën mundësi të hakmerreshin, shikuar historikisht, ishte periudha 1941-1944, kur Kosova u përfshi në të ashtuquajturën "Shqipëri e Madhe" e sajuar nga Fuqitë e Boshtit, nga Italia dhe Gjermania. Por edhe atëherë janë të njohura rastet e marrjes nën përkujdesje të serbëve nga ana e shqiptarëve. Raste të këtilla, ndonëse më të rralla, ka pasur edhe në vitin 1999. Për më tepër, nga radhët e kosovarëve ka pasur njerëz të dijes, me emra publikë, të cilët dolën dhe thanë zëshëm: Nuk duhet vrarë serbët e pafajshëm!

Mirëpo, bota nuk desh të dëgjonte më se çfarë thoshin kosovarët. Që nga momenti që disa shqiptarë të Kosovës ua kthyen pushkën serbëve të pafajshëm, bota nuk desh t'ia dinte më për ta. Ajo u fut në një shurdhësi argumentesh, ose thënë më mirë në një *refuzim irracional* të çfarëdo arsytimi që mund të shërbente si "mbulesë" për veprimet

hakmarrëse të kosovarëve. Unë as sot nuk e kuptoj përse për një pjesë të botës serbi kriminel është i tolerueshëm, i pranueshëm, madje deri-diku edhe i pëlqyeshëm, ndërsa shqiptari mund të pranohet dhe të pëlqehet vetëm si viktimë. Foto të serbëve tek vrasin dhe presin boshnjakë dhe shqiptarë kanë qarkulluar anë e kënd botës. Nuk them se janë pëlqyer ato foto, nuk them se dikush është mburrur me pamje të tilla, por duhet pranuar se në botën perëndimore nuk kanë marrë stigmatizimin e merituar, veçmas jo në Europën katolike dhe me sqimë civilizuese. Madje, për shkak të reagimit të vaktë, ndonjëherë mund të jetë krijuar përshtypja e gabuar se një kategori e perëndimorëve, ndërsa i shihnin serbët e tërbuar me thika dhe kallashnikovë ndër duar, si fshehurazi, që të mos e kuptonte askush, që të mos e kuptonte madje as ndërgjegjja e tyre, mund t'ia kenë shkelë syrin njëri-tjetrit në shenjë të një miratimi të heshtur. Kjo mund të quhet tepri, madje mund të quhet trillim irritues, sikur të mos ndodhte që pamjet, të cilat i tregonin kosovarët si luftëtarë pothuajse i çmenden ndërkombëtarët e zbarkuar në Kosovë.

Më kujtohet, pas demilitarizimit të UÇK-së, patrullat e KFOR-it dhe herë-herë edhe të policisë së UNMIK-ut iu patën vërsulur vitrinave të dyqaneve dhe çdo vendi tjetër, ku mund të ishin vënë foto dhe posterë të luftëtarëve me emblema të UÇK-së, kryesisht emra të shquar të rezistencës së armatosur. Urdhëronin të hiqeshin ato foto, e kur ndodhte që këtë nuk e bënte pronari, e bënë vetë ushtarët dhe policët, në ndonjë rast duke sharë dhe kërcënuar, në ndonjë rast tjetër duke i shqyer posterët dhe duke i shkelur me këmbë. Gjithsesi, kjo mund të quhej sjellje e gabuar e ekzekutuesve të urdhrave, por që ekzistonte një urdhër për t'i hequr ato foto, kjo nuk mund të kontestohet, ndërkohë që në enklavat serbe, aty ku KFOR-i përkujdesej për çdo gjë, jo

më fotot e Milosheviqit e Sheshelit që nuk u hoqën kurrë, por edhe të Arkanit, të Legias mund t'i shohësh edhe sot e kësaj dite.

Perceptimi i gabuar i lirisë

Të gjitha këto nuk desh t'i shihte askush më dhe askush nuk i shkroi në libra, analiza, komente, intervista etj. Askush nuk desh të dinte më se çfarë thonë kosovarët, sepse ata nuk ishin më ato viktimat e idealizuara, për të cilat bota kishte bërë ndërhyrjen e parë morale në historinë e saj. Mbështetësit e Kosovës nëpër botë, veçmas në Europë, u gjetën në një pozitë të keqe, sepse kundërshtarët e ndërhyrjes, agresivë që nga fillimi, tani e morën në dorë situatën. Nuk kishin nevojë t'i kërkonin argumentet atje ku nuk ishin. Kosovarët vetë ua nxorën përpara, ata vetëm duhej të thoshin: Ju kemi thënë, nuk ia vllente, ndërhyrja ka qenë e gabuar, nëse serbët ishin barbarë, këta janë edhe më të këqij. Pastaj vinin përshkrimet e gjata dhe të trishtueshme të situatave tragjike, ku kosovarët ishin kampionë të së keqes, vrasës, kriminelë, dhunues, shkatërrues monumentesh fetare dhe kulturore, barbarë, talibanë. Askush më nuk desh të bënte krahasime, t'i vinte në peshojë krimet e njërit dhe të tjetrit, barbaritë e njërit dhe të tjetrit, motivet e njërit dhe të tjetrit. As sot nuk arrij ta kuptoj përse për një perëndimor, për një njeri të asaj bote të madhe e të ditur, e cila për neve gjithmonë ka qenë pikë referimi për kulturë dhe civilizim, për demokraci dhe sistem vlerash, ka qenë ideal që ne e kemi ëndërruar si parajsë mbi tokë; pra, si ka mundësi që për njerëzit e një bote të tillë vrasja e një serbi mund të jetë më e keqe se vrasja e njëqind shqiptarëve; përse

djegia e një shtëpie serbe mund të jetë më e keqe se djegia e njëqind shtëpive shqiptare, përse dhunimi i një serbeje mund të jetë më e keqe se dhunimi i njëqind grave shqiptare. Unë e kuptoj, ta zëmë, përse në Europë dhe përgjithësisht në botën e krishterë djegia e një kishe nuk bën përshtypje të njëjtë me djegien e një xhamie, sepse bëhet fjalë për simbolin e një tradite të gjatë dhe akti i cenimit të këtij simboli prek edhe sentimentin e njerëzve. Fundja, mund të ndodhte dhe mund të gjente një fije arsyeje, që midis akteve të barbarisë ballkanike të vihej shenja e barazimit. Unë këtë e kuptoj dhe, në njëfarë mase e arsyejoj. Nga ajo që kanë parë, perëndimorët mund të thonë: Ballkanasit janë bisha, të gjithë njësoj! Por nuk e kuptoj idenë e vendosjes së shkallëzimit, të vendosjes së njërit mbi tjetrin, të rangimit të njërit mbi tjetrin, të serbit mbi shqiptarin, të serbit më lart se shqiptarit, sepse serbi vrau shqiptarin me idenë e shovinizmit dhe racizmit, ndërsa shqiptari e vrau serbin po me këto ide (ta zëmë!), plus për hakmarrje. Pas kësaj plobe, përse serbi u dashka të dalë i larë, ndërsa shqiptari duhet të vazhdojë të mbajë kryqin në shpinë? Ose, thënë ndryshe, përse stigmatizimi i Serbisë gradualisht duhet të nivelohet, duke ndërmarrë fushata të vazhdueshme të denigrimit të Kosovës dhe të kosovarëve? Madje, jo vetëm të nivelohet, por të dalë se perëndimorët bënë një gabim të pafalshëm që goditën Serbinë, sepse Kosova nuk e meritonte këtë, se kosovarët nuk e meritonin këtë ndërhyrje, se ata gjenetikisht janë kriminelë, terroristë, fundamentalistë islamikë, çdo gjë!

Të shumtë janë ata që mendojnë se këto fushata janë të nxitura dhe të financuara nga Serbia. Pa mëdyshje. Por, përse ato gjejnë kaq shumë të çara morale në botëkuptimin dhe botëvështrimin perëndimor, në filozofinë e tyre, në mënyrën e tyre të të kuptuarit të botës dhe të politikave të saj? Jashtëzakonisht shumë të çara morale te këta njerëz kaq

racionalë, kampionë të racionalizmit! Jashtëzakonisht shumë të çara morale të këta njerëz që kërkojnë të japin shembull të tolerancës, të humanitetit, të mendimit të lirë. Ne të gjithë e dimë se Serbia e ka parë shansin e saj pikërisht të këto të çara morale të perëndimorëve, më shumë të europianëve e më pak të amerikanëve, prandaj ajo është koncentruar të nxitja dhe financimi i këtyre fushatave, kryesisht në Bruksel dhe në metropolet europiane. Por, para se të ndodhte kjo dhe Serbia ta rifitonte betejën e humbur, ndeshja faktike ndodhi në Kosovë, aty ku ne ishim të pranishëm, ishim të tërë, në një kohë që bashkësia ndërkombëtare kishte këtu “ekspoziturat” e saj, kurse Serbia na mbante në një rrethim virtual.

Si ndodhi beteja finale dhe a u humb ajo nga kosovarët, kjo është pyetja që do të qëndrojë pezull për një kohë të gjatë dhe do të kërkojë përgjigje të vazhdueshme. Çfarë bëmë ne gabim, që nuk duhej ta bënim, që tani na u faturua si dështim, që duhet ta paguajmë në vazhdimësi...? Njërin nga këto gabime tashmë e përmendem: sulmi ndaj serbëve pas 12 qershorit 1999. Është fakt se kosovarët i vranë disa syresh. Është fakt po ashtu se, as në atë situatë, kosovarët nuk vranë ata që, mbase, e meritonin më shumë hakmarrjen dhe mllefin tonë, të tillë që i kishin duart me gjak. Të tillët nuk i zumë dot, sepse, derisa merreshim me uzurpime dhe grabitje të vogla e të mëdha, ata tashmë kishin përfunduar në Serbi, por edhe për faktin se nuk ishim aq heronj dhe aq trima të vdisim tashmë që liria ishte shfaqur në horizont. Prandaj, atyre nuk ua zumë rrugën askund. Prandaj, në ato ditë qershori, nuk ndërmorëm as ndonjë sulm në veri të Mitrovicës, kësaj radhe jo për të vranë serbë të pafajshëm, por për të vënë kontroll mbi territorin. Thënë ndryshe, ishte një dorëzim pa kushte i Kosovës ndaj bashkësisë ndërkombëtare, ndaj NATO-s, ndaj OKB-së. Dhe ky është

gabimi i dytë i madh që bëri Kosova, madje, po u vendos në kronologjinë e ngjarjeve, ky është gabimi i parë i madh i Kosovës, që do të prodhojë pasoja të jashtëzakonshme në krejt zhvillimet e mëvonshme.

Në të vërtetë, çfarë bënë kosovarët më 12 qershor 1999 dhe çfarë nuk duhej të bënin në atë ditë të lumnume? Ata ishin në trans dhe nuk i besonin tamam asaj që shihnin me sy. Ata kishin vuajtur gjatë dhe kishin ushqyer frikën e vazhdueshme se nuk do t'ia dilnin dot as kësaj radhe, se bashkësia ndërkombëtare do të përsëriste mënyrat e njohura të sjelljes: pak keqardhje, pak kompromis, pak trysni për përmirësim elementar të gjendjes, pra asgjë tamam. Kosova kishte një kujtesë të hidhur edhe me Serbinë, edhe me bashkësinë ndërkombëtare, ndonëse kësaj radhe gjërat kishin marrë një drejtim pak më ndryshe: ose të zgjidhjes përfundimtare, ose të dështimit përfundimtar. Edhe kosovari më i zakonshëm e dinte këtë, sikundër që e dinte se mundësitë për dështim kishin qenë po aq të afërta sa edhe gjasat për fitore. Prandaj, njerëzit ishin në trans, i kishte përfshirë euforia dhe në organizmin e tyre kishte shumë adrenalinë. Ishte e tepërt të kërkoje prej tyre të bëheshin racionalë, të mos bënin veprime të pamatura. Por nuk ishte vetëm kjo. Përveç lirisë së papërballueshme, para tyre shtrihej edhe një Kosovë pa pushtet, një *Kosovë e askujt*. Të gjithë e dinin se ajo ishte një gjendje kalimtare, por njëkohësisht të gjithë e dinin se në Kosovën e atyre ditëve mund t'i nxirrje nga thellësia e shpirtit pasionet më të fshehta. Mund të abuzoje me lirinë në mënyrën më të vrazhdët, mund të vrisje nga smira, mund të hakmerreshe nga pasioni, mund të bëje veprime të tilla, kryesisht të ulëta, që njerëzit zakonisht i bëjnë kur mbi ta nuk vepron asnjë pushtet dhe asnjë ligj. Kosova gjendej në një vakuum rendi dhe ligji, në vakuum institucional, pa polici, pa ruajtës të

rendit, pa përgjegjës për një institucion, për një veprimtari, për një rend, për një rregull të shkruar ose të pashkruar. Që atëherë ishte e qartë se kosovarët do ta kishin të vështirë me lirinë e tyre, ndoshta më të vështirë se çdo popull tjetër që kishte fituar lirinë, ndoshta po aq të vështirë sa ç'e kishin pasur në robëri. Dukej se robëria e gjatë ua kishte deformuar *kuptimin e lirisë*, ua kishte bërë më të pamundur perceptimin e saj të drejtë, ashtu siç e perceptojnë të gjithë popujt e lirë të botës.

Në një gjendje të këtillë Kosova e kaloi pothuajse tërë verën e vitit 1999. Nuk ishin vetëm serbët që e pësuan gjatë kësaj periudhe. E pësuan edhe shqiptarët, prona e tyre, pasuria e tyre. Këtë vakuum pushteti dikush mund ta ketë paguar me jetë, ndonjë nga ata që mund të jetë etiketuar si kolaboracionist. Të tillë mund të ketë qenë një numër, nuk e di sa, sepse kurrë nuk u tha ndonjë shifër. Por që ka pasur vrasje dhe plaçkitje, kjo nuk diskutohet. Por a ishte kjo një gjendje që dallon kosovarët nga njerëzit e tjerë të botës? Natyrisht që jo. Specifika e situatës qëndronte në disa detaje. Së pari, OKB-ja dhe bashkësia ndërkombëtare, duke qenë një organizëm inert dhe jashtëzakonisht i komplikuar, e vonoi zbarkimin në Kosovë dhe gjendjen pa pushtet e la më gjatë se ç'mund të ishte normale. Së dyti, rreth UÇK-së u krijua një situatë dualiste: asaj nuk iu njoh e drejta e vendosjes së pushtetit, por edhe demilitarizimi nuk u bë aq shpjegues, kështu që periudha tremujore ishte kohë e mjaftueshme që disa struktura të saj të degjeronin. Së treti, lufta kishte ndodhur në vetë territorin e Kosovës dhe ideja për plaçkë lufte, kushdo që mund ta ketë stisur i pari, ishte tërësisht e gabuar, sepse, në rrethanat e Kosovës, vetë vrisje, vetë vidhje; vetë ishe i vrarë, vetë ishe i vjedhur. Së katërti, ideja e strukturave udhëheqëse të UÇK-së, që bashkë me çlirimin e Kosovës të bëhej edhe një rebalancim social, kishte

elemente recidivistë të revolucioneve komuniste. Së pesti, patriotizmi kosovar, që u shpërfaq me një kthim të shpejtë në vatrën e veta, në shumë aspekte ishte “flakë kashtë”, jo vetëm pse u shua shpejt, por kishte brenda edhe motive të diskutueshme. Së gjashti, abstenimi i LDK-së, edhe nëse ishte e motivuar nga sjellja e saj e paqartë rreth luftës, pra edhe nëse ishte e detyruar nga rrethanat, ishte një *hakmarrje e heshtur* ndaj Kosovës, e cila së fundi nuk i kishte mbështetur tërësisht politikën e saj.

Të gjithë këta faktorë kishin rëndësi në këtë situatë, sepse disa syresh do të qëndrojnë në themel të zhvillimeve të mëvonshme dhe do të përcaktojnë raportet e ndërvetshme kosovare, sikundër edhe raportet me bashkësinë ndërkombëtare. Ta marrim vetëm faktorin LDK. Për vite me radhë LDK nuk do të shërohet nga kompleksi se në një çast vendimtar për Kosovën, në vitet e luftës, ajo nuk që në gjendje të merrte përsipër përgjegjësitë që tashmë i takonin. Sjellja refuzuese e LDK-së ndaj UÇK-së, njësoj si sjellja armiqësore e UÇK-së ndaj LDK-së, do të përcaktojë pothuajse të gjithë zhvillimet politike të faktorit të brendshëm në krejt periudhën pas vitit 1999, qoftë në raport me vendimet e rëndësishme që duheshin marrë, qoftë në raport me bashkësinë ndërkombëtare, e cila, përveç që kërkonte bashkëpunëtorin më të zellshëm dhe më kredibël, jo rrallë kishte nevojë për *kolaboracionistë* në kuptimin e plotë të fjalës. Në këtë sens, e shtyrë pikërisht nga motive ndonjëherë krejt të paqarta, ndonjëherë kundërshtuese ndaj palës rivale (UÇK-së), herë duke ndjekur traditën e vjetër të kooperativitetit me bashkësinë ndërkombëtare, por ndonjëherë vetëm për pozë, LDK-ja krijoi çarjen e parë të unitetit të faktorit shqiptar kundrejt bashkësisë ndërkombëtare.

Klithja e vitit 2004

Në të vërtetë, deri vonë as që ishte menduar se Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare mund të ishin rivalë në ndonjë çështje të caktuar, se mund të kishin pikëpamje të kundërta, se, madje, mund t'i kundërviheshin njëra-tjetrës. Rruga e realizimit të asaj që synonte bashkësia ndërkombëtare në Kosovë ishte e thjeshtë: së pari hidhej mbi tavolinë kërkesa e caktuar, ta zëmë, ndonjëri nga koncesionet e shumta që duhej bërë Serbisë, pastaj futej në lojë faktori politik vendor, LDK-ja do të pranonte e para, qoftë për faktin se ajo vazhdonte traditën e kooperativitetit me bashkësinë ndërkombëtare, por qoftë edhe për faktin se pala tjetër mund ta kundërshtonte; pastaj fillonin trysnitë dhe kërcënimet ndaj atyre që shfaqnin rezerva ose kundërshtime; pastaj përdroreshin miqtë e dëshmuar të Kosovës, në këtë rast SHBA-ja dhe njerëzit e saj në përfaqësinë diplomatike ose në strukturat e UNMIK-ut; pastaj pala që kundërshtonte duhej të zbuste qëndrimin, gjithnjë kështu, deri sa një ditë kosovarët me gjithë burrat e tyre të vyer, me gjithë partitë dhe organizmat e tyre, me gjithë shërbyesit e mëdhenj dhe të vegjël nuk u gjenden në pozitë absurde: e panë veten duke bërë garë se cili do të ishte më bashkëpunues dhe më i përkulur karshi kërkesave gjithnjë e më absurde të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo ishte *beteja e dytë e humbur* e Kosovës, që në ditët e para të lirisë së saj.

Por radha nuk u ndal këtu. Këta njerëz, nga bota e madhe, të cilët kishin zbarkuar në Kosovë dhe me të cilët kosovarët jo vetëm që duhej të bashkëpunonin, por edhe t'u jepnin rrugë zhvillimeve të ardhshme, a kishin një vizion të qartë se çfarë duhej të bënin me këtë vend? A ishin ata aq të ditur e të vyer dhe a kishin vullnet për të gjetur një zgjidhje?

Një numri syresh as që u interesonte se çfarë do bëhej me Kosovën pas pesë vjetësh, pas dhjetë vjetësh, sepse nuk kishin as mandat për një projekt të tillë afatgjatë. Ata shikonin të përmbyllnin kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në Kosovë me dy përfundime të pazgjidhura: që Kosova, ndërkohë, të mos kishte marrë asnjë atribut shtetëror më shumë se ç'i jepte Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, e para; dhe, e dyta, që në përballjen ndërkombëtare rreth Kosovës, ndërkohë, të mos kishte fituar asnjëra palë. Veçmas evropianët, që i referoheshin Brukselit, ishin tepër të kujdesshëm që opsioni amerikan për një shtetësi graduale të Kosovës të mos fitonte pikë. Shefat e tyre në Bruksel, pas rënies së Milosheviqit, kishin ngarendur njëri pas tjetrit në Beograd dhe ishin shprehur të penduar që kishin miratuar bombardimin e Serbisë më 1999. Vetëm britanikët dhe amerikanët nuk e bënë këtë asnjëherë, në asnjë rrethanë. Të tjerët radhazi. Dhe, doemos, kjo keqardhje duhej të prodhonte një efekt, i cili do të reflektohej në Kosovë, një herë hap pas hapi dhe, së fundi, edhe në zgjidhjen përfundimtare.

Krahas gjithë kësaj situatë, në Kosovë kishte filluar një shtresëzim i ri i kundërthënive të brendshme. Ishte e qartë se Kosova, pas një qëndrimi pezull të një periudhe pesëvjeçare, duhej të merrte një zgjidhje, vetëm se bashkësia ndërkombëtare, kryesisht evropianët, zgjidhjen e kishin çuar në drejtim të gabuar, në drejtim të afrimit të Kosovës me Serbinë, në drejtim të një rikthimi të mundshëm të Serbisë në Kosovë. Koncesionet që shefat e UNMIK-ut ia bënë Serbisë, duhej të çonin pikërisht në zgjidhjen e statusit të Kosovës sipas diktatit të Serbisë. Beogradi filloi të pyetej për çdo gjë që ndodhte dhe për çdo gjë që duhej bërë në Kosovë. Mungonte vetëm një legalizim formal, një deklaratë politike e Brukselit dhe Nju-Jorkut, pastaj një zhvendosje e shpejtë e

zyrave qendrore të UNMIK-ut në Beograd dhe statusi i Kosovës do të thuhet se buron jo nga e drejta e vetëvendosjes, por nga e drejta e qeverisjes autonome.

Edhe NATO-ja ishte aty, që ta pacifizonte çdo rebelim të mundshëm, sepse mandati i saj ishte të zbatonte vendimet politike. Më 2004, NATO-ja e dëshmoi se pa ndonjë ngurrim të madh mund të vepronte kundër kosovarëve, se mund t'i vriste ata pa u brengosur. Me atë rast gjithashtu u dëshmuua se Aleanca Veriatlantike, e cila një herë e kishte çliruar Kosovën nga Serbia, nën tryshninë politike të Brukselit, tani kishte ndryshuar pozicion: ajo do të mbronte vetveten, administratën ndërkombëtare, enklavat serbe, përfshirë edhe zonën më të gjerë të veriut të Kosovës, ndërsa ndaj shqiptarëve dukej se do të hakmerrej për një mllef që nuk dihej nga i vinte. Sjelljet e trupave të KFOR-it në mars të vitit 2004 nuk ishin të paanshme, nuk ishin të balancuara, ishin antishqiptare. Askush nuk e vinte në dyshim nevojën e mbrojtjes së serbëve nga një çmenduri eventuale shqiptare, por që kjo çmenduri të mos ndodhte, ishte i nevojshëm një veprim pararendës dhe parandalues i forcave të sigurisë, i policisë së UNMIK-ut dhe i trupave të KFOR-it. Tashmë nuk bëhej fjalë për provokime të vazhdueshme të serbëve ndaj shqiptarëve, që ata i bënin nën mbrojtjen e KFOR-it, por për veprime që shkonin në drejtim të dominimit të situatës në Kosovë: serbët ende mund të vritnin shqiptarë dhe të fshiheshin nën mbrojtjen e KFOR-it, ose të bllokonin rrugët dhe arteriet kryesore të komunikimit, përsëri nën mbrojtjen e KFOR-it dhe të UNMIK-ut.

Kjo mund të quhet rrethanë reale, ndërkohë që askush nuk do ta marrë vesh ndonjëherë se kush i organizoi tamam trazirat e marsit të vitit 2004, shërbimet e huaja sekrete, ata që e donin pavarësinë e Kosovës apo ata që e donin Kosovën nën Serbi, vetë Serbia me praninë e saj të fshehtë

(me para dhe me spiunë), strukturat e pakënaqura dhe të radikalizuara të ish-UÇK-së, ndonjë organizatë islamike, pra ishte një paqartësi e jashtëzakonshme e faktorëve të implikuar në ato ngjarje. Ishte e mundur që mllefi i shqiptarëve të ishte spontan, i diktuar nga një situatë pa shtegdalje, por që ky mllef pastaj u shfrytëzua për veprime irracionale, për këtë nuk ka asnjë dyshim. Realisht ishte një *çoroditje e kosovarëve*, e tillë perceptohej qoftë nga të huajt, qoftë nga vetë shqiptarët e Kosovës. Analizat politike nuk do nxjerrin asnjë përfundim të vlershëm. Më anë tjetër, nga këto ndodhi të gjithë do të krijojnë argumentet e tyre, por imazhi i Kosovës përfundimisht do të marrë rrokullimën, një teposhtë të pandalshme, që do të reflektohet drejtpërdrejtë në statusin e saj, respektivisht të mënyrën sesi mund të implementohej ky status.

Piketat e planit të Ahtisaarit do të vihen në vitin 2004, një *pavarësi e mbikëqyrur*, në esencë fyese për kosovarët, sepse konteksti i mbikëqyrjes do të jetë pohimi i zëshëm i europianëve: ata nuk e meritojnë pavarësinë, por nuk ekziston një zgjidhje tjetër më e mirë. Pastaj decentralizimi, që do të ketë kuptimin e jofunksionalitetit të shtetit. Pastaj dera e hapur e Serbisë që çdoherë të ndërhyjë në Kosovë, përmes lidhjeve të veçanta të komunave serbe ndër veti dhe me Serbinë njëkohësisht. Pastaj edhe zonat e sigurisë përreth objekteve të kultit dhe të trashëgimisë kulturore serbe. Pra, ideja e pavarësisë së Kosovës do të deformohet dhe do të degjenerojë në një zgjidhje pa asnjë kuptim, që zakonisht nuk e kanë shtetet sovraane. Vetë kosovarët, me ngjarjet e vitit 2004, do të vihen në anën e zgjidhjeve të pafavorshme për Kosovën, sepse do t'i krijojnë alibinë faktorit ndërkombëtar të ndërmarrë masa të njëanshme. Në këtë e sipër, Kosova defaktorizohet dhe merr atributet e një *Zululandi*, një vend pa vlera civilizuese, i padenjë,

mosmirënjohës. Marrë në përgjithësi, Serbia dhe ajo pjesë e penduar e bashkësisë ndërkombëtare kishin pasur nevojë pikërisht për këtë imazh të përmbysur të Kosovës, në mënyrë që, ndër të tjera, të krijonin edhe një siguri se Kosova, edhe në këto rrethana, apo të ndonjë rrethane të një konflikti të përmasave më të mëdha, mund të kontrollohej me dhunë. Ky ishte një test, se statusi i Kosovës, sido që të zgjidhej, do të implementohej pa ndonjë konsideratë për parimet e kryehershme të lirisë dhe të humanitetit, apo të vullnetit të lirë të qytetarëve të Kosovës. Edhe njëra, edhe tjetra nuk kishin më asnjë vlerë.

Krijimi i identitetit mercenar

Pas ngjarjeve të shëmtuara të vitit 2004, në Kosovë dhe rreth saj u krijua një situatë paradoksale. Vetë Kosova e pranoi përgjegjësinë për ndodhitë dhe u squll, u gjend disi e turpëruar, pa guxuar as të thoshte se shkaktar i kësaj situatë ishte një si tradhti e bashkësisë ndërkombëtare, e cila me dredhi kishte filluar ta projektonte krejt qartë Kosovën në kuadër të Serbisë. Kosova, establismenti i saj politik dhe opinioni nuk thanë gjë as për statusin, sepse forcat politike në Kosovë tashmë kishin krijuar idenë se qëndrimi pezull ishte gjendje normale. Askush nuk merrte përgjegjësi për asgjë. Madje edhe në ata sektorë, ku përgjegjësitë kishin kaluar te vendorët, si në fushën e arsimit, të kulturës, apo edhe në ndonjë sektor tjetër, gjendja ishte e mjerueshme. Nën përkujdesjen e OKB-së, pra të UNMIK-ut, gjithandëj kishte filluar të krijohet një administratë krejtësisht joprofesionale, e cila të vetmen vlerë matëse e kishte lojalitetin ndaj shefave të huaj. Ishte një lloj "përshtatshmërie

moralo-politike” që aplikohej me rastin e punësimit dhe të trajnimit të kësaj administrate. Përveç lojalitetit, kërkohej ose ishte i preferuar një identitet i paformësuar, i shkapërderdhur, gjithsesi sa më pak shqiptar dhe sa më shumë multietnik, diçka si *hibridë anacionalë*, të tillë që tashmë kishte filluar t’i krijonte me shumicë e ashtuquajtura shoqëri civile në Kosovë.

Në të vërtetë, që nga vitit 1999, në emër të tolerancës dhe të frymës integruese, në Kosovë kishte filluar eksperimenti i madh i krijimit të një shoqërie pa identitet nacional. Në dukje të parë, tejkalimi i identitetit duhej të sillte një frymë të re në Ballkan, sepse nga perëndimorët konsiderohej se identitetet nacionale në gadishullin konfliktor ishin një nga shkaqet e luftërave dhe tragjedi që kishin ndodhur. Mënyra e kërkuar dhe e gjetur për t’i tejkeluar identitetet nacionale, në rastin e Kosovës, ishte e pashembullt: një metodë recidiviste e kohës së vëllazërim-bashkimit të ish-Jugosllavisë, pa i hequr dhe pa i shtuar asaj asnjë detaj, vetëm duke bërë një riemërim: në vend të vëllazërim-bashkimit, tani gjetja quhej *tolerancë multietnike*. Pra, njësoj si në kohën e jugosllavizmës, ata që duhej të hiqnin dorë nga identiteti dhe të bëheshin “zemërgjerë” në cilindo ballafaqim nacional, ishin shqiptarët. Shqiptari që fliste serbokroatisht në shtëpi, që i çonte fëmijët në shkollën serbe, që e kalonte ditën duke folur serbisht, që lexonte libra serbisht, ai quhej shqiptari model, që e kishte përqafuar tamam vëllazërim-bashkimin. Në rrethanat e reja *shqiptari model* ishte ai që nuk e theksonte përkatësinë e tij shqiptare, që fliste sadopak anglisht, që kishte afinitet ndaj serbëve, madje, nëse kishte një origjinë të përzier shqiptaro-sllave, ose sllavo-shqiptare ishte një ekzemplar jashtëzakonisht i kërkuar dhe i dëshiruar. Shqiptari model nuk duhej të thoshte se Serbia kishte ushtruar gjenocid në Kosovë, se

lufta me Serbinë nuk kishte qenë luftë, por një konflikt ndëretnik, se Serbia si shtet dhe si popull nuk mbante asnjë përgjegjësi për atë që kishte ndodhur në Kosovë, por përgjegjës ishte vetëm regjimi i Milosheviqit, se nga konflikti e kishin pësuar njësoj, si shqiptarët, si serbët. Nëse doje të bëheshe shqiptar model, nuk duhej të thoshe se serbët kishin qenë ata që i kishin bërë krimet, ndërsa shqiptarët kishin qenë viktima. Duhej të thoshe se të dyja palët e kishin pësuar njësoj. Kjo trushpërlarje e shqiptarëve synonte të shkonte deri atje, ku nuk kishte arritur të shkonte as komunizmi dhe socializmi me internacionalizmin proletar: të ndryshonte dhe të korrigjonte historinë, veçmas atë të teksteve shkollore, në mënyrë që shqiptari i gjeneratave të ardhshme në Kosovë të mos kishte *kujtesë historike*, të ishte i lirë nga të gjitha “paragjykimet” dhe i gatshëm që serish të integrohej në Serbi. Unë as sot nuk e kuptoj, përse vetëm identiteti nacional i shqiptarëve ishte problematik. Nuk ishte problematik identiteti serb, i cili kishte prodhuar jo më nacionalizëm dhe jotolerancë, por shovinizëm ekstrem. Mund të mos ishte problematik, ta zëmë, identiteti boshnjak, ose rom, ose ashkali, por nuk mund të mos ishte problematik identiteti serb, të cilit nuk i duhej asnjë veshje e re, por vetëm i tillë siç kishte qenë, kishte dhënë dëshmi pa fund të ekstremizmit.

Por tani, njësoj si në kohën e vëllazërim-bashkimit, metoda e trushpërlarjes, pasi gjendeshin ekzemplarët e përshtatshëm, shkonte përmes joshjes dhe privilegjeve. Çuditërisht, ekzemplarë më të shumtë, të rekrutuar nga fondacionet e ndryshme, ishin të po asaj provenience shoqërore, të diferencuar që më parë në Kosovë si trashëgimtarë ideologjikë dhe biologjikë të jugosllavizmës. Të mësuar dhe të dëshiruar pas privilegjeve, ata do të jenë të gatshëm për të gjitha kompromiset, përfshirë këtu edhe

zhbërjen identitare, mjafton që si kompensim për këtë mund të siguronin një status të privilegjuar shoqëror dhe një rehati ekonomike dhe financiare. Shumë shpejt, duke shitur ideale, më shumë duke improvizuar diçka të tillë, sepse ideale të vërteta rreth kombit dhe atdheut ata nuk kanë pasur kurrë; duke manipuluar ide avangarde në sytë e ndërkombëtarëve, më shumë duke marrë poza intelektuale karshi mediokërve të krejt botës të mbledhur në kafenetë dhe restorantet e Prishtinës; duke aktruar elitën politike-intelektuale, ndonëse kurrë nuk do të bëhen të tillë në Kosovë, sepse, sa herë që do të dalin nga shoqëria civile dhe do ta provojnë garën politike, do të pësojnë fiasko të pashembullt; pra, të tillë u bënë shumë shpejt një klasë e privilegjuar e Kosovës, shfrytëzues fondacionesh, parazitë të pashembullt, ripërtpës të ideve më të shëmtuara, por njëkohësisht mbështetësit më të zjarrtë të tolerancës ndëretnike, hartues dhe implemetues të projekteve të bashkëpunimit me serbët dhe me Serbinë, mbështetës të mëdhenj të integritimeve europiane dhe kundërshtarë të heshtur ose të fshehtë të integritimeve shqiptare.

Nuk është aspak e çuditshme pse këta eksponentë të multietnicitetit, të lojalitetit ndaj ndërkombëtarëve, trashëgimtarë të jugosllvizmës së dikurshme, tani ishin përkrahës dhe mbështetës të flaktë të *kosovarizmës*, madje mund të quhen ideologë të saj. Ata, madje, e donin Kosovën shtet, e donin Kosovën e pavarur, por gjithmonë të tillë, për aq sa ajo iu shërbente atyre. Ata kurrë nuk dolën jashtë disa kafeneve dhe restoranteve të Prishtinës, që të shihnin dhe të njihnin Kosovën e vërtetë, atë me probleme të mëdha sociale dhe ekonomike, Kosovën e frustruar nga zhgënjimi i madh. Projektet e tyre të shoqërisë civile, tek shpenzonin para të mëdha të fondacioneve të huaja, merreshin me gjepura multietnike, të cilave askush nuk ua vinte veshin, përveç

atyre që vetë përfitonin prej tyre. Ta zëmë, bënin takime me ndonjë shkas, bashkë me ndërkombëtarët, në Muzeun Etnografik, ose në Muzeun e Kosovës, ku ambienti me ekspozate muzeore shërbente si dekor për orgjitë e tyre, të cilat fillonin me të ngrënë të flijave tradicionale dhe përfundonin me ndeja të fshehta grupore nëpër banesë e shtëpi, ku Kosova përjetonte zhburrimin dhe çmoralizimin më të madh. Kosova ishte *kuadër i kuroërisë dhe prostitucionit intelektual* më të paguar në historinë e saj. Më anë tjetër, sekush shpikte dhe trillonte performanca teatrore, instilacione, botime dhe të tjera improvizime, me subjekte të rivendosjes së harmonisë në marrëdhëniet shqiptaro-serbe, të cilat realisht nxitnin kureshtjen e askujt, vetëm se mashtronin donatorët dhe krijonin në medie idenë e një Kosove me identitet të moderuar, pra një Kosovë që ikte nga vetja e saj, që në të vërtetë ishte një gënjeshtër me damkë, por një gënjeshtër e paguar mirë.

Ishin po këta eksponentë të multietnicitetit, të cilët hodhën tezën e hibriditetit identitar të Kosovës. Që në krye të herës, ata vunë në dyshim të gjitha lidhjet kulturore të Kosovës me Shqipërinë, duke goditur boshtin kryesor të këtyre lidhjeve, pra gjuhën letrare. Është pak e çuditshme sesi gjuha, një çështje që nuk lidhet askund me demokratizimin e shoqërisë, me të cilin kryesisht duhej të merrej shoqëria civile, u bë objekt i interesimit të kësaj proveniencë. Eksponentët e shoqërisë civile u ngutën të futnin në përdorim publik të folmen lokale, duke u përpjekur t'i japin asaj përdorim sa më të gjerë, një punë që nuk kishin përse ta bënin, jo vetëm pse nuk u takonte atyre, por në Kosovën që vuante mungesat elementare në të gjitha fushat, spikatja e çështjes gjuhësore ishte një ekzagjerim i pashembullt. Më pas, po me kaq jokompetencë, u hodh në "tregun e diskutimeve" çështja e identitetit kosovar, të gjitha

këto me një qëllim të vetëm: që Kosova të përgatitej për një zgjidhje politike të pafavorshme, hibride, që do të përfshinte një qëndrim ndërmjet, pra as Shqipëri, as Serbi.

Kosovari i zakonshëm gjatë gjithë kësaj kohe do të gjendet larg të gjitha mundësive për të kuptuar përse procesi politik i zgjidhjes së statusit të Kosovës kishte mbetur pezull. Ai nuk do të arrijë ta kuptojë se një betejë politike e stërzgatur nuk zhvillohej vetëm në kancelaritë diplomatike të fuqive vendimmarrëse, larg syve dhe mundësive të tij për ta parë, por një betejë akoma më e rëndësishme zhvillohej në afërsi të tij. Kjo betejë duhej ta fillonte ndryshimin e qenies kosovare, në mënyrë që zgjidhjet politike të pafavorshme të zinin vend, të gjenin mbështetje, të akomodoheshin në rrethanat dhe në mentalitetin kosovar. Kjo nuk ishte e lehtë të bëhej, sepse kosovari ishte konservativ në pikëpamje dhe nuk pranonte të ndryshonte aq lehtë mentalitetin politik dhe idealet e kryehershme. Prandaj beteja duhej të zhvillohej në shumë fronte njëherësh. Shoqëria civile e kishte zhvilluar betejën kryesisht në frontin medial, aty ku aderonte ose kishte qasje një pjesë e shoqërisë kosovare, e cila nuk përbënte shumicën, por nuk ishte pa ndikim në jetën publike të Kosovës. Kjo shoqëri civile (mbase nuk ishte e tillë, por emër të tillë i kishin vënë) kishte arritur ta deformonte çështjen politike të Kosovës përmes çështjes së identitetit, e cila deri në vitet e para të shekullit XXI kishte qenë kristalisht e pastër. Ajo tashmë e kishte përgatitur terrenin që Kosova në asnjë rrethanë të mos bëhej Shqipëri, pra nga agjenda politike të përjashtohej opsioni i *bashkimit* ose i *bashkëngjitjes*. Me t'u hequr ky opsion, të gjitha zgjidhjet e tjera ishin të akceptueshme. Dhe deri në këtë pikë Kosova ishte çuar ose po çohej përmes një mashtrimi kapital, siç ishte gjoja paqartësia e saj rreth identitetit. Në të vërtetë, të gjithë e dinin se kjo paqartësi nuk ekzistonte, por ajo ishte trilluar, ishte

stisur, në të shumtën e rasteve përmes gënjeshtreve publike dhe mashtrimeve ordinere. Kjo ishte tradhtia e radhës që po i bëhej Kosovës, një tradhti përmes një dredhie tepër të hollë që të merrej vesh nga populli, i cili mund të reagoje në mënyrë radikale. Kosova e pavarur, shtet sovran, mund të ishte opsion për një zgjidhje politike të përhershme ose të përkohshme, varësisht nga rrethanat. Por Kosova me identitet të ndryshuar nënkupton tërheqjen me vete të një zgjidhjeje politike të përhershme, të pandryshuar, një testament që i lihej në dorë Serbisë, si kompensim moral për humbjen e saj të Kosovës. Kosova e pavarur mund të ishte kompromis i përkohshëm, të cilin e kërkonin rrethanat momentale, por Kosova me identitet joshqiptar do të lidhej përjetësisht sa me Shqipërinë, po aq me Serbinë, gjithmonë duke i krijuar mundësi Serbisë që ta ushtrojë ndikimin e saj në Kosovë dhe, që nga dita e parë, ta bëjë Kosovën shtet jofunksional. Një Kosovë e tillë me identitet të ndryshuar, që domethënë pa identitet, i duhej Serbisë, mund t' u duhej edhe evropianëve, për ta zhvilluar me sukses procesin e pacifizimit të Ballkanit, por nuk iu duhej shqiptarëve, të cilët *duhej të humbnin Kosovën për të fituar kosovarizmin*. Kosovarizma nuk mund të kishte kuptim tjetër, përveç se një koncesion që mund t'i bëhej Serbisë për hatërmбетjen e saj. Identiteti kosovar ishte *identitet mercenar*, i paguar me para në dorë ose me shërbime të tjera.

Shitja e idealeve

Por gjithsesi, fronti me çkurajues, ku zhvillohej beteja për statusin e Kosovës, për kosovarin e zakonshëm ishte shtrëngesa ekonomike. Ashtu sikundër mund të pritej, pas

vitit 1999 në Kosovë pushuan të gjitha aktivitetet ekonomike. Edhe ashtu dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, Kosova e kishte kaluar në kushtet e rënda të një vetëmbajtjeje, e cila shkonte deri në kufijtë e mjerimit social. Serbia kishte marrë çdo gjë që mund të vlente në Kosovë, por kishte lënë ato kapacitete prodhuese që nuk mund të nxirrnin ndonjë profit. Pas vendosjes së administratës ndërkombëtare, puna e parë më e rëndësishme që u bë në fushën e ekonomisë, ishte shkatërrimi i këtyre kapaciteteve prodhuese, në emër të njëfarë reforme, e cila i qe besuar Bashkimit European, por që udhëhiqej nga njerëz shumë kontraverz, madje edhe me precedent penal në vendet prej nga vinin. Për shkak të statusit të papërcaktuar të Kosovës, ata e vonuan aq sa munden procesin e privatizimit, duke bërë që objektet ekonomike të degradonin edhe më shumë. Prioritet i tyre ishte telekomunikacioni dhe energjetika, aty ku zhvatja ishte e lehtë dhe e shpejtë.

Më anë tjetër, Kosova kishte shpenzuar shumë para për rindërtim, para të vetat, kursime ose të ardhurat nga diaspora. Ndihamat për rindërtim, edhe përkundër zhurmës së madhe, kishin qenë të kufizuara dhe jofunksionale. Ishte gjë që dihej se, pas kësaj faze, pas rindërtimit emergjent dhe pas pezullimit të të gjitha aktiviteteve ekonomike, do të vinte faza e gjendjes së rëndë sociale. Kosova kishte mbijetuar ekonomikisht me anë të dërgesave të diasporës dhe me ekonomitë e vogla familjare. Që të dy këta burime kishin shteruar, kështu që koha e ardhjes së krizës ishte matur saktësisht dhe përputhej me zhvillimet e tjera të trazuara të vitit 2004. Mungesa e buxhetit për shkak të mosfunksionimit të sistemit të taksave, evazionit fiskal, sistemit të pakonsoliduar doganor etj., të gjitha këto bënë që Kosova të mos mund të krijonte një skemë efikase të solidaritetit social, por, në mungesë të kësaj, ndërtoi skemën

e mjerimit dhe të diferencave sociale tejet të rrezikshme, madje shpërthyes. Korrupsioni, kontrabanda dhe trafiqet e ndryshme u mbështeten fuqishëm nga faktori ndërkombëtar. Kjo rrethanë, njësoj sikundër shpërndarja krejtësisht e gabuar e parasë publike, krijoi një klasë shoqërore të privilegjuar, ku, ndër të tjerë, hynin edhe njerëzit e politikës, vendorë dhe të huaj. Në të vërtetë, të huajt e dinin se në Kosovë tashmë kishte filluar të vidhej çdo gjë. Të huajt, ata që jepnin urdhra nga lart, gjithashtu e dinin se segmente të caktuara të politikës dhe të administratës ndërkombëtare ishin të lidhura fort me kontrabandën dhe krimin e organizuar. Të gjitha këto i toleruan, qoftë për shkak se edhe vetë ishin pjesë e kësaj loje, qoftë edhe për një arsye tjetër: Ishte kjo një si strategji e shkatërrimit ekonomik dhe e varfërimit të skajshëm të Kosovës. Ishte njëkohësisht edhe skemë e përpunuar e krijimit të një ambienti shoqëror dhe politik të degraduar.

Sikundër mund të pritej, pasojat e kësaj gjendjeje, në aspektin politik ishin shumëplanësh. E para, mjerimi social krijonte ambient të përshtatshëm për shpërthime të natyrës së marsit të vitit 2004, që domethënë se Kosova edhe më tej i dërgonte mesazhe të ngatërruara bashkësisë ndërkombëtare, mbi të gjitha si një vend i trazuar, që ende duhej mbajtur nën një kontroll dhe monitorim të fuqishëm. Kjo situatë ia zgjaste afatin misionit të UNMIK-ut në Kosovë, pra në këtë mënyrë realizohej një interes i spekulantëve të mëdhenj me misionet e këtilla të OKB-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, përfshirë edhe ato me seli në Bruksel. Së dyti, një mjerim ekonomik dhe social e zhvlerësonte në mënyrë të tmerrshme kuptimin e idealeve të lirisë. Kjo kishte rëndësi për t'i pacifizuar idealistët e paemancipuar. Së treti, krijimi i modelit të keq të qeverisjes edhe në ata sektorë, ku kompetencat e vendorëve

ishin të plota, kishte kuptimin e statusit të Kosovës si zgjidhje pa ndonjë vlerë. Pra, keqqeverisja dhe abuzimi me pushtetin, që kosovarët mund ta kenë ditur, por që më së miri e njohën përmes administratës ndërkombëtare, popullit të Kosovë i dërgonte mesazh të bërjes së një shteti të keq, të cilin nuk do ta dëshironte askush. Ndërkombëtarët ishin në dijeni të keqqeverisjes dhe të abuzimit me pushtetin, por nuk ndërmerrnin asgjë për ta ndryshuar gjendjen. Së katërti, mjerimi social, diferencat sociale dhe të gjitha dukuritë që shkojnë më këto, duhej t'ua bënin me dije kosovarëve se shteti i tyre, të cilin ata mund ta synonin, nuk mund të bëhej pa një mbikëqyrje ndërkombëtare. Së pesti, një shtet pa perspektivë, me një ekonomi të pazhvilluar dhe me një gjendje të keqe sociale mund të manipulohej dhe të detyrohej për çfarëdo koncesioni politik, por, mbi të gjitha, në këtë mënyrë i krijohet hapësirë e përshtatshme Serbisë për ta dominuar Kosovën si treg dhe si ekonomi dhe, bashkë me këtë, edhe si politikë. Ekonomisë informale, tregtisë pa dogana dhe përgjithësisht kontrabandës menjëherë pas luftës iu krijuan kushte shumë të favorshme për lidhje të pashkëputshme me Serbinë. Më anë tjetër, edhe sikur të ekzistonte vullneti politik për një zgjidhje të shpejtë të çështjes së veriut të Kosovës, kjo nuk do të ndodhte, për shkak të favoreve ekonomike që iu sillte kontrabanda dhe krimi i organizuar të gjitha palëve të implikuara, si eksponentëve të veçantë të bashkësisë ndërkombëtare, si shtetit të Serbisë dhe krerëve të saj politikë, po ashtu edhe pushtetarëve të Kosovës, atyre drejtpërdrejtë ose bizneseve të lidhur me ta.

Me ekonominë, me paranë, lidhet edhe një fenomen tjetër, i cili ndodhi në Kosovë që në ditët e para të pasluftës dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Në lëvizjen çlirimtare të Kosovës, njësoj si në UÇK dhe në segmente të ndryshme të

organizimit politik u rekrutuan shumë njerëz, të cilët as që supozohej se mund të kontrolloheshin nga strukturat që u përkitnin. Por, mbi të gjitha, një nga problemet e mëdha të UÇK-së qëndronte te koncepti i luftës çlirimtare, e cila nga disa ideologë të saj ishte perceptuar edhe si *revolucion social*, por pa elemente të drejtësisë sociale. Nuk është e nevojshme të stigmatizohet njeri për këtë shkarje ideologjike, sepse deformimet e ndryshme që lindin në një lëvizje çlirimtare jo gjithmonë burojnë as nga prijësit e lëvizjes, as nga ideja e lirisë. Shkarjet janë fenomene përcjellëse, të cilat duhet t'i sanojë lëvizja në proces e sipër, nëse dëshiron që deformimet brenda saj të mos i japin ton dhe orientim krejt lëvizjes. Në rastin e UÇK-së, shumica e ideologëve, të organizatorëve dhe të eksponentëve të saj vinin nga zona të varfra rurale, me pak mundësi emancipimi dhe arsimimi dhe ende më me pak mundësi për pasje ekonomike dhe standard jetësor. Shumica e atyre që u përfshin në lëvizje gjatë viteve pararendëse, përveç që ishin të edukuar me literaturën revolucionare të Partisë së Punës, kishin edhe një ëndërr të madhe të mëkëmbjes ekonomike. Prandaj, secili syresh, përveç se ëndërronte lirinë e Kosovës, po kaq e kishte të dëshiruar edhe një Kosovë me konstalacion tjetër social, ose, thënë më ndryshe, një Kosovë që do të shërbente për ëndërrën e tyre të madhe të pushtetit dhe të pasjes ekonomike. Pra, bashkë me lirinë e Kosovës ata kishin ëndërruar edhe pushtetin dhe privilegjet e tij dhe se ky pushtet, njësoj si në rastin e revolucioneve socialiste, iu takonte atyre, të vuajturve dhe të përcmuarve të deridjeshëm.

Se çfarë ndodhi me një numër të eksponentëve të UÇK-së në vitet e para dhe më vonë pas luftës, është e njohur për shumicën e njerëzve në Kosovë. Nuk bëhet fjalë më për deformimin dhe keqpërdorimin e idealit të lirisë, sepse ai

ideal edhe ashtu pësoi fiasko të gjithanshme, por bëhet fjalë për përfshirjen e kësaj strukture (njësoj si edhe e strukturave të tjera me prejardhje të dyshimtë sociale), në procesin vendimmarrës për Kosovën, për statusin e saj. Kjo strukturë dihej se kishte edhe ndonjë precedent penal nga periudha e luftës apo menjëherë pas saj, gjë që e bënte të paqëndrueshme kundrejt faktorit ndërkombëtar. Ata duhej të tregoheshin luajalë ndaj bashkësisë ndërkombëtare, ndryshe dihej se disa syresh kërcënoheshin hapur se do të përfundonin në Hagë. Përveç kësaj, disa syresh kishin bërë abuzime të mëdha financiare dhe ekonomike, bashkë me eksponentë të bashkësisë ndërkombëtare ose ndaras prej tyre. Thënë ndryshe, në radhë ishte komprometimi material i idealistëve të dikurshëm. Kjo rrethanë i bënte të përdorshëm politikisht për një status të cenuar të Kosovës edhe idealistët më të mëdhenj, edhe radikalët më të pabindur.

Natyrisht, kjo situatë nuk ishte e rezervuar vetëm për UÇK-në dhe eksponentët e saj. LDK-ja që në vitet '90 kishte filluar ta improvizonte pushtetin dhe, në këtë e sipër, kishte abuzuar me të që në kohën kur kishte marrë organizimin e të ashtuquajturit pushtet paralel. Në LDK që herët ishin identifikuar personat që kishin keqpërdorur ndihmat humanitare, më vonë disa syresh, veçmas në terren, "futën duart" në paratë e "fondit të trepërqindëshit", ndërsa pas luftës edhe LDK-ja u përfshi shpejt në organizime klanore dhe grupe të interesit, disa duke u përpjekur të ruajnë skemën dhe hierarkinë e vjetër sociale të Kosovës, disa të tjerë, si në rastin e UÇK-së, duke synuar ta përmbysnin këtë skemë. Me t'u përfshirë në institucionet e Kosovës, në bashkëqeverisje me ndërkombëtarët, LDK-ja i kishte pothuajse të parapërgatitura "vijat" funksionale të abuzimit me paranë publike, vetëm se duke qenë trashëgimtare e një

strukture sociale më të avancuar ekonomikisht se sa trashëgimtarët e UÇK-së, keqpërdorimet e saj nuk do të problematizohen aq shumë.

Pra, nga një vend i vuajtjes dhe idealeve shumë të mëdha, Kosova për një kohë tepër të shkurtër u bë vend i *hedonizmit* dhe i idealeve tërësisht të arritshme dhe krejt tokësore, veçmas për kategorinë e njerëzve të politikës, të cilët, duke qenë njerëz me vlera të dyshimta ose pa to fare, shumë shpejt u përfshinë në spiralen e një jetë të shturur, duke krijuar një klasë shoqërore krejtësisht të diferencuar, thellësisht abuzive: para, kurva, shtëpi luksoze, makina të shtrenjta, udhëtime në vende ekzotike etj. Në përgjithësi, ky hedonizëm nuk mund të quhet tipik shqiptar dhe as tipik kosovar, sepse kosovarët do të bëjnë atë që pushtetarët e tjerë të vendeve të rajonit e kishin provuar vite më parë. Por Kosova kishte një problem tjetër: hedonizmi i pushtetarëve kosovarë ia ulte çmimin Kosovës dhe statusin e saj e bënte lehtësisht të manipulueshëm, sepse gjithmonë ekzistonte rreziku që për pushtet kaq të dëshiruar dhe kaq të pëlqyeshëm, klasa politike e Kosovës të tregohet e gatshme, kooperative dhe luajale për koncesione të jashtëzakonshme ndaj Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Gatishmëria për kompromise

Thënë me një fjalë, që më 2004 dhe prapa, nga këndvështrimi i bashkësisë ndërkombëtare, veçmas të atyre që kërkonin që zgjidhja të bëhet mbi bazën e kompromiseve, Kosova i kishte plotësuar të gjitha kushtet për një proces të avancuar të zgjidhjes së statusit. E para, me ngjarjet e marsit të atij viti, pra me turrin që kishin bërë dofarë bandash mbi

objektet serbe të kultit, e kishin shkatërruar deri në groposje imazhin e Kosovës. E dyta, bashkësia ndërkombëtare, përmes parave të abuzuara së bashku, kishte fuqizuar dukshëm të ashtuquajturën shoqëri civile në Kosovë, e cila ishte kthyer në një klasë shoqërore e privilegjuar, e gatshme të mbronte pozicionin e saj të diferencuar social dhe identitar, pavarësisht se me çfarë kompromisi të statusit të Kosovës duhej paguar këtë pozicion. E treta, administrata ndërkombëtare kishte qeverisur keq Kosovën dhe e kishte varfëruar ekonomikisht, duke përdorur shtrëngesën ekonomike për zhvlerësim e të gjitha idealeve, përfshirë idealin e lirisë dhe idealin kombëtar. E katërta, bashkësia ndërkombëtare tashmë kishte bërë përzgjedhjen e kujdesshme të luajalistëve të saj në Kosovë, duke neutralizuar me kujdes secilin element radikal dhe jokoooperativ. E pesta, bashkësia ndërkombëtare kishte lejuar keq-qeverisjen dhe mundësinë e pakufishme të pasurimit të pushtetarëve përmes abuzimit të drejtpërdrejtë me paranë publike, ose përmes përfshirjes në korrupsion, kontrabandë dhe në krim të organizuar. Kjo klasë politikanësh, për të mbrojtur pozitën e tyre të privilegjuar pasurore, ose për të mos u bërë objekt hetimesh dhe gjyqesh, ishte në gjendje të bënte kompromise të jashtëzakonshme rreth statusit të Kosovës. E gjashta, politikanët që vinin nga provenienca e UÇK-së, duhej të tregoheshin sa më kooperativë me administratën ndërkombëtare në Kosovë, edhe kur bëhej fjalë për statusin e Kosovës, sepse atyre hapur u bëhej shantazh me Gjykatën e Hagës, madje edhe përmes ndonjë procesi të kurdisur. E shtata, administrata ndërkombëtare, me mënyrën e sjelljes dhe të qeverisjes, shkatërroi përfundimisht secilin sistem të vlerave në Kosovë, vlerat tradicionale të shoqërisë kosovare, vlerat bashkëkohore të shoqërisë kosovare, vlerat kombëtare, vlerat kulturore, vlerat diturore, përfshirë edhe vlerat morale.

Me këto cene dhe mungesa, edhe shumë vjet pas luftës, në punë të zgjidhjes së statusit, Kosova kishte mbetur në fillim të fillimit, aty ku duhej të ishte gjendur menjëherë pas vitit 1999. Realisht, ajo dukej sikur nuk kishte asgjë, as identitet, as perspektivë, as mundësi zhvillimi, pra një qëndrim pezull në një vakuum zgjidhjesh të paprovuara ose të pamundshme. Çmimi i saj kishte rënë, ishte gati i barabartë me zero. Statusi i Kosovës nuk kishte marrë zgjidhje me Konferencën e Rambujesë, nuk kishte marrë zgjidhje as me ndërhyrjen e NATO-s dhe as me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së. Tani që kjo çështje ishte lënë pa zgjidhje për një kohë më të gjatë, përveç që kishte çuar drejt degradimit, në këtë e sipër kishte bërë të nevojshme që të hapeshin tema, të cilat më herët as që ishin menduar se mund të viheshin në rend të ditës. Kosova e pavarur ishte ide e hershme e LDK-së dhe e liderit të saj, Ibrahim Rugovës, por ajo kishte shkuar nëpër një rrugë të tillë të një shpërputhjeje, sa që në shumë raste ishte bërë objekt talljeje edhe nëpër takime dhe forume ndërkombëtare. I ashtuquajtur i krah i luftës në Kosovë, duke qenë i lidhur ngushtë me trashëgiminë e kryehershme të lëvizjes ilegale, as që e kishte menduar se zgjidhja e statusit të Kosovës mund të kalonte përmes ndryshimeve të identitetit, ose, thënë më mirë, përmes hapjes së çështjeve që konsideroheshin të mbyllura që në shekullin XIX. Ky krah njihej si kundërshtar i vendosur edhe i opsioneve politike të LDK-së, kështu që një sprovë që bëri LDK-ja me nxjerrjen e flamurit të Rugovës në vende publike në Prishtinë, përfundoi me incidente kërcënuese. Situata e krijuar me këtë rast bënte të ditur dy gjëra: se LDK-ja, edhe nëse e kishte ndër mend të bënte diçka kësaj, nuk do të mund të kontrabandononte ndonjë zgjidhje politike jo të favorshme për Kosovën; dhe se vendimet për statusin e Kosovës, në çfarëdo rrethane, duhej të kalonin përmes një miratimi

publik ose të heshtur të proveniencës politike dhe luftarake të UÇK-së.

Pavarësisht se ithtarëve të LDK-së dhe mbështetësve të saj jo të paktë nuk iu pëlqente marginalizimi i rolit të kësaj partie dhe të kësaj lëvizjeje nga vendimet e mëdha, në këtë rast për statusin e ardhshëm të Kosovës, edhe në këtë rrethanë taktika e LDK-së kishte mbetur e pandryshuar, e tillë çfarë ishte përdorur në Rambuje: LDK-ja e shihte të përshtatshme të tërhiqej nga roli prijës, në mënyrë që vendimet kontraverze politike, përfshirë edhe kompromiset e saj, të mos lidheshin direkt me LDK-në dhe liderin e saj. Më anë tjetër, në njëfarë mënyre, njerëzit në Kosovë, pavarësisht nga bindjet politike, trashëgiminë e UÇK-së e shihnin si një garanci, se nuk do të lejoheshin shkarje në vendimet e mëdha për statusin e Kosovës, sepse UÇK-ja, përveç që kishte derdhur gjak për Kosovën, ajo tërhiqte me vete edhe trashëgiminë e hershme të lëvizjes ilegale, e cila bashkimin kombëtar e kishte pasur ideal dhe promotor të të gjitha angazhimeve dhe sakrificave. Askush nuk besonte se kompromiset e saj mund të shkonin aq larg, sa të rrezikohej ideja e një Kosovë si entitet i pavarur, ndërkohë që idealet e mëdha për një shtet të të gjithë shqiptarëve tashmë kishin pësuar fiasko. Megjithatë, çfarëdo që të ndodhte, provenienca radikale e UÇK-së dhe e gjithë mbështetja e saj ideore, ideologjike, por edhe sociale, nuk mund të pajtohej me ulje të “çmimit” të Kosovës nën atë që i kishte vënë LDK-ja, kështu që, në njëfarë mënyre, ekzistonte një besim i përgjithshëm se nën pavarësi nuk do të kishte konsensus për një zgjidhje të mundshme. Ishte e vërtetë se UÇK-ja kishte kaluar nëpër një proces të ngatërruar të transformimit, të zbutjes dhe pacifizimit; se prijësit e saj luftarakë ishin bërë liderë të një partie politike, të Parisë Demokratike të Kosovës, dhe se pjesëtarët e UÇK-së ishin bërë aktivistë ose

militantë të kësaj partie; se kjo parti tashmë kishte hyrë në garën politike për pushtet, pra në garë politike dhe jo më në garë luftarake, siç e kishte menduar situatën e kryehershme. Pra, edhe përkundër të gjithave, ekzistonte një besim i përgjithshëm se trashëgimia e UÇK-së nuk mund të dilte tradhtare e kauzës.

Pas dështimeve të reja me stërzgjatje të paargumentuara, siç ishin *standardet para statusit*, bashkësia ndërkombëtare më në fund u detyrua të vendoste në rend dite çështjen e statusit të Kosovës. Pala e Kosovës hiqej sikur ishte e gatshme për procesin politik të përcaktimit të statusit, sepse, sipas mendjes së saj, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes politike në vend ishte arritur konsensusi për pavarësi, kështu që, sipas bindjes së tyre, çështja paraqitej e lehtë, pa implikime të mëdha. Dukej se edhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare e kishte krijuar këtë bindje, se me kosovarët gjërat kishin shkuar në drejtimin e duhur, se ata tashmë kishin dëshmuar kooperativitet dhe lojalitet, por edhe gatishmëri për kompromise të mëdha. Kosovarëve iu duhej një pavarësi, veçmas klasës politike, çfarëdo që mund të ishte ajo, sepse ndryshe kjo klasë politike nuk mund të mbijetonte politikisht. Amplitudat e kësaj pavarësie mund të ishin të paskajshme, por mjaftonte që ajo ta kishte këtë emër.

Në të vërtetë, sikundër që tashmë është e njohur, pala kosovare për bisedimet e Vjenës nuk përgatiti ndonjë opsion tjetër, përveç pavarësisë së Kosovës. Ekzistonte një bindje e përgjithshme se bashkësia ndërkombëtare, përveç asaj pjese që mbështeste Serbinë, ishte e gatshme ta pranonte opsionin e pavarësisë, veçmas SHBA-ja, e cila tashmë ishte identifikuar si mbështetëse e fuqishme e palës kosovare në të gjitha ballafaqimet rreth statusit të Kosovës. Më anë tjetër, të mësuar me sjelljen e Serbisë, duket se pala kosovare më shumë ishte e përgatitur për dështimin e bisedimeve, se sa

për ndonjë rezultat që mund të dilte prej tyre. Prandaj fokusi i saj ishte pavarësia dhe asgjë tjetër, as më shumë, as më pak; as kërkesa maksimaliste, as minimaliste. Askush nuk pyeste nëse pavarësia e Kosovës ishte tani dhe kishte qenë gjithmonë ideal i kosovarëve. Ajo ishte zgjidhje e mundshme, zgjidhje optimale, madje logjike, për një situatë çfarë ishte krijuar me Kosovën përgjatë viteve të fundit. Edhe kosovarët, marrë realisht, nuk kishin përse të mos ishin të kënaqur, përfshirë edhe ata që kishin ëndërruar më shumë se kaq. Ç'ishte e vërteta, me pavarësinë e Kosovës çështja shqiptare në Ballkan nuk po merrte një zgjidhje ideale, por dukshëm po i ofrohej një zgjidhjeje të pranueshme. Kështu mund të gjykonin edhe idealistët më të mëdhenj shqiptarë, përfshirë edhe ata që kishin sakrifikuar shumë për idealin e bashkimit kombëtar. Dy shtete shqiptare në Ballkan nuk ishte shaka, veçmas për Serbinë, e cila mezi ishte pajtuar me një shtet shqiptar dhe kishte bërë çdo gjë që ta zhdukte edhe atë, ndërsa tani duhej të ballafaqohej edhe me një shtet tjetër shqiptar. Pra, edhe ata që shkallën e patriotizmin e matnin me inatin ndaj Serbisë, pavarësinë e Kosovës mund ta quanin zgjidhje të kënaqshme.

Unë këtu nuk e kam ndër mend të përshkruaj në detaje procesin e bisedimeve të Vjenës dhe as kronologjinë e zhvillimeve politike të asaj periudhe, jo pse e konsideroj të parëndësishme, por nga se ky proces, kurdo, duhet të shpjegohet në tërësi, me të gjitha prapaskenat, nga vetë pjesëmarrësit, jo për të kënaqur kureshtjen e opinionit, por për një transparencë të domosdoshme politike rreth një zhvillimi jo pa damka, jo pa prapaskena dhe jo pa mistere. Deri më tani pjesëmarrësit e këtij procesi nuk kanë folur hapur, a thua se janë betuar për ruajtjen e fshehtësisë, aq këmbëngulëse është jogatishmëria e tyre për të pranuar

përgjegjësitë për gabimet që tashmë janë evidente. Secili që do të merrte publikisht pjesën e vet të përgjegjësisë për të gjitha zhvillimet politike të viteve të fundit, përfshirë edhe procesin e bisedimeve dhe shpalljen e pavarësisë, duhet të ballafaqohet me rrezikun e dështimit në skenën politike, në një kohë që jo të gjithë pjesëmarrësit e këtij procesi tashmë janë aktivë në politikë, që domethënë se mungesa e gatishmërisë për të folur hapur më shumë lidhet me frikën nga një stigmë publike, se sa nga dështimi eventual në karrierë. Mbase duhet pritur edhe shumë vite, që dikush të dalë nga ky rreth i mbyllur, në mënyrë që të fillojë zbardhja e detajeve të krejt asaj që tashmë ka marrë emrin si proces parapërgatitor i pavarësisë së Kosovës, përfshirë bisedimet e Vjenës, periudhën pas bisedimeve të Vjenës dhe vetë shpalljen e pavarësisë. Transparenca domosdo nuk nënkupton dyshimin, por më shumë mungesën e dijes politike dhe një dështim lapidar të vetë Kosovës për të menaxhuar si duhet një proces kaq vital për të ardhmen e saj.

Deficiti moral dhe kombëtar

Shpallja e të ashtuquajturës pako e Ahtisaarit për pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës nxori në sipërfaqe dështimet e mëdha të palës kosovare në procesin e bisedimeve të Vjenës, të lidërshiptit politik, i cili nuk e bëri transparent procesin negociator, sikundër edhe mungesën e gatishmërisë së këtij lidërshipti që në këtë proces të tërhiqte ekspertët e fushave, duke e kufizuar çështjen në rrethe të mbyllura politike. Në të vërtetë, as këto rrethe nuk ishin aq të mbyllura, sa i përket ruajtjes së konfidencialitetit, sepse

pothuajse në secilin të ashtuquajtur grup i ekspertëve do të gjendet së paku njëri që rregullisht e bënte me dije palën serbe me çdo gjë që bisedohej ndërmjet palës shqiptare, përfshirë edhe draftet e dokumenteve që qarkullonin pa ndonjë kufizim. Vetëm nga shqiptarët e Kosovës bisedimet dhe dokumentet ruheshin në fshehtësi të thellë, sepse vetëm ata kishin arsye të ishin të pakënaqur dhe vetëm ata, me ndonjë veprim radikal, mund ta prishnin këtë proces. Serbia nuk kishte përse ta prishte procesin, sepse ajo tashmë ishte e përgatitur ta refuzonte çdo zgjidhje që dilte jashtë kornizës së kushtetutës së saj, e ajo kushtetutë thoshte në mënyrë decizive se Kosova ishte pjesë e Serbisë. Ajo, pra Serbia, do të merrte pjesë në proces, jo për ta pranuar atë, as për të ofruar zgjidhje, por vetëm për të nxjerrë kompromiset maksimale.

Pala serbe do ta arrijë këtë përmes tri formave: e para, përmes pendesës së thellë të Europës që kishte ndërhyrë në Kosovë dhe, si pasojë, gatishmërisë së saj për të bërë trysni mbi palën kosovare për të gjitha koncesionet; e dyta, përmes Ruisë, e cila tashmë kishte shpalosur në botë idenë se pavarësia e Kosovës përbënte një precedent të rrezikshëm për rastet e ngjashme, që nga Osetia dhe Nagorni Karabahu në Kaukaz, Tibeti e Kashmiri në Azinë e largët, te Sahara Perëndimore në Afrikë, e deri te Qiproja, Baskia e Transilvania më afër në Europë; dhe, e treta, përmes joseriozitetit dhe mungesave të mëdha në dije politike dhe profesionale të palës kosovare. Lidhur me papërgatitjen e kosovarëve, le të themi se kjo nuk ndryshonte nga çdo rast tjetër i ngjashëm, sepse nga burime brenda ekipit negociator kosovar tashmë kishin dalë të tilla informacione, që bënin të ditur për mungesë lapidare të seriozitetit dhe përgjegjësisë në bisedime, që shkonte deri në atë pikë, sa të vinte në siklet edhe mbështetësit e tyre më të mëdhenj, amerikanët dhe

ndonjë aleat të rrallë europian. Ta zëmë, unë mund të mos jem në dijeni si ka shkuar situata me atë pjesë të ekipit kosovar që merrej me decentralizimin, por e di se çfarë ka ndodhur me pjesën e ekipit që merrej me çështjen e trashëgimisë kulturore. Në të vërtetë, edhe sikur të mos ndodhte asgjë, aneksi V i dokumentit të Ahtisaarit bën të ditur se pala kosovare nuk ishte serioze, ishte e padijshme dhe kishte mungesa profesionale, madje nuk kishte as konsistencë kombëtare. Negociatat me Serbinë për të gjitha fushat ishin çështje serioze dhe t'ua lësh në dorë çështjet e këtilla njerëzve me *deficit moral*, me *deficit profesional* dhe me *deficit kombëtar* nuk besoj mund t'i ndodhte dikujt tjetër, përveç Kosovës.

Ndodhi, kështu, që të gjithë pjesëtarët e ekipit negociator, të gjitha subjektet politike, i gjithë faktori vendimmarrës i Kosovës, për dy vjet radhazi sa zgjatën bisedimet e Vjenës, u mbulua me heshtje dhe mister, duke marrë përgjegjësinë për diçka aq të madhe, sa që realisht nuk mund ta bartte askush. Ta zëmë, për mënyrën e këtillë të rregullimit territorial të Kosovës, me pasoja largvajtëse për funksionimin e saj, nuk mund të merrte përgjegjësi askush, as presidenti i Kosovës, as qeveria, as Kuvendi, as të gjithë së bashku. Një përgjegjësi të tillë mund ta merrte vetëm populli i Kosovës, i cili duhej të shprehej me referendum, jo për të plotësuar formalisht një normë demokratike, por ngase çështjet për të cilat merreshin vendime, do të kishin reperkusione të mëdha pikërisht për të ardhmen e popullit të Kosovës. Çudia më e madhe ishte se, derisa ekipet negociatore numëronin njërin pas tjetrit koncesionet që i bëheshin Serbisë dhe paratë që merrnin nga mëditjet, entuziazmi dhe krekosja në radhët e kosovarëve dita më ditë merrte pamjen e sjelljes fëmijërore, ndonjëherë madje duke marrë edhe poza qesharake, me idenë se tashmë

po bënë pavarësinë e Kosovës dhe se historia ua kishte caktuar një vend nderi në pedestalin e saj.

Shpallja publike e dokumentit të Ahtisaarit nuk ngjalli reagime të papritura, as te subjektet e veçanta politike, as te masat e gjëra të popullit të Kosovës. Me gjithë përpjekjet e pareshtura, lëvizja “Vetëvendosje” nuk arriti ta radikalizonte popullin e Kosovës. Njerëzit e kishin humbur sensin e reagimit. Nuk duhej të kishe një dije të veçantë politike, për të kuptuar se një mënyrë e këtillë e rregullimit administrativ të Kosovës, me shumë komuna të reja serbe, me mundësinë e tyre të çuditshme dhe të jashtëzakonshme që të lidheshin mes veti dhe të gjitha së bashku me Serbinë, pastaj statusi i gjuhës serbe si gjuhë e dytë zyrtare në tërë territorin e Kosovës, zonat e sigurisë përreth monumenteve serbe të kultit etj., të gjitha këto veç e veç apo së bashku, krijojnë argumente të mjaftueshme për pakënaqësi të përgjithshme. Por pakënaqësi përmasash të tilla nuk kishte askund, kishte topitje, apati, një lodhje të përgjithshme me gjepurat e përçdoditshme të politikës, që donte të thoshte se Kosova, me të gjitha ato që i kishin ndodhur viteve të fundit, ishte e gatshme ta pranonte çdo gjë që mund të kishte emrin pavarësi, madje edhe pa veriun, pa një copë të territorit, pa komb, pa identitet, pa asgjë. Nuk mund të shpjegohej kjo me besimin e madh që mund të kishte Kosova as te Ahtisaari, as te SHBA-ja dhe miqtë e tjerë eventuale, apo te elita politike e vendit. Më shumë lidhej me atë topitjen e ndjenjave dhe të sensit për reagim politik.

Në të vërtetë, tashmë përgatitja e madhe për kompromiset që lidheshin me pavarësinë ishin bërë me fitoren në zgjedhje të të ashtuquajturit krah i luftës. Unë nuk them se ata vërtet nuk i fituan zgjedhjet, se rezultati ishte i kurdisur, siç duan të thonë disa. Për bindjen time, PDK-ja vërtet i fitoi zgjedhjet dhe me këtë u krijuan rrethana të

favorshme për të shpallur një pavarësi të kushtëzuar, të kontrolluar dhe të monitoruar, për të bërë flamur të ri e për të bërë himn pa tekst; për ta përfshirë në Kushtetutën e Kosovës dokumentin e Ahtisaarit dhe gjëra të këtilla dhe të ngjashme. Gjithashtu nuk them se kjo proveniencë politike në Kosovë ishte e predispozuar për kompromise të këtilla, mjaftonte që i ofrohej shansi historik për ta bërë realisht Kosovën shtet, pra të zinte vendin në histori edhe me bërjen e pavarësisë, duke e mbyllur kështu ciklin e saj, të filluar shumë kohë përpara, që me lëvizjen ilegale, me organizimin e luftës dhe, së fundi, me shpalljen e pavarësisë së njëmendët.

E vërteta është se këtij krahu politik në Kosovë, në një mënyrë, i takonte e *drejta e patjetërsueshme* për ta zënë këtë vend në historinë e Kosovës dhe të mbarë kombit shqiptar, sepse sakrificat e saj vërtet kishte qenë e jashtëzakonshme. Lëvizja që kishte filluar që në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, kishte përjetuar dhunë të paparë shtetërore, burgime të gjata dhe të përsëritura, tortura pa fund, përfshirë edhe vrasje. Shumica syresh ishin njerëz që kishin pësuar trauma të mëdha fizike, psikike dhe shpirtërore, por të gjithave u kishin bërë ballë vetëm për një ideal. Më anë tjetër, pas viteve '90, pra pas rënies së komunizmit, për shkak të lidhjeve të kryehershme me ideologjinë e Partisë së Punës dhe Enver Hoxhën, ishin kritikuar dhe ishin tallur e përqeshur, deri në mohim të sakrificës. Kishin qenë të kota shpjegimet e tyre se Shqipëria kishte qenë ideal dhe se ideologjia kishte qenë vetëm perde tymi, prapa të cilës gjithmonë fshihej ideali kombëtar. E vërteta, në praktikën politike, në mënyrën e organizimit të luftës, por edhe më vonë në mënyrën e organizimit dhe të bërjes së pushtetit, dukej qartë se ata kishin trashëguar metoda të gueriljes partizane, të celulave komuniste e, së fundi, edhe të

përmbysjes së regjimeve antipopullore dhe të vendosjes së diktaturës së proletariatit. Ishte e qartë, literaturë bazë e edukimit të tyre politik kishin qenë veprat e Enver Hoxhës dhe historia e Partisë së Punës. Sipas kësaj ideologjie, çlirimi kombëtar bëhej përmes revolucionit, me përfshirje të gjerë të klasës punëtore dhe fshatarësisë.

Pavarësisht se përpjekjet për çideologjizim dhe modernizimin politik të kësaj lëvizjeje kishin qenë të mëdha, në disa pika ajo kishte mbetur e pandryshuar, veçmas një pjesë e strukturave të saj më konservative dhe njëkohësisht më të dëshpëruara më zhvillimet politike të viteve të fundit. Por, në përgjithësi, pjesëtarët e kësaj lëvizjeje politike, që nga mbarimi i luftës së vitit 1999 dhe prapa, nuk e mohuan se atyre iu takonte e drejta e bërjes së shtetit të Kosovës dhe e drejta e sundimit në këtë shtet. Vetëm se brenda këtij synimi politik kishte një ngatërresë jo të vogël. Të drejtën e marrjes së pushtetit me *metoda revolucionare* ata nuk e vunë në dyshim asnjëherë, vetëm se ndërmjet idealit të bashkimit kombëtar dhe shtetit të Kosovës kishte një shpërputhje jo të vogël. Për shkak të idesë së Kosovës së pavarur, ata me vite e kishin tallur Ibrahim Rugovën dhe LDK-në, kështu që tani "gracka" e pavarësisë ishte njëllëj konfirmimi i vizionit politik të kësaj proveniencie. Por nuk ishte vetëm kjo. Bërja e shtetit të Kosovës në një mënyrë nënkuptonte edhe heqje dorë nga ideali i kryehershëm për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, për ç'gjë ata ishin angazhuar me krejt qenien e tyre. Por këtu, ndonëse me vështirësi, u gjend një kompromis në trashëgiminë politike të lëvizjes: kjo zgjidhje duhej të ishte e ngjashme me kërkesën politike për Kosovën republikë, e cila më pastaj do të kishte "të drejtën e vetëvendosjes deri në shpëputje", sipas parimeve të Leninit për kombin dhe shtetin. Pra, sipas kësaj vije politike, pavarësia e Kosovës ishte një zgjidhje e përkohshme, një

kompromis i përkohshëm i Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare, ndërsa zgjidhja e qëndrueshme do të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, përmes një plebishiti, përmes një referendumi, përmes një revolucioni, sido që t'i vinte puna. Edhe dalja në skenë e lëvizjes "Vetëvendosje" kishte këtë prapavijë politike dhe ideologjike.

Shtet nën protektoratin serb

Mirëpo çështja nuk doli aq e thjeshtë, siç u mendua në krye të herës. Shteti i Kosovës, që në fillim, nuk mori atributet e një zgjidhjeje të përkohshme as nga vetë kosovarët, as nga bashkësia ndërkombëtare që e mbështeti atë. Ai doli të jetë një projekt politik më serioz sesa që mund të jetë dukur në fillim. Ai tashme po vendoste një drejtpeshim strategjik në Ballkan, të avancuar në krahasim me kohën e shkuar, por jo pa kompromise dhe zgjidhje dëshpëruese për dy popujt kryesorë të kësaj hapësire: për shqiptarët dhe serbët. Për serbët humbja e Kosovës ishte cenim i identitetit, zhbërje e mitologjisë kombëtare dhe gjëra të këtilla, me të cilat tashmë i qenë mbushur veshët historisë dhe politikës kontemporane. Asgjë nga këto nuk ishin të vërteta, jo pse tashmë serbët nuk jetonin me mitet e shkuara, por te shumica syresh, përveç kishës dhe elitës politike, ishin zhbërë ëndrrat për Serbinë si fuqia më e madhe imperialiste në Ballkan. Tani është vështirë të thuhet, nëse ambiciet imperialiste të Serbisë kishin prodhuar mitin e Kosovës, apo miti i Kosovës kishte prodhuar ambiciet imperialiste, por hiperbolizimet serbe për Kosovën, së fundmi, më seriozisht i kishte marrë një pjesë e Europës, sesa vetë Serbia. Ishte njësoj si ambicia e saj e dikurshme për

dalje në Detin Adriatik. Kam lexuar shkrimtarë serbë të fundit të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, të cilët kanë shpenzuar aq shumë fjalë dhe aq shumë letër për të përshkruar bukuritë e Adriatikut, sa të duket se një det i tillë, aq madhështor dhe aq pangjashëm, nuk ekziston gjëkund tjetër në botë. Më vonë, ëndrra serbe për dalje në Adriatik përmes Shqipërisë pësoi fiasko, dikur u realizua pak më ndryshe nëpërmjet Jugosllavisë së Versajës, por së fundi ai det nuk përbënte më asnjë ëndërr dhe asnjë mit, kështu që e humbi atë shkëlqim dhe mrekulli, që e kishte pasur një herë e një kohë.

Kështu disi duhej të ndodhte edhe me Kosovën. Miti serb për Kosovën ka qenë dhe vazhdon të mbetet *mit imperialist*, mit pushtues dhe përrallat e kryehershme për Betejën e Kosovës, për Jerusalemin serb etj., që të gjitha të stisura në shekullin XIX, duhej të arsyetonin sa mbajtjen e Kosovës nën sundim, po aq edhe pushtimet e reja në drejtim të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Kosova nuk ka pasur dhe nuk ka asgjë nga ajo mrekulli, e cila përshkruhet nga tërë shkrimtaria serbe e dy shekujve të shkuar. Peizazhi i saj nuk është i ndryshëm nga peizazhi ballkanik kontinental, ndërkohë që varfëria dhe dendësia e madhe e popullsisë kanë bërë që ai në shumë pika të degradojë dhe të marrë pamje jo aq të këndshme. Po të donin, këtë fakt, pra shpërputhjen e madhe ndërmjet mitit dhe realitetit, do të mund ta kenë parë të gjithë ndërkombëtarët që kanë kaluar qoftë edhe një ditë të vetme në Kosovë. Por Serbia, në procesin e negociatave për statusin e Kosovës, bëri atë që tashmë e kishte provuar edhe herë të tjera: mitin e hershëm eterik e konvertoi në përfitim politik, ndërsa shqiptarët nuk ditën që realitetin jetësor ta shndërronin në argument politik. Ata lejuan që Serbia të diktonte tempin dhe domenin e bisedimeve, duke u mbajtur pas pavarësisë si argument

kryesor, ndërsa anash këtij boshti statusor filloi të mbështillej një lëmsh i madh *koncesionesh alternative*.

Pra, përmes Rusisë dhe europianëve të penduar, Serbia nuk e pat të vështirë ta tërhiqte procesin aty ku asaj i konvenonte më së shumti. Ajo bëri një lidhje hipotetike, imagjinare, ndërmjet tri komponentëve të favorshme për të: mitit të mjegullt, historisë së manipuluar dhe një realiteti inversiv. Serbia në këto bisedime u soll si agresor dhe si viktime njëkohësisht. Ajo arriti të bindte mbështetësit e saj se për gabimin historik që kishte bërë Milosheviqi nuk duhej të ndëshkohej pa asnjë alternativë. Ajo, për shkak të dobësisë së kosovarëve dhe mbështetjes së bashkësisë ndërkombëtare, nxori koncesione të jashtëzakonshme për disa çështje që ishin me interes të veçantë për të. Së pari, me kërcënimin e vazhdueshëm se do të prishej baraspesha në Ballkan, ajo e imponoi kompromisin e pavarësisë së Kosovës si opsion. *Pavarësia e Kosovës nuk u bë për t'ua plotësuar vullnetin politik kosovarëve, por si zgjidhje kompromisi për Serbinë*. Me këtë zgjidhje Serbia siguroi edhe për një kohë të gjatë pozitën e saj të favorshme dhe dominuese në raport me kombin tjetër më të madh në fqinjësi të saj, pra me shqiptarët. Për më shumë se kaq, duke imponuar zgjidhje politike të pafavorshme për Kosovën, ajo krijoi një garanci afatgjate se do të ishte faktor i rëndësishëm brenda vetë Kosovës dhe këtë në tri forma të ndryshme: përmes decentralizimit, përmes lidhjeve të veçanta të komunave serbe me Serbinë dhe përmes trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Në fqinjësi të Serbisë, me këtë hapësirë që iu la Serbisë brenda vetë Kosovës, shteti i ardhshëm i Kosovës nuk do të mund të siguronte stabilitet afatgjatë, nëse për këtë nuk merrte miratimin nga Beogradi. Në të vërtetë, me këto zgjidhje Kosova u vendos *nën protektoratin serb*, një

protektorat në distancë, i cili do të diktonte ritmin e të gjitha zhvillimeve, ekonomike, politike, kulturore etj. Shikojeni me kujdes Kosovën e ditëve të sotme, tri vjet pas pavarësisë, dhe e shihni sesi nga një teshtitje në Beograd tronditet opinioni dhe skena politike e Kosovës, sepse tashmë të gjithë e dinë se varshmëria në të gjitha planet është e padiskutueshme. Mbi të gjitha, duke lënë veriun e Kosovës pa një zgjidhje të qëndrueshme, ose si një kërcënim permanent për Kosovën, por edhe si një mundësi ta jashtëzakonshme për të abuzuar me shtetin dhe me pushtetin, Serbia futi në lojën e kontrabandës dhe të krimit të organizuar të gjitha strukturat politike dhe shtetërore të Kosovës, duke i bërë ato të varura dhe të paqëndrueshme politikisht, por edhe me një imazh jashtëzakonisht të keq ndërkombëtar. Më anë tjetër, Serbia e mban si kërcënim veriun e Kosovës, ashtu siç e mbante Rusia, Osetinë e Jugut në raport me Gjeorgjinë, kërcënim ky që duket se ka mbështetësit e vet jo vetëm në OKB, por mbase edhe në BE dhe në NATO.

Thënë me një fjalë, ka shumë argumente që thonë se pala kosovare në bisedimet për status ishte e papërgatitur, inferiore dhe kooperative deri në nënshtrim. Ajo e mendoj pavarësinë e Kosovës si zgjidhje maksimale, optimale dhe ideale njëkohësisht, gjë që nuk ishte dhe nuk mund të ishte e tillë, duke bërë kështu që pikërisht te ky opsion pa alternativë të fillonin *rrënimet strukturore*. E para, pavarësia e Kosovës nuk do të ishte zgjidhje kompromisi nëse bëhej me referendum, pra, që do të shprehte vullnetin e shumicës së qytetarëve të Kosovës. E dyta, Kosova nuk mund të shpallej shtet multietnik, duke qenë vend me përbërjen më homogjene të popullsisë në rajon. E treta, decentralizimi nuk duhej të krijonte asimetri të tillë në organizimin territorial të Kosovës, duke konstituuar komuna politike dhe duke

zhbërë strukturën funksionale të administrimit. E katërta, Kuvendi i Kosovës do të ishte i bllokuar në të gjitha vendimet që mund të merren pa obstrukcionin serb apo të minoriteteve të tjera. E pesta, me të ashtuquajturin diskriminim pozitiv që iu bëhej pakicave, Kosova bëhej shtet me shumicën e diskriminuar. E gjashta, lidhjet e njëanshme të komunave serbe të Kosovës me Serbinë, pa kaluar nëpër institucionet qendrore të Kosovës, realisht është kundër parimit të sovranitetit të çdo shteti. E shtata, zonat e sigurisë përreth objekteve kulturore dhe fetare serbe ua ngjiste shqiptarëve nofkën e talibanëve të Europës. E teta, e nënta, e dhjeta...

Çështje e vërteta, askush nga ekspertët nuk bëri ndonjë analizë të vlershme, profesionale, të dokumentit të Ahtisaarit, por të gjithë, politikanët, gazetarët, publicistët, analistët e paktë etj., që të gjithë u mjaftuan me një kamuflazh patriotik që iu bë *pavarësisë së kushtëzuar* të Kosovës. As Kushtetutës së Kosovës, e cila u fuqizua dhe hyri në fuqi tre muaj pas shpalljes së pavarësisë, nuk iu bë një analizë sado sipërfaqësore, politike dhe juridike, por ajo u miratua me një aklamacion euforik, krejtësisht të pambështetur dhe jashtëzakonisht spekulativ. Disa prej kushtëzimeve esenciale të mbetura në këtë Kushtetutë, që të gjithë e dimë, nuk mund të hiqen pa u miratuar edhe nga minoritetet, veçmas nga minoriteti serb, ndërsa ky minoritet nuk do të bëhet kurrë aq luajal, sa t'i vendosë kufizime Serbisë për t'u implikuar gjithmonë në zhvillimet politike në Kosovë.

Në këtë e sipër, në analiza të ndryshme ndonjëherë është theksuar njëlloj neutraliteti i Kosovës, për shkak të pozitës së saj të ndjeshme, në raport me Serbinë dhe Shqipërinë, duke dashur të krijohet ideja se pozicioni i ndërmjetëm dhe i paanshëm i Kosovës mund të jetë faktor i

mbajtjes së drejtpeshimit dhe stabilitetit në rajon. Në të vërtetë, kjo nuk është fare kështu. Kosova është *kushtimisht e pavarur* vetëm nga Serbia, ndërsa është e pavarur për të gjithë shtetet e tjera të botës, përfshirë edhe Shqipërinë. Ky kushtëzim, ose kjo lidhje varshmërie me Serbinë, sikundër thamë, e bën Kosovën të paqëndrueshme në të gjitha pikëpamjet, përfshirë këtu edhe të ardhmen e saj krejtësisht të pasigurt. Me këtë zgjidhje statusore, Kosova nuk është shtet i besueshëm, nuk është shtet serioz, nuk është shtet partner, por është një kreaturë shtetërore-administrative e përkohshme. Pra, nuk është shtet në kuptimin e plotë të fjalës, sikundër që nuk reflekton zgjidhje të përhershme politike, por një zgjidhje të përkohshme. Ta zëmë, po të mos paraqitej rreziku i destabilizimit të Maqedonisë, Serbia do të hynte me policinë dhe ushtrinë e saj pa ndonjë frikë të madhe në veriun e Kosovës, madje këtë zgjidhje do ta miratonin edhe disa faktorë të rëndësishëm vendimmarrës të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo edhe mund të ndodhë, sapo të pushojë rreziku shqiptar i destabilizimit të Maqedonisë. Apo paralelizmi që tashmë është vendosur ndërmjet Republikës Serbe të Bosnjës dhe kësaj pjese të Kosovës. Pra, ky drejtpeshim është i përkohshëm dhe nuk do të zgjasë gjithmonë.

KUNDËRTHËNIET KOMB-SHTET

Zgjidhjet e limituara

Me t'u shpallur pavarësia e Kosovës, ose në prag të shpalljes, kosovarët u përballën me disa dilema. Që Kosova do të bëhej shteti i dytë shqiptar në Ballkan, kjo tashmë ishte e qartë për të gjithë dhe, nëse merrej parasysh fakti se Serbia dhe aleatët e saj për një kohë të gjatë punuan ta zhbënin edhe Shqipërinë, ndërsa tani detyroheshin të pranonin faktin e dy shteteve shqiptare, pra vetëm kjo rrethanë mund të konsiderohej sukses historik i shqiptarëve. Më anë tjetër, dokumenti i Ahtisaarit, i mbështetur tani edhe nga fuqitë kryesore perëndimore, kishte precizuar qartë limitet e kësaj pavarësie: Kosova, përveç që do të mbahej nën një vëzhgim të kujdesshëm ndërkombëtar në planin e brendshëm dhe të jashtëm, ajo do të detyrohej të përfshinte në kushtetutë pamundësinë e bashkimit me ndonjë shtet tjetër (Shqipërinë), apo me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër (shqiptarët e Maqedonisë). Ky kompromis, i bërë me idenë e ruajtjes së stabilitetit afatgjatë në rajon dhe të krijimit të një status quo-je të re, nuk doli si vullnet politik i shqiptarëve, por si kompromis i imponuar i faktorit vendimmarrës evropian.

Por kosovarët, ende nën trysninë e kujtesës së gjenocidit, nuk u shqetësuan shumë nga këto kufizime që do të kishte shteti i tyre i ardhshëm. Madje, për shumicën syresh, ky ishte kufizimi më pak i rëndësishëm, krahasuar

me kufizimet e tjera, të cilat po ashtu kaluan dhe u miratuan pa ndonjë vërejtje. Ndryshe as që mund të ndodhte, sepse shteti i Kosovës tashmë ishte projekt i komunitetit ndërkombëtar, ndërsa kosovarët nuk mund ta kundërshtonin atë, nuk kishin as vullnet për diçka të tillë, nuk kishin as kurajë, nuk kishin as vizion politik. Kosovarët sillleshin si fëmijë bonjakë, të cilin dikush bën sevap dhe e merr për dore, e ulë pranë zjarrit, ia ngroh duart e mërdhita, i jep diçka për të veshur dhe për të ngrënë. Kërkesat e tyre politike ishin minimaliste, madje mund të thuhet se ata nuk kishin kërkesa fare. Ata i qenë dorëzuar bashkësisë ndërkombëtare, me idenë se duhej të ishin të lumtur që kishin shpëtuar lëkurën nga një Serbi e çmendur.

Po me këtë dokument të Ahtisaarit, Kosova duhej të krijonte *identitet të ri shtetëror*, të tillë identitet që do ta diferenconte qartë nga shtetet e tjera, veçmas nga Shqipëria. Pra, ajo duhej të kishte flamur dhe himn, që do të shprehnin karakterin multietnik të Kosovës, një shpikje kjo që limitonte të gjitha idetë integraliste shqiptare. Kosova do të kishte flamurin e saj pa simbolet shqiptare, një flamur që nuk do të ishte as kuq e zi dhe nuk do të kishte në të as shqiponjën dykrenore. Meqë shpallja e pavarësisë duhej të bëhej shpejt, për të parandaluar ndonjë krizë të mundshme, gjetja e zgjidhjes për flamur, stemë dhe himn kaloi nëpër një proces të shpejtë politik, madje të ngathtë dhe, për nga zgjidhja, mjaft qesharak dhe me improvizime të shumta. Fundja, tashmë nuk është me rëndësi nëse flamuri i Kosovës i plotësonte kriteret e heraldikës dhe nëse ishte një zgjidhje e pëlqyer në pikëpamje estetike, sikundër që nuk ishte aq me rëndësi nëse procesi i bërjes së tij ishte i ngutshëm dhe i imponuar nga disa faktorë ndërkombëtarë. Për këto çështje u shpenzuan shumë diskutime joesenciale. Problemi do të

dalë gjetiu: nëse dikush në Kosovë do ta dojë atë flamur ose jo.

Sikundër është e njohur, procesi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës u desh të kalonte nëpërmes të një koalicioni të gjerë politik, në mënyrë që zgjidhjet e limituara të mos ndeshnin në kontestime të menjëhershme. Me rëndësi të madhe ishte që këtë proces të mos e kundërshtonte i ashtuquajturi krah i luftës, i cili barte trashëgiminë e gjatë të lëvizjes nacionaliste. Kjo lëvizje, sikundër e kemi thënë, nuk mund të pranonte aq lehtë heqjen dorë nga idealet e saj të kryehershme, të cilat kishin shërbyer si inspirim për sakrifica të mëdha. Me këtë ideal ajo e kishte organizuar dhe i kishte prirë edhe luftës së fundit. Tani, përnjëherësh, kjo lëvizje duhej të ballafaqohej me bërjen e Kosovës shtet multietnik, me një flamur qesharak dhe me një himn pa tekst, i ngjashëm me himnin e Europës, sepse teksti i një himni multietnik duhej të thoshte afërsisht kështu: Le të rrojë Kosova përgjithmonë; shteti i përbashkët i qytetarëve të saj të barabartë; i shqiptarëve, i serbëve, i romëve, turqve etj. Pra, një himn që nuk duhej t'i referohej askujt në mënyrë eksplicite, që nuk duhej të përmbante asnjë karakteristikë nacionale dhe nuk duhej të shprehte asgjë që do të lidhej me historinë e ndonjërit popull. Një himn që do t'i këndonte lavdi një *shteti hibrid*, i shartuar mbi nevojat politike më të fundit dhe jo mbi ndonjë trashëgimi tjetër.

Duke qenë në pushtet krahu i luftës, pacifizmi i kundërshtarëve për një proces të këtillë nuk ishte ndonjë punë e vështirë të sigurohej. Edhe mbështetja e LDK-së nuk mungonte, sepse angazhimi i saj për Kosovën shtet më vete ishte i kryehershëm dhe loja e saj fëmijërore me flamuj dhe himne kishte filluar që në vitet '90. Tani vetëm legaliteti i vendimeve duhej të sigurohej dhe ky po ashtu nuk ishte i vështirë, sepse në pushtet ishte një koalicion i gjerë,

pothuajse pa asnjë zë opozitar. Prandaj, ishte e pritshme që procesi të shkonte pa vështirësi dhe pa kundërshtime, madje as nën zë. Kush mund të ishte kundër pavarësisë së Kosovës? Asnjëri, ani që pavarësia nënkuptonte diçka që nuk ishte menduar deri atëherë: një simbolikë ndryshe dhe gjëra që mund të shkonin bashkë me të. Të gjitha këto, derisa shpallej pavarësia dhe derisa zgjaste entuziazmi, qëndruan disi në prapaskenë dhe nuk përbënin ndonjë shqetësim. Askush nuk i thoshte askujt se çfarë shteti po bëhej Kosova, se cilat ishin vështirësitë reale të funksionimit të një shteti të tillë në të ardhmen. Me rëndësi ishte që procesi historik i bërjes së shtetit të përfundonte dhe klasa politike aktuale të krekosej për një akt historik të papërsëritshëm për mbarë kombin shqiptar.

Mirëpo, derisa klasa politike merrej me kompromiset e pavarësisë, përfshirë formulimet evazive në deklaratën për këtë akt, në prapaskenën e këtij zhvillimi kosovarët bënin referendumin e tyre të jashtëzakonshëm dhe unik: i mbushën sheshet e qyteteve me numër pafund flamujsh shqiptarë. Në të vërtetë, që në këtë rast, ndonëse ende nuk ishte promovuar flamuri i ri i Kosovës, u pa qartë se brenda Kosovës do të vazhdojë të jetojë dhe të funksionojë një *dualizëm* i pazakonshëm. Zyrtarisht Kosova do të ketë flamurin e saj, përdorimi i të cilit do të paraqitet i domosdoshëm për ta promovuar dhe për të bërë shtetin e ri, ndërsa emocionalisht kosovarët do të vazhdojnë të mbeten të lidhur pas flamurit dhe simboleve të tjera kombëtare. Ditët, muajt dhe vitet vijuese do të nxjerrin në pah edhe një dyzim tjetër: shteti i Kosovës do të përkujdeset që në mënyrë institucionale të plotësohet kuadri ligjor dhe kushtetues i simboleve të Kosovës, ndërsa më anë tjetër, në vijë paralele, kosovarët do të vazhdojnë lidhjen emocionale me simbolet e kryehershme. Ta zëmë, shteti i Kosovës bëri

edhe kompromise të tilla, ç'identifikuese, siç ishte mospërfshirja e 28 Nëntorit në radhën e festave shtetërore, mirëpo kosovarët spontanisht do ta tejkalojnë këtë kufizim, serish dhe serish duke vënë në përparësi traditën historike dhe lidhjen emocionale me këtë datë, në raport me urdhrin e shtetit të ri dhe me ligjet e tij. Vetë kosovarët, pa pyetur shtetin e tyre, do ta bëjnë 28 Nëntorin festë popullore dhe, pak nga pak, do t'i japin të gjitha atributet e festës shtetërore.

Ky dualizëm ka edhe elemente të tjera dhe në këtë pikë Kosovën e bën shpesh të qëndrojë në kontradiktë me vetveten. Me logjikën shtetërore, ashtu sikundër janë përpjekur ta bëjnë, Kosova do të duhej të krijonte kalendarin e saj të festave dhe 28 Nëntori, festë kombëtare e një shteti fqinj, nuk ka përse të festohet në Kosovë, sepse dita e pavarësisë së këtij shteti është 17 shkurti 2008. Afërsisht e njëjta gjë mund të thuhet edhe për flamurin dhe himnin. Kështu mund të logjikojë secili, që përpiqet të vendos rregull racional edhe në këtë drejtim. Por çfarë po ndodhë realisht? Kosovarët kanë një trashëgimi tjetër historike, një tjetër kujtesë kolektive dhe një tjetër lidhje emocionale me këto data, e cila nuk mund të zëvendësohet as me data e as me simbole të reja. Duke e vendosur në mes të këtij dualizmi, kosovarin e kanë detyruar të bëjë zgjedhjen e tij, në kundërshtim me pritshmërinë e shumëkujt. Së këndejmi, po u shikua atmosfera që sundon në Kosovë në të dy datat, më 28 nëntor dhe 17 shkurt, secili mund të vërejë se ende 28 Nëntori qëndron si festë kombëtare, e pazëvendësueshme nga 17 Shkurti, madje e para gjithandaj Kosovës (përfshirë edhe ata që e kundërshtojnë) shkruhet me shkronjë të madhe, ndërsa të dytën (përfshirë edhe ata që duan ta madhërojnë) e shkruajnë me shkronjë të vogël. Pra, zgjedhja, të cilën u detyrua ta bëjë kosovari, doli e favorshme për kombin shqiptar, ndërsa doli e pafavorshme për shtetin e

Kosovës. E njëjta gjë vlen edhe për flamurin dhe himnin. Madje, në këtë pikë gjërat kanë shkuar edhe më keq, sepse flamurin e Kosovës dhe himnin pa tekst duket sikur e duan vetëm ata që e kanë obligim ligjor dhe kushtetues, pra vetëm institucionet dhe vetëm njerëzit kur janë brenda tyre.

Përse, pra, Kosova duhej të shkonte kësaj rruge, a kishte një zgjidhje tjetër, përse ajo duhej të bënte një flamur që nuk e do askush (ose pakkush) dhe përse duhej të bënte një himn, të cilit, edhe kur t'i vihet teksti, nëse një gjë e tillë ndodhë ndërkohë, nuk do ta këndoje asnjëri? Përse Kosova duhet të ketë data historike, të cilat nuk pritet që së shpejti të zënë vend në kujtesën historike të kosovarëve? Krejt ky zhvillim, a ka mundur të merrte një rrugë tjetër? Por, mbi të gjitha, cilat janë pasojat e një dualizmi të këtillë, që tashmë nuk është vetëm i jashtëm, është edhe i brendshëm, është bërë pjesë e konstalacionit psikologjik të kosovarit...? Kosovari, pa fajin e tij, tashmë është bërë *qenie e dyzuar*, duket sikur bën jetë të dyfishtë, një jetë shtetërore dhe një jetë tjetër kombëtare. Pse, në këtë rast, a nuk kishte mundësi që të bëhej një harmonizim ndërmjet shtetit dhe kombit? A nuk kishte mundësi që shteti i Kosovës të bëhej pa prekur sentimentin dhe kujtesën kolektive të kosovarëve? A nuk mund të gjendeshin zgjidhje, të cilat detyrimisht nuk do ta çonin kosovarin te mohimi i njëjës apo tjetrës?

Të gjitha këto ishin të mundura, sikur kompromiset e pavarësisë të ndaleshin në Kosovë dhe rreth Kosovës, pa një shtrirje më të gjerë dhe pa një përfshirje ndërkombëtare. Kështu siç ndodhi, u krijua përshtypja se pavarësia e Kosovës nuk u bë për të dhënë një zgjidhje problemit, por pikërisht për ta penguar zgjidhjen e tij. Nëse problemi më i madh i pazgjidhur i Ballkanit perëndimor ishte çështja shqiptare, atëherë sprova e bërë që kjo zgjidhje të bëhej përmes një procesi të panatyrshëm, madje fytes për

kosovarët, siç është ndërtimi i një identiteti të ri, atëherë del se kjo provë nuk ishte serioze, madje tërësisht e manipuluar, e bërë me dredhi. Një mënyrë e këtillë e bërjes së shtetit të Kosovës, sikur iu thotë kosovarëve: Ja, ku e keni një shtet, që nuk do t'ju hyjë në punë për asgjë, të cilin as ju vetë nuk do ta doni, sepse shteti i ri njëmend që ju dha lirinë, por iu nxor në një terren me identitet të paqëndrueshëm. Kush është ai mendjepaktë që sot në Ballkan pranon të humbë identitetin, qoftë edhe me çmimin e shtetit? Askush, sepse të gjithë janë të vetëdijshëm se një shtet me identitet të ri, që domethënë të paqëndrueshëm, të luhatshëm, rrezikon të zhbëhet ende pa u bërë tamam. Prandaj kosovarët, për shkak të lehtësimeve që duhej bërë Serbisë, nuk duhej të viheshin para një dileme të tillë: o shtetin, o identitetin! Ekzistonte një zgjidhje tjetër: edhe shtetin, edhe identitetin, madje një zgjidhje aspak radikale, që do të ishte po kjo që është, por gjithsesi e dizajnuar ndryshe.

Kundërvëniet identitare

Ç'është e vërteta, karta e një identiteti të ri të entitetit kosovar ishte hedhur që më parë, disa vjet përpara se të shpallej pavarësia. Sipas kësaj ideje, që në krye të herës ishte e qartë se Kosova do të bëhej shtet më vete, prandaj si ekuivalent duhej të kishte shenjat e veta të dallueshme, jo vetëm simbolet shtetërore, por edhe gjuhën dhe kombësinë. A ishte kjo e domosdoshme? Askush nuk e thoshte, por problemi, si pa të keq, nisi me gjuhën. U orkestrua një fushatë e çuditshme mediale dhe e shoqërisë civile kundër gjuhës letrare shqipe, kundër standardit, me idenë se Kosova nuk kishte si ta pranonte dhe ta zbatonte një

standard të tillë, të imponuar dhe të papërshtatshëm, që ishte kundër traditës së shkrimit shqip në Kosovë. Nuk ishte me rëndësi nëse shqyrtimi i kësaj problematike ishte krejtësisht amator, madje i nxitur nga pasione krejtësisht personale të disa individëve. Me rëndësi ishte krijimi i një atmosfere, e cila, së pari në pikëpamje gjuhësore dhe më pastaj në të gjitha pikëpamjet, Kosovën duhej ta largonte sa më shumë nga Shqipëria. E ku mund të çohet Kosova? Nuk u tha ndonjëherë, por me rëndësi doli largimi, një herë ndarja gjuhësore, pastaj ndarja identitare, pastaj kundërvënia e identitetit kosovar kundrejt identitetit shqiptar, e kështu me radhë.

Të gjithë ata që u angazhuan dhe vazhdojnë të angazhohen rreth ndarjes gjuhësore të Kosovës, në asnjë rrethanë nuk do të pranojnë se këtë e kanë bërë me ndonjë prapavijë politike, ani që, në ndonjë rast, "rebelimi" i tyre ishte kryekëput mercenar, pra paguhej me para të thata nga fondacione të dyshimta, disa prej të cilëve thonë se i shtrinin rrënjët deri te "Gasprom"-i i Ruisë. Le ta quajmë këtë si konspiracion banal, sepse edhe i tillë mund të jetë, por përfituesit e këtyre fondeve përse nuk e shtruan pyetjen më të thjeshtë, e cila mund t'i bjerë ndër mend secilit njeri normal: Ç'interes mund të kishte një fondacion i huaj, dy ose tre të tillë, pavarësisht se nga mund ta kenë burimin e financimit, të sponsorizojë një skizmë gjuhësore në Kosovë? Fondacionet e këtilla në Kosovë zakonisht angazhoheshin për funksionimin e demokracisë, për ngritjen e kapaciteteve institucionale etj. Pra, ç'hynte gjuha shqipe në këtë mes? Nëse dikujt mund t'i interesonte një çështje gjuhësore në Kosovë, ajo do të duhej të lidhej me ngritjen e kulturës së gjuhës, me nxënien e drejtshkrimit, të gjitha këto në një nivel shumë të ulët. Ishte paradoksale që e vetmja çështje kulturore shqiptare, e cila financohej nga fondacionet e

huaja në Kosovë, dilte të ishin *kishat serbe* dhe *skizma gjuhësore* e Kosovës. Përse të ndodhte kjo? Përse çështja e gjuhës, respektivisht çështja e skizmës kosovare të gjuhës edhe tani të bëhet objekt interesimi i OJQ-ve, në vend se ato, ta zëmë, t'u mësojnë shkrim-lexim analfabetëve të shumtë, të cilët dita-ditës shtohen anë e kënd Kosovës?

Pra, a ishte kjo një çështje politike, e kurdisur që në krye të herës, e arsytuar si *identitet i mëvetësishëm* i Kosovës së pavarur, por me prapavijë interesash separatiste, që, në fund të fundit, duhej të prodhonte si rezultat një shkërmoqje sa më përcopëzuese të njësisë kombëtare shqiptare? Besoj se po. Por edhe një gjë tjetër: ky përcopëzim i njësisë kombëtare shqiptare është gabim të thuhet se bëhej vetëm për interesa të Serbisë ose të dikujt që mbështeste Serbinë. Bëhej edhe nga marrëzia lapidare shqiptare. Bëhej edhe nga interesa meskine. Bëhej edhe nga ideja e krijimit të të ashtuquajturave principata kulturore ose edhe politike, në të cilat "skizmatikët" mund të ndiheshin komod, karshi një hapësire më të gjerë kulturore e politike, që i fuste në një konkurrencë të papërballueshme. Krijimi i një hapësire unike kulturore shqiptare, ta zëmë, ndjeshëm do t'i rrezikonte mediokritetet, kudo që mund të gjenden të tillët, por mediokritetet kulturorë të Kosovës në mënyrë të veçantë, sepse ata për një kohë relativisht të gjatë kishin ushqyer iluzionin e bërjes së një kulture "të madhe", lehtësisht duke e anashkaluar përballjen me tërësinë kulturore shqiptare. Kjo vlen edhe për fushat e tjera, vlen për burrat e vyer të kombit, të cilët tashmë e kanë krijuar idilin e *patriotëve lokalë*. Mrekullisht mirë ndjehen edhe njerëzit e shkencës dhe të dijes, të cilët nuk kanë nevojë të futen në kurrfarë konkurrence, mjafton të jenë të adhuruarit e mëhallës së tyre shkencore dhe diturore. Mrekullisht mirë ndjehen edhe politikanët, sepse lehtësisht bëhen pashallarë

të një province politike shqiptare, sikundër edhe për faktin tashmë të njohur e të ditur: sa më i vogël shteti, aq më i madh pushteti.

Sido që të ishte, dilte e qartë se gjuha, si njësi më kohezive e secilit komb, duhej t'i paraprinte një procesi tjetër politik, i cili do të nxiste të gjitha ndasitë e tjera të identitetit. Ata që vazhdojnë të jenë mbështetës të identitetit kosovar, zakonisht funksionin unifikues të gjuhës e quajnë si perceptim romantik, tradicionalist dhe të prapambetur, duke nxjerrë si kundërpeshë funksionet e relativizuara të gjuhëve të veçanta në kuadër të proceseve integruese europiane dhe të përbotshme, pra globale. Mund të jetë edhe kështu. Po përse ne u dashka të bëjmë ndryshe nga të tjerët, të shkojmë dy hapa përpara të tjerëve në çështjen e rrafshimeve identitare, në një kohë që në proceset e tjera integruese shkojmë dhjetë hapa prapa? Thënë me një fjalë, pas zhvillimeve jashtëzakonisht të pafavorshme në shtetin e Kosovës askush nuk beson më se ndarja e tij identitare nga trangu shqiptar nuk ka një prapavijë politike, lokale ose rajonale, se kjo ndarje nuk vjen si jehonë sado e largët e proceseve, por më shumë si kuadër politik ballkanik, për të krijuar një stabilitet sa më afatgjatë, duke relativizuar faktorin shqiptar ose duke anashkaluar atë. Edhe ndarja gjuhësore e Kosovës ka këtë kontekst, pra një kontekst të pastër politik dhe, sikundër e kemi vërejtur, nuk ka një mbështetje kulturore apo vetëm gjuhësore. Skizma kosovare e gjuhës shqipe që në krye të herës ishte menduar si stimulues dhe mbështetës i ndarjeve të tjera identitare, të gjitha këto me prapavijë të qartë politike.

Ndarja e identitetit të Kosovës, më anë tjetër, merr edhe një kontekst më të gjerë. Unë as sot nuk mund ta perceptoj ndryshe insistimin e disa të huajve, veçmas europianëve, për krijimin një identiteti kosovar, përveç se si një tallje e

pashembullt me Kosovën dhe me shqiptarët në përgjithësi. I veçoj këtu europianët, për shkak se ata, shumica syresh, jo vetëm që e duan një zgjidhje të çështjes shqiptare të tillë që të mos cenojë Serbinë, por më shumë për faktin se ata, për shkak të mospajtimeve të ndërvetshme identitare, janë të gatshëm ta rrezikojnë edhe të ardhmen e BE-së, ndërkohë që shqiptarëve të Kosovë iu sugjerojnë, madje edhe përpiqen t'iu imponojnë lëvizje politike që shkojnë në drejtim çeuropianizues. Është ky një nënçmim që iu bëhet shqiptarëve dhe Kosovës, diçka që mund të gjente ekuivalentin e vet te *kombet postkolonialiste* në kontinentet e tjera, ndërsa në Europë te *kombet socialiste*, të tipit të Maqedonisë dhe të Moldavisë. Pastaj, në këtë drejtim ndiqen edhe kritere të dyfishta: shkelen parimet sa çel e mbyll sytë, duke bërë makiavelizëm edhe me çështje fundamentale. Ta zëmë, në Bosnje askush nga komuniteti ndërkombëtar nuk u angazhua që serbët e atjeshëm të mos quhen serbë, ndonëse të gjithë e dinë se ishte pikërisht identiteti i tyre i mbitheksuar serb që e shkaktoi luftën dhe tani rrezikon ta shpërbëjë Bosnjën nga çasti në çast. Përse edhe ata, bashkë me kroatët e Bosnjës, të mos quhen boshnjakë, njësoj si entiteti mysliman, që së voni ndërroi "kombësi" dhe e mori këtë emër, në mbështetje të emërtimit të vendit, siç i bëri Kosova kosovarët? Ndonëse i përkasin një entiteti të veçantë në kuadër të Bosnjës, serbët e Republikës Serbe e kanë të garantuar me marrëveshjen e Dejtonit dyshtetësinë e Serbisë. Në rastin e Kosovës, të gjitha joparimsitë i ngarkohen si barrë bashkësisë ndërkombëtare, sepse ajo vendosi në Kosovë jo vetëm rregulla të ashpra të ndarjes me pjesën tjetër të kombit shqiptar, por këtë ndarje përpiqet ta çojë përtej logjikës së gjërave, deri në identitet dhe më tej akoma.

Ripërkufizimi i etnonimit

Ndryshe nga gjuha, rreth përbërësve të tjerë të identitetit të Kosovës nuk u hap ndonjë diskutim i gjerë, para se të ndodhte shpallja e pavarësisë. Më vonë, entuziazmi i pavarësisë dhe përgjithësisht angazhimet estradeske për shtetin e Kosovës (roli historik për bërjen e institucioneve shtetërore, njohja ndërkombëtare, vendimi i GJND-së etj.) duket sikur për një kohë nxorën në margjinë disa çështje esenciale, identitare, të cilat ende vazhdojnë të qëndrojnë pezull, siç është *kosovarizmi si identifikim etnik*, patriotizmi i paqenë kosovar kundrejt patriotizmit shqiptar, simbolet jofunksionale të pavarësisë, atdheu i papërceptueshëm, mungesa e vlerave identifikuese, përdorimi i shtetit si etablim johistorik, dilema rreth qëndrueshmërisë së shtetit të Kosovës, ndjenja e të përkohshmes dhe, mbi të gjitha, kosovarizmi si alibi për rrënim të shpejtë të idealeve kombëtare dhe përdorimi afatshkurtër i shtetit për meskinitet pragmatik.

Këto tema, ose shumica syresh, as që janë hapur për diskutim në opinionin e Kosovës, qoftë për shkak se janë tema të vështira dhe tërheqin me vete dilema ende të pasqaruara, qoftë edhe për faktin se shumë njerëz janë të prirë nga ideja se situata e tashme në Kosovë është një gjendje kalimtare, një gjendje e përkohshme, në fund të së cilës duhet të ndodhë ose tejkalimi i padiskutueshëm i të gjitha vështirësive fillestare dhe konsolidimi pa alternativë i shtetit të Kosovës, ose një zgjidhje tjetër, e cila do të ishte më funksionale, më e qëndrueshme, më reale dhe më afatgjatë. Kjo përkohshmëri, nëse një e tillë ekziston, sepse asnjëherë nuk i është vënë një emër i tillë, është rrënuese për Kosovën, është sjellje në rreth, është qëndrim pezull, është *humbje e kohës historike*, është gënjeshtër dhe mashtrim lapidar, mbi të

gjitha, do të ishte dështimi historik shqiptar, paaftësi e pashembullt e tyre për të çuar në favor të vetin një zhvillim historik pozitiv. Nuk besoj se dikush do ta mohojë as pas shumë vitesh se zhvillimet historike në botën shqiptare në fund të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI kanë qenë pozitive, të tilla që shpesh nuk kanë mundur të merren me mend as nga vizionarët më optimistë. Ky vlerësim pak si rozë ka dy mbështetje: e para, se kthesa në historinë shqiptare ka qenë e jashtëzakonshme dhe se rreziku i zhbërjes, si me magji, u kthye në faktorizim; dhe, e dyta, se parashenjat për mbylljen pozitive të këtij procesi janë evidente, perspektive, të dukshme dhe lehtësisht të perceptueshme.

Por, më anë tjetër, ekziston edhe një perceptim i kundër me këtë, i skeptikëve, apo edhe i idealistëve, të cilët tani gjenden në të njëjtën radhë, pra i atyre që mendojnë se shqiptarët ishte dashur të ishin ndryshe nga ç'janë, se pas zhvillimeve të favorshme në botën e tyre të njëzet viteve të fundit, ka qenë krejt normale që ata të mos mbeten populli më i varfër, më i prapambetur, më i vuajtur, më i vonuar dhe më i paintegruar i Europës së vjetër. Sipas tyre bëhet fjalë për një shans të humbur në rrugën e faktorizimit përfundimtar të shqiptarëve në Ballkan, për ridefinimin e potencialit të tyre kombëtar, politik, ushtarak, ekonomik, kulturor etj. Pavarësisht nga trashëgimia e rëndë, pavarësisht nga arsyetimet që mund të gjenden, idealistët shqiptarë, ndonëse gjithmonë kanë vullnet të madh dhe manifestojnë qëndrueshmëri të jashtëzakonshme në parashikimet e tyre optimiste, tashmë edhe ata kanë dhënë shenja të qarta të zhgënjimit. Edhe skeptikët po ashtu kanë dhënë shenja të qarta të lodhjes, duke kritikuar pa fund fenomenet negative, të cilat kanë dominuar dhe vazhdojnë të sundojnë botën shqiptare, duke filluar nga mungesa e

tradiçës shtetërore dhe institucionale, tradhtia e kudogjendshme, mercenarizmi i patejkalueshëm, e deri te prirjet e jashtëzakonshme kriminale, që e bëjnë shqiptarin shtetas të keq për vendin e vet dhe qytetar të padenjë të Europës së integruar.

Në këtë konstalacion të gjerë çështjesh problemore, të diskutueshme dhe të mbetura jashtë vëmendjes, ndër të tjera, është edhe Kosova si entitet historiko-politik dhe etnonimi *kosovar* si emërtim identifikues. As Kosova as kosovarizmi, vetëm si tillë, nuk janë dhe nuk përbëjnë identitet, por janë elementë të identitetit, apo, në një kontekst më të gjerë, janë përbërës identitarë në tentativë. Tashmë e kemi sqaruar se çfarë përbën Kosova në kuptimin historik: përrallë dhe legjendë për serbët, vilajet në kohën e Turqisë, një përqendrim i paparë zhvillimesh tragjike për shqiptarët. Në kohën e Turqisë qendër e vilajetit të Kosovës ishte Shkupi, që domethënë se kufijtë e Kosovës ishin të tjerë. Në periudhën e sundimit të mbretërisë jugosllave, Kosova nuk përbënte entitet, ishte e ndarë ndërmjet banovinave të Serbisë dhe Malit të Zi. Duket se për herë të parë si entitet politik me konotacionin e tanishëm zë të formësohet me lëvizjen komuniste, pas vitit 1941, por edhe atëherë gjërat mbesin të paqarta, deri në përfundim të Luftës së Dytë dhe me organizimin e ri territorial të Jugosllavisë socialiste. Ta zëmë, Lidhja e Dytë e Prizrenit në organizimin e saj përfshinte jo vetëm Shkupin, Tetovën, Gostivarin e Dibërën, por edhe Pazarin e Ri, Tutinin, Rozhajën, Plavën dhe Gucinë. Gjatë kohës së sundimit të fuqive të boshtit, Kosova ishte e ndarë ndërmjet Italisë, e cila përfshinte një zonë më të gjerë të bashkëngjitur Shqipërisë (ajo zonë quhej Kosovë, pa ndonjë atribut tjetër), Gjermanisë në veri (një ndarje që i afrohet ndarjes që aktualisht e synojnë serbët) dhe Bullgarisë në lindje. Po në këtë periudhë, komunistët e

PKJ-së organizojnë njësi partizane shqiptaro-maqedonase, ndërsa Konferencën e Bujanit dokumentet në gjuhën shqipe flasin për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit, ndërsa në gjuhën serbe për Kosovë dhe Metohi. Në Bujan (nuk thuhet se pse) morën pjesë edhe përfaqësuesit e Plavës dhe Gucisë, por jo edhe të territoreve të tjera shqiptare të përfshira në mbretërinë jugosllave.

Me këtë emërtimin (Kosovë-Metohi, shkurt Kosmet) Kosova merr edhe atributet e organizimit territorial dhe të autonomisë në Jugosllavinë socialiste, gjithnjë derisa lëvizjet politike të viteve '60 krijojnë hapësirë për ekuivalentin shqip të këtij emërtimi të kryehershëm (Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit). Ky dualizëm emërtimesh, një shqip dhe një serbisht, sikundër edhe fakti se toponimi Metohi kishte karakter kishtar, bëhet një nga objektivat e ndryshimeve politike në Kosovë dhe rreth Kosovës pas Plenumit të Brionëve: Kosovës i hiqet atributi Metohi apo Rrafsh i Dukagjinit dhe hapësira e saj përkufizohet si njësi territoriale autonome në kuadër të Jugosllavisë. Aq sa mund të konsiderohet meritë e autonomistëve vendosja e kufijve administrativë të Kosovës në ish-Jugosllavi, po kaq mund të konsiderohet dështim i tyre mbetja jashtë Kosovës e territoreve etnikisht dhe historikisht shqiptare, siç ishin Shkupi dhe Tetova, Lugina e Preshevës apo Plava e Gucia.

Sido që të jetë, toponimi Kosovë u stabilizua në një përdorim të gjerë nga vetë banorët e kësaj hapësire pikërisht në periudhën e autonomisë jugosllave. Shqipëria, ndërkaq, dukej se kishte ruajtur një perceptim më të hershëm të Kosovës, e cila nuk kufizohej vetëm në krahinën autonome jugosllave, por përfshinte zona më të gjëra të banuara me shqiptarë, veçmas në Serbi dhe Maqedoni. Serbët, ndërkohë, për një kohë të gjatë e mbajtën vëmendjen te Kosova si sinonim i hapësirës ku ishte zhvilluar beteja legjendare,

kështu që heqja e pjesës së dytë të emërimit, Metohi, për një kohë nuk përbente asnjë problem. Pas zhvillimeve politike në Serbi në prag të viteve '90, me ndryshimet kushtetuese të asaj kohe, Kosovës iu kthye edhe emërtimi i bashkëngjitur Metohi, më një anë si identifikim i ndajshtuar kishtar dhe, më anë tjetër, si perceptim politik i një Kosove pa autonomi, siç kishte qenë dikur, tërësisht e përfshirë në kuadër të Serbisë. Edhe aktualisht Serbia mban në përdorim po këtë emërtim, sepse në raport me Kosovën, Kushtetuta e Serbisë është po ajo e kohës së Milosheviqit. Në mediet ndërkombëtare, mbase edhe në kancelaritë diplomatike, Kosova zë të përmendet pas vitit 1981, duke arritur shkallë të lartë të identifikimit me ngjarjet politike të viteve '90 dhe tutje.

Ndryshe nga toponimi Kosovë, *etnonimi kosovar* ka një shtrirje kohore krejt të ndryshme, madje dukshëm më të reduktuar. Në periudhën e ish-Jugosllavisë, banorët e Kosovës, pra shqiptarët, shumë rrallë e quanin veten kosovarë, por me një emërtim më evaziv dhe jo njëgjymtyrësh, më shumë si sintagmë - *shqiptarë të Kosovës*, për t'u dalluar nga shqiptarët e Maqedonisë dhe shqiptarët e Malit të Zi (shqiptarët e Luginës së Preshevës nuk janë quajtur kurrë shqiptarë të Serbisë, por vetëm të Preshevës). Më anë tjetër, nga shqiptarët e ish-Jugosllavisë, Shqipëria nuk është quajtur *shteti shqiptar*, sepse nuk është konsideruar kuadër që mund ta përfshijë këtë kuptim. Të gjitha këta etnonime ruanin në plan të parë përkatësinë shqiptare dhe atë e theksonin domosdo përpara përkatësisë territoriale. Po ta pyesje kosovarin e viteve '70 ose '80 se kush ishte, ai do të thoshte pa një pa dy: jam shqiptar i Kosovës dhe shumë rrallë do të përdorte etnonimin kosovar. Më shumë se kosovarët për vete, këtë etnonim filloi ta përdorte më dendur Shqipëria në kohën e marrëdhënieve intensive me

Kosovën, si dhe shqiptarët e Maqedonisë dhe të Malit të Zi, për të bërë një dallim të përkatësisë territoriale, nga se të gjithë së bashku përbënin entitetin e përbashkët, *shqiptarë të Jugosllavisë*. Madje as në vitet '90, kur ngjarjet rreth Kosovës filluan të fitonin dinamikë të paparë, komuniteti ndërkombëtar nuk e përdori etnonimin kosovar, por emërtimin *shqiptarë etnikë*. Serbët, ndërkaq, asnjëherë nuk e përvetësuan këtë etnonim, e para, sepse nuk deshën që banorët e Kosovës të përbënin një etni të veçantë, ngase, sipas perceptimit të tyre, Kosova është pjesë integrale e Serbisë; dhe, e dyta, si rrjedhojë e këtij përkufizimi territorial të Kosovës, duhej të rridhte edhe identifikimi i shqiptarëve të Kosovës, si pakicë kombëtare në kuadër të shtetit serb. Pavarësisht se Serbia unike është derivat i politikës së Milosheviqit, këtij parimi i përmbahen të gjithë serbët edhe sot e kësaj dite, edhe e ashtuquajtura shoqëri civile, edhe klasa politike, sikundër edhe qytetarët e zakonshëm.

Vetëm pas vitit 1999 filloi një përdorim më i shtuar i etnonimit kosovar, brenda dhe jashtë Kosovës, si ekuivalent i entitetit politik Kosovë, e cila tashmë duhej të përkufizohej si e mëvetësishme dhe qartësisht e identifikueshme. Kështu, pas vitit 1999 etnonimi kosovar pati dy përdorime të njëhershme: njëri, që nënkuptonte banorët e hapësirës ku kishin ndodhur zhvillime politike të deriatëhershme, emërtim që mund të thuhet se kishte realizëm dhe objektivitet; dhe, tjetri, që sugjeronte zhvillimet e pritshme politike, ku ndonjëherë kishte mosdije, ndonjëherë dashaligësi, madje edhe komplot politik. Nuk janë të paktë të huajt në Kosovë dhe jashtë saj që etnonimin kosovar e shohin si emërtim adekuat për banorët e hapësirës që përfshin Kosovën, banorë këta që popullojnë një entitet të veçantë politik, rreth të cilit bashkësia ndërkombëtare zhvilloi një luftë dhe jashtëzakonisht shumë diplomaci. Në

mendjen e këtyre të huajve kosovarët nuk emërtohen si të tillë me ndonjë prapavijë, ta zëmë, për t'i ndarë nga shqiptarët e tjerë, por vetëm për qartësi përkufizimi. Më anë tjetër, që nga viti 1999 e prapa, ekzistonte edhe një kontekst politik i përdorimit të etnonimit kosovar, brenda dhe jashtë Kosovës, si përkufizues i ndarjes së këtij entiteti politik nga hapësirat e tjera shqiptare. Qëllimi i këtij emërtimi, njësoj si qëllimi ndarjes, kishte për synim krijimin e një identiteti të ri, i cili do ta bënte funksionale ndarjen e Kosovës nga hapësirat e tjera shqiptare, në mënyrë që Kosova, e konsideruar si vatër e nacionalizmit shqiptar, eventualisht, të mos pretendonte prishjen e balancave politike në Ballkan.

Modeli postkolonial

Shpallja e pavarësisë dhe bërja e Kosovës shtet më vete, për një numër njerëzish në Kosovë dhe jashtë saj do të duhej të ishte kuadër i mjaftueshëm që kjo pjesë e shqiptarëve të krijonte një identitet të ri, të diferencuar nga të tjerët. Ky identitet i ri, duke mbledhur copat e mbetura të *identiteteve plotësuese*, siç është identiteti i mëvetësishëm politik, kuadri shtetëror, por edhe përbashkësia e banorëve me përkatësi të ndryshme kombëtare që banojnë të njëjtën hapësirë; pra, të gjitha këto së bashku, të funksionalizuara në një tërësi identitare të diferencuar teorikisht mund të krijojnë edhe komb të ri. Në këtë rast, pjesëtarët e kombit kosovar nuk do të kishin përbërës kryesorë të identitetit gjuhën e përbashkët, traditën, historinë, madje këto mund të përbënin elementët e ndarjes së tyre, por krejt diçka tjetër, siç mund të jetë territori dhe projeksioni hipotetik ose real i të ardhmes politike. Sipas kësaj teorie, në botën

bashkëkohore të integritimeve dhe komunikimeve intensive, shtetet janë ato që krijojnë kombet, ndryshe nga ç'kishte ndodhur në shekullin XIX, kur kombet kanë krijuar shtetet. Në të vërtetë, ky është modeli amerikan i kombit-shtet, i cili ka ndjekur një rrugë tjetër të krijimit të identitetit, rrugë e krijimit të ashtuquajturve kombe të reja postkolonialë, që historikisht dhe politikisht ndryshojnë shumë nga traditat europiane e krijimit të kombeve dhe identiteteve kombëtare.

Pra, në rastin tonë, shteti i Kosovës duhej të ishte kuadër i mjaftueshëm, që i plotëson të gjitha kushtet për të krijuar, fillimisht, një identitet të ri të pjesëtarëve të tij dhe, më pastaj, edhe një komb të ri, i identifikueshëm jo me veçoritë ndarëse të përbërësve të identitetit të shekullit XIX, por me karakteristikat kohezive të përbërësve identitarë të modernitetit. Me një fjalë, pjesëtarët e etnisë shqiptare që banojnë Kosovën dhe pjesëtarët e etnive të tjera, që nuk përbëjnë më shumë se 8% të popullsisë së Kosovës (serbë, malazezë, boshnjakë, turq, romë etj.), ndërsa janë të lidhur mes veti me jetën e përbashkët në një hapësirë administrative; ndërsa janë të lidhur mes veti me internet dhe komunikojnë anglisht (shqiptarët, për inat të serbëve, nuk flasin serbisht; serbët, turqit etj. e kanë nënçmuar gjithmonë gjuhën shqipe dhe nuk duan ta flasin atë); ndërsa kanë aspirata të përbashkëta të integritimeve europiane; ndërsa shqiptarët nuk duhet ta duan Shqipërinë, sepse janë 92% e popullsisë së Kosovës dhe çdo dashje e tyre e Shqipërisë rrezikon stabilitetin e rajonit; ndërsa serbët, që përbëjnë 5% të popullsisë së Kosovës, mund ta duan Serbinë, sepse me dashjen e tyre të Serbisë nuk e rrezikojnë stabilitetin e rajonit; pra, në një rrethanë të këtillë është krejt e natyrshme, madje e pëlqyeshme, që shqiptarët e Kosovës, të cilët përbëjnë 92% të popullsisë së këtij shteti të ri, me synim që t'i integrojnë pakicat dhe ta bëjnë Kosovën

multietnike, duhet të heqin dorë nga identiteti i tyre i kryehershëm dhe të transformohen në një përkatësi tjetër etnike, e cila është më pak e urryer nga serbët dhe pjesëtarët e tjerë të pakicave. Këtë u takon ta bëjnë shqiptarët, sepse, duke qenë shumicë, ata kanë interes të veçantë bërjen dhe funksionimin sa më të mirë të shtetit të Kosovës.

Thënë me një fjalë, kjo procedurë e bërjes një herë të një *identiteti të ri* dhe më pastaj edhe të një *kombi të ri* me parashenjë integruese, duhet ta diferencojë qartë kombin nga etnia: kombi kosovar do të duhej të ishte njësi kohezive shtetërore me përbërës të identitetit të përbashkët mbietnikë, në të cilin do të merrnin pjesë me identitetet e tyre të ndara pjesëtarët e të gjitha etnive që jetojnë në Kosovë. Ky është një hap më tej, nga ç'është kërkuar me dokumentin e Ahtisaarit, sepse aty thuhet se Kosova duhet të jetë shtet multietnik, por jo një sajese mbietnike, ku banorët e saj, për ta bërë shtetin funksional, duhet të heqin dorë nga identitetet e tyre. Kjo vështirë që mund të ndodhë, sepse, në radhë të parë, detyrimet politike duan kohë të gjatë që të prodhojnë vetëdije. Në rastin tonë, shteti i Kosovës paraqitet *detyrim politik* dhe koncesionet më të mëdha duhet t'i bëjnë shqiptarët. Ata që janë bartësit kryesorë të sovranitetit, sepse përbëjnë 92% të popullsisë. Që të jemi edhe më eksplicitë: ata, pra shqiptarët, bashkë me 8% të pakicave, duhet të heqin dorë nga disa përbërës identitarë për të ndërtuar kombin mbietnik kosovar, ide kjo që duhet të funksionalizohet për dy arsye: e para, që Kosova t'i integrojë dhe t'i bëjë qytetarë luajalë 5% të popullsisë së vet serbe, sepse, sipas logjikës së gjërave, nëse shqiptarët e Kosovës heqin dorë nga disa përbërës identitarë, respektivisht nuk e afishojnë përkatësinë e tyre etnike shqiptare, kanë më shumë gjasë që serbët e Kosovës t'i bëjnë për vete; dhe, e dyta, që Kosova të marrë attribute shtetërore të

mëvetësishme, krejtësisht të diferencuara nga Shqipëria, në mënyrë që kushtëzimi i dokumentit të Ahtisaarit që Kosova të mos bashkohet me Shqipërinë dhe as me shqiptarët e Maqedonisë të bëhet fakt i pakthyeshëm, sa më i qëndrueshëm në kohë.

Natyrisht që kjo ide, për shumë arsye, është degjeneruese, sepse krijon konfuzion dhe nxjerr jashtë funksionit të gjitha forcat kohezive që e mbajnë Kosovën dhe e bën atë të paqëndrueshme, si një lojë fëmijësh, madje më keq, si fantazmagori pianecësh. Së pari, shembuj të këtillë të krijimit të kombeve të reja, me ose pa diferencim nga etnia, nuk ka në Europën e vjetër. Më anë tjetër, asnjëri nga konfliktet e ngjashme me Kosovën në Europë nuk janë zgjidhur dhe as që pritet të zgjidhen me *lëvizje degjeneruese identitare*. Askush, ta zëmë, nuk ka kërkuar që katolikët dhe anglikanët e Irlandës së Veriut të bëjnë paqe, duke hequr dorë njëra dhe tjetra palë nga përkatësia e tyre e identitetit, për të krijuar një identitet mbietnik ose mbifetar. Së dyti, lëvizjet identitare, sado të motivuara që mund të jenë, janë lëvizje tektonike, që tronditin kombet deri në qenien e tyre, pra deri në esencë, duke lënë prapa zbrazësi të mëdha, që vështirë plotësohen me motive politike, çfarëdo që të jenë ato. Shteti i Kosovës mund të jetë interes superior i shqiptarëve të tij, por çështja shtrohet nëse ai shtet i bërë duke sakrifikuar të pasakrifikueshmen mund të funksionojë ose jo, sepse heqja dorë nga identiteti kombëtar për shqiptarët e Kosovës, sado e motivuar politikisht, është një sakrificë që nuk përballohet. Pra, thënë me një fjalë, shqiptarët e Kosovës nuk është dashur dhe nuk duhet të vihen në pozitë që të zgjedhin ndërmjet shtetit të Kosovës dhe identitetit të tyre kombëtar, sepse zgjedhja do të jetë e pamundur, madje tragjike.

Mund të thuhet, pa ndonjë hamendje të madhe, se shteti i Kosovës është rezultat i padiskutueshëm i qëndrueshmërisë së identitetit të shqiptarëve të Kosovës. Pra, nuk bëhet fjalë për një rrugë tjetër historike të bërjes së Kosovës së pavarur, përveç të ndjekjes me konsekuencë të idesë që lidhet me *përkatësinë shqiptare* të shumicës së popullit të saj. Kjo është historia. Por disa mendojnë se proceset duhet çuar përpara dhe se Kosova nuk mund të mbetet rob i historisë, sado e qëndrueshme dhe pozitive të jetë ajo. Sipas kësaj logjike, historia duhet t'ia lërë vendin një procesi politik të avancuar, në mënyrë që aktualiteti kosovar të dalë nga ngërçi i tejzgjatur dhe të avancojë drejt sfidave të reja, siç janë integrimet e kështu me radhë. Në pikëpamje të pragmatizmit politik kjo duket e akceptueshme, por ka një defekt shumë të madh brenda. Shoqëria kosovare nuk është në bërje e sipër, përkundrazi, ajo tashmë e ka përmyllur një proces historik, ku përbërësit identitarë kanë luajtur rolin kryesor. Ajo mund të përfshihet në proceset e reja, çfarëdo qofshin ato, jo duke shpërbërë sistemin e saj të vlerave, por duke i përshtatur ato me rrethanat dhe synimet bashkëkohore. Sepse sistemi i vlerave, që hyn në përbërësit e identitetit të secilit komb, nuk mund të zëvendësohet. Nëse zhbëhet, ai lë prapa një zbrazësi të paplotësuar, e cila u ngjan atyre vrimave të zeza të gjithësisë, të cilat gëlltisnin materien, në këtë rast vetë qenien e kombit.

Kjo tani po ndodh me Kosovën. Lëkundja e përbërësve të identitetit ishte lëkundje e sistemit të vlerave, që solli pasoja të mëdha për Kosovën, në konstalacionin e saj të tanishëm politik, social, kulturor, pra, ndodhi një zhvendosje e identitetit nga idealizmi në pragmatizëm. Identiteti kombëtar i shqiptarëve të Kosovës ishte sistem vlerash, disa ishin vlera të qëndrueshme, pra reale, disa të tjera ishin të paqëndrueshme, pra hipotetike. Në këtë pikë,

në dualitetin e vlerave hipotetike dhe reale, ne nuk dallojmë shumë nga kombet e tjera, përveç se sasia e vlerave hipotetike ose të supozuara, mund të jetë shumëfish më e madhe se ajo e vlerave reale. Ky sistem vlerash, i tillë çfarë ka qenë, me shumë përbërës hipotetikë dhe me më pak përbërës realë, ka krijuar *patriotizmin* e shqiptarit të Kosovës, *idealizmin* e tij. Në idealizmin e shqiptarit të Kosovës ka pasur shumë mungesa, shumë kotësi. Në patriotizmin e tij ka pasur shumë folklorizëm, naivitet, madje edhe hipokrizi. Tani, nëse shqiptarit të Kosovës, që t'ia ndryshojmë ose t'ia ribëjmë identitetin, ia heqim përbërësit identitarë, siç është dashuria ndaj atdheut (Kosovë e Shqipëri), pastaj të drejtën për ta ëndërruar një atdhe ideal dhe të përsosur, bashkë me idealizmin se atdheu dhe kombi i tij janë *attribute* për t'u ndjerë krenar (romantizmin), atëherë çfarë do të mbetet prej tij? Do të mbetet pragmatizmi jetësor, që është shumë i rëndësishëm, por nuk është i mjaftueshëm.

Në të vërtetë, shqiptari i Kosovës i kthyer në kosovar, do të duhej të ishte pikërisht i tillë, pragmatik, njeri i zhveshur nga idealizmi dhe iluzionet, praktik, hedonist, që synon të jetojë mirë, që pasjen e ka ideal, të gjitha këto për një kohë sa më të shkurtër. Në esencë, edhe idealistët i synojnë të njëjtat gjëra, por derisa ata mendojnë t'i arrijnë këto përmes një procesi të komplikuar, pragmatikët këtë e bëjnë nëpër një rrugë tjetër, të drejtpërdrejtë, egoiste, shpesh duke shkelur mbi parime dhe duke e parë botën të zhveshur nga çdo vlerë tjetër, vetëm si hapësirë të realizimi të interesave të tyre.

Së këndejmi, për shkak të tronditjeve dhe luhatjeve që ndodhën në procesin politik të Kosovës, i cili u shoqërua me luhatje identitare, veçmas të asaj pjese që përbënte idealizmin e shqiptarëve të Kosovës, Kosova papandehur ra në një *vakuum vlerash* dhe kosovari me identitet të posabërë,

pragmatik dhe hedonist, materialist dhe mercenar, i zhveshur nga idealizmi dhe i egër në synime për të shfrytëzuar çdo rrethanë të përshtatshme për interesa egoiste, shumë shpejt u transformua në njeri me vese, i paskrupullt, i rrezikshëm për veten e tij dhe i papërshtatshëm për ambientin që e rrethon, përfshirë edhe Europën e synuar deklarativisht. Për të shteti i Kosovës tashmë nuk ka kuptimin e ndonjë ideali, sepse një shtet i bërë me armime politike dhe me copëza identitetesh të deformuara, nuk mund të shërbejë për vizione idealiste, por vetëm për pragmatizëm afatshkurtër. Prandaj ky shtet duhet shfrytëzuar maksimalisht për makutëri dhe harbutëri, për krim dhe korrupsion, me një fjalë për përfitim të shpejtë, pa respektuar asnjë ligj dhe asnjë vlerë morale.

Mund të jetë se kjo rrëshqitje e kosovarëve nga idealizmi në zhbërje vlerash do të ndodhte në çdo rrethanë, edhe sikur në asnjë formë të mos viheshin në diskutim çështjet e identitetit, edhe sikur idealizmi të ishte përfshirë në përbërësit jo vetëm identitarë por edhe politikë të shtetit të Kosovës, sepse shteti i Kosovës ishte një kuadër i porsazbuluar për nga mundësitë për abuzim masiv, nga njëra anë, ndërsa vetë idealizmi i shqiptarëve, në përgjithësi, është i shpenzueshëm, për përdorim afatshkurtër. Mirëpo, nuk mund të mohohet se rruga ose procesi i bërjes së këtij shteti i theu barrierat psikologjike të kufizimeve morale për t'iu nënshtruar negativiteteve. Procesi i degradimit dhe degjenerimit të shqiptarit të Kosovës ishte shumëplanësh dhe u zhvillua paralelisht në disa drejtime. Zhbërja identitare është njëri prej tyre, siç është njëri prej tyre edhe modeli i keq i ndërkombëtarëve të përfshirë në administratën e UNMIK-ut, apo edhe i evropianëve të përfshirë në misionin e EULEX-it.

Në këtë proces, pra në procesin e bërjes së shtetit të Kosovës, shqiptari i Kosovës u ballafaqua me rrënimin e shumë shënjtërive, ndër të cilat edhe të luhatjes së identitetit kombëtar. Para këtij procesi, shqiptari i Kosovës mund të reagoonte me shumë egërsi nëse i prekej ky identitet. Ai mund të reagoonte ashpër edhe nëse i thuhej se Shqipëria nuk duhet të jetë ideal i tij politik. Ai mund të reagoonte ashpër nëse i thuhej se shteti i Kosovës në radhë të parë do të bëhet jo për sendërtim idealesh, por për interesa makutërie të klasës politike. Ai mund të reagoonte po kaq ashpër nëse i thuhej se 28 Nëntori nuk do të jetë më festë e tij kombëtare. Ai do të reagoonte po kaq ashpër nëse i thuhej se shteti i Kosovës do të bëhej për të jetuar keq shumica e banorëve të tij. Ai nuk do ta honeste aq lehtë një nënshtrim pa kushte ndaj bashkësisë ndërkombëtare të politikanëve të Kosovës, për shkak të dosjeve të tyre të krimeve gjithfarëshe. Pra, shndërrimi identitar i shqiptarit të Kosovës në kosovar ka qenë dhe është i përplotësuar, i ngarkuar dhe i sulmuar nga të gjitha anët me shumë dukuri përcjellëse negative, të cilat ose janë pjesë e këtij procesi, ose e kanë shoqëruar atë hap pas hapi.

Shteti si kompromis

Prandaj, për shkak të kësaj situatë të fillimit, edhe pas decenies së parë të shekullit XXI, Kosova mbeti në gjendjen fillestare të një paqartësie të përgjithshme, një gjendje pezull, sepse ishin zgjidhjet e papërshtatshme politike ato që e vendosen pikëpyetje rreth identitetit të saj. Me kërkimin e një identiteti të ri, po u bëhej një fyerje kosovareve, sepse ata nuk mund të ishin njerëz aq pa vlera, pa histori, sa që tani të

kërkonin attribute identitare. Po të merrte një zgjidhje të drejtë statusi i Kosovës, zgjidhje të natyrshme, çështja e identitetit kosovar as që do të hapej ndonjëherë, sepse ai nuk kishte bazë historike, ndërkohë që bazën politike (nëse e ka një të tillë) e krijoi nga refuzimi i zgjidhjeve optimale, apo nga konfuzioni që shkaktoi ky refuzim. Kjo nuk është situatë për krenari, madje është një situatë që përbën një stigmë, sepse të arrish në shekullin XXI me identitet të diskutueshëm, kjo rrethanë përjashton mburrjen dhe krekosjen dhe është e panatyrshme për secilin popull të Europës. Dhe është një damkë që i vihet Kosovës, në një kohë që ajo kërkon zgjidhje për çështjen e saj të mbetur pezull. Kosova kërkonte zgjidhje politike, nuk kërkonte identitet, sepse një gjë e tillë atë e fyen, ia fyen kujtesën dhe historinë. Edhe Europa e dinte se të jesh një popull-thjeshtër, të cilit kërkohet t'i vihet një emër, mund të ketë qenë veçori e shekujve të mesjetës deri në shekullin XIX, por jo e shekullit XXI.

Larg këtyre teorive, rruga e bërjes së Kosovës kaloi nëpër një proces politik arbitrar, që nuk përfillte shumë nga rregullat e bërjes së shteteve, nuk përfillte procesin historik, nuk përfillte *idetë shqiptare*, të cilat e kishin mbajtur gjallë Kosovën, e kishin prurë atë deri në prag të këtij zhvillimi. Në vend të ideve shqiptare, autentike, Kosovës iu imponua bërja e shtetit sipas ideve dhe teorive kontemporane, modele të transplantuara ose të huajtura. Kjo vinte si rrjedhojë e faktit se Kosova nuk u çlirua me forcat e veta dhe bërja e saj u shndërrua në projekt ndërkombëtar. Prandaj edhe procesi duhej të pësonte devijim. Po të fitonin *idetë shqiptare*, Kosova nuk do të bëhej shtet, sepse shteti i Kosovës, edhe pse i afishuar përpara se të ndodhte lufta e vitit 1999, jo vetëm që ishte ide e kohëve të vona, por, mbi të gjitha, ishte përimituar

në mendjen e shqiptarëve dhe të ndërkombëtarëve si ide kompromisi.

Thënë më saktë, ideja e shtetit të Kosovës lindi në fillim të viteve '90, kur nisi të zhbëhej Jugosllavia. Më parë kishte ekzistuar ideja e Republikës së Kosovës në kuadër të Jugosllavisë, jo për të mbetur pjesë e atij shteti, por për shkak se, sipas parimit leninist, republikat respektivisht kombet mund të futeshin në përbërjen e një shteti socialist-komunist me një marrëveshje, duke ruajtur gjithnjë të drejtën e shkëputjes. Lëvizja separatiste-nacionaliste në Kosovën e viteve '68-'81 synonte pikërisht këtë, jo bërjen e ndonjë republike të Kosovës me attribute të shtetit, por një republikë socialiste në kuadër të Jugosllavisë, siç ishin edhe republikat e tjera të kësaj federate, e cila në momentin e përshtatshëm do të shkëputej nga ky shtet dhe do t'i bashkohej Shqipërisë. Realisht, lëvizja politike në Kosovë deri në vitet '90 të shekullit XX ishte lëvizje tipike separatiste. Askund, as në shtypin ilegal të asaj kohe, as në ndonjë diskutim sado joformal dhe klandestin, nuk ishte hedhur ideja për shtetin e pavarur të Kosovës. Pavarësia lindi si njëri nga tre opsionet e zgjidhjes së çështjes së Kosovës në prag të zhbërjes së ish-Jugosllavisë, që i nxori një forum i përbashkët i partive politike të Kosovës në fillim të viteve '90. Nëse mbetej Jugosllavia federatë ose konfederatë, Kosova kërkonte të bëhej njësi e barabartë me republikat e tjera në atë shtet. Edhe e ashtuquajtura deklaratë kushtetuese e 2 korrikut mbështetej mbi këtë opsion. Ky ishte opsioni i parë. Opsioni i dytë ishte pavarësia, që do të vinte si rezultat i zhbërjes së ish-Jugosllavisë dhe i pavarësimit të republikave që e përbënin shtetin federativ. Dhe opsioni i tretë ishte bashkimi me Shqipërinë, nëse ndodhte rikonfigurimi i kufijve në Ballkan.

Përse fitoi opsioni i dytë? Sepse ishte opsion kompromisi dhe në konkordancë të plotë me proceset e bërjes së shteteve nacionale nga ish-federata jugosllave. Në të vërtetë, sikundër dihet, i ashtuquajtimi komision i Badinterit nuk ia njohu Kosovës të drejtën e sukcesionit. As marrëveshja e Dejtonit nuk e përfshiu. Megjithatë, parimi më i mundshëm dhe më i afërt për zgjidhjen e çështjes së Kosovës mbeti parimi i ndjekur nga bërja e shteteve të tjera, që dolën nga ish-Jugosllavia. Si të thuash, ky ishte parim i gatshëm, që nuk kërkonte përpunim të rregullave të reja. Më anë tjetër, bërja e Kosovës shtet hapte një konflikt provizor me Serbinë, por i linte të qetë shtetet e tjera të rajonit. Pavarësia, pra, ishte *opsion i kompromisit*, që shqiptarët duhej të bënin për të ruajtur baraspeshat rajonale, në mënyrë që rikonfigurimi i kufijve të mos hapte kutinë e Pandorës, të mos niste një proces tjetër, atë të rirregullimit të kufijve, që do të ishte edhe më i vështirë se ky i bërjes së shteteve nacionale.

A u pajtuan lehtë shqiptarët e Kosovës me këtë zgjidhje? Para se të ndodhte zgjidhja, shqiptarët e Kosovës qëndruan për një kohë kundruall një sërë opsionesh tmerrësisht më negative. Ata provuan dhunën sistematike serbe, provuan gjenocidin, kështu që ata mund të pranonin çdo zgjidhje politike, e cila do të përjashtonte kontrollin e Serbisë mbi Kosovën, madje edhe një protektorat të përjetshëm ndërkombëtar, ose një *gubernë* e kujtdo qoftë. Opsioni i pavarësisë i përmbushte pjesërisht ambiciet historike të Kosovës, ndërsa i përmbushte plotësisht ambiciet e klasës politike, përfshirë këtu edhe ata që kishin dalë nga lufta. Gatishmëria pothuajse pa asnjë kundërshtim për ta pranuar pavarësinë, pra, përveç që u kushtëzua me mbetjen nën Serbi ose nën një protektorat afatgjatë ndërkombëtar, u kushtëzua edhe me braktisjen e mbështetjes së aleatëve.

Kosova iu dorëzua atyre që e bënë lirinë e saj dhe, në këtë drejtim, deri në bisedimet e Vjenës, klasa politike e Kosovës mund të thuhet se ishte pothuajse e pafuqishme të ndryshonte çfarëdo qoftë. Thënë me një fjalë, pavarësia e Kosovës tashmë ishte bërë opsion i fuqive vendimmarrëse dhe shqiptarët e Kosovës nuk mund ta ndryshonin atë. Këtë e dinë të gjithë. Por atë që nuk e dinë ose nuk e thonë të gjithë, është se opsioni i pavarësisë kishte modalitete, ndërsa klasa politike e Kosovës, e padijshme, arrogante, jotransparente me popullin e saj, u fut në gracka marrëveshjesh që do ta lëndonin rëndë pavarësinë. Nuk bëhet fjalë nëse pavarësia ishte opsion i pranueshëm për kosovarët ose jo, bëhet fjalë për *shkallën e lëndimit* të saj, respektivisht për pamundësinë e funksionimit të një shteti normal me kushtëzime të këtilla.

Ta zëmë, askush nuk e ndalonte klasën politike të Kosovës, pjesëmarrëse në bisedimet e Vjenës, që për një mori çështjesh të ishte transparente me popullin e vet, ta njoftonte atë me kohë për të gjitha opsionet, të përfshinte në këtë proces inteligjencën akademike, për disa zgjidhje t'ia kalonte kompetencat Kuvendit të Kosovës, për disa të tjera, që lidheshin me sovranitetin, ta përdorte referendumin. Përkundrazi. Klasa politike e Kosovës, pjesëmarrëse në bisedimet e Vjenës, fshehu çdo gjë nga populli. Ata, me shkurtpamjen e tyre, u futën në një rrugë pa krye, duke bërë kompromise joparimore. Më pas u shpall pavarësia, por pavarësia ishte e kushtëzuar dhe në rrethanat e euforisë pakkush e vërejti se Kosova po bëhej një shtet i lënduar, një shtet që do ta kenë të vështirë ta duan vetë mbështetësit e saj më të flaktë.

KOSOVARIZMA KUNDREJT SHQIPTARIZMËS

Luhatjet identitare

Pikërisht, në fazën e përmbylljes së kompromiseve për pavarësi, u hodhën në qarkullim edhe idetë për identitetin kosovar, identitet ky që duhej të “mbulonte” jo pavarësinë si zgjidhje të çështjes së Kosovës, por lëndimet që iu shkaktuan kësaj pavarësie. Pra, identiteti kosovar nuk u shfaq si imanencë e pavarësisë, por si *surrogat* i saj, ose, thënë më mirë, si argument për të minimizuar dështimet evidente. Nëse opsioni i shtetit të Kosovës ishte projekt ndërkombëtar dhe fuqitë vendimmarrëse nuk deshën që Kosova t’i bashkohej Shqipërisë për shkaqe që tashmë i kemi të njohura, atëherë ishte krejt logjike që Kosova do të bëhej shteti i dytë shqiptar në Ballkan. Çdo gjë që ndodhi pastaj, u bë për të minimizuar këtë fakt, ose, thënë më mirë, për ta degraduar këtë arritje historike të shqiptarëve. Dikush thotë se kjo u bë për shkak të koncesioneve ndaj Serbisë dhe Ruisë, dikush tjetër për shkak të mospajtimeve SHBA-BE. Ç’rëndësi ka kjo për ne? Me rëndësi është fakti i bërjes së Kosovës një shtet që nuk mund të funksionojë, sepse një Kosovë me jo plot njëmbëdhjetë mijë kilometër katrorë, e përkufizuar si shtet multietnik, e lidhur fort përmes komunave serbe me Serbinë, me një konflikt të ngrirë në veri (i lënë qëllimisht si i tillë), me mungesë të theksuar të traditës shtetërore, me potencial të papërfillshëm ekonomik,

me konflikte të brendshme politike të trashëguara, e gjendur në një udhëkryq rrugësh për trafiqe e kontrabandë, e përqeshur dhe e tallur nga bashkësia ndërkombëtare, e refuzuar me arrogancë nga Europa e vjetër, me një klasë politikanësh të papërgjegjshëm, pra, ç'mund të paraqesë një Kosovë e këtillë kundruall Serbisë, e gatshme në çdo kohë për ta shantazhuar deri në pafund?

Të gjithë këta faktorë të rëndësishëm për mbijetesën e Kosovës do të ishin periferikë kundruall luhatjeve të identitetit, të cilat u imponuan pikërisht me idenë se projekti duhej të çohet deri në fund. Dikush e perceptoi pavarësinë si projekt ideal dhe çështjen identitare e konsideroi ndihmë për ta arritur sa më lehtë këtë idealitet. Por, në të vërtetë, shpejt do të vërehet se çështjet e identitetit nuk u hapën për idealizëm të atyre që u mrekulluan me pavarësinë, por për ta bërë më të lehtë shkërmoqjen e Kosovës, ose pamundësinë e bërjes së saj. E zëmë se ky është konspiracion dhe se buron nga një paranojë kolektive ose individuale e shqiptarëve të Kosovës nga Serbia. Atëherë le të themi pak më ndryshe, se “gota nuk është gjysmë e zbrazët, por është përgjysmë plot” dhe këtë “prirje mohuese” le ta kthejmë në “mendim pozitiv”. Në një rrethanë të këtillë, identiteti i rikompozuar kosovar do të ishte i vetmi garantues se Kosova e pavarur, se shteti i Kosovës nuk është *zgjidhje kalimtare*, por një zgjidhje e qëndrueshme, pra e përhershme. Kjo është ajo pika më e ndjeshme, aty ku Kosova reale, Kosova e sotme ballafaqohet jo më me historinë, me të shkuarën e saj iluzioniste, por me të sotmen dhe me të ardhmen. Një identitet i ndarë i Kosovës, një identitet i ribërë i Kosovës, për çfarëdo qëllimi dhe për çfarëdo motivi, mund të zëvendësojë mijëra trupa të NATO-s, për ta mbajtur Kosovën larg Shqipërisë. Një identitet i ribërë i Kosovës është e vetmja garanci se Kosova

do të ketë një pozicion të ndërmjetëm, një *pozitë neutrale* ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë.

Thënë me një fjalë, shikuar nga ky kontekst, identiteti kosovar ishte një urgjencë politike, që nuk ka asgjë të përbashkët as me historinë dhe as me teorinë për kombe të reja dhe gjepura të kësaj natyre. Bashkësisë ndërkombëtare vendimmarrëse, veçmas Europës së vjetër, i duhet qëndrueshmëria në rajon, përmes ruajtjes së baraspeshës. Shteti i Kosovës është faktor i rëndësishëm në këtë qëndrueshmëri dhe vetë ky shtet e ruan këtë qëndrueshmëri nëse në betejën ndërmjet integralizmit dhe indipendentizmit fiton ideja e indipendentizmit. Identiteti i ribërë i Kosovës, përfshirë këtu edhe bërjen eventuale të kombit kosovar, nuk është indipendentizëm vetëm si i tillë, por është një instrument në funksion të indipendentizmit dhe, në të njëjtën kohë, instrument kundër integralizmit shqiptar. Argumentet historike këtu nuk hyjnë në punë, ose, thënë më mirë, shpesh keqpërdoren ose deformohen, vetëm sa për ta përlligjur pragmatizmin politik.

Ta zëmë, askund nuk gjen bazë historike bërja e kombit kosovar, sepse, sikundër e kemi thënë, Kosova ka marrë pjesë aktive në të gjitha ngjarjet që e kanë bërë kombin shqiptar, duke filluar nga Lidhja e Prizrenit e deri te shpallja e pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë proces, por edhe në zhvillimet e mëvonshme, Kosova nuk ka mundur të veprojë e ndarë, që domethënë se nuk është diferencuar në asnjë pikëpamje nga pjesa tjetër e kombit. Edhe potenciali i saj ka qenë i vogël për të bërë një diferencim të tillë. Më anë tjetër, krejt procesi historik i ndërtimit të identitetit të saj shqiptar është zhvilluar në një varshmëri të thellë nga Shqipëria dhe nga idetë integraliste që vinin andej. Vetë bërja e Kosovës së pavarur, e Kosovës së lirë nga Serbia, është rezultat i drejtpërdrejtë i identitetit të saj të fuqishëm shqiptar. Kosova

nuk do të bënte luftë, po të mos ishte shqiptare. Në luftën e fundit, por edhe më herët, askush në Kosovë nuk do të vritej me idenë e *kosovarizms*. Të gjithë ranë dhe u sakrifikuan me idenë e *shqiptarizms*.

Të gjitha këto janë të njohura dhe të ditura, pavarësisht nëse thuhet ose jo, pavarësisht nëse theksohen ose jo. Ajo që nuk thuhet, ka qenë dhe vazhdon të mbetet një kapje peng e shqiptarëve të Kosovës ndërmjet shumë pamundësive. Ata e deshën Kosovën të bashkuar me Shqipërinë, por nuk e bënë dot. E supozojmë se, në pamundësi për ta bërë siç e deshën në fillim, ata e deshën edhe shtetin e Kosovës. Por prapë ata u ballafaquan me pamundësinë e bërjes së tij. Gënjejnë ata që thonë se Kosova e do flamurin e saj dhe nuk e do flamurin kombëtar. Flamuri i Kosovës dhe simbolet e tjera të saj, janë *pamundësia e afishuar* e Kosovës për t'i çuar zhvillimet politike në drejtimin që ajo e dëshironte. Pra, sipas kësaj ideje del se pavarësia është limiti maksimal i Kosovës, deri ku ajo, me ndihmën e aleatëve dhe të interesuarve të tjerë mund të arrinte, por më tej nuk bënte dot asnjë hap. Mbase pavarësia po, por jo çfarëdo pavarësie; mbase një flamur dhe himn më vete po, por jo çfarëdo himni dhe flamuri. Mbase shtet i qytetarëve të barabartë po, por jo shtet multietnik. Mbase shtet i varur nga bashkësia ndërkombëtare po, siç janë të varur shumica e shteteve në botën e sotme, por jo një varshmëri e tillë, që e bën një gjuhë të huaj gjuhë supreme, me të cilën duhet të matet saktësia e secilit kuptim. Mbase po një shtet që do të kishte marrëdhënie të mira me Serbinë, por jo duke ia detashuar Serbisë deri edhe të drejtën për ta shantazhuar shtetin dhe për ta rrënuar atë.

Pra, suaza reale e bërjes së Kosovës nuk ka qenë kjo. Suaza reale e bërjes së saj ka qenë më e avancuar, përfshirë edhe kompromiset e domosdoshme me faktorët

vendimmarrës. Pakoja e Ahtisaarit në shumë pika ka mundur të korrigojohet, sikur faktori politik i Kosovës të ishte më konsistent. Decentralizimi do të bëhej, por jo duke iu dhënë status të veçantë edhe një fshati të Rahovecit me 500 banorë serb. Flamuri ka mundur të bëhet më mirë, duke respektuar edhe veçantinë e Kosovës, por edhe identitetin e saj themelor. Himni gjithashtu. Kushtetuta e Kosovës ka mundur të bëhet më e mirë, nga kjo që është tani, një tekst evaziv, me dualizma dhe me zgjidhje që paragjykojnë sovranitetin e luhatshëm. Të gjitha këto së bashku nuk do të nxirrnin në sipërfaqe kërkesën rrënimtare për identitet të ri të Kosovës, për komb kosovar dhe ngatërresa të tilla, duke bërë që ky identitet i ri dhe ky komb kosovar të bëhet alibi për projekte shkatërruese, ose strehë për profiterët me emblemën e BE-së; për spiunët e Serbisë, të hershëm dhe të vonë; për nostalgjikët jugosllavë dhe trashëgimtarët e tyre biologjikë dhe botëkuptimorë; për kontrabandistët dhe trafikantët e të gjitha mallrave dhe të gjitha vlerave; pra, për gjithë këtë shumësi horrash, që tashmë kanë zënë vend dhe përbëjnë hierarkinë shoqërore në hapësirën e ngushtë të Kosovës.

Braktisja e idealeve

Natyrisht, do të ishte tepër e pandershme nëse nga synimi për të bërë identitetin kosovar hiqet pjesëmarrja e idealistëve, të cilët, për shkaqe dhe arsye krejtësisht të ndryshme, mund të krijohet përshtypja e gabuar se qëndrojnë në të njëjtën radhë me përfituesit e pavarësisë, të shtetit të Kosovës dhe të identitetit të mëvetësishëm kosovar, apo me proserbët ende të fshehtë ose me

nostalgjikët jugosllavë gjithnjë e më të zëshëm. Është paradoksale që të tri këto kategori njerëzish në Kosovë, për shkaqe rrethanash, të gjenden në të njëjtën radhë, tashmë jo si indipendentistë të njëmendët (sepse të tillë ka më shumë), pra që i lidh ideja e përbashkët e pavarësisë së Kosovës, por më shumë si *kujdestarë shpirtërorë* të kësaj pavarësie. Nuk do mend, si çdoherë tjetër, idealistët janë krijesat më fatkëqija dhe tragjikët më të mëdhenj të këtij procesi të ngatërruar dhe kontradiktor. Ata vërtet e shohin ëndërr Kosovën si shtet europian, të zhvilluar ekonomikisht, me institucione demokratike, me liri dhe të drejta të njeriut, me barazi të qytetarëve, me një sundim shembullor të rendit dhe ligjit, pra një shtet ideal, që ta mbush kraharorin me ëndje, teksa e mendon. Unë nuk them se nuk ka idealistë të këtillë dhe nuk them se në Kosovë nuk ka njerëz që besojnë sinqerisht në këto ideale. Por një pjesë e tyre, pjesa më e madhe, nuk janë krejt naivë, si të gjithë idealistët, ngase të angazhohesh për një Kosovë të tillë në rrethanat e tanishme nuk është se nuk shpaguhet. Madje, ky idealizëm ndonjëherë mund të konvertohet shumë shpejt në fonde të vjela nga BE-ja, nga Komisioni Europian ose nga dikush i ngjashëm me të.

Por edhe përtej këtij idealizmi që shpaguhet, duhet besuar se ka idealistë të njëmendët, të cilët bëjnë e Kosovës europiane e ndjejnë si imanencë të qenësishme, pra as gënjeshtër, as pozë, as përfitim, por ideal të njëmendët. Sado që është e tytmë, një ëndërr të tillë duhet respektuar, sepse e drejta për të ëndërruar idealën, e drejta për të synuar idealën, e drejta për të pasur qëllim idealën nuk mund t'i mohohet askujt. Madje është e këndshme dhe të bën të ndjehesh mirë, kur e di se ky idealitet lidhet me Kosovë, me ëndrën tonë të gjithmonshme, njësoj sikundër që duhet besuar se nuk mund të ketë ndodhur që Kosovën ta ketë braktisur përfundimisht krejt soji njerëzor i idealistëve,

sepse bërija e saj, që nga mbijetesa e deri te zgjidhja e fundit politike, qoftë ose jo përfundimtare, iu referohet pikërisht *idealistëve*. Situatën do të duhej konsideruar si një qëndrim pezull, si një ngecje të përkohshme, si një hutim të shqiptarëve të Kosovës pas mrekullisë së lirisë, e cila sikur ende i mban ata në një ëndërr të stërzgjatur, ose më keq se kaq, një mrekulli që ua ka nxitur pasionet dhe ua ka zhbërë racionalitetin.

Thënë me një fjalë, nuk duhet mohuar se idealistët, sado të paktë që mund të jenë, mund ta kenë menduar bërjen e identitetit kosovar si një rrugë që më shpejt dhe më lehtë e çon Kosovën drejt integriteteve europiane, drejt pranimit dhe faktorizimit të saj ndërkombëtar, sepse, sipas bindjes së tyre, një ndarje identitare e Kosovës nga pjesa tjetër e botës shqiptare, duke pasur edhe mbështetjen e disa fuqive vendimmarrëse, heq përfundimisht embargon mbi shqiptarët si potencial rrënimtar ose plangprishës në Ballkan dhe krijon pozicion të përshtatshëm të Kosovës për integrim të suksesshëm. Sepse, sipas bindjes së tyre, një Kosovë me identitet të diferencuar i tejkalon lehtë pengesat e trashëguara, heq dyshimet rreth fantazmës së "Shqipërisë së Madhe" dhe bëhet më e akceptueshme, madje më e përshtatshme për Serbinë e frustruar dhe aleatët e saj. Thënë ndryshe, bëhet fjalë për një *opsion zbutës* për Kosovën dhe shqiptarët nacionalistë, të cilët, të bashkuar ose të integruar ndërvetshëm, i frikësuakan fqinjët e tyre dhe Europën që i mbështet ata. Ky integrim i ndërvetshëm i shqiptarëve veçmas paraqitet problematik në funksionimin e boshtit tradicional ballkanik veri-jug, duke përfshirë këtu edhe interesat e Rusisë, sikundër edhe të disa fuqive evropiane, të cilat tashmë janë deklaruar se mbështesin ruajtjen e status quo-s tradicionale në këtë rajon të trazuar të Europës.

Teoritë se Kosova edhe pas vitit 1999 u gjend në vëmendje të fuqive vendimmarrëse nuk duhet injoruar në tërësi, sikundër që nuk duhet dhënë aq shumë prioritet. E vërtetë është se Kosova pat rëndësi për rikonfigurimin e Ballkanit pas luftërave të përgjakshme, por faktorët e implikuar nuk lejuan që të krijohet një drejtpeshim përmes trinitetit Serbia-Shqipëria-Kosova në mes, duke mbajtur qëndrimin se çështja e Kosovës lidhej kryekëput me Serbinë dhe nuk kishte të bënte fare me Shqipërinë. Edhe kosovarëve indipendentistë duket se iu pëlqeu një këndvështrim i këtillë, sepse, në rend të parë, ua përkëdhelte sedrën politike, duke i faktorizuar ndjeshëm dhe duke i vënë si të barabartë kundruall Serbisë. Më anë tjetër, mbështetur në një përvojë historike dhe në disa situata jo shumë fatlume, te kosovarët tashmë ishte ngulitur një mosbesim ndaj Shqipërisë në raport me Serbinë. Herën e parë, Shqipëria monarkiste e kohës së Zogut nuk e kishte pasur për gjë që, për interesa të pushtetit, ta tradhtonte Kosovën me lehtësinë e një loje fëmijësh. Këtë e kishin përsëritur, po me kaq lehtësi, edhe Shqipëria komuniste e Enver Hoxhës. Nuk kishte asnjë arsye që, po ta shihnin të nevojshme, këtë mos ta bënë edhe pushtetarët e Shqipërisë demokratike. Prandaj, heqja e Shqipërisë si palë e interesuar në përballje me Serbinë u mbështet nga indipendentistët kosovarë, pavarësisht se mund të mos i kishte pyetur njeri për këtë. Mbi të gjitha, një përballje e këtillë e Kosovës vetëm për vetëm me Serbinë fuqizonte opsionin e pavarësisë së Kosovës, sikundër që, deri diku, hiqte dilemat e ndarjes së Kosovës dhe krijonte përshtypjen se mënjanimi i fantazmës së "Shqipërisë së Madhe" ua lehtësonte punën jashtëzakonisht shumë aleatëve të saj, në përballje me atë pjesë të botës që kundërshtonte pavarësinë.

Mirëpo, sikundër që do të dalë më vonë, mënjanimi i Shqipërisë nga procesi i bërjes së shtetit të Kosovës dhe lënia e Kosovës vetëm për vetëm përball Serbisë, me aleatët e besueshëm në krah, vetvetiu do të krijojë një ç'balancim politik, i cili gradualisht do të shndërrohet në dokumente dhe drafte me koncesione të mëdha ndaj Serbisë, pa një palë të tretë që do të mund të drejtpeshonte në një përballje të këtillë. Sikundër që do të shihet, mënjanimi i Shqipërisë nga i tërë procesi i bërjes së Kosovës dhe mbështetja pa rezervë e kësaj ideje nga indipendentistët kosovarë, teorikisht do ta përjashtojë idenë e ndarjes së Kosovës, por praktikisht do ta lërë të hapur këtë çështje, qoftë si kalkulim eventual politik i Serbisë, qoftë si opsion real në shumë kancelari ndërkombëtare. Së këndejmi, në këtë histori të re Shqipëria nuk u bë faktor i bërjes apo i ruajtjes së Kosovës. Kjo ia lehtësoi punën Shqipërisë, e cila tashmë ka krijuar një komoditet të panatyrshëm në raport me Kosovën, duket edhe me arsyetimin se edhe vetë kosovarët e mbështetën një rol të këtillë të Shqipërisë. Rolin e ruajtjes së tërësisë së Kosovës, në një mënyrë gati të panatyrshme, e morën dhe vazhdojnë ta mbajnë shqiptarët e Maqedonisë.

Pra indipendentistët kosovarë, ose idealistët indipendentistë, t'i quajmë kështu, duke mënjanuar Shqipërinë si palë me Kosovën në përballje me Serbinë e bënë një dëm që vështirë do të riparohet ndonjëherë. Ky gabim edhe mund të falet, nëse dëmi u bë për shkak të idealizimës. Por historikisht do të jetë e pafalshme nëse idealizmi i kryehershëm tashmë është braktisur dhe ideja e pavarësisë, pra idealizmi indipendentist rrëshqet në pragmatizëm. Në të vërtetë, pavarësia e Kosovës është idealitet dhe ajo e tillë mund të mbetet, tani dhe gjithmonë. Të bësh një Kosovë të pavarur, një shtet europian, të zhvilluar dhe të denjë për jetën e njerëzve, mund të jetë një

ëndërr për të gjithë. Mirëpo, nëse mbi këtë idealizëm bëhen kalkulime të tjera, idealistët kosovarë, sado të paktë që mund të jenë, i bën mashtrues dhe hipokritë të pafalshëm. Me një fjalë, ideja e bërjes së Kosovës shtet europian është ide fisnike, por nëse këtë ide duhet “plotësuar” me koncesionin e identitetit, atëherë del se idealistët realisht asnjëherë nuk kanë qenë të tillë, por kanë qenë djaj të përbindshëm, të cilët e manipuluan besimin me pamjen e tyre prej engjëjsh.

Separatizmi identitar

U morëm pak më gjatë me kategorinë e idealistëve indipedentistë, për t’i diferencuar më qartë nga kategoritë e tjera të mbështetësve të identitetit kosovar, sepse ata, me vetë faktin e të qenit idealistë dhe me faktin se bërja e Kosovës ka qenë produkt i idealistëve, e meritojnë një diferencim të këtillë. Megjithatë, sikundër e thamë, angazhimet e idealistëve, në një situatë të konfuzionit të përgjithshëm, do të ngatërrohen pa ndonjë vështirësi me paradoksin e të gjendurit në të njëjtën radhë pikërisht me ata që përbëjnë *antipodin* e këtij idealizmi. Në këtë mënyrë, mbështetës të flaktë të identitetit kosovar do të bëhen edhe përfituesit e ndryshëm dhe ata që i quajtmë nostalgjikë të ish-Jugosllavisë, ose, që të jemi më eksplikitë, prosërbët e të gjitha angazhimeve, të fshehta dhe gjysmë publike. Të dy këto kategori duhet kundruar nga afër, për të parë prapavijën e angazhimit të tyre për identitetin kosovar dhe për t’i identifikuar qartë si kundërshtarë të mëdhenj të integralizmit shqiptar.

Në këtë kuadër, së pari duhet bërë të qartë se ideja e inegralizmit shqiptar, vetëm si e tillë, nuk është dhe nuk mund të jetë ide antieuropiane, as ide nacionaliste, aq më pak ide shoviniste. Ajo përfaqëson vazhdimësinë e identitetit shqiptar pa kufizime kohore dhe hapësinore, që domethënë një identitet shqiptar mbipolitik. Integralizmi shqiptar, pra *ideja e të qenit njësh* nuk është ide manipulative, është gjendje reale. Shqiptarët janë njësh jo pse ata duan të jenë të tillë, por ngase kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të tillë të shtrënguar nga rrethanat. Të qenit njësh dhe në njëfarë shkalle i diferencuar nga *të tjerët* nuk është zgjedhje, është imanencë, është fat historik, është fat njerëzor. Derivatet e nacionalizimit dhe të shovinizmit nuk lindin nga kjo ide. Ato lindin nga ideja e përjashtimit. Më anë tjetër, nëse një grup shqiptarësh duan të ndahen nga pjesa tjetër e shqiptarëve, për këtë ide mund të kenë tre motive: ose kanë interesa tepër specifike, ose duan të tradhtojnë, ose duan të bëhen *mbikomb*, pra një surrogat fashist. Sikundër që është vërejtur gjatë kësaj periudhe, në diskutimet për identitetin kosovar, nga të dyja palët, nga mbështetësit dhe nga kundërshtarët, jo rrallë janë hedhur në qarkullim edhe ide fashiste, ose ide të një shovinizmi brendashqiptar, duke i diferencuar pjesët e kombit njërën më *cilësore* se tjetrën. Ndërkaq, duhet pasur të qartë se identiteti nuk është vetë itegralizmi, por është komponentë themelore e tij. Në rastin tonë, diferencimet e identitetit brenda një kombi vetvetiu prodhojnë dekompozim, shpërbërje, shthurje, sepse mbajtja e *kohezionit kombëtar* nuk bëhet vetëm për ide patriotike ose nacionaliste, por më shumë për nevoja reale dhe interesa tokësore.

Atëherë, nëse integralizmit shqiptar ia njohim dobësitë dhe përparësitë; nëse identitetit shqiptar si përbërës fundamental i integralizimit shqiptar gjithashtu ia njohim

dobësitë dhe përparësitë, nuk ka asnjë arsye që edhe për tendencat e kundërta të mos shprehemi me të njëjtën konsideratë. Bie fjala, nëse themi zëshëm se në rrethanat e Kosovës identiteti shqiptar prodhon negativitete, se prodhon nacionalizëm konfliktual, se prodhon ambicie shoviniste për "Shqipërinë e Madhe" etj., atëherë nuk kemi asnjë arsye që po kaq zëshëm të themi se, më anë tjetër, edhe stisja e identitetit kosovar ndonjëherë prodhon fashizëm brendashqiptar, herë të tjera tradhti dhe, në rastin e tretë, mercenarizëm politik, në rastin e katër diçka edhe më të zezë, e kështu me radhë. Nëse tashmë e kemi thënë zëshëm dhe e përsërisim jo rrallë se patriotizmi folklorik shqiptar është strehë e horrave dhe matrapazëve të të gjitha llojeve, atëherë nuk ka asnjë arsye të mos pohojmë gjithashtu se *separatizmi identitar kosovar* është keqpërdoruesi dhe shkatërruesi më i madh i idesë së shtetit të Kosovës. Sepse, nëse për kategorinë e turbo-patriotëve shqiptarë nuk mbeti asnjë shenjtëri që të mos keqpërdorej për interesa mesquine, është krejt e logjikshme që edhe bërësit e identitetit kosovar e keqpërdorën deri në tradhti idealin e bërjes së Kosovës. Nuk ekziston ndonjë arsye madhore që dikush të amnistohet as në këtë rast.

Megjithatë, nga ky nivel i pasioneve, gjërat duhet zbritur në një rrafsh më real. Të provojmë të shohim tani më nga afër se cilët janë ata që e kanë prodhuar dhe që e mbështesin identitetin kosovar. Deri këtu kemi përmendur disa kategori njerëzish, kategori sociale dhe politike, të cilët për një arsye ose për një tjetër bënë përpjekje t'i diferencojnë kosovarët nga pjesa tjetër e shqiptarëve. Pra, nga njëra anë ata u paraqiten si *dashës* të mëdhenj të Kosovës, ndërsa nga ana tjetër u përpoqën me të gjitha mjetet të rrënonin njësinë kombëtare shqiptare. E zëmë se jo të gjithë, derisa angazhoheshin për kosovarizëm, e dinin se me këto ide janë

kthyer në rrënues të tërësisë kombëtare shqiptare. Disa syresh këtë e motivonin me rrethanat ndërkombëtare, pra me kërkesat e një pjese të bashkësisë ndërkombëtare, që bërija e shtetit të Kosovës të mos jetë një akt nacionalist shqiptar i tipit të bërijes së Shqipërisë në fillim të shekullit XX, por një akt modern, me referenca politike bashkëkohore. Pjesa tjetër ishin të bindur, madje disa syresh ende vazhdojnë ta ruajnë këtë bindje, se bërija e shtetit të Kosovës në mënyrë të natyrshme duhet të shoqërohet me bërijen e një *kombi-shtet*, i ndarë në shumë pika identitare jo vetëm nga pjesa tjetër e kombit shqiptar, por edhe nga idetë integraliste. Të tretët mendojnë se kosovarët, për shkak të historisë dhe të politikës tashmë janë diferencuar vetvetiu brenda etnisë shqiptare, se etnia është një tërësi më e gjerë, ndërsa kombi është nëndegëzim brenda kësaj etnie. Të katërtët refuzimin e Shqipërisë kundrejt Kosovës, me bazë historike, kulturore dhe politike, e panë si pengesë të pakapërcyeshme të funksionimit të tërësisë shqiptare, prandaj menduan se zgjidhja e vetme mbetej bërija identitetit kosovar dhe, gradualisht, edhe të kombit kosovar. Të pestët, nën trysinë e një pjese të bashkësisë ndërkombëtare, e perceptuan Kosovën si një *gjendje të ndërmjetme*, një territor i ndarë dhe i diferencuar, një identitet gjithashtu i ndarë dhe i diferencuar, i cili rri diku në mes, ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, që domethënë se është etni shqiptare, por me një ndikim të fuqishëm të Serbisë brenda përbërësve të saj të identitetit, diçka si Moldavia që rrinte dhe vazhdon të rrijë ndërmjet Rumanisë dhe Ruisë. Të gjashtë, veçmas një pjesë e klasës politike e cila u popullarizua gjatë viteve '90, e perceptoi Kosovën si një *principatë mesjetare*, ku princi kishte një suitë, një oborr, një pallat dhe jetonte në iluzione se tashmë e kishte bërë shtetin e Kosovës. Të shtatët, pas luftës së fundit, panë se Kosova e vogël mund t'i plotësojë kërkesat themelore të pushtetit, duke ofruar kuadër të

mjaftueshëm për një *pashallëk anadollak*, ku mund të sundohet, ku mund të abuzohet, ku mund të bëhesh i pasur, ku mund të vidhet, ku mund të merresh me krim të organizuar, ku mund të manipulosh çdo shenjtëri për interesa mesquine. Të tetët, me sensin e jashtëzakonshëm të nuhatjes së prirjeve të një pjese të bashkësisë ndërkombëtare që mbështeste Serbinë dhe që kishte të ngulitur idenë se Kosova duhej të rrinte në mes, në mënyrë që të mos prishte drejtpeshimin ballkanik, bërjen e identitetit kosovar e panë si mundësi për vjelje fondesh dhe tani ata janë përfitues të mëdhenj që ua ofron kosovarizma. Të nëntët, të stigmatizuar si bashkëpunëtorë të hapur ose të fshehtë të Serbisë, ose si trashëgimtarë të damkosur të atyre që kanë bashkëpunuar me Serbinë, në identitetin kosovar gjejnë nëse jo alibinë e plotë për veprimet antikombëtare të bëra në kohë të ndryshme, atëherë gjithsesi një azil sadopak të qetë; nëse jo mundësinë për rikuperim, atëherë gjithsesi shansin jetësor për rehabilitim...

Atëherë, nëse kaq shumë kategori të qytetarëve të Kosovës kanë interesa që të konsolidohet identiteti kosovar dhe më pas të bëhet edhe kombi me këtë paradigmë, fitohet përshtypja se ky proces jo që nuk mund të ndalet, por tashmë mund të konsiderohet i përfunduar, sepse na qenkësh vullnet pothuajse plebishitar i popullit të Kosovës. Por a është kështu? Në asnjë mënyrë, në asnjë rrethanë. Të gjitha këto kategori që i përmendëm më sipër, jo vetëm që nuk përbëjnë një shumicë në Kosovë, por numerikisht janë pakicë krejtësisht marginale. Ata janë të identifikueshëm dhe kanë medialitet, interesat e tyre janë të tejpashme dhe nuk gëzojnë një mbështetje të gjerë në Kosovë. Në të vërtetë, në rrethanat tona duhet bërë një diferencim të qartë ndërmjet idealit kombëtar, ku tashmë është përfshirë edhe bërja e shtetit të Kosovës, dhe deformimeve politike,

ideologjike, botëkuptimore dhe të tjera që e kanë përcjellë dhe vazhdojnë ta ndjekin këtë proces. Ideali i bërjes së Kosovës i ka mundur dhe i ka arsyetuar të gjitha. Ideali i bërjes së Kosovës u ka krijuar alibi edhe keqpërdoruesve më të mëdhenj të kësaj ideje dhe të këtij ideali. Liria dhe bërja e Kosovës fsheh me lehtësi edhe keqpërdoruesin e pushtetit, edhe spiunin, edhe kriminelin, sikundër që neutralizon dhe e bën të paidentifikueshëm patriotin e madh, njeriun e sakrificës, mendjen e ndritur, të gjithë këta të lënë në margjinë për shkak të zallamahisë së përgjithshme dhe mungesës së rendit të vlerave.

Mesazhet negative

Sikundër e thamë më sipër, Kosova ishte projekt i idealistëve shqiptarë, përpara se të bëhej projekt i bashkësisë ndërkombëtare. Ajo, krahas arritjeve të pamohueshme, kishte dhe vazhdon të ketë dështimet e saj. Ka qenë e pritshme që një numër deformimesh të shfaqeshin përgjatë gjithë procesit të bërjes së Kosovës, sepse vetë procesi ishte shumë i ngatërruar, shpesh kontradiktor dhe me ndërhyrje nga të gjitha anët. Vetë shqiptarët e Kosovës duhej të ishin qenie të mbinatyrshme që të mos binin pre e sfidave të llojllojshme, të ngasjeve dhe grackave të ndryshme, të shitjeve dhe blerjeve, të ofertave të leverdishme dhe mundësive pa fund për të deformuar procesin. Fazën e idealizmit e karakterizoi një homogjenizim i paparë i shqiptarëve të Kosovës. Dihej se kjo nuk mund të ishte gjendje reale, sepse çarjet do të ndodhnin, së pari në vetëdije, në kontakcionin psikologjik dhe emocional të individëve dhe të kolektivitetit, pastaj edhe në veprimet e tyre praktike.

Dikush kishte vuajtur burgjeve dhe donte kompensim moral dhe material për atë që kishte bërë. Dikush kishte luftuar dhe tani donte kompensim moral dhe material për sakrificën e tij. Dikush kishte tradhtuar dhe donte të mos quhej i tillë. Dikush kishte qëndruar anash dhe kërkonte çastin e volitshëm që të futej në valle. Dikush kishte qenë i shtypur dhe te liria dhe shteti i Kosovës kërkonte status të ndryshuar social. Dikush kishte qenë i privilegjuar dhe këto privilegje kërkonte t'i ruante edhe më tej. Dikush kishte luftuar për interesa mesquine, dikush për ideale, por erdh një çast kur palët u barazuan, madje kërkonin t'ia zinte vendin njëra-tjetrës. Vetë historia më e re e Kosovës kishte predispozita të jashtëzakonshme që patrioti dhe tradhtari shpesh t'i ndërronin vendet.

Mbi të gjitha, Kosova e kishte përjetuar një fazë të zgjimit dhe të ngritjes kombëtare në kohën e komunizmit, një lloj dyzimi ndërmjet nacional-komunizmit shqiptar dhe të socializmit vetëqeverisës jugosllav. Trashëgiminë e saj patriotike e pretendojnë të dyja palët, edhe ata që ishin viktima dhe ideologjinë komuniste marksiste-leniniste të Partisë së Punës së Shqipërisë e përvetësuan si alibi për bëma patriotike; sikundër edhe persekutorët e tyre, të cilët nacionalistët i luftuan me të gjitha mjetet, i dënuan, i vranë dhe i burgosën në emër të jugosllavizmës, por, më anë tjetër, bënë autonominë e Kosovës, bënë institucionet, bënë një kuadër politik, ku pat mundësi të zhvillohej integralizmi shqiptar. Tani së voni del një palë e tretë, e cila e mohon edhe njëherë, edhe tjetrën, sepse të dy palët paskëshin qenë komunistë dhe se kjo ideologji në esencën e saj ishte antikombëtare. Më anë tjetër, një pjesë e antikomunistëve shqiptarë, pra edhe ata kosovarë, kishin degraduar në fashistë. Ose mund të mos kishin qenë të tillë, por ata e

kishin humbur luftën dhe për një kohë të gjatë nuk arritën të luanin asnjë rol në bërjen dhe ribërjen e Kosovës.

Pra, është shumë e vështirë që të ndërtohet një *Kosovë ideale* mbi kontradikta të këtilla. Nuk qëndron ideja se të gjithë shqiptarët e Kosovës kanë qenë bashkëvuajtës dhe bashkëfajtorë dhe se bërja e *paqes shoqërore*, duke lënë në harresë të shkuarën nuk paraqitet si opsion real i zgjidhjes së ndonjë problemi. Kjo nuk ka ndodhur askund dhe Kosova nuk përbën ndonjë përjashtim. Çështjet duhet të sqarohen, të zbardhet roli i secilit, sepse në të kundërtën, nëse vazhdohet për një kohë të gjatë të jetohet mbi kundërshti të këtilla, Kosova humb vlerën më të çmuar që ka, *idealizmin*. Pikërisht, idealizmi i shqiptarit të Kosovës është në krizë të madhe, për shkak të një ngatërrese që ka ndodhur në sistemin e vlerave dhe në rrafshimin ose zëvendësimin e vlerave me antipodin e tyre, pra me antivlera, ose me shkëmbim vendesh, ose me shndërrime të pamundshme. Ideja se Kosova ka jetuar mbi kontradikta të mëdha dhe, si e tillë, duhet ta tejkalojë këtë situatë me një *harmonimbihistorike* nuk mund të qëndrojë, sepse lëndon shumë viktimat e një përpjekjeje të gjatë me shumë rrëfenja tragjike, sikundër që mbyll të gjitha mundësitë që dikush të ndjekë rrugën e idealizmit, pra të bërjes së një Kosove pa ngasje negative.

Në një rrethanë të këtillë të kontradiktave të mëdha, Kosova nuk mund të kthehet prapa, që ta rifillojë procesin e ribërjes, por ajo duhet të fillojë procesin e diferencimit të vlerave nga antipodet e tyre. Ajo duhet të fillojë me historinë, veçmas nga Lufta e Dytë Botërore e prapa, duke qartësuar saktësisht përparësitë dhe dështimet. Themë nga Lufta e Dytë Botërore, sepse ndodhitë e kësaj periudhe kanë pasur reflektim të drejtpërdrejtë në zhvillimet politike në Kosovë. Kjo nuk bëhet për arsye akademike, por për shkak

të një pragmatizmi ekzistencial. Nga kjo distancë nuk është aq e vështirë të dihet se kush çfarë bëri në këto zhvillime, kush ishte vrasësi dhe kush ishte viktimi, kush i persekutuari dhe kush persekutori. Apo të arrihet një konsensus shoqëror, duke analizuar faktet, të dhënat, dokumentet, se Kosova, për shkak të specifikave, nuk mund të bëjë një diferencim të qartë të këtyre kundërshtive. Kjo vlen edhe për periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Duhet të sqarohen bëmat e të gjithëve, të nacionalistëve, të nacional-komunistëve, të komunistëve jugosllavë, të autonomistëve, të marksist-leninistëve, të spiunëve të ish-Jugosllavisë dhe të spiunëve të Shqipërisë, të atyre që e kanë pësuar për shkak të idesë së lirisë dhe të atyre që e kanë pësuar për shkak të ideologjisë. Askush nuk mund ta ruajë të paprekur e të pandotur idealin e Kosovës, kur, ta zëmë, në faqet e shtypit, ose në TV shfaqen spiunët ordinerë të UDB-së, ose edhe trashëgimtarët e tyre dhe thonë se ata patën rol të rëndësishëm në bërjen e Kosovës. Kjo, përveç që hedh baltë mbi historinë dhe fyen viktimat, e zhvlerëson idealin dhe përcjell një mesazh tepër kontradiktor, negativ, për të ardhmen e këtij vendi.

Dhe, pikërisht, janë mesazhet negative që vijnë nga të gjitha anët, të cilët e tronditën deri në themel idealin e Kosovës. Mesazhe të këtilla vijnë nga historia më e largët dhe nga historia më e afërt. Mesazhe të këtilla vijnë nga periudha e komunizmit, nga koha e socializmit jugosllav dhe nga koha e socializmit shqiptar. Vijnë edhe nga periudha e homogjenizimit të paparë të shqiptarëve të Kosovës të fundit të viteve '80 dhe fillimi i viteve '90, nga krejt periudha e të ashtuquajturës rezistencë paqësore, sikundër që vijnë edhe nga periudha e luftës së fundit dhe nga vitet e para pas saj. Mesazhe negative vijnë nga këto dhjetë vitet e lirisë, nga bëmat e të huajve dhe nga ata që

Kosovën e kishin atdhe të vetëm, pa një vend tjetër ku mund të futnin kokën. Kjo shumë e mesazheve negative është e jashtëzakonshme, e tillë që rrezikon çdo gjë në këtë vend, përfshirë edhe vlerat morale dhe idealin.

NË MBYLLJE

Një shekull më parë, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Konicës i atribuohet se kishte thënë: Shqipëria u bë, por u bë e tillë, që t'ua plaste zemrën atyre që e donin më së shumti. Në të vërtetë, duke parë zhvillimet e asaj periudhe dhe angazhimet e vetë Konicës në planin e brendshëm dhe të jashtëm (botimin e "Albania"-s me mbështetjen e Austro-Hungarisë, më vonë të Italisë; rreshtimin një herë në krah të Nolit kundër Zogut, pastaj në krah të Zogut kundër Nolit; deklarin kundër pushtimit italian më 1939, por dorëzimi i vulave dhe dokumenteve të legatës shqiptare asaj italiane në Uashington, kur Italia sulmoi Greqinë më 1941 etj.), duket se vetë bërësit e Shqipërisë, përfshirë edhe Konicën, ndiqeshin nga një fatalitet i përhershëm: që Shqipëria kurrë të mos i kënaqte shtetasit e saj dhe shtetasit e saj kurrë të mos e kënaqnin Shqipërinë. Kjo paradigmë e zyrtë, ky një si mallkim, nuk ishte e domosdoshme ta ndiqte prapa edhe bërjen e Kosovës, sepse përsëritja e vazhdueshme e historisë të shqiptarët, në variantin më negativ, tashmë duket si lojë cinike e fatit dhe e proveniencës qiellore.

Në të vërtetë, bota shqiptare, edhe në këtë çast, derisa bëjmë mbylljen e këtij libri, është e përfshirë nga zhvillime politike të nxitura dhe të shkaktuara nga fqinjët ballkanikë, të cilët nuk rreshtin së manifestuari agresivitet dhe ide shoviniste, si të mos ishte shekulli XXI, por koha e Paqes së Shën Stefanit apo e Kongresit të Berlinit, e luftërave

ballkanike ose e Luftës së Parë Botërore, aq të pashembullt dhe të paskrupullt që janë në antishqiptarizmin e tyre. Duket si një garë e fqinjëve, për të forcuar pozicionin e tyre në raport me shqiptarët, përpara se këto marrëdhënie “të ngrihen” me përfshirjen e rajonit në BE.

Kështu, Serbia, me mbështetjen e hapur të Rusisë dhe të mercenarëve të saj, si dhe me mbështetjen e kamufluar të disa vendeve të Bashkimit Europian, synon t’u sigurojë serbëve të veriut të Kosovës një autonomi territoriale, përpara se zyrtarisht të marrë statusin e vendit kandidat për në BE. Në krahun tjetër, Greqia, që dyzet vjet anëtare e BE-së, pasi i asimiloi arvanitasit deri në atë shkallë, sa t’i detyrojë ata ta shkruajnë gjuhën e tyre me alfabet grek (një shembull i këtillë nuk gjendet në Europën e vjetër) dhe ta quajnë veten joshqiptarë; pasi deklaroi dhe rideklaroi se nuk ekziston asnjë çështje çame, i kthehet Shqipërisë dhe herë i kërkon ujëra territoriale, herë i kërkon Korçën dhe herë të tjera gati gjysmën e Shqipërisë. Ndonëse në krizë të rëndë financiare, po kjo Greqi, me fondet e BE-së për rimëkëmbje ekonomike, vazhdon t’u japë dhjetëra mijë shqiptarëve pensione politike, që ata të ndryshojnë kombësi dhe të deklarohen grekë. Së fundi, ajo diktoi edhe mënyrën si do të bëhet regjistrimi i popullsisë gjatë kësaj vjeshte në Shqipëri.

Po në këtë kohë, fqinji lindor i shqiptarëve, shteti pa emër zyrtar, pra Maqedonia, që nga fillimi, që nga koha kur u bë shtet, zhvillon politika antishqiptare dhe, për të qenë ironia më e madhe, të gjitha qeveritë maqedone të kësaj periudhe i realizojnë projektet e tyre antishqiptare me ndihmën e partive politike shqiptare, herë të një krahu, herë të një krahu tjetër. Në vitin 2001, Maqedonia e humbi luftën me shqiptarët dhe tani, që nga Marrëveshja e Ohrit dhe prapa, duket sikur në mënyrë paradoksale shqiptarët janë

ata që e ruajnë Maqedoninë nga shpërbërja, ndërsa maqedonët synojnë prishin atë një orë e më parë. Disa liderë shqiptarë të Maqedonisë pretendojnë se kanë kapacitete intelektuale të rregullojnë çështjet e mbarë botës shqiptare, ndërkohë që është e njohur botërisht se e kanë shitur lëkurën të maqedonët për dy aspra, siç thuhet zakonisht. Si shpërblim për lojalitetin e shqiptarëve, nuk kalon pothuajse asnjë ditë që maqedonët, përmes mediejeve, botimeve, ose deklaratave zyrtare nuk hedhin në etër nga një fyerje raciste për shqiptarët.

As fqinjët e “e matanshëm” ballkanikë, Bullgaria, Rumania dhe Turqia, nuk kanë dëshmuar se i kanë moderuar qëndrimet recidiviste ndaj shqiptarëve. Kështu Bullgaria, pasi pretendon kulturën e Voskopojës si kulturë bullgare dhe pasi e ka manipuluar minoritetin sllav në Shqipërinë juglindore, së fundi u është kthyer goranëve të Kosovës dhe të tjerëve përreth tyre, të cilëve u jep shtetësi bullgare dhe pasaporta me lehtësi lëvizjeje në shtetet e BE-së. Po këtë e ka bërë edhe Rumania me arumunët e Shqipërisë, ndërsa në Kosovë duket se nuk ka ndonjë synim tjetër, përveç se ta shfrytëzojë BE-në për ta mbështetur Serbinë me të gjitha mjetet dhe, kur t’i jepet rasti, po me emblemën e BE-së, të rikthejë në Kosovë vrasësit e kryhershëm. Turqia, ndërkaq, duke qenë investitori më i madh i jashtëm në Kosovë, këtë pozicion është duke e shfrytëzuar në mënyrë jo aq miqësore, për t’i manipuluar minoritarët turq, kudo që gjendet një i tillë. Lojaliteti i pushtetarëve të Kosovës ndaj Turqisë ka bërë që pikërisht në kohën e regjistrimit të popullsisë, në krye të dikasterit që duhej ta udhëhiqte këtë proces vendosi një pjesëtar të kombësisë turke. Ndërkohë, Ministria e Administratës Publike e Kosovës, aty ku ministër është minoritari turk, hapi zyre të përkohshme për regjistrimin e turqve në Prizren

dhe rrethinë, duke sjellë në vëmendje të kosovarëve një kohë jo edhe aq të largët, kur regjistrimi i shqiptarëve të Kosovës si turq u shoqërua me zhvillime të tjera tragjike, për të cilat as Turqia e sotme dhe as turqit e Kosovës nuk do të duhej të ndiheshin krenarë.

(Si Shqipëria, si Kosova, një proces themelor për një shtet, siç është regjistrimi i popullsisë, e bëjnë me ndërhyrje të jashtme, ndërkohë që Maqedonia tashmë e ka shpallur jozyrtarisht si strategji afatgjatë zvogëlimin e numrit të shqiptarëve të atjeshëm. Është pak e çuditshme, një si marrëzi ballkanike, e cila jo rrallë përfshin edhe europianët, që të përdorën të gjitha mënyrat dhe mjetet për të zvogëluar sa të jetë e mundur numrin e shqiptarëve, kudo që janë ata, në Greqi, në Maqedoni, në Serbi, në Mal të Zi, madje edhe në Kosovë dhe Shqipëri. Ky është racizëm i hapur, që po ashtu nuk gjen një shembull të këtillë në Europë.)

Ndërkohë, kushtëzime kanë filluar të vijnë edhe nga Mali i Zi, i cili, pasi dëboi më shumë se gjysmën e popullsisë së vet shqiptare në Amerikë, tani, për vendosjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me Kosovën, sheh si pengesë mospërfshirjen e minoritetit malazias në Kushtetutën e Kosovës. Janë dhënë premtime se kjo do të ndodhë së shpejti, me rastin e ndryshimeve më të reja kushtetuese, ndërsa në këtë e sipër, në shembullin mëhershëm të Maqedonisë, Mali i Zi ka shtyrë kufirin për disa kilometër në brendësi të territorit të Kosovës, në Kullë dhe në Çakor, ose në zonat përreth, me idenë se të zhatësh një copë tokë nga një shtet në bërje e sipër, është një mund që shpaguhet.

Kjo përballje negative e botës shqiptare me fqinjët ballkanikë e bën të qartë se popujt e Ballkanit në raport me shqiptarët nuk e kanë ndryshuar mendësinë e vjetër, ndërsa integrimet europiane, me gjithë ikonografinë dhe

vokabularin e përdorur gjerësisht, këtu nuk përfytyrohen si ndryshime në konstalacionin botëkuptimor, por më shumë si një situatë e turbullt, e cila për disa krijon favore, kurse për disa të tjerë vazhdon të shkaktojë fatkeqësi. Shqiptarët, të përcopëzuar dhe të defaktorizuar siç paraqiten aktualisht, për shkak të obstrukcioneve të vazhdueshme dhe shpërndamësisë së madhe, e kanë shumë të vështirë që këto procese t'i kthejnë në favor të tyre. Duke mbetur të fundit që do të përfshihen në BE nga rajoni i Ballkanit (nëse BE-ja, ndërkohë, do t'u qëndrojë sfidave të njëpasnjëshme), duhet pritur se kushtëzimet dhe obstrukcionet e fqinjëve do të rriten dhe të shumëfishohen vazhdimisht.

Sekush mund të mendojë se kjo është njëllor ksenofobie, se ky është projeksion i errët i një realiteti që nuk është aq i zymtë, sepse bota shqiptare, realisht, asnjëherë nuk ka qenë në pozitë më të favorshme, ngase në Shqipëri vazhdojnë të ndodhin zhvillime shumë pozitive, se Kosova u bë shteti i dytë shqiptar në Ballkan dhe se shqiptarët e Maqedonisë janë faktorizuar aq sa Maqedonia nuk bën dot pa pjesëmarrjen e tyre në jetën institucionale. Mirëpo, edhe ky perceptim rozë e ka një të metë brenda: krijon një realitet jofunksional, i cili nuk i hyn në punë shumicës së shqiptarëve, përveç hedonistëve mendjelehtë, klasave politike dhe oligarkive ekonomike, apo strukturave mafioze, të cilat, për shkak të interesave meskine, të gjitha zhvillimet në botën shqiptare do t'i shohin me dioptrinë e shtrembër të *atdhengrënsve*. Për shkak të këtyre pjesëtarëve të deformuar të kombit apo etnisë, quajeni si të doni, ne jemi keq edhe me historinë, edhe me politikën, edhe me kulturën, edhe me identitetin, edhe me integritet, edhe me idealet e kryehershme, edhe me atdheun, edhe me patriotizmin, edhe me shqiptarizmin, edhe me kosovarizmin, pra me të gjitha. Mbajtja në jetë e "principatave" të paintegruara shqiptare

nuk mund të ketë ndonjë kuptim dhe funksion tjetër për rrethanat tona, përveç se të ushqyerit e bollshëm dhe të kënaqshëm të këtyre oligarkive lokale me politikë mediokre, me kulturë mediokre, me ekonomi informale, duke rrënuar njëkohësisht çdo sistem vlerash, të trashëguara ose bashkëkohore, dhe duke nëpërkëmbur pa asnjë konsideratë çdo shenjtëri. Në botën shqiptare të paintegruar ndërvetshëm, këto oligarki lokale jetojnë mirë, realisht ose me iluzione, pa u futur në asnjë konkurrencë.

Entuziazmi dhe krekosja e kryehershme se shqiptarët në fillim të shekullit XXI arritën të bënin edhe një shtet të ri në Ballkan duket se u zvjerdh shumë shpejt, sepse këto shtete shqiptare, dy e një çerek apo sa janë tani, për shumicën e shtetasve ose të qytetarëve të tyre nuk janë duke e kryer asnjë funksion si duhet. Ato nuk ngjajnë me shtete që iu shërbejnë qytetarëve, idealeve ose pragmatizmit të tyre, por janë instrumente në duart e keqpërdoruesve. Krijohet përshtypja se Shqipëria, ta zëmë, nuk është më vend ku qytetarët e saj projektojnë ëndrrat ose të ardhmen e tyre (ëndrrat dhe të ardhmen shqiptarët i projektojnë rrugëve të botës), ndërkohë që Shqipërinë e shohin si plaçkë, si objekt uzurpimesh dhe tregtish të pandershme. Duket sikur Shqipërinë nuk e do më njeri, përveç ndonjë kosovari të jashtëkohshëm, i cili nuk di se çfarë të bëjë me idealet e tij të dikurshme.

Edhe me Kosovën e njëjta gjë. Kujt i hyn në punë tani një Kosovë e mashtrimit lapidar, se liria e fituar me aq sakrifica paska ndonjë kuptim për shtetasit e saj? Për kosovarin e sotëm, për kosovarin idealist ose pragmatik, kuptimi i shtetit që nuk të jep mundësi për jetë të dinjitetshme është kuptim i degraduar, kuptim i braktisur ose kuptim i pagjetur. Gënjeshtër e kryehershme se kosovarët janë patriotë, janë atdhedashës nuk ua mbush

mendjen më as fëmijëve, të cilët ditë për ditë shohin prindërit e tyre sesi gënjejnë në emër të Kosovës, sesi abuzojnë në emër të Kosovës, sesi mashtrojnë në emër të Kosovës. Nga një ideal i dikurshëm, për të cilin njerëzit u sakrifikuan, për të cilin njerëzit vuajtën dhe e pësuan, Kosova është kthyer në objekt talljeje, përqeshjeje, fyerjeje, përuljeje, denigrimi. Një Kosovë e këtitillë, me ose pa identitet të mëvetësishëm, iu duhet dhe iu kryen shërbime të gjithëve, përveç atyre që e duan me të vërtetë.

Më anë tjetër, shqiptarët e Maqedonisë ende nuk e kanë zgjidhur çështjen elementare, nëse kanë ose jo atdhe, nëse kjo Maqedoni që i fyen, që i urren, që përpiqet t'i vrasë sa herë që mundet, arrin ta mbajë atributin e atdheut të shqiptarëve të atjeshëm. Kur ta zgjidhin këtë problem themelor, vetëm atëherë shqiptarët e Maqedonisë mund të nisin diskutimet për çështje më të holla politike ose identitare.

Ndërkohë, përveç se me sfidat e shumta të modernitetit, të integritimit, të dinamikës së ndryshimeve që kanë përfshirë botën, shqiptarët janë duke u përballur edhe me një sërë çështjesh të mbetura pezull që një kohë të gjatë. Në radhë të parë ata duhet të hapin diskutimin për potencialin e tyre, nëse kanë kapacitete politike, intelektuale, kulturore, nëse kanë dije dhe elita politike të përgatitura për të mbajtur dy shtete dhe për të participuar në mbajtjen e një shteti të tretë. Krahas kësaj, shqiptarët do të duhej të hapnin edhe një herë diskutimin për kombin dhe atdheun, për vlerat e trashëguara dhe për ato bashkëkohore, për moralin dhe për etikën, për erozionin e brendshëm dhe për raportet me botën bashkëkohore, sikundër edhe për një sërë çështjesh të tjera civilizuese, kulturore dhe identitare. Nga një diskutim i tillë nuk mund të përjashtohet askush, jo pse këto janë çështje që iu takojnë të gjithëve, por më shumë për faktin se

ridimensionimi i shqiptarizmës (si korpus vlerash) është e pamundur të bëhet pa një pjesëmarrje të gjerë dhe pa një konsensus parimesh. Kriza e tanishme e botës shqiptare është krizë e stërzgatur e vlerave, e kuptimit dhe e kriterëve për matjen e tyre.

Problemet e identitetit, me të cilat u morëm kësaj radhe, janë vetëm disa nga këto çështje, ndoshta nga më të rëndësishmet, për shkak se ato kanë reflektim të drejtpërdrejtë në zhvillimet aktuale. Shteti i Kosovës nuk është dhe nuk duhet të jetë përmendore, tek e cila vihen kurora në një datë të caktuar. Bërja e këtij shteti, pavarësisht nëse i kënaq ose jo ambiciet e shtetasve të tij, është rezultat i idealizmit shqiptar, i patriotizmit shqiptar, i identitetit të konsoliduar shqiptar. Shteti i Kosovës nuk bëhet më i qëndrueshëm, më i dashur për shtetasit e tij, nëse identitetit shqiptar, të cilit i detyrohet, i kundërvihet me një identitet të ri, të pakonsoliduar, siç është identiteti kosovar. Perceptimi dhe afishimi i identitetit kosovar jo si identitet lokal, por si kundërvënie ndaj identitetit shqiptar shkakton ndarje, përcopëzim dhe defaktorizim të potencialit shqiptar, i cili edhe më tej duhet të mbetet i qëndrueshëm, për shkak të agresivitetit recidivist të ballkanasve dhe keqkuptimeve të përsëritura të Europës së vjetër. Më anë tjetër, bërja e shtetit të Kosovës ka hapur shumë çështje, të cilat deri më tani nuk i kemi shqyrtuar dhe diskutuar. Mbi të gjitha, nuk e kemi diskutuar nëse ky shtet ka nevojë për dashje, nderim dhe respekt të qytetarëve të tij dhe nëse ai, që të marrë dashjen, nderimin dhe respektin e merituar, ka arritur t'i përmbush sadopak ëndrrat e shqiptarëve të Kosovës. Ne gjithashtu nuk kemi thënë asgjë për fundamentin e vlerave që duhet ta sigurojnë qëndrueshmërinë e këtij shteti dhe nëse këto vlera janë të mjaftueshme për të rikrijuar idealizmin tashmë të harruar dhe të braktisur pothuajse nga të gjithë.

Ne, gjithashtu, nuk kemi hapur një diskutim as me Shqipërinë, për të drejtat dhe obligimet e saj rreth Kosovës dhe shqiptarëve të tjerë, në shtetet fqinje apo gjetiu nëpër botë. Deri tani Shqipëria është mjaftuar të luajë një "rol konstruktiv" në raport me Kosovën dhe shqiptarët e Maqedonisë, rol që nënkuptonte harmonizimin e plotë të qëndrimeve të saj me bashkësinë vendimmarrëse ndërkombëtare. Ajo vetë pothuajse asnjëherë nuk mbajti qëndrim të pavarur për ndonjë çështjeje të hapur, përveç se u përpoq të ushtronte ndikimin e saj politik në profilizimin e skenës politike në Kosovë dhe Maqedoni, sipas shembullit të vet të përçarjes së thellë dhe konfliktit të vazhdueshëm. Abstenimi i Shqipërisë nga diskutimet për integrimet shqiptare, e aq më pak mosbërja e asnjë veprimi që do t'i nxiste këto integritime, nuk mund të quhet neglizhencë e thjeshtë dhe shkujdesje e zakonshme, por më shumë bëhet fjalë për një refuzim të qartë të Shqipërisë që në çfarëdo mënyre të përfshihet në këto procese. Prandaj diskutimet e filluara në Kosovë për bashkim kombëtar ose për krijimin e një shteti të përbashkët Shqipëri-Kosovë, pa përfshirjen e Shqipërisë në këtë diskutim, përveç që reflektojnë krizë të thellë politike në të cilën është përfshirë Kosova, flasin edhe për krizën e koncepteve dhe të vizionit politik për Kosovën, e cila tashmë ka filluar ta ndjejë në çdo hap zhgënjimin e madh, krahas shtrëngesave që vijnë nga bërja e shtetit me kushtëzime të shumta. Pra, ky diskutim është i kushtëzuar nga zhvillimet negative afatshkurta dhe nuk prihet nga një vizion i qartë politik i botës shqiptare.

Ndërkaq, çdo diskutim për integrimet shqiptare ose për çfarëdo forme të bashkimit kombëtar pa përfshirjen e Shqipërisë është i paqëndrueshëm, madje joserioz, jo pse Shqipëria realisht do të duhej të mbante çelësin e këtyre zhvillimeve, por ngase mospërfshirja e saj, njësoj si qëndrimi

i rezervuar ose abstenimi, përçon mesazhe jashtëzakonisht konfuze. Kosova mund të mos e pranojë paternalizmin e Shqipërisë në asnjë çështje me rëndësi të përbashkët, por duhet t'i marrë në konsideratë të gjitha përparësitë e Shqipërisë si gjendje dhe rrethanë krejt e natyrshme, e tillë që buron nga rendi logjik i gjërave. Fundja, nëse duan të bashkohen në një shtet Kosova dhe Shqipëria, emri i atij shteti kurrë nuk do të jetë Kosovë, kjo gjë është e ditur.

Ulpianë, pranverë-verë 2011

MEHMET KRAJA
IDENTITETI KOSOVAR

U shtyp në shtypshkronjën
PROGRAF
Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

